Hipoteza: Menaxhimi i mirë i disiplinës në klasë ndikon ndjeshëm në ngritjen e cilësisë në mësim.

Për realizimin e këtij studimi do të përdoren disa metoda si: Metoda e analizës teorike, Metoda e analizës së dokumentacionit, Metoda statistikore, Metoda e krahasimit.

Popullacionin e këtij hulumtimi e përbëjnë 187 mësimdhënës të shkollave të mesme të larta të Komunës së Malishevës, ndërsa grupin përfaqësues e përbëjnë 127 mësimdhënës.

Fjalët kyçe: *Menaxhim, disiplinë, cilësi, klasë, sukses, mësim.*

HYRJE

Mësimdhënia cilësore është domosdoshmëri për të gjithë mësimdhënësit, andaj për t'u arritur kjo duhet të kemi menaxhim të mirë të disiplinës në klasë.

Mësimdhënësve u nevojitet përvetësim permanent i njohurive adekuate për menaxhimin në përgjithësi e veçanarisht për menaxhimin e disiplinës në klasë si sfidë që është duke i përcjellur mësimdhënësit në përgjithësi.

Në funksion të menaxhimit të drejtë të disiplinës në klasë ekzistojnë rregullore të cilat janë në fuqi dhe duhet zbatueshmëri nga mësimdhënësit dhe nxënësit për të pasur mësimdhënie produktive, si dhe nxënie të lehtësuara si dhe për të arritur rezultate të knaqshme.

Të mbash disiplinën në nivel të duhur në klasat ku jep mësim me 25-30 apo edhe më shumë nxënës kërkojnë aftësi psiko-pedagogjike, dhe mjeshtëri menaxhuese, si dhe organizim të mirë.

Që mësimdhënësi të jetë i suksesshëm në menaxhimin e disiplinës në klasë kërkojnë nga ai që të jetë vazhdimisht i vëmendshëm dhe aktiv për t'ju përgjigjur kërkesave të nxënësve.

Meqë secili nxënës është botë në vete, dhe ka stilin e vet të komunikimit, veprimin, reagimin, të mësuarit etj, kërkojnë që mësimdhënësi t'i njohë nxënësit, pra stilet e tyre, për të ditur të veprojë karshi stileve dhe kërkesave të tyre pa e penguar njëri tjetrin, madje të krijojë një klimë të përshtatshme që të gjithë nxënësit të kenë mundësi që të mësojnë sa më shumë që është e mundur për kundër ndryshueshmërisë që posedojnë.

Mësimdhënësi për të pasur suksese në menaxhimin e disiplinës në klasë dhe për të arritur objektivat e parashikuara duhet të mbajë nxënësit të përqendruar dhe të përfshirë në mësim gjatë gjithë kohës.

Mospërmbyshja e orës mësimore me aktivitete mund të krijojë hapësirë të nxënësit që të na zbehin disiplinës në klasë. Menaxhimi i disiplinës në klasë ka të bëjë me drejtimin dhe organizimin e veprimtarive edukativo-arsimore të ndryshme duke synuar maksimalisht përfshirjen produktive të nxënësve në mësim që të na sjellë dobi permanente.

Meqë disiplina ka të bëjë me rregull në klasë, rrjedhimisht menaxhimi i drejtë i saj e ngritë cilësinë në mësim.

METODOLOGJIA DHE METODAT

Qëllimi i hulumtimit

Ky studim për qëllim ka konstatimin e ndikimit të menaxhimit të disiplinës në klasë, në ngritjen e cilësisë në mësim.

Pyetja kërkimore

Sa ndikon menaxhimi i mirë i disiplinës së klasës në ngritjen e cilësisë në mësim?

Hipoteza e hulumtimit

Menaxhimi i mirë i disiplinës në klasë ndikon ndjeshëm në ngritjen e cilësisë në mësim.

Metodat e hulumtimit

Për realizimin e këtij studimi janë përdorur: Metoda e analizës teorike, Metoda e analizës së dokumentacionit, Metoda statistikore, Metoda e krahasimit.

Popullacioni dhe grupi përfaqësues

Popullacionin e këtij hulumtimi e përbëjnë 187 mësimdhënës të shkollave të mesme të larta të Komunës së Malishevës, ndërsa grupin përfaqësues e përbëjnë 127 mësimdhënës.

Instrumenti i hulumtimit


Si instrument i hulumtimit është përdorur shkalla likert me 5 shkallët e saj: Shumë i interesuar, i interesuar, deri diku i interesuar, pak i interesuar, aspak i interesuar dhe plotësisht dakord, dakord, i lëkundur, Jo dakord dhe aspak dakord, i përbërë nga tri pjesë me gjithsej 15 pyetje.

Analiza e të dhënave

Analiza dhe përpunimi i të dhënave janë bërë me anë të programit SPSS, ku përmes tabelave janë paraqitur mesataret, devijimi standard, përqindjet.


Të dhënat e pjesëmarrësve

Grafikoni nr. 1. Gjinia e mësimdhënësve




Në hulumtim 79 % e pjesëmarrësve janë mësime të gjinisë mashkullore dhe 21 % e mësimeve janë të gjinisë mashkullore.

Grafikoni nr. 2. Moshë e mësimeve




Në bazë të rezultateve, vërehet se 25.2 % e mësimeve janë të moshës deri 30 vjet, 37.8 % janë të moshës 31-40, 19.7 % janë të moshës 41-50, 14.2 % janë të moshës 51-60 dhe 3.1 % e tyre janë të moshës mbi 60.

Grafikoni nr. 3. Shkollat pjesëmarrëse



Rreth 45.7 % e pjesëmarrësve janë mësime të gjimnazit, 24.4 % janë mësime në shkollën profesionale dhe 29.9 % e mësimeve janë mësime të Qendrës së Kompetencës.

Grafikoni nr. 4. Niveli arsimor i mësimeve



Rreth 74 % e mësimeve pjesëmarrës kanë të mbaruar fakultetin, ndërsa 26 % e tyre kanë nivelin master.

INTERPRETIMI I REZULTATEVE

Tabela numër. 1. Ndikimi i menaxhimit të mirë të disiplinës së klasës në ngritjen e cilësisë në mësim.

PYETJA KRYESORE					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Po	127	100,0	100,0	100,0

Në bazë të rezultateve që vërehen në tabelën numër 1, të gjithë mësimeve pajtohen se menaxhimi i mirë i disiplinës së klasës ndikon mirë në ngritjen e cilësisë në mësim.

Tabela numër 2, Pyetjet e hulumtimit

		Plotësisht dakord	Dakord	I lëkundur	Jo dakord	Aspak dakord
1	Shkolla duhet të ketë rregullore të brendshme për trajtimin e disiplinës në shkollë dhe mësim	85%	13.4%	0%	1.6%	0%
2	Menaxhimi i mirë i disiplinës në klasë është domosdoshmëri për ngritjen e cilësisë në mësim	73.2%	25.2%	1.6%	0%	0%
3	Menaxhimi i një klase gjatë mësimit bëhet lehtësisht nga mësuesi	34.6%	38.6%	13.4%	12.6%	0.8%
4	Mbajtja e vëmendjes dhe përqendrimit të nx. Në një orë mësimore është çështje mjaft komplekse	38.6%	50.4%	3.9%	3.9%	3.1%
5	Planifikimi i mirë i kontribuon menaxhimit më	64.6%	33.9%	0.8%	0.8%	0%

të lehtë të klasës						
6	Problemi më i madhe në shkollë sot, është menaxhimi i drejtë i klasës	33.9%	38.6%	12.6%	14.2%	0.8%
7	Disa teknika mund të jenë më të dobishme se të tjerat për të arritur qëllimet e veta	31.5%	55.1%	8.7%	3.1%	1.6%
8	Komunikimi efektiv është çelës në menaxhimin e klasës dhe orës mësimore	58.3%	40.9%	0%	0.8%	0%
9	Zhurma në klasë rrezikon seriozisht menaxhimin e klasës	51.2%	39.4%	5.5%	3.1%	0.8%
10	Menaxhimin e disiplinës në klasë e ndihmon bashkëpunimi mësimdhënës- prindër	49.6%	28.3%	11%	8.7%	2.4%
11	Klasa është vështirë të menaxhohet nëse mësuesi nuk ka njohuri për menaxhimin e drejtë të klasës	55.9%	33.9%	5.5%	3.9%	0.8%
12	Ndarja e drejtë e kohës për çdo fazë të orës mësimore e bën orën më lehtë të menaxhueshme	51.2%	35.4%	10.2%	3.1%	0%
13	Nxënësit duhet të jenë të njoftuar me rregullat e sjelljes në shkollë, në klasë dhe në orën mësimore	78.7%	18.1%	1.6%	1.6%	0%
14	Menaxhimi i klasës është problemi i fundi në mësimdhënie	11%	18.9%	12.6%	40.9%	16.5%
15	Menaxhimi i klasës nuk ka ndonjë efekt në mësimdhënien bashkëkohore	4.7%	13.4%	15.7%	44.1%	22%

Në bazë të rezultateve të paraqitura në tabelën nr. 2, vërehet se 98.4 % e mësuesve të shkollave të mesme, mendojnë se shkolla duhet të ketë rregullore të brendshme për trajtimin e disiplinës në shkollë dhe mësim, ndërsa 1.6 % e tyre mendojnë se shkolla nuk duhet të ketë rregullore të brendshme për trajtimin e disiplinës në shkollë dhe mësim.

Rreth 98.4 % e mësimdhënësve janë të pajtimit se menaxhimi i mirë i disiplinës në klasë është domosdoshmëri për ngritjen e cilësisë në mësim, ndërsa 1.6 % e tyre janë të lëkundur.

Rreth 73.2 % e mësimeve pajtohen se menaxhimi i një klase gjatë mësimit bëhet lehtësisht nga mësuesi, 13.4 % e tyre janë të lëkundur dhe 13.4 % nuk pajtohen me këtë, duke e kundërshtuar këtë, ata tregojnë se nuk është e lehtë të menaxhohet klasa gjatë orës mësimore.

Rreth 89.1 % e mësimeve pajtohen se mbajtja e vëmendjes dhe përqendrimit të nxënësve në një orë mësimore është çështje mjaftë komplekse, 3.9 % e tyre janë të lëkundur, ndërsa 7 % mendojnë se nuk është e vështirë të mbahet vëmendja dhe përqendrimi i nxënësve në një orë mësimore.

Rreth 98.5 % e mësimeve pajtohen se planifikimi i mirë i kontribuon menaxhimit më të lehtë të klasës, 0.8 % janë të lëkundur, dhe 0.8 % nuk pajtohen me këtë pohim.

Rreth 72.5 % e mësimeve pajtohen se problemi më i madh në shkollë sot, është menaxhimi i drejtë i klasës, 12.6 janë të lëkundur, ndërsa 15 % nuk pajtohen me këtë pohim, e që i bie se menaxhimi i drejtë i klasës nuk është problemi më i madh që ekziston sot në shkollat tona, pra sipas këtij grupi të mësimeve ka probleme edhe më të mëdha se sa kjo.

Rreth 86.6 % e mësimeve pajtohen se disa teknika mund të jenë më të dobishme se të tjerat për të arritur qëllimet e veta, 8.7 % e tyre janë të lëkundur, ndërsa 4.7 % e mësimeve nuk pajtohen me këtë pohim.

Rreth 99.2 % e mësimeve pajtohen se komunikimi efektiv është çelës në menaxhimin e klasës dhe orës mësimore, ndërsa 0.8 % nuk pajtohen me këtë.

Rreth 90.6 % e mësimeve pajtohen se zurma në klasë rrezikon seriozisht menaxhimin e klasës, 5.5 % e tyre janë të lëkundur, ndërsa 3.9 nuk pajtohen me këtë.

Rreth 77.9 %, pajtohen se menaxhimin e disiplinës në klasë e ndihmon bashkëpunimi mësues-prindër, 11 % janë të lëkundur, ndërsa 11.1 % e tyre nuk pajtohen me këtë pohim.

Rreth 89.8 % e mësimeve pajtohen se klasa është vështirë të menaxhohet nëse mësuesi nuk ka njohuri për menaxhimin e drejtë të klasës, 5.5 % e tyre janë të lëkundur, ndërsa 4.7 % nuk pajtohen me këtë pohim.

Rreth 86.6 % e mësimitdhënësve pajtohen se ndarja e drejtë e kohës për çdo fazë të orës mësimore e bën orën më lehtë të menaxhueshme, 10.2 % e tyre janë të lëkundur, ndërsa 3.1 % e mësimitdhënësve nuk pajtohen me këtë pohim.

Rreth 96.8 % e mësimitdhënësve pajtohen se nxënësit duhet të jenë të njoftuar me rregullat e sjelljes në shkollë, në klasë dhe në orën mësimore, 1.6 % e tyre janë të lëkundur dhe 1.6 % nuk pajtohen me këtë pohim.

Rreth 29.9 % e mësimitdhënësve, pajtohen se menaxhimi i klasës është problemi i fundit në mësimitdhënie, 12.6 % janë të lëkundur, ndërsa 57.4 % e tyre mendojnë se menaxhimi i klasës nuk është problemi i fundit në mësimitdhënie. Pra më shumë se gjysma e mësimitdhënësve pjesëmarrës në hulumtim me të drejtë mendojnë se menaxhimi i klasës nuk është problemi i fundit në mësimitdhënie.

Rreth 18.1 % e mësimitdhënësve pajtohen se menaxhimi i klasës nuk ka ndonjë efekt në mësimitdhënien bashkëkohore, 15.7 janë të lëkundur dhe 66.1 % nuk pajtohen me këtë ide, pra ata mendojnë se menaxhimi i klasës ka efekt në mësimitdhënie. Me të drejtë shumica e mësimitdhënësve mendojnë se menaxhimi i klasës ka efekt në mësimitdhënien bashkëkohore.

Tabela nr. 3. Mesatarja dhe devijimi standard

Descriptive Statistics			
	Mean	Std. Deviation	N
PK	2,00	,000	127
P1	4,82	,495	127
P2	4,72	,486	127
P3	3,94	1,029	127
P4	4,17	,918	127
P5	4,62	,548	127

P6	3,91	1,050	127
P7	4,12	,813	127
P8	4,57	,543	127
P9	4,37	,795	127
P10	4,14	1,074	127
P11	4,40	,829	127
P12	4,35	,791	127
P13	4,74	,566	127
P14	2,67	1,267	127
P15	2,35	1,108	127

Në bazë të rezultateve të paraqitura në tabelën nr. 3, vërehet se mesataret më të larta të përgjigjeve të mësimdhënësve janë: Pyetja kryesore (mesatarja është maksimumi 2), pyetja e parë **4.82**, pyetja e trembëdhjetë **4.74**, pyetja e dytë **4.72**, pyetja e tetë **4.57**, pyetja e njëmbëdhjetë **4.4**, pyetja e nëntë **4.37**, pyetja e dymbëdhjetë **4.35**, pyetja e dhjetë **4.14**, pyetja e shtatë **4.12**, të cilat mesatare, janë shumë të larta, e disa prej tyre i ofrohen maksimumit, pastaj vijjnë mesataret e pyetjeve të tjera, të cilat janë më pak të larta.

Sa i përket devijimit standard, në pyetjen kryesore, devijimi standard është **.000**, e që është tregues se grupimi është shumë i mirë, nuk ka dallime fare, që lidhet edhe me rezultatin në tabelën nr. 1, ku 100 % e mësimdhënësve mendojnë se menaxhimi i mirë i disiplinës së klasës ndikon në ngritjen e cilësisë në mësim, si dhe mesatarja e kësaj pyetje e cila është 2 nga 2 sa është maksimumi. Me grupim të mirë në përgjigje janë edhe:

Pyetja e dytë **,486**, pyetja e parë me **,495**, pyetja e tetë **,543**, pyetja e pestë **,548**, pyetja e trembëdhjetë **,566**, pyetja e dymbëdhjetë **,791**, pyetja e nëntë **,795**, pyetja e shtatë **,813**, pyetja e njëmbëdhjetë **,829**, pyetja e katërt **,918**.

Në bazë të rezultateve vërehet se mesatarja e shumicës së pyetjeve është mjaftë e lartë, e që është një bazë se është një grupim i mirë në dhënien e përgjigjeve të njëjta nga ana e mësimitdhënësve, kjo jep një rezultat mjaftë të mirë edhe në paraqitjen e devijimit standard.

KONKLUZION

Menaxhimi i mirë i klasës është një problematikë me rëndësi pasi që çdo ditë e më tepër po rritet sjellja jo e mirë e nxënësve në raport me nxënësit e tjerë, me mësimitdhënësit apo personelin tjetër të shkollës, por edhe forma të tjera të sjelljes, për çka duhet të merren masa adekuate me qëllim të mbajtjes nën kontroll të sjelljes së mirë të nxënësve në shkollë.

Menaxhimi i disiplinës në klasë është specifikë mjaftë komplekse e mësimitdhënies.

Menaxhimi i mirë i disiplinës në klasë është sfidë permanente për të gjithë mësimitdhënësit, andaj për të pasur sukses mësimitdhënësit patjetër duhet të paisen më njohuri adekuate për menaxhimin e disiplinës në klasë.

Në funksion të menaxhimit të drejtë të disiplinës në klasë ekzistojnë rregullore të cilat janë në fuqi dhe duhet zbatueshmëri nga mësimitdhënësit dhe nxënësit.

Mësimitdhënja produktive si dhe mësimitnxënja e lehtësuar është rezultat i menaxhimit të mirë të disiplinës në klasë.

Menaxhimi i mirë i disiplinës në klasë e kushtëzon arritjen e suksesit dhe cilësisë në mësim. Jemi koshient se kjo problematikë do një studim më të thellë dhe një qasje më serioze nga shoqëria në përgjithësi, me qëllim që nxënësit me sjellje jo të mira të kontrollohen dhe të normalizohet sjellja e tyre me qëllim të mbarëvajtjes së procesit mësimor dhe të ngritet cilësia në mësimitdhënje e sidomos në nxënje.

Pra, ky hulumtim është vetëm një pikënisje ku më pastaj të vazhdohet me studime sistematike në këtë lëmi paralel me ecuritë, reformat dhe synimet e arsimit në Kosovë.

Referenca:

1. Aleksandër Bojaxhi: Disiplina në klasën mësimore, Tiranë 2004;
2. Hyseni, Halim; Mita, Nikoleta; Salihaj, Jonuz; Popovci, Dugagjin: Qeverisja dhe udhëheqja në arsim, KEC, Prishtinë, 2003;
3. Karaj, Theodhori; Menaxhimi i klasës, (Psikologji e zbatuar në mësimdhënie), Tiranë, 2008;
4. Kastrati, Ma. Avdyl & Sylejmani, Ma. Admir: Rëndësia e orientimit në karrierë të nxënësve në shkollimin e mesëm të lartë, Libri Shkollor, Prishtinë, 2011;
5. Miller, Bonnie: Si të krijohet kontakti i suksesshëm me nxënësit, QPEA, Ferizaj, 2005;
6. Muka, P.: Të mësuarit me objektiva dhe Modeli, Eureka, Tiranë, 1995;
7. Musai, Bardhyl: Mjeshtëritë themelore të mësimdhënies, SHBLU, Tiranë 1997;
8. Musai, Bardhyl: Metodologji e mësimdhënies, Albigraf, Tiranë, 2003;
9. Musai, Bardhyl: Psikologji edukimi, PEGI, Tiranë, 1999;
10. Garo, Sofokli: Sfidat e mësimdhënies, Tiranë, 2002;
11. Dr. Riza Brada: Kujdestari i klasës, Pejë, 1997.

NDIKIMI I ZHVILLIMEVE TEKNOLOGJIKE NË ARSIM (metodat e- learning)

Alma SELAMI

ABSTRAKT

Me kalimin e dekadave ne arsimin shqiptar parauniversitar metodologjitë dhe teknikat në procesin e mësimdhënie-mësimnxënies, kanë pësuar ndryshime të shumta. Sot në këto procese janë përfshirë si ato tradicionalet, për të cilat shumica e mësuesve të vjetër janë fanatikë, duke qenë të bindur për efikasitetin e tyre, e deri tek ato ‘moderne’(bashkëkohore), të cilat mbështesin strukturën ERR (evokim,realizim,reflektim). Ky dhjetëvjeçar, duket sikur po sfidon metodat dhe teknikat e vjetra, sidomos në vendet e zhvilluara, duke i zëvendësuar ato me metoda që kanë në bazën e tyre teknologjinë dhe paisjet elektronike, duke ndryshuar komplet konceptin mbi procesin mësimor në tërësi. Tani pyetja që shtrohet është: A duhet shkollat shqiptare të përqafojmë këto metoda? Nëse PO, ku dhe si? Nëse JO, pse? Cilat do ishin aspektet pozitive dhe negative të përdorimit të tyre, duke u fokusuar në mundësitë reale,fizike, teknike,por jo vetëm, në sistemin tonë arsimor te mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë.

Duke qenë se kam patur shansin të punoj me të gjitha këto metoda, që me A94, ERR, dhe tani së fundmi me E-Learning(Electronic Learning), si risi ne metodologjine e mesimdhënies dhe nxënies, besoj eshte e arsyeshme të bëj një hulumtim të hollësishëm për metodën E-learning dhe kushtet në të cilat kjo metodë zhvillohet në rajonin tonë dhe konkretisht në shkollat e qytetit nga i cili une vij dhe ku unë aktualisht punoj.

Fjalë Kyçe: *Mësimdhënie-mësimnxënies, E-Learning, teknologjinë dhe paisjet elektronike.*

LISTA E SHKURTIMEVE DHE E FJALORIT

- ERR (Evokim Realizim Reflektim)
- E-learning(Electronic Learning)
- ED (Edukim në Distançë)
- Ëeb-based (bazuar në internetin)
- M-learning (Mobile Learning) Të mësuarit në lëvizje
- PISA (Program For International Student Assessment)
- PNVN(Program Ndërkombëtar për Vlerësimin e Nxënësve)
- AVA (Agjensia e Vlerësimit të Arritjeve)

- OECD (Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim)
- TEL (teknologji-të zgjeruara të të mësuarit)
- IBT (trajnimet bazuar në internet)
- VLE (arsimi online, arsimi virtual, mjediset e të mësuarit virtual)
të cilat janë quajtur edhe platforma të mësuarit
- LMS (Learning Menagement Sistem) Sistem i Menaxhimit të të Mësuarit)

HYRJE

Qëllimi: Të analizohen aspektet dhe kushtet e përdorimit të teknologjisë në sistemin arsimor të mesëm të lartë dhe përdorimi i metodave e- learning në shkollat tona.

Objektivat:

- Njohja me realitetin e sistemit arsimor shqiptar në dekadën e fundit edhe më herët, si dhe cilësia e atij sistemi sipas PISA-s .
- Evidentim i ndryshimeve metodologjike të procesit të mësimdhënies e mësimnxënies, dhe si ka ndryshuar ky koncept gjatë dekadës së fundit.
- Të studiohet mënyra se si vendet e zhvilluara kanë integruar teknologjinë në funksion të procesit mësimor.
- Analizimi i kushteve sociale,infrastrukturore, kulturore, të shkollës shqiptare për të përqafuar teknologjinë në procesim mësimor dhe metodën E-learning.
- Vlerësim i avantazheve dhe disavantazheve te metodës E-learning në shkollën shqiptare.
- Të jepen rekomandimet e nevojshme për një përdorim efikas të teknologjisë dhe metodave E-learning në shkollat tona.

METODOLOGJIA E STUDIMIT

Metodologjia e përdorur për procesin e vlerësimit kaloi disa faza:

Hapi i parë ishte mbledhja e dokumentacionit për verifikimin e cilësisë së sistemit arsimor shqiptar

Përzgjedhja e literaturës që mund të ishte e vlefshme për studimin (literaturë vendase dhe e huaj, si studime, libra të autorëve të ndryshëm në këtë fushë, ose në internet në ëbsitet përkatëse)

Përzgjedhja e target grupit dhe shtrirja e studimit.

Në këtë studim morën pjesë të rinj të shkollave të mesme të përgjithshme dhe profesionale, nga qyteti dhe fshati. Instrumenti i përdorur për mbledhjen e të dhënave ishte një pyetësor i strukturuar.

Pyetësi përmban 40 pyetje.

Metodë tjetër është target grupi. Gjatë target-grupit u përdorën disa teknika si: brainstorming, punë në grup, analize e arritjeve të nxënësve nga LMS-ja e platformes E-learning ku ky target grup ben pjese dhe njekohehisht i kam ne tutorim, si dhe diskutimet për të përfituar sa më shumë informacion. Gjetjet nga target-grupet u përdorën për të krahasuar të dhënat nga pyetësorët .

CILËSIA E ARSIMIT DHE EFEKTIVITETI I SHKOLLAVE SHQIPTARE

2.1.1 Cilësia e arsimit gjatë dy dekadave të fundit

Sistemi arsimor shqiptar, fillesat e tij i daton që në shekullin XVII, kur u hap dhe Mësonjëtorja e parë shqipe në Korçë, të vitit 1887. Arsimi është një nga fushat më të rëndësishme të çdo shoqërie dhe të çdo sistemi. Problematika e arsimit shqiptar është aq shqetësuese sa që duhet konceptuar seriozisht një strategji konkrete për një ndryshim progresiv.

Programi Ndërkombëtar për Vlerësimin e Nxënësve (PISA), (Program For International StudentAssessment), që përbën një nga studimet më prestigjioze ndërkombëtare për matjen e arritjeve të nxënësve, është zbatuar fillimisht në 2001. Ky program tregoi se rezultatet janë relativisht të dobëta. Një nga shkaqet e uljes së nivelit të cilësisë së mësimin është mbi popullimi i klasave sidomos në zonat e periferive të qyteteve kryesore si rezultat i migrimit të brendshëm. Rezultatet më të fundit të PISA janë nga viti 2012 . Sipas planit, PISA thekson aftësitë funksionale që nxënësit kanë fituar në përfundim të arsimit të detyruar.

Praktikat e ndjekura në klasa tregojnë një cilësi të ulët të strategjive të mësimdhënies dhe të mësuarit në Shqipëri krahasuar me vendet e tjera të OBZHE-së dhe EAQ-së.

PNVN 2009 ofroi mundësinë që të vlerësohet se cilat lloj strategjish të të mësuarit (memorizim, përpunim, kontroll ose përmbledhje) përdoren më shumë nga nxënësit dhe cilat lloje praktikash të mësimdhënies (disiplina, menaxhimi i klasës, ose aftësia për të angazhuar nxënësit) përdoren tipikisht nga mësuesit.

2.1.2 Ndryshimet në Sistemin arsimor shqipëtar

Nga një vëzhgim i përgjithshëm i bërë në shkolla, rezulton se ankesat e mësuesve sot, janë:

1. përdorimi i celularit, kufjeve në provime;
2. përqendrimi i ulët i nxënësve në orën e mësimit;
3. nxënësit janë shkëputur pothuajse fare nga libri;
4. tendenca e marrjes së informacionit të gatshëm;
5. mos interesim në përgjithësi për mësimin etj.

Në sistemin tonë arsimor sot njihen 3 modele bazë të organizimit të kurrikulës, që janë:

Modelet e përqendruara tek lënda

Modelet e përqendruara tek nxënësi

Modelet e përqendruara tek problemi

Nga të mësuarit tradicional në atë bashkëkohor

Sipas konceptit tradicional për arsimimin dhe të mësuarin, themi që ai është një proces formal, që përfshin të mësuarit dhe provimet, që zhvillohen brenda një institucioni arsimor, në periudha të caktuara kohore dhe si qëllim kanë kualifikimin sipas një procedure të paravendosur. Rreth viteve 2000 procesi tradicional i të mësuarit zhvillohej si më poshtë ku struktura e mësimit përmban tri faza:

1. Parashikimi (Përgatitja për të nxënësit). *Ndryshe*: Evokimi, Konstitucionalizimi.
2. Ndërtimi i njohurive (Përpunimi i përmbajtjes/përmbajtjeve). *Ndryshe*: Realizimi, Informacioni
3. Përforsimi – Konstruktivizmi (Konsolidimi i të nxënësit). *Ndryshe*: Reflektimi, Funkcionalizimi.
4. Vlerësimi i nxënësve

Aktualisht, institucionet arsimore po përqendrohen në aftësitë dhe në shprehjet e reja të punës dhe në një mënyrë tjetër të menduarit, atë krijues dhe kritik.

Klasa karakterizohet nga:

- veprimtaria, jo pasiviteti;
- bashkëpunimi, jo konkurrenca;
- shumë mundësi për të mësuar.

Duke u bazuar në studime të ndryshme, procesi mësimor ose mësimdhënia kalon në disa faza, ku ne tani mund të dallojmë edhe vendin se ku mund të integrojmë mjetet dhe aplikacionet teknologjike:

- 1) Përcaktimi i qëllimeve dhe i objektivave mësimorë;
- 2) Zgjedhja e permbajtjes;
- 3) Zgjedhja e metodave dhe e procedurave të përshtatshme mësimore; *Zgjedhja e mjeteve dhe aplikacioneve*
- 4) Zhvillimin e mësimin (dhënia e mësimin); *Përdorimi i mjeteve dhe aplikacioneve, vënia në zbatim.*
- 5) Matjen dhe vlerësimin e arritjeve.

Pra, mësimdhënia shënon veprimtarinë e mësuesit në raport me nxënësit. Ajo është tërësia e strategjive, të metodave dhe procedurave pedagogjike që përdor mësuesi për të mësuar nxënësit. Gjithashtu, thuhet se mësimdhënia *është proces i qëllimshëm*, që do të thotë se me këtë proces synohet të realizohen objektiva të caktuara, gjithmonë të orientuar drejt të nxënit.

2.2 Integrimi i Teknologjisë Me Sistemin Arsimor

2.2 .1 . Pse Teknologjia?

Teknologjia ka sjellë një sferë influence që përfshin një ndikim të thellë në botën e arsimit. Ajo po ndryshon metodat e mësimdhënies, të mësuarit, dhe të menduarit. Trendi i arsimit në shekullin 21 do të vazhdojë të përjetojë një rritje të madhe në fushën e informacionit dhe komunikimit teknologjik.

Edhe pse teknologjia nuk është zgjidhje për mësimdhënie të dobët, teknologjia ka lehtësuar kalimin e kurrikulës nga me në qendër mësuesin në atë me në qendër nxënësin, nga të mësuarit pasiv, në të mësuarit aktiv. Të mësuarit ëeb-based(bazuar tek interneti): e-learning, mësimi online, m-learning (mobile learning) të mësuarit në lëvizje;dhe të mësuarit nëpërmjet teknologjisë, janë sot realitete të arsimit' (Suzanne Bell,2006:11).

2.2.2 Si Integrohet teknologjia me sistemin arsimor?

Sistemi arsimor, dhe sidomos shkolla është vendi ku nxënësi ka mundësi të marrë njohuritë teknologjike dhe të praktikojë ato për qëllime edukative. Pyetjet kryesore që koleget dhe shkollat adresojnë është nëse ajo, teknologjia, është në funksion të individit, apo individi në funksion të saj. Qëllimi nuk është që ti përgjigjemi kësaj pyetje pasi kjo është thjesht në dorën dhe inteligjencën e gjithësecilit, që të përdorë atë në dobi të intetresave të veta profesionale, pa kaluar në abuzim.

2.3.1. Historiku

Si pjesë e një lëvizjeje në Shtetet e Bashkuara, për të integruar aftësitë e shekullit të 21-të në të gjitha (12) klasat, shtetet e ndryshme u angazhuan në iniciativa për të përmbushur "katër ftësitë" e të mësuarit, të menduarit kritik, zgjidhja e problemeve, komunikimi & bashkëpunimi, kreativiteti dhe inovacioni, (Robert N. Ronau, 2012:123).

2.3.2 Interneti si mjet efikas në aksesimin e dokumentacionit të sistemit arsimor

Qendra e Informacionit ERIC, një sistem informacioni kombëtar i financuar nga Instituti Arsimit dhe Shkencave të Edukimit, prodhon Bazën e të dhënave të dokumentacionit të arsimit (p.sh., raportet, fjalime, letrat e konferencave, teste, instrumentet e vlerësimit, udhëzon, tezat, materiale historike, analizën e informacionit, të dhëna statistikore, pikëpamje, dhe materiale referuese), që nga viti 1969. Sistemi i ri Eric, është i aksesueshëm në internet, për publikun, që në shtator 2004. Këto materiale përfshijnë më shumë se 105,000 dokumente të plotë tekst.

2.3.3. E-learning

Teknologji Arsimore, Media, dhe E-Resources (Burimet elektronike)

Shumë terma që përshkruajnë përdorimin e teknologjisë për të mësuarit, nuk janë më të përshtatshme për një botë digjitale. E-learning "është një term i përdorur zakonisht nga (Rosenberg, 2001). Ai siguron tri kritere themelore: (1) e-Learning është pjesë e rrjetit, që e bën atë të aftë për të bërë menjëherë përditësimin, ruajtjen dhe tërheqjen, shpërndarjen, dhe ndarjen e informacionit; (2) i është dorëzuar përdoruesit nëpërmjet një kompjuteri duke përdorur teknologjinë standarde në Internet; dhe (3) fokusohet në pikëpamje më të gjerë të zgjedhjeve të mësuarit.

2.3.4 Platformat LMS (Learning Management Systems)

Soft-e të fuqishëm për menaxhimin e bazave të të dhënave komplekse janë kombinuar me strukturat dixhitale për menaxhimin e kurrikulave, materialeve dhe mjeteve të vlerësimit. Këto soft-e janë ato që i quajmë ‘Sistemet e Menaxhimit të të mësuarit’ (Learning Management Systems).

2.4. NDIKIMI I TEKNOLOGJISË NË KONTEKSTIN SOCIAL DHE ORGANIZATIV

2.4.1 Ndikimet e teknologjisë në arsim

Studimet mbi rolin dhe ndikimin e teknologjisë në arsim janë kritikuar shpesh, nxitur më shumë nga mundësitë ose më saktë pamundësitë e disponueshmërisë së teknologjisë si në shkollë dhe jashtë saj. Gjatë viteve të fundit ka pasur një interes të konsiderueshëm në marrjen e njohurive teknologjike me përmbajtje pedagogjike.

2.4.2. Drejtimit e ardhshme të teknologjisë në arsim

Me çfarë njohurish kanë nevojë mësuesit të pajisen për mësimdhënien sot dhe në të ardhmen, ku teknologjitë dixhitale janë duke ndikuar në mënyrë të konsiderueshme në jetën tonë të përditshme? Duke pasur parasysh gjendjen aktuale, dhe atë se ku po shkon zhvillimi i teknologjisë, duhet të jemi të përgatitur për t’u përshtatur me këto zhvillime.

3. REALIZIMI I VEZHGIMIT

3.1. Realizimi i studimit nëpërmjet pyetsorëve

Kufiri i moshës i përfshirë në studim, një kampion prej 500 nxënësish, është 15 – 19 vjeç ku përqindjen më të madhe e zë moshë 17 vjeç, 197 (39.4%) dhe 18 vjeç 178 (35.6%), pjesa tjetër 14.4% e zë moshë 15, 16 vjeç, 72 nxënës, por janë përfshirë gjithashtu edhe mësues të shkollave përtkatëse, 53 mësues, në përqindje 10.6% .

3.2. Vezhgim mbi gjendjen e implementimit dhe përdorimit në “ Nazmi Rushiti “ te e-learning.

Si fillim, shkolla e mesme profesionale “Nazmi Rushiti” Peshkopi, ku është realizuar vezhgimi, përbëhet nga rreth 330 nxënës ku, 143 pra 43% janë vajza dhe 187 pra 57% janë djem. 74% e nxënësve banojnë në fshat dhe 26% banojnë në qytet, ku pjesa më e madhe e tyre

e kanë mundësinë e të paturit një kompjuter dhe internet njëkohësisht në shtëpi, kusht ky i domosdoshëm për përdorimin e programit E-learning.

4.PSE DUHET TË PËRDORIM NJË PLATFORMË E-LEARNING?

Është sinonim me: të mësuarit multimedial, teknologji-të zgjeruara të të mësuarit (TEL), trajnimet bazuar në internet (IBT), trajnimet bazuar në eeb (EBT), arsimi online, arsimi virtual, mjediset e të mësuarit virtual (VLE), të cilat janë quajtur edhe platforma të të mësuarit. Më poshtë po tregojmë disa nga avantazhet dhe disavantazhet e e-Learning:

Avantazhe:

- Puna në klasë planifikohet rreth punës dhe familjes.
- Zvogëlon kohën dhe shpenzimet e udhëtimit për studentët e largët.
- *Rezultate dhe reagime të menjëhershme:*

Disavantazhe:

- Nxënësit me motivim të ulët ose zakone jo të mira të studimit mund të ngelen pas.
- Pa një strukturë të një klasë tradicionale, studentët mund të bëhen konfuz në lidhje me aktivitetet e kurseve dhe afatet.

KONKLuzion

1.SHIKOHET QE TEKNOLOGJIA KA NDIKIM TE THELLE NE METODOLOGJITE E MESIMDHENIES.

2.NDIKIMI ESHTË I THELLE DHE NE FORMAT E REJA TE TE MESUARIT DHE LEHTESISE NE PERVETESIM NGA BREZAT E RI SOT.

A. INVESTIM NE LABORATORE GJUHESORE DIGITAL;

B.TRAJNIM I MESUESVE ME KETO METODA TE REJA;

C.WORKSHOP-E TE NDRYSHME DHE PERFSHIRJE E MESUESVE NE DEGJESA TE CILAT LIDHEN DREJTPERDREJT ME INTERESAT E TYRE DHE TE NXENESVE(DUKE U BERE PJESE E NISMAVE TE NDRYSHME LIGJORE DHE REFORMATORE).

TERMA

- ❖ Softe (Programe kompjuterike)
- ❖ Teknologji Arsimore (Tërësia e elementeve të sistemit arsimor)
- ❖ Media, (Transmetim)
- ❖ E-Resources (Burime Elektronike)
- ❖ TPACK (Technological Pedagogical Content Knowledge)

Referenca :

FAQJA E E-LEARNING

<http://www.tellmemorecampus.com/> (ctrl+ klik mbi adresen per te hapur faqen e linkut)

FORMA GRUPORE E PUNËS MËSIMORE NË MËSIMDHËNIEN INTERAKTIVE**Phd.can, Arbona XHEMAJLI**

Universiteti Shtetëror i Shkupit “Shën Kirili i Metodi”, Fakulteti Filozofik – Pedagogji
Universiteti Publik “Kadri Zeka” Gjilan

arbona.xhemajli@hotmail.com

ABSTRAKT

Për të realizuar me sukses përmbajtjet mësimore, në mësimdhënien interaktive nuk është e mjaftueshme të përcaktohen vetëm mjetet, metodat dhe teknikat e mësimdhënies. Përvetësimi cilësor i njohurive bazohet edhe në gjetjen dhe zbatimin e formës më të përshtatshme të punës mësimore. Forma mësimore e cila aktualisht përkrahët më së shumti nga nxënësit dhe mësimdhënësit në procesin mësimor dhe synon të tejkaloj mësimdhënien tradicionale, është puna në grupe.

Organizimi i mëimit përmes formës së punës në grupe e ndryshon pozicionin e mësimdhënësit dhe të nxënësve përballë kërkesës të kohës për një mësimdhënie bashkëkohore dhe nxënie aktive e ndërvepruese.

Në këtë punim aktualizohen edhe një sërë çështjesh të tjera që lidhen me organizimin e mëimit përmes formës së punës në grupe dhe formimin e grupeve në mësimdhënien interaktive

Përveç analizës teorike për formën së punës në grupe në mësimdhënien interaktive kemi realizuar hulumtimin - vrojtimit me pjesëmarrje në klasën I-2, në shkollën fillore “Selami Hallaçi” në Gjilan, Kosovë. Gjithashtu janë paraqitur një pjesë e rezultateve nga intervista gjysëm e strukturuar në fokus grup me nxënës nga klasa në të cilën është aplikuar mësimdhënia interaktive. Hulumtimi është kryer në një mjedis natyror, në të cilin kishte mundësi të studiohet mësimdhënia interaktive në praktikën shkollore.

Rezultatet e fituara nga vëzhgimi dhe intervista në fokus grup vërtetojnë se aplikimi i formës së punës në grupe është efektiv në mësimdhënien interaktive.

Fjalë kyçe: *Interaksion, mësimdhënie interaktive, forma grupore, të nxënësve aktiv.*

HYRJE

Me punën mësimore në grupe kuptojmë ndarjen e nxënësve nëpër grupe për realizimin e suksesshëm dhe cilësor të mësimdhënies, të përvetësimit të diturive shkathtësive dhe shprehive.

Suksesi në punën grupore rritë motivimin e nxënësve duke krijuar një klimë pozitive emocionale në grup, duke rezultuar në ndryshime pozitive në fushën e kompetencave njohëse dhe emocionale.

Që një grup të funksionoj mirë duhet të bazohet në disa karakteristika:

1. Arsyetimi i nevojës së punës konkrete për ndarjen e nxënësve në grupe.
2. Saktësimi i detyrave arsimore dhe aktiviteteve mësimore për secilin grup.
3. Formulimi i përmbajtjes mësimore (temës mësimore) dhe materjalit të nevojshëm për punë.

Mësimdhënësit gjatë aplikimit të mësimdhënies interaktive në grupe inkurajojnë nxënësit të mbledhin të dhëna, të mbajnë shënime dhe të përgatiten për prezentim të punës së tyre dhe diskutim.

Interaksioni dhe komunikimi mes antarëve të grupit është esencial për të arritur rezultate gjatë të nxënësve. Përqëndrimi në punën në grupe ndryshon rrënjësisht rolin e nxënësve dhe mësimdhënësit duke ndryshuar edhe mënyrën e interaksionit midis tyre. (Ismajli, H., 2012. fq. 324)

Aplikimi i mësimdhënies interaktive në grupe kryesisht mund të organizohet në tri mënyra:

- Mënyra e parë është kur të gjithë grupet punojnë në një përmbajtje mësimore ose zgjidhin një detyrë, realizojnë një eksperiment, një detyrë laboratorike apo një vëzhgim.
- Mënyra e dytë është kur secili grup punon në detyra të ndryshme. Si zakonisht grupet janë si tërësi, mikroklasë, por jo mikroklasë e rastësishme. Këto grupe janë si tërësi të veçanta të klasës, të organizuara mes veti me detyra të caktuara nga mësuesi. Secili grup ka detyrat që duhet t'i realizoj gjatë procesit mësimor. Detyra diferenciale mund të ipen edhe brenda grupit, secili anëtar i grupit do të marr detyra në përputhje me aftësitë tij dhe nivelin e njohurive paraprake.

- Kurse mënyra e tretë grupet kohë pas kohe ndërrojnë detyrat me njëri- tjetrin apo kryejnë punë me detyra në rotacion.

E rëndësishme për interaksion efikas në grup është:

- Formimi i drejtë i grupeve;
- Ndërveprim pozitiv në mes anëtarëve të grupit;
- Zhvillimi i aftësive ndërpersonale dhe njohëse;
- Krijimi i klimës së favorshme emocionale;
- Analizimi dhe vlerësimi i punës grupore;
- Zgjedhja e formave dhe metodave të duhura mësimore.

Veprimtaria e çdo grupi punues është e pavarur, zhvillohet kryesisht nën udhëheqjen dhe me ndihmën e mësimit të nxënësve që nga faza përgatitore, deri te kontrollimi i rezultateve të punës, përkatësisht përgjatë gjithë procesit të organizimit të veprimeve dhe me zhvillimin e raporteve interaktive të komunikimit mes të mësimit të nxënësve dhe anëtarëve të grupit dhe anasjelltas.

FORMIMI I GRUPEVE

Grupet mund të formohen sipas kërkesave ose kritereve të ndryshme. Grupimi i nxënësve në grupe nuk është thjeshtë një ndarje e nxënësve në grupe apo përcaktim detyrash. Grupet duhet të formohen në bazë të nivelit të aftësive mësimore, interesave, karakteristikave të personalitetit, shprehive shoqërore apo kombinimit të këtyre faktorëve. Zakonisht grupet përmbajnë nxënës me nivele aftësishe të ndryshme, të cilët mbështesin njëri- tjetrin në shumë mënyra. (Musai, B., 2014. fq. 289)

Rreth formimit të grupeve ekzistojnë dilema; të formohen grupet homogjene, heterogjene ose grupet ad hoc. Kuptohet, si njëri ashtu edhe tjetri model i ka përparësitë e veta.

Në grupet homogjene grumbullohen nxënësit përafërsisht me dituri dhe aftësi të barabarta. Homogjeniteti i grupeve do të krijojë situatë, ku grupet janë të barabarta për kah potenciali i tyre intelektual. Disa grupe janë më të forta e disa grupe mbetën me nxënës më të dobët. Në grupe që janë homogjene në aspektin e njohurive në kushte të caktuara mund të lindin zgjidhje shumë origjinale për probleme të ndryshme.

Grupet heterogjene përbëhen prej nxënësve me nivel të ndryshën të diturive dhe dhe aftësive psiko-fizike. Pra, në grupet heterogjene nxënësit janë të përzier. Nisur nga fakti, se në jetën e përditëshme ekzistojnë vetëm grupe të përziera, atëherë analogjikisht edhe në mësimdhënien interaktive formohen grupe heterogjene. Këto grupe janë më dinamike dhe interaktiviteti i pjesëtarëve të grupit është më i mirë. Puna në grupe të vogla heterogjene është një nga mënyrat më të mira që nxënësit të fitojnë njohuri të reja.

Grupe **ad hoc apo** spontane - formohen në disa raste me qëllim për të plotësuar preferencat e nxënësve për tu grupuar. Gjithashtu formohen në rastet kur është e nevojshme shpejt që të formohen grupe. Mënyra e ndarjes në grupe është arbitrare zakonisht duke numëruar anëtarët, pavarësisht nga karakteristikat e tyre (duke numëruar deri në 5) pa pasur kriter për grupim.

Mësuesi është në interaksion të ngushtë me nxënësit, ai zgjedh rrugën, format dhe metodat e punës, duke u përpjekur që procesin mësimor ta bëjë më cilësor më interesant dhe më të përshtatshëm për nxënësit.

METODOLOGJIA DHE ANALIZA E REZULTATEVE TË HULUMTIMIT

Në këtë punim prezentohen një pjesë e rezultateve të vrojtimit me pjesëmarrje në klasën I-2, në shkollën fillore “Selami Hallaçi” në Gjilan, Kosovë. Gjithashtu janë paraqitur një pjesë e rezultateve nga intervista gjysëm e strukturuar në fokus grup me nxënës nga klasa në të cilën është zbatuar mësimdhënia interaktive.

Hulumtimi është kryer në një mjedis natyror, në të cilin kishte mundësi të studiohet mësimdhënia interaktive në praktikën shkollore. Klasa përbëhej prej 29 nxënësve. Prej tyre 13 femra dhe 16 meshkuj. Është e rëndësishme që të theksohet se më parë në procesin e mësimdhënies në këtë klasë më të shpeshta kanë qenë forma e punës frontale dhe në çifte.

Gjatë vrojtimit në klasë janë vërejtur disa përparësi të punës në grupe:

- Bartës të punës kryesore janë vetë nxënësit;
- Nxënësit janë në lidhje të drejtpërdrejtë me përmbajtjen mësimore dhe burimet nga ata mësojnë, e që rritë interesimin e nxënësve për mësim;
- Gjatë punës në grupe ekziston një bashkëpunim i vazhdueshëm i drejtpërdrejtë në mes nxënësve;

- Duke bërë punën vet nxënësit formojnë aftësitë e tyre punuese;
- Kjo formë e punës lejon lëvizshmëri më të madhe fizike të nxënësve;
- Puna në grupe e nxënësve ndikon në socializimin e tyre. Ata në kohën e lirë pas mësimit më lehtë grupohen për aktivitete të ndryshme të përbashkëta (lojëra, sport, etj);
- Gjatë punës në grupe nxënësit njohin më mirë njëri- tjetrin;
- Favorizohet zhvillimi i miqësive;
- Krijon kushtet për interaksion në mes të nxënësve;
- Puna në grupe gjen zbatimin e saj në të gjitha lëndët mësimore.

Takimi me fokus grupin me nxënës zgjati 50 minuta. Në diskutim morën pjesë 15 nxënës. Paraprakisht për intervistimin e nxënësve kemi marr leje nga prindërit.

U mbajtën shënime me dorë gjatë diskutimit, poashtu diskutimet e nxënësve u regjistruan me audio dhe video. Intervista me nxënës (edhe pse në moshë të re) ofroi shembuj dhe fakte të cilat ishin shumë të rëndësishme për temën që po hulumtohet.

Në pyetjen: A ju pëlqen forma grupore e punës?

Nxënësit dhanë këto përgjigje:

D- 1: Po, më pëlqen të punojmë në grupe.

D- 2: Po gati gjithmonë punojmë në grupe.

D- 3: Kam dëshirë të punojmë në grup se më ndihmojnë shoqet.

D- 4: Punojmë me shokët e shoqet dhe çdo gjë më shkon mirë.

D- 5: Mua më pëlqen kur punojmë bashkë sepse e kam më lehtë për ta përfunduar detyrën që na e ka dhënë mësuesja.

D- 6: Çdo orë punojmë në grupe dhe detyrat grupore i kryejmë së bashku.

D- 7: Mua më pëlqen të punojmë në grupe.

D- 8: Shokët dhe shoqet më ndihmojnë kur unë nuk di diçka por edhe unë i ndihmoj ata kur kanë nevojë.

D- 9: Unë jam e kënaqur që punojmë në grupe së bashku me shokët e klasës

D- 10: Në bashkëpunim në grup, secili shpreh mendimin e vet dhe njëri prej nesh zgjedhet përfaqësues i grupit.

D- 12: Detyrat e matematikës në grup i llogarisim më saktë.

D- 13: Gjatë mësimit mund t'i shprehim lirshëm mendimet tona.

D- 14: Më pëlqen të punojmë në grupe sepse jemi më afër shokëve.

D- 15: Gjatë punës në grupe të gjithë nxënësit marrin pjesë në aktivitete.

KONKLUZION

Bazuar në analizën e literaturës pedagogjike e didaktike për formën e punës në grupe në mësimdhënien interaktive, nga rezultatet e vërtetimit në klasë si dhe nga deklaratimet e nxënësve nxjerrim këto përfundime:

Efikasiteti i mësimdhënies tradicionale nuk mund të mohohet, por duhet pranuar që forma frontale e punës ka fushëveprim të kufizuar. Nga vërtetimi në klasë është vërtetuar se puna në grupe sjellë një klimë pozitive bashkëpunimi në klasë.

Në mbështetje të rezultateve konkludojmë se nxënësit gjatë punës në grupe janë më aktiv dhe bashkëveprojnë njëri me tjetrin.

Puna në grupe për nxënësit është interesante, të mësuarit është argëtues dhe nxënësit më lehtë përparojnë në mësim.

Nxënësit kanë arritur bashkëpunim më të mirë me shokët e klasës dhe kanë qasje më të mirë ndaj informacionit të prezentuar.

Është vënë re që gjatë orëve mësimore të gjithë nxënësit e kishin më lehtë për të shprehur atë që mendojnë apo e dinë, në bashkëpunim me të tjerët mësojnë të përdorin literaturën dhe të marrin pjesë në mënyrë aktive në procesin mësimor.

Në grupet heterogjene vërehet interaksioni në mes nxënësve më shumë sepse nxënësit më të mirë ndihmojnë nxënësit të cilët kanë vështirësi gjatë të mësuarit.

Në bazë të deklarimeve të nxënësve në focus-grup, shihet se nxënësit preferojnë që puna në grupe të zbatohet gjatë procesit mësimor, sepse nxitë pjesëmarrjen aktive dhe motivon të nxënësit ndërveprues. Në bazë të përgjigjeve të nxënësve mund të konstatojmë se ekziston gadishmëria dhe motivimi për të shprehur lirshëm idetë e tyre gjatë punës në grupe.

Rezultatet e nxjerra nga deklaratimet e shumicës së nxënësve për punën në grupe argumentojnë se në grup nxënësit janë të lirë të shprehin idetë e tyre, rritet konkurrenca në mësim, si dhe të nxënësit aktiv në klasë. Nxënësit dëshirojnë të punojnë në grupe sepse mësojnë mësimet më lehtë kur punojnë me shokë, ndihen më mirë, janë më bashkëpunues dhe krijohet ambient pune më i mirë.

Në fund , mendojmë se zbatimi i formës grupore në mësimdhënien interaktive ndikon edhe në socializimin e nxënësve duke i përgatitur për jetë dhe punë si një ndër kërkesat më bashkëkohore që i shtrohen shkollës sonë ku format e punës mësimore janë të drejtuara kah puna e përbashkët e mësimdhënësit dhe nxënësit.

Referenca:

1. Ангелоска-Галевска, Н. (1998), *Квалитативни истражувања во васпитанието и образованието*. Битола: Киро Дандаро.
2. Адамческа, С. (1996), *Активна настава*, Скопје: Легис.
3. Адамческа, Г. (2004), *Активности на учениците*, Скопје: Сонце.
4. Bognar, L. & Matijević, M. (2002), *Didaktika*, Zagreb: Školska knjiga.
5. Cohen, L., Manion, L. & Marrison, K. (2007), *Research methods in Education*. (5th Ed). London: Routledge/Falmer.
6. Grillo. K., (2002), *Fjalor edukimi*. Tiranë: Instituti i studimeve pedagogjike.
7. Ilić. M. (1999), *Od tradicionalne do kvalitetne škole*: Banja Luka.
8. Jensen, E. (2003), *Super nastava*, Zagreb: Educa.
9. Musai, B., (2014), *Metodologji e mësimdhënies*. Tiranë: CDE.
10. Meta, N. (1999), *Metodika e mësimet*, Tiranë: Geer.
11. Mattheës, B., & Ross, L. (2010), *Metodat e hulumtimit – Udhëzues praktik për shkencat sociale dhe humane*. Tiranë: CDE.

12. Miller, B. (2003), *Si të krijohet kontakti i suksesshëm me nxënësit*. Ferizaj: Qendra për Përparimin e Edukimit dhe Arsimit.
13. Nathanaili, V. (2011), *Reforma dhe legjislacioni: Arsimi parauniversitar*, Tiranë: Albanian University Press.
14. Novačevska, B. (2007), *Interaktivna Komunikacija*. Manastir.
15. Orlich, H. (1995), *Strategjitë e të mësuarit*, Tiranë: Eureka.

RËNDËSIA E KOMUNIKIMIT EFEKTIV NË MËSIMDHËNIE

Bashkim Ali AZEMI

shef i sektorit per arsim gjatë gjithë jetës në Institutin Pedagogjik të Kosovës

ABSTRAKT

Komunikimi është një nga nevojat e para për njeriun, andaj hapat e parë hidhen në fëmijëri. Në fillim si një mjet komunikimi të fëmijes me të rriturit, por në ecurinë e zhvillimit kur ndërgjegjësohen për ekzistencën e tij, ajo bëhet cilësi e brendshme dhe nis të përmbushë funksionin zhvillimor dhe intelektual për njeriun.

Për të realizuar këtë funksion pas prinderve mësimdhënsit duhet ta kenë parasyesh gjithnjë komunikimin, dhe e pranueshme dhe e dëshirueshm do të ishte një komunikim efektiv jo vetem gjatë shpjegimit dhe bashkëbisedimit me nxënës por edhe gjatë procesit të të pyeturit dhe vlersimin e nxënësve.

Aftësitë e mësimdhënsit në komunikim janë shumë të rëndësishme për të mësuarit e nxënësve në përkrahje, në mundësin për tu shprehur si dhe kohën për bashkëbisedim me nxënës në mënyrë të pavarur e kritike.

Aftësitë në komunikim në performancën e mësimdhënies cilesore duhet të merren në konsideratë, nga akteret e sistemit arsimor, poashtu edhe nga inspektorët dhe hulumtuesit arsimor. Si rrjedhim, nevoja për të zhvilluar aftësitë e një komunikimi efektiv të mesimdhënsve të rinjë gjatë përgatitjes së tyre universitare, është domosdoshmeri e kohës që në plan-programet e universiteteve publike dhe kolegjeve jopublike të jetë e përfshirë edhe lënda Komunikologji pedagogjike.

Qëllimi i këtij studimi është konstatimi se sa është i rëndësishëm është komunikimi efektiv i mesimdhënsit në klasë për ngritjen e cilësisë në mësim.

Pyetja kryesore : A duhet të ridimensionohet rëndësia e komunikimit të mësimdhënsit me nxënësit në funksion të mësimdhënies bashkohore?

Hipoteza e hulumtimit - Rëndësia e komunikimit efektiv nga këndvështrimi i mësimdhënsit.

Për realizimin e këtij studimi do të përdoren disa metoda si: Metoda e analizës teorike, Metoda e analizës së dokumentacionit, Metoda statistikore, Metoda e krahasimit.

Popullacionin e këtij hulumtimi e përbëjnë 1260 mësime të shkollave fillore dhe të mesme të ulëta të Kosovës, ndërsa grupin përfaqësues e përbëjnë 127 mësime

Hipoteza e hulumtimit - Rëndësia e komunikimit efektiv nga këndvështrimi i mësimit.

Fjalët kyçe: *Komunikim efektiv, Mësimdhënie, Nxënës.*

HYRJE

Qasjet e reja të mësimit theksojnë rëndësinë e madhe që ka komunikimi andaj kërkojnë nga mësuesit një **komunikim efektiv në mesimdhënie**.

Komunikimi efektiv në mesimdhënie është një proces i cili inicohet dhe orientohet nga mësuesi, duke pasur në fokus variacione atraktive të komunikimit që kanë efekt në motivimin e nxënësve, të cilat më pastaj nxisin tek nxënësit besimin për të komunikuar.

Nëpërmjet komunikimit efektiv në mësime mesimdhënie lënë përshtypje pozitive për nxënësit sidomos për nxënësit të cilët rrinë të mbyllur në vetvete, të pamotivuar, të painteresuar apo që janë introvert duke ndikuar në rritjen e besimit se mund të arrijnë suksese në mësim.

Për shkak të detyrave të shumfishta gjatë procesit të mesimdhënies, një pjesë e mësimeve nuk i kushtojnë vëmendjen e mjaftueshme komunikimit efektiv me nxënës. Andaj për mësuesit një nga prioritetet më të rëndësishme gjatë procesit mësimor duhet të jetë komunikimi efektiv me nxënësit.

METODOLOGJIA DHE METODAT

Qëllimi i hulumtimit

Ky studim për qëllim ka konstatimin e rëndësisë së komunikimit efektiv në mesimdhënie, me qëllimnë rritjen e cilësisë në mësim.

Pyetja kërkimore

A duhet të ridimensionohet rëndësia e komunikimit të mësimit me nxënësit në funksion të mësimit bashkohor?

Hipoteza e hulumtimit

Rëndësia e komunikimit efektiv nga këndvështrimi i mësimdhënësit.

Metodat e hulumtimit

Për realizimin e këtij studimi janë përdorur: Metoda e analizës teorike, Metoda e analizës së dokumentacionit, Metoda statistikore, Metoda e krahasimit.

Popullacioni dhe grupi përfaqësues

Popullacionin e këtij hulumtimi e përbëjnë 1260 mësimdhënës të shkollave fillore dhe të mesme të Kosovës, ndërsa grupin përfaqësues e përbëjnë 127 mësimdhënës

Instrumenti i hulumtimit

Si instrument i hulumtimit është përdorur shkalla likert me 5 shkallët e saj: Plotësisht dakord, dakord, i lëkundur, Jo dakord dhe aspak dakord, i përbërë nga tri pjesë me gjithsej 15 pyetje.

Analiza e të dhënave

Analiza dhe përpunimi i të dhënave janë bërë me anë të programit SPSS, ku përmes tabelave janë paraqitur mesataret, devijimi standard, përqindjet.

INTERPRETIMI I REZULTATEVE

Sa i përket dallimeve në nivelin e shkollimit vërejmë se:

		SHK			
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Nëntëvjeçare	90	71,4	71,4	71,4
	E memse e lartë	36	28,6	28,6	100,0
	Total	126	100,0	100,0	

Dallimet gjinore nuk janë të mëdha apo ..

		Gjinia			
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	MASHKULL	64	50,8	50,8	50,8
	FEMER	62	49,2	49,2	100,0
	Total	126	100,0	100,0	

Sa i përket moshës së mesimdhënësve të përfaqësuar në këtë studim vërehet se përqindja më e madhe është tek moshë 31-40

		Mosha			
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Deri 30	30	23,8	23,8	23,8
	31-40	56	44,4	44,4	68,3
	41-50	28	22,2	22,2	90,5
	51-60	10	7,9	7,9	98,4
	Mbi 60	2	1,6	1,6	100,0
	Total	126	100,0	100,0	

Nga aspekti i përgatitjes akademike sipas niveleve kemi vërejtur se....

		Përgatitja Arsimore			
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Master	32	25,4	25,4	25,4
	Fakultet	70	55,6	55,6	81,0
	Shkolla e lartë	24	19,0	19,0	100,0
	Total	126	100,0	100,0	

Besueshmëria e instrumentit

Reliability Statistics		
Cronbach's Alpha	Cronbach's Alpha Based on Standardized Items	N of Items
,731	,756	16

Besueshmëria e instrumentit të hulumtimit është mjaftë e lartë. Matja besueshmërisë është bërë me Alpha Chronbah, dhe është .731.

Pyetja Kryesore					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Jo	2	1,6	1,6	1,6
	Po	124	98,4	98,4	100,0
	Tota	126	100,0	100,0	

Në pyetjen kryesore, A duhet të ridimensionohet rëndësia e komunikimit të mësimdhënësit me nxënësit në funksion të mësimdhënies bashkëkohore, 98.4 % e mësimdhënësve janë shprehur se janë për ridimensionim, ndërsa 1.6 % janë shprehur kundër ridimensionimit.

Pyetjet rreth çështjes

		Plotësisht dakord	Dakord	I lëkundur	Jo dakord	Aspak dakord
1	Mësimdhënësit duhet të jenë model ë mënyrën e komunikimit	58.7%	37.7%	1.6%	0%	0%

2	Vlerësimi i performancës së mësimdhënësit duhet t'ia shtojmë edhe aftësinë në komunikim	52.4 %	39.7%	6.3%	1.6%	0%
3	Aftësitë në komunikim duhet të merren në konsideratë në analizë e mësimdhënies cilësore	41.3 %	47.6%	7.9%	3.2%	0%
4	Komunikimi efektiv është i rëndësishëm kur na ndihmon të menaxhojmë me sukses mësimdhënien në klasë	58.7%	34.9%	3.2%	3.2%	0%
5	Element i rëndësishëm që e bënë më efektiv procesin e mësimdhënies është komunikimi	49.2%	44.4%	6.3%	0%	0%
6	Komunikim konsiderohet dialogu	19%	34.9%	17.5%	22.2%	6.3%
7	Aftësitë komunikuese të mësimdhënësve si ofrues të njohurive dhe aftësitë për të bashkëbiseduar duhen vlerësuar	27%	61.9%	7.9%	1.6%	1.6%
8	Komunikimi në mësimdhënie nuk është unik	14.3 %	38.1%	15.9%	27%	4.8%
9	Komunikimi është i rëndësishëm për sigurinë dhe vetëbesimin e nxënësve gjatë procesit të vlerësimit	41.3 %	44.4%	9.5%	4.8%	0%
10	Komunikimi nënkupton përkrahjen që iu ofron mësimdhënësi nxënësve për t'u shprehur në mënyrë të pavarur gjatë bashkëbisedimit	44.4 %	39.7%	11.1%	4.8%	0%
11	Gjatë komunikimit me nxënësin duhet respektuar etikën e mësimdhënies	65.1 %	33.3%	1.6%	0%	0%
12	Të mësuarit përmes komunikimit mësimdhënës-nxënës është një proces i bazuar në njohuri interpretuese	33.3%	47.6%	11.1%	7.9%	0%
13	Një aspekt i rëndësishëm për të qenë një mësimdhënës motivues është komunikimi	52.4%	34.9%	9.5%	3.2%	0%
14	Mësimdhënësit duhet t'ia trajtojnë procesin e komunikimit në mësimdhënie në mënyrë sa më efektive	46 %	46%	6.3%	1.6%	0%
15	Mësimdhënësit pjesën më të madhe të kohës janë të angazhuar në procesin e komunikimit	23.8%	33.3%	25.4%	12.7%	4.8%

Lidhur me pohimin se Mësimdhënësit duhet të jenë model në mënyrën e komunikimit, 96.4 % e mësimdhënësve kanë qëndrim akordues, 1.6 % kanë qëndrim neutral dhe asnjë nuk ka qëndrim negativ.

Me pohimin se Vlerësimi i performancës së mësimdhënësit duhet t'ia shtojmë edhe aftësinë në komunikim, 92.1 % e mësimdhënësve kanë qëndrim akordues, 6.3 % qëndrim neutral dhe 1.6 % qëndrim negativ.

Në pikën Aftësitë në komunikim duhet të merren në konsideratë në analizë e mësimdhënies cilësore, 88.9 % e mësimdhënësve janë dakord, 7.9 % kanë qëndrim neutral dhe 3.2 % qëndrim negativ.

Në pikën Komunikimi efektiv është i rëndësishëm kur na ndihmon të menaxhojmë me sukses mësimdhënien në klasë, 93.6 % e mësimdhënësve kanë qëndrim akordues, 3.2 % qëndrim neutral dhe 3.2 % qëndrim negativ.

Në pikën Element i rëndësishëm që e bënë më efektiv procesin e mësimdhënies është komunikimi, 93.6 % e mësimdhënësve kanë qëndrim akordues, 6.3 % qëndrim neutral dhe asnjë nuk ka qëndrim negativ.

Me pohimin se Komunikim konsiderohet dialogu, 53.9 % e mësimdhënësve janë dakord, 17.5 % kanë qëndrim neutral dhe 28.5 % kanë qëndrim të kundërt me këtë pohim.

Lidhur me pohimin se Aftësitë komunikuese të mësimdhënësve si ofruet të njohurive dhe aftësitë për të bashkëbiseduar duhen vlerësuar, 88.9 % e mësimdhënësve janë dakord, 7.9 % kanë qëndrim neutral dhe 3.2 % kanë qëndrim të kundërt me këtë pohim.

Lidhur me pohimin se Komunikimi në mësimdhënie nuk është unik, 52.4 % pajtohen, 15.9 % janë neutral, 31.8 % nuk pajtohen.

Lidhur me pohimin se Komunikimi është i rëndësishëm për sigurinë dhe vetëbesimin e nxënësve gjatë procesit të vlerësimit, 85.7 % pajtohen, 9.5 % janë neutral dhe 4.8 % kanë qëndrim të kundërt.

Lidhur me pohimin se Komunikimi nënkupton përkrahjen që iu ofron mësimdhënësi nxënësve për t'u shprehur në mënyrë të pavarur gjatë bashkëbisedimit, 84.1 % e mësimdhënësve pajtohen, 11.1 % kanë qëndrim neutral dhe 4.8 % kanë qëndrim të kundërt.

Lidhur me pohimin se Gjatë komunikimit me nxënësin duhet respektuar etikën e mësimdhënies, 88.4 % e mësimdhënësve kanë qëndrim akordues, 1.6 % kanë qëndrim neutral dhe asnjëri nga mësimdhënësit nuk ka qëndrim të kundërt me këtë pohim.

Lidhur me pohimin se Të mësuarit përmes komunikimit mësimdhënës-nxënës është një proces i bazuar në njohuri interpretuese, 80.9 % e mësimdhënësve kanë qëndrim akordues, 11.1 % e mësimdhënësve kanë qëndrim neutral, ndërsa 7.9 % e mësimdhënësve kanë qëndrim të kundërt me këtë pohim.

Lidhur me pohimin se Një aspekt i rëndësishëm për të qenë një mësimdhënës motivues është komunikimi, 87.3 % e mësimdhënësve kanë qëndrim dakordues, 9.5 % kanë qëndrim neutral dhe 3.2 % kanë qëndrim të kundërt.

Lidhur me pohimin se Mësimdhënësit duhet t'a trajtojnë procesin e komunikimit në mësimdhënie në mënyrë sa më efektive, 92 % e mësimdhënësve kanë qëndrim akordues me këtë pohim, 6.3 % kanë qëndrim neutral dhe 1.6 % kanë qëndrim të kundërt me këtë pohim.

Lidhur me pohimin se Mësimdhënësit pjesën më të madhe të kohës janë të angazhuar në procesin e komunikimit, 57.1 % e mësimdhënësve kanë qëndrim akordues, 25.4 % kanë qëndrim neutral dhe 17.5 % kanë qëndrim të kundërt me këtë pohim.

MESATARJA DHE DEVIJIMI STANDARD

Mesatarja e rezultateve është mjaftë e lartë, duke filluar nga pyetja e parë, kur nga maksimumi që është 2, mesatarja është 1.98, pastaj pyetja e 11, mesatarja është 4.63, pyetja 1, mesatarja 4.57, pyetja e katër me mesatare prej 4.49, pyetjet 2 dhe 5 me mesatare prej 4.43, pyetjet 13 dhe 14 me mesatare prej 4.37, pyetja 3 me mesatare prej 4.27, pyetja 10 me mesatare prej 4.24, pyetja nëntë me mesatare prej 4.22, pyetja e shtatë me mesatare prej 4.11, pyetja 12, me mesatare prej 4.06, pyetja e 15 me mesatare prej 3.59, e gjashta me 3.38 dhe e teta me 3.3. Sa I përket devijimit standard, në përgjithësi grupimi është i mirë, përjashtimisht, në pyetjen e gjashtë pyetjen e tetë dhe në pyetjen e pesëmbëdhjetë.

Item Statistics			
	Mean	Std. Deviation	N
PK	1,98	,125	126
P1	4,57	,528	126
P2	4,43	,686	126
P3	4,27	,742	126
P4	4,49	,713	126
P5	4,43	,612	126
P6	3,38	1,206	126
P7	4,11	,740	126
P8	3,30	1,154	126
P9	4,22	,809	126
P10	4,24	,834	126
P11	4,63	,515	126
P12	4,06	,874	126
P13	4,37	,786	126
P14	4,37	,676	126
P15	3,59	1,126	126

KONKLUZION

Aftësitë e mësimdhënësit në komunikim janë shumë të rëndësishme për të mësuarit e nxënësve në përkrahje, në mundësin për tu shprehur si dhe kohën për bashkëbisedim me nxënës në mënyrë të pavarur e kritike.

Aftësitë në komunikim në performancën e mësimdhënies cilësore duhet të merren në konsideratë, nga akteret e sistemit arsimor,poashtu edhe nga inspektorët dhe hulumtuesit arsimor. Si

rrjedhim, nevoja për të zhvilluar aftësitë e një komunikimi efektiv te mesimdhensve të rinjë gjatë përgatitjes së tyre universitare, është domosdoshmeri e kohës që në plan-programet e universiteteve publike dhe kolegjeve jopublike të jetë e përfshirë edhe lënda Komunikologji pedagogjike.

Referenca:

1. Miller, Bonnie: Si të krijohet kontakti i suksesshëm me nxënësit, QPEA, Ferizaj, 2005;
2. Muka, P.: Të mësuarit me objektiva dhe Modeli, Eureka, Tiranë, 1995;
3. Musai, Bardhyl: Mjeshtëritë themelore të mësimdhënies, SHBLU, Tiranë 1997;
4. Musai, Bardhyl: Metodologji e mësimdhënies, , Tiranë, 2014;
5. Garo, Sofokli: Sfidat e mësimdhënies, Tiranë, 2002.

DHËNIA DHE NXËNIA E GJUHËS ANGLEZE NË KLASA ME SHUMË NXËNËS: RAST STUDIMI NË SHQIPËRI

Dr. Dorjana KLOSI

dorianaklosi@gmail.com

Doc. Lulzim HAJNAJ

Lecturers

Blv. Vlorë- Skele, Albania

lulzimhajnaj@yahoo.com

ABSTRAKT

Punimi ynë bazohet në dy elemente të rëndësishme të studimit: hulumtimi teorik i punimeve shkencore të fundit dhe përfundimet e arritura nga realizimi konkret i planifikimit e realizimit të mësimdhënies në shkollë të mesme. Planifikimi i procesit mësimor, vendimarrja në lidhje me metodat e teknikat e mësimdhënies që do të përdoren në orën e mësimimit duhet të bazohen në qëllimin e rëndësishëm të nxitjes së të menduarit kritik nga ana e nxënësve. Pra, motivimi, objektivat, organizimi i klasës në grupe pune, reflektimi etj., janë disa nga çështjet që trajtohen në punim.

Planifikimi i metodave të mësimdhënies e mësimnxënies janë pjesë të rëndësishme të procesit dhënie-nxënie. Pikërisht, nëpërmjet këtyre dy proceseve realizohet objektivi thelbësor i të mësuarit të gjuhës së huaj: zotërimi i njohurive dhe aftësive për të komunikuar në gjuhën e huaj.

Fjalë Kyçe: *Mësimdhënie, motivimi, objektivat, organizimi i klasës në grupe pune, reflektimi.*

HYRJE

Mësimi i gjuhës së huaj gjen shtrirje të gjerë në sistemin arsimor shqipëtar. Ministria e Arsimit e Sportit ka investuar se tepërmi në këtë drejtim duke u përqëndruar më tepër në përhapjen e gjuhës angleze. Si rezultat, ky diskutim gjen shtrirje në dy plane: perspektivat teorike dhe zbatimi i tyre në praktikë.

Në këtë situatë është domosdoshmëri trajnimi dhe kualifikimi i mësuesve të gjuhës angleze sipas metodave bashkëkohore të mësimdhënies. Proceset e mësimdhënies dhe mësimnxënies janë baza e arsimit. Është tejet e rëndësishme që këto procese të ndërlihdura ngushtë me njëri-tjetrin, të hartohen paraprakisht dhe realizohen në mënyrë sa më gjithëpërfshirëse në klasë. Në këtë situatë, rolin kryesor të udhëheqësit e modelit e kryen mësuesi i cili nëpërmjet përdorimit të duhur të metodave bashkëkohore me në qendër nxënësin duhet të realizojë objektivin kryesor të mësimdhënies: nxënësi në qendër të procesit mësimor dhe autonomia e tij. Pra, dhënia dhe nxënia e informacionit janë të lidhura ngushtë, duke bërë që mësuesi, nxënësi dhe kurrikula të organizohen në mënyrë të tillë që secili element të kalojë në disa faza. (fig. 1)

1. a PLANIFIKIMI I PROCESIT TË DHËNIES DHE NXËNIES

Duke u bazuar në përvojën shumë vjeçare në mësimdhënie, mendojmë se planifikimi i orës mësimore është hap tejet i rëndësishëm. Përcaktimi i qartë i objektivave që duhen realizuar, metodat dhe teknikat që do të përdoren për realizimin e objektivave, aktiviteteve që do të zhvillohen në klasë, pyetjet drejtuar nxënësve, ushtrimet etj., janë disa prej vendimeve që çdo mësues duhet të marrë përpara realizimit të orës së mësimi.

Gjatë shfletimit të literaturës dhe realizimit konkret të objektivave tona në orën e gjuhës angleze, pranë shkollës së mesme Halim Xhelo, Vlorë, u vërejt bashkëveprim i ngushtë ndërmjet tre elementëve.

1. Planifikim i saktë i objektivave para procesit mësimor.
2. Zbatimi i objektivave gjatë orës së mësimi.
3. Procesi i reflektimit pas orës së mësimi.

Pavarësisht, përvojës mësimore që mësuesit mund të kenë në mësimdhënie, ata duhet t'u kushtojnë kohë e përgatitje fazës së parë e të dytë të planifikimit dhe realizimit në praktikë të objektivave të punës. E rëndësishme është të ndiqet një rregullsi logjike në orën e mësimi në mënyrë që asgjë të mos të lihet rastësisë. Në këtë rast, përfshihet edhe menaxhimi i klasës, që për hir të të vërtetës, në Shqipëri klasat e shkollave publike janë të mbipopulluara. Në orën e

mësimin mund të ndodhin situata të paparashikuara, që mësuesi si menaxher i klasës, duhet tu japë zgjidhje.

1. b FAKTORËT QË KUSHTËZOJNË PROCËSIN E SUKSESSHËM TË MËSIMDHËNIES

Përvoja e disa dekadave e autorëve në mësimdhënie na jep sigurinë të shprehemi me bindje se dhënia e informacionit është e realizuar nëse këta elementë merren parasysh para dhe gjatë orës së mësimin:

- a) Rritja e interesit të nxënësve nëpërmjet metodave dhe aktiviteve të ndryshme;
- b) Menaxhimi i situatave të paparashikuara;
- c) Krijimi i atmosferës së duhur në orën e mësimin, duku ulur nivelin e stresit në klasë;
- d) Dhënia e kërkesave në mënyrë të qartë e të saktë;
- e) Analizim e reflektim për ecurinë e orës së mësimin, mësuesi duhet të vlerësojë elementët teknikë që ishin të suksesshëm dhe ata jo të suksesshëm me qëllim përmirësimin e tyre.

Si rezultat, mund të shprehemi se organizimi i mirë i orës mësimore është çelësi i suksesit të mësimdhënies. Planifikimi, si proces intelektual e konjitiv, përfshin marrjen e vendimeve në lidhje me përzgjedhjen e objektivave, metodave, informacionin, zbatimin e projektimin e tyre në orën e mësimin, modelin e performancës së mësuesit etj.

RAST STUDIMI

350 nxënës të shkollës së mesme “Halim Xhelo” ishin pjesë aktive e studimit dhe zhvillimin e aftësive të ndryshme gjuhësore.

Për realizimin e plotë të studimit u përzgjedhën një numër i gjerë aktivitetesh bashkëkohore të cilat nxisin mësimin dhe nxënien e gjuhës angleze.

2. METODAT PËR TË NXITUR MËSIMDHËNIEN DHE MËSIMNXËNIEN

- I. **Aktivite për të zhvilluar e nxitur mendimin kritik.** Nxënëit mësojnë të argumentojnë, reflektojnë e vlerësojnë informacionin e dhënë. Ndër aktivitetet të cilat

zhvillojnë këto aftësi mund të përmendim: esetë, review, ditaret, komentet mbi një artikull të caktuar etj.

- II. **Aktivite për zgjidhjen e problemeve:** puna në grup, analizimi i një çështjeje.
- III. **Aktivite prezantuese para klasës.** Ndër të cilat mund të përmendim: demonstrimin, aktrimin, prezantimin e një posterit etj.
- IV. **Aktivite për nxitjen e punës individuale dhe punës në grup.** Qëllimi i tyre ishte aftësimi i nxënësve për të kryer një detyrë në mënyrë të pavarur, të jenë të organizuar për të gjidhur kërkesat e detyrës, të menaxhojnë kohën etj. Ndërsa puna në grup nxit bashkëveprimin e nxënësve të cilët kishin njohuri të nivele të ndryshme të gjuhës angleze.
- V. **Aktivite për aksesimin dhe menaxhimin e informacionit.** Ky objektivi u realizua nëpërmjet aktiviteteve si: projekte, detyra kurse etj. Pra, kërkimi, organizimi i materialit, rishikimi i tij, perifrazimit dhe interpretimi u dhanë mundësi nxënësve të evidentonin aftësitë e tyre.
- VI. **Aktivite të ndryshme bazuar në kontrollin e njohurive.** Si ushtrime të llojeve të ndryshme, provime të realizuara në formë të shkruar e verbale ishin gjithashtu pjesë e zhvillimit dhe kontrollit të njohurive.
- VII. **Komunikimi, element i rëndësishëm i gjuhës angleze,** e jo vetëm, u nxit e zhvillua nëpërmjet aktiviteteve si: prezantime në formë të shkruar e të folur, diskutime e debate për tema të caktuara, aktrimi, puna në grup etj.

Kjo është një listë e aktiviteteve dhe teknikave të përdorura në studim. Qëllimi kryesor ishte zhvillimi i aftësive si: krijimi, prezantimi, të kuptuarit, komunikimi i folur dhe i shkruar, zgjidhja e ushtrimeve, të menduarit kritik etj.

DISKUTIM

Elementi kryesor për të pasur sukses në mësimdhënie është ta kuptosh atë si një proces dinamik dhe bashkëpunimi. Pra, lidhja e ndërsjellë midis mësuesit dhe nxënësve është me rëndësi për realizimin e aktiviteteve të shumta.

Mënyra e të vepruarit e menduarit të nxënësve ndikon në faktorë të tillë si realizimi i detyrave, rolet e mësuesit etj. Ndërsa, stili i mësimdhënies ndikon në nxitjen e dhënies dhe marrjes së informacionit.

Bazuar në bisedat, pyetësorët me 350 nxënës të shkollës së mesme të përgjithshme “Halim Xhelo”, si dhe vëzhgimet e kryera në orët mësimore u konkludua se:

- Aktivitete për të zhvilluar e nxitur mendimin kritik:** esetë, revieë, ditaret, komentet mbi një artikull të caktuar.

Shumë 96ire [60 %]	Mirë [25 %]	Neutral [9 %]	Jo 96ire [6 %]	Keq [--]
---------------------	--------------	---------------	-----------------	------------

- Aktivitete për zgjidhjen e problemeve:** puna në grup, analizimi i një çështjeje.

Shumë 96ire [85 %]	Mirë [13 %]	Neutral[3 %]	Jo 96ire [--]	Keq --]
---------------------	-------------	--------------	---------------	---------

- Aktivitete prezantuese para klasës:** demonstrimin, aktrimin, prezantimin e një posterit etj.

Shumë 96ire [30 %]	Mirë [40 %]	Neutral [15 %]	Jo 96ire [8 %]	Keq [7 %]
---------------------	--------------	-----------------	-----------------	------------

- Aktivitete për nxitjen e punës individuale dhe punës në grup,**

Shumë 96ire [45 %]	Mirë [40 %]	Neutral [12 %]	Jo 96ire [--]	Keq [3 %]
---------------------	--------------	----------------	---------------	------------

- Aktivitete për aksesimin dhe menaxhimin e informacionit.**

Shumë 96ire [68 %]	Mirë [16 %]	Neutral [4 %]	Jo 96ire [2 %]	Keq [--]
---------------------	-------------	----------------	-----------------	----------

- Aktivitete të ndryshme bazuar në kontrollin e njohurive.**

Shumë 96ire [40 %]	Mirë [25 %]	Neutral [35 %]	Jo 96ire [7 %]	Keq [3 %]
---------------------	--------------	----------------	-----------------	------------

- Komunikimi, element i rëndësishëm i gjuhës angleze:** prezantimie në formë të shkruar e të folur, diskutime e debate për tema të caktuara, aktrimi, puna në grup.

Shumë 96ire [55 %]	Mirë [30 %]	Neutral [10 %]	jJo 96ire [3 %]	Keq [--]
---------------------	--------------	----------------	------------------	----------

Tabelë 1. Rezultatet e përdorimit të metodave të ndryshme të paraqitura në %

Rreth 40 % e nxënësve treguan aftësi të mirat analizuese e interpretuese nëpërmjet aktiviteteve si ese, ditare, analizim i një çështjeje, punë në grup, projekte etj.

Aktivitete të tilla si: shkrimi i letrave, eseve, artikujve të ndryshëm, analizimi i temave, puna në grup, projektet, prezantimet ishin tejet të suksesshme. Disa nxënës, rreth 15 % , nuk patën ndonjë ndikim apo ndryshim nga përdorimi i këtyre metodave, disa prej tyre u shprehën se për ta nuk kishte rëndësi metodat që përdorte mësuesi por informacioni të jepej i saktë dhe i qartë. Ndërsa 10 % e nxënësve pjesëmarrës në studim nuk kishin shumë dëshirë të punonin e mësonin me metoda e teknika të tjera përveç atyre që mësuesi i gjuhës angleze përdorte zakonisht në klasë. Opinionet të ndryshme u shprehën për këtë çështje: nuk ishin mësuar të punonin me metoda të tilla, nuk kishin ndonjë mendim konkret për tematika të ndryshme, disa ishin të turpshëm të flisnin përpara klasës.

Një grup i vogël nxënësish, rreth 20 %, pranuan se ndiheshin të stresuar gjatë realizimit të kontrollit të njohurive, vetëm 3 % e nxënësve pjesëmarrës preferuan provimin nëpërmjet të folurit në vend të provimit me shkrim.

KONKLUZION

Planifikimi i procesit të mësimdhënies është tejet i rëndësishëm për lehtësimin e mësimnxënies dhe është ndihmesë për punën e mësuesit. Renditja logjike e kronologjike e etapave të mësimin ndihmon mësimdhënësin të kontrollojë e menaxhojë klasën dhe situatat e paparashikuara.

Metodologjistë shqiptarë dhe të huaj, në studimet e tyre, theksojnë se planifikimi i dhënie dhe nxënies së informacionit është kusht i domosdoshëm për sukses.

Gjithashtu, ky përfundim u arrit edhe në studimin tonë. Planifikimi i mirë i orës mësimore kushtëzon suksesin e mësimin dhe objektivave të tij.

Nëpërmjet planifikimit, mësuesit kanë mundësi të njohin materialin, të shtojnë informacion shtesë, të përcaktojnë aktivitetet, ushtrimet, pyetjet dhe metodat e teknikat me qëllim përfshirjen sa më të madhe të nxënësve në orën mësimore dhe përcjelljen e saktë e të qartë të materialit të ri.

Referenca:

1. Cochran-Smith, M., & Fries, M. (2001). Sticks, stones, and ideology: The discourse of reform in teacher education. *Educational Researcher*, 30(8), 3–15.
2. ¹Darling-Hammond, L. (1997). *The right to learn: A blueprint for creating schools that work*. San Francisco: Jossey-Bass.
3. **Murati, Prof. Dr. Xheladin. Didaktika (Metodologjia e mësimdhënies)**, Tetovë, 2002
4. Brookfield, S. J. and Preskill, S. (1999) Discussion as a Way of Teaching: Tools and Techniques for a Democratic Classroom. (CA: Jossey Bass), page 49.
5. Nightingale, P., Te Wiata, I.T., Toohey, S., Ryan, G., Hughes, C., Magin, D. (1996) Assessing Learning in Universities Professional Development Centre, University of New South Wales, Australia
6. Cohen, D., & Lowenberg Ball, D. L. (2001). *Making change: Instruction and its improvement*. Phi Delta Kappan.

METODA BASHKËKOHORE PËR REALIZIMIN E VLERËSIMIT PËRFUNDIMTAR ME NOTË NË LËNDËN E GJUHËS ANGLEZË

Dr. Dorjana KLOSI

University — Ismail Qemali Vlore

Lecturer

Blv. Vlorë- Skele, Albania

dorianaklosi@gmail.com

ABSTRAKT

Vlerësimi ditor i nxënësve është etapë tejet e rëndësishme, e cila ndihmon mësuesin të përcaktojë ecurinë dhe vështirësitë që nxënësit hasin gjatë procesit të mësimnxënies. Në këtë mënyrë, mësuesit mund të lehtësojnë të mësuarin e nxënësve në çështjet që ata hasin vështirësi. Vlerësimi ditor dhe përfundimtar, objektivat që duhet të realizohen, arsyet e vlerësimit dhe përmirësimet që mësuesi duhet të bëjë, detyrat e shtëpisë, testimet, provimet dhe përparësitë/ të metat e tyre janë çështje që trajtohen gjerësisht në punim.

Qëllimi kryesor i punimit është realizimi i vlerësimit ditor dhe përfundimtar në orën e gjuhës angleze. Metodatat e përdorura për të realizuar vlerësimin janë pjesë thelbësore e procesit të dhënies-nxënies së informacionit. Por cilat janë metodatat e teknikat e përdorura për të arritur rezultate të larta në gjuhën angleze e për të përmirësuar aftësi të tilla si: komunikimi verbal dhe i shkruar, të kuptuarit e gjuhës së angleze dhe sintetizimi i informacionit? Mbi të gjitha të zhvillohet e nxitet aftësia e të menduarit në gjuhën e huaj. Kështu që, komunikimi të jetë sa më i natyrshëm në gjuhën angleze.

Provimet dhe testimet me shkrim, ditarët, punë kërkimore, përmbledhje e sintetizim i informacionit, prezantimi i detyrave para klasës, vlerësimi individual dhe vlerësim nga shokët e klasës janë disa nga metodatat e përdorura në studimi për të përftuar vlerësim objektiv e të saktë. Mendimet e mësuesve dhe nxënësve për përparësitë e të metat e këtyre metodave përbëjnë boshtin e rezultateve dhe diskutimeve në punim.

Fjalë Kyçe: *Studentë, vlerësim, metoda, reflektim, evulim.*

HYRJE

Në dekadën e fundit, sistemi arsimor në Shqipëri po kalon disa faza ndryshimi, ndër të cialt rëndësi i është kushtuar mësimdhënies, kontrollit të njohuri e vlerësimit përfundimtar me notë. Përpjekje janë bërë për zëvendësimin e metodave tradicionale të kontrollit të njohurive me metoda të tjera bashkëkohore. Standardet e kontrollit të njohurive dhe vlerësimit përfundimtar të nxënësve kanë ndryshuar duke u përqëndruar jo më në vlerësimin e njohurive, por në vlerësimin e kompetencës. Për më tepër, është me rëndësi shmangia e subjektivizmit gjatë vlerësimit me notë.

1. METODOLOGJIA

I. Organizimi i ndërveprimeve

- **Përzgjedhja e pjesëmarrësve** (pjesëmarrësit u përzgjedhën në bazë të gjuhës së huaj)
- **Vend i realizimit të bisedës** (klasa të niveleve të ndryshme në shkollën e mesme të përgjithshme “Halim Xhelo”)
- **Tematika e bashkëveprimit** (metodat e teknikat e mësimdhënies së gjuhës së huaj: anglisht)

Subjektet

Subjekti kryesor i vëzhgimeve, bisedave dhe anketimeve janë nxënësit e viteve të para, të dyta dhe të treta të shkollës e mesme të përgjithshme “Halim Xhelo.

2. PERSPEKTIVA TEORIKE

1.1 Natyra e kontrollit të njohurive dhe vlerësimit përfundimtar

Informimi dhe udhëzimi i duhur janë të rëndësishëm për mësimdhënien dhe procesin e kontrollit të njohurive. Për realizimin e plotë, të saktë e objektiv të kontrollit dhe vlerësimit të njohurive duhen përdorur një shumëllojshmëri metodash vlerësuese. Në Shqipëri vazhdojnë të bëhen përpjekje për ndryshimin e konceptit të vlerësimit. Nota apo vlerësimi me shprehje, tashmë nuk konsiderohen vetëm si përcaktues të nivelit të nxënësit në një lëndë të caktuar, por ato janë elementi i cili ndihmon nxënësit të monitorojnë e vlerësojnë vetë ecurinë e tyre në mësim¹

¹ Osmani, Shefik. **Fjalor i pedagogjisë**, Tiranë, 1999.

1.2 Roli dhe rëndësia e kontrollit të njohurive e vlerësimit përfundimtar

Tashmë në metodologjinë vendase dhe të huaj i kushtohet rëndësi e veçantë këtyre dy elementëve². Procesi i dhënies dhe nxënies së informacionit është i paplotë pa fazën përfundimtare të vlerësimit me notë.

Në klasë, roli i mësuesit dhe nxënësit është i lidhur ngushtë me këto dy elemente:

- Dualizmi ndërmjet dhënies dhe nxënies së informacionit,
- Vlerësimi i kontrollit të njohuri.

Për këtë arsye, këto dy etapa kanë rëndësi për mësuesin e nxënësin.

Për mësuesin:

- Kontrolli dhe vlerësimi i njohurive siguron informacion cilësor për të përmirësuar më tepër orën mësimore, metodologjinë, materialet mësimore etj.,
- Kontrolli dhe vlerësimi i njohurive siguron informacion të vlefshëm e krahasues për të vlerësuar ecurinë e nxënësve.
- Kontrolli dhe vlerësimi i njohurive është mjeti që drejton mësuesit për të përmirësuar mësimnxënien.

Për nxënësin³, kontrolli dhe vlerësimi i njohurive është etapë e rëndësishme sepse:

- Ky proces i ndihmon ata të analizojnë më mirë të mësuarin e tyre,
- Kontrolli dhe vlerësimi i njohurive nxjerr në pah nevojat e tyre për tu përqëndruar në aftësitë më të mira që ata kanë,
- Ky proces i ndihmon nxënësit të ndryshojnë stilin e të mësuarit nëse është e nevojshme.

² Cerbin, William (1994), "The course portfolio as a tool for continuous improvement of teaching and learning." *Journal on Excellence in College Teaching*.

³ Angelo, T.A. & Cross, P.K. (1993). *Classroom Assessment Techniques* (2nd ed.). San Francisco: Jossey-Bass.

3. METODA BASHKËKOHORE PËR REALIZIMIN E KONTROLLIT TË NJOHURIVE DHE VLERËSIMIT PËRFUNDIMTAR

Në lëminë e metodologjisë janë të shumta metodat e vlerësimit të studiuara në praktikë⁴. Lind pyetja: cila metodë është më efektive e praktike për të kontrolluar njohuritë e nxënësve?

Përpara huazimit dhe zbatimit të tyre në klasë, është me rëndësi përshtatja e teknikave e metodave me kulturën e praktikën mësimore vendase. Gjithashtu, është me rëndësi të zgjidhet metoda e cila përshtatet me objektivat e temës, qëllimin e programit dhe aftësitë e nxënësve, të cilat mësuesi do të vlerësojë.

Ndër metodat⁵ për të përdorura në studimin tonë për realizimin sa më të plotë e të saktë të vlerësimit me notë të nxënësve, mund të përmendim: provim, testim, detyrë me shkrim, punë kërkimore, ese, përmbledhje e sintetizimi i informacionit, performancë dhe prezantim i detyrave, vlerësim i ecurisë individuale, vlerësim nga shokët e klasës etj.

RAST STUDIMI

4. REZULTATET

300 nxënës të shkollës së mesme të përgjithshme “Halim Xhelo” morën pjesë në studim. Mësuesve të gjuhë angleze iu kërkua të kontrollonin njohuritë dhe vlerësonin me notë nxënësit e klasave të 10-ta, 11-ta e 12-ta, nëpërmjet metodave e teknikave të lartpërmendura.

Vëzhgimet e kryera dhe bisedat me nxënësit e mësuesit, ndihmuan në përcaktimin e përparësive e të metave të secilës prej metodave. Kjo u dha mundësi mësuesve të ndryshonin e përmirësonin teknikat e metodave të klasë.

Ndër përparësitë e **provimeve dhe testeve me shkrim** mund të përmendim:

- Nxënësit testohen për një gamë të gjerë njohurish,
- Nxënësit kanë mundësi të shprehen me fjalët e tyre,

⁴ Theall, Michael and Franklin, Jennifer, Eds. (2006). Student Ratings of Instruction: Issues for Improving Practice, New Directions in Teaching and Learning, No. 43

⁵ Changing Practices in Evaluating Teaching: A Practical Guide to Improved Faculty Performance and Promotion/Tenure Decisions (MA: Anker Press):

- Nxënësit testohen për koncepte në përgjithësi e jo për çështje të veçanta,

Në rastet e përdorimit në provim të ushtrimeve me shumë alternative, përparësitë janë:

- Ulje e nivelit të stresit në lidhje me vlerësimin. Nxënësit nuk përjetojnë të njëjtin stres që përjetojnë në rastet e provimeve të zhvilluara nëpërmjet të folurit.
- Këto ushtrime janë të sakta, sepse vetëm një përgjigje është e saktë.
- Këto ushtrime janë njësi matëse të mira për të përcaktuar të kuptuarin dhe aftësitë analizuese të nxënësve.

Mësuesit përcaktuan qartazi edhe disa të meta të provimeve me shkrim:

- Nxënësit nuk marrin spjegim për vlerësimin e tyre.
- Vlerësohet më tepër teknika e realizimit të provimit sesa cilësia e përvetësimit të materialit.
- Nxënësit vlerësohen në bazë të paraqitjes së tyre në një ditë të caktuar.
- Nxënësit mund të moskuptojnë kërkesën e ndonjë ushtrimi.

Në lidhje me ushtrimet me shumë përgjigje, të metat e evidentuara janë:

- Hamendësim i përgjigjeve. Ndonëse rezultati mund të jetë i saktë, kjo nuk tregon nivelin e njohurive të nxënësve.
- Hartimi i ushtrimeve të tilla është i lodhshëm për mësuesin dhe kërkon kohë të realizohet.
- Nuk krijojnë hapësirë të mjaftueshme për krijimtarinë e nxënësve.

Detyra me shkrim⁶ u ofron nxënësve mundësinë për të shfaqur aftësitë e tyre në shkrim, por kërkon kohë për përgatitje, si dhe jo të gjithë nxënësit arrijnë të shprehen saktë në detyrën me shkrim.

Ditarët janë një alternativë tjetër për kontrollimin e njohurive e vlerësimin me notë. Në këtë mënyrë, nxënësit mund të shprehin ndjenjat, mendimet për një temë të caktuar.

Përparësitë e mbajtjes së ditarëve janë:

⁶ Cohen, D., & Lowenberg Ball, D. L. (2001). Making change: Instruction and its improvement. *Phi Delta Kappan*, 83,73–77.

- Nxit reflektimin dhe vetë-vlerësimin;
- Zhvillon përgjegjësinë individuale.

Ndër të metat e mbajtjes së ditarëve, mund të përmendim:

- Nxënësit mund të shmangen nga detyrimet e tyre, duke paraqitur një punë jo serioze;
- Kërkon kohë të përgatitet;
- Duhet vendosur kritere të qarta vlerësimi.

Punë kërkimore, përmbledhje e sintetizim i informacionit mund të realizohen individualisht ose në grup. Këto aktivitete ofrojnë disa mundësi:

- Nxisin iniciativën, pavarësinë e përgjegjësinë e realizimit të detyrës,
- Nxënësit kanë mundësi të punojnë gjerësisht për një temë të caktuar ose temë të lirë.

Të metat e këtyre aktiviteteve janë:

- Nxit plagjiaturë;
- Nxënësit mund të hasin vështirësi në sintetizimin e informacionit.

Prezantimi i detyrave para klasës për tematikë të ndryshme u krijon mundësi nxënësve të shfaqin aftësitë e njohuritë e tyre. Ndërsa, e meta e kësaj metode është koha që duhet për përgatitjen e saj.

Vlerësimi individual dhe vlerësim nga shokët e klasës⁷

- Nxit pjesëmarrjen e bashkëveprimin me njëri-tjetrin;
- Nxënësit mësojnë nga gabimet e të tjerëve dhe përdorin njohuritë e tyre për të kontrolluar e korrigjuar detyrat e shokëve të klasës.

Mund të ndodh që korrigjimi i detyrave të jetë subjektiv e të bazohet në mendimet e ndjenjat e nxënësve që korrigjojnë detyrat. E meta tjetër është mungesa e njohurive të mjaftueshme për të korrigjuar saktë detyrat e shokëve të klasës.

⁷ Mary Ellen Weimer (1990). *Improving College Teaching* (CA: Jossey Bass Publishers), 202.

5. DISKUTIM

Krahas evidentimit prej mësuesve të përparësive e të metave të metodave të ndryshme për kontrollin e njohurive, u vërejt edhe përfaqja e nxënësve kundrejt procesit të kontrollit dhe vlerësimit të përgjithshëm me notë.

Shumë nxënës shprehën shqetësimin e tyre në lidhje me:

I. Pritshmëritë e tyre në lidhje me vlerësimin:

- nxënësit duan udhëzime të qarta në lidhje me vlerësimin dhe metodat e kontrollit të njohurive;
- Gjithashtu, ata duan të kuptojnë kriteret e vendosjes së notave;
- Nxënësit presin shpjegim për notat e vendosura dhe sugjerime se si mund të përmirësohen.

64 % e nxënësve mësojnë më mirë kur ata e kanë të qartë materialin me të cilin po punojnë.

II. Detyrat të kenë lidhje të drejtpërdrejtë me mësimet, ushtrimet e punuara e aftësitë e tyre etj. 25 % e nxënësve presin që procesi i kontrollit të njohurive të bazohet në materialet e punuara më parë, në mënyrë që ata të paraqesin aftësitë e tyre.

III. Mundësi zgjedhjeje e fleksibilitet. Nxënësit, 21 % e tyre, preferojnë të kontrollohen sipas metodave për të cilat ata besojnë se nxjerrin në pah aftësitë e cilësitë e tyre.

Numri i nxënësve	300
Pritshmëritë e tyre në lidhje me vlerësimin	64 %
Lidhje e drejtpërdrejtë e detyrave me materialet mësimore	25 %
Mundësi zgjedhjeje e fleksibilitet	21 %

Tabelë 1 Përfaqja e nxënësve për metodat e kontrollit të njohurive e vlerësimit me note

Gjatë këtij procesi, nxënësit vlerësojnë së tepërmi përpjekjet e mësuesit për ti nxitur e ndihmuar ata me qëllim fitimin e autonomisë në mësimnxënie.

Është e rëndësishme që nxënësit të jenë të informuar plotësisht e qartazi për mënyrën e vlerësimit. Por, çfarë mendojnë nxënësit në lidhje me objektivitetin e vlerësimit nga mësuesi?

Pyetje	Përgjigje		
	Po	Jo	Disi
Vlerësoheni saktë?	80 %	6 %	14 %
Është objektiv mësuesi gjatë vlerësimit?	86 %	3 %	11 %
Janë të lehta apo të qarta metodat e përdorura për vlerësim?	67 %	13 %	30 %

Tabelë 2 Mendimet e nxënësve për objektivitetin e mësuesit gjatë procesit të kontrollit e vlerësimit të njohurive.

80 % e nxënësve u shprehën se mësuesi i ka vlerësuar saktë nëpërmjet metodave bashkëkohore. 11% e pjesëmarrësve në studim mendojnë se mësuesi është disi objektiv në vlerësim, ndërsa 86 % pohuan objektivitetin e mësuesit gjatë vlerësimit me notë. 13 % e tyre mendojnë se metodat e vlerësimit nuk janë të qarta dhe mësuesi nuk u ka dhënë informacion të qartë në lidhje me kriteret e vlerësimit. 30 % e nxënësve shprehen pjesërisht pozitiv në lidhje me qartësinë e metodave vlerësuese. Ndoshta, në këtë rast, mësuesi duhet të kishtë punuar më tepër me nxënësit për tu dhënë atyre udhëzime të plota e të sakta.

KONKLuzion

Kontrolli i vazhdueshëm i njohurive dhe vlerësimi përfundimtar me notë janë të ndërlidhur me njëri-tjetrin. Vlerësimi përfundimtar është rezultat jo vetëm i provimit të fundit, por edhe i shumësisë së notave e vlerësimeve të ndryshme që nxënësit marrin gjatë semestrit apo vitit shkollor.

Këto janë etapa të rëndësishme të organizimit e zhvillimit të mësimdhënies e mësimnxënies. Këto dy etapa duhet të jenë të plota, objektive e të sakta⁸. Gjatë këtij procesi, elementi më i rëndësishëm është nxitja e përmirësimit i performancës së nxënësve. Fitimi i autonomisë së nxënësit në zotërimin e gjuhës së huaj, angleze, ndikon drejtpërdrejt në

⁸ Bracey, G. W. (2002). International comparisons: An excuse to avoid meaningful educational reform. *Education Week*, 21(19), 30–32.

përmirësimin e aftësive si leximi, shkrimi, i foluri dhe dëgjimi. Efektet pozitive të autonomisë së nxënësit realizohen së tepërmi kur nxënësit zhvillojnë aftësinë e të menduarit në gjuhën angleze. Në këtë rast, ndodh kalimi i natyrshëm nga gjuha amë në gjuhën e huaj.

Ndër metodat për të përdorura në studimin tonë për realizimin sa më të plotë e të saktë të vlerësimit me notë të nxënësve, mund të përmendim: provim, testim, detyrë me shkrim, punë kërkimore, ese, përmbledhje e sintetizimi i informacionit, performancë dhe prezantim i detyrave, vlerësim i ecurisë individuale, vlerësim nga shokët e klasës etj.

Referenca:

1. Osmani, Shefik. **Fjalor i pedagogjisë**, Tiranë, 1999.
2. Cerbin, William (1994), "The course portfolio as a tool for continuous improvement of teaching and learning." *Journal on Excellence in College Teaching*.
3. Angelo, T.A. & Cross, P.K. (1993). *Classroom Assessment Techniques* (2nd ed.). San Francisco: Jossey-Bass.
4. Theall, Michael and Franklin, Jennifer, Eds. (2006). *Student Ratings of Instruction: Issues for Improving Practice*, *New Directions in Teaching and Learning*, No. 43
5. *Changing Practices in Evaluating Teaching: A Practical Guide to Improved Faculty Performance and Promotion/ Tenure Decisions* (MA: Anker Press):
6. Cohen, D., & Lowenberg Ball, D. L. (2001). Making change: Instruction and its improvement. *Phi Delta Kappan*, 83, 73–77.
8. Mary Ellen Weimer (1990). *Improving College Teaching* (CA: Jossey Bass Publishers), 202.
9. Bracey, G. W. (2002). International comparisons: An excuse to avoid meaningful educational reform. *Education Week*, 21(19), 30–32.

**LIDHJA HISTORIKE E SHQIPTARËVE ME GJUHËN DHE KULTURËN ITALIANE
NIVELI I VËRTET I MËSIMNXËNIES SË GJUHËS ITALIANE SOT**

Dr. Eglantina GERVENI

University of Tirana

The Faculty of Foreign Languages

The Department of Italian language

egla_gerveni@yahoo.com

ABSTRAKT

Bota në të cilën jetojmë, ka si fjalë kryesore të të gjitha lëvizjeve të ndodhura në periudha të ndyshme historike lirinë. E drejta për të qenë i lirë në zgjedhje, ide, mendime. Të lirë për të ndërtuar identitetin e tyre pa u privuar nga rrethnat historike apo regjimet e kufizimet e induktuara prej tyre. Në këtë kuptim tema e përgatitur për refererim trajton mendimin se kufizimi apo heqja e të drejtës për të mësuar, studiuar apo folur një gjuhë të huaj, të çon në një etje për të asimiluar, edhe fshehurazi gjuhën, kulturën apo historin e atij kombi, kështu ka ndodhur dhe me ne shqiptarët në lidhje me gjuhën kulturën e italisë fqinje, këto 100 vjet shtet.

Tema është ndare në dy pjesë në pjesën e parë trajtojmë përdorimin dhe mësimin e gjuhës italiane nga shqiptarët dhe ndikimet që regjime të ndryshme politike kanë pasur në lulëzimin apo ndrydhjen e saj.

Pjesa e dytë e studimit trajton nismat dhe përpjekjet e mëdha të ndermarra nga shteti italian për ta institucionalizuar këtë mësimdhënie e mëimnxënie të gjuhës së tyre në Shqipëri, duke e kthyer atë pas viteve 1990 në gjuhën e dytë më të studiuar në shkolla pas anglishtes.

Fjalë kyçe :*Shqiptarë, gjuhë italiane,kulturë, mësimnxënie.*

HYRJE

Kombet lindin,formësohen,jetojnë nëpërmjet gjuhës.Aq të vërteta janë këto fjalë ,sa të vërteta janë dhe përpjekjet që kanë bërë popujt ,veçanërisht ata të varfër për të mbijetuar në një shoqëri sfiduese hera-herës nënshtruese dhe si rrjedhojë edhe imponuese.Të tillë popuj si populli ynë në histori qëndrese kanë treguar të qëndrojnë stoikë në hapësirën e vet kombëtare ,por nga ana tjetër kanë vlerësuar rrethanat historike duke krijuar marrëdhënie hera-herës të diktuar,me

popuj fqinjë. Dhe sigurisht përtej një miqësie të bazuar në ndenjat e një fqinjësie të mire, qëndron edhe dëshira për të qenë i barabartë e ndonjëherë edhe më mire se tjetri (miku).

Punimi është i ndare në dy pjesë në pjesën e parë do të trajtojmë prezencën ekonomike kulturore e atë të gjuhës italiane në kohë në vendin tonë, në pjesën e dytë do të trajtojmë gjendjen reale të mesimnxënies dhe mësimnxënies së gjuhës italiane në vendin tonë. Për t'i dhënë vlera dokumentare punimit jemi përpjekur të shfletojmë shtypin e kohës si dhe ta trajtojmë gjuhën italiane si të mësuar me dëshirë, ndarë nga gjuha shqipe, mëmë, por edhe interferencat e gjuhës italiane në gjuhën shqipe, e pasqyruar kjo në fjalë e shpreje të përdorura brenda gjuhës mëmë.

MIQËSIA ITALO-SHQIPTARE

Midis dy vendeve egziston një lidhje shekullore e cila dëshmohet nga shumë fakte historike.

Kështu, në testamentin e Heroit tone të Madh Gjergj Kastriot Skënderbeut, më 17 Kalldër 1467, ditë kjo që po vdiste në Lezhë, i kujtoi të birit të vet kët gjë: "Biri im, unë po vdes i qetë, mbasi Senati i Venedikut mori për sipër zavendësimin e babës t'and dhe mbrojtjen e provinceve të jueja nga sulmet e osmanliver." (Gazeta e Re, e diel 7 korrik 1929)⁹

Këto fjalë të thëna nga goja e të madhit Skënderbe tregojnë një miqësi të hershme të lindur prej lufrash e nderesh reciproke. Kështu në shtypin e kohës, po në këtë artikuj vijon të tregohet lidhja e Skënderbeut me Italinë dhe konkretisht, (Më 2 shtatuer 1427, i ndimuem prej Romakvet, prej Papës Eugenit të 4 e pastaj prej Kaliasit të 3, me mjetin e të hollavet dhe të galevet anije luftime dhe 1000 kambësorë e 500 sulmues moschettieri qi pati dhanë mbreti i Napolit, pati ngallnimin e madhnueshëm në Tomornicë, ngallnim ky qi i dha titullin "Kapitan i Përgjithshëm i Krujës Romane". në luftën kundra turkut (Capitano generale della curia Romana nella Guerra contro il Turco). (Gazeta e Re, e diel 7 korrik 1929)¹⁰).

Lidhja midis Skënderbeut dhe shtetit Italian do të vazhdonte kështu, më 26 mars 1461 ndodhi traktati i aleancës ndërmjet Skanderbeut dhe Alfonsit Aragona Mbret i Napolit, marrëveshje kjo që bën emrin "Gaeta e Torre Otavva"

⁹ Gazeta e Re, e diel 7 korrik 1929

¹⁰ Gazeta e Re, 1929

Në vitin 1466, Princi shqiptar qe në Romë dhe Pali i 2 i dha për banim një shtëpi për nën Kuirinalin,ku banoi deri në vitin 1467,dhe rruga ku banoi,mori emrin e tij.Ndërmjet viteve 1450-1470 ndodhi emigracioni shqiptar në Mbretërinë e Napolit,edhe sot në Italinë e Jugut e sidomos në Kalabri e në Sicili jetojnë kolonina të lulzueshme qi përbahen prej 100 000 shqiptarësh.

Ndjenja miqësore e Italisë për Shqipninë nuk asht një gja e sotme ,citetohet në gazetë ,kjo rrjedh qysh prej traditave shekullore .Kombëtare e historike,e cila qe ndriçuem,shkruem,komentuem prej të gjithë letraturës italo-shqiptare.Marrëdhëniet e miqësisë vazhduan dhe në kohën e rilindjes italo-shqiptarët,tashmë të provincave arbëreshe morën pjesë aktive në luftat me besë dhe me entuziazëm.Të gjithë luftuan ndër rreshtat Galibardine dhe luftuan heroikisht në mënyrë si e thotë Galibardi vetë në urdhrin e ditës së shpallur më 1 tetor 1860(Shtyna në sulmin burrat kalabrez të Paqit,të cilët i gjeta në pyllin nga e djathta e ime,dhe që luftuen mrekullisht). Dëshmohet se pjesa më e madhe e kalabrezëve të majorit Pace të Kastovilarit qenë shqiptarët e Kalabrisë,të cilët luftonin në rradhët e para të vullnetarëve. Sipas dëshmive të shtypit të kohës heroi i madh Galibardi në vitin 1886 i shkroi Princeshës Elena Gjika,e cila njihej me pseudonimin letrar “Dora Distria” dhe i tha : Cështja e shqiptarëve është një cështje e imja, vërtet unë do të isha i lumtur të përdorja gjithcka kam në jetë në favor të këtij populli të zashëm”.

Me rastin e njëzet e pesë vjetorit të pamvarsisë së shqipëris në gazetën “Drita” 1937 18 Dhjetor¹¹ gjejm kryeartikullin “Pamvarësia Shqiptare” në këtë artikull bëhet një falenderim për gazetarin Nicola Larusso Attoma ,i cili ka bërë një shkrim të gjatë e të qartë për marrëdhëniet italo-shqiptare në fletoren italiane “Il Popolo d’Italia” ku ndër të tjera shkruan “Në një atmosferë aktiviteti të frytshëm realizues, Shqipnija do të festojë këto ditë 25 vjetorin e shpalljes së pamvarsis së saj, ndërsa nga ana tjetër e Adriatikut do ti arrijë urimi i përzemërt i Italis Fashiste, mike dhe aleate, i sjellun nga Thaon di Revel, Ministër i financave . Vijn artikulli me një letër që Duce-ja i dërgon mbretit Zog :”*Kremtimi i pamvarësis shqiptare asht bamë kremtim dhe urim për popullin Italian .Italia dhe Shqipnija,në fakt janë të bashkueme ngushtësisht me shoqa shopen. Episode të vjetra dhe të tashtishme, të gjitha ripohojnë realitetin e ndritëshëm të marrëdhënieve të përzemërta italo-shqiptare: shembull i shkëlqyeshëm në historinë e marrëdhënieve midis popujve.*”

Prezenca ekonomike e Italisë në Shqipëri

¹¹ Drita 1937 18 Dhjetor

Prezenca e Italisë në Shqipëri ka qenë edhe në fushën e mbështetjes ekonomike në rast fatkeqsish këtë e shohim në një tjetër kryeartikull të revistës “Drita” Shkurt 1938¹² me titullin :

“Qeveria e Italisë fashiste, gjithmonë Mike e madhe dhe bujare, vrapon në ndihmë të të mjerueve shqiptarë” 1.500.000 lireta dhurohen për të lehtësue damet e pësueve nga inondata

Në këtë artikull ndër të tjera shkruhet: *“Miqësia italo- shqiptare kalon përsipër protokoleve, sepse buron prej vetë shpirtit të dy popujve; sot themi edhe se populli Shqiptar, përtej jetës e përtej vdekjes, i asht mirënjohës Italis së madhe për gjithëshka ka bamë për ne.”* Jo pa qëllim i renditëm faktet më lart për të treguar se njohja e gjuhës italiane nga shqiptarët i ka burimet në një miqësi të hershme të bazuar në lidhjet historike të diktuar në shekuj.

GJUHA DHE KULTURA ITALIANE NË SHQIPËRI

Ndikimet e kulturës italiane vihen re dhe në fushën e drejtësisë .kështu te Gazeta e Re Korrik 1928¹³ kemi artikullin “Shteti Ligjor ”, ku ndër të tjera shkruhet se: hyrja në fuqi e Kodit Penal në Shqipëri ka pasur një rëndësi të madhe jo vetëm në luftën kundër krimit, por edhe për të futur një koncept të ri për ligjin pozitiv: duhet theksuar se ai hoqi rregullat e Kanunit të Lekë Dukagjinit, që transmetoheshin nga e kaluara. Në këtë artikull specifikohet se si pikë referimi e si ndriçues për ligjin penal shqiptar dhe për realizimin e drejtësisë penale në Shqipëri është marr Kodi Penal Italian. Për këtë arsye edhe sot në ditët tona shumë terma të fushës së drejtësisë janë fjalë të huazuara nga gjuha italiane.

Mësimi i gjuhës së huaj u diktua edhe nga udhëtimet e shpeshta që bënin tregtarët, por edhe të rinjtë shqiptarë, të cilët shkonin në Itali edhe si paraushtarë për të marrë njohuri ushtarake. Kështu nga Gjirokastra do të shkonin në Tiranë e mandej në Itali të shoqëruar nga mësuesi i tyre Ferik Toto disa djelmosha , të cilët do të shkonin në Alpet e Italis së Veriut, ku do të qëndronin për 1 muaj në stërvitje. (Gazeta e re 1929 30 korrik¹⁴)

Por ajo që tregon lidhjen edhe midis kulturave janë rrethet Italo-Shqiptare, organizimi i të cilave shërbente për shkëmbim kulture, por edhe përsosjen e gjuhës italiane. Në shtypin e kohës,

¹² Drita 1938 Shkurt

¹³ Gazeta e Re Korrik 1928

¹⁴ Gazeta e Re 1929 30 Korrik

gazeta Drita 1939 6 Janar¹⁵ kemi një artikull me titull "Organizimi i rrethit Italo-Shqiptar "Skënderbeg"

Me qëllim bashkëpunimi dhe rritje të marrëdhënieve midis popullit Italian e atij shqiptar, në Tiranë filluan punimet për rrethin Italo-Shqiptar "Skanderbeg". Ky rreth kryesohet nga Ministri i punëve të jashtme të Shqipërisë, dhe nga Ministri i punëve të jashtme të Italisë dhe selinë e kishte në Tiranë, por që kishte seksione të ndërvarura ndër qendrat më të rëndësishme të Shqipërisë. Organizata qendrore e rrethit përbëhet nga kryesia, drejtori, shërbimi kulturor, shërbimi artistik, shërbimi i argëtimit dhe i udhëtimit, shërbimi sportive, shërbimi i shtypit, zyra e administratës, sekretaria.

Shërbimi kulturor kujdeset për themelimin dhe funksionimin e Bibliotekës së rrethit, për organizimin e konferencave dhe konkurseve letrare midis shkrimtarësh shqiptarë dhe italianë për vepra karakteristike të cilave do të caktoheshin me program. Shërbimi artistik kujdesohet për organizimin e koncerteve, të shfaqjeve, të ekspozitave. Shërbimi i argëtimit organizon ekskursionet, shëtitjet, shfaqje në vende me rëndësi arkeologjike dhe historike. Shërbimi sportive kujdeset për seksionin e lundëtarëve në Durrës, dhe seksionet e gjuetisë, qitjes, atletikës së lehtë, të sporteve dimërore. Shërbimi i shtypit, përveç veprimtarisë së zakonshme kujdeset dhe për revistën që del 1 herë në muaj. Për të bërë të mundur realizimin e të gjitha këtyre funksioneve do të ngrihet një godinë nga sipërmarrës milanez. Ky rreth i përsosur në çdo detaj do të realizojë shkëmbimin kulturor artistik sportive midis dy vendeve. Drita 1939¹⁶.

Lidhja midis shteteve kultivon edhe gjuhën, kështu shkrimtari ynë i shquar Ernest Koliqi ka perkthyer nga gjuha italiane katër poetë të mëdhenj të Italisë si; Parini, Foskolo, Montie Manzoni, të cilët përfaqësojnë ajkën e letërsisë së shekullit të kaluar. Për të dhënë më saktë një mendim mbi vlerën e veprës në shypin e kohës gjejmë një riprodhim të parathënies që i bëri Profesor Carlo Tagliavini, ordinar i Glottologjis në Universitetin e Padovës

Ai shkruan: "Kam filluar një bashkëpunim të frytshëm me Koliqin, sidomos nga ajo ditë në të cilën Universiteti i Padovës vendosi të hapë një kurs zyrtar të gjuhës e të letërsisë shqipe edhe të mbështesë pjesën gjuhësore si lektor. Koliqi më solli vëllimin e parë të poetëve të mëdhenj të Italisë dhe përkthimet madhështore të "Vorreve" e të "Pesë Majit" Me gjithse un me zakon të rrënjësor në mue jam i prirur të shqyrtoj pjesën gjuhësore, nukmujta mos t'admiroj

¹⁵ Drita, 1939, 6 Janar

¹⁶ Gazeta Drita, 1939, 6 Janar

poezin qi rreh flatrat n'ato copa të poetëve t'anë ma t'mëdhenj që ai deshi t'i përkthejë në vargje. Gjaja qi ma tepër më ka çuditur asht përputhja e testit poetik të shqipes me atë të italishtes dhe zhdërvjelltija me të cilën Koliqi riprodhon stilin, po aq të ndryshëm të Dantes, Petrarckës, t'Ariostos, Të Tassos, të Fascolos, të Manzoni. Kjo është arritur duke mbajtur përherë metrin e origjinalit. Kështu Dante është përkthyer në treshe e Ariosto në tetshe, Vorret e Foscolos, pa dyshim një ndër armtime ma t'vështira të letërsisë italiane janë përkthyer me të njëjtin numër njëmbëdhjetë rrokshash. Sipas autorit të shkrimit që është njëkohësisht dhë recënsori i vëllimit të Koliqit, ai e krahason atë me poetin e madh rumun duke bërë dallime të dukshme. Shembulli është marrë nga treshja e famshme e këngës së Franceskës:

“Io cominciai ,poeta, valentieri

Parlerei a que'due che insieme vano me vanno

Epaion si al vento esser le –

Cosbuc-u përktheu: gjeri

“Si-asa ‘ncepui ;’”Cu drag eu le-as vorbi

acelor do ice adusi de vijelje

asa de-usor pareche par a fi”

Koliqi:

“Un fillova , poet , kasha me dashtë t'i u flas njatyne t'dyve qi aq letë dukën s'bashku tue shkue n'kët duhi t'vrashtë”

Krahasimi kthen krejt në dobi të Koliqit. Në të parin varg Cosbuc –u lë mbas dore përkthimin e fjalës poet, i dyti e i treti varg janë më tepër një parafrazë se sa një përkthim, ndërsa Koliqi tue bam gjithnjë vargje të bukura shqipe i mban besnikëri absolute tekstit. Herë herë në përkthimin e Koliqit bën pershtypje përdorimi i ndonjë fjale shqipe të kulluet, por jo të rëndomtë, kështu për shembull, për të cituem të njëjtin episode të Franceskës. Koliqi përktheu italishten “O anime affanate” me “o shpirtën të ngashruem”. Fjala ngashrim (affanato, afflizione) toskërisht gashërim, me etymologji të panjoftun shif Meyer, Et, Eörteb, der Alb.Sprache305) ep përsosmënisht vështrimin e italishtes affanato dhe bën pershtypje për arkaicitetin e vet të thjeshtë më tepër se të kish përdorur autori frazën “trazuem”. Në parathënie e tij profesori Italian u tregon lexuesve se Koliqi përkthen për mrekulli shkrimtarët italianë në të gjitha bukuritë e holla të tyre e me shpirtin e tij të pasosur e me ndjesi të natyrshme poetike, din

të kuptojë poezin e të mëdhenjve poetë italianë. Kjo dëshmon tashmë për tradita të kultivuara të gjuhës italiane aq sa të na vinin nga përtej kufirit edhe poetët më të mëdhenj italianë të kohës.

Tregues të tjerë të shtrirjes së gjuhës italiane në kohë janë edhe reklamat që bëheshin për produkte të ndryshme ,ku dukshëm vihej re përdorimi i fjalëve nga gjuha italiane. Kështu në shtypin e kohës ,gazeta Vullneti 1930 23 Tetor¹⁷ gjejmë një reklamë për një shoqëri sigurimesh me emërtimin ‘Fiume’ Po citojmë reklamën:

Shoqnia anonime e sigurimeve dhe rishtsigurimit ‘Fiume’

Qendra dhe drejtoria e përgjithshme Fiume

Shoqëni e themelueme me bashkëpunim kombëtar Italian të sigurimeve

Agjencia e përgjithshme në Tiranë

Me agjenci kryesore në Shkodër, Elbasan, Fier, Vlonë, Përmet, Gjinokastër, Sarandë dhe Korçë.

Siguron kundra rrezikut të zjarrit.

Në një tjetër reklamë të kohës kemi citimin:

Vini re!

Mobilat më të bukura me material të jashtëm në MOBILARIA

Apo vihet re përdorimi i fjalës finestra në shumë reklama të ndryshme. Sigurisht këto janë dëshmi e ndikimit që kishte italishtja në gjuhën shqipe, por edhe të njohjes së mirë të kësaj gjuhe e kulture nga shqiptarët.

Në shfletimin e gazetave kemi vënë re dhe lajmërimet që bëheshin përse u përket programeve në radio të stacioneve italiane të Roma I- Bari I- Napoli I ,të gjitha këto janë dëshmi të dëshirës së pareshtur të shqiptarëve për kulturë e qyterim italian.

Një tjetër fakt i cili ndihmoj në një përvetsim më të mirë të gjuhës italiane nga shqiptarët është fakti se më 30 gusht 1933 në Shqipëri , mësimi i italishtes si gjuhë e dytë është bërë i detyrueshëm në të gjitha shkollat e mbretërisë.

GJUHA ITALIANE NË SHQIPËRI PAS VITIT 1990

Pas rënies së regjimit komunist (1990), distanca mes Shqipërisë dhe Italisë u reduktua menjëherë. Italia e kuptoi shpejt se problemet e Shqipërisë u bënë edhe probleme të saj nga numri i madh i emigrantëve që zbarkuan në Itali .Ajo që u vu re me habi ish se këto masa të emigrantëve kuptonin pak a shumë gjuhën italiane, e cila favorizoi dhe krijoi mundësinë e

¹⁷ Gazeta Vullneti 1930 23 Tetor

integrimin të shpejtë shoqëror. Merita e njohurive të gjuhës italiane i detyrohej kryesisht televizioneve italiane, të cilat ndiqeshin në mënyrë klandestine gjatë regjimit dhe pastaj, pas rënies së regjimit diktatorial ato u ndoqën lirisht.

Sot, edhe pse gjuha e huaj më e studiuar në shkollë për zgjedhje politike të shtetit Shqiptar është anglishtja, gjuha e huaj më popullore në mesin e popullsisë është gjuha italiane. Nuk ka një të dhënë të saktë statistikore, por përshtypja e përgjithshme sugjeron se të paktën 70% e të rinjëve e kuptojnë italishten dhe 50% mund ta flasin mirë atë. Kjo gjendje spontane e italofonis e krijuar pas viteve 1990 nuk ishte një politikë e qeverisë italiane për të forcuar njohjen e italishtes, por ishte shtypja për të ndërrmarrë një fushatë të gjere projektesh e aktiviteteve kulturore e fetare të cilat patën si synim mësimin e italishtes në mënyrë të institucionalizuar.

Për të insitucionalizuar mësimin e gjuhës italiane kemi fillimin e bashkëpunimeve shkencore dhe teknologjike, përse i përket aspektit thjesht akademik ka lëvizur në fusha të ndryshme, kështu që në këtë moment ne kemi:

- 1) Krijimi i tre seksione dygjuhëshe italo-shqiptare në shkollat e mesme të Tiranës, Shkodrës dhe Korçës.
- 2) dërgimi i pedagogve italianë në Universitetin e Tiranës, Elbasanit, Gjirokastrës, Vlorës, Shkodrës.
- 3) Fillimi i projektit Iliria, i cili ofron mësimin e gjuhës italiane si gjuhë e huaj e parë që nga klasa e 3-të të shkollës fillore.
- 4) Memorandumi i Mirëkuptimit mes Qeverisë italiane dhe asaj shqiptare për të bërë që në vitin 2010 përqindja e nxënësve që studiojnë Italisht si gjuhë të huaj të parë të jetë 10% .
- 5) ofrimi i bursave për të gjithë mësuesit dhe pedagogët shqiptarë të gjuhës italiane për ndekjen e kurseve të avancuara dhe hulumtimeve pasuniversitare, si dhe për ndjekjen e masterave dhe doktoraturave në universitet italiane.
- 6) Krijimi nga Instituti Italian i Kulturës i 17 qendra kursesh, të cilat mbulojnë gjithë territorin dhe japin mundësi për të marrë provimin e Celi 3.

Përveç fushës së arsimit shteti Italian u mundua të rrit numrin e italishtfolësve edhe nëpërmjet organizimeve e shkëmbimeve të ndërsjellta në shumë fusha si :

- 1) Institucionet fetare: përmes punëve bamirëse (klinika, kolegje, qendra për të gjymtuarit, etj.
- 2) Forcat e armatosura: Sipas një bashkëpunim pluriarma, Italia është e angazhuar në të gjithë

sektorët, Ushtri, Forcat Ajrore (helikopter Body), Navy dhe Policia Ushtarake .Përveç kësaj ka edhe Guardia di Finanza (në portin e Durrësit) dhe një delegacion italian i NATO-s. Konsideroni, më në fund, që në bazë të marrëveshjeve bashkëpunimi, disa shqiptarë ushtarake ndjekin kurse për kadetë në shkollat italiane të Modenës, Pozzuoli, Livorno, Napoli, etj .

3) bashkëpunim: ka 27 organizata italiane jo qeveritare që veprojnë në territorin shqiptar.

4) ekonomia :ka investime e sipërmarrje italiane në fushën e ndërtimit, këpucë, tekstile, ushqimore, bankare, turizmit,telefonisë dhe shumë të tjera.

5) produkteve komerciale: nga makaronat,djathërat,salcat supat në qese etj ,të gjitha shenjat që mund të jenë me interes për konsumatorin, mënyrat e gatimit janë në Italisht dhe përfaqësojnë një prani të mëtejshme të gjuhës.

Kjo është afërsisht një hartë socio-gjuhësore që na tregon se si gjuha italiane është e pranishme në Shqipëri, jo vetëm në nivel shkolle, por e përhapur në të gjithë shoqërinë.

KONKLuzion

Siç thamë dhe në hyrje të punimit tonë ajo që donim të trajtonim ishte një përpjekje për të parë prezencën ekonomike kulturore e atë të gjuhës italiane në kohë në vendin tonë . Për t'i dhënë vlera dokumentare punimit ju referuam revistave e gazetave, në shfletimin e të cilave gjetëm fakte të pakontestueshme të cilat dëshmuuan më së miri se fatet e dy vendeve tanë kanë qenë e vazhdojnë të janë të lidhura pazgjidhshmërisht bashkë .

Intensiteti i marrëdhënieve kulturore dhe tregtare mes Italisë dhe Shqipërisë dhe marrëdhëniet historike mes dy popujve që në kohën e heroit tonë kombtar e deri në kulmimin e tyre në periudhën e mbretit Zog, periudh kjo në të cilën ndikimi Italian në Shqipëri ka qenë më i fortë se kurr , e gjuha italiane u bë gjuhë e dytë në të gjithë shkollat e mbretërisë , janë faktorë të pakontestueshëm të lidhjeve midis dy gjuhëve e kulturave.

Ndikimi e mbështetja e Italisë mike vihet re në fushën e mësimdhënies , në fushën e perfeksionimit ushtarak , në fushën e drejtësisë , në fushën ekonomike e në mbështetjen e pakushtëzuar ekonomike në rast vështirësie, në fushën e artit dhe krijmatarisë letrare. Përkthimet e autorve të mëdhenj Italian të shekullit të kaluar janë një deshmi e mirë e njohjes së gjuhës italiane nga shqiptarët të cilët përveçse përkthyen shkrimtarët e mëdhenj italian patën fatin të shkolloheshin në universitet Italiane më me emër të kohës .

Për këto arsye e për gjithë të tjerat që renditëm më lart mund të themi me plot bindjen se historia dhe fatet e dy vendeve tanë janë të lidhur ngushtë me njëri tjetrin .

Referenca:

- 1) Gazeta e Re ,Shkurt 1928
- 2) Gazeta e Re 1929 14 Maj
- 3) Gazeta e Re , Prill 1929
- 4) Gazeta e Re, Korrik 1929
- 5) Gazeta e Re , Dhjetor 1929
- 6) Gazeta e Re , Mars 1932
- 7) Gazeta Drita, Dhjetor 1937
- 8) Gazeta Drita , Shkurt 1938
- 9) Gazeta Drita ,Qershor 1935
- 10) Gazeta Drita Janar 1939
- 11) Gazeta Drita , Mars 1934
- 12) Gazeta Vullneti , Tetor 1930
- 13) Gazeta Vullneti , Dhjetor 1932
- 14) Gazeta Dielli , Mars 1937
- 15) Gazeta Dielli , Nëntor 1939
- 16) Gazeta Koha 1930 Tetor
- 17) Gazeta Koha 1933 Shkurt
- 18) Gazeta Kombi Shqiptar , Prill 1937

**SCHOOL EDUCATION IN THE COMPLEXITY OF THE NEW MEDIA
IMPORTANCE OF THE ICT IN THE TEACHING AND LEARNING PROCESS**

Eliona NAQO¹

Universiteti "Ismail Qemali"-Vlorë-Albania

eliona.naqo@gmail.com/ /eliona.naqo@univlora.edu.al

ABSTRACT

Education is the process of facilitating learning, or the acquisition of knowledge, skills, values, beliefs, and habits. Educational methods include storytelling, discussion, teaching, training, and directed research. Education frequently takes place under the guidance of educators, but learners may also educate themselves. Education can take place in formal or informal settings and any experience that has a formative effect on the way one thinks, feels, or acts may be considered educational. Educational technology is defined as "the study and ethical practice of facilitating learning and improving performance by creating, using, and managing appropriate technological processes and resources. Educational technology refers to the use of both physical hardware and educational theoretics. It encompasses several domains, including learning theory . computer based learning,, online learning, and, where mobile technologies are used, m-learning. Accordingly, there are several discrete aspects to describing the intellectual and technical development of educational technology:

- educational technology
- educational technology ,that assist in the communication of knowledge, and its development and exchange
- educational technology (LMS), such as tools for student and curriculum management, and education management information systems (EMIS)
- educational technology itself as an educational subject; such courses may be called "Computer Studies" or ICT

It is clear that such a teaching and technological progress involves continuous as inevitable changes in school organization and teaching function, yet it seems that they can not properly deal with strategic educational issues, if upstream is not posed and solved a problem paradigmatic order, enabling the identification of the most correct scientific lines to capture and update of

concrete functional links between the educational tools hypothesized and individual / classroom training without qualitative and quantitative elements , keeping with a pedagogical model intent on enhancing the cognitive pluralism and meta-reflection pupil learning.

Keywords: *School education,teaching,learning,media, new technologies.*

INTRODUCTION

In this short introduction i will try to give a preliminary definition of the field.Educational technology is a wide field. Therefore, one can find many definitions, some of which are conflicting. Educational technology can be considered either as a design science or as a collection of different research interests addressing fundamental issues of learning, teaching and social organization. Nevertheless, there are a few features on which most researchers and practitioners might agree:

- Use of technology is principled: Technology means the systematic application of scientific knowledge to practical tasks. Therefore, educational technology is based on theoretical knowledge drawn from different disciplines as communication, education, psychology, sociology, philosophy, artificial intelligence, computer science, etc. plus experiential knowledge drawn from educational practice.
- Educational technology aims to improve education. Technology should facilitate learning processes and increase performance of the educational system(s) as it regards to effectiveness and/or efficiency.

Researchers in educational technology adopt different stances of what it means to practice academic research. Some researchers may combine a fundamental research perspective with a particular kind of instructional design and a particular kind of technology. Depending upon these options, research interests and research methodology will not be the same.Educational technology can be considered as a design science and as such, it has developed some specific research methodology like “Design-based research”. However, since it addresses also all fundamental issues of learning, teaching and social organization, educational technology makes use of the full range of modern social science and life sciences methodology. Globally

speaking, research methodology for educational technology relies on general research methodology, in particular on approaches of the social sciences.

THE NEW EDUCATIONAL TECHNOLOGIES

The growing virtualization of today's advanced society produces, especially in the field of education, the emergence of an increasingly widespread use of new technologies and their inevitable evolutions, and transformations to the point that it is natural to ask whether lawful to identify some possible watershed between a 'healthy' use of technological tool that enhancer of the processes of teaching and learning and, instead, its use actually altering the actual scope of these formative processes.

In fact, it is not always clear whether new technologies introduced in the educational and institutional environments to facilitate the process of cultural transmission, or whether you actually meet them from colliding with certain educational priorities of the learners' mind - priorities that institutional contexts training would have the task of not failing, you always want to think of minds educated to construct actively the meanings of reality transmitted, rather than passive made from rote learning models.

This question on the possible dilemma between teaching techniques versus pro or new technologies touches quite a few ethical and educational issues and programmatic-didactic, especially when you consider how the new media are gone now becoming familiar with traditional teaching languages, integrating and dynamically interacting with them within a broader cultural process that is now spokesman for a progressive phenomenon of hybridization between the classical instruments of knowledge, such as the textbook or lecture, and tools as it were new, like hypertext, networking or remote lesson, leading us to "navigate" in a kind of expanding media universe, an instrumental cyberspace even as much virtual as you might think instead in terms perhaps prejudicial.

The production of these new educational machines and their level of technological evolution are particularly active in the present era, making ever more lively the pedagogical objective methodological potential of heartfelt debate already on these new media, by virtue of their functional use in the educational process. It is clear that such an educational and

technological progress entails continues as inevitable changes in school organization and function lecturer, although it appears evident that we cannot address issues strictly educational strategy, if not both place and fixed a paradigmatic problem , to identify the correct scientific lines to capture and updating of functional links between the concrete educational tools hypothesized and training individual/class without losing quality and in tune with a pedagogical model intent on valuing intellectual pluralism and the meta-reflection of the student learning. In any case, it seems useless to keep criticism these new media, degenerating towards attitudes too circumspect, as is often the case in front of the new, strongly criticized the writing because weakened memory; nor should it be regarded as much unlike the attitude of those who opposed means that today have become standardized fruition, such as radio or television, or in more recent times the personal computer. The problem around the new educational media, perhaps, is not so much whether to use it or not: the only question would be enough to fear the pedagogical danger of increasing the already extensive existing rift between school practices and the socio-cultural reality, a training dyad between school and mass culture that forces the young to live more than a few cognitive tensions and values vacuum between times, and school and extracurricular spaces.

The culturalist Bruner line and the contextualist Gardner are clear in this regard, calling on the pedagogical experimentally and school programmers to remain sensitive to the cultural context of belonging, when making educational reform policies and curriculum planning: if languages with which you are used to communicate daily through the work of the mass media culture is not least a reflection likely than those used by schools, it is easy to the occurrence of interpretative dystonias in the teaching - learning processes and instrumental and formative insidious anachronisms little help to orient themselves in a highly technological society and hypercomplex like ours. In this case, the risk is to contextualize the dynamics of teaching, making abstract and uninteresting, because of the difficulty in tuning into a bound student from a culture that seduces him with fast and virtual language of playstation or with the interactive and hypertext Internet, or with the changing ways of telling hyper-realistic stories and speed than cinematographic images reworked on computer ,all languages of the era of digital that appear still very different from those which the traditional school is however, in general, used to communicate educationally.

It is likely, however, that a good use of the many tools that the new technologies are able to make school education provision could prove suited to the good use of certain cognitive properties of the pupil and (not least) of 'teacher: it could be argued that, depending on the medium used to transmit the necessary information, different cognitive areas are solicited by the learner and that those areas can be mobilized in different ways and intensities; in this way, it could be argued not only that the new languages used are closer to the context of life of the student, being able to turn to him with symbolic lexical tools that are most familiar, but also that educational stress can trigger a more wide range of individual and group cognitive nuances, by virtue of certain priorities of a pluralistic mind itself complex, designed to interact in terms recursive with a cultural environment equally complex, priorities that would otherwise remain out of the scene of the pedagogical and educational considerations, because we indulged by a unitary and static view of the potential cognitive or apprenditive pupil.

On the other hand, if it is true that the "education language is the language of creation of culture, not just the acquisition of knowledge or of consumption it is also true that the means by which speech is expressed not have an effect negligible, if not primary, in the process of knowledge construction. That's how new techniques taking and enhance the old in a growing process of fusion between the traditional techniques, usually identifiable by the media who spread the message from a center to a plurality of recipients (such as writing, printing, film and television), and new, coincident with the so-called information and communication technologies (ICT , Information and Communication Technologies), which are the fulcrum of change and more functional cognitive needs multidimensional and cultural meanings correspond to ipercomplesse, such that the pedagogy to reflect on their use in school and on the ways in which educational innovation, especially in tune with the new requirements/cultural demands.

Already in 1967 w. Kenneth Richmond reiterated the viability of a revolution in teaching, first by searching in the changes strictly dictated by the drive technology of advanced societies, to relate to a renewable energy concept of educability, although its location, , typical of many curriculum makers attracted by cybernetic yearnings of the middle of the last century, would seem to opt for a mechanistically productivism in background behaviorist in complying so rather extremist, thinking about the possibility of accelerating the steps of learning with effective and productive use of new techniques for education, by team-teaching to programmed instruction,

communication systems, multi-media, educational objectives and pursuing a taxonomic hierarchical planning thus giving an interpretation, very personalized and not properly shareable – instrumental conceptualism. Such a machine would own all the property to play what you would like to be an "*ideal teacher*", often powerless before the excess of information, and would be likely to change the behavior itself of the learner in order to make it work "more effectively" .

THE FUNCTIONAL AND THE PLURAL USE OF NEW MEDIA IN EDUCATION

What is certain is that a sensible comparison with the new teaching machines, which is not fideist but even "apocalyptic" not only can but must find a legitimate space in the current educational dimension reaching out to an unstoppable process of globalization of information which traced a ' optical increasingly enciclopedia and interactive knowledge which, through new multimedia and computer cognitive technologies multiply and intertwine, blending in intersubjective terms and with a more empathetic enlarged opening, The epistemological rethinking of pedagogical constructs underlies this inexorable process informatization of education, need not to get lost in the vortex of hypertrophic information, it leads to rethink the mind-medium-teaching relationship not only in Community-planetary sense, but also in the direction of cognitive, in order to meet modulariste requirements (in particular cases), and pluralist at the same time.

BENEFITS OF TEACHING AND LEARNING WITH THE TECHNOLOGIES

Effective technology use deploys multiple evidence-based strategies concurrently (e.g. adaptive content, frequent testing, immediate feedback, etc.), as do effective teachers. Using computers or other forms of technology can give students practice on core content and skills while the teacher can work with others, conduct assessments, or perform other tasks. Through the use of educational technology, education is able to be individualized for each student allowing for better differentiation and allowing students to work for mastery at their own pace. Modern educational technology can improve access to education, including full degree programs. It enables better integration for non-full-time students, particularly in continuing education and improved interactions between students and instructors Learning material can be

used for long distance learning and are accessible to a wider audience. Course materials are easy to access. Students can access and engage with numerous online resources at home. Using online resources can help students spend more time on specific aspects of what they may be learning in school, but at home. Schools, like have made certain course materials free online.

Although some aspects of a classroom setting are missed by using these resources, they are helpful tools to add additional support to the educational system. The necessity to pay for transport to the educational facility is removed. Students appreciate the convenience of e-learning, but report greater engagement in face-to-face learning environments. According to James Kulik, who studies the effectiveness of computers used for instruction, students usually learn more in less time when receiving computer-based instruction and they like classes more and develop more positive attitudes toward computers in computer-based classes. Students can independently solve problems. There are no intrinsic age-based restrictions on difficulty level, i.e. students can go at their own pace. Students editing their written work on word processors improve the quality of their writing. According to some studies, the students are better at critiquing and editing written work that is exchanged over a computer network with students they know. Studies completed in "computer intensive" settings found increases in student-centric, cooperative and higher order learning, writing skills, problem solving, and using technology. In addition, attitudes toward technology as a learning tool by parents, students and teachers are also improved.

The use of educational apps generally has positive effect on learning. Pre- and post- tests reveal that the use of apps on mobile devices reduces the achievement gap between struggling and average students. Some educational apps improve group work by allowing students to receive feedback on answers and promoting collaboration in solving problems, examples of these apps can be found in the third paragraph. The benefits of app-assisted learning have been exhibited in all age groups. Mobile devices and apps have also been shown to assist in the education of disabled students, with one study reporting increased engagement and accelerated comprehension and learning.

DISADVANTAGES

New technologies are frequently accompanied by unrealistic hype and promise regarding their transformative power to change education for the better or in allowing better educational opportunities to reach the masses. Examples include silent film, broadcast radio, and television, none of which have maintained much of a foothold in the daily practices of mainstream, formal education. Technology, in and of itself, does not necessarily result in fundamental improvements to educational practice. The focus needs to be on the learner's interaction with technology—not the technology itself. It needs to be recognized as "ecological" rather than "additive" or "subtractive". In this ecological change, one significant change will create total change. Technology does not guarantee effective learning" and inappropriate use of technology can even hinder it. With the Internet and social media, using educational apps makes the students highly susceptible to distraction and sidetracking. Even though proper use has shown to increase student performances, being distracted would be detrimental. Another disadvantage is increased potential for cheating. Smartphones can be very easy to hide and use inconspicuously, especially if their use is normalized in the classroom. These disadvantages can be managed with strict rules and regulations on mobile phone use.

CONCLUSION

The growing virtualization of today's advanced society produces, especially in the field of education, the emergence of an increasingly widespread use of new technologies and their inevitable evolutions, and transformations to the point that it is natural to ask whether lawful to identify some possible watershed between a 'healthy' use of technological tool that enhancer of the processes of teaching and learning and, instead, its use actually altering the actual scope of these formative processes. Effective technology use deploys multiple evidence-based strategies concurrently (e.g. adaptive content, frequent testing, immediate feedback, etc.), as do effective teachers.

Using computers or other forms of technology can give students practice on core content and skills while the teacher can work with others, conduct assessments, or perform other tasks. Through the use of educational technology, education is able to be individualized for each student allowing for better differentiation and allowing students to work for mastery at their own

pace. New technologies are frequently accompanied by unrealistic hype and promise regarding their transformative power to change education for the better or in allowing better educational opportunities to reach the masses.

In fact, it is not always clear whether new technologies introduced in the educational and institutional environments to facilitate the process of cultural transmission, or whether it actually meets them from colliding with certain educational priorities of the learners' mind - priorities that institutional contexts training would have the task of not failing, it should always think of minds educated to construct actively the meanings of reality transmitted, rather than passive made from rote learning models.

References:

1. Dimmick, J., Chen, Y., & Li, Z. (2004). Competition between the internet and traditional news media: The gratification-opportunities niche dimension. *Journal of Media Economics*;
2. Thompson, John B. (1995). *The Media and Modernity*. Cambridge: Polity Press, pg. 150;
3. Violaine Hacker, "Building Media's industry while promoting community of values in the globalisation", *Politické Vedy, Journal of International Affairs, Policy and Security*, 2/2011, Volkmer, Ingrid (1999) *News in the Global Sphere*;
4. DeFleur, Everette E. Dennis, Melvin L. (2010). *Understanding media in the digital age : connections for communication, society, and culture*. New York: Allyn & Bacon;
5. Williams, Raymond (1974) *Television: Technology and Cultural Form*, London, Routledge;
6. Durham, M & Kellner, Douglas (2001) *Media and Cultural Studies Keywords*, Malden, Ma and Oxford, UK, Blackwell Publishing;
7. Lister, Martin, Dovey, Jon, Giddings, Seth. Grant, Iain. & Kelly, Kieran (2003) "New Media: A Critical Introduction", London, Routledge;
8. Castells, Manuel, (1996) *Rise of the Network Society, The Information Age: Economy, Society and Culture volume 1*, Massachusetts, Blackwell Publishing;
9. Lister, Martin, Dovey, Jon, Giddins, Seth. Grant, Iain. & Kelly, Kieran (2003) *New Media: A Critical Introduction*, London, Routledge;
10. McLuhan, Marshall (1962) *The Gutenberg Galaxy: The Making of Typographic Man*, London, Routledge and Kegan Paul;

11. McLuhan, Marshall (1964) *Understanding Media: The Extensions of Man*, Toronto, McGraw Hill;
12. Reed, television, "Will the Revolution be Cybercast?";
13. Kellner, Douglas, "New Technologies, TechnoCities, and the Prospects for Democratization";
14. Preston, Paschal "Reshaping Communications: Technology, Information and Social Change," London:Sage, 2001;
15. Kellner, Douglas, "Globalization and Technopolitics".

KUPTIMI DHE PËRKTHIMI I MONOLOGUT TË HAMLETIT

Ma.Sc. Era Ukë BUÇPAPAJ

ABSTRAKT

Ky artikull do të merret me zbërthimin kuptimor dhe analizën përkthimore të monologut të Hamletit në tragjedinë që mban të njëjtin titull. Ai, më së shumti, do të përqendrohet në shqyrtimin e vargut **“To be, or not to be: that is the question”**, si një ndër më të njohurit në kanunin e letërsisë botëror. Kështu, duke u mbështetur në tre parime dialektike: (a) lëvizja e së pjesshmes kushtëzon lëvizjen e së tërës; (b) zhvillimi i së tërës mundëson zhvillimin e së pjesshmes; dhe (c) ruajtja e këtij uniteti dyjar arrihet vetëm kur ngjizësi nuk e lejon inercinë e së tërës të frenojë shpejtësinë e së pjesshmes dhe, anasjelltas, do të argumentohet se këtu gjendet çelësi që hap derën për t'u futur brenda thelbit të mesazhit qendror të monologut (e pjesshmja) të veprës letrare (e tëra) dhe të autorit përkatës (ngjizësi) njëherazi. Pa shtënien në dorë të këtij mjeti, përkthyesi dhe lexuesi mund të mbeten jashtë tekstit, në qiellin e hapur të hamendësimeve. Ndërkohë, nëpërmes shfrytëzimit të gjetjeve dhe dhënies së variantit në shqip të shprehjes në fjalë, do të sqarohet saktësia ose pasaktësia e barasvlerësit “Të rrosh a të mos rrosh – kjo është çështja” që ka zgjedhur Fan Stilian Noli për vargun e lartpërmendur. Pastaj, përfundimet e nxjerra do të përdoren për të diskutuar nëse “tradhtia” kundrejt tekstit burimor dhe ndryshimet gjuhësore kanë marrë përmasa të tilla sa të shtrojnë nevojën e përkthimit përsëdyti në Shqipe të veprës së plotë të Uilliam Shekspirit.

Fjalët kyçe: *Gjuhë Burimore; Gjuhë Përkthimore; Barasvlerë; Përkthim; Autor; Përkthyes; Tekst; Audiencë.*

HYRJE

Tanimë monologu **“To be, or not to be: that is the question”** është më i fuqishmi i të gjitha veprave të Uilliam Shekspirit dhe, mbase, më i njohuri anembanë botës letrare. Kjo ndodh jo vetëm sepse këto gjashtë fjalët hyrëse janë fort tërheqëse, fort të paharrueshme, fort kërshtëri ndjellëse, por edhe sepse Uilliam Shekspiri “kullot” kulturë më kulturë dhe përvojë më përvojë për të gjetur gjuhën e përshtatshme për veshjen e imazheve, ku mishërohen konceptet themelore të jetës.¹⁸ Vetëm pasi ka vepruar kështu,

¹⁸ Aguirre, Manuel. “Life, Crown, and Queen: Gertrude and the Theme of Sovereignty.” *The Review of English Studies* 47.186 (May 1996). Pages 163-174.

Uilliam Shekspiri arrin të vërë ide të ndërlikuara filozofike në gojën e Hamletit që i duhet të dalë në skenë për të komunikuar me një audiencë të rrafshëve të ndryshme arsimore dhe botëkuptimore.¹⁹

Monologu **“To be, or not to be: that is the question”** ka 33 vargje dhe 262 fjalë në Gjuhën Burimore, ndërkohë që vetë tragjedia “Hamleti” është vepra më e gjatë e Uilliam Shekspirit, me 4042 vargje.

Monologu **“To be, or not to be: that is the question”** dëshmon se Hamleti ndodhet në darën e dy zgjedhjeve që e përjashtojnë njëra-tjetrën. Hamleti është i detyruar të zgjedhë ja për të qenë, ja për të mos qenë, ja për të luftuar kundër mundimeve që e sulmojnë njeriun papritur dhe pareshtur, t’i mposhtë ato, duke iu dhënë fund një herë e mirë, ja të dorëzohet pa kushte, të pranojë zgjedhën e tyre.

Rrjedhimisht, Hamleti mendohet thellë dhe zbulon se fryti që jep secila nga këto dy zgjedhje është vdekja, vdekja në të dy trajtat e veta të gjumit: (1) të gjumit të përkohshëm; dhe (2) të gjumit të përjetshëm.²⁰ Njeriu, nëpërmjet gjumit, mund të heqë qafe pikëllime, dhimbje dhe vuajtje të panumërta në rrjedhën e jetës, mund të bëhet pjesë ose shkaktar i tyre. Duket sikur njeriu i ka varur shpresat te ky fund.

Gjumi i përkohshëm, domethënë, gjumi i jetës, mundëson ëndërrimin. Gjumi i përjetshëm, domethënë, gjumi i vdekjes, në çastin që shpirti i shpëputet nga trupi, pamundëson ëndërrimin, por mundëson prehjen. Ky gjykim shkakton katastrofën e të jetuarit gjatë.

Megjithatë, njeriu mezi pret të shpëtojë nga kamxhiku dhe përçmimi i jetës, nga fyerja e tiranit, nga përbuzja e mendjemadhës, nga helmi i dashurisë së mohuar, nga pafytyrësia e prijësit fodull, nga shfrytëzimi i mirësisë në dobi të ligësisë. Dhe për t’ia arritur kësaj, njeriu e ka të lehtë, fare të lehtë. Atij i duhet vetëm tehu i mprehtë i çfarëdo thike.²¹

Sidoqoftë, megjithëse njeriu mezi pret të shkarkojë shpine këtë ngarkesë tepër të rëndë, pra, peshën e jetës sfiluese që i shkakton të djersitura dhe hungërima, ai i trembet botës së përtejme, atij vendi tërësisht të panjohur, nga i cili nuk kthehet asnjë udhëtar. Pikërisht kjo gjë e huton njeriun, kjo gjë e detyron njeriun të përballë me të këqijat që njih dhe të mos nxitojë në drejtim të atyre që nuk i njih. Prandaj, mendimi për vdekjen e shndërron njeriun në frikacak. Prandaj, mendimi për vdekjen e mbyt në

¹⁹ Bevington, David. “Introduction.” *Twentieth Century Interpretations of Hamlet*. Edited by David Bevington. Englewood Cliffs, New Jersey: Prentice Hall, 1968. Pages 1-12.

²⁰ Bloom, Harold. “Introduction.” *Modern Critical Interpretations: William Shakespeare’s Hamlet*. Edited by Harold Bloom. New York: Chelsea House, 1986. Pages 1-10.

²¹ Danson, Lawrence. “Tragic Alphabet.” *Modern Critical Interpretations: William Shakespeare’s Hamlet*. Edited by Harold Bloom. New York, Chelsea House, 1986. Pages 65-86.

terr impulsin e parë për t'i dhënë fund jetës. Prandaj, mendimi për vdekjen e ngrin njeriun, duke e katandisur në rob të mosveprimit.²²

Gjashtë fjalët e para vendosin drejtpeshim. Kemi të bëjmë me kundërvënien të drejtpërdrejtë. Hamleti është duke menduar për jetën dhe vdekjen si dhe duke peshuar me mend veç e veç dhe ballas gjendjen e të qenit me gjendjen e të paqenit, gjendjen e të qenit gjallë dhe gjendjen e të qenit vdekur.²³

Ky drejtpeshim vijon me gjykimin e qëndrimit të njeriu ndaj jetës dhe vdekjes. Jetës i mungon fuqia, të gjallët janë të burgosur në mëshirën e grushteve të fatit mizor. Kështu, veprimi i vetëm që mund të kryejë njeriu për ta shmangur apo kundërshtuar atë është marrja e jetës. Kështu, vdekja del e pasur në fuqi. Kështu, marrja e jetës është mënyrë të vepruari, pra, duke rrokur armët, duke luftuar, njeriu mund gurët dhe shigjetat e fatit mizor. Kështu, akti i të jetuarit është gjendje pasive, kurse akti të vdekurit është gjendje aktive.²⁴ Mirëpo, për të kryer aktin e të vdekurit, njeriu duhet të veprojë, të shtjerë kundër fatit me të gjitha llojet e armëve. Pra, njeriu nuk gëzon pushtet veprimi në jetë.

Vdekja nganjëherë është e dëshirueshme, mbyllje e përkryer. Nuk është asgjë tjetër, përveçse gjumë, gjumë i përjetshëm. Mirëpo, gjendet një yçkël që Hamleti e quan “pengesë”. Dhe frika nga jeta në botën e përtejme është pengesa që e detyron njeriun të pushojë, të heshtë dhe, mbase, të ndryshojë drejtimin e të menduarit. Njeriu nuk i kontrollon dot ëndrrat dhe, rrjedhimisht, nuk ka sesi ta dijë se çfarë ëndrrash do t'i shfaqen në gjumin e përjetshëm, ku ai ka shkaktuar gjithë ankthin dhe belanë e jetës. Me këtë mendim në mendje, Hamleti pushon për ta bluar në mendje sërish.²⁵ Njeriu nuk e di se çfarë do të ndodhë pasi të ketë hequr dorë nga trazirat dhe rrëmuajt e jetës. Puna është se ai druhet se mos jeta në botën e përtejme mund të jetë më e keqe sesa jeta në botën e këtjme. Ky mendim të kallë datën. Kjo është pengesa që ndryshon drejtimin e rrjedhës së mendimeve të tij.

Prandaj, Hamleti mendon për fundin përfundimtar. Njeriu nuk sesi të mos çlirohet nga pesha jashtëzakonisht e rëndë që i shkakton djersitje dhe hungërima. Njeriu nuk ka pse të durojë vuajtje të tilla përderisa ai mund të heqë dorë prej saj me një të rënë lapsi.

²² Hughes, Peter. “Playing with Grief: Hamlet and the Act of Mourning.” *Comparative Criticism* 9 (1987): Pages 111-133.

²³ Poe, Edgar Allen. “Review of ‘The Characters of Shakespeare,’ by William Hazlitt.” *Hamlet: Enter Critic*. Edited by Claire Sacks and Edgar Whan. New York: Appleton-Century-Crofts, 1960. Pages 199-200.

²⁴ Thatcher, David. “Horatio’s ‘Let Me Speak’: Narrative Summary and Summary Narrative in *Hamlet*.” *English Studies* 74.3 (June 1993). Pages 246-257.

²⁵ Visconti, Laura. “The ‘Play’ in *Hamlet*: the Primacy of Theatre.” *Shakespeare Quarterly* 43.2 (Summer 1992). Pages 30-42.

Pastaj Hamleti e lë imagjinatën të rendë te tema e udhëtimeve të ekspeditave zbuluese dhe eksploruese. Vdekja, sipas tij, është si kalimi i kufirit ndërmjet gjeografisë së njohur dhe të panjohur. Njeriu ka gjasa të humbasë në atë vend të pahedhur në hartë, nga i cili askush nuk do të kthehet ndonjëherë. Nënkuptimi është se në këtë vend mund të hasen tmerre të papërfytyrueshme.

Duket se Hamleti merr vendim. Ai arrin në përfundimin se vetëdija na bën të gjithëve frikacakë. Mbase kjo është fjalia më e rëndësishme e këtij monologu. Ka përmasë fetare, sepse marrja e jetës është mëkat. Kështu, nëpërmjet kësaj përmase të shtuar, shtohet frika nga e panjohura në botën e përtejme.

Mirëpo, ka më tepër sesa kaq. Nuk bëhet fjalë vetëm për vetëvrasjen, por edhe për misionin që ka, pra, të hakmerret për vdekjen e të atit, duke vrarë vrasësin e tij. Gjatë gjithë rrjedhës së veprimit të kësaj vepre ai shfaqësohet për mosvrasjen e tij dhe largohet sa herë që i jepet mundësia për ta vrarë. “Vetëdija na bën të gjithëve frikacakë”. Tradita ia kërkon që ai të vrasë vrasësin e të atit, por vrasja është mëkat, dhe kjo përbën thelbin e veprës.²⁶

Në mbyllje të monologut, ai del nga kjo gjendje reflektimi, duke arsyetuar se të menduarit e tepërt është gjëja që do ta shmangë atë nga veprimi që duhet të kryejë.

Ky nuk është plotësisht një çast i një vetëvrasjeje të mundshme. Hamleti bën sikur mendon për vetëvrasjen, por, në të vërtetë, ai zbërthen jetën, dhe këtë temë e hasim në tekst nga fillimi, deri në fund. Në këtë monolog jeta paraqitet e rëndë dhe e zbratur nga fuqia. Në këtë monolog Hamleti rendit të gjitha gjërat që e detyrojnë të marrë inat jetën, pra, “përbuzjen dhe kamxhikun e botës”, “zullumin e shtypësit”, “përdhunën e krenarit”, “lëngimin e dashurisë së papërfillur”, “vonimin e ligjit”, “gojë shthurjen e zyrtarit dhe shkelmat që çdo vlerë zemërgjerë nga të pavalersimit merr”. Mirëpo, në këtë monolog, kemi një ndjesi të mërzi së mundimshme se sado e keqe të jetë jeta, frika nga e panjohura na pengon të bëjmë ndonjë veprim për të shpëtuar prej saj.

Duke mbështetur zbërthimin kuptimor dhe analizën përkthimore të monologut të Hamletit në parimet dialektike: (a) lëvizja e së pjesshmes kushtëzon lëvizjen e së tërës; (b) zhvillimi i së tërës mundëson zhvillimin e së pjesshmes; dhe (c) ruajtja e këtij uniteti dyjar arrihet vetëm kur ngjizësi nuk e lejon inercinë e së tërës të frenojë shpejtësinë e së pjesshmes dhe, anasjelltas, kam nxjerrë përfundimin se barasvlerësi “**Të rrosh a të mos rrosh – kjo është çështja**” për vargun “**To be, or not to be: that is the question**” është pjesërisht i saktë. Kështu, përkthyesi, në vend të foljes “jam” në kuptimin “rroj”, “jetoj”, “gjëllij”, ka përdorur foljen “rroj” në kuptimin “jam gjallë”, “jam në jetë”, “jetoj”, “bëj një jetë të gjallë”,

²⁶ Wentersdorf, Karl P. “Hamlet’s Encounter With the Pirates.” *Shakespeare Quarterly* 34.4 (Winter 1983). Pages 434-440.

ndërkohë që autori burimor ka përdorur foljen “to be” në kuptimin “to exist” (“ekzistoj”, “jam gjallë”, “jetoj”, “rroj”), “to be present” (“ndodhem”, “jam i pranishëm”), në vend të sinonime të saj “to exist” (“ekzistoj”, “jam gjallë”, “jetoj”, “rroj”), “to abide” (“banoj”), “to act” (“kryej”), “to breathe” (“marr frymë”), “to continue” (“vazhdoj”, “vijoj”), “to do” (“bëj), “to endure” (“duroj”, “qëndroj”), “hold” (“mbahem”), “to inhabit” (“jetoj”, “banoj”), “to last” (“zgjat”), “to live” (“ekzistoj”, “jetoj”, “mbijetoj”, “mbahem”, “banoj”, “rroj”, “kaloj jetën”), “to move” (“lëviz”), “to obatin” (“gjëllij”), “to persist” (“ngulmoj”), “to prevail” (mbizotëroj), “to remain” (“mbetem”), “to rest” (“prehem”), “to stand” (“qëndroj”), “to stay” (rri); “to subsist” (“rroj”, “mbahem gjallë”), “to survive” (“mbijetoj”, “mbetem gjallë”; “to be alive” (“jam gjallë”), “to go on” (“vijoj”). Thelbi i brendisë së tragjedisë “Hamleti” zbulon se autori në Gjuhën Burimore e ka zgjedhur qëllimisht foljen “to be” (“jam”) për të vënë theksin në “gjëllimin” e njeriut si mëshirim i “fytyrës”, pra, i “nderit”, dhe jo si mishërim i “gjëllimit” trupor në trajtën e “varrit të pabërë” apo të “barrës së vvarë”. Edhe barasvlerësi “kjo është çështja” në Gjuhën Përkthimore për shprehjen “that is the question”, megjithëse i përpiktë në rrafshin kuptimor, nuk është i saktë për nga fuqia shprehëse. Prandaj, variant i goditur për vargun **“To be, or not to be: that is the question”** mund të ishte **“Me qenë a mos me qenë, në dorën tënde qenka lënë”**. Sikundër shihet, “tradhtia” kundrejt tekstit burimor dhe ndryshimet gjuhësore që kanë ndodhur në rrjedhën e viteve shtrojnë nevojën e përkthimit përsëdyti në Gjuhën Shqipe të veprës së plotë të Uilliam Shekspir.

Shtojca 1

William Shakespeare

(“Hamlet”, Act 3, Scene 1)

“To be, or not to be: that is the question:

Whether ‘tis nobler in the mind to suffer

The slings and arrows of outrageous fortune,

Or to take arms against a sea of troubles,

And by opposing end them? To die: to sleep;

No more; and by a sleep to say we end

The heart-ache and the thousand natural shocks

That flesh is heir to, ‘tis a consummation

Devoutly to be wish'd. To die, to sleep;
To sleep: perchance to dream: ay, there's the rub;
For in that sleep of death what dreams may come
When we have shuffled off this mortal coil,
Must give us pause: there's the respect
That makes calamity of so long life;
For who would bear the whips and scorns of time,
The oppressor's wrong, the proud man's contumely,
The pangs of despised love, the law's delay,
The insolence of office and the spurns
That patient merit of the unworthy takes,
When he himself might his quietus make
With a bare bodkin? who would fardels bear,
To grunt and sweat under a weary life,
But that the dread of something after death,
The undiscover'd country from whose bourn
No traveller returns, puzzles the will
And makes us rather bear those ills we have
Than fly to others that we know not of?
Thus conscience does make cowards of us all;
And thus the native hue of resolution
Is sicklied o'er with the pale cast of thought,

And enterprises of great pith and moment
 With this regard their currents turn awry,
 And lose the name of action.—Soft you now!
 The fair Ophelia! Nymph, in thy orisons.”

Shtojca 2

Fan Stilian Noli

(“Hamleti”, Akti 3, Skena 1)

“Të rrosh a të mos rrosh – kjo është çështja:

M’ e lart’ është valle të durosh

Hobe, shigjeta fati të tërbuar

A të përballsh një det te turbull helmesh

Me arm’ e funt t’u japsh. Te vdeç – të fleç –

Jo më – dhe me një gjumë të mbarosh

Çdo zemër-dhembje, mijëra tronditje,

Që trupi prej natyrës trashëgon.

Ja një qëllim që duhet dëshëruar

Me gjithë shpirt. Të vdeç – të fleç; të fleç?

E ndofta t’ëndërrosh! ah, këtu ngeç;

Se ç’ëndrra shohim n’atë gjumë-vdekje,

Pasi na shkundet kjo pështjellj’ e mortme,

Kjo frikë na qëndron; ja arsyeja

Që aq’ e zgjat një jetë me mjerime;

Se kush duron përbuzjen dhe kamçikun’ e botës,

Zullumn' e shtypësit, përdhunën e krenarit,
Lëngimn' e dashuris' së papërfillur,
Vonimn' e ligjës, gojë-çthurjen e zyrtarit,
Dhe shkelmet, që çdo vlerë zemër-gjerë
Nga të pavlershmit merr, kur munt t'a lanje
Hesapin fare me një copë thike?
Kush vallë barra mban e kush dërsin,
Rënkon nënë një jetë të mërzitur,
Po vetëm tmerr' i asaj diç pas vdekjes –
Vendit të pazbuluar, nga s'na kthehet
Kurr' udhëtari – na trullos vullnetin,
Dhe vuajmë të ligat që po kemi
Se sa të hidhemi n'ato që s'dimë.
Kështu na bën ndërgjegjia gjith' frikacë;
Kështu dhe ngjyr' e gjall' e rezollutës
Sëmuret, verdhet nga hij' e mejtimit,
Dhe plane të mëdha e rendësore
Ndalen, përçajnë rrjedhjen, dhe humbasin
Emrin e veprimit. Hesht tani!
E bukura Ofeli! Në lutjet
Mëkatet m'i kujto të gjitha.”

Referenca:

1. Beauregard, David N. Virtue's Own Feature. Newark, New Jersey: University of Delaware, 1995.
2. Bloom, Harold. Hamlet: Poem Unlimited. New York: Riverhead, 2003.
3. Bowers, Fredson. Hamlet as Minister and Scourge and Other Studies in Shakespeare and Milton. Charlottesville, Virginia: University Press of Virginia, 1989.
4. Calderwood, James L. To Be and Not to Be: Negation and Metadrama in Hamlet. New York: Columbia, 1983.
5. Calderwood, James. Shakespeare and the Denial of Death. Amherst, Massachusetts: University of Massachusetts Press, 1987.
6. Charney, Maurice. All of Shakespeare. New York: Columbia, 1993.
7. Clemen, Wolfgang. Shakespeare's Soliloquies. Translated by Charity Scott Stokes. New York: Routledge, 1987.
8. Cohen, Michael. Hamlet in My Mind's Eye. Athens, Georgia: University of Georgia, 1989.
9. Desmet, Christy. Reading Shakespeare's Characters. Amherst, Massachusetts: University of Massachusetts, 1992.
10. Hart, Jeffrey. "Hamlet's Great Song." Smiling Through the Cultural Catastrophe. New Haven: Yale University Press, 2001.
11. Maher, Mary Z. Modern Hamlets and Their Soliloquies. Iowa City, Iowa: U of Iowa Press, 1992.
12. Prosser, Eleanor. Hamlet and Revenge. Second edition. Stanford, California: Stanford University Press, 1971.
13. States, Bert O. Hamlet and the Concept of Character. Baltimore, MD: Johns Hopkins University Press, 1992.
14. Watts, Cedric. Hamlet: Harvester New Critical Introductions to Shakespeare. London: Harvester, 1988.

NDIKIMI I ANKTHIT NDAJ TESTEVE NË ARRITJET SHKOLLORE**Flutura DERVISHI**

PhD kadidade në Universitetin European të Tiranës, Shqipëri

E-mail: d_flutura@yahoo.com**ABSTRAKT**

Ky studim paraqet rezultatet e një pune kërkimore, e cila synon vënien në dukje të ankthit ndaj testeve në rezultatet shkollore të nxënësve.

Ky studim synon të vërtetojë hipotezën se ankthi ndaj testeve është një faktor i rëndësishëm që ndikon në uljen e rezultateve shkollore të nxënësve.

Qëllimi i këtij studimi është pasqyrimi i gjendjes reale të ankthit që testet shkaktojnë te nxënësit dhe ndikimi i tij në rezultatet e arritjeve të nxënësve. Për të vërtetuar këtë hipotezë, kemi ngritur pyetjen kërkimore të hulumtimit: Si ndikon ankthi ndaj testeve në arritjet shkollore? Këtë problem e kemi vërtetuar nga nxënësit e intervistuar, nga të cilët kemi mundur të kuptojmë se nxënësit përjetojnë simptoma ankthi para ose gjatë zhvillimit të testimeve, madje, në persona të vecantë, të cilët e kanë ankthin tipar të personalitetit të tyre, edhe pas zhvillimit të testimit. Nga rezultatet e hulumtimit, kemi arritur në përfundimin se ankthi ndaj testeve ul pritshmëritë në rezultatet shkollore të nxënësve.

Të dhënat empirike u morën nëpërmjet metodës së fokus – grupit, te nxënësit e shkollës “Abdulla Hida”, në Elbasan. Në studim u përzgjedhën 6 nxënës të klasës së nëntë. Nga këta, 3 femra dhe 3 meshkuj. Nxënësit u përzgjedhën nga nivele të ndryshme të arritjeve.

Fjalët kyçe: *Teste kontrolli, ankth, arritje shkollore.*

HYRJE

Për të realizuar matjen dhe vlerësimin e njohurive të nxënësve në shkollë përdoren lloje të ndryshme teknikash, instrumentesh dhe procedurash. Në këtë sistem të gjerë matjesh, në të gjitha nivelet e shkollimit, një vend të veçantë zënë testet, të cilat nëpërmjet procedurës së testimit matin njohuritë, aftësitë, suksesin e nxënësve për grup temash, kapitujsh apo për të gjithë lëndën. Sipas Dispozitave Normative, per Sistemin Arsimor Parauniversitar Shqiptar (2013),

vlerësimi me teste zë 50 % në llogaritjen e vlerësimit përfundimtar të nxënësit, në raport me 40 % të vlerësimit të vazhduar dhe 10 % të vlerësimit të projekteve lëndore ose ndër-lëndore të nxënësit.

Arritja shkollore është e lidhur drejtpërdrejt apo tërthorazi me shumë faktorë, si interesi i nxënësve në mësim, vullneti i tyre për të mësuar, motivimi, i cili parashikon sukses akademik (Oliver dhe Simpson, 1988), faktorët emocionalë, të cilët mund të konsiderohen si faktorët themelorë, që ndikojnë në rritjen e interesit për shkollën apo dhe në dështimet shkollore.

Nga njëra anë, për shkak të shpeshësisë së përdorimit të kësaj metode vlerësuese, duket sikur nxënësit janë familjarizuar me natyrën e testeve. Por, pavarësisht se të testuarit e njohurive me metodën e testimit është i rëndësishëm dhe i zakonshëm, shumë nxënës vuajnë nga ankthi ndaj testeve, nga e panjohura e pyetjeve që përmbahen në test, apo sic quhet ndryshe ankthi nga e panjohura apo ankthi situativ (Speilberger, 1966).

QËLLIMI I KËRKIMIT

Qëllimi kryesor që na shtyri të merremi me këtë problem është se metoda e vlerësimit me anë të testeve, vërtet është një metodë bashkëkohore që përdoret për vlerësimin e njohurive të nxënësve, por është një metodë vlerësuese që sjell shpeshherë situata ankthioze te nxënësit, duke ndikuar në pritshmërinë e rezultateve të tyre. Nga njëra anë, për sa i përket ankthit, mund të jetë tipar i personalitetit të vetë nxënësit, por, nga ana tjetër, përqindja në llogaritjen e pikëzimit për vlerësimin përfundimtar të vlerësimit të marrë në punët me shkrim (siç janë dhe testet), sjell situata ankthioze, duke ulur, shpeshherë, vlerësimin e pritshëm.

METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Gjatë hulumtimit të këtij punimi, kemi përdorur metodën cilësore të fokus – grupit, përmes të cilit kemi hulumtuar këtë problem mjaft të ndjeshëm, duke përgjithësuar dhe analizuar punimin rreth ndikimit të ankthit ndaj testeve në arritjet shkollore.

Të dhënat empirike u morën nëpërmjet metodës së intervistës gjysmë të strukturuar, te nxënësit e shkollës “Abdulla Hida”, në Elbasan. Në studim u përzgjedhën 6 nxënës të klasës së nëntë. Nga këta, 3 femra dhe 3 meshkuj. Nxënësit u përzgjedhën nga nivele të ndryshme të arritjeve. Përzgjedhja e nxënësve u bë në klasën e nëntë, pasi në fund të klasës së nëntë nxënësit

do t'u nënshtrohen testimit për Provimet e Lirimit, si provime përmbyllëse të ciklit të arsimit të mesëm të ulët.

Nga të dhënat e hulumtimit, kemi nxjerrë rezultate përfundimtare nga nxënësit e intervistuar, duke i specifikuar sipas tematikave më të prekshme.

GJETJET PRAKTIKE

Gjetjet nga teoria na ndihmojnë të orientohe mi dhe të fokusohemi te gjetjet nga puna me rastet. Nisur nga puna me rastet, na rezultojnë këto gjetje, të cilat kontribuojnë në vërtetimin e hipotezës se ankthi ndaj teste ve është një faktor i rëndësishëm që ndikon në uljen e rezultate ve shkollore të nxënësve. Rastet hedhin dritë nëpërmjet përmbajtjes së tyre. Nëpërmjet intervistës gjysmë të strukturuar të zhvilluar me nxënësit e përzgjedhur në kampionim, në fokus – grup, na rezulton se këta nxënës përjetojnë simptoma ankthi, si dhimbje stomaku, marramendje, te vjella, djersitje duarsh, shtrëngim në kraharor, dobësim të përkohshëm të kujtesës.

ANALIZA DHE INTERPRETIMI I REZULTATEVE TË HULUMTIMIT

Përmes këtij hulumtimi, analiza e të dhënave tregon se të gjithë nxënësit, para dhe gjatë zhvillimit të testimit, kishin përjetuar simptoma ankthi, duke bërë që shpeshherë të kishte pasur rënie në performancë, krahasuar me përgatitjen ditore. Prandaj, në vazhdim do të përpiqemi që këtë problem ta sjellim të ilustruar me të dhëna të grumbulluara nga të intervistuarit. për një interesim mjaft të madh të nxënësve rreth vlerësimit të tyre me anë të pikëve:

➤ Përjetimi i simptomave ankthioze para dhe gjatë zhvillimit të testimit

Në shumicën e studimeve gjejmë se nxënësit para dhe gjatë zhvillimit të testimit përjetojnë simptoma ankthioze, si: djersitje duarsh, dhimbje koke, provokim të vjellash, humbje oreksi, shtrëngim në kraharor, hutim. Gjatë intervistave, u vu re se:- djersitje duarsh dhe dhimbje koke kishin përjetuar të gjashtë të intervistuarit; - provokim të vjellash kishin përjetuar katër prej tyre; - humbje oreksi dhe shtrëngim në kraharor kishin përjetuar tre prej tyre. Ajo që u vu re ishte se janë vajzat ato që përjetojnë simptomën e humbjes së oreksit para provimit dhe shtrëngim në kraharor si para testimit, ashtu edhe gjatë testimit. Madje, siç pohojnë ato, nëse nuk kanë mundur të performojnë në testim shumë mirë, e vuajnë edhe pasi është zhvilluar testimi, humbjen e oreksit.

Përmes intervistave me nxënësit, gjetëm se te të gjithë ishte shfaqur simptoma e hutimit. Ajo që u vu re ishte se hutimi më tepër prekte nxënësit, të të dyja gjinive, dhe sidomos kur ata ishin të sigurtë që përgatitja e tyre nuk ishte në nivelin e kërkuar, siç del përmes përgjigjeve të tyre: *“Më tepër hutohem, kur nuk përgatitem aq sa duhet. Duke e menduar se s’do jem e zonja t’i kujtoj të gjitha, hutohem më tepër”*; *“Hutohem nga frika se mos ngatërroj formulat në matematikë apo fizikë. Sado që përpiqem t’i mbaj mend përmendësh, hutohem dhe dua kohë ta mbledh veten”*.

➤ **Faktorët që sjellin ankth ndaj testimeve**

Salend (2012) thekson se janë shumë variabla që shkaktojnë ankthin ndaj provimeve, ndër të cilët ai përmend vetëvlerësimin e ulët të nxënësit, motivimin dobët, mungesën e besimit, performancën e dobët para provimeve, presionin nga grupi i moshatarëve, familja e mësuesit për arritjen e rezultateve të larta në provime, ambientet jo të favorshme të provimit. (Salend, 2012, 20 – 25).

- **Frika nga dështimi**

Gjatë hulumtimit tonë, përmes intervistave, frika nga dështimi në testim, përbënte faktorin kryesor që sillte ankth te nxënësit. Kjo u vu re te të gjithë të intervistuarit, madje edhe te nxënësit me rezultate të larta në mësim. Këtë e shohim përmes shprehjeve të tyre *“Kam frikë se mos ngatërroj ndonjë detaj dhe kjo më penalizon në pikëzim”*. Kjo vjen edhe nga natyra e testeve, ku pikëzimi është i përcaktuar, sidomos në pyetjet me përgjigje me alternativa, ku një hutim i lehtë, mund të të çonte në përgjigje të gabuar. *“E kam më të lehtë të shprehem me fjalë, duke argumentuar rreth asaj që di,- është përgjigjja e njërës prej të intervistuarave. Pikët që humbas në testim janë pikët e pyetjeve me alternativa”*. *“Ndodh që nga hutimi, pa u thelluar, qarkoj alternativën e gabuar. Kur i rikthehem testit në fund për verifikimin e përgjigjeve, vërej që kam gabuar. Kjo ma shton akoma më shumë stresin. Te punimi i pyetjeve me zhvillim jam më i qetë. E argumentoj me fjalët e mia idenë që kam rreth koncepteve të dhëna ”*.

- **Presioni nga grupi i moshatarëve**

Studimet tregojnë se moshatarët kanë një ndikim të madh në fillimet dhe gjatë adoleshencës, veçanërisht në atë sferë që i përket arritjeve shkollore. (Dragoti, 2005; Howard, 2004, 11). Për t’u pranuar në grup dhe për të qenë në qendër të vëmendjes së bashkëmoshatarëve, adoleshenti e vë veten çdo ditë në garë me ta, qoftë në aspektin social, atë emocional, qoftë në aspektin e

arritjes së rezultateve mësimore. Mosarritja e performancës së njëjtë me moshatarët, në cilëndo sferë, sjell stres e ankth te ta. E njëjta gjë ndodh edhe me mosarritjen e rezultateve të duhura në provime. Kjo gjë u vu re edhe në hulumtimin tonë, në katër prej tyre, duke u shprehur se ankthin më tepër shtohet, kur mendonin se mund të vlerësoheshin më ulët se shokët e grupit, me të cilët cdo ditë bashkëndanin mendime, ide rreth tematikave të ndryshme nga temat e mësimit apo dhe nga tema të tjera të trajtuara në media.

- Presioni nga pritshmëritë e prindërve dhe mësuesve

Gjatë hulumtimit tonë, tre nga të intervistuarit (dy vajza dhe një djalë) u shprehën se situata bëhet më tepër ankthioze, kur mendojnë premtimin që u kanë bërë prindërve e mësuesve për arritjen e rezultatit maksimal në provimin me shkrim. Frika nga dështimi në provim vjen jo vetëm, sipas tyre, nga rezultati i pakënaqshëm, por edhe ndëshkimi për ta nga ana e prindërve dhe mësuesve.

- Volumi i materialit për testim rrit presionin e ankthit

Një tjetër faktor, që rrit presionin e ankthit ndaj testeve është sasia e madhe e materialit për t'u përgatitur për një testim. Nxënësit shprehen se, në rastet kur testimet në një lëndë të caktuar kanë qenë më afër njëri tjetrit, para provimit dhe gjatë provimit, kanë qenë më të qetë nga ana emocionale, më të përqendruar dhe, sigurisht që kanë arritur ta përvetësojnë më mirë materialin e dhënë për testim. Ndryshe ka ndodhur kur testimet përmbajnë shumë tema (në kapitujt e gjatë) dhe sidomos në provimet përfundimtare lëndore, ku arritja e rezultateve nga ana e nxënësve është poshtë nivelit të arritur përgjatë vitit mësimor.

➤ Ndikimi i ankthit ndaj testeve në rezultatet e pritshme

Nga të dhënat e grumbulluara nga të intervistuarit tanë, ashtu siç konkludohet në studimet e Jan Hambree (1988), Zeidner (1998), gjejmë se në pesë prej tyre, në situata ankthioze s'kanë mundur të arrijnë rezultatet e dëshiruara. Nxënësit tregojnë raste kur, nën presionin e ankthit s'kanë mundur dot të përqendrohen për të mbajtur mend materialin e lexuar, duke u përpjekur drejt mësimit përmendësh të formulimeve. Kjo ka sjellë mosthëllim në të kuptuarin e materialit të lexuar. Gjithashtu, ata tregojnë edhe raste, kur pavarësisht se janë përgatitur paraprakisht, hutimi ka bllokuar kujtesën e tyre, sidomos në mbajtjen mend të shifrave, datave e formulave. Në të dyja rastet, situatat ankthioze kanë çuar në marrjen e rezultateve më të ulëta se vlerësimi i vazhduar (vlerësimi me gojë).

Situatat ankthioze bëjnë që nxënësit të mos përqendrohen në kërkesat e pyetjeve të testeve, duke sjellë përgjigje të tjetërsuara nga të duhurat, siç edhe vetë nxënësit thonë: *“Aq e hutuar isha, sa që në vend që të listoja, në provimin e gjuhës, të veçantat dhe të përbashkëtat ndërmjet përrallave dhe legjendave, kam folur ç’dija për përrallat dhe për legjendat, në përgjithësi. Unë përshkrova në përgjithësi dhe jo specifikova”* apo *“Frika se mos nuk përqendrohem te kërkesat e ushtrimeve më shoqëron gjithmonë para provimit”*.

Jo gjithmonë emocionet negative e pengojnë individin të përballojë me sukses një veprimtari. Mc Donald(2001) pohon se, nëse dikush është shumë i përgatitur dhe ka besim të plotë te vetja e tij, ndjenjat, emocionet negative zhduken. Kjo, në studimin tonë, del në pah përmes asaj ç’ka shprehet një vajzë, nxënëse me rezultate shumë të mira, e cila thotë :*“ Ngaqë nuk e di se ç’pyetje do të përmbajë testi, ndjehem paksa e frikësuar, por kjo nuk më pengon të mësoj. Jemi mësuar me zhvillimin e testeve. Në çdo lëndë testohemi. I marr me seriozitet testimet, kam mësuar dhe kam arritur të marr po të njëjtat rezultate si edhe në vlerësimin me gojë”*.

KONKLUZION

Përfundimet e punës empirike

- Nga rezultatet e këtij studimi empirik dhe shfrytëzimit të literaturës, konstatohet se testimet, si instrument matës të njohurive, sjellin ankth te nxënësit;
- Ankthi, i shkaktuar nga testimet, shpeshherë ndikon në uljen e rezultateve të pritshme të nxënësve në një lëndë të caktuar.
- Nxënësit që përgatiten rregullisht në mësim, pavarësisht situatave ankthioze para testeve, arrijnë ta menaxhojnë ankthin e të mos kenë luhaje në rezultatet e tyre në lëndë të ndryshme.

Rekomandime

Nisur nga rezultatet e këtij hulumtimi, nxjerrim disa rekomandime që do të vlenin për të mirën e nxënësve, në aspektin emocional e akademik të tyre, si dhe për të mirën e shoqërisë:

- Testimet duhet të zhvillohen sa më shpesh, në mënyrë që të përmbajnë më pak material, për të mos shkaktuar ankth për shkak të volumit të madh, që nxënësi të arrijë ta përthithë materialin e dhënë;

- Punonjësit e shërbimit psiko – social, mësuesit dhe prindërit të bëjnë punë parapërgatitore me nxënësit për të reduktuar stresin dhe ankthin para provimeve.

Referenca:

1. Ayres,B Bristow.M; Anxiety in College Students; 2009 ;
2. Cara,M, Revista Pedagogjike “Personaliteti dhe edukimi:Teoria 5 faktoriale dhe arritjet shkollore”, Tiranë, 2011;
3. Dispozitat Normative për Sistemin Arsimor Parauniversitar Shqiptar, Tiranë, 2013;
4. David H. Barloë. Guilford Press, 2002; Anxiety and Its Disorders: The Nature and Treatment of Anxiety and Panic;
5. Dragoti, E; Adoleshenti; Tiranë, 2005;
6. Gjini,F; Nxënësi dhe grupi, Elbasan,1998;
7. **Hembree**, R; Correlates, causes, Effects and Treatment of Test Anxiety; 1988;
8. Huberty,T; Test and Performance Anxiety; 2009;
9. **Howard**, N. (2004), Peer influence in relation to academic performance and socialization among adolescence;
10. Karameta,P “Stresi, epidemia e rinisë” ;Gazeta “Shqip”, dt.04.09.2010;
11. Kaza, N; adoleshenca, stina e shpërthimeve; Tiranë, 2006;
12. **McDonald**, A. (2001) The prevalence and effects of test anxiety in school children. Educational Psychology, 21, 89-101;
13. Musai, B; Psikologjia e edukimit; Tiranë, 2003;
14. **Oliver, JS ç Simpson, RD (1988)**. Ndikimet e qëndrimi ndaj shkencës,Motivimi Vetë arritje dhe Shkencës Koncepti mbi arritje në shkencë: Një Studimi gjatësisë Shkenca Edukimi 72 (2): 143-155 ;
15. Pettijohn, T; Psikologjia, një hyrje koncize; Tiranë, 1996;
16. **Salend**, ST; Teaching students not to seeat the test; 2012;
17. **Spielberger**, C; Theory and research in Anxiety, Academic Press, Neë York, 1996;
18. **Zeidner, M**; Test Anxiety. The state of the art; Neë York, 1998;

19. <http://www.adaa.org/living-with-anxiety/children/test-anxiety>; “Test Anxiety” from “Anxiety depression of America”, parë më 10 .01.2013;
20. <http://sq.yourwebdoc.com/anxiety.php>;
<http://www.psikologji.net> /Ankthi.

ROLI I KOMUNIKIMIT SHENJOR JOGJUHËSOR DHE SHENJOR GJUHËSOR

Dr. Gani PLLANA

Faculty of Mechanical Engineering University of Prishtina “Hasan Prishtina” in Prishtina

E-mail: ganipllana44@gmail.com

ABSTRAKT

Komunikimi gjuhësor njerëzor, i realizuar si komunikim njeri/njeri në gjuhën e mirëfilltë njerëzore, ku dhënësi dhe marrësi janë individë njerëzorë, të cilët e kryejnë aktin kumtues në formë gojore, me forma tingullore, në mënyrë plotësisht aktive. Në komunikimin gjuhësor zbulohet mekanizmi i plotë i formimit dhe i funksionit të gjuhës dhe marrëdhëniet e saj me të gjitha anët e brendshme e të jashtme për të (që lidhen me pjesëmarrësit në komunikim, me vetë shenjën si kod e mesazh, me situatën e mjedisin), si dhe me komunikimet e tjera (paragjuhësore e jashtëgjuhësore), që e shoqërojnë, mbështesin, ose e plotësojnë atë.

Nga skemat, e dhëna në punim, mund të zbulohen një varg lidhjesh, në të cilat përfshihet komunikimi shenjues gjuhësor me të gjitha komunikimet e tjera, prej nga dalin në sipërfaqe veçoritë e komunikimit gjuhësor dhe komunikimeve të tjera, kurse nga ana tjetër rastet e kalimeve nga njëri komunikim tek tjetri.

***Fjalët Kyçe:** Komunikimi gjuhësor njerëzor, komunikimi shenjor jogjuhësor, komunikimi shenjor gjuhësor.*

HYRJE

Në fillim të punimit do të përqendrohemi kryesisht mbi fjalët dhe imazhet, e, do të veprojmë përmes krahasimit. Fjalët dhe imazhet janë shenja. Semiologjia e përshkruan atë si një realitet me dy faqe-*shenjuesi* dhe i *shenjuari*, pra si një shfaqje që paraqit dhe paraqitet njëkohësisht. Treguesit janë shenja, ku nuk kemi ndarje mes shenjuesit dhe të shenjuarit. Shenjuesi dhe i shenjuari bëjnë pjesë në një të tërë, shfaqen në të njëjtën kohë dhe në të njëjtin objekt.

KOMUNIKIMI SI PROCES

Komunikimi është çdo proces, në të cilin ndajmë një informacion, ide dhe ndjenja. Ai nuk përfshinë vetëm fjalët e folura apo të shkruara, por edhe gjuhën e trupit, manierizmat personal dhe stilin çdo gjë që i shtohet kuptimit të një mesazhi.

Elementet e komunikimit janë disa: *Marrësi- dhënësi, mesazhet, kanalet, zhurma, Feedback, dhe mjedisi.*

Për të kuptuar rolin e komunikimit joverbal mund të bëni një eksperiment të thjeshtë. Shikoni një film apo emision debati duke ia ulur zërin në minimum televizorit. Shumica prej nesh janë në gjendje të kuptojnë qëndrimet emocionale dhe ndjenjat e folësve pavarësisht se nuk dëgjojmë asnjë fjalë. Madje në raste të veçantë nëse njihni kontekstin e bisedës dhe personazhet mund të kuptohet edhe ndonjë pjesë nga përmbajtja e saj.

Në fakt është e pamundur për një njeri të mos e përdor komunikimin joverbal. Ajo që është e veçantë te komunikimi joverbal është fakti që ne u dërgojmë mesazhe të tjerëve dhe kundër vullnetit tonë.

Komunikimi nuk përfshin vetëm fjalët por edhe shumë më i gjerë ku përfshihen fjalët, gjestet, lëvizjet, mimika e të tjera janë këto elemente që përbëjnë shkencën e komunikimit. Njeriu i nxitur nga subkoshienca e tij, përdor trupin shpeshherë, fytyrën, sytë, lëvizjet e gjymtyrëve, për të treguar gjendje të ndryshme emocionale. Nëpërmjet fjalëve zërit apo lëvizjeve të trupit, transmetojmë mesazhe tek njëri- tjetri, apo pasqyrojmë ndjenjat tona, si frikën, gëzimin, surprizën, të vërtetën apo gënjeshtren. Sipas kërkimeve nga shkencat e komunikimit lëvizjet përbëjnë 55% të transmetimit të mesazhit, fjalët 7% dhe 38% e mesazhit jepet nga përdorimi i zërit. Gjuha e trupit ka tejkaluar shpejt kuadrin e kërkimeve shkencore. E sot mund të themi se ka gjetur zbatime të mëdha në marketingun bashkëkohorë, në politik, sociologji, reklama apo kriminalistikë.

Një shprehje amerikane thotë: “ *Nuk ka rëndësi se çka thua po rëndësi ka se si e thua*”. Qoftë në marrëdhëniet personale në mes të dy personave, qoftë edhe tek e folura në publik ku realisht pjesa e folur e komunikimit verbal përbën vetëm 7% të impaktit që ti ke tek të tjerët.

KULTURA E KOMUNIKIMIT

Sipas autorit Marshall McLuhan, në historinë e qytetërimit njerëzor janë zhvilluar tri kultura të komunikimit të veçantë, por të lidhura:

- auditore,
- vizuale,
- elektronike.

Kultura auditore e komunikimit. Forma më e vjetër e komunikimit njerëzor që lindi spontanisht dhe evoluar me zhvillimin e bashkësive njerëzore.

Dëgjimi - komunikimi verbal zhvillohet kryesisht me të folur dhe gjuhës, media e të folurit është vendimtare. Megjithatë, ekziston edhe manifestimi jo-gjuhësore i këtij lloji të komunikimit: kollitjes, gërhitës, fishkëllimës etj.

Kultura vizuale të komunikimit. Ka filluar sëpari me shënimin e shenjave, me paraqitjen e shtypit, ky lloj komunikimi në mes të njerëzve merr tipare të reja. Manifestohen në formë gjuhësore dhe jogjuhësore.

Kultura elektronike të komunikimit. Ka më shumë se 140 vjet nga shpikja e telegrafit, që ka pasur një ndikim të fortë në të gjitha lidhjet e komunikimit. Ndikim të fuqishëm dhe zbatim ka gjetur zbulimi dhe dhe përdorimi i kompjuterit.

Kompjuteri bazohet në mediat audio-vizuale, të tilla si TV, teletekst, telefona celular, internet etj

MARRËDHËNJET NË MES TË KOMUNIKIMIN SHENJOR DHE JOGJUHËSOR

Vështruar nga pikëpamja e marrëdhënieve hierarkike me komunikimet e tjera shenjore jogjuhësore, komunikimi shenjor gjuhësor hyn në lidhje të shumta të përbëra në bazë të tiparit themelor, siç është karakteri i tyre shenjor si edhe i tipareve të tjera, të cilat, nga njëra anë, mund të jenë të diferencuara, kurse, nga ana tjetër, mund të shërbejnë si kalime nga njëra tek tjetra²⁷. Për të sqaruar, në vijim do të paraqesim skemat (shembull: 1. Në komunikimin shenjor jogjuhësor semaforin dhe njeriun (fig. 1), kurse në komunikimin shenjor gjuhësor: 2. Dy njerëz dhe shenjën përkatëse gjuhën (fig. 2)).

²⁷ Duro, A. , “Teori komunikimi (kurs leksionesh)”, QSA IGJL Tiranë, 2013, f. 20.

1. Semafori:




Fig. 1. Komunikimi shenjor jogjuhësor

2. Gjuha



Fig. 2. Komunikimi shenjor gjuhësor

Në vazhdim do të paraqesim të përbashkëtën dhe të dallueshmen e komunikimit:

E përbashkëta e komunikimit:

- Dy pjesëmarrës në komunikim (dhënës (A)-marrës (B)),
- Shenja prej dy elementesh (shënuesi - i shënuari) si imazh psikik,
- Karakteri fizik dhe i strukturueshëm i shenjës,
- Kanali i pranishëm tek të dy,
- Mesazhi dhe kodi.

E dallueshmja e komunikimit:

1. **Shenjë/njeri:** Dhënësi është shenje. Shenja (drita jeshile) është shumë e lidhur pas subjektit dhe vendit e kohës, ku dhe kur realizohet lidhja.
2. **Njeri(shenjë)/njeri:** Dhënësi dhe marrësi janë njerëz (shenja pozicionohet në mes tyre). Shenja gjuhësore “kalo”! Del si zëvendësuese e shenjës së semaforit (*dritë jeshile*). Pra, shfaqet si shenja e shenjës, e cila zëvendëson shenjën me fjalë, si edhe çdo shenjë tjetër jogjuhësore. Shenja gjuhësore nuk është e lidhur vetëm me vendin dhe kohën, ku dhe kur ajo realizohet.

Komunikimi gjuhësor njerëzor /*njeri/njeri*/, i konvertuar në komunikim *shenjë/njeri*, ku dhënësi (njeri) është shndërruar në shenjë (tekst, fjalë, fjali deri një vepër), të prodhuar prej tij, kurse marrësi është individ i njerëzor. Ky komunikim kryhet në mënyrë pasive, ku informacioni i dhënë (nga dhënësi, tekste), zbulohet si mesazh për marrësin, me të gjitha anët që takohen në komunikimin gjuhësor gojor (*njeri/njeri*). Në këtë mënyrë një komunikim i tillë (*shkrimor*) mund të pranohet si zëvendësues i komunikimit gjuhësor gojor, por mund të shoqërohet, mbështetet, plotësohet nga komunikimet e tjera paragjuhësore, sidomos jashtëgjuhësore (nga ato figurative, audiovizive deri në objekte, si p.sh. komunikimi reklamativ, ku bashkohen teksti, figura (e vdekur, e gjallë/lëvizëse) dhe objekte që reklamohet etj.

Komunikimi gjuhësor njerëzor (*njeri/njeri*), ku dhënësi dhe marrësi janë brendësuar tek një individ i vetëm njerëzor i cili me gjuhën e tij *komunikon brenda vetes* (me të folurit e brendshëm), por që mund të shfaqet sipas rastit edhe jashtë tij me forma tingullore. Ky shoqërohet me komunikimet e tjera si p.sh., paragjuhësore (të folurit me vete + gjesti, shprehje të fytyrës). Mund të sillen shembuj nga jeta reale, nga personazhe filmash etj.).

Komunikimi gjuhësor njerëzor (*njeri/njeri*), i realizuar në mënyrë të nëpërmjetur, i cili në tërësi merr formën e komunikimit *njeri/(makinë/makinë)/njeri*, siç mund të jetë komunikimi telefonik (me telefon fiks, me telefon lëvizës (celular), ku del si kombinim i komunikimit *njeri/njeri* (komunikimi gjuhësor (gojor) dhe komunikim sinjalor makinë/makinë. Komunikimi i parë është plotësisht i njëjtë me atë njerëzor, por lidhjet me komunikimin tjetër, meqë bëhen në mënyrë të nëpërmjetuar dhe marrësi dhe dhënësi nuk shohin njëri tjetrin (ose në teknologjinë e sotme edhe mund ta shohin).

Komunikimi gjuhësor njerëzor, i reduktuar në komunikim *makinë/njeri*, ku makina (aparati) shërben si *dhënës*, në vend të *dhënësit njerëzor* (i cili mund të dalë si imitues i tij), kurse njeriu vetë është *marrës i informacionit*, siç mund të përmendim komunikimin me aparat dhënës

(dëgjimor, pamor) (radio/njeri, televizor/njeri. Ky lloj komunikimi mund të marrë, në vartësi nga aparati, forma komplekse, siç mund të thuhet për komunikimin *televizor/njeri*, i cili shoqërohet në figurë lëvizëse, mjete statike e dinamike, si dhe me komunikimin sinjalar, ku marrësi ndërkohë shikon dhe dëgjon, duke u lidhur edhe me komunikimet e tjera, paragjuhësore, jashtëgjuhësore.

Komunikimi shenjor gjuhësor dhe komunikimi shenjor jogjuhësor (paragjuhësor e jashtëgjuhësor) dalin si shtojca të njëri tjetrit, në vartësi nga vendi që zë njëri apo tjetri në procesin e komunikimit. Kështu, p.sh. një fotografi, figurë, skemë, shenjë në përgjithësi (si parësore), (në një libër) shpjegohen nga një fjalë, fjali, tekst ose anasjelltas. Në rastin e kundërt shenjat (figurat, skemat), si dytësore, konkretizojnë fjalët (tekstin) si parësore. Këtu mund të futet te komunikimi gjuhësor gojor (ajo që flitet e shoqërohet me figurë, objekt etj.). Por mund të shihet edhe si rasti i anasjelltë.

Komunikimi gjuhësor me prejardhje nga komunikimi paragjuhësor, i ngritur në sistem rregullash, siç mund të jetë komunikimi gjestor (me gjeste) për të shurdhëritë, komunikimi me gishta (didaktik) për të verbëritë. Ndonëse ky lloj komunikimi ka kufizimet e veta në krahasim me komunikimin real gjuhësor (sidomos me atë gojor), ai gjithsesi është sistem nëpërmjet të cilit organizohet marrëveshja njerëzore (në rastin tonë kur njeriu nuk dëgjon ose nuk shikon).


Komunikimi gjuhësor, i realizuar me anë të përpunimit të komunikimit gjuhësor, duke e reduktuar atë për qëllime të caktuara më të ngushta siç mund të jetë gjuha e makinës (në kompjuterat e sofistikuar) etj.

Komunikimi gjuhësor, që mund të konsiderohet si gjuhësor nga tiparet e tij të kufizuara dhe nga qëllimet për të cilat shërben, siç mund të sillen si shembuj komunikimi makinë/makinë ku makina paraqitet si imituese e gjuhës njerëzore.

POZICIONIMI I KOMUNIKIMIT SHENJOR GJUHËSOR

Komunikimi shenjor gjuhësor pozicionohet në nivelin më të lartë të shkallës së abstraksionit të shenjës, që pasqyrohet në shkallën më të lartë të arbitraritetit të saj në krahasim me komunikimet e tjera. Kjo bën që komunikimi *shenjë/njeri*, nga pikëpamja e shkallës së arbitraritetit të shenjës, të vështrohet në mënyrë të përshkallëzuar nga niveli më i ulët i arbitraritetit, madje *niveli zero*, (ku shenja identifikohet me vetveten, e del si shenjë objekt) e deri

në shkallën më të lartë të saj, çka pasqyrohet në marrëdhëniet shenjë gjuhësore gojore/njeri, siç do ta shohim të paraqitur më poshtë në mënyrë skematike:



KONKLUZION

Komunikimi gjuhësor njerëzor merr forma shumë të larmishme e komplekse, shfrytëzohet plotësisht në media, duke realizuar lidhjen masive (publike) të njeriut me botën në të gjitha anët e saj, prandaj kohët e fundit edhe në Teorinë e komunikimit gjuhësorë përbën një objekt të veçantë studimi. Këtu vend të parë marrin ngjarjet e përditshme të lidhura me problemet e politikës, të ideologjisë, me reklamat, me botën shpirtërore të njeriut etj.

Komunikimi gjuhësor i prejardhur nga një komunikim shenjor jashtënjerëzor, por i ngritur gjithsesi në një sistem, i cili shërben si mjet i marrëveshjes, si komunikim gjuhësor, siç mund të përmendet si e tillë komunikimi me daulle, me fshikullima etj.

Referenca:

- [1] Adele, F.&Elaine, M. (2005). *Si të flasim me adoleshentët*. Botimet “Max”, Tiranë.
- [2] Baylon, Ch.&Xavier Mignot, X. (2003). *Komunikimi*. Logos, Shkup.
- [3] Cavalli-Sforza, L. L. (2012). *Gjenet, popujt dhe gjuhët*, Besa, Tiranë.
- [4] Çoni, A. (2009). *Vlerësimi i elementëve të të folurit publik në leksione*. Aktet e konferencës shkencore ndërkombëtare “COMMUNICATING LINGUISTICALLY, INTER-CULTURALLY AND SOCIALLY”, Tiranë.
- [5] Duro, A. (2013). *Teori komunikimi (kurs leksionesh)*, QSA IGJL Tiranë.
- [6] *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe (1980)*, ASHSH IGJL, Tiranë.
- [7] Gupta. S. (2009). *Globalization and literature*. Polity Press, UK.
- [8] Marshall McLuhan (2011), “*Das Medium ist die Massage*“ Tropen-Verlag Label von Klett-Cotta, Stuttgart.
- [9] Mera, R. (2015). *Funksionet e komunikimit në veprën e De Radës trajtuar në Gjuha Shqipe dhe letërsia e shkollës së mesme*. KËRKIME SHKENCORE III, Konferencë shkencore ndërkombëtare mbajtur më 11 korrik 2014, QSA IGJL, Tiranë.
- [10] Minxhozi, M. (2012). *Sfida e aftësisë për të komunikuar ndërkulturalisht në shoqëritë global*. Seminari i VI Ndërkombëtar i Albanologjisë, USHT, Tetovë-Shkup.
- [11] Sforca, C.L.L. (2012). “*Gjenet, popujt dhe gjuhët*”, BESA Tiranë.
- [12] Shkurtaç, Gj. (2009). *Sociolinguistikë e shqipes*. Morava, Tiranë.

STRESI TE STUDENTËT E UNIVERSITETIT

Ma.Sc. Ismail ALIU

ABSTRAKT

Stresi është një gjendje e pakëndshme e zgjimit emocional dhe fiziologjik që studentët e provojnë në situata të ndryshme por më shpesh dhe më i koncentruar është gjatë afatit të provimeve.

Disa studentë e përcaktojnë stresin si ngjarje apo situata që shkaktojnë tek ata ndjenjën e tensionit, presionit apo emocionet negative të tilla si ankthi dhe zemërimi .Të tjerët e shohin stresin si reagim ndaj këtyre situatave.

Kjo përgjigje përfshin ndryshimet fiziologjike - të tilla si rritjen e rrahjeve të zemrës dhe tensionin muskolor, si dhe ndryshimet emocionale dhe te sjelljes.

Fjalët kyçe: *stresi, studenti, ankthi, rezultat.*

HYRJE

Stresi është gjendje e zakonshme dhe e natyrshme e gjallesës sonë të vdekshme. Ai lind si rrjedhojë e përpjekjeve tona për të aritur qëllimet, për t'u lidhur me të tjerët dhe për t'u përshtatur me kërkesat e të jetuarit në një botë që ndryshon çdo ditë. Përderisa gjatë jetesës tokësore ,, të gjitha gjerat mbartin kundërshti", midis lindjes dhe vdekjes tek ne përherë do të jenë të pranishme sasi të caktuara STRESI. Prapëseprapë, përgjithësisht ne e konsiderojmë stresin si dicka të padëshirueshme, që duhet zvogluar ose eliminuar përpara sesa të na shtrepsojë frutshmerine vetjake dhe të na bjerrë aftësinë e të jetuarit të jetës. Nga një këndvështrim tjetër, stresit mund ti shihen vlerat pozitive pas të cilave duhet kapur patjetër, nëse është e mundur. Kësisoj, qëllimi yne nuk duhet të jetë shmangia tëresore e stresit, e cila sidoqoft do të ishte e pamundur, por të mesuarit se si të dallojmë reagimet tona tipike ndaj tij dhe pastaj përpjekja për rregullimin e jetesës ne perputhje me të. Ne vend që të tërhiqemi nga stresi, mund te mesojmë të jetojmë me të dhe të rrisim aftësitë për të përballuar sfidat e jetës.

Nëse nuk arijmë të shohim ndonjë vlerë tek stresi, mund të zbrazemi shpirtërisht, mund të vuajmë dhe mund të nxjerrim perfundimin se nuk jemi ne rregull. Ne zakonisht kërkojme çlirim të menjëhershëm nga përjetime të tilla. Dhe kjo gjendje shihet duke u nisur nga e bardha.

Jetojmë ne nje botë ku kudo kundërshtia detyron filozofinë e shpërblimit të menjëhershëm. Duket se të menjëhershmen e kerkojmë ne cdo gjë, duke përfshi ketu edhe zgjidhjen sa çel e mbyll syte të problemeve tona.

E përkeahim doktrinën se gjithcka duhet të na bëjë disi të ndihemi mirë emocionalisht. Nëse nuk ndodh kështu, disa i zë ankthi dhe të gjithë më tepër se sa shpesh, e kerkojnë çlirim nëpërmjet këshillimeve, analizave ose kurave mjekësore. Është shkruar qe jeta të jetë SFIDË! Vuajtja nga ankthi, nga depresioni, zhgënjimi ose dështimi është mëse normale. Edhe kur ndonjëherë në të rrallë ose per disa dite me rradhë përjetohet shpirtzbrastia, NDALOHET dorëzimi pa kushte. Gjerat do të permisohen, kauza e luftës së jetesës është e madhërishme.

Meqenëse cdo njeri e menaxhon stresin në menyra të ndryshme, asnjë program i vetëm nuk garanton zbutjen e tij. Gjithsesi, mjaft sugjerime mbeten te vlefshme dhe mund të ndihmojnë për të frenuar stresin. Sfida jonë është që, mes tyre të zgjedhim cfarë na sherben më së miri.

NIVELI I STRESIT

Njohja dhe pranimi i stilit më të rehatshëm të të jetuarit, i cili përfshinë përmasën e ditjes së sasisë së stresit që mund ta tolerojmë, është rruga e frytshme e shmangies se pushtimit prej stresit. Disa njerez kanë stilin e të jetuarit si ne „**garën e kuajve**” dhe duket se nëpërmjet veprimtarisë së vrullshme, lulezojnë shpirtërisht dhe mendërisht, ndërsa disa të tjerë parapëlqejne stilin e të jetuarit si në „**garën e breshkave**” dhe funksionojnë më së miri kur ulet shkalla e veprimtarisë së tyre. Perpjekja për të përvetsuar stilin e te jetuarit si ne „**garën e kuajve**” kur në të vërtetë na parapëlqen shpejtësia e „**breshkës**”, ose anasjelltas, mund të jetë stresuese dhe kësisoj mund të ketë rrjedhoja shkatërrimtare.

Shpesh është vështire të zbulohet niveli i tolerancës së stresit, ngaqë ai priret të ndryshojë me kalimin e kohës. Nganjëherë duket se është më i lartë se sa zakonisht, kurse herat e tjera vështirsohet perballimi i sasive më të vogla të trysnisë.

Gjithsecili ka nivel të ndryshëm të tolerimit të stresit dhe nuk duhet të ndihemi fajtores nëse nuk mund të bëjme garë me dikë tjetër ne këtë ”betejë”. Përherë, për tu matur me njerëz me nivele më të larta se sa tonat sjell stress të përzgjatur. Prandaj, ne duhet ti besojme vetëm

vetvetes si autoritet per sasine e stresit që trupi dhe emocionet tona janë ne gjendje te perballojnë.

OBJEKTIVAT

Shumë herë, vënia e objektivave të aritshme mbetet vështirë, vecanërisht kur prindërit, shoket dhe dashamirët, na japin këshilla lidhur me çfarë do te ishte më e mira per ne. Është e rëndësishme që të vendosim vetë për objektivat tona, meqë marja përsipër e përmbushjes së objektivave që caktohen nga dikush tjetër krijojnë probleme. Megjithatë vështersite janë të mëdha, duhet ti analizojmë aftësite dhe interesat vetjake, duhet që të ndjekim kursin që të con drejt tyre, edhe sikur ato te mos mbartinin aq prestigj social dhe siguri financiare, sa të sugjeruara prej te tjerëve. Ta zëmë, mund të humbet mjaft kohë e dobishme, duke studiuar per tu bërë mjek, derisa ta kuptojmë se i kemi cuar dëm dhuntite tona nga matematika dhe kimia. Puna, sado e madhe dhe e zellshme, nuk garanton as suksesin dhe as lumturine.

Objektivat të arritshme lehtë me *”qitje te shkurter”*, duhet të vendosen krahas objektivave të veshtire, të aritshme me *”qitje te larget”*. Këta të parat na japin shansin e arritjes se niveleve të përmbushjes në rrugë e sipër dhe na pajisin me mundësi e të ndjerit mirë për sasi të vogla progresi. Do të ishim më të qetë me vetveten ne mbarimin e ditës, po të mendonim rreth detyrave të përfunduara, në vend të gjërave ende të pa filluara.

Asnjëhere nuk duhet të harojmë se stresi vjen edhe nga mospasja e objektivave dhe nga vënija e objektivave të paaritshme. Pra, rehatia e vazhdueshme është simptoma e shpeshtë e dikujt që ka zgjedhur të mos përcaktojë objektiva.

FORCIMI I BESIMIT

Duke pasur parasysh se jetojmë ndryshe nga se çfarë mendojmë, ky është një stress i pallogaritshëm mund të mbahet nën kontroll përderisa gjërat shkojnë mire. Mirëpo, trysnia e vërtetë e tij vihet re atëhere kur na kërkohet të kryejme punë shpirtërore. Në këtë rast detyrohemi që të shqyrtojmë shkallen e shpirtësise sonë dhe shpesh na kaplon përjetimi i të qenit kot dhe të pavlefshëm. Të gjithë arijmë të lexojmë termometrin shpirtërorë, teksa vërtetë përpiqemi për tu rritur shpirtërisht, ndjehemi mirë dhe me ndërgjegje të lehtësuar. Nësë nuk veprojmë kështu, tundohemi, fshihemi, mbrohemi kritikojmë dhe tjetërsohemi. Përjetimet e tilla janë stresuese.

Shpirti yne mund të qetsohet nëse pendohe mi për padrejtësite tona (ketu futen qëndrimet, mendimet dhe sjelljet), duke jetuar shpirtërisht më tepër.

ÇLODHJA E PËRDITSHME

Është mirë sikur të mund të krijojmë një "ishul kohorë" ku të lexojmë, të mejtojmë, të mendojmë dhe të lutemi pa ndërprerje cdo ditë. Kemi nevojë të mendojmë mirë për veten tonë, kemi nevojë të clodhemi në mënyrë që tju japim trupit, shpirtit dhe mendjes, mundësi për tu pregaditur për detyrat që na presin për gjatë ditës.

Trupi na dërgon sinjale që tregojnë, se kur duhet të pushojmë fizikisht dhe emocionalisht. Kërkohet që të jemi të ndjeshëm ndaj treguesve të tillë dhe të sillemi në përputhje me to. Përteritja emocionale dhe përteritja fizike lidhen ngusht me njëra tjetren. Studimet kanë treguar se vazhdimi i stresit emocional për një periudhë të gjatë mund të shkaktojë dëmtime të rrënda të shëndetit. Kur stërlodhemi, zotësia për tu marë me detyrat e zakonshme jetësore ulet dhe shpesh edhe problemi më i vogël na mund emocionalisht. Një periudhë pushimi i përditëshëm mund të na ndihmojë për të ruajtur të paprekura rezervat tona fizike dhe emocionale.

Përvec kësaj, është e dobishme të zbulojmë se kur duhet të heqim dorë nga sjellje të caktuara dhe kur duhet të mbledhim veten dhe të shtojmë intensitetin, që të përballojmë situatat e vështira dhe të pakëndeshme.

TË MENDUARIT SHËNDETSHEM

Mendimet që kemi shpesh përcaktojnë ndjenjat tona. Njerëzit dhe rrethanat nuk na inatosin dhe as nuk na merzisin, përkundrazi na inatos dhe na mërzi ajo që i themi vetes për këta njerëz dhe këto rrethana. Duhet që të merret parasysh se mendimet që ushqejmë për ngjarjet shkaktojnë stres dhe jo vete ngjarja. Me pranimin e këtij parimi hidhet një hap i madh në drejtim të kontrollimit të stresit.

Të menduarit shëndetshëm përfshinë pranimin e vendimeve të shkuara, pa e fajtuar veten. Është e lehtë të kthejmë kokën prapa dhe të shohim se çfarë mund të kishim bërë, duke mos kuptuar se atëherë bëmë më të mirën e mundëshme. Vrasja e mendjes për vendimet e shkuara është humbje kohe, na mërzi, nuk na lë që të jetojmë të tashmen dhe nuk na pengon që të planifikojmë për të ardhmen. Nga gabimet e shkuara, duhet që të nxjerrim mësim për të

ndërtuar sjellje dhe veprime të drejta duke mënjanuar vetëfajsimin dhe pasigurinë. Ndaj gabimeve të shkuara, duhet që të mësojmë të reflektojmë, duke u nisur nga parimi "*HEREN TJETER*" nëvend të parimit "*SIKUR*".

Të menduarit shëndetshëm nganjëhere shmanget, nëse vendosim ti ngaterojmë gjerat lidhur me ne dhe stresin që përjetojmë. Na pelqen të menduarit e mjegullt dhe përdorim shprehje të tilla si "*S'e di pse ndjehem kështu....*". Ne shpesh i përdorim këto terma për të përfutur vëmendjen dhe kujdesin e të tjerëve ose për të shmangur ballafaqimin me problemin konkret, ose përgjegjësitë vetjake dhe shoqerore.

ULJA E ZEMËRIMIT

Kur ndjenjat tona stresuese përfshijnë zemërimin, është mirë që ti largojmë sa më shpejtë që të jetë e mundur. Mbajtja përbrenda e zemërimit dhe mërise, duke ushtruar trysni të madhe mbi trupin, mund të shndërohet në simptoma serioze psikozomatike, të tilla si dhimbje koke, ulcera dhe probleme të ndryshme gastrointestinale. Zemërimi jo vetëm që na dëmton fizikisht por edhe na gryen shpirtërisht duke na lënë në dorën e forcave të liga. Në mënyrë për të zvogluar zemërimin është falemenderimi i të tjerëve për të mirat që na kanë bërë. Zoti mund të falenderohet gjithmonë për dhuratat hyjnore, që na ka dhënë (dritën e syrit, shëndetin, prindërit, ajërin dhe lirinë).

USHQIMET E SHËDETSHME

Mund të flitet shumë për ngrënien rregullt të ushqimeve të shëndetshme. Megjithatë, pothuajse të gjithë e dimë tashmë se ndjehemi më mirë fizikisht dhe emocionalisht, po të shmangim ushqimet me permbajtje të lartë sheqeri, duke i zëvendësuar me qumsht dhe bylmete, mishin, me frutat dhe perimet, buken me drithërat.

Mirëqenia fizike lidhet drejtpërdrejtë me menaxhimin e stresit emocional. Të ngrënit herë po e herë jo, dhe konsumi i tepërt i ushqimeve të thata ul ndjeshëm fuqinë e përballjes me detyrat tona të ditë përditshme. Ndërkohë, ushqimi i rregullt që përfshinë mëngjesin e bollshëm dhe të përhershëm, na ndimton për ti kontrolluar emocionet, duke mënjanuar luhatjet e tyre dramatike. Depresioni dhe ankthi mund të cojnë krye me lehtësi, nëse trupi nuk është i ushqyer si duhet. Mjaftë, atletë dhe kërcimtare, të cilet mbështeten në kapacitetet fizike, përpiqen që të ruajnë

peshën brenda dhjetë përqindëshit të idealeve për ta. Ky është një udhëzim i mirë që duhet shfrytëzuar nga secili prej nesh, për të mos i shpenzuar energjitë me mbipeshë.

PRITMËRITË TONA

Jo rallë, zhgënjimi, shpartallimi dhe zemërimi, vijnë si rrjedhojë e zhvillimeve të papritura, ngaqë përherë ushqejmë pritmeri të vetedijëshme dhe të pavetëdijshme lidhur me sjelljet tona, me qendrimet e të tjerëve dhe me ngjarje të vecanta të jetës. Disa shembuj pritmerie mund të përfshijnë:

1. Marrja e notave të larta
2. Përballimin e ngarkesës mësimore
3. Dhurimin e parave për ditëlindje
4. Pagesën e oreve të tepërta të punës
5. Leximin e mendimeve të pashprehura
6. Mirënjohjen e ndërsjellte dhe
7. Ndihmën në nevojë

Mënyra e dobishme për përballimin e stresit që buron nga pritshmeritë e papërmbyshura është zëvendësimi i tyre me SHPRESA.

RIINTERPRETIMI I STRESIT

Është lehtë të zemrohemi, të frikësohemi ose të humbasim shpresën, pas gjykimit nxjerrim konkluzionin se ndodhitë e përditshme janë stresuese. Përgjithësisht, motin e keq, të folurit vend e pa vend të shokut, humbjen e lojës apo të garës, marrjen e notave të dobta, refuzimin e kërkesës, ndryshimin e mjedisit i shohim me nota negative, mirepo stresi që prodhojmë mund të zvoglohet nëpërmjet riinterpretimit të të njëjtave situata nën një dritë tjetër.

Për shembull, ngjarjet që na pajisin me pëervoja dhe dije, sado të paperballueshme, duhet që ti vlerësojme edhe si nxitëse të përparimit personal dhe si sfida ku mundësohet shfrytëzimi eksperimental i afëtsive në kapërcimin e pengesave dhe si pjesë të natyrshme dhe normale të

jetës toksore. Përherë zgjedhja e menyrës së interpretimit të nje situatë është në dorën e vetë njeriut. Mënyra e interpretimit të stresit ndikon drejtpërdrejt mbi ndjenjat dhe rrjedhimisht prek edhe sjelljen. Interpretimi negativ prodhon ndjenja stresuese dhe shkakton sjellje bishtnuese ose kokefortsie. Interpretimi pozitiv prodhon ndjenja kenaqesie dhe shkakton sjellje productive, që nxit zhvillimin dhe rritjen e personalitetit.

KONKLUZION

Pranimi se stresi është i pashmangshëm, pjesë thelbësore e jetës dhe gjithashtu potencialisht i dëmshëm, aty për aty të përgatit për ta përballuar atë. Mundohu që të identifikosh shenjat e stresit dhe burimet e tij. Përpiku të njihesh me gjendjet shpirtërore të stresuara dhe të kesh idenë për sasinë e stresit që mund të menaxhosh pa rënie energjie. Zhvillo aftësite e interpretimit të ngjarjeve stresuese në menyrë positive. Energjia që vjen nga stresi mund të kanalizohet në formë konstruktive dhe mund të shndërohet në një mjet ndihmues për të ndërmarë ndryshime në mënyren e të jetuarit. Bëhu i ndërgjegjshëm për fuqinë tëndë. Mark Aureli (Marcus Aurelius) ka thënë: *"Nese je i pikelluar nga dicka e jashteme, dhimbja nuk eshte per shkak te asaj gjeje, por per shkak te vleresimit te saje prej teje"*. Çdo njeri ka fuqi të mjaftueshme për ta kontrolluar reagimin ndaj stresit. Prandaj, planifiko reagimin ndaj stresit.

Referenca:

1. Adams, A (1994) Bullyng at Work: How to Confront and Overcome It. London: Virago Pres;
2. Banton, M.(1995) Diskrimination. Milton Keynes: Open University Pres;
3. Purcell, K. and Pitcher, J. (1996) Great Expectation: The New Diversiti of Graduate Skills and Aspirations. Manchester: Higher Education Careers Services Unit, Careers Service Trust, Institute for Employment Research;
4. Rickards, T. (1992) Hoe to Win as a Mature Student. London: Kogan Page;
5. Ismail, A. (2004) Metodologjia e Mësimnxënies. Tiranë.

NDRYSHIMET NË VARGJET HOMONIMIKE PREJ FJALOR I GJUHËS SË SOTME SHQIPE 1980 NË FJALOR I GJUHËS SHQIPE 2006

Dr. Jonida CUNGU

Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan

jonida_cungu@yahoo.com

ABSTRAKT

Çështja e homonimisë në gjuhën shqipe është një çështje e studiuar dhe më e hulumtuar nga studimet gjuhësore se sa dukuria e polisemisë. Ajo vendoset në qendër të semantikës me pyetjen themelore: si mundet që me fjalë të njëjta të shprehim kuptime të ndryshme? Qasja e sotme kah studimit të homonimisë është përqendruar kryesisht në llojet e homonimisë dhe faktin pse ndodh kjo dukuri. Në këtë punim është guxuar më tej, duke i bërë analizë të hollësishme shtimit dhe eliminimit të çifteve homonimike, si dhe ndryshimeve që ka pësuar kjo dukuri në vargjet homonimike, si dhe lidhjet e saj me pjesët e pandryshueshme të ligjëratës.

Përfundimet e nxjerra kanë shërbyer si argument për të përcaktuar ndryshimet në vlerën e homonimisë në raport me poliseminë përgjatë kohës.
Fjalët kyçe: *Varg homonimik, shpërbërje, bashkim, rrudhje, zgjerim.*

HYRJE

Janë marrë në konsideratë për të shqyrtuar ndryshimet që kanë pësuar vargjet homonimike në gjuhën shqipe, duke trajtuar shpërbërjen e vargjeve homonimike, por edhe formimin e vargjeve të reja, duke u përqendruar në krahasimin e vargjeve homonimike me njëri-tjetrin nga “Fjalor i gjuhës së sotme shqipe” 1980 në “Fjalor i gjuhës shqipe” 2006. Studimi i këtyre rasteve ka shërbyer për të nxjerrë në pah ndryshimet e dukurisë së polisemisë, që hasen jo vetëm në çiftet homonimike, por edhe në vargjet homonimike.

MENDIME MBI PËRCAKTIMIN E DUKURISË SË HOMONIMISË

Tradita studimore e dukurisë së homonimisë daton që në shekullin e kaluar. Për shumë kohë në gjuhën shqipe do të mungonin studimet përgjithësuese dhe të gjithanshme, gjë që do të reflektohej në praktikën leksikografike. Edhe pse janë kryer studime e kumtesa të ndryshme mbi

këtë dukuri leksikore, përsëri raporti dhe dallimi i saj me poliseminë mbetet një çështje për t'u trajtuar më thellë. Në mesin e gjuhëtarëve nuk ka një mendim të përbashkët rreth fenomenit të homonimisë. **J.Lyons**²⁸ e përcakton dukurinë e homonimisë si “fjalë të ndryshme me forma të njëjta”, duke bërë ndarjen e tyre në *homonime absolute*, e cila duhet të plotësojë tri kushte: kuptime të palidhura, forma identike dhe gramatikalisht të barazvlefshme. Ndarja tjetër i takon homonimeve të pjesshme, ku fjalët dalin si homonime vetëm në disa pjesë të ligjëratës, pra të kushtëzuara gramatikalisht. Parimet e klasifikimit të saj, ndarja e njësive përbërëse homonimike në një fjalë të vetme ose jo, kanë qenë gjithnjë të diskutueshëm, edhe pse njihet ndarja e homonimisë në dy lloje: homonime leksikore (që i referohen të njëjtës pjesë të ligjëratës) dhe gramatikore (që i referohen pjesëve të ndryshme të ligjëratës).

Sipas studiuesit **F.R.Palmer**²⁹ homonimia përkufizohet si “fjalë të ndryshme me formë të njëjtë, të cilat pasqyrohen në fjalor si fjalë më vete”. Por një term i ri që është përhapur në gjuhësinë moderne dhe i takon klasifikimit të homonimisë, është "*homonimia funksionale*", i ofruar nga **A.S.Ahmanova**³⁰, pas viteve '80. Brenda këtij grupi janë përfshirë fjalët me tingëllim të njëjtë, që historikisht janë njohur si fjalë që vijnë nga e njëjta familje fjalësh, por që u përkasin pjesëve të ndryshme të ligjëratës.

Në traditën gjuhësore shqiptare, më e rëndësishme është të shihet prirja që ka gjuha shqipe kah homonimisë dhe trajtimi i tyre në praktikë. Është pranuar se kjo dukuri ka lindur për shkak të ndryshimeve që kanë ndodhur në gjuhë gjatë zhvillimit të saj historik. Pra, fjalët mund të kenë përfituar më kalimin e kohës një përputhje tingullore, për shkak të shqiptimeve të ndryshme që bëjnë njerëzit, por që kanë ruajtur një përmbajtje leksikore të ndryshme. Prandaj homonimia si dukuri gjuhësore, duket se i takon nivelit formal të gjuhës. Kjo mund të argumentohet me faktin se folësi mund t'i bëjë zgjedhjet e tij për forma tingullore të njëjta dhe në mënyrë të vullnetshme. Ai interesohet shumë pak nëse fjalët e përputhura fonetikalisht kanë të njëjtën origjinë apo jo. E rëndësishme është që ngatërresa kuptimore midis tyre zgjidhet nga përdorimi kontekstual.

²⁸ J.Lyons, "Linguistics semantics", Cambridge University Press, London, 1995, fq. 47.

²⁹ F.R.Palmer, "Semantics", Cambridge University Press, London, 1976, fq.67.

³⁰ A.S. Ahmanova. Slovar omonimov russkogo jazyka, Russia, 1984.

Ende mbetet në diskutim parimi themelor se ku duhet të mbështetet përcaktimi i homonimisë. Sipas **A.Kostallari**³¹ që mbështetet në gjuhësinë e kohës, përcaktimi i homonimeve bëhet në bazë të analizës semantiko-strukturore, e cila bën të mundur nëse kemi të bëjmë me homonimi apo me polisemi. Prandaj kërkimet mbi këtë fenomen janë gjithnjë një hap drejt përcaktimit më të saktë të termit "homonim", rreth klasifikimit të tyre dhe prirjen e gjuhës shqipe në këtë fushë.

Ndërsa studiuesi **Xh. Lloshi**³², veçon si parim themelor të dallimit të homonimisë në praktikë, vendin e fjalës në sistemin e sotëm të gjuhës shqipe, i cili përcaktohet jo vetëm nga lidhjet etimologjike të fjalës, por dhe nga lidhjet leksikore, morfologjike dhe sintaksore të fjalës. E thënë me fjalë të tjera, fjalët ndryshojnë nga njëra-tjetra jo vetëm në natyrën e tyre përmbajtjesore, por dhe në funksionin e përfshirjen kuptimore.

R.Memushaj³³ i konsideron homonimet si fjalë që përputhen nga forma, por dallohen nga kuptimi. Dallimi midis polisemisë dhe homonimisë qëndron në faktin se, në polisemi të shënuarit e ndryshëm lidhen me midis tyre me një shënues që funksionon si një njësi e vetme, ndërsa në homonimi të shënuarit e dryshëm janë pa lidhje midis tyre, duke u lidhur secili veçmas me shënuesin. Pra kriteri i dallimit është semantiko-strukturor. Në vija të përgjithshme kriteret përcaktuese të dallimit të homonimisë nga polisemia janë të përafërta, por ende mbetet problematikë dallimi ndërmjet dy dukurive gjuhësore.

METODA E STUDIMIT

Metoda e përdorur në këtë punim për të dhënat statistikore të përfuara është analiza krahasuese, e realizuar me imtësi ndërmjet dy fjalorëve shpjegues të gjuhës shqipe. Është marrë në shqyrtim fondi leksikor i shqipes, duke u ndalur në prurjet e reja leksikore në fjalorin shpjegues, por edhe në njësitë leksikore apo variantet kuptimore të fjalëve të veçanta, të cilat tashmë kanë dalë nga përdorimi. Për të realizuar këtë punim është bërë krahasimi i ndryshimeve

³¹ A.Kostallari, "Parimet themelore për hartimin e Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe", në "Studime mbi leksikon" II, Tiranë 1972, fq.51.

³² Xh.Lloshi, "Vëzhgime mbi homonimet në gjuhën shqipe", në "Studime mbi leksikon" I, Tiranë 1972, fq.204.

³³ R.Memushaj, "Hyrje në gjuhësi", Tiranë, "Toena", fq.172.

që paraqesin vargjet homonimike prej “Fjalor i gjuhës së sotme shqipe” 1980 në “Fjalor i gjuhës shqipe” 2006. Analiza krahasuese është bërë në formë shteruese, me qëllim që të japë të dhëna të sakta për ndryshimet që ka pësuar dukuria e homonimisë dhe vlerën e saj në gjuhën shqipe.

NDRYSHIMET NË VARGJET HOMONIMIKE

Studimi i klasifikimit të homonimeve ka përfshirë në mënyrë të përgjithësuar dhe të dhënat për vargjet homonimike. Sipas J.Thomait³⁴ në gjuhën e sotme shqipe numërohen rreth 500 çifte ose vargje homonimesh. Kjo do të thotë se studimi i vargjeve, të cilat rendisin më shumë se tre homonime, gjithmonë është shqyrtuar në kornizën e çifteve homonimike. Por dhe ky fragment i dukurisë ka pësuar ndryshime të dukshme. Shumica e fjalëve që formojnë vargje homonimike i përkasin fjalëve shërbyese, të cilat kanë patur dhe numrin më të lartë të njëjësive për fjalë, bazuar në “Fjalor i gjuhës së sotme shqipe” 1980. Hartimi i fjalorit të ri “Fjalor i gjuhës shqipe” 2006 i ka rezervuar lëvizje fjalëve në njësitë përbërëse. Do të thotë se, fjalë të veçanta, të cilat arrinin deri në 6 vargje homonimike, sot kanë 3-4 vargje të tilla. Pra, rrudhja, zvogëlimi ka prekur dhe vargjet homonimike. Mënyra se si vepron gjuha ndaj kësaj dukurie është e njëjtë me atë të fjalëve homonimike. Fillimisht ilustruam me shembuj rastet e shpërbërjes së vargjeve homonimike:

ah,-u_I *bot.* dru i lartë... ah,-u_{II} britmë me shpirt dhe mungon **ah,-u_{III}** haku; arrç,-i_I *bot.* shkurre me gjethe... arrç,-i_{II} *anat.* fikthi i fytit dhe mungon **arrç,-i_{III}** *zool.* dosëz; cek/ë,-a_I vend i cekët. cek/ë,-a_{II} pjesa më e mirë, balli. cek/ë,-a_{III} loja cekash dhe mungon **cek/ë,-a_{III}** vendos të bëj dicka; koc/ë,-a *zool.* peshk deti dhe mungojnë **koc/ë,-a_I** kocak. **koc/ë,-a_{III}** dhi e zezë; lal/ë,-a_I *vjet.* emër i lashtë i banorëve të Myzeqesë. lal/ë,-a_{II} *bised.* babai kundrejt fëmijëve dhe mungon **lal/ë,-a_{III}** lloj guri lara-lara; mahi,-a_I *ndërt.* gërrshërëz anësore e çatisë... mahi,-a_{II} *krahin.* shaka, tallje dhe mungon **mahi,-a_{II}** pezmatim i një plage; makth,-i_I *bot.* bimë e ngjashme me trëndelinën. makth,-i_{II} *anat.* shtrat, makrosë. makth,-i_{III} ankth dhe mungon **makth,-i_{II}** këlysh lepur; pal/ë,-a_I pjesë e përthyer e një rrobe. pal/ë,-a_{II} 1. dy sende të një lloji a të një madhësie dhe mungon **pal/ë,-a_{III}** 1. fik i shtypur ose i çarë më dysh; pol,-i 1. *gjeogr.* secili nga dy skajet e kundërta të bushtit të Tokës dhe mungojnë **pol,-i_{II}** *krahin.* kind. **pol,-i_{III}** thith, çivi dere; por,-i_I *libr.* vrima

³⁴ J.Thomai “Prejardhja kuptimore në gjuhën shqipe” fq. 159.

shumë të imta në lëkurën e njeriut. *por*, -i_{II} *krahin*. sobë dhe mungon **por**, -i_{II} hallkë e hekurt që i vihet qerres; pruj prura (e kr. thj. bie) dhe mungon **pruaj**_{II} *krahin*. i bie pas një sëmundjeje. **pruaj**_{III} *krahin*. ruaj, mbroj; re, -ja_I 1. grumbull avujsh uji. re, -ja_{II} *muz*. notë muzikore. re, -ja_{III} e re dhe mungon **re**, -ja_{IV} *krahin*. fytyrë, pamje. **re**, -ja_V *vjet*. leje, urdhër.³⁵

Nga materiali i paraqitur vihet re se në 12 raste largimi i njëres prej njësive përbërëse të vargut homonimik, ka çuar në kthimin e tyre në çifte homonimike ose në fjalë monosemantike në pak raste. Mospërdorimi më i këtyre njësive mund të ketë ndodhur për tri arsye:

1. është zgjedhje e fjalorit për të lënë jashtë elementët e panevojshëm, të cilët i përkasin një hapësire të ngushtë komunikuese.
2. vjetërimi dhe pasivizimi i këtij lloji leksiku nga ana e praktikës ligjërimore.
3. shprehje e ekonimizmit në gjuhë.

Arsyeja e parë duket se është dhe më bindëse për këtë dukuri. Qëllimi për të ndikuar sa më shumë në pastërtinë e gjuhës shqipe, mendoj se nuk po merr parasysh as ndikimet që sjellin largime të tilla në dukurinë e homonimisë. Me të vërtetë që çdo ndryshim, i kujtdo lloji qoftë, përbën zhvillim për gjuhën, pasi vetë ajo reflekton prirje për përsosje dhe përmirësim, por pasoja shkon në rrudhjen e homonimisë, prishjen e vargjeve homonimike dhe shtimin e fjalëve monosemantike. Prandaj, problematika më e diskutueshme e homonimisë nuk mund të mbetet vetëm në klasifikimin e saktë të homonimeve, në marrëdhëniet që vendos ajo me poliseminë apo shkaqet e ndryshimeve kuptimore, por dhe me prirjen që ka kjo dukuri në gjuhë.

Pjesa më e madhe e njësive të eliminuara i takon kategorisë së emrit, të cilët shënojnë diçka konkrete. Duket se homonimet që i përkasin së njëjtës pjesë të ligjëratës, janë të prirura për t'iu përgjigjur shndërrimeve më shpejt se llojet e tjera të homonimeve. Përpos kësaj, fjalët e mësipërme janë të burimit dialektor, të cilët kanë marrë një zhvillim të ndryshëm, për të mos iu përgjigjur më dukurisë së homonimisë. Vetëm në një rast ka ndodhur që vargu homonimik të eliminohet edhe si njësi leksikore njëkohësisht. Këtë gjë ka pësuar fjala *-plengu-*, e cila nuk

³⁵ Shënim: Fjalët me shkronja të zeza i takojnë njësisë së vargut homonimik të cilat janë eliminuar nga Fjalori i 1980-ës.

paraqitet më fare në fjalor. Ose, njësitë i janë larguar dukurisë së homonimisë dhe kanë qëndruar si njësi leksikore, psh: ndajfoljet *-pak* dhe *shumë*- paraqesin këtë dukuri.

Ka dhe fjalë për të cilat mund të ngrihen pikëpyetje. Nëse do t'i referoheshim elementit lidhës që cilësohet si nyje semantike e kuptimeve, gjenden raste që mund të ishin paraqitur dhe si kuptime të një fjale polisemantike dhe jo homonime. Psh. te fjala *-lalë*- ekziston një lidhje, e cila i referohet dhe anës kontekstuale. Kjo është një fjalë që përdoret në një territor të caktuar dhe nuk duket aspak e çuditshme që dhe kuptimi "babai kundrejt fëmijës", të ketë burim nga ky territor. Ose te fjala *-palë*-, ku dy homonimet e para ngjasojnë më tepër me kuptimet e një fjale, që kanë si nyje semantike "palosjen, e palosur", se sa si fjalë më vete. Kjo dëshmon vështirësinë që has akoma leksikologjia në përcaktimin dhe diferencimin e polisemisë nga homonimia.

Lëvizshmëria kuptimore te vargjet homonimike ka sjellë dhe të kundërtën, prurje në shtimin e vargjeve homonimike, e cila ka ndodhur në këto raste:

çe/k,-ku_I *fin.* urdhërpagesë. çe/k,-ku_{II} banor i Çekisë. çe/k,ku_{III} ushqimi që merr me vete bariu për të ngrënë dhe shtohen **çe/k,-ku_{II}** cep, skaj; çik/ël,-la copë shumë e vogël e diçkaje të ngurtë dhe shtohen **çik/ël,-la_{II}** bice. **çik/ël,-la_{III}** bot. barishte e vendeve të thata shkëmbore; krap/e,-ja_I *anat.* vezore e kafshëve dhe shtohen **krap/e,-ja_{II}** *anat.* heqës. **krap/e,-ja_{III}** bot. qershia me kokrra të zeza e të forta; larëz,-a_I bot. larushkë, larëz,-a_{II} *zool.* zog i vogël sa një harabel dhe shtohet **larëz,-a_{III}** sëmundje si zgjebja; nusk/ë,-a_I *vjet.* hajmali. nusk/ë,-a_{II} kukull fëmijësh dhe shtohet **nusk/ë,-a_{III}** bot. ferrënuse.³⁶

Struktura e fjalëve homonimike është shtuar me njësi të tjera, të cilat kanë sjellë zgjatjen e vargut homonimik. Shihet që një dukuri e tillë është pak e zhvilluar. Njësitë e reja të vargjeve homonimike janë terma nga fusha të veçanta, të cilat mund të kenë qenë të zhvilluara kuptimisht në të folme apo në dialekte të ndryshme. Duke përfaqësuar një fjalë të re, krijojnë marrëdhënie homonimike me fjalët ekzistuese.

Vargjet, ashtu si dhe çiftet homonimike i janë nënshtruar bashkimit njësisive në një fjalë të vetme ose në reduktimin e tyre deri në çift fjalësh. Fjala *-masë*- numëronte varg prej tri homonimesh në Fjalorin e 1980-ës: *mas/ë,-a_I* njësi matjeje; *mas/ë,-a_{II}* mënyrë veprimi dhe

³⁶ Shënim: Fjalët e shënuara me gërma të zeza i përkasin njësisive të reja, të shtuara në Fjalorin e 2006-ës.

mas/ë,-a_{III} sasi e madhe prej lënde. Sot kjo fjalë shënon çift homonimik, pasi njësia e parë është bashkur me të tretën në një fjalë të vetme. Ato janë kthyer në njësi semantike të së njëjtës fjalë, për faktin se kanë të përbashkët si një semantike, “vlerë e një sasi”. Prandaj, dhënia si kuptime të një fjale dhe jo si homonime, është e justifikueshme. Po e njëjta gjë ndodh dhe te fjalët: *pup/ë*,-a_I *bised.* tufë prej diçkaje, *pup/ë*,-a_{II} *bised.* kërcim me të dyja këmbët e bashkuara, *pup/ë*,-a_{III} këpucë të vogla për foshnja, *pup/ë*,-a_{IV} pjesa e prapme e anijes, *pup/ë*,-a_V *zool.* pupëz dhe *pup/ë*,-a_{VI} *biol.* larva e disa kandrrave. Vargu homonimik shkurtohet deri në katër njësi, sepse bashkohen njësia e I, V dhe e VI homonimike në një të vetme, pasi kanë si nyje të përbashkët semantike “të mbështjellë, xhufkë”. Kjo njësi polisemike zhvillon dhe njësi të tjera leksikore, që kanë po të njëjtën nyje, si: pupëz dhe pupëzon. Prandaj në këtë njësi kemi të bëjmë me kuptime të një fjale polisemike.

Bashkimi i varianteve semantike në një njësi leksikore ndodh dhe te fjala –shkarpë-, e cila sot paraqitet si fjalë polisemantike pas shkrirjes së katër njësive homonimike: *shkarp/ë*,-a_I degë të holla e të gjata që përdoren për zjarr, *shkarp/ë*,-a_{II} këpucë që nuk mbahen më, *shkarp/ë*,-a_{III} *bot.krahin.* xinë, *shkarp/ë*,-a_{IV} pite pa mjaltë. Nyja, e cila i lidh këto kuptime është “elementë që përdoren për t’u hedhur në zjarr, të djegshëm”. Kjo nyje mendoj se është më tepër një lidhëse kontekstuale, pra nyje kontekstuale, se sa semantike. “Këpucët” dhe “pitja e mjaltit” me hamendësim mund të konsiderohen si lëndë të djegshme dhe jo një lidhje konkrete dhe e justifikuar midis kuptimeve.

E njëjta gjë ndodh dhe te mbiemri -(i,e) shtënë-, i cili na Fjalorin e 2006-ës paraqitet si fjalë polisemantike, ku janë bashkuar tri homonimet në një njësi: shtënë (i,e)_I *mb.* që i pëlqen dikush a diçka, që është i dhënë, shtënë (i,e)_{II} *mb.* i shtirë dhe shtënë (i,e)_{III} *mb.* shtijak. Nyja lidhëse midis njësive është “i sajuar, i stisur”. Shkalla e qartësisë së lidhjeve nuk është bindëse, nëse nuk i referohemi kontekstit, prandaj mbështetja te nyja kontekstuale do ta argumentonte më tej bashkimin në një njësi leksikore, pavarësisht se ato shënojnë cilësi. Mbi nyjen semantike “zbres, shkarkoj”, janë bashkuar dhe dy njësitë e vargut homonimik të fjalës –shkarkoj-, e cila ka përfunduar në çift homonimik: *shkalit*,-ur_I shkreh, dobësoj, flashk. *shkalit*,-ur_{II} *vjet.* zbres nga kali. *shkalit*,-ur_{III} *tek.* i heq kalitjen diçkaje prej çeliku. Lidhjet kuptimore janë bindëse dhe kanë korrigjuar ndarjen e mëparshme, që e jepte si varg homonimik.

Mirëpo ka dhe raste të tjera, kur lidhjet midis kuptimeve janë të largëta dhe jobindëse për të qenë si variante semantike të një fjale. Kjo ndodh te fjala *-palëz-*, ku të treja njësitë homonimike janë bashkuar në një njësi të vetme leksikore polisemantike: *palëz, -a_I* bula e veshit, *palëz, -a_{II}* fije prej mëndafshi e mbështjellë në një rrotull, *palëz, -a_{III}* palë fiku. Midis dy njësive të fundit mund të marrim si një semantike “të renditura, të mbështjella”, por me njësinë e parë nuk gjejmë dot ndonjë lidhje. Gjithashtu, struktura kuptimore e njësive të dyta mund të plotësohet dhe me zhvillimet kuptimore të tyre. Kemi *-palëz, palëzoj* “e bëj me pala a me rrudha”, *palëzim, palëzohet, palëzuar* (i,e), të cilat i përgjigjen po të njëjtës nyje semantike. Ndërsa njësia e parë nuk gjeneron zhvillime të tjera kuptimore, por mbetet e lokalizuar si emërtim termi. Zbulimi i prejardhjes semantike në lidhje të tilla homonimike na ndihmon për të dhënë përgjigjen, se këtu kemi të bëjmë me një çift homonimik dhe jo me një fjalë polisemantike.

Ndërsa te fjala *-verore-* kemi bashkimin e homonimit të parë me të dytë dhe na paraqitet si çift homonimik; *veror/e, -ja_I* *etnogr.* gjalmë i hollë, i dredhur me dy-tri fije, që u vihet fëmijëve në dorë, *veror/e, -ja_{II}* *zool.* zhabë që del e kuak në fillim të pranverës, *veror/e, -ja_{III}* mjet për të bërë veri. Edhe këtu lidhjet kuptimore janë të paqarta, sado që t’i referohemi dhe nyjes kontekstuale “që lidhet me pranverën”. Ato shënojnë dy nocione më vete, pasi flitet për dy koncepte të ndryshme, që logjikisht nuk mund të kenë shenjën e barazisë midis tyre. Për më tepër që homonimi i dytë shënon term nga një fushë e vecantë, lloji i të cilëve e ka më të vështirë të zhvillohet si prejardhje semantike, për hir të karakterit konciz që ata kanë. Prandaj, këtu duhej të kishim një varg dhe jo çift homonimik.

Një vend të veçantë zënë dhe fjalët shërbyese, vargjet e të cilave në pjesën më të madhe të rasteve e humbin lidhjen homonimike, duke u kthyer në fjalë më vete, ose bashkohen për të dhënë një fjalë polisemantike. Kjo duket te fjalët shërbyese të paraqitura më poshtë: *do, pa, të* dhe *u*. Ndryshimet që kanë pësuar fjalët shërbyese është e nevojshme që të trajtohen më vete, jashtë këtij punimi, pasi kërkojnë analizë të hollësishme .

KONKLUZION

Në këtë punim u përpoqëm për të përvijuar të dhëna rreth situatës së vargjeve homonimike në gjuhën shqipe. Ndryshimet që kanë ndodhur në vargjet homonimike, kanë lënë

pasoja në dukurinë e homonimisë dhe në vlerën e saj në gjuhën shqipe sot. Dallohen dy lloje ndryshimesh të vargjeve homonimike:

1. shpërbërja e vargut homonimik në çift homonimik ose në fjalë monosemantike, e cila sjell rruhdje të dukurisë së homonimisë.
2. zgjerimi i çiftit homonimik me njësi të tjera, deri në formimin e vargut homonimik, e cila sjell zgjerim të dukurisë së homonimisë.

Shpërbërja e vargjeve homonimike ka sjellë këto ndryshime:

-pjesa më e madhe e njësive të eliminuara i takon kategorisë së emrit, të cilët shënojnë diçka konkrete.

- shkrirja e gjithë njësive homonimike në një fjalë të vetme polisemantike. Një dukuri e tillë haset dhe në shkrirjen e njësive të çiftit homonimik në një fjalë të vetme shumëkuptimëshe. Njësitë e reja të vargjeve homonimike janë terma nga fusha të veçanta, të cilat mund të kenë qenë të zhvilluara kuptimisht në të folme apo në dialekte të ndryshme.

Shqyrtimi i ndryshimeve të vargjeve homonimike, shënon një pasqyrë të re të shndërrimeve që ka pësuar dukuria e homonimisë dhe lëvizjet që pësojnë njësitë homonimike Brenda saj, për të studiuar vlerën e dukurisë së homonimisë në gjuhën shqipe.

Referenca:

1. A.Kostallari, “Parimet themelore për hartimin e Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe”, në “Studime mbi leksikun” II, Tiranë 1972.
2. A.Kostallari, “ Në rrugën e hartimit të fjalorit normative të shqipes së sotme”, Studime mbi leksikun 1972.
3. A.S. Ahmanova. Slovar omonimov russkogo jazyka, Russia, 1984.
4. F.R.Palmer, “Semantics”, Cambrdige Universitty Press, London, 1976.
5. J.Lyons ,“Linguistics semantics”, Cambrdige Universitty Press, London, 1995.
6. J.Thomai, “Leksikologjia e gjuhës shqipe” 1984.
7. J.Thomai “Prejardhja kuptimore në gjuhën shqipe”, 2009.
8. R.Memushaj, “Hyrje në gjuhësi”, Tiranë, “Toena”.
9. Xh.Lloshi, “Vëzhgime mbi homonimet në gjuhën shqipe”, në “Studime mbi leksikun” I, Tiranë 1972.

DOSJA /PORTOFOLI I NXËNËSIT NJË MËNYRË PËR TË VLERËSUAR PËRPARIMIN E TIJ

Luiza MYRTAJ

PhD kandidate në Universitetin Europian të Tiranës, Shqipëri

E-mail: luizamyrtaaj@yahoo.com

ABSTRAKT

Ky studim paraqet rezultatet e një pune kërkimore, e cila synon vënien në dukje të rëndësisë së dosjes në arritjet e nxënësve

Studimi synon të vërtetojë hipotezën se krijimi i dosjes/portofolit është një ndër faktorët kryesorë me anën e të cilit mësuesi vlerëson progresin e nxënësit.

Qëllimi i punimit është të analizojë efektin e vlerësimit të nxënësit me anë të dosjes dhe ndikimi i saj në rezultatet e arritjeve të tyre. Për të vërtetuar hipotezën ngritëm pyetjen kërkimore të hulumtimit: Çfarë ndikimi ka dosja në vlerësimin e nxënësve? Nga rezultatet e nxjerra nga pyetësorët e shpërndarë nxënësve kemi mundur të kuptojmë se një dosje duhet të tregojë historinë e një nxënësi.

Nga rezultatet e hulumtimit, kemi arritur në përfundimin se nxënësit janë të njohur me përgatitjen, qëllimin e hartimit të dosjes dhe e shohin atë si një mundësi shumë të mirë në vlerësimin përfundimtar të tyre.

Të dhënat u morën nëpërmjet pyetësoreve.

Në studim morën pjesë 27 nxënës që studiojnë në shkollën 9-vjeçare Kongresi i Manastirit”, në Tiranë” që kryejnë mësim në klasat VI-IX. Subjektet nxënës janë studiuar sipas këtyre variablave:mosha ,gjinia,klasat që zhvillojnë mësim.

Fjalët kyçe: *Vlerësim, nxënës, dosja/portofoli i tij, mësimdhënie.*

HYRJE

Nxënësit e dinë se cilat janë qëllimet e mësimin, cilat janë standardet që pritet t’i arrijnë ata dhe si do të vlerësohet e arritura e tyre (çka duhet të mësojnë dhe çka, si dhe kur do të vlerësohet

Llojet e vlerësimit janë të shumta të tilla si Vlerësimi formativ;Vlerësimi Sumativ (përmbledhës) ;Vlerësimi për nxënie (VpN) ;Vlerësimi i të nxënësit (ViN) ; Vlerësimi

diagnostikues;Vlerësimi me anë të testeve ;vlerësimi i vazhdueshëm;vlerësim i përditshëm ;vlerësim paraprak dhe **vlerësimi me dosje që** do të jetë objekti i rëndësishëm i punimit.

Ç'është dosja e nxënësit ? një 'koleksion' i qëllimshëm i punimeve të nxënësit që tregon për përpjekjet, përparimin dhe të arriturat e tij në një fushë mësimore të caktuar. Ky 'koleksion' duhet të përfshijë pjesëmarrjen e nxënësit në përzgjedhjen e përmbajtjes së dosjes, udhëzimet për përzgjedhje dhe kriterin e vlerësimit për të dëshmuar meritat dhe dëshmitë e vetëreflektimit të nxënësit'.(Arter&Spandel, 1992 (fq 32)

Në një dosje mund të përfshihen :Punë me shkrim, hulumtime, problemet e matematikës , raporte laboratorike, punë arti,lojëra, grafikë, anketa, vizatime , faqe ëeb-i, foto , kasete audio dhe video,testet , ese etj

Dosja e nxënësit mund të përdoret në të gjitha klasat, në të gjitha lëndët Para se të fillojmë procesin e krijimit të dosjes, është thelbësore që të përcaktojmë qëllimin e saj i cili përfshin :Çfarë materiale do të mbledhë nxënësi në to? Cilat nga objektivat e të nxënës do të vlerësohen me anë të saj? Do të vlerësohet procesi apo produkti? A është dosja mënyra më e mirë për të marrë informacionin që na duhet?

Të gjitha vendimet e tjera lidhur me formatin, përmbajtjen, reflektimet e nxënësve dhe mjetet e vlerësimit do t'i lidhë përsëri qëllimi. Qëllimi do të përcaktojë më pas llojin e dosjes dhe objektet që mësuesi dëshiron të përfshijnë nxënësit, si dhe kriteret mbi të cilat do të vlerësohen këto objekte Qartësia e qëllimit është kyç në përcaktimin si për të vlerësuar dhe pse do të përdoret dosja.

QËLLIMI I KËRKIMIT

Qëllimi kryesor që na shtyu të merremi me këtë problem është mënyra e re e vlerësimit të nxënësve me anën e dosjes. Për nxënësit e klasës IV-V vlerësimi i vazhduar përbën 45% të peshës, vlerësimi me test 30% të peshës, ndërsa portofoli i nxënësit përbën 25% të peshës. Ndërsa për nxënësit e klasave VI-IX, vlerësimi i vazhduar dhe ai me test kanë 40% të peshës së vlerësimit secili prej tyre, ndërsa dosja e nxënësit përbën 20% të peshës.Kjo peshë që zë dosja vërteton hipotezën tonë se krijimi i dosjes / portofolit është një ndër faktorët kryesorë me anën e të cilit mësuesi vlerëson progresin e nxënësit.

GJETJET PRAKTIKE

Gjetjet nga teoria na ndihmojnë të orientohemi dhe të fokusohemi te gjetjet nga puna me rastet. Nisur nga puna me rastet, na rezultojnë këto gjetje, të cilat kontribuojnë në vërtetimin e hipotezës se krijimi i dosjes është një ndër faktorët kryesorë me anën e të cilit mësuesi vlerëson progresin e nxënësit. Rastet hedhin dritë nëpërmjet përmbajtjes së tyre. Nëpërmjet pyetësorëve me nxënësit e përzgjedhur në kampionim, na rezulton se këta nxënës e dinë pse është e rëndësishme të shfrytëzohet dosja ;që dosja është individualej; ajo është dashamirëse, d.m.th. në të vendosen punimet më të mira të nxënësit, si dhe punime të cilat ai ka mundur t'i korrigjojë në të ardhmen, pra, është si një ditar i episodeve të mbara të tij

Meqenëse dosja është një risi, nxënësit do të hasin vështirësi të natyrshme në hapat e parë.

Dosja e nxënësit i vlen mësuesit për të shtuar edhe një zë tjetër në vlerësimin përfundimtar të nxënësit. Pra, për të vendosur notën vjetore të një nxënësi, mësuesi konsultohet edhe me dosjen e nxënësit

METODOLOGJIA

Në studim morën pjesë 27 nxënës që studiojnë në shkollën 9-vjeçare “Kongresi i Manastirit” dhe që kryejnë mësim në klasat VI-IX.

Subjektet nxënës janë studiuar sipas këtyre variablave:mosha ,gjinia,klasat që zhvillojnë mësim.

Kriteret përfshirëse:

- Të qënit nxënës të kësaj shkolle
- Përfshirja e nxënësve me moshë të ndryshme 12-15
- Përfshirja e nxënësve meshkuj dhe femra

Numri i nxënësve në studim	Mosha	Gjinia	Klasat që zhvillojnë mësim
27 nxënës	12-15 vjeç	17/F – 10/M	VI-IX

Më poshtë janë pasqyruar të dhënat lidhur me grup moshat e tyre dhe gjininë.

Tabela 2

Gjithsej /nxënës	Grup moshë	Meshkuj	Femra
2 nxënës	12 vjeç	-----	2
5 nxënës	12-13vjeç	-----	5
10nxënës	13-14vjeç	4	6
8 nxënës	14-15vjeç	4	4
2nxënës	mbi 15 vjeç	2	-----

Nxënësve të shkollës “Kongresi i Manastirit” u është shpjeguar qëllimi i studimit dhe përmbajtja e pyetësorëve. Pasi janë sqaruar për gjithçka, atëherë është kryer aplikimi i pyetësorëve. U është siguruar anonimat, u është bërë e qartë se plotësimi apo jo i pyetësorit është sipas dëshirës,dhe nuk janë të detyruar ta plotësojnë atë.

Për të ndërtuar pyetësorin na ka ardhur në ndihmë Qualtrics dhe shpërndarja e tyre është bërë me anë të postës elektronike. Pyetësori është ndërtuar me 5 pyetje ku nxënësit japin mendimet etyre rreth përmbajtjes së dosjes së nxënësit,rreth rëndësisë së saj,rreth vlerës që ka përdorimi i dosjes në vlerësimin përfundimtar të tyre dhe rreth lëndës që zë sasinë më të madhe të punëve në këtë dosje.

ANALIZA DHE INTERPRETIMI I REZULTATEVE TË HULUMTIMIT

Siç e thamë dhe pak më parë në studim morën pjesë 27 nxënës të shkollës 9 vjeçare “Kongresi i Manastirit” në qytetin e Tiranës.Pyetësori kishte në përbërje të tij 5 pyetje dhe pas analizës së përgjigjeve u fituan këto të dhëna dhe konstatime:

Pyetjes së parë . Çfarë përmban një dosje,? Pjesëmarrësit në pyetësor u përgjigjën 100% dhe më poshtë po japim disa nga përgjigjet:

Nje dosje permban te gjitha punet te vleresuara si me te mira nga mesuesit ne lende te ndryshme. si ne vizatim ,krijimet ne poezi ,hartat ne gjeografi




Te gjitha punet qe ne na pelqejne dhe qe kane marre vleresime maksimale nga mesuesit e lendeve.

Nje dosje permban punet me te mira ne lende te ndryshme si: vizatim, esete ne lexim ose ne gjuhe te huaj.

Punet e perzgjedhura, tonat

Pyetja e dyte : Sa e rendesishme eshte dosja per ju?

Paraqitur ne menyre grafike keto te dhena duken keshtu

#	Pergjigjet e pyetjes		Nr pergjigjesve	%
1	Dosja e nxenesit eshte pjesë e punës sime të përditshme		19	70%
2	Dosja e nxenesit nuk eshte pjesë e punës sime të përditshme		7	26%
3	nuk kam dosje /fare		1	4%
	Total		27	100%

Pyetja e tretë: A zë një vend të rëndësishëm vlerësimi i dosjes në vlerësimin tuaj përfundimtar të një lënde?

Në këtë pyetje 22 prej pjesëmarrësve që plotësuan pyetësonin dhanë përgjigjen se të pasurit e një dosje të mirë ndikonte në vlerësimin përfundimtar të lëndës, pasi vlerësimi i portofolit është një prej kolonave të vlerësimit ,ndërsa 5 pjesëmarrës dhanë përgjigjen se ajo nuk ndikonte dhe luante rol në vlerësimin përfundimtar


Kundrejt kësaj pyetje ka opinione pozitive dhe më pak pozitive dhe këto të fundit duhet të shërbejnë për të nxjerrë konkluzione për të ardhmen

Pyetjes së katërt se A përdoret dosja si një mjet për të ndjekur përparimin e nxënësve?

Një numër i konsiderueshëm nxënësish gati 60% e tyre ishin të mendimit se në lëndë të tilla si edukimi figurativ ,leximi letrar apo gjuha e huaj mësuesit e këtyre lëndëve e përdornin si një mjet për të ndjekur përparimin e nxënësve në këto lëndë dhe 40% e tyre shpreheshin se mësuesit tregoheshin entuziastë në fillim të hartimit të dosjes/portofolit dhe më pas as nuk merreshin me faktin nëse nxënësit po përparonin në këto lëndë apo po stoponin në vend.

Pyetja e pestë: 5. Ranko se cilat lëndë kanë më shumë punë në dosjen tuaj?

Ka këtë paraqitje grafike ku lexohet qartë dhe nëpërmjet garafikut që do të paraqesim më poshtë se lëndët që “mbushnin” dosjen me punët e tyre ishin gjuha shqipe dhe leximi letrar, edukimi figurativ dhe gjuha e huaj dhe më pak lëndët e tjera.



KONKLUZION

Përfundimet më interesante të punimit janë:

- Mësuesi vlerëson progresin e nxënësit nëpërmjet dosjes së tij.
- Mësuesi vlerëson punët dhe produktet e realizuara, prezantimet e ndryshme individuale dhe në grup, të përfshira në dosje.
- Mësuesi dhe nxënësi vendosin bashkarisht për punimet që do të futen në dosje
- Portofoli i nxënësit është një lloj koleksioni i cili synon të pasqyrojë progresin e nxënësit.
- Ai përmban detyra me shkrim, fotografi, incizime etj.
- Portofoli është individual, d.m.th. çdo nxënës mban portofolin e tij. Portofoli është dashamirës, d.m.th. në të vendosen punimet më të mira të nxënësit, si dhe punime të cilat ai ka mundur t'i korrigjojë në të ardhmen, pra, është si një ditar i episodeve të mbara të tij. Nxënësi vendos kryesisht vetë se me se do ta mbushë portofolin e tij.
- Mësuesi i udhëzon nxënësit e tij se si të krijojnë një portofol të mirë dhe bashkëpunon me ta rreth përmbajtjes së portofolit.
- Meqenëse portofoli është një risi, nxënësit do të hasin vështirësi të natyrshme në hapat e parë. Fillimisht, mësuesi, pasi t'i sqarojë mirë për portofolin, t'ua lërë në dëshirën e vet

nxënësve mbajtjen e tij, duke nxitur posaçërisht ata që shfaqen më të zellshëm. Me kapërcimin e vështirësive fillestare të mësuesit dhe të nxënësve, portofoli kthehet në një detyrim të përhershëm.

- Nxënësi ka detyrimin që kur mësuesi e porositi të mbajë portofol dhe t'ia paraqesë mësuesit sa herë ai ta kërkojë.
- Portofoli nxënësit i vlen mësuesit për të shtuar edhe një zë tjetër në vlerësimin përfundimtar të nxënësit. Pra, për të vendosur notën vjetore të një nxënësi, mësuesi konsultohet edhe me portofolin e nxënësit

Propozime

Me qëllim që vlerësimi me dosje të jetë një proces i suksesshëm duhet:

- Vendosni për qëllimet e dosjes
- Caktoni rezultatet e pritura dhe si mund të shfrytëzohet dosja për t'i paraqitur ato;
- Krijoni mundësitë që në bashkëpunim me nxënësit ta caktoni përmbajtjen e dosjes ;
- Jepni kohë nxënësve të reflektojnë dhe të angazhohen në vetëvlerësim

Referenca:

- 1)Garo, S. “Mësimdhënie bashkëkohore”, Botimet TOENA, Tiranë 2008 ;
- 2)IKAP” Inspektimi dhe vlerësimi i brendshëm i shkollës (Udhëzues për inspektimin e plotë të shkollës) Tiranë, 2011;
- 3)Musai.B”Metodologji e mësimdhënies”Tiranë 2003;
- 4) Saskatchewan Professional Development Unit” Portfolios:“More Than Just a File Folder”;
- 5)Udhëzues për zhvillimin e kurrikulës së re të gjimnazit - Portofoli i nxënësit http://ëëë.izha.edu.al/programet/udhezues/UDHEZUESI_Per%20Zhvillimin%20e%20Kurrikules%20se%20Re%20te%20Gjimnazit.pdf fq 122.

**MEJTEPI I KOSHTOVËS SË BOBIT QENDËR E RËNDËSISHME ARSIMORE,
FETARE DHE HUMANITARE NË RAJONIN E MITROVICËS**

Ma.Sc. Naim SEFERI

Tel: 044-213-947, 049-155-297

n.seferi@hotmail.com

ABSTRAKT

Në këtë studim kam elaboruar përpjekjet e atdhetarëve shqiptarë përhapjen e shkollës shqipe që datonin që nga koha e sundimit të P.Osmane. Këto përpjekje për mësimin e gjuhës shqipe ishin rritur që nga koha e Lidhjes së Prizerenit. Kërkesa për shkollë shqipe ishte përsëritur edhe gjatë kohës së Lidhjes së Pejës. Gjatë qeverisjes së turqëve të ri disa patriotët shqiptar, ndihmuan në ndërtimin e mejtepit në Koshtovë të Bobit. Ndërtimi kishte filluar më 1902 dhe kishte përfunduar më 1905. Si mejtep kishte punuar deri në vitin 1912, kur Kosova bie nën sundimin e Serbisë, e mbyllin mejtepin dhe e lënë të funksionoi vetëm si xhami deri në vitin 1915.

Gjatë luftës së parë Botërore Kosova bie nën sundimin e Austro-Hungarisë ku u hapen një numër shkollash për mësimin e gjuhës shqipe, në mesin e tyre shkollave hapet edhe shkolla e Koshtovës së Bobit, e cila do të punonte gjatë viteve 1915-1918. Pas përfundimit të luftës së parë botërore Kosova bie nën sundimin jugosllav. Pushtuesit serb mbylli të gjitha shkollat shqipe. Shkolla e Koshtovës shëndrohet në shkollë për mësimin e gjuhës serbe edhe pse në këtë fshat nuk kishte serb. Një situatë e tillë do të zgjatë deri me fillimin e luftës së dytë botërore. Gjatë luftës së dytë botërore Koshtova bie nën sundim Gjermanisë, naziste të cilet e hapen, përsëri shkollën shqipe në Koshtovë. Në lokalet e mejtepit të Koshtovës janë zhvilluar shumë veprimtari si; politike, humanitare, ushtarake, fetare dhe arsimore. Edhe pse në këtë lokalitet u zhvilluan shumë veprimtari nuk gëzon mbrojtje institucionale, kujdesen fshatarët në mënyrë humanitare.

Fjalë kyçe: *Gjuhë shqipe, mejtep, shkollë shqipe, Koshtovë.*

HYRJE

Fshati Koshtovë e Bobit gjendet nëkomunën e Mitrovicës nëpjesën veriore të Kosovës . Në fillim të shekullit XX, Perandoria Osmane ishte në rënie e sipër, patriotët shqiptarë e

dinin se krijimi i një shteti shqiptarë pa shkollë shqipe ishte shtëpi pa pullaz. Shtëpia e Shaban Rexhës në Koshtovë kishte qenë qerdhe e organizimeve të atdhetare që i bënte Hasan Prishtina e Isa Boletini në rajonin e Mitrovicës. Në odën Shaban Rexhës vendoset të ndërtohet një shkollë në Koshtovë e cila kishte karakterin e mejtepit. Etja për dije i kishte motivuar si fshatarët e Koshtovës ashtu edhe patriotët shqiptarë si Hasan Prishtina, Isa Boletini, Ferat Draga, Shaban Rexha që ta ndërtonin mejtepin në Koshtovë. Vendin për ndërtimin e mejtepit e dhanë banorët e Koshtovës, ndërtimi fillon në fund të vitit 1902 dhe në fillim të vitit 1903³⁷. Objekti u përfundua në vitin 1905.



Foto 1. Mejtepi i Koshtovës së Bobit në gjendjen aktuale³⁸

Isa Boletini i kishte paguar mjeshtër, dërrasat i kishte paguar Ferat Draga, pusin e kishte hapur Shaban Rexha, token për ndërtimin e mejtepit e kishte dhënë vllazërit Osmani dhe Sylejmani. Ata kishin bërë një ndërrim të tokës me lagjën Bahtiraj tash lagjja Grepaj, dhe pjesa që kishte tepruar nga toka i ishte dhënë për ndërtimin e mejtepit.³⁹ Sipas historikut të lokalit të shkollës fillore në Koshtovë tokën e kishte ofruar Kamber Sylë Grepj⁴⁰. Banorët e Koshtovës kishin punuar në mënyrë vullnetare që të përfundohej sa më shpejt mejtepi. Mësimi kishte filluar

³⁷ Historiku i shkollës fillore në Koshtovë të Bobit, "Jusuf Rexha"

³⁸ Pamja aktuale e Mejtepit

³⁹ Intervista e dates/03.06.2015 me Plakun 96 vjecar, Behram Feka

⁴⁰ Historiku I lokalit te shkolles fillore "Jusuf Rexha" ne Koshtove te Bobit

të zhvillohej në gjuhën osmane në vitin 1905 dhe shërbente si mejtepi. Mësuesit që kishin zhvilluar mësim në fazën fillestare të mejtepit të Koshtovës ishin; mulla Imer Kaqaniku, mulla Hasani, mulla Selimi etj. Gjatë sundimit të Perandorisë Osmane shkollat kishin karakter islam..Në qytetin e Mitrovicës në vitin 1909 ishte hapur edhe një ruzhdije ku kanë mësuar familjet turq dhe ata shqiptar të fesë muslimane, kanë mësuar edhe në gjuhën shqipe ata nxënës të cilët kanë dëshiruar.⁴¹ Pas shumë propozimesh në kongresin e Manastirit 14-22 nëntorit 1908 ishte vendosur që gjuha shqipe të shkruhej me germa latine që do të kishte 9 diagrame dhe dy diakritikë. Alfabeti i dalë nga kongresi i Manastirit u bë i detyrueshëm për shqiptarët dhe filluan të shtypen të gjitha gazetat, revistat dhe librat⁴². Alfabeti Manastirit i jep fund periudhës së trubullt gjuhësore të shtypit shqiptarë dhe e futi atë në rrugën moderne. Lokali i mejtepit të Koshtovës së Bobit do të punoj deri në vitin 1912 kur Kosova bie nën sundimin e Serbisë. Për shkak të rrethanave të krijuara mejtepi mbyllet duke luajtur vetëm rolin e xhamisë. Austro-Hungaria kishte përkrahur shkollimin shqip duke dhuruar fonde për shkollimin e shqiptarëve duke mundësuar të rinjëve shqiptarë shkollimin në Austri,që shqiptarët të mund ta mësonin gjuhën dhe historin e tyre e tere kjo në kohën kur shqiptarët gjendeshin nën pushtimin Osman.

MEJTEPI I KOSHTOVËS SË BOBIT QENDËR E RËNDËSISHME

SH.F.M.U Jusuf Rexha”,në Koshtovë e mbanë emrin e mësuesit të parë të shkollës shqipe. Keto shkolla kane luajturnje rol shumë te madh ne arsiminin e të rinjëve shqiptar në Mitrovicë dhe në rrethinën e saj. Mirëpo në vitin 1918, kur u ripushtua Kosova, mbreteria SKS I mbylli te gjitha shkollat ekzistuese ne gjuhen shqipe.

Më 1915 kur Kosova bie nën sundimin e Austro-Hungarisë lejohet për herë të parë hapja e shkollës së parë shqipe dhe mësimi i abetares në gjuhën shqipe të hartuar sipas parimeve të kongresit të Manastirit, e kishte sjellur mësuesi Jusuf Rexha banorë i Koshtovës. Banorët e Koshtovës kishin pasur fat ta kenë mësuesin që ishte banorë i fshatit kjo e lehtësonte banorët nga disa shpenzime. Banorët të etur për dije kishin festuar për një muaj kur ishte hapur shkolla shqipe,shkolla të tilla ishin hapur ne Mitrovicë,Fushiber(Zhabar),Koder(Zasellë),Vllahi,Kqiqdhe Broboniq.

⁴¹ Rexhepagiq, Jashar “Arsimi ne Mitrovice”, Gazeta e perditeshme “Rilindja”, Prishtine, 1976, fq. 16.

⁴² Blendi Fevziu,Historia e shtypit shqiptarë 1848-2005,Tiranë 2005,fq 42

Lëndët që ishin mësuar në shkollën e Koshtovës ishin:Gjuhë shqipe,matematikë,histori,gjeografi,këndim,xhimmastik e lëndë të tjera Dihej se Kontribut në hapjen e shkollës shqipe në Koshtovë të Bobit kishte dhënë edhe patrioti Hasan Prishtina. Gjatë periudhës së sundimit austro-hungarez (1915-1918) këtu janë hapur disa shkolla, ku përpos Rexhep Remzi Efendiut, janë shquar edhe Hajrë Haxhija, Jusuf Rexha, Shaban Idrizi etj.⁴³ Rol rëndësishem në hapjen e shkollave shqipe ka luajtur organizata arsimore e kulturore “Bashkimi” i cili ishte formuar nga ideologu Hasan Prishtina e Nexhip Draga ne vitin 1915⁴⁴ Këto shkolla kanë luajtur rol të madh në arsimin e të rinjëve shqiptare në Mitrovicë me rrethinë.⁴⁵



Lokali ku u mbajt për herë të parë mësimi shqip në Koshtovë të Bobit prej vitit 1915-1918.

Mirëpo këto shkolla nuk patën jetë të gjatë sepse pas ripushtimit të Kosovës nga mberteria SKS, të gjitha shkollat ekzistuese në gjuhën shqipe u mbyllën.⁴⁶

Disa nga nxënësit e kësaj shkolle kanë qenë Isa Mehmeti, Osman Miftari, Mehmet Grepri, Ramë Hajredini, Selim Jashari etj, kishte edhe nxënës nga fshatrat për rreth. Pas përfundimit të luftës së pare botërore dhe ripushtimit të Kosovës nga Jugosllavia shkolla shqipe e Koshtovës mbyllet. Jugosllavët e sidomos sërëbët ishin të interesuar për asimilimin e shqiptarëve dhe

⁴³ https://sq.ëikipedia.org/ëiki/Historia_e_Mitrovic%C3%ABs

⁴⁴ Hajrizi, Fazli, “Mitrovica dhe Shala e Bajgores në fokusin e historisë”, Prishtinë, 2011, fq. 280

⁴⁵ Hajrizi, Fazli, Revista “Shkendija”, Prishtinë, 1998

⁴⁶ Miftari, Imer, “ Vllahija ne rrjedhat e historisë”, Mitrovicë, 2008, fq. 64

vendosin që shkolla shqipe Koshtovës të shëndrohej në shkollë ku do të mësohej gjuha dhe kultura serbe edhe pse në fshat nuk kishte asnjë sërë .Me një veprim të tillë Jugosllavia godiste jo vetëm mësimin e gjuhës shqipe por edhe besimin fetar sepse i largon besimtarët nga gjamia duke i detyruar që lutjet fetare ti bënin nëpër oda dhe në qytetin e Mitrovicës.Në vitin 1927 fëmijët e fshatit ishin të obliguar që të shkonin të mësonin gjuhën sërë dihet .Jugosllavia vendosë që mësues në Koshtovë të shkonte rusi Jonxji me të shoqën Sofinë duke iu mundësuar që të banonin në Koshtovë së bashku me fëmijët Brankun, Tallken dhe Marien. Nuk dihet pse sërëbët nuk e dërgojn një mësues sërëb por e dërgojn mësuesin rus.Nga presioni i fshatarëve Serbia e atëhershme e lejon që të kryheshin disa ritual fetare në mejtepe . Imami i atëhershëm mulla Meti duke parë situatën në të cilën ishin shqiptarët përveq ritualeve fetare përpiqej edhe të mësonte gjuhën shqipe në kuadër të ritualeve fetare.

Me fillimin e luftës së dytë botërore, Koshtova i përkiste zonës së sundimit gjerman shkolla e Koshtovës rihapet si shkollë ku mësimi zhvillohej në gjuhën shqipë, shkollës i vihet emri Nexhip Draga. Shkolla e Koshtovës së Bobit do të përdoret edhe për qëllime fetare, politike dhe ushtarake gjatë luftës së dytë dhe pas përfundimit të luftës së dytë botërore. Pas përfundimit të luftës së dytë botërore shkolla e Koshtovës vazhdon të funksionoi si shkollë fillore ku mësimi zhvillohej në gjuhën shqipe por shërbente edhe për rituale fetare të besimit islam. Në mejtepin e Koshtovës u organizuan veprime anti shqiptare në kohën kur udhëheqës i ministrisë së punëve të brendëshme të Jugosllavisë ishte Aleksandër Rankoviqi. Kjo i detyronte besimtarët islam të Koshtovës ti falnin taravitë dhe xhumanë nëpër oda në fshat,falja e taravive bëhej me radhë nëpër oda si psh në odën Dulit,Salihit Ujkanit,Fazlisë, Isufit etj.

Situata do të ndryshoi vetëm me ndërtimin e shkollës fillore në Koshtovë në vitin 1962. Shkolla e Koshtovës do ta marrë primatin e gjamisë ku do të këryhen ritet e rregulta fetare pas ndërtimit të shkollës së re fillore në Koshtovë,me elektrifikimin e fshatit gjamisë do ti vihet shtylla e cila do ta luaj rolin e minares prej nga mund të shihej nga të gjitha fshatrat për rreth kur ishte ramazani apo ndonjëra nga netët e mëdha.



Foto 2. Shtylla e cila luante rolin e minares së xhamisë së Koshtovës,tash shfrytëzohet për antena të internet

Në mejtepin e Koshtovës i shërbyen shumë hoxhollarë si mulla Meti i cili ishte nga Koshtova,mulla Alia, mulla Sadiku prej Vërrnice, mulla Hajra prej Vaganice dhe Hajzer Ahmeti nga Koshtova.

Pas suprimimit të autonomisë së Kosovës nga Serbia, gjendja e popullësisë shqiptare në Kosovë ishte keqësuar ,gjendja keqësohet edhe në Koshtovë sepse Serbia i dëbon nga puna shqiptarët, shoqata Nëna Tereze e shfrytëzon xhaminë e Koshtovës për të shpërndarë ndihma humanitare, në xhami u mbajtën edhe shumë takime me karakter politik. Me keqësimin e gjendjes në Kosovë xhamia shërbeu edhe si vend ku Koshtova bënte organizime ushtarake në mbrojtje të vetëvehtes.

Në objektin e mejtepit-xhamisë së Koshtovës janë bërë aktivitete të ndryshme arsimore, fetare, politike, ushtarake, humanitare etj. Në këtë lokal dhanë kontribut shumë atëdhetarë si dhe përcjelli dy perandori: P.Osmane, P.Austrohungareze mbretinë jugosllave, nazizmin gjerman jugosllavin socialiste, dhe në shtetin e ri të Kosovës nuk është në listën e monumenteve të mbrojtura.



Foto 3. Gjendja në brendësinë e mejtepit-xhamisë së vjetër të Koshtovës

KONKLUZION

Duke marrë parasysh se arsimiti është një nga segmentet më të rëndësishme të shoqërisë, dhe një kategori kombëtare me karakter universal na del të kuptojmë se shkollat shqipe kanë zënë fill në fillim të shekullit të XX.

Deri atëherë kanë ekzistuar disa shkolla të uleta në gjuhën turke, ku i ndiqnin mësimet edhe të rinjtë shqiptar.

Kërkesat e popullatës shqiptare të këtij mjedisi për tu hapur shkollat edhe në gjuhën shqipe ishin të mëdha. Mësuesi i parë në këtë mejtep Jusuf Rexha, ka luajtur një rol të pazëvendësueshëm, për arsimimin e brezave me radhë.

Pas përfundimit të luftës së parë botërore dhe ripushtimit nga mbretëria SKS, kjo mbretëri i mbylli të gjitha shkollat në Kosovë, e me këtë edhe atë në Koshtovë të Bobit.

Të gjithë ata që merreshin, ose dispononin ndonjë libër shqip ndiqeshin dhe burgoseshin pameshirë. Kjo gjendje vazhdoi deri me fillimin e luftës së dytë botërore.

Duke marrë parasysh se ky mejtep është ndër më të vjetrit në komunën e Mitrovicës dhe më gjerë kjo vatrë edukative arsimore ka luajtur një rol shumë të madh në emancipimin arsimor dhe kulturor të popullatës së këtij mjedisi. Në fund mund të themi, historia e kronologjise se kësaj vatre arsimore është e madhe dhe e një rëndësie të veçantë.

Referenca:

1. Hajrizi, Fazli, “ Mitrovica dhe Shala e Bajgore në fokusin e historisë”, Prishtinë, 2011;
2. Hajrizi, Fazli, Revista “Shkendija”, Prishtinë, 1998;
3. Haziri, Mustafë, “ Monografi për mësuesin Shaban Idrizi”, Mitrovicë, 2012;
4. Miftari, Imer, “ Vllahija në rrjedhat e historisë” Mitrovicë, 2008;
5. Rexhepagiq, Jashar, “ Arsimiti në Mitrovicë”, Rilindja, Prishtinë, 1976;
6. https://sq.ëikipedia.org/ëiki/Historia_e_Mitrovic%C3%ABs;
7. Intervista me Behram FEKA;
8. Historiku i Shkolles fillore “Jusuf Rexha;
9. Blendi fevziu, Historia e shtypit shqiptar 1848-2005, Tiranë 2005;
10. Elena Kocaqi Levanti, Si e krijoi Austro-Hungaria Shtetin Shqiptar, Tiranë 2012.

FORMIMI I MENAXHERËVE TË ARSIMIT**PhD can. Nexhmedin BARDHI**

Prof. Kolegji "Humanistica" Ferizaj

PhD kandidat - Universiteti Ndërkombëtar në Strugë

e-mail: nexhbardhi@hotmail.com, tel +377 44 142 110**ABSTRAKT**

Lëvizjet e rëndësishme të bëra në kontekstin strategjik shoqërohen edhe me sfida në rrugëtimin e formësimit të menaxherëve të shkollave ku secili duhet të jap kontributin e tij duke ofruar shërbimet cilësore në institucionin që e drejton si dhe zbatimit të praktikave profesionale.

Nevojat për formimin e menaxherëve të arsimit rezultojnë të jetë e menjëhershme marrë si referencë rezultatet në të gjitha nivelet e arsimit. Për të menaxhuar një institucion arsimor, janë të mishëruara të gjitha situatat profesionale që menaxheri do të përballet me to. Në të vërtetë aty i hasim aftësitë e strukturuar që menaxheri duhet të ketë në realizimin e menaxhimit të suksesshëm të institucionit arsimor. Duke e patur parasysh që ballafaqimi me gjendje të ndryshme e të komplikuar gjatë punës na imponohen situata të papritura, menaxhimi kërkon aftësitë intelektuale të nivelit të lartë nga ana e menaxherëve.

Në këtë studim paraqesim rezultatet bazuar në literaturën e trajtuar, lidhur me nevojat për formimin e menaxherëve të shkollave, rezultateve të studimit bazuar në pesë shkollat e komunës së Vitisë duke nxjerrë konkluzionet konform gjendjes.

Menaxherët duhet të jenë të aftë që të gjitha obligimet që dalin në realizimin e projektit të vënë drejt realizimit në përputhje me orientimet e institucionit. Duhet të kenë qëllimet e qarta dhe së bashku me akterët e tjerë të arrijnë realizimin e planit të suksesit në arsim.

Fjalët kyçe: *Menaxhim, Institucion Arsimor, Liderhip, vlerësim performancë.*

HYRJE

Performanca e Menaxherëve të shkollave, niveli i përgatitjes së tyre për ushtrimin e funksionit të menaxherit sfidat dhe vështërsitë që hasin ata në kryerjen e detyrave të tyre, dhe nevoja për formimin e menaxherëve të shkollave të cilët do ishin bartësit kryesor, të vënies në binarë të arsimimit dhe edukimit bazuar edhe nga përvojat pozitive të vendeve progresive. Por kjo performance duhet shoqëruar me një vizion të tyre drejt strukturimit të një institucioni arsimor të fokusuar në nevojat edukative të nxënësve.

Format e para, të paorganizuara, të menaxhimit hasen shumë herët, qysh në Kinën e lashtë kur bëhej mbikëqyrja e ndërtimit të Murit Kinez. Ndërsa, format e para të shkrimeve për menaxhimin i hasim në shekullin XVIII, në kohën e Revolucionit Industrial në Angli. Kështu, të gjitha organizatat e mëdha apo të vogla, private apo publike, profitabile apo joprofitabile, dhe pavarësisht nga veprimtaria e tyre, kanë nevojë për t'u menaxhuar. Duke qenë një proces mjaft i ndërlikuar dhe i cili është i pranishëm pothuaj në çdo situatë të jetës sonë, po ashtu edhe përkufizimi i termit menaxhim është mjaft i vështirë dhe i ndryshëm, varësisht nga autorë të ndryshëm dhe nga situata të ndryshme.

Sipas Presidentit të Shoqatës Amerikane të Menaxhmentit (1980): “Menaxhimi është bërja e gjërave me dhe nëpërmjet njerëzve tjerë”.

Ndërsa, sipas Uren & Voic: “Menaxhimi është proces i bashkërendimit, sigurimit, shpërndarjes (renditjes) dhe shfrytëzimit të potencialeve të burimeve njerëzore dhe potencialeve të tjera në organizatë, me qëllim të arritjes së objektivave të caktuara”.

Në të dy definicionet mund të vërehen tri karakteristika, në të cilat duhet të vendoset theksi:

- Theksi kryesor është arritja e rezultateve apo objektivave të institucionit;
- Përqendrimi tjetër është roli i burimeve njerëzore në institucionin arsimor;
- Përbushja e objektivave personale së bashku me ato të institucionit është një përqendrim tjetër në teorinë e menaxhimit të një institucioni.

Një profesionist definon identitetin e tij në lidhje me një fushë të ekspertizës e njohur nga shoqëria dhe që ka aftësitë për ta arritur. Për këtë qëllim identiteti profesional është ndërtuar në veprim dhe është pjesë e një lëvizje që manifestohet. Kur përdor në mynyrë efektive burimet e brendshme dhe ato të mjedisit, bazuar në diversitetin e situatave që hasim, demonstron

kompetencën ku edhe arrinë rezultatet e synuara në ushtrimin e profesionit dhe organizimin e saj kjo bënë të njihet si kompetent.

THEMELIMI I NJË PROFESIONI

Ballafaqimi me komplicitetin dhe një pasigurie, në lëvizjet dhe strukturimet duke pasur parasysh shumëllojshmërinë dhe diversitetin a pjesmarrësve të cilët bashkëveprojnë krijuan një lëvizje të profesionalizimit e cila vien në pah përmes një përgjegjësie të përbashkët.

Themelimi i një profesioni sipas Pelletier⁴⁷ bazohet në ekzistencën e katër elementeve themelore si në vijim:

1. Prania e aktiviteteve komplekse të njohura, ku si të tilla për të arritur realizimin e tyre kërkohen aftësi të larta.
2. Njohja e një statusi të veçantë e dallon këtë profesion nga tjerët, apo të përafërtë, si psh. rastin e mësimit dhe menaxhimit të arsimit.
3. Ekzistimi i ekipit me përgatitje shkencore evlutive dhe pragmatike, që mundëson njohjen e praktikave të konsideruara më të mira dhe ti kodifikojnë për qëllime komunikimi.
4. Ekzistenca e praktikave të socializimit dhe të trajnimit, u mundësojnë njerëzve që gjatë ushtrimit të profesionit të tyre, ti përvetësojnë dhe të jenë në gjendje ti zbatojnë, duke krijuar ndërtimin evlutiv të identitetit personal.

Ashtu si Pelletier dhe Brassard,⁴⁸ nga qëndrimi i adaptuar këtu, del se koncepti i themelimit dhe profesionalizimit të menaxherëve të institucioneve shkollore mbulon disa realitete. Nuk ka asnjë dyshim që ky profesion ka një shumëllojshmëri të aktiviteteve komplekse, menaxhimin e situatave profesionale i cili duhet të shoqërohet me një veprim autonom duke u bazuar në gjykimin profesional e etikë të menaxherit.

⁴⁷ Pelletier, G. "La professionnalisation de la gestion scolaire : défis, enjeux et pistes d'action", *La revue des Échanges*, vol. 23, no 3, p. 9-15. La Formation a la Gestion d'un etablissement d'enseignement, Quebec, 2008, p.21.

⁴⁸ Brassard, A. (2004 b). « La professionnalisation de la fonction de direction d'un établissement d'enseignement et le développement du champ d'études de l'administration de l'éducation », *la revue Éducation et francophonie*. vol. XXXII, no 2; Pelletier, G. (2006). « La professionnalisation de la gestion scolaire : défis, enjeux et pistes d'action », *La revue des Échanges*, vol. 23, no 3, p. 9-15. La Formation a la Gestion d'un etablissement d'enseignement, Quebec, 2008, p.21.

Profesionalizimi bazohet në dy principe logjike. I pari i referohet profesionalizimit duke përdorur racionalizimin e njohurive, për të ndërtuar aftësitë e nevojshme në ushtrimin e punës profesionale. Principi i dytë logjik është i lidhur me profesionalizimin, mbron interesat, vlerat si dhe statusin e një profesioni në shoqëri.⁴⁹ Edhe pse dukshëm manifestohen të dy logjikat (qasjet) janë plotësuese dhe duhet kombinuar me realitetin intern (marrjen dhe zotërimin e e shkathtësive profesionale), dhe të jashtme (njohja sociale) të profesionalizimit. Nga njëra anë kërkimin e një identiteti vetëbesues profesional, si individual dhe kolektiv që konfirmohet nga rëndësia që i jepet një kompetence për të gjitha grupet e interesuara për trajnim të detyrueshëm në drejtim të institucionit.

Njohuritë e fituara bazuar në praktikën e ndjekura mund të përkrahin fitimin e njohurive në fushën e menaxhimit në arsim, administratën e shkollës në formë evolutive (zhvillim). Një profesionist definon identitetin e tij në lidhje me një fushë të ekspertizës e njohur nga shoqëria dhe që ka aftësitë për ta arritur. Për këtë qëllim identiteti profesional është ndërtuar në veprim dhe është pjesë e një lëvizje që manifestohet. Kur përdor në mynyrë efektive burimet e brendshme dhe ato të mjedisit, bazuar në diversitetin e situatave që hasim, demonstron kompetencën ku edhe arrijnë rezultatet e synuara në ushtrimin e profesionit dhe organizimin e saj kjo bënë të njihet si kompetent.⁵⁰

Në fakt, vetëm drejtuesit e institucioneve dhe ata të cilët aspirojnë mund të vendosin të bëhen profesionist, ku për ta bërë këtë, ata duhet domosdoshmërisht të angazhohen në procesin e fitimit dhe zhvillimit të aftësive të njohura shoqërore, posedimin e mundësive për të evoluar në hapsirat e parapara për profesionalizim, duke pasur parasysh që personeli mësimdhënës paraqet potencialin bazë, për tu zgjedhur menaxher i institucioneve arsimore, atëherë profesionalizimi i menaxherit do ishte i mirëfilltë duke valorizuar personelin mësimdhënës në shkollë. Është shumë e evidente se një menaxher duhet gjithmonë të ketë parasysh se me vlerësim të punës së personelit kuptojmë, zbatimin e një sërë procedurash sistematike të cilat kanë për qëllim, të

⁴⁹ Uwamariya, A., Mukamurera, J. (2005). « Le concept de « développement professionnel » en enseignement : approches », *Revue des Sciences de l'éducation*, vol. XXXI, no 1, p.133-155. La Formation a la Gestion d'un établissement d'enseignement, Québec, 2008, p.22.

⁵⁰ La Formation a la Gestion d'un établissement d'enseignement, Québec, 2008, p.23.

gjykojnë lidhur me meritat dhe kualifikimet e punonjësve të një institucioni.⁵¹ Vlerësimi i personelit është një komponent shumë e rëndësishme si në planin ekonomik, planin organizativ, vlerësimi paraqetë një domosdoshmëri nga pikpamja njerëzore, vlerësimi i personelit është i lidhur edhe me një seri të ndryshme si: planifikimi i efektivave, analiza e punës, vlerësimi i punëve, shpërblimi, rekrutimi dhe seleksionimi, formimi dhe drejtimi i karrierës.⁵²

PROFESIONALIZMI I MENAXHERËVE TË SHKOLLAVE –NJË PËRGJEGJËSI E PËRBASHKËT

Procesi i profesionalizimit, përfshinë në radhë të parë menaxherët e rinj, të cilët duhet të jenë të vetëdijshëm për burimet e tyre personale të cilat duhet ti përdorë në mjedisin e tij, duke u mobilizuar në kombinim edhe me praktikën profesionale. Një komponent kyç i këtij procesi është përvetësimi i njohurive dhe aftësive të domosdoshme për të arritur me sukses ushtrimin e profesionit. Për më tepër zhvillimi i kompetencës profesionale nuk llogaritet asnjëherë si i përfunduar plotësisht, por procesi vazhdon vazhdimisht rrugëtimin e tij, e jo vetëm gjatë kohës së trajnimit të detyrueshëm.⁵³

Sistemi i integruar i menaxhimit bazuar në një vision- Menaxhimi i integruar në një institucion bazohet në veçanti në aftësinë e menaxherit, për të vëzhguar dhe kontrolluar të gjitha situatat, proceset. Me një fjalë menaxhimi i integruar rrjedh nga një vizion sistematik i strukturës organizative, i cili përfshinë edhe marrdhëniet në mes të nënsistemeve të ndryshme të menaxhimit. Kjo pikëpamje lejon menaxherin ose institucionin që nga një menaxhim pak nga pak të hyjë në një regjim më të unifikuar efikas dhe të suksesshmëm të menaxhimit. Bashkëpunimi në mes të nënsistemeve të ndryshme në institucionin shkollor, do jenë pjesë e implimentimit të projektit të institucionit, i cili është edhe baza kryesore e realizimit të projektit ku si i tillë përbënë boshtin kryesor rreth të cilit ndërtohet struktura organizative të institucionit. Në këtë drejtim, është shumë e rëndësishme që nga ana e menaxhmentit dhe stafit, të krijohet një

⁵¹ Ahmet Ceni, Menaxhimi i Burimeve Njerëzore, cikël leksionesh, Kolegji i Menaxhmentit Inernacional "Globus", p.132.

⁵² Po aty.p.133.

⁵³ La Formation a la Gestion d'un etablissement d'enseignement, Quebec, 2008, p.23.

vizion global e sistematik ku do prodhonte një konsistencë mes synimeve, veprimeve dhe rezultateve.⁵⁴

Projekti i institucionit përfshin investimin e të gjitha palëve si punonjësve, partnerëve të involvuar në suksesin në arsim, ku qëllimi parësor është sukcesi i numrit sa më të madh të studentëve. Duke u bazuar në nevojat e veçanta arsimore të studentëve që ndjekin studimet në institucion , krijimi i projektit është elementi kryesor i strukturimit e organizimit shkollor, organizimi i punës si dhe alokimi i burimeve. Kjo dikton edhe prioritetet. I udhëheqë dhe arsyeton zgjedhjen e qasjes pedagogjike si dhe paralelisht me të edhe trajnimin e të gjitha kategorive të personelit., duke ngritur bashkëpunimin dhe afirmuar rëndësinë e partnerëve.

Përveç kësaj projekti i institucionit arsimor mundë të jetë një mundësi tjetër për ndryshim duke u ofruar akterëve suksesin arsimor, të punësuarëve dhe partnerëve të institucionit mundësinë për të ndërtuar s'bashku ndjenjën e bashkëpunimit të tyre individual, por duke ndarë një vision për rezultatet e pritura, me të vetmin qëllim që krahas tyre në mynyrë evlutive, zhvillimin e gjithë sistemit organizativ të institucionit. Kështu, nga rezultatet a arritura bazuara nga synimet e projektit të institucionit na dalin në pah edhe strategjitë më të përshtatshme të menaxhimit.

Formimi i mbështetur tek përqasja e kompetencës- Korniza e Kompetencës është projektuar për trajnimin e stafit i cili do të bëjë menaxhimin e institucioneve shkollore si dhe qendrave të ndryshme të aftësimin profesional si dhe edukimi për të rritur. Korniza kompetencës synon drejtimin dhe orientimin teorik si dhe praktikën e programeve të detyrueshme të trajnimit për këta njerëz, ajo gjithashtu synon të mbështesë të gjitha format me synim profesionalizimin e tyre duke u mbështetur në kërkesat ku si qëllim kanë ushtrimin e profesionit. Si mbështetja dhe udhëzimet janë të pandashme nga trajnimi dhe kanë për bazë kornizën e kompetencës.⁵⁵

Në funksion të përgatitjes të menaxherëve të institucioneve duhet adoptuar një qasje si në vijim:

- Merr pjesë në zhvillimin dhe adoptimin e sjelljeve bazuar në situatën konkrete,
- Bënë pjesë në përcaktimin e perspektivës së profesionalizimit të administratorëve të shkollave si dhe qasjes për një menaxhim të integruar të funksionit,

⁵⁴ Po aty, p.24.

⁵⁵ Po aty, p.27.

- Zbaton në praktikë të gjitha qështjet me interes duke u bazuar ne situatat e paraqitura.

Paraqet në mynyrë eksplicite lidhmërinë në mes të aftësive dinamike në mes të kompetencës dhe situatës profesionale llojet e profesionit dhe rezultateve të pritura.

REKRUTIMI I PERSONELIT

Një çështje shumë me rëndësi është forma e rekrutimit dhe përzgjedhjes së kandidatëve, ku para së gjithash një institucion arsimor identifikon nevojat e saj për burime njerëzore nëpërmjet planifikimit të punësimit, ajo fillon procesin e rekrutimit të kandidatëve potencial për vende të lira pune aktuale dhe mëvonshme.⁵⁶ Një çështje shumë me rëndësi padyshim është se si është konceptohet procesi i rekrutimit, pastaj planifikimi i nevojave si dhe objektivat.⁵⁷ Tek fokusi i rekrutimit duhet të kemi parasysh, aftësitë aktuale apo potenciali i ardhshëm, balancimi i vlerave konkurruese si kohë + cilësi konkurruese, si dhe ku duhet të vëhet theksi në procesin e rekrutimit p.sh. Në njohuritë, aftësitë, zotësit, motivimin, diversitetin dhe përfaqësimin e grupeve të mbrojtura, besnikërin.⁵⁸ Në procedurën e aplikimit institucioni ka përgjegjësinë ndaj aplikantit që rekrutimi të jetë i hapur apo i mbyllur, jo procese të shtira, jo informacione në fazën fillestare.⁵⁹

Komponent tjetër shumë e rëndësishme e rekrutimit është se: A është procedura e rekrutimit e konceptuar mirë, a janë përdorur drejtë strategjitë për personat e interesuar? A nxit procesi kandidatët më të mirë për të aplikuar? A ndihen mirë aplikantët rreth procedurave të aplikimit?⁶⁰ Një komponent shumë e rëndësishme gjatë përzgjedhjes së kandidatit është interesi për punën sa është ai i motivuar për vendin që konkuron, a mundë të jenë element ineteresi për të, realizimi, sfida profesionale, përgjegjësia, njohja, avancimi. Poashtu duhet patur parasysh edhe personalitetin e aplikantit se a mund të konceptohet me postin e kërkuar, cili personalitet i përshtatet punës së kërkuar, ku disa nga aspektet e personalitetit mund të jenë: Lider,anëtar grupi, influencues, stil interpersonal, vetëbesimi, menaxhimi i konfliktit, afrimi me nxënësit dhe vartësit.

⁵⁶ Ahmet, Ceni, Koncepte të ligjëratave”Globus”, Kapitulli 5, Rekrutimi, p.3.

⁵⁷ Po aty. P.11.

⁵⁸ Po aty p.12.

⁵⁹ Po aty.p.12.

⁶⁰ Po aty. P.13.

Karakteristikat e kompetencës- Duke marrë me shqetësim se duhet patur parasysh që drejtimet e duhura të trajnimit në institucion kanë për qëllim “trajnimin” e kandidatëve, ku ata të jenë në gjendje të zbatojnë praktikat profesionale të adaptuara për tu rezistuar sfidave gjatë ushtrimit të funksionit të tyre.

Duhet pasur parasysh që mobilizimi në situata komplekse duhet shoqëruar edhe me një vullnet dhe përkushtshmëri në zgjidhjen e problemit.

Një menaxher i shkollës duhet të jetë i përgatitur jo vetëm të zgjidhë problemet por edhe të mobilizojë burimet (njohuritë, aftësitë, qëndrimet, proceset njohëse) por njashtu duhet të dijë edhe si ti organizojë ato. Duhet të kombinojë elementet e ndryshme të cilat do mundësonin në situata të veçanta të përfshinin edhe kërkesat specifike.

Këto karakteristika mobilizimi dhe kombinimi i burimeve të brendshme dhe të jashtme kontribuojnë për një aftësi e cila korrespondon me një zotësi për të vepruar me kompetencë e përgjegjësi.

Njohuritë që do na mundësonin të zhvillohemi gjatë gjithë jetës profesionale, përvojat të cilat na mundësojnë në një zhvillim të kompetencave, janë shumë dhe zhvillohen në mynyrë graduale. Nga perspektiva e profesionalizimit zhvillimi i aftësive rritet në mynyrë progressive me një nivel të zotërimit ku kjo vazhdon gjatë gjithë jetës profesionale.

Njohuritë e nevojshme për të vepruar në situata të veçanta, me theks na paraqiten situatat profesionale të dizajnuara ku për bazë kanë dy shkaqe kryesore veprimi. Situata e vendit të punës që menaxhojmë si dhe rezultatet e synuara. Konteksti i udhëheqjes, përzgjedhjes dhe organizimit të burimeve të mobilizuara. Natyra kontekstuale dhe aftësia për të vepruar është vendimtare për shkak se ajo lejon futjen dhe mbështetjen e veçantë për të arritur një rezultat të parashikuar.

Kjo perspektivë është thelbësore në trajnimin e detyrueshëm dhe të vazhdueshëm, por duhet patur parasysh se përkundër përgatitjes profesionale është e pamundur të pasqyrojmë të gjitha situatat profesionale ku duhet të ballafaqohemi.

Një dimension reflektiv – Një person nuk mund të njihet kompetent nëse nuk është në gjendje të ketë sukses, por edhe të kuptojë se si duhet të veprojë. Të jesh kompetent don të thotë

të jesh në gjendje të bësh apo të reagosh, por edhe të analizosh, shpjegosh mënyrat se si duhet reaguar. Dimensioni reflektiv lejon zhvillimin që vetë- rregullon veprimet e tij por edhe të kërkojë burimetjera që do jenë në gjendje të bartin, e kjo është ri-investim në kontekste të ndryshme.⁶¹

Struktura dhe organizimi i brendshëm i kompetencës- Kompetenca është aftësia për të reaguar në një situatë që shfaqet në aspektin e punës profesionale, veprimet e bëra në drejtim të organizimit me synim arritjen e rezultateve të pritura. Aftësitëe menaxherit bëjnë të arrijë të strukturojë dhe menaxhojë tërë veprimtarinë me një kompetencë.

Përgatitjet e menaxherëve në menaxhimin edhe zbatimin e projektit në një institucion arsimor. Projekti i shkollës duhet të jetë fokusi kryesor për realizim në një institucion, menaxherët duhet të jenë të aftë që të gjitha obligimet që dalin në realizimin e projektit ti vënë drejt realizimit në përputhje me orientimet e institucionit. Duhet të ketë qëllimet e qarta dhe së bashku me akterët e tjerë të arrijnë realizimin e planit të suksesit në arsim. Për të realizuar me sukses planin e suksesit janë të kyçura në implimentim strukturat vendimmarrëse, kontributi individual i anëtarëve të grupit, stafi i shkollës, shpërndarja dhe alokimi i burimeve financiare dhe materiale. Padyshim menaxheri duhet të demostrojë aftësitë e kërkuara për të ndjekur zbatimin e politikave të institucionit. Kompetencat e ushtruara gjatë punës në një institucion e kanë qëllimin e arritjes së rezultatit të synuar.

Mirëpo për tu ushtruar një kompetencë e tillë duhet të plotësojmë një varg kushtesh si: njohuritë, veprimet, aftësitë, proceset njohëse. Përkundër këtyre kushteve të cekura për të arritur që me kompetencë dhe efektivitet rezultatin e synuar duhet përditësuar dhe aplikuar këto kushte varësisht nga situata e paraqitur. Për të menaxhuar një institucion arsimor janë përcaktuar dhjetë kompetenca. Për të menaxhuar një institucion arsimor, janë të mishëruara të gjitha situatat profesionale që menaxheri do të përballlet me to. Në të vërtetë aty i hasim aftësitë e strukturuara që menaxheri duhet ti ketë në realizimin e menaxhimit të suksesshmëm të institucionit arsimor.

Harmonizimi në përputhje me kompetencat sjellë edhe vendimet për secilën gjendje profesionale ku me rigozitet dhe efektivitet manifeston kompetencat e përgjithshme të menaxhimit. Këto kapacitete janë të nderlidhura me:

⁶¹ La Formation a la Gestion d'un etablissement d'enseignement, Quebec, 2008, p.20.

Metodën&Qasjen - Duke e patur parasysh që ballafaqimi me gjendje të ndryshme e të komplikuara gjatë punës na imponohen situata të papritura, menaxhimi kërkon aftësitë intelektuale të nivelit të lartë nga ana e menaxherëve. Administratorët e shkollave duhet të kenë qasje solide në njohuritë e tyre për tu përballur me me të gjitha situatat gjatë punës.

Udhëheqja - e institucionit arsimor gjatë punës së përditshme, duhet të krijojë lidhjet mes elementeve të ndryshme në kuadër të strukture shkollore (ligjet, programet e trajnimit, rregullorën e shkollës,, politikat arsimore, projektet e shkollës, planin e suksesit dhe përgjegjëshmërinë) dhe të ketë një vazhdimësi në mes të aktiviteteve si dhe planeve për të arritur suksesin e nxënësve si dhe të mbështet kohezionin e ekipeve lidhur me realizimin e projektit. Duhet pasur parasysh që gjendja e institucionit arsimor duhet të përcillet në vazhdimësi për të arritur identifikimin e faktorëve për arritjet e nxënësve, duhet patur shumë kujdes që me saktësi të vazhdohet drejt realizimit të prioriteteve të institucionit. Duhet shtuar edhe këtë që sipas nevojës të intervenojme në etapat e zhvillimit të punës dhe të identifikojmë problemin, të analizojmë situatën, eksplorimin e masave të përshtatshme në mënyrë efektive udhëzuese, zbatimin dhe vlerësimin e planeve të veprimit.

Komunikimi –Është themeli kryesor në biznes, pa komunikim efektiv asgjë e përbashkët nuk ndërtohet. Varësisht nga rrethanat dhe veprimeve individuale e kolektive rrezikojmë të kemi marrdhënje jo të mira dhe kundërshtuese, kështu komunikimi është mjeti thelbësor për të mobilizuar aktet e arsimit rreth zgjedhjes së objektivave dhe rezultateve të synuara duke ndërtuar një kuptim të përbashkët, një gjuhë të përbashkët, një vizion të përbashkët, të bëjë të kuptojë dhe të mundësoj pranimin e planit të institucionit, të bëjë evaluimin e praktikave arsimore dhe kolektive.

Lideri &Orientimi i Politikave - Udhëheqësit e shkollave ushtrojnë lidhshpinin e tyre, ku duhet të jenë në gjendje mobilizojnë anëtarët e ekipit të shkollës rreth një projekti të përbashkët.

Projekti i përbashkët inkurajon të gjithë, të marrin pjesë në kryerjen dhe zbatimin e tij, si dhe të marrë pjesë në trajnim ku do rritej performanca e tij në drejtim të arritjes së rezultateve në kuadër të ekipit. Përveç kësaj ata e drejtojnë procesin e vendimmarrjes duke u fokusuar në suksesin e studentëve. Ata poashtu kujdesen rreth zhvillimit të potencialit dhe cilësisë tek anëtarët e ekipës si dhe marrdhënjet mes tyre, për të arritur këtë duhet të demostrojnë, risi, kreativitet, adaptim dhe më shumë vëmendje në zhvillimin e tyre profesional për të ruajtur

ekuilibrin e stafit. Një udhëheqje me mirëkuptim e institucionit ka për qëllim udhëheqjen e politikave për të zbuluar rrjetet sociale dhe të arrijë marrdhënje kyçe. Menaxheri bënë organizimin e punës, vë rregullat e punës në institucion. Një udhëheqje e institucionit në aspektin e politikave duhet të ketë informimin e duhur për gjendjen e institucionit dhe të mbështetë qëllimet dhe një strategji të përshtatshme.

Bashkëpunimi&Bashkëveprimi - Me qëllim që aktivitetet e shkollës të jenë më të dobishme dhe me bashkëpunim të frytshëm, menaxheri i institucionit vendos krijimin dhe mirëmbajtjen e strukturës së punës me kushte të favorshme bashkëpunimi. Llojet e bashkëpunimit brenda institucionit arsimor janë shumëdimensionale, që ndryshojnë në formë, përbërjen e infrastrukturës dhe kohëzgjatjen. Megjithatë, pa marrë parasysh llojin e tyre, bashkëpunimeve të synojnë kryesisht dy objektiva plotësuese: lehtësimin e tregtisë dhe ndërveprime që mund të pasurojnë praktikën profesionale, të stimuloj evolucionin kulturor të institucionit dhe në këtë mënyrë të arrijë sukses tek studentët. Udhëheqja e një institucioni supozon dy funksione të ndara në aspektin e bashkëpunimit. Funksioni i parë është për të pilotuar situatat bashkëpunuese, në këtë drejtim udhëheqësi kujdeset që akterët të kenë kujdes në detyrat që ju kanë besuar atyre, poashtu siguron që kushtet për funksionimin e tyre janë përmbushur. Funksioni i dytë – kryhet kur menaxhimi është vetë i përfshirë në rrjetet e bashkëpunimit që mund të kenë objektiva të ndryshme: për të krijuar një forcë të madhe politike që mund të kenë individët e izoluar, të bëjë një kontribut të rëndësishëm në përparimin e organizatës- shkollës, të marrë pjesë në shkëmbimet e favorshme për evolucionin e vet dhe pasurim profesional.

Vlerësimi & Rregullimi – i praktikës së vetë profesionale janë procese të pandashme e procesit të profesionalizimit. Shumë udhëheqës të shkollave përfshijnë aspektet praktike të vlerësimit si dhe rregullimin e shkëmbimit të praktikës së tyre profesionale. Megjithatë përdorimi sistematik dhe rigoroz në vlerësim favorizon arsimin efektiv dhe të vazhdueshëm duke rritur rëndësinë e praktikave profesionale duke vendosur mekanizma dhe analiza të monitorimit që mundësojnë të mirren masa në zvoglimin e ndryshimit midis rezultateve të arritura dhe atyre të synuara.

Etika – Menaxheri i shkollës vepron me integritet, drejtësi dhe moral të lartë, kupton dhe ka njohuri për: qëllimin e arsimit dhe rolin e udhëheqjes në shoqërinë modern, parimet dhe

praktiken e gjithpërfshirjes brenda shkollës dhe komunitetit të shkollës, korniza të ndryshme etike dhe perspektivën etike, vlerat e shkollës – komunitetit divers, kodet e etikes profesionale. Gjithmonë duke patur parasysh se mësimdhënia përkufizohet si akt i të dhënit mësim në një institucion arsimor⁶², ku menaxheri duhet ta ketë gjithnjë në shënjestër.

Veprimet kyçe - Një veprim kyç merret në një kontekst të caktuar, kombinohet dhe lidhet me veprimet e tjera në mënyrë për të arritur një rezultat të veçantë. Në këtë kuadër lista e veprimeve kyçe është aftësi jo shteruese, ka për qëllim të jap një ide të veprimeve të vazhduara për të menaxhuar kompetencat profesionale.

KONKLUZION

Nevoja për formimin e menaxherëve të institucioneve arsimore është një urgjencë. Lëvizjet e rëndësishme të bëra në kontekstin strategjik shoqërohen edhe me sfida në rrugëtimin e formësimit të menaxherëve të shkollave ku secili duhet të jap kontributin e tij duke ofruar shërbimet cilësore në institucionin që e drejton si dhe zbatimit të praktikave profesionale.

Për të menaxhuar institucionin duhet të bazohet në burimet njerëzore si dhe cytjës së tyre të japin kontributin maksimal në edukim gjë që është një sfidë në vehte, ku kjo sfidë lidhet me udhëheqjen dhe menaxhimin. Për të arritur sukses duhet të krijohen raporte të besimit të ndërsjellë si dhe krijimit të hapsirave të hapura për dialog me të vetmin qëllim realizimit të objektivave dhe implimentimin e projekteve të përbashkëta duke u bazuar në përvojat e tyre mësimore si dhe akterëve tjerë të përfshirë në organizimin e saj.

Bashkëveprimi i vazhdueshëm me anëtarët e grupit duhet të jetë i bazuar kryesisht në besimin e ndërsjellë, komunikim të duhur dhe ndëgjim aktiv. Menaxherët duhet të besojnë në aftësitë e grupit të tij por edhe grupi duhet besoj në aftësitë e menaxherit. Tek çështja e besimit na paraqitet si lloj kredibiliteti, të njohjës së tjetrit si dhe synimeve të tij në realizimin e objektivave.

Mobilizimi i individëve dhe ekipeve rreth misionit arsimor, gjithnjë duke rrespektuar rregulloret dhe marrveshjet kolektive.

Sfidë e menaxhimit të një institucioni arsimor është edhe miratimi i një vizioni gjithpërfshirës ku ndjenja e misionit edukimi bëhet burim i angazhimit për aktorët përgjegjës.

⁶² Grillo, K. (2002). Fjalor edukimi (Psikologji-Sociologji-Pedagogji), Shtypur në shtypshkronjën “DITA 2000”, Tiranë, f. 182.

Poashtu, sfidë për menaxhmentin e shkollën paraqet edhe përqëndrimi në zhvillimin e një ndjenje të madhe kolektive ku kontributi i ç' do individi do jetë i vlerësuar dhe i njohur.

Referenca:

1. La Formation a la Gestion d'un Etablissement d'enseignement, Quebec, 2008;
2. Ahmet, Ceni, Menaxhimi i Burimeve Njerëzore, Cikël leksionesh, Kolegji i Menaxhmentit Internacional "Globus". Prishtine 2015;
3. Dr. Stenke Dor: Bazat e vlerësimit ne arsim, ligjëratë e mbajtur me zyrtare nga Ministria e Arsimit, Prishtinë, 2008;
4. Grillo, prof.dr.Kozma): Glossary Education (Psikologji -Sociologji - Arsim), "Light 2000", Pristinë, 2002;
5. Husayn, H., Salihaj, J., Nikoleta, M., Mrs, D., Qeverisja dhe udhëheqja ne arsim, KEC, Pristinë, 2003;
6. Malik, Fredmund: Führen, Leisten, Leben. Wirksames für eine neue Zeit Management. Heyne Business, 2001;
7. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë , Korniza e Standardeve te Praktikës Profesionale për Mësimdhënës në Kosovë, 2004;
8. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (AI 5/2010): Udhëzimi administrativ për licencim të mësimdhënësve, 2010;
9. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë , Korniza e kurrikulës për nivelin parashkollor, fillor dhe të mesëm, Prishtinë, 2011;
10. Standardet e praktikës profesionale për drejtorët e shkollave (AI 4/2012);
11. Grup autorësh. Metoda të mësimdhënies: Manual për mësuesit e rinj, AEDP, Toena, Shtypshkronja LAERT, Tiranë, 1999;
12. Rather A. R.. Essentials Of Instructional Technology. Publisher, Discovery Publishing House, 2004;
13. Banks, T. Teaching learning process. Center for Aide Regulation and education. North Carolina, 2000;
14. Pelletier. G. "La professionnalisation de la gestion scolaire : défis, enjeux et pistes d'action", La revue des Échanges, vol. 23, no 3, 2006;

15. Pelletier, G. Former les dirigeants de l'éducation. Apprentissage dans l'action, Paris, De Boeck, Université.1999;
16. Perrenoud, P. Construire des compétences dès l'école. (4e éd.). Paris: Éditions Sociales Françaises. 2004;
17. Brassard, A. (2004 b). « La professionnalisation de la fonction de direction d'un établissement d'enseignement et le développement du champ d'études de l'administration de l'éducation », la revue Éducation et francophonie. vol. XXXII, no 2;
18. Lafortune, L., Cyr, S., Masse, B. . Travailler en équipe-cycle entre collègues d'une école. Sainte-Foy : Presses de l'Université du Québec, 2004;
19. Brassard, A. « L'institutionnalisation du champ d'études de l'administration de l'éducation : une analyse critique de l'expérience québécoise », Revue française de pédagogie, no 130. 2000;
20. Dionne, P. Prendre le leadership des compétences. Le réveil du management, Éditions du Renouveau Pédagogique inc.2004;
21. Lasnier, F. Réussir la formation par compétences. Montréal : Ed. Guérin, 2000;
22. Le Boterf, G. Ingénierie et évaluation des compétences. (5e éd.). Paris: Éditions d'Organisation. 1re éd : 1998,2006;
23. Le Boterf, G. Professionnaliser. Paris : Eyrolles. Éditions d'Organisation, 2007.

FAKTORËT AKADEMIKË QË NDIKOJNË NË NIVELIN E STRESIT TË STUDENTËVE

Dr. Petrit TARAJ

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë

ptaraj2@gmail.com

ABSTRAKT

Ky studim kërkon të hetojë dhe të evidentojë marrëdhëniet midis stresit të studentëve dhe faktorëve akademikë që e shkaktojnë atë si: Mbingarkesa, Përshtatja me Mjedisin, Rezultatet e Provimeve dhe Presioni i Familjes. Në realizimin e këtij studimi u përdor teknika Cluster Sampling (kampionimit me grupe) për të kryer një anketim tërësor dhe të detajuar me studentët e tre Universiteteve Publike. Studiuesit përshtatën një pyetësor në lidhje me (SA) stresin akademik të këtyre studentëve, i cili përmbante 69 pyetje. Qëllimi i këtij studimi është për të matur ndikimin e faktorëve akademikë të evidentuar nga analiza faktoriale nëpërmjet metodës Analiza e komponentëve kryesor në nivelin e stresit akademik të studentëve gjatë periudhës pranverë 2015. Në anketim morën pjesë 436 studentë të Fakultetit të Shkencave Humane të Universitetit Ismail Qemali të Vlorës, të Universitetit Aleksandër Xhuvani të Elbasanit dhe Universitetit Fan S. Noli të Korçës.

Paketa Statistike e Shkencave Sociale (SPSS për Windows XP version 16) u përdor për të kryer vrojtimin e të dhënave dhe analizën statistikore të faktorëve të evidentuar në studim. Analiza e të dhënave evidentoi se ka një korrelacion midis faktorëve të evidentuar në studim dhe (SA) stresit akademik të përjetuar nga studentët ku Koefficienti i korrelacimit r varion nga (.259 ~ .382).

Fjalë kyçe: *Stres, faktor stresant, stres akademik, performancë akademike, stres i perceptuar.*

HYRJE

Stresi në institucionet akademike mund të ketë pasoja pozitive dhe negative nëse nuk menaxhohet mirë (Stevenson & Harper, 2006). Mbi shkaqet e stresit në universitete dhe sjelljet përballuese të studentëve janë bërë dhe po bëhen shumë studime. Studimet kanë treguar se stresi është një katalizator domethenës dhe një shenjë paralajmëruese drejt depresionit. Një trend

shqetësues në shëndetin e studentëve universitar është rritja e raportuar e stresit të studentëve (Sax, 1997). Stresorët që ndikojnë tek studentët mund të kategorizohen si akademikë, financiar, të ndërlidhura me kohën ose shëndetin dhe të vetimponuara (Goodman, 1993). Në studim u përdor një literaturë e kontrolluar dhe e përshtatshme që shërbeu si një bazë e rëndësishme për të shqyrtuar faktorët që shkaktojnë stres akademik tek studentët. Studentët raportojnë përjetimin e stresit akademik gjatë çdo semestri dhe evidentojnë se burimet kryesore të stresit akademik rezultojnë kryerja dhe studimi për provime, konkurrenca për notë dhe sasia e madhe e përmbajtjes së informacionit që u kërkohet nga stafet akademike për tu zotëruar në një njësi kohe të shkurtër (Abouserie, 1994; Britton & Tesser, 1991).

Qëllimi i studimit, është vlerësimi i faktorëve stresant që kanë impakt në rritjen e nivelit të stresit akademik të studentëve. *Objekti i këtij studimi* është gjetja e një korrelacioni sinjifikativ midis stresit akademik dhe katër faktorëve të evidentuar nga analiza faktoriale (Faktori1: Mbingarkesa (F1M); Faktori2: Presioni i Familjes (F2PF); Faktori 3: Përshtatja me Mjedisin (F3PM); Faktori 4: Rezultatet e Provimeve (F4RP). Ky studim nëpërmjet përzgjedhjes së faktorëve që shkaktojnë stres akademik tek studentët kërkon të sjellë dhe të trajtojë një listë të faktorëve të stresit akademik të provuar empirikisht. Në mënyrë të veçantë, ky studim kërkon t'i japë përgjigje pyetjeve të kërkimit të mëposhtme:

A janë faktorët e evidentuar në këtë studim shkak i rritjes së nivelit të stresit akademik të studentëve? A ka një korrelacion të rëndësishëm statistikor në mes të nivelit të stresit akademik të studentëve dhe faktorëve të evidentuar në studim. Cili nga faktorët e evidentuar në studim ndikon më shumë në rritjen e niveli të stresit të studentëve.

Në seksionin e rishikimit të literaturës, në studim janë pasqyruar gjetjet më bashkëkohore në lidhje me stresin akademik që përjetojnë studentët e universiteteve. Faktorët e evidentuar në literaturë dhe që kanë patur impakt në rritjen e stresit akademik, janë objekt i këtij studimi për t'u analizuar dhe vlerësuar. Në seksionin e metodologjisë së përdorur në këtë studim është përshkruar, procesi i ndjekur nga studiuesit për realizimin e detyrës kërkimore, të qëllimit dhe objektivave të studimit. Analiza përshkruese dhe statistikore e të dhënave në studim përshkruan hap pas hapi procesin e kërkimit. Një aspekt i rëndësishëm në studim janë gjetjet dhe diskutimi i tyre. Në studim janë diskutuar edhe implikimet e rezultateve dhe kufizimet e studimit. Sigurisht që ky studim me gjetjet e ofruara jep mundësi dhe hap perspektiva për studime të mëtejshme me vlera përgjithësuese.

I. RISHIKIMI I LITERATURËS

Stresi është bërë një temë e rëndësishme në rrethet akademike të shoqërisë tonë. Shumë studiues në fushën e psikologjisë së sjelljes kanë kryer kërkime të gjera rreth stresit dhe nga rezultatet është arritur në përfundimin se kjo është një temë më se e nevojshme që kërkon më shumë vëmendje (Agolla, 2009). Stresi ndodh kur një individ është përballur me një situatë që ata e perceptojnë si të papërballueshme. “Stresi është një përgjigje fizike dhe mendore për kërkesat e përditshme, veçanërisht ato të lidhura me ndryshimin” (Richlin-Klonsky & Hoe, 2003). Stresi mund të konsiderohet si “çdo faktor, duke vepruar brenda ose jashtë, e cila e bën përshtatjen me mjedisin të vështirë dhe shkakton rritjen e përpjekjeve të individit për të ruajtur një gjendje ekuilibri midis vetes dhe tjetrit dhe ambientit të jashtëm”(Humphrey, Au, & Bowden, 2000). Një formë e stresit që vazhdimisht përjetohet nga studentët është stresi në lidhje me shqetësimet akademike. “Stresi akademik është produkt i kombinimit të kërkesave akademike të lidhura që i tejkalojnë burimet adaptuese në dispozicion të një individi” (Wilks, 2008). Stresi akademik është një shqetësim që nuk duhet të merret si i mirëqenë, sepse kjo ndikon negativisht në përshtatjen e studentëve. Përvoja e stresit në mesin e studentëve të universitetit është konsideruar si normale, por “nëse stresi është i rëndë dhe / ose i zgjatur, ai mund të reduktojë performancën akademike; të ndikojë në aftësinë e studentit për të marrë pjesë dhe për të kontribuar në jetën e kampusit dhe për të rritur gjasat e abuzimit me substanca narkotike dhe sjellje të tjera potencialisht të dëmshme” (Richlin - Klonsky & Hoe, 2003).

Stresorët akademikë: Studimet flasin për shumë faktorë që kontribuojnë në nivelin e stresit që po përjetohet nga studentët, si: çështjet e menaxhimit të kohës, vështirësitë financiare, ndërveprimi me mësuesit, qëllimet personale, aktivitetet sociale, akomodimi në kampus, mjedisi universitar, mungesa e rrjeteve mbështetëse (Wilks, 2008), procedurat e pranimit, standardet e larta të prindërve, (Masih & Gulrez, 2006), pritjet e vetë nxënësit, pritjet e prindërve dhe pritjet e mësuesve (Ang & Huan, 2006). Gjithashtu janë të lidhur me stresin akademik faktorët e njohur si: ngarkesa akademike, ndjekja e leksioneve, performanca në punën akademike, vështirësitë akademike, klasat e mbipopulluara, pritjet e anëtarëve të familjes / prindërit, (Agolla & Ongori, 2009). Për stresin akademik në mesin e studentëve ka kohë që janë bërë hulumtime dhe studiuesit kanë identifikuar stresorët që ndikojnë në të si: detyrat e tepërta, konkurrenca me nxënësit e tjerë, dështimet, mungesa e parave në xhep, marrëdhëniet e varfra me studentët e tjerë apo pedagogët, familjen apo problemet në shtëpi (Fairbrother dhe Warn, 2003). Studimet

grykojnë se stresi spikatet në raste të rëndësishme dhe kur rezultatet e këtyre situatave janë të paqarta, atëherë individët formojnë një lloj pasigurie në vetvete. Një përmbledhje e literaturës, tregon se studentët në universitete mund të përjetojnë stres për shkak të faktorëve të tillë si: *faktorët e shëndetit, faktorët akademikë dhe faktorët socialë*. Stresi akademik përshkon jetën e studentëve dhe ka tendencë të ndikojë negativisht në shëndetin e tyre mendor dhe fizikë dhe aftësinë e tyre për të kryer punë efektive në shkollë. Stresi Akademik është një shqetësim që nuk duhet të merret si i mirëqenë, sepse ai ndikon negativisht në rregullimin e përgjithshëm të studentëve (Hussain, Kumar, & Husain, 2008). Disa studime kanë dokumentuar tashmë efektin e stresit mbi studentët dhe kanë gjetur se faktorët akademikë janë përgjegjës për nivelin e lartë të stresit në mesin e studentëve universitar.

Në studimin e tyre Misra dhe McKean (2000), treguan se ngarkesa e punës akademike është për shkak të semestrit të shkurtër ku studentëve u duhet të përballojnë së bashku me testet dhe përgatitjen për provimin përfundimtar të semestrit edhe detyrat e shumta. Ata përmendën se u duhet të kryejnë shumë punë brenda një kohe të shkurtër për të patur një performancë të mirë akademike, por kjo nuk iu lë shumë kohë për të shijuar jetën e tyre sociale. Ky studim shqyrton përjetimin e stresit akademik të studentëve të tre universiteteve publike në Shqipëri nën ndikimin e faktorëve: Mbingarkesë, Presioni i Familjes, Përshtatja me Mjedisin dhe Rezultatet e Provimeve

Hipoteza e Studimit: H_1 : Faktorët e evidentuar në studim ndikojnë në rritjen e nivelit të stresit akademik të studentëve.

II. METODOLOGJIA

Instrumenti i studimit: Zhvillimi i instrumentit të studimit për të matur shqetësimet e studentëve të universitetit u realizua nëpërmjet një procedure të strukturuar hap pas hapi: duke filluar me rishikimin e literaturës lidhur me stresin akademik që studentët përjetojnë. Hapi i dytë i zhvillimit të instrumentit u pasua nga intervista me fokus-grupe të studentëve të Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë. Pas analizave dhe mendimit të studentëve u hartua një pyetësor i cili përfshiu 69 pyetje për stresin akademik.

Seksioni i parë: Studentëve iu kërkohet të raportojnë gjininë dhe universitetin publik ku studiojnë.

Seksioni i dytë: Studentëve iu kërkohet të raportojnë nivelin e stresit akademik të përjetuar. Një shkallë me pesë pika të tipit Likert nga 1 (Aspak stres) në 5 (Stres ekstrem) u përdor nga studiuesit për të matur nivelin e stresit të përjetuar nga studentët gjatë këtij semestri akademik.

Seksioni i tretë: Një Shkallë me pesë pika e tipit Likert nga 1(Aspak dakord) në 5 (Plotësisht dakord) e hartuar nga studiuesit iu kërkon responduesve që të raportojnë mendimin e tyre për 69 pyetjet që përmban ky seksion i pyetësorit.

Pjesëmarrësit

Në këtë studim u përdor një përzgjedhje e kampionimit në grup për të matur ndikimin e faktorëve stresant në nivelin e stresit akademik të studentëve. Në studim u thirrën rreth 500 studentë të Universitetit “Ismail Qemali” të Vlorës, të Universitetit “Aleksandër Xhuvani” Elbasan dhe Universitetit “Fan Noli” Korçë. 64 pyetësorë nuk ishin plotësuar saktë dhe u mendua nga studiuesit që të skualifikoheshin në këtë analizë. Kampioni i përdorur për këtë studim është 436 studentë të cilëve iu është premtuar nga studiuesit e drejta e anonimitetit.

Profili respondentëve

Të anketuarit u përzgjedhën në mënyrë të rastësishme, pra u përzgjedh një kampion në mënyrë rastësore. Shumica e studentëve ishin femra (85%) me një frekuencë shpërndarje 363 dhe (15 %) e respondentëve ishin meshkuj me një frekuencë shpërndarje 64.

Me një frekuencë shpërndarje 209 (48.9%) e respondentëve ishin studentë të Universitetit “Ismail Qemali” të Vlorës. 116 (27.2%) e respondentëve ishin studentë të Universitetit “Aleksandër Xhuvani” Elbasan dhe 102 (23.9%) ishin studentë të Universitetit “Fan Noli” të Korçës (Tab.1).

Tabela 1

Universiteti publik					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Vlore	209	48.9	48.9	48.9
	Elbasan	116	27.2	27.2	76.1
	Korçë	102	23.9	23.9	100.0
	Total	427	100.0	100.0	

IV. REZULTATET E STUDIMIT

Analiza statistikore

Paketa Statistikore e Shkencave Sociale (SPSS version 16 për Windows XP) u përdor nga studiuesit për të analizuar të dhënat e marra nga aplikimi i anketës i cili përdori si instrument një pyetësor të vetadministruar dhe të hartuar për të matur impaktin që kanë faktorët stresant në rritjen e nivelit të stresit akademik të studentëve.

Analiza faktoriale

Analiza faktoriale në këtë studim përdori Testin Bartlett i cili synon të zbulojë variablat që kanë lidhje midis tyre. Test Bartlett i këtij pyetësori është 1.123E4 i ngjashëm me vlerën e Chi-square (një test që përdoret për të zbuluar sa e përshtatshme është një teori duke e krahasuar me fenomenin që studiohet). Nga (Tab. 2) shihet qartë se indeksi (Kaiser-Meyer-Olkin Measure of Sampling Adequacy) ($KMO = .891$) > 0.6 dhe Bartlett's Test of Sphericity e barabartë me Chi-Square tregon se ($Sig = .000$) pra ($p < .005$) verteton standartizmin e testit të përdorur për mbledhjen e të dhënave dhe se është statistikisht domethënës. Analiza *Total Variance Explained* (Shpjegimi i Variancës Totale) nxorri 18 faktorë që kanë një lidhje të fuqishme korrelacioni > 1 të cilët në analizën faktoriale duhen marrë në konsideratë. Në analizën faktoriale faktorët me koeficient korrelacioni nën 0.30 u përjashtuan nga analiza.

Tabela 2

KMO and Bartlett's Test

Kaiser-Meyer-Olkin Measure of Sampling Adequacy.		.891
Bartlett's Test of Sphericity	Approx. Chi-Square	1.123E4
	df	2346
	Sig.	.000

Në analizën faktoriale artikujt (Var 41 dhe Var 42) me koeficient korelacioni (eigen value) $< .30$ u përjashtuan nga analiza e mëtejshme statistikore. Këto 67 artikuj (variablat) e shkallës Likert janë kategorizuar pas analizës faktoriale në mënyrë specifike në katër nën/shkallë që përfaqësojnë faktorët (komponentët) e identifikuar të stresit akademik:

- F1. Mbingarkesë (Kjo nënshkallë përmban 23 artikuj),
- F2. Presioni i Familjes (Kjo nënshkallë përmban 15 artikuj),
- F3. Përshtatja me Mjedisin (Kjo nënshkallë përmban 17 artikuj)
- F4. Rezultatet e Provimeve (Kjo nënshkallë përmban 12 artikuj)

Analiza e besueshmërisë

Studimi zbatoi testin e besueshmërisë së Chronbachut. Vlera e Cronbach's Alpha e Shkallës që mat besueshmërinë e Faktorit 1: Mbingarkesa ishte (α) = 0.873 (numri i variablave

23); Faktorit 2: Presioni i Familjes ishte (α) = 0.858 (numri i variablave 15); Faktorit 3: Përshtatja me Mjedisin ishte (α) = 0.843 (numri i variablave 17); Faktorit 4: Rezultatet e Provimeve ishte (α) = 0.779 (numri i variablave 12) duke treguar se konsistenca e brendshme e (4) nënshkallëve është e shkëlqyer.

Analiza e nivelit të stresit akademik të përjetuar

Analiza përshkruese e (SA) stresit akademik tregon se mesatarja (Mean = 3.45199), Gabimi i mesatares (S.e.m) = .036906 e papërfillshme. Std. Deviation (Devijimi standard) = .762634 i papërfillshëm për analizën statistikore të variablit. Statistika përshkruese e variablit të varur (SA) kolona (Valid Percent) na paraqet këto të dhëna statistikore (Tab. 3)

Pak stres	(40)	9.4 %
Stres mesatar	(185)	43.3 %
Shumë stres	(171)	40 %
Stres ekstrem	(31)	7.3 % e respondentëve.

Pra 83.3% e respondentëve kanë përjetuar stres mesatar dhe shumë stres.

Tabela 3

Stres akademik

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Pak stres	40	9.4	9.4	9.4
	Stres mesatar	185	43.3	43.3	52.7
	Shumë stres	171	40.0	40.0	92.7
	Stres ekstrem	31	7.3	7.3	100.0
	Total	427	100.0	100.0	

Analiza përshkruese e artikujve

Analiza përshkruese e artikujve të katër nënshkallëve (Tab.4) tregon se disa artikuj kanë një mesatare më të lartë se niveli i stresit akademik të përjetuar (Mean 3.4).

Tabela 4

Nr	Faktoret akademkë	Mesatare
Var 5	Mosvlerësimi i duhur më irriton dhe më shkakton stres.	4.1171
Var 19	Ndjej stres dhe ankth para fillimit të provimit sepse dua të dal mirë.	4.6698
Var 20	Më shkakton stres mendimi, nëse do t'i marr të gjitha lëndët për shkak të vështirësisë që paraqesin.	4.1194
Var 21	Më shkakton stres mendimi, nëse do e marr lëndën për herë të dytë?	4.0375
Var 23	Ngarkesa e tepërt e testeve në provime më streson.	4.0867
Var 24	Më shkakton stres mosdhënia e notës së merituar në provime.	4.1616
Var 32	Rri zgjuar deri vonë përpara ç'do lloj testimi (provimi) që kemi në shkollë.	4.3044
Var 44	Ethet e provimeve më shkaktojnë një gjendje emocionale të brendëshme	4.3396

	stresante.	
Var 48	Ndihem në gjendje të pashpresë kur mendoj se ku do të punësohem pasi të mbaroj studimet.	4. 0562

Analiza e Korrelacionit të produkt-momentit.

Ky studim përdori koeficientin e korelacionit të produkt momentit për të përlloritur marrëdhënien midis (SA) stresit akademik dhe faktorëve që e shkaktojnë atë. Koeficienti i korrelacionit qe midis .259 ~ .382 dhe tregoi se ekziston një marrëdhënie domethënëse e moderuar midis faktorëve stresues të evidentuar në shkallën me 5 pika të tipit Likert dhe stresit akademik. Për të provuar forcën e shoqërimit midis stresit akademik (Variabli i varur) dhe faktorëve që ndikojnë në rritjen e tij: performanca e pedagogëve, rezultatet e studimit, mbingarkesa, manaxhimi i kohës dhe i vetvetes, mjedisi, programet akademike, problemet financiare dhe marrëdhëniet me shoqërinë (Variabli i pavarur), u përdor nga studiuesit Analiza Bivariate e korrelacionit të Produkt Momentit (Bivarriate Correlations) duke parë vlerën e Koeficientit r Pearson i produkt momentit. Koeficienti i korelacionit i produkt momentit midis variablit të varur; Stres i përjetuar akademik dhe 4 faktorëve të pavarur arriti vlerat:

1. Stresi i perjetuar akademik dhe F.1 Faktori 1. Mbingarkesa $r = .317$ (i moderuar)
2. Stresi i perjetuar akademik dhe F.2 Faktori 2: Presioni i familjes. $r = .293$ (i dobët)
3. Stresi i perjetuar akademik dhe F.3 Faktori 3: Përshtatja me mjedisin $r = .259$ (i dobet)
4. Stresi i përjetuar akademik dhe Faktori 4: Rezultatet e provimeve $r = 0.382$ (i moderuar).

V. DISKUTIMI

Nisur nga analiza përshkruese dhe statistikore e të dhënave në pajtim më testin e Cronbach's Alpha të besueshmërisë dhe vlefshmërisë të 4 nënshkallëve ku $(\alpha) > 0.6$ arrijmë në konkluzionin se përshtatshmëria e instrumentit të hartuar nga studiuesit në besueshmërinë dhe vlefshmërinë e kërkesave të një studimi u arrit. Rezultatet statistikore të stresit akademik të përjetuar nga studentët shfaqën rezultate të kënaqshme. Pas analizës faktoriale Total Variance Explained (Shpjegimi i variancës totale), 18 faktorë u evidentuan si faktorë me lidhje korrelative të qëndrueshme dhe të fortë në shkallën e përdorur nga studiuesit. Studimi ynë gjeti gjithashtu se, faktotërë të tillë si: mosvlerësimi i duhur, ankthi para fillimit të provimit, mendimi nëse do t'i marr të gjitha lëndët për shkak të vështirësisë që paraqesin, nëse do e marr lëndën për herë të dytë, ngarkesa e tepërt e testeve në provime, mosdhënia e notës së merituar në provime,

pagjumësia, ethet e provimeve dhe mendimin se ku do të punësohem pasi të mbaroj studimet, ishin faktorë me një vlerë mesatare të përzgjedhur nga studentët (Mean) > 4. Këta janë faktorë që kanë ëatur më tepër ndikim në rritjen enivelit të stresit akademik të studentëve. Fakti që 83.3% e respondentëve kanë përjetuar stres mesatar dhe shumë stres, është domethënës për të vërtetuar se studentët kanë përjetuar stres të moderuar deri në shumë stres. Analiza e korrelacionit bivariat tregoi se 2 faktorët me një koeficient korrelacioni më të lartë janë F1 Mbingarkesë $r = .317$ (i moderuar), dhe F4 Rezultatet e provimeve $r = .382$ (i moderuar). Por edhe dy faktorët e tjerë pavarësisht se fortësia e lidhjes dhe ndikimi që kanë patur mbi stresin e studentëve është e dobët, nuk duhen neglizhuar. Pavarësisht se marrëdhënia është e moderuar për të dy faktorët, por është tregues që duhet vlerësuar nga pedagogët. Pra pedagogët duhet të përmirësojnë përmbajtjen cilësore të kurseve, vlerësimin real të studentëve dhe të ulin presionin ndaj studentëve. Pavarësisht se korrelacioni midis Stresit të përjetuar akademik të studentëve dhe faktorëve (Faktorit 2: Presioni i familjes $r = .293$ dhe Faktorit 3: Përshtatja me mjedisin, $r = .259$) është e dobët, përsëri duhet marrë në konsideratë nga stafet drejtuese në universitete dhe familjet. Këta faktorë duhen vlerësuar si nga vetë studentët në krijimin e raporteve ndërpersonale, ashtu edhe nga pedagogët në trajtimin e informacionit të përmbajtjes së kursit, dhe lirim të studentëve nga ngarkesat e tepërta joefikase.

Pra H_0 në bazë të rezultateve të Koeficientit të korrelacionit Pearson bie, dhe studimi vërteton H_1 që ishte qëllimi i këtij studimi. Ky rezultat është mjaft në përputhje me studimet e tjera të përmendura në seksionin e rishikimit të literaturës.

KONKLuzion

Analiza statistikore e stresit akademik tek studentët e tre universiteteve që morën pjesë në këtë studim tregon se kur problemet e ndërlidhura akademike dhe problemet e tjera që varen nga vetë studentët nëse nuk vlerësohen në kohë dhe me seriozitet do të hasen probleme tek studentët si: paaftësi në përshtatje, si dhe shfaqja e fenomeneve të trishtueshme dhe problematike fizike dhe mendore. Instrumenti i stresit akademik të këtij studimi përfshinte 69 pyetje që për arsye të analizës statistikore i grupuam në 4 faktorë. Shkalla pesë pikëshe Likert u përdor duke variuar nga 1 (aspak dakord) në 5 (plotësisht dakort). Sa më të larta qenë pikët e një faktori aq më e lartë qe grada e stresit të përjetuar nga studentët nën ndikimin e prodhuar nga ky faktor.

Si përfundim do të konkludonim se: Studentët e universiteteve publike gjatë semestrit pranverë 2015 kanë përjetuar nivel të moderuar të stresit akademik. Në përgjithësi, ne mund të konkludojmë se studentët kanë përjetuar stres në sezonin Pranverë 2015 në një nivel të mesëm 3.4 të dalë nga rezultati i përgjithshëm 5. Inventari i stresit akademik të këtij studimi u nda në katër faktorë dhe me një total prej 67 pyetje (artikuj). Shkaqet e mundshme që u hasën në inventarin e stresit akademik të përpiluara në këtë studim qenë;

1. *Stresi nga mbingarkesa:* detyrat e kursit, metodat e mësimdhënies, korrupsioni, vlerësimi, rezultatet e testeve dhe komunikimi me pedagogët
2. *Stresi nga Presioni i familjes.* pritjet e prindërve, problemet financiare, gjendja ekonomike e familjes.
3. *Stresi nga Përshtatja me mjedisin;* menaxhimi i vetvetes, marrëdhëniet me shoqërinë dhe puna në grup, infrastruktura, programet akademike, guidat orientuese, menaxhimi i kohës, raporti aktivitetet relaksues - mësim, lodhja.
4. *Stresi nga rezultatet e provimeve:* ngarkesa e testeve, pagjumësia dhe perspektiva e së ardhmes.

Shkaqet e mundshme që u hasën në inventarin e stresit akademik të përpiluara në këtë studim qenë paaftësia e studentëve për të menaxhuar vetveten, pritshmëritë dhe zhgënjimi nga rezultatet e studimeve dhe paqëndrueshmëria e programeve akademike. Në bazë të rezultateve të studimit është detyrë imediate e stafeve akademike për të vlerësuar stresin akademik të studentëve dhe për të ndihmuar në përmirësimin e cilësisë së jetës së studentëve. Duke u nisur nga rezultatet e studimit gjithashtu do të sugjerohet autoriteteve relevante përpilimin e planeve të aktiviteteve të përshtatshme ose programeve për studentët të tilla si; organizimi i bisedimeve mbi menaxhimin financiar, motivimin, menaxhimin e kohës, aftësitë e studimit dhe ndoshta edhe tema për menaxhimin e stresit. Këto programe duhet të organizohen në vazhdimësi. Gjithashtu departamentet duhet të angazhohen në hartimin e programeve akademike koherente që i përgjigjen zhvillimit të shoqërisë, teknologjisë dhe informacionit. Rritja cilësore e stafeve akademike në universitete. Nisur nga lidhja pozitive e korrelacionit arrijmë në konkluzionin se faktorët: Mbingarkesë, rezultatet e provimeve janë faktorë që duhen vlerësuar. Është e domosdoshme interesimi i autoriteteve relevante të universiteteve për punësimin e studentëve pas diplomimit.

Kufizimet

Ky studim mund të përdoret si bazë për eksplorim të mëtejshëm mbi ndikimet e nivelit të stresit në punën akademike të studentëve. Përveç kësaj, faktorët e tjerë të mundshëm që mund të kontribuojnë për të theksuar që nuk janë shqyrtuar në këtë studim të tillë si faktorët e ambientit, sfondi familjar, arritjet e mëparshme akademike dhe sfondi i detajuar i studentit mund të eksplorohej më tej nga studiuesit në të ardhmen. Kjo mund të ndihmojë për të gjetur marrëdhënie më të forta midis faktorëve stresant dhe stresit të studentëve që ka impakt në performancën akademike të studentëve. Ndoshta kufizimi më i rëndësishëm i studimit është mospërfshirja edhe e faktorëve të tjerë që ndikojnë në nivelin e stresit akademik. Teknikat statistikore të përdorura mund të ndikojnë në rezultatet. Në të ardhmen duke shpresuar për një studim kërkimor më të avancuar mund të arrihen përfundime të përgjithshme në lidhje me faktorët e stresit që ndikojnë në nivelin e stresit dhe të performancës akademike të studentëve.

Referenca:

1. Agolla, E.J. (2009). "Occupational Stress among Police Officers": The case of Botswana Police service, *Res. J. Bus. Manage.* 2(1):25-35;
2. Abouserie, R. (1994). Sources and levels of stress in relation to locus of control and self-esteem in university students. *Educational Psychology*, 14(3), 323-330;
3. Ang, R. P. & Huan, V. S. (2006). Relationship between Academic Stress and Suicidal Ideation: Testing for Depression as a Mediator using Multiple Regression. *Child Psychiatry and Human Development*, 37(2), 133-143;
4. Agolla, J. E. & Ongori, H. (2009). An Assessment of Academic Stress among Undergraduate Students: The Case of University of Botswana. *Educational Research and Review*, 4(2), 63-70. Available online at <http://www.academicjournals.org/ERR>;
5. Britton, B.K., & Tesser, A. (1991). Effects of time-management practices on college grades. *Journal of Educational Psychology*, 83(3), 405-410;
6. Fairbrother K, Warn J (2003). Workplace Dimensions, Stress and Job Satisfaction, *J. Managerial Psychol.* 18(1): 8-21;
7. Goodman, E.D. (1993). How to handle the stress of being a student. *Imprint*, 40: 43;
8. Humphrey, J.H., Yow, D.A., & Bowden, W.W. (2000). *Stress in College Athletes: Causes, Consequences, Coping*. Binghamton, NY: The Haworth Half-Court Press. An imprint of the Haworth Press, Inc;

9. Masih, P. P. & Gulrez, N. K. (2006). Age and Gender Differences on Stress. In Husain, A. & Khan, M. I. (eds.). *Recent Trends in Human Stress Management (97-104)*. New Delhi, India: Global Mission Publishing House. Khan, M. I. (eds.). *Recent Trends in Human Stress Management (97-104)*. New Delhi, India: Global Mission Publishing House;
10. Misra, R., & McKean, M. (2000). COLLEGE STUDENTS' ACADEMIC STRESS AND ITS RELATION TO THEIR ANXIETY, TIME MANAGEMENT, AND LEISURE SATISFACTION. *American Journal of Health Studies*, 16(1). 41-45
<http://www.biomedsearch.com/article/College-students-academic-stress-its/65640245.html>;
11. Richlin-Klonsky, J. & Hoe, R. (2003). Sources and Levels of Stress among UCLA Students. *Student Affairs Briefing*, 2;
12. Stevenson A, Harper S (2006). Workplace stress and the student learning experience, *Qual. Assur. Educ.*, 14(2): 167-178;
13. Sax, L.J. (1997). Health trends among college freshmen. *Journal of American College Health*, 45(6), 252-262;
14. Wilks, S. E. (2008). Resilience amid academic stress: The moderating impact of social support among social work students. *Advances in Social Work*, 9(2), 106-125
<http://advancesinsocialwork.iupui.edu/index.php/advancesinsocialwork/article/view/51/195>.

PËRPARËSITË DHE DOBËSITË E VETËVLERËSIMIT TË NXËNËSVE NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR

Vetëvlerësimi – aspekte terminologjike

Ma.Zamira Gashi SHATRI

Universiteti i Gjakovës

Fakulteti i Edukimit

zamira.gashi@uni-gjk.org

ABSTRAKT

Vlerësimi i nxënësve si proces i vazhdueshëm dhe i pranishëm çdo herë në sistemin shkollor është mjaft i rëndësishëm për nxënësit, komunitetin e familjes, të shkollës dhe të shoqërisë në përgjithësi. Nëpërmjet vetëvlerësimit nxënësit kanë mundësi që në lidhje me qëllimet e caktuara të mësimit të vlerësojnë veten, arritshmërinë e tyre.

Arritjet tona personale dhe profesionale shtyjnë përpara konceptin tonë mbi veten, sidomos kur ne e shohim atë të pasqyruar në vlerësimet e të tjerëve. Duke u bazuar në këto praktika, atëherë qëllimi i këtij studimi është të pasqyrojë përparësitë dhe dobësitë të cilat shfaqen tek nxënësit në arsimin parauniversitar. Ky hulumtim është realizuar në katër lokalitete në Kosovë si: Prishtinë, Gjakovë, Klinë, Istog dhe Deçan. Janë të përfshirë të dy gjinitë si djemtë poashtu edhe vajzat e këtyre shkollave në grup moshë të ndryshme, do të thotë prej nxënësve të kl.VI - IX dhe kl. X – XII apo nxënës të moshës 12-18 vjeçare.

Numri i përgjithshëm i nxënësve të anketuar ka qenë 725 nxënës, në dhjetë shkolla: pesë shkolla të mesme të ulta (400 nxënës pjesëmarrës) dhe pesë shkolla të mesme të larta (325nxënës pjesëmarrës) si dhe 80 mësimdhënës të anketuar. Realizimi i hulumtimit është bërë në mënyrë direkte me mësimdhënësit dhe nxënësit.

Kërkimi është realizuar me kombinimin e metodave të hulumtimit kualitativ dhe metodat e hulumtimit kuantitativ. Metodën që kam përdorë janë: metoda e analizës teorike, metoda komparative, metoda deskriptive dhe metoda statistikore. Si teknikë të hulumtimit u aplikua teknika e anketimit përmes *fletëpyetësit* apo *pyetësorit* si instrument.

Fjalët kyçe: *Vetëvlerësim, nxënës, shkollë, vetëbesim, hulumtim.*

1. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

1.1. Objekti i hulumtimit.

Kudo në shkollat e botës poashtu edhe në shkollat tona, ekzistojnë mënyra dhe forma të ndryshme për vlerësimin e nxënësve, andaj vetëvlerësimi i nxënësve si sistem apo formë mjaft me rëndësi në këtë rast është edhe objekt i hulumtimit.

1.2. Qëllimi i hulumtimit.

Qëllimi i këtij hulumtimi është të paraqesë përparësitë dhe dobësitë e vetëvlerësimit të nxënësve në arsimin parauniversitar, njëkohësisht të shihet se sa është i pranishëm në shkollat kosovare.

1.3. Objektivat e hulumtimit:

- Shqyrtimi dhe analiza teorike e literaturës dhe burimeve të ndryshme lidhur me këtë temë;
- Informimi i lexuesve për vetëvlerësimin e nxënësve;
- Zbatimi i teknikave të përshtatshme për aplikim;
- Grumbullimi i të dhënave nga mësimdhënësit dhe nxënësit përkitazi me këtë dukuri;
- Krahasimi i rezultateve të shkollave të mesme të ulta me ato të mesme të larta;

1.4. Rëndësia e hulumtimit

Koncepti i vlerësimit të vetes lidhet me pranimin e përgjithshëm të vetes, me shkallën me të cilën ju ndjeni se jeni njeri me vlerë. Në qoftë se keni vetëvlerësim të lartë atëherë ju respektoni, pranoni dhe vlerësoni pozitivisht veten tuaj.

1.5. Mostra e hulumtimit

Për realizimin dhe zhvillimin e këtij hulumtimi si mostër janë mësimdhënësit dhe nxënësit e këtyre shkollave me mendimet e tyre lidhur me këtë ecuri. Janë të përfshirë të dy gjinitë e këtyre shkollave në grup moshë të ndryshme, do të thotë prej nxënësve të kl.VI-IX dhe kl. X–XII apo nxënës të moshës 12-18 vjeçare. Numri i përgjithshëm i nxënësve të anketuar ka qenë 725 nxënës, në dhjetë shkolla: pesë shkolla të mesme të ulta (400 nxënës pjesëmarrës) dhe

pesë shkolla të mesme të larta (325 nxënës pjesëmarrës) si dhe 80 mësimitdhënës të anketuar. Realizimi i hulumtimit është bërë në mënyrë direkte me mësimitdhënësit dhe nxënësit.

2. VETËVLERËSIMI – ASPEKTE TERMINOLOGJIKE

Vetëvlerësimi nga ana e nxënësve është një komponent thelbësor i vlerësimit formues, përpjekje për të mësuar. Nëse vlerësimi formativ është që të jetë produktiv, nxënësit duhet të jenë trajnuar në vetëvlerësim në mënyrë që ata të mund të kuptojnë qëllimet kryesore të të mësuarit e tyre dhe në këtë mënyrë të kuptojnë atë që ata kanë nevojë për të bërë, për të arritur.⁶³

Vetëvlerësimi është proces gjatë të cilit institucioni, shkolla, mësimitdhënësi, nxënësi mbledhin informacion për veten e tyre dhe bëjnë gjykimin e vlerave të tyre.⁶⁴ Këtë vlerësim nxënësi e realizon duke krahasuar rezultatet e veta me rezultatet e nxënësve të tjerë, apo duke zgjedhur teknika të ndryshme të vlerësimit. Nëpërmjet vetëvlerësimit nxënësit kanë mundësi që në lidhje me qëllimet e caktuara të mësimit të vlerësojnë veten, arritshmërinë e tyre. Vetëvlerësimi i bazuar në kritere të drejta, krijon bazë për të motivuar, përmirësuar dhe çmuar më tej arritjet në të nxënët e nxënësve.

Vetëvlerësimi i nxënësve bazohet në shkathtësitë intelektuale të nivelit të lartë që i përdorin ata për të vlerësuar mësimitin e tyre në aspektin e proceseve dhe rezultateve.

Vetëvlerësimi i nxënësve është proces me të cilin nxënësi mbledh informacion rreth vetes dhe reflekton mbi të mësuarit e vet, është vlerësimi i vetë nxënësit e progresit personal në njohuri, shkathtësi, procese apo qëndrime. Vetëvlerësimi çon një nxënës në një ndërgjegjësim më të madh dhe të kuptuarit e vetvetes ose veten si nxënës.⁶⁵

Vetëvlerësimi shpreh efektivitetin, vlerën e procesit që zhvillohet në institucion, vlerën e produktit, arritjeve dhe është rezultat i matjes, monitorimit të procesit ose produktit të tij.

⁶³ Black, P, & Wiliam, D. (1998). Inside the black box: Raising standards through classroom assessment. Phi Delta Kappan, 80(2), f. 143

⁶⁴ Hyseni, Halim (2003). Qeverisja dhe Udhëheqja në Arsim, KEC, Prishtinë, f.186

⁶⁵ Capacity Building Series: Student Self-Assessment (2007) (PDF) f. 1

Disa studiuës e trajtojnë vetëvlerësimin si gjykim përmbledhës, burim informacioni për programet e reja, program testesh që pasqyrojnë standardet e arritjes, testim diagnostifikues, formë e llogaridhënies, instrument menaxhimi dhe kontrolli, pjesë e rolit profesional të mësuesit që monitoron mbarëvajtjen, zhvillimin etj.

Koncepti i vetëvlerësimit shikohet nga dy këndvështrime:

Së pari, shihet si instrument menaxhimi dhe kontrolli dhe

Së dyti, si mjet për të nxitur profesionalizmin.

Vetëvlerësimi shtrihet kështu mes dy përdorimeve: vlerësim për llogaridhënie dhe vlerësim për zhvillim profesional. Vetëvlerësimi kontribuon kështu në zhvillimin e planit strategjik të institucionit. Ai ndihmon në identifikimin e nevojave për zhvillim profesional të punonjësve dhe përcaktimin e nevojave organizative.⁶⁶

2.1.PËRPARËSITË DHE DOBËSITË E VETËVLERËSIMIT TË NXËNËSVE NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR

Mendimi se jemi më të mirët na ndihmon që të kemi sukses në jetë: këtë e konfirmon një studim i publikuar në revistën shkencore “*Nature*” ku ekziston tendenca apo njerëzit janë të prirur për të mbivlerësuar veten.⁶⁷

Lidhur me përparësitë dhe dobësitë e vetëvlerësimit të nxënësve në arsimin parauniversitar, përvec literaturës, atëherë unë jam përpjekur që të paraqesë problemet që kanë të bëjnë me procesin e vetëvlerësimit të nxënësve bazuar në përgjigjet e nxënësve dhe

⁶⁶ Inspektorati kombëtar i arsimit parauniversitar (2011). Metodologjia e inspektimit dhe e vlerësimit të brendshëm të institucioneve arsimore parauniversitare. Tiranë f.26-27

⁶⁷ “Për vite me radhë, psikologët kanë vënë re se njerëzit janë të prirur të mbivlerësojnë veten dhe aftësitë e tyre”, thotë përgjegjësi i studimit *Dominic Johnson*, një biolog i evolucionit në Universitetin e Edinburgut në Skoci. Sipas disa studiuësve të tjerë, besimi i tepërt në vetvete është një karakteristikë pozitive, na nxit të bëhemi më ambiciozë dhe të vendosur. Megjithatë duke u bazuar te studimi, vetëvlerësimi mund të ketë edhe pasoja negative: mund të na shtyjë që të bëjmë vlerësime të gabuara dhe të marrim vendime të rrezikshme.

mësimdhënësve të anketuar në shkollat e mesme të ulta dhe në shkollat e mesme të larta, pra në dhjetë shkollat e cekura më lart. Të anketuar kanë qenë nxënësit nga klasa V-XII , filluar nga kjo moshë ngase konsiderohet si moshë më madhore dhe kanë njohuri për këtë proces që zhvillohet në sistemin edukativo-arsimor.

Përparësitë	Dobësitë
- Nxënësi bëhet më kritik dhe vetëkritik	- Nxënësi mund të mbivlerësojë veten
- Nxënësi shpreh sinqeritet gjatë vlerësimit të vetvetes	- Mund të jetë jo real
- Nxënësi i din të arriturat e veta, ata janë real	- Nënvlërëson të tjerët
- Shtytje për nxënie të vazhdueshme	- Përpiqet me qenë dominues ndaj të tjerëve
- Duke i parë rezultatet e veta, nxënësi çdo herë e nxit vetveten, është i lirshëm, nuk ngurron	- Duke e vlerësuar veten mund të nënvlërësojë veten
- Zbulohen talentet, shkathtësitë	- Mundësi e të mos shprehurit
- Nxënësi ndihet përgjegjës dhe në vlerësim e shpreh opinionin e tij	- Disa nxënës mund të ngrisin duart lart duke i thënë vetes se “Unë nuk di asgjë” dmth., dorëzohen.
- Nxënësi e din që për të qenë i mirë duhet të mësojë më shumë për rezultate më të mira	- Mund të lakmoj dhe mos të vlerësoj drejtë
- Nxënësi arrin të vlerësoj veten, arrin suksese më të mëdha në mësim dhe në jetë	- Mos angazhimi, ngurrimi
- Besimi në vetvete	- Numri i madh i nxënësve dhe ata shpesh janë jashtë nxënies së informacioneve
- Gjatë vlerësimit të vetes nxënësi arrin më shumë suksese	- Hulumtimi i ideve të reja
- Fiton shkathtësitë, talentin, disiplinën në punë, angazhimin...	- Atëherë të gjithë nxënësit do të kenë dëshirë për vetëvlerësim dhe kjo nuk është metoda më e mirë.
- Angazhimi dhe puna e nxënësit	
- Qasja e nxënësve në debate e diskutime të ndryshme	

- E njohin vetveten	
---------------------	--

Tabela 2. Opinionet e mësimeve lidhur me përparësitë dhe dobësitë e vetëvlerësimit të nxënësve

Nga përgjigjet e mësimeve shihet se vetëvlerësimi nga ana e nxënësve ka më shumë përparësi sesa dobësi. Përparësia më e madhe është se nxënësit gjatë vlerësimit për veten mësojnë të mendojnë në mënyrë kritike, e zhvillojnë logjikën, aftësitë shprehëse dhe të menduarit krijues. Gjatë vlerësimit të vetes ata e njohin vetveten, fitojnë vetëbesimin, motivohen për punë të mëtutjeshme dhe arrijnë rezultate në mësim si dhe në jetën në përgjithësi. Ndërsa si dobësi është se ka mundësi që gjatë vetëvlerësimit nxënësit të mbivlerësojnë veten, nganjëherë mund të mos jenë real kur vlerësojnë. Poashtu, nxënësit mund edhe të nënvlerësojnë veten duke menduar se ata nuk din asgjë dhe nuk e kanë këtë të drejtë.

Ndërsa, disa nga opinionet e nxënësve lidhur me përparësitë e vetëvlerësimit të tyre janë:

Nx.1: Besimi në vetvete;

Nx.2: Nxitje për sukses;

Nx.3: Shprehja e lirë e mendimit që rezulton me sukses;

Nx.4: Njohja e vetvetes;

Nx.5: Bashkëpunimi dhe komunikimi i arsimtarëve me nxënësit;

Nx.6: Vetëvlerësimi i drejtë;

Nx.7: Mund të shohim deri ku kemi arritur (njohim rezultatet dhe ngecjet tona);

Nx.8: Kur krahason veten me të tjerët, ai është në një gjendje të dijes shkathtësitë që posedon.

Dobësitë e vetëvlerësimit sipas nxënësve janë:

Nx.1: Nxënësi mund të mbvlerësojë veten, gjë e cila nganjëherë të bën të dështosh;

Nx.2: Nxënësi mund të jetë jo real gjatë vetëvlerësimit;

Nx.3: Ngritja shumë e lartë e vetëbesimit që jep si rezultat vetëvlerësim të gabuar apo superior për veten;

Nx.4: Nënçmimi i nxënësve të urtë;

Nx.5: Mungesa e vetëbesimit;

Nx.6: Nuk ka dobësi.

Nga opinionet e nxënësve shihet se vetëvlerësimi i nxënësve ka më shumë përparësi se sa dobësi, ku një pjesë e tyre konsiderojnë se vetëvlerësimi nuk ka dobësi fare.

Përparësia kryesore e vetëvlerësimit sipas tyre qëndron në atë se ata fitojnë vetëbesimin, e njohin vetveten ku me shprehjen e lirë të mendimit ata nxiten, motivohen për rezultate të mëtejme. Poashtu, edhe garat në mësim me shokët/shoqet e klasës i shtyjnë ata të bëjnë krahasime dhe të gjejnë më lehtë tek vetja shkathtësitë dhe mangësitë në mënyrë që të dijnë ku dhe çfarë të bëjnë përmirësime.

Dobësia kryesore sipas nxënësve konsiderohet se nxënësit mund të mbivlerësojnë veten, të lakmojnë për notë më të lartë, por ka raste të atilla kur nxënësit nuk shprehen shumë dhe e nënvlerësojnë veten duke mos besuar në potencialet dhe aftësitë e tyre.

KONKLUIZION

Ky hulumtim është realizuar në disa nga shkollat e mesme të ulta dhe shkolla të mesme të larta në pesë vende të Kosovës si në: Prishtinë, Gjakovë, Klinë, Istog dhe Deçan. Në secilin qytet janë marrë nga dy shkolla: një shkollë e mesme e ulët dhe një shkollë e mesme e lartë.

Nga rezultatet e hulumtimit del se vetëvlerësimi i nxënësve ka më shumë përparësi, e më pak dobësi. Përparësia shihet në atë se nxënësit shprehen më lirshëm nëse u jepet kjo mundësi,

fitojnë vetëbesimin se kanë vlera e virtyte të fuqishme të cilat i nxisin për rezultate si në mësim poashtu edhe në jetën në përgjithësi. Dobësia kryesore shihet se nxënësit mund të mbivlerësojnë apo edhe të nënvlerësojnë veten, pra duke ekzistuar të dyja mundësitë.

Referenca:

1. Black, P & Wiliam, D (2011). Inside the Black Box. King's College, London;
2. Black, P, & Wiliam, D. (1998). Inside the black box: Raising standards through classroom assessment. Phi. Delta Kappan, 80(2);
3. Blanchard, J (2002). Teaching and targets: Self-evaluation and school improvement” RoutledgeFalmer;
4. Brooks, V (2002). Assessment in Secondary Schools” OUP;
5. Hyseni, H (2003). Qeverisja dhe udhëheqja në arsim. Prishtinë: KEC;
6. Inspektorati kombëtar i arsimit parauniversitar (2011). Metodologjia e inspektimit dhe e vlerësimit të brendshëm të institucioneve arsimore parauniversitar. Tiranë;
7. James, M (1998).Using assessment for (Secondary) School Improvement.Heinemann;
8. Lausset, R.(2004). Doracak i vetëvlerësimit. I.M.PACT - Aplikimi i metodologjisë për iniciativat e edukimit për demokraci qytetare të Paktit të Stabilitetit;
8. MASHT (2007). Strategjia për zhvillimin e arsimit parauniversitar në Kosovë 2007-2017. Prishtinë;
9. MASHT.(2011). Korniza e kurrikulës e arsimit parauniversitar të Republikës së Kosovës. Prishtinë;
10. Raporti i vetëvlerësimit (2011). SH.M.P.”Fehmi Agani” Klinë;
11. Secondary Assessment Practice (2001). Evaluation and Development Materials. AAIA;
12. Sutton, R (1991). Assessment – A framework for teachers, NFER Nelson;

Burimet nga interneti:

- [http:// www.gtce.org.uk](http://www.gtce.org.uk)-General Teaching Council website's research of the month June 2001;
- <http://www.assessment-reform-group.org.uk>- latest ideas from the Assessment Reform Group;
- [http:// www.slamnet.org.uk](http://www.slamnet.org.uk) - Suffolk LEA assessment website;
- http://www.informnorth.com/pdfs/2005/Nov_Dec05.pdf;
- <http://www.teachingkidsbusiness.com/entrepreneurship-program-what-it-takes.htm> ;

AAIA North East Region *Self Assessment* (Available at www.aaia.org.uk/);
http://www.ikub.al/FEMRA_CATEGORY/1201280018/Article-Mbivlerësimi_i_vetes_si_ndikon_te_ne.aspx ;
http://www.nasergashi.com/t2902-vetevleresimi_ure-perparimi-per-ne.

ALBANIAN LITERATURE IN HIGH-SCHOOL BOOKS, IN KOSOVO**Mr. Safete Statovci-SHALA**

Pedagogical Institute of Kosovo

safete.shala2@hotmail.comsafete.shala@rks-gov.net**ABSTRACT**

Albanian literature textbooks have a very important role in the planning and evaluating of teaching and learning. Literature textbooks for secondary senior education for students from classes X - XII are of great importance for the development of the subject of literature. The object of the textbook literature compiled based on the Curriculum of Education of the Republic of Kosovo and the plans and programs for Albanian Language and Literature approved by the Ministry of Education, Science and Technology of the Republic of Kosovo.

From the research goals of this theme, ranging from the intrinsic related to obtaining knowledge of the literary periods of national and world literature, are systematically learning of other knowledge from the theory of literature, culture the writing, the culture of speaking, and the aesthetic experience of a literary text. A total of 658 respondents were included in this survey in seven regions of Kosovo, twelve questions for teachers and also twelve questions for the pupils. While the percentage of responses to questions for discussion is seen the different opinions of the gymnasium textbooks, because it shows high disagreement with state teacher of literature texts, claiming that many things have changed in the selection of literary representation in textbooks. So at work I used the method of theoretical analysis, descriptive and the comparative method, then inductive-deductive and the statistical method. By comprehensively analyzed from multiple competent entities of different perspectives and, even by professors and high school students, however, it is deemed to consider the possibility that these texts changed their design criteria to undergo advanced professional, scientific and technical research.

Keywords: *Literature, Research, Gymnasium Textbook.*

INTRODUCTION

Albanian literature textbooks have a very important role in the planning and evaluation of teaching and learning. Literature textbooks for secondary education for students of classes X - XII are of great importance for the development of the subject of literature. The object of the textbook literature compiled is based on the Curriculum of Education of the Republic of Kosovo and the plans and programs for Albanian Language and Literature approved by the Ministry of Education, Science and Technology of the Republic of Kosovo.

Planning and development of the literature curriculum in learning and evaluation are particularly important for the successful implementation of the learning process. Planning literature is considered successful when the inclusion of the literary contents, topics and units of targeted programming. The success of the work relies on proper planning of the subject of literature. The subject of literature should have a more comprehensive discussion programs and textbooks for secondary education. Selection should be made with sustainable planning and evaluation. Education reform should also include access to innovation and modern interpretation on the literature and must be new trend in the culture of expression. Contents of literary programs have created a new environment in the cultural values of literature, although the subject literature has plenty of room for review, selection and interpretation of it.

1. THE OBJECT OF STUDY

The objects of this study are textbooks of high school literature for the period 2000 to 2010, with particular emphasis on those that are currently in use. This has its justification because since 2004, they have been reprinted and texts that are being used at present, so that the approach of the earliest ones or those that are in use later, since 2007, can identify changes, both positive approach to interpretation, the inclusion of periods or even literary writers selected to represent worthily a literary period or a particular literary gender.

2. INVOLVEMENT IN METHODOLOGICAL PROBLEM

2.1. The purpose of the research

From the research goals of this theme, ranging from the intrinsic related to obtaining knowledge of the literary periods of national and world literature, are systematically learning of other knowledge from the theory of literature, culture the writing, the culture of speaking, the

aesthetic experience of a literary text that enriches students' emotional world, which creates spiritual pleasure in reading it, which is also the basic element that distinguishes works of literature from other fields of art. Artistic impressions that students gain in reading literary influence in their intellectual sensibilities. Emotional state of mind that created the literary reading has the highest weight, which serves as the impetus for new readings, thus realizing the main function of literature, the aesthetic, instilling a sense of beauty.

3. RESEARCH METHODS

This study did attempt to implement modern scientific methodologies based on the study of literature. We tried to apply these methodologies as faithfully as could be by carrying out in an objective and more advanced approach and serve as an overall scope of this study. Of course, I do not pretend that I have achieved the goal completely, but for good measure I believe that I have come to realize the objectives of the study on the basis of the most appropriate methods, which have had an impact on the achievement of certain ends. So at work I used the method of theoretical analysis, descriptive and comparative method, then inductive-deductive and the statistical method. Each of these methods has been used of research and extent, I think that it gives the desired result, so it is implied that not all methods are used in all chapters equally.

3.1. Survey research questions

Research questions of this study include:

1. Selected literary texts in the books of literature or that arouse your interest for reading and interpretation.
2. What is the general condition, quality of literature textbooks in Kosovo gymnasiums?

4. INVOLVEMENT IN LITERATURE TEXT BOOKS

Before you ask a series of questions about literature textbooks, contents and their involvement in the school curriculum, I think it is appropriate to present, however briefly a history textbooks in Albanian. No doubt that the history textbooks in Albanian language is directly linked and dependent on the fate of the people, such as general historical, social, political, cultural, educational processes, which are the heel of economic development, in a word,

it appears closely related to our national life through the centuries.

4.1. Literature and schools

Based on the plans and programs of Albanian literature in our schools, but also those of Albania, Macedonia and Montenegro, "there is a unified terminology, which will be preceded by a common unifying attitude about literary contents, especially about the terminology how we call our national literature: Literature in Albanian or Albanian literature." We say this because in various literary texts used again we find literature in Albanian, Albanian literature of time; however that is why it is implicit.

4.2.1. The importance of the textbook

By giving the huge impact of textbooks in the formation of students, and in particular that of literature, then the social responsibility of professional writers of literary texts is great. So the writers of literature must adhere to strict criteria of literary representation in its entirety, especially considering the representation of values achieved national literature. This is because the messages conveyed in the value of sound and sustainable management of students taking the best information possible about the creativity of the people, in our case, the Albanian people. Therefore units represented should be representative and selected because of their impact on the overall formation of youth and change their consciousness is large and sometimes decisive way.

5. ANALYSIS AND RESEARCH RESULTS

The research included 10 gymnasiums in different regions of Kosovo, a total of 658 respondents (participants), of which 458 students and 200 teachers. The research was conducted at Schools such as: "Sami Frashëri" and, "Xhevdet Doda" in Pristina, "Zejnel Hajdini" in Gjilan, "Hivzi Sylejmani" in Fushë Kosova, "Alexander Xhuvani" in Podujeva Gymnasium, "Bedri Pejani" in Peja, "Luigi Gurakuqi" in Klina, "Skenderbeu" in Drenas, "Xhon Buzuku" in Prizren "Abdul Frashëri" in Malisheva. Taken into account the views and suggestions of students and teachers about textbooks, are they functional? What would you change in textbooks? and Should literature be an authentic text of the literary school?, How satisfying are the actual texts of

literature?, Is making the right choice of topics in literature in high school textbooks, the students get literary culture?, etc. From all opinions and thoughts we shall see the following. This survey was conducted in two categories: one is drawn in questions for teachers, based on their professional profile, so their answers were given special attention. In this survey they were given 12 questions, for which we have expected competent response to issues raised.


5. 1. Data on student questionnaires

Even in developed questionnaires for students, from more focused questions are only a few of them, the ones that have tried to have greater weight to relevant topics. We may say that the results are generally expected to show a healthy learning process, with few exceptions, that in the future remain to be addressed to change the situation.

1. How do you rate during your use of the literature and a book, is it appropriate for your age?

While the question of the 200 responses or 64% of them responded positively, the other 36% of them responded negatively. This indicates a positive state of teaching in schools.

question	percentage %	students
How do you rate during your use of the literature and a book is it appropriate for your age?		
a/Yes	64	
b/No	36	
Number of students in this survey		200



6. QUESTIONNAIRAS FOR TEACHERS


This survey was conducted in two categories: one is drawn in question for teachers, based on their professional profile, so their answers were given a special attention. In this survey there

were given 12 questions, of which we have expected a competent response to issues raised. So the question how teachers are satisfied with the quality of high school literary texts from three possible alternatives answers they have been surprisingly equal. Also in question: Is the selection appropriate or not in learning contents in textbooks, suddenly more than double of them responded that it was not (see attached table), which proves that teachers are not satisfied with the inclusion of literary contents on these texts. While the questions in texts are loaded with terms of literary expression that are not understood by students, teachers surprisingly most are of the opinion that they are .

1. How functional are the curriculum of literature in gymnasium textbooks?

Answers to the first question are the following table and graphical representation. It means that 62% of respondents think that the literature curriculum in gymnasiums and in textbooks is less functional, while 30% said that it is functional and only 8% think that this program is not functional.

Questions	How are functional are the curriculum of literature in gymnasium textbooks?	percentage%
	a) Not much	62
	b) Very much	30
	a) Not at all	8
	Number of students in this survey	100%




2. Are you satisfied with the textbooks of literature, you work with?

Surprisingly percentages of responses to this question are as equal as yet shown that

something is wrong, because there are many disagreement with the current text, which must be addressed in the future by competent organs.

Questions	Are you satisfied with the literature textbooks you work with?	percentage %
s	a) Partly	33
	b) Average	34
	c) Completely	33
	Number of students in this survey	100%



CONCLUSION

During the elaboration of this theme have also been encountered problems of objective and subjective nature, because it was not easy to judge, the texts that have a tradition of use in our school system. However, by analyzing comprehensively, from different perspectives and from multiple competent entities, even by professors and high school students, however, it is deemed to consider the possibility that these texts and their design changed to undergo advanced criteria professions existing literature textbooks for all levels of high school, despite the fact that they have an acceptable level of professional, scientific and technical tradition of use, because their writers mostly have in mind to comply with the requirements of the curriculum, they also follow the defects of numerous concessions;.

- Alleged omissions, such as the exclusion of some Albanian writers of different periods can be eliminated in the future. This is because the objective, because it is understandable that not everyone can be included as a writer of all time periods, so that the selection criteria imposed as necessary, in order not to appear voluminous text.
- Even this criterion is easily feasible in the design of new textbooks; compilers have enough to reduce in teaching units for foreign authors and do attempt to include units from popular literature, i.e. other genres in this area, such as anecdotes.
- Use of a sometimes difficult language, the expressions in question, the foreign words, the terms of unnecessary scientific and construct syntactic structures not in compliance with the standard of professional care less eagles could be eliminated in future texts literary. It would be necessary in addition to literary editors; texts pass through the hands of editors of selected language.
- Number of hours learning the language and literature is necessary to add. This is because the fund's of current hours, taking into account holidays and other objective circumstances in school, then the large number of existing educational topics is impossible their realization, so that more hours for at least one hour more indispensable as an imperative comes before the competent institutions of education in Kosovo.

References:

1. Qosja R.: “Letërsia shqipe në shkolla dhe në fakultete”, punim në përmbledhjen me të njëjtin emër të Institutit Albanologjik, Prishtinë, 2008, fq. 11 ;
2. Agalliu F. : “Tekstet e gjuhës shqipe të shkarkohen nga gjërat e tepërta dhe të jenë të sakta”, Mësuesi, Tiranë 1967 ;
3. ASHAK, ASHSH: “Historia e letërsisë shqipe”, Prishtinë, 2010;
4. Aliu, Ali, Ese letrare, Rilindja, Prishtinë, 1987;
5. Aliu, Ali: “Teoria e letërsisë”, Prishtinë 2001;
6. Altimari, Françesko: Vëzhgime gjuhësore dhe letrare arbëreshe, “Shpresa” & “Faik Konica”, Prishtinë, 2002;
7. Bullo, Jorgo: Magjia dhe magjistarët e fjalës, Tiranë ;
8. Devetaku –Gojani H.: “Gjuha shqipe në tekstet shkollorë”, Prishinë, 2007;

9. Hyseni H. Meta N. Salihu J. Pupovci D.: “Qeverisja dhe udhëheqja në arsim”, Prishtinë 2003;
10. Historia e letërsisë botërore, 1-7, Rilindja, Prishtinë, 1984-1987;
11. Historia e letërsisë shqipe I, Universiteti Shtetëror i Tiranës-Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, Tiranë, 1959;
12. Historia e letërsisë shqipe II, Universiteti Shtetëror i Tiranës- Instituti i - Historisë dhe i Gjuhësisë, Tiranë, 1960;
13. Instituti Albanologjik i Prishtinës: “Letërsia në shkolla dhe në fakultete”, Prishtinë 2008;
14. Instituti i Studim- Historia e letërsisë shqiptare, Akademi e Shkencave e RPS të Shqipërisë e ve Pedagogjike: “Hartimi dhe vlerësimi i letërsisë shkollore”, Tiranë 2003;
15. Karamitri E, Petriti K., Murthi L., Pepa V. : ”Letërsia në shkollë”, Tiranë 2001;
16. Rexhepi N.: “Metodikë e gjuhës shqipe”, Prishtinë;
17. Ramaj A.: “Formësimi didaktik i lëndës në tekstin mësimor”, Prishtinë 2001;
18. Rrahmani Z.: “Teoria e letërsisë”, Prishtinë, 2008.

Materials from internet:

1. [portali albanologjik Shqipëri – Kosovë;](#)
2. www.see-educoop.net/...in/.../reforma_kurikuluma-cro-hrv-t;
3. [www.see-educoop.net/...in/.../reforma_kurikuluma-cro-hrv-t ;](http://www.see-educoop.net/...in/.../reforma_kurikuluma-cro-hrv-t)
4. [http://pedagogjia.ëordpress.com/didaktike/pershtatja-e-te-mesuarit-moshes-se-nxenesve-parim-i-rendesishem-i-mesimdhënies-dhe-te-nxenit/.](http://pedagogjia.ëordpress.com/didaktike/pershtatja-e-te-mesuarit-moshes-se-nxenesve-parim-i-rendesishem-i-mesimdhënies-dhe-te-nxenit/)

KOMPONENTËT PSIKOLOGJIKË QË PËRBËJNË TALENTIN NË LETËRSI

Dr.Skënder DEMALIAJ

Shef i Departamentit të Shkencave Politike dhe Administrative

skender.demaliaj@umsh.edu.al, Cel: 0682468339

Dr.Luljeta KODRA

Shefe e Departamentit të Drejtësisë

luljeta.kodra@umsh.edu.al ,Cel: 0692122174

Dr. Zhaneta SALIU,Lektore

ShLP Mesdhetare e Shqipërisë

anisanoemi1@libero.it, Cel: 0692074549.

ABSTRAKT

- Dallimi nxënës i zgjuar dhe i talentuar.
- Faktorët gjenetikë, socialë, ekonomikë, psikologjikë, pedagogjikë (arsimorë) që luajnë rol tek talenti:
 - Aftësia shumë e mprehtë dhe e madhe e të vërejturit.
 - Të mësuarit është një nga bazat më të fuqishme për zhvillimin e aftësisë dhe talentit në çdo drejtim.
 - Interesat e gjëra dhe të shumta.
 - Pasioni i zjartë për të shkruar.
 - Fantazia (ndërtim i veçantë mendor që vjen natyrshëm prej botës së pavetëdijes dhe prej vetëdijes individuale).
 - Frymëzimi, ndjenjat, të menduarit artistik, meditimi.
- Puna e individit dhe e shkollës për zhvillimin e talentit në letërsi.
- Përfundime.
- **Fjalë kyçe:** *Vrojtimi, të mësuarit, interesat e gjëra, fantazia dhe meditimi, ndjenjat dhe të menduarit artistik.*

HYRJE

Mësuesi që punon me talentet duhet të jetë krijues, ku dijet që u jep nxënësve të mos jenë të gatshme, por t'u transmetohen në atë mënyrë që të mund të punojnë vetë, të vëzhgojnë vetë,të kërkojnë ta gjejnë vetë dijen. Për mësuesin nuk mjafton vetëm të ketë dëshirë, por edhe pasion, nuk mjafton të ëndërrojë diçka, por duhet të jetë i gatshëm të bëjë atë që është e domosdoshme

për të arritur qëllimin e tij. Nuk mund të ndezësh zjarrin krijues në shpirtin e fëmijës pa qënë vetë i tillë. Ai që nuk është pishtar vetë, s'mund t'i bëjë të tillë të tjerët. Nisur nga kjo sintezë e njerëzve të mëdhenj, puna e mësuesit me talentet e reja, është një detyrë e rëndësishme dhe me përgjegjësi, me të cilat duhet të punojë me përkushtim, të studiojë, të studiojë vetë mësuesi, të kualifikohet e të rikualifikohet. Përpunimi shkencor pedagogjik i formave dhe i metodave në punën me nxënësit e talentuar, i përgatitjes së tyre për veprimtari njohëse e praktike të pavarura, i rrugëve dhe i mjeteve për aftësimin dhe pajisjen me bazat fillestare të metodikës për të hyrë në rrugën e krijimtarisë artistike në të ardhmen - është detyrë parësore dhe e ngutshme e shkollës sonë.

Në Kushtetutën e Japonisë thuhet: “Të gjithë njerëzit kanë të drejtë të marrin arsim të barabartë sipas aftësive të tyre”, kurse në Kushtetutën e Zvicrës: “Është e drejta e pamohueshme për çdo fëmijë dhe qytetar të marrë arsim deri në kufijtë maksimale të kapacitetit të tij” (Grup autorësh, 1995: 10).

I

KOMPONENTËT PSIKOLOGJIKË QË E PËRBËJNË TALENTIN NË LETËRSI

Para shkollës shtrohet pyetja: “Ç’është talenti letrar dhe cilët janë tërësisht dhe individualisht komponentët psikologjikë që e përbëjnë atë?”

Krijuesi është një njeri i kohës së vet. Në shpirtin e tij animë është mbledhur një botë e tërë, me të cilën dhe në të cilën ai jeton. Me këtë lidhen edhe komponentët psikologjikë që e përbëjnë talentin e tij:

- **Aftësia shumë e mprehtë dhe e madhe e të vërejturit** -Vrojtimi është komponent thelbesor psikologjik, është një vrojtim specifik, një vrojtim permanent që i sheh të gjitha bukuritë e botës me syrin e përshkrimit artistik, të harmonizuara gjithnjë me probleme të imagjinatës. Syri sheh dhe aty për aty imagjinata krijon produktin origjinal artistik që nuk e ka krijuar njeri më parë (Dedja,1998:47-48).

Gëte shkruante: “Objektivitetin e poezisë sime ia detyroj aftësisë për të vëzhguar dhe ushtrimeve të syrit, sikundër natyrisht edhe dijenive që fitova në sajë të tyre”. Balzaku vetë e pranonte se dallohej nga një aftësi e madhe për të vëzhguar. “Komedia njerëzore” përfshin afro 100 romane, novela, tregime, ese, komedi. Dhuntitë e tij të vëzhgimit të jetës që e

rrethonte dhe të imagjinatës e bëjnë atë njërin nga shkrimtarët më të mëdhenj të shekullit të vet. 559 personazhe tek romani “Lufta dhe paqja” nuk mund të realizohen pa një aftësi vëzhguese të mprehtë dhe depërtuese në psikologjinë e personazheve. Të vëzhgosh do të thotë të dallosh çdo gjë që ndodh përreth, të fiksosh shikimin ose dëgjimin në një send që ka rëndësi, të “fotografosh” ndodhi e ngjarje e t’i ruash ato në magazinën e kujtesës. Baza e përfytyrimeve, e kujtesës, e të menduarit dhe e imagjinatës janë vrojtimet e drejtpërdrejta të realitetit objektiv. Është kjo arsyeja që Leon Tolstoi në veprat e tij ka arritur të përshkruajë 85 nuanca të shprehjes së syve dhe 97 nuanca të buzëqeshjeve, të cilat zërthejnë gjëndjet emocionale të personazheve të tij (Freud, 2000: 19). Krijuesi e ka të zhvilluar aftësitë perceptuese dhe vëzhguese, aftësitë analitike dhe përgjithësuese, shfaq aftësi të mëdha për punë mendore, ka natyrë autoritare, mund të karakterizohet nga sjellje agresive kur nuk arrin suksesin, sepse është i vetëmjaftueshëm, pak frenues në disa drejtime, joformal dhe i pavarur në punë, nuk kënaqet lehtësisht, motivohet nga kurioziteti dhe nga prirja për të qenë i suksesshëm në punën e tij. Migjeni, pikërisht se është vëzhgues i thellë dhe i hollë i jetës shqiptare e pasqyron atë me ngjyrimet e saj, me kontradiktat dhe problemet e saj, duke na dhënë pamje që të rrënoqethin e të trishtojnë.

➤ **Të mësuarit është një nga bazat më të fuqishme për zhvillimin e aftësisë.**

dhe talentit në çdo drejtim- Është e domosdoshme njohja e thellë shkencore përmes të mësuarit të përmbajtjes dhe të natyrës së procesit krijues. Kjo edhe për vetë krijuesit, edhe për ata që punojnë me ta. Sa më intensive të jetë veprimtaria mësimore-edukative, aq më e madhe është mundësia për zhvillimin e fëmijës, aq më të lartë treguesit e këtij zhvillimi në fushën e aftësive. Kjo përbën edhe thelbin e ligjit të intesitetit të veprimtarisë psikike.

➤ **Interesat e gjëra dhe të shumta-** Viktor Hygoi dhe Majakovski janë edhe poetë, edhe piktorë. Sartri edhe shkrimtar, edhe filozof. Emil Zolai dhe Mitrush Kuteli edhe shkrimtarë edhe ekonomistë. Faik Konica shkrimtar, edhe publicist, edhe etnograf, edhe kritik. Fan Noli poet, historian, përkthyes, kritik letrar dhe studiues i muzikës, politikan, prift. Gjergj Fishta shkrimtar, gjuhëtar, publicist, etnograf, sociolog etj. Dritëro Agolli, shkrimtar, politikan, kritik letrar, përkthye.

➤ **Pasioni i zjartë për të shkruar-**Shumë bukur e jep këtë poeti i madh hungarez Petefi në vjershën “Ti deshe...”:

“Ti deshe, o baba!
Zanatin tënd të kisha marrë,

të bëhesha kasap në këtë dynja,
por ja që dola një shkrimtar.

Ti me hanxharin çaje bagëtinë,
ndërsa me pendë unë ligësinë.
Mos u mërzit, o ati im,
vetëm në emër ka ndryshim”.

Anatol Fransi në veprën “Krimi i Silvester Bonarit” është shprehur: “Pasionet janë armiqtë e qetësisë. Pa to në botë nuk ka as industri, as arte, as shkencë”.

➤ **Fantazia (ndërtim i veçantë mendor që vjen natyrshëm prej botës së pavetëdijes dhe prej vetëdijes individuale)**-Frojdi porosiste që t’i kërkojmë që në fëmijëri gjurmët e para të fantazisë poetike. Me fantazinë lidhet imagjinata dhe ëndërrimet, lloji i veçantë i imagjinatës aktive që drejtohet kryesisht nga e ardhmja, nga perspektiva, nga ajo që një individ do të dëshironte të shihte të kthyer në realitet (Orhani, 2003: 187). Imagjinata është mënyra me të cilën Viktor Hygoi komunikon me gjithçka. “Onegini” është krijimi më i përzemërt i Pushkinit, është pjella më e dashur e fantazisë së tij.

➤ **Frymëzimi (tregues i entuziazmit që provohet në jetë, rrjedhë e akumulimit dhe e përpunimeve të mjaftueshme që bëhen rreth përvojave personale)**- Për Çajkovskin “Frymëzimi është një mikeshë e tillë, e cila nuk dëshiron të vizitojë dembelët. Ajo shfaqet tek ata që e vizitojnë atë”, kurse për V.Johanson “Frymëzimi është frymëzim, por nën të shtrihen zanati, shkolla, metoda”.

➤ **Ndjenjat (ndjenjat e krijuesit të madh i ngjajnë vullkanit)**- E tillë është poezia e Majakovskit, e Eseninit, e Uitmanit etj. Nën ndikimin e ndjenjave të fuqishme dhe të ideve shpërthen hovi krijues i njeriut.

➤ **Të menduarit artistik**-Krijuesi udhëhiqet në krijimet e tij nga një përmbajtje e caktuar intuitive. Në vetëdijen e krijuesit bëhet pasqyrimi i realitetit, pastaj transformimi në një krijim artistik. Figura artistike është bartëse e të veçantës, konkretes dhe njëkohësisht është një përgjithësim. Në krijimtari kemi (si operacion mendor), arsyetimin dhe ballafaqimin me realitetin.

➤ **Meditimi - veçori dalluese e krijuesit - lat. meditatio = përsiatje**- Katër stadet e meditimit (Anondamitia, 2001: 72-73):

1. Stadi i vështirësisë kur duhet ushtruar shumë përpjekje për të qetësuar dhe

kontrolluar valët e trazuara dhe të përhapura të mendjes.

2. Stadi i arritjes kur mendja arrin përqëndrimin e plotë dhe përjeton një gjëndje më të lartë të ndërgjegjes.

3. Në stadin e tretë nëpërmjet përqëndrimit të rregullt dhe intensiv, mendja bëhet koherente dhe zhvillon fuqitë psikike.

4. Stadi, ku një lumturi e papërshkrueshme lind nga çdo fibër e qënies.

➤ **Puna dhe vetëm puna është çelësi i suksesit-1% talent,99% punë.**Sipas psikologëve njerëzit me vullnet të fortë e kalojnë me sukses detin e jetës, kurse ata me vullnet të dobët vetëm lahen në të. Viktor Hygoi thoshte “nuk duhet të ndërpresësh një ditë punën në krijimtari”. Ky dallohet për vullnetin dhe dëshirën e tij për t’u afirmuar me çdo kusht. Në vitet e rinisë shprehej: “Dua të bëhem Shatabrioni ose asgjë”. Kur u bë i famshëm Rubeishtani dikush e pyeti: “Tani që arrite kulmin e artit a vazhdon të studiosh?” Ai u përgjigj: “Po të rrija një ditë pa studjuar do ta kuptoja vetë. Në rast se do të rrija dy ditë do ta kuptoja edhe ti. Në rast se do të rrija tre ditë do ta merrte vesh i tërë publiku (Demaliaj, 2002: 22).

Mbi një gjysëm shekulli punoi Gëte për kryeveprën “Fausti”. Varianti i parë i komedisë “Tartufi” u shkrua, më 1664 dhe vetëm pas 5 vjetësh, pasi e përpunoi disa herë, e shfaqti atë para publikut të gjërë. Floberi është ndër shkrimtarët më kërkues në fushën e përsosmërisë artistike. Ai i përpunonte për një kohë shumë të gjatë veprat e tij para se t’i botonte. Për romanin “Ringjallja” të Tolstoit në një dorëshkrim studiuesit kanë gjetur mbi 90 variante. Për Çehovin “artisti duhet të punojë gjithnjë dhe të mëndojë gjithnjë, pasi ndryshe nuk mund të jetojë”. Krijuesit e mëdhënj kanë pohuar se po pushove së shkruari, shpejt mund të ç’mësohesh. Çdo veprimtari kërkon punë, vëmëndje dhe studim, kurse letërsia jo më pak, ndoshta më shumë se të tjerat.

Sipas Maksim Gorkit “talenti zhvillohet nga ndjenja e dashurisë për punën, madje ndoshta talenti në thelb është vetëm dashuria për punën, për procesin e punës (Grup autorësh, 1962: 344). Gjeniu dhe aftësia për punë janë si dy motra që ecin bashkë. Pa punë nuk mund të njohësh talentin. Para së gjithash duhet të punosh, por pa talent nuk mund të ecësh larg (Çehov, 1994: 285). Si përfundim mund të themi se puna dhe kërkesa për veprimtari - janë faktorë të rëndësishëm për edukimin e aftësive.

KONKLUZION

Punë krijuese, e motivuar, e kualifikuar dhe me pasion e mësuesit të letërsisë më nxënësit e talentuar.

Talenti është si ai prushi që rri poshtë hirit të vatrës. Duhet ta fshish, ta pastrosh që ai të shkëlqejë si një margaritar i madh (Dedja, 1998: 24).

Me talentet e reja duhet punuar mbi baza shkencore dhe pedagogjike, me një sistem punimesh e detyrash të shkallëzuara dhe individuale. Mësuesi i letërsisë është shoqëruesi i parë i shkrimtarit të ardhshëm. Puna me nxënësit në shkollë kalon përmes katër etapave:

Etapa e parë, ajo e zbulimit të talentit. Për këtë është e domosdoshme:

- Njohja e natyrës psikologjike të aftësive (dispozitat dhe aftësitë, aftësitë e larta të përgjithshme intelektuale, aftësitë e larta krijuese, aftësitë e larta speciale për gjuhë e letërsi, talenti në krijimtari letrare, për teatrin, filmin, muzikën dhe artet figurative).
- Bashkëpunimi me prindërit për t'i evidentuar, për të njohur edhe temperamentin e tyre (fëmijët e talentuar emocionalisht janë më të ekuilibruar, më pak agresivë).

Etapa e dytë, ajo e studimit të personalitetit, ku merr pjesë psikologu, mësuesi, mjeku, punonjësi social, ekspertët e specializuar për probleme gjuhësore e artistike.

Etapa e tretë, ajo e konstatimit dhe e veprimit pedagogjik (interpretimi pedagogjik i përfundimeve të nxjerra për fëmijët e zgjuar për gjetjen e modaliteteve pedagogjike dhe didaktike-metodike për zhvillimin intensiv të tyre). Mësuesi duhet të njohë dhe të aftësohet për përdorimin e testeve të inteligjencës së përgjithshme, të aftësive të posaçme speciale, të aftësive krijuese, të aftësohet për vlerësimin e produkteve të nxënësve nga krijimet artistike, nga përpjekjet për gjurmime shkencore, të aftësohet për komunikimin me nxënësit e talentuar.

Etapa e katërt, ajo e zhvillimit dhe e afirmimit të talenteve.

Mësuesi që punon me nxënësit e talentuar nuk mund të ketë sukses pa njohur thellë veçoritë e përgjithshme dhe individuale të zhvillimit psikik të grupmohave dhe të nxënësve të ndryshëm dhe me ndërtimin e procesit të të mësuarit mbi këtë bazë dhe me forcimin e rolit të tij në stimulimin dhe drejtimin e këtij zhvillimi (Revista pedagogjike, 1982: 32).

Rrethi letrar në shkollë mund të jetë me 4-5 nxënës (edhe me një nxënës). Ky mund të jetë në bazë klasash, atje ku janë mundësitë. Nga viti në vit, jo programe dhe kërkesa të njëjta,

pasi nxënësit kanë një zhvillim intensiv më të lartë fizik dhe psikik nga viti në vit. Mësuesi gjithashtu duhet të shmangë përsëritjet dhe njohuritë që nxënësit i marrin në kanale të tjera informative jashtë shkollës (mbi bazën e tyre mund të organizojë debate e diskutime).

Zhvillimi i aftësive dhe i talentit është i pashkëputur nga zhvillimi i përgjithshëm i tyre, nga formimi kulturor, mendor, moral dhe estetik. Nxënësit e talentuar të trajtohen nga mësuesi si bashkëpunëtorë, jo si fillestarë që duhen kapur për dore për t'u futur në rrugën e krijimtarisë. Ai mësues që s'ka dashuri për fëmijët, që s'i quan si fëmijët e vet ose ndoshta më tepër se të vetët nuk ka shpirt sakrifice. Ai është mercenar që shkon nga një vënd në një tjetër për të marrë shpërblimin (Bota e re, 1936: 24).

Kjo cilësi, e domosdoshme për të gjithë mësuesit, për ata që punojnë me talentet është parësore. Përgatitja psikologjike e talenteve, kujdesi i veçantë, mjedisi i ngrohtë, respekti i dyanshëm i palëve për njëri-tjetrin, optimizmi, mirëkuptimi, gatishmëria për t'iu gjendur pranë sa herë të kenë nevojë - janë hallka të rëndësishme të punës së një mësuesi të suksesshëm. Vetë mësuesi duhet të bëjë përgatitje serioze kur punon me nxënësit e talentuar, të ndjekë zhvillimet letrare brënda dhe jashtë vendit, të shfrytëzojë internetin, të dijë sa e shfrytëzojnë nxënësit, t'i aktivizojë nxënësit. Veprimtaritë bashkë me ta të jenë të karakterit formuese hulumtues dhe jo thjesht informues. Veç njohurive shumë të thella teknike për zanatin e tyre, përveç njohjes së shkëlqyer të historisë së arritjeve në fushën e vet ata (talentet e reja) kanë nevojë t'u hapet dera për çdo gjë njerëzve në rrugën e arsimit të përgjithshëm. Lehtësimi i kësaj pune nuk është vetëm detyrë, por detyrimi ynë (Dedja, 1998: 117). Në motivin për sukses ndikon vlerësimi i aftësive, të qenit realist, vetërespekti dhe orientimi për të ardhmen. Nga ky këndvështrim duhet të udhëhiqet mësuesi në punën me talentet. Mësuesit të ndërhyjnë me takt në motivacione të nxënësve me të cilët punojnë për t'i nxitur e stimuluar që ata të punojnë më mirë e në mënyrë sistemstike. Përpjekjet për formim, të çfarëdo niveli apo rrethane, ku të ketë si qëllim kryesor fitimin prej të talentuarve të sjelljeve me karakteristikat e mëposhtme: disponibilitet, kreativitet, autonomi, përgjegjshmëri, liri, lulëzim personal, efikasitet - duhet të jenë pjesë e tematikës së punës së mësuesit të letërsisë.

Çdo gjë që u jepet me lehtësi dhe me punë sipërfaqësore përfaqëson në vetvete vlera të dyshimta. Këtë duhet ta ketë mirë parasysh mësuesi që punon me nxënësit e talentuar, i cili e ndërton punën e tij mbi disa parime (Brada, 1996: 16):

1. Parimi i intereksionit social (Nxënësit ta kuptojnë se janë të dobishëm për rrethin social dhe si të këtillë i ka përvetësuar dhe i trajton ky rreth social).
2. Parimi i aktivitetit të vetëdijshëm (të formojë identitetin e vet në raport me identitetin e të tjerëve, çfarë dinë e duhet të dinë, çfarë munden e duhet të munden).
3. Parimi i diferencimit dhe individualizimit që lidhet:
 - a. me individualizimin e përmbajtjeve mësimore sipas gjërësisë e thellësisë,
 - b. me individualizimin e teknikës e të teknologjisë (eksperimentet, krijimtaria, modelimi),
 - c. me individualizimin e formave të punës në mësim, në formën e punës së pavarur individuale.

Referenca:

1. Anondamitja, Avadhutika, 2001 “*Sekretet e mëndjes*”, Ilar, Tiranë.
2. Brada, Riza, 1996 “*Nxënësit e zgjuar dhe talentë*”, Prizren.
3. “*Bota e re*”, revistë, 30 shtator 1936, nr.12, Korçë.
4. Çehov, Anton, 1994 “*Për letërsinë*”, botim në rusisht, Moskë
5. Dedja, Bedri, 1998 “*Sekreti i talentit*”, Toena, Tiranë.
6. Demaliaj, Skënder, 2002 “*Njerëz të mëdhenj*”, Dardania, Tiranë.
7. Freud, Sigmund, 2000 “*Psikoanaliza e letërsisë dhe e artit*”, Dituria, Tiranë.
8. Grup autorësh, 1962 “*Estetika dhe letërsia*”, vëllimi 2, Tiranë.
9. Grup autorësh, 1995 “*Karakteristikat e sistemit arsimor demokratik*”, Sh.B.L.Sh, Tiranë.
10. Orhani, Zenel, 2003 “*Imazhet mendore, imagjinata dhe fantazia*”, Tiranë.
11. *Revista pedagogjike*, 1982, nr.1, Tiranë.

MANAXHIMI I INOVACIONIT NË SIPËRMARRJEN UNIVERSITARE**Dr. Ira GJIKA**

ShLP “Mesdhetare”,

Dr. Nikollaq PANO

ShLP “Mesdhetare”

MSc. Marinela SHEHAJ

ShLP “Mesdhetare”

ABSTRAKT

Ky punim ka si objektiv analizën e rolit të inovacionit në rrugëtimin sipërmarrës të edukimit universitar. Ai përfshin mjetet, medodat dhe procedurat që ndikojnë në këtë proces duke ndërtuar një raport të ri të të mësuarit me tregun sipërmarrës. Ky fenomen analizohet në dy këndvështrime, në atë të pedagogjikës sipërmarrëse universitare, nga njëra anë dhe në atë të të mësuarit sipërmarrës studentor nga ana tjetër. Janë dy anë të së njëjtës medalje dhe që synojnë të njëjtin qëllim, atë të veprimit dhe kalimit nga një ide biznesi në një shoqëri sipërmarrëse me fitim.

Analizën e këtij raporti punimi e bënë duke u mbështetur në 5 kriteret të përcaktuara dhe të njohura shkencërisht sipas standarteve ndërkombetare në një vëzhgim analitik në 27 Sh.L.P. shqiptare me financim privat. Pasi analizon situatën aktuale të tregut universitar shqiptar në aspektin e Universitetit Sipërmarrës, mjetet e përdorura deri më sot nga ky treg, ky punim ndalet në mundësitë e ndërtimit dhe përdorimit nga studentët të platformave dixhitale pranë universiteteve për të nxitur më tej sipërmarrjen studentore.

Në tërësinë e platformave dixhitale të përdorura me sukses nga universitetet e huaja, punimi veçon dhe analizon më hollësisht platformën “Re Start & Start Up” të përdorur kryesisht nga fakultetet ekonomike të universiteteve më të dëgjura të Europës dhe bën përpjekje të matë probabilitetin e suksesit të saj. Në fund të punimit jepen sugjerime lidhur me aktivitetet jashtë programit mësimor që mund të rrisin vetëpunësimin apo shpirtin sipërmarrës të studentit. Pritshmëritë e këtij punimi janë ndërtimi i platformave dixhitale ku të përfshihen universitetet, bizneset private, bankat e nivelit të dytë, studentët dhe pedagogët.

Fjalë kyçe: *“Sipërmarrja në procesin mësimor”, “platforma dixhitale”, “Inkubatorët e Biznesit”.*

HYRJE

Inovacioni, edukimi universitar dhe sipërmarrja edhe në Shqipëri po vihen në qendër të vëmendjes së specialistëve të ndryshëm, sidomos në aspektin e metodave dhe mjeteve të përdorura për stimulimin e iniciativave të reja të biznesit. Filluar në mesin e shekullit të kaluar me krijimin e inkubatorëve të biznesit, i pari në vitin 1959 në New York, ShBA (Barrow, 2001) dhe vazhduar në ditët e sotme me krijimin e një sërë kushteve për të stimuluar ndjenjën e sipërmarrjes tek studentet në të gjithë elementet e tregut universitar shqiptar, lidhja e edukimit me inovacionin dhe sipërmarrjen zë një vend themelor.

Në këtë punim, pasi bëjmë një analizë të shkurtër të gjendjes aktuale të shkollave të larta private në stimulimin e sipërmarrjes duke përdorur kritere të përcaktuara vlerësimi, ndalemi më analitikisht në rolin që mund të luajnë platformat dixhitale të krijimit të bizneseve në Universitetet Shqiptare.

Hipoteza e këtij studimi është: “A mundet inovacioni, në formën e një platforme dixhitale të stimulojë interesin e studentëve për të ndërmarrë një iniciativë të re sipërmarrjeje?”

Përgjigjen pozitive të kësaj pyetjeje jemi përpjekur ta argumentojmë duke analizuar të gjithë faktorët që mund të ndikojnë në numrin e aplikimeve që studentët mund të bëjnë në këtë platformë, në vlerësimin e probabilitetit të suksesit që mund të ketë çdo ide biznesi, në integrimin e suportit teknik dhe ekonomik që pedagogët e çdo universiteti mund të japin, në mundësitë e ndërtimit të prototipit dhe në një sërë faktorësh të tjerë teknik. Duke i analizuar të gjithë këta faktor arrijmë në konkluzionin se platformat dixhitale në një hark kohor nga tre deri pesë vjet mund të përfaqësojnë një teknikë të re të stimulimit të bizneseve të reja, por njëkohësisht dhe një mjet shumë të përdorshëm nga studentët për të përcaktuar probabilitetin e suksesit të idesë së tyre të biznesit.

Punimi përfundon me rekomandimin se përveç elementeve të tjerë që përdorin sot universitet për stimulimin e biznesit, platformat dixhitale, përfaqësojnë një mjet të ri shumë të përdorshëm sidomos nga studentët, për të krijuar dhe vënë në jetë ide të reja biznesi. Format e thjeshta të ndërtimit të këtyre aplikacioneve, mundësia e përdorimit të tyre në çdo kohë dhe nga çdo vend,

tërësia e informacioneve që mund të vlerësohen analitikiisht dhe nxjerrja e rezultateve paraprake në kohë reale bënë të mundur që rezultatet e para të një ideje biznesi të merren shumë shpejt dhe të analizohen në mënyrë objektive.

I. RAPORTI NDËRMJET SIPËRMARRJES DHE UNIVERSITETIT NË NJË TREG NË ZHVILLIM NË EPOKËN E REVULUCIONIT DIXHITAL

Një analizë e kujdesshme e Tregut Universitar Shqiptar do na vinte përballë një fenomeni shumë pozitiv, sic është ai i rritjes së vazhdueshme të studentëve që mbarojnë shkollën e lartë, por që nga ana tjetër shoqërohet gjithmonë e më shumë me një kërkesë në rënie në tregun e punës për profesionistë që mbarojnë këto studime. Ky fakt shpesh herë na paraqitet si një kontradiktë reale karakteristike e një vendi në zhvillim ku përputhja e kërkesës dhe ofertes në tregun e punës realizohet nëpërmjet ndryshimeve të vazhdueshme që kanë shkallët e ekuilibrit të këtij tregu.

Në kushte të tilla, një ekosistem biznesi i shtyn idetë drejt rrugës së përdorimit të tyre, fuqizon kompanitë që krijojnë vende pune dhe i pergatit njerezit te jene gati per te marrë përsipër punë. Kjo është në dobi të bizneseve të veçanta, ekonomisë dhe gjithë shoqërisë (Kanter, 2014, 4). Duke parë gjithmonë e më shumë vështirësitë reale të punësimit të studentëve sipas specialiteteve që kanë studjuar dhe kufizimet e tregut të punës në Shqipëri, shumë shkolla të larta dhe universitete private filluan t'i plotësojnë zyrat e karrierës pranë institucioneve të tyre me fillesa të inkubatorëve të biznesit.

Në këtë mënyrë ato synojnë të rrisin gjithmonë e më shumë lidhjen e ngushtë midis sipërmarrjes, edukimit sipërmarrjes dhe studimit universitar. Përvoja botërore dhe vëzhgimet në këtë fushë kanë treguar që inkubatorët e biznesit pranë universiteteve (të quajtur UBI) kanë si avantazh konkurrues primar të tyre garantimin e vazhdimësisë (ose mbijetesës) dhe shfrytëzimin e potencialeve të rritjes për bizneset dhe sipërmarrjet që ata mbështesin (Lendner, 2009, 163).

Ata shërbejnë si mekanizma formale për t'i përfshirë kompanitë start-up në rrjetet e sipërmarrjeve, duke jua bërë më të lehtë zhvillimin e lidhjeve të nevojshme. Në këtë rrjet vlerësohen lidhjet dhe raportet që rrisin shanset për sukses, me partnerë për financime, kërkim-zhvillim, aspekte ligjore, konsulence, burime punësimi të kualifikuar, të cilat janë më lehtësisht

të arritshme brenda universiteteve. Nga ky këndvështrim, sa afër është “tregu universitar shqiptar” me sipërmarrjen dhe si mund ta vlerësojmë evoluimin e nxitjes së shpirtit sipërmarrës nëpër universitetet shqiptare?

Për të realizuar këtë vlerësim, në të cilin ndërthuren faktorë objektivë dhe subjektivë, jemi munduar të bëjmë një krahasim të disa treguesve mbi bazën e të cilëve të japim opinionin tonë lidhur me raportin edukim-sipërmarrje që kanë Sh.L.P. shqiptare. Ky vëzhgim është fokusuar në ato institucione të edukimit universitar që janë zhvilluar me investime private dhe nuk përfshin universitetet publike të vendit, të cilët për shkak të burimeve të deritanishme të financimit të tyre (kryesisht me fonde publike) nuk ndjekin të njëjtat rrugë lidhur me nxitjen e sipërmarrjes.

Le të shohim më nga afër 5 kriteret që kemi përzgjedhur për të analizuar shkallën e lidhjes midis edukimit universitar dhe sipërmarrjes.

1. Ekzistenca dhe funksionimi i inkubatorëve të biznesit pranë Sh.L.P. ose Universiteteve Shqiptare me financim privat

Nga 27 Sh.L.P. dhe Universitete me financim privat që funksionojnë dhe janë të certifikuara në Shqipëri vetëm 12 prej tyre kanë bërë si zgjedhje institucionale krijimin e laboratorëve të biznesit ose strukturave të ngjashme me to (APAAL website). Pra 44,4% e subjekteve që funksionojnë në “tregun universitar shqiptar” kanë ndërtuar një strukturë që në 5 vitet e ardhshme pritet të stimulojë sipërmarrjen studentore dhe më gjerë. E krahasuar me universitetet europiane për kohën që këto institucione funksionojnë në Shqipëri nuk është një shifer e vogel. E rëndësishme është që funksionimi i tyre të stimulohet gjithnjë e më shumë jo vetëm me fonde të vetë këtyre subjekteve por dhe me mjete të tjera. Në këtë mënyrë kemi një rritje të pjesëmarrjes studentore në këto struktura dhe lidhjeve më të ngushta me biznesin, bankat dhe tregun në përgjithësi. Kjo përforcohet edhe nga angazhimi i Komunitetit European, për të fuqizuar mjedisin e biznesit per start-ups në Europë përmes shumë instrumentave si HORIZON 2020 Programme, the Startup Europe Initiative, Erasmus for Young Entrepreneurs and FIËARE Accelerator Programme, të lidhur ngushtë në radhë të parë me universitetet. (<http://ec.europa.eu/programmes>)

2. Ekzistenca dhe funksionimi i programeve master për “sipërmarrjen ose inovacionin” pranë Sh.L.P. ose Universiteteve Shqiptare me financim privat

Institucione të tilla si universitetet, sipërmarrësit, rrjetet e furnizimit, tregjet e punës dhe programet e trajnimit të punonjësve janë më pak efektive si agjentë ekonomike, kur veprojnë të veçuar. Ata mund të kontribuojnë shumë më tepër nëse bashkëveprojnë, duke lejuar rrjedhën e kapitalit intelektual, financiar dhe njerëzor drejt ndërmarrjeve në çdo faze të zhvillimit (Kanter, 2012). Programet e nivelit të dytë, si Master profesional ashtu edhe shkencor në shumicën e Universiteteve dhe Sh.L.P. shqiptare janë të orientuara nga studime më të thelluara në fushat klasike të disiplinave ku vetë subjektet janë të specializuara. Në veshtrimin e ngushtë edukues dhe formativ shumë pak subjekte universitare (më pak se 14%) e shikojnë sipërmarrjen si një element që mësohet në shkolla, por, shikojnë një gamë të gjerë lëndësh të programeve të tyre si të domosdoshme për të bërë sipërmarrje. Vlerësojnë pozitivisht lidhjen e shkollës me përfaqësuesit e biznesit shqiptar por rrallë herë me përjashtime të vogla i ftojnë sipërmarrësit shqiptarë në sallat e tyre të leksioneve.

3. Ekzistenca dhe funksionimi i shoqatave të studentëve sipërmarrës pranë Sh.L.P. ose Universiteteve Shqiptare me financim privat

Nga vëzhgimi që kemi bërë në të paktën 24 subjekte të tregut universitar shqiptar njiheshin më shumë se 5 studentë në nivel Bachelor ose Master që kishin punën e tyre (kishin marrë përsipër) me aktivitete të vogla deri në ato relativisht të mëdha. Në shumicën e rasteve nuk e kishin trashëguar biznesin nga familja dhe kishin krijuar veprimtarinë e tyre si pasojë e eksperiencave paraprake në punë. Në asnjë nga këto subjekte megjithëse personat njiheshin për aktivitetin e tyre nuk ekzistonte ndonjë organizim apo shoqatë e studentëve sipërmarrës. Në shumë institucione nuk konsiderohej ekzistenca e kësaj shoqate si një element që mund të rrisë frymën sipërmarrëse edhe tek studentët e tjerë ose si një levë për lidhje më të ngushtë të universitetit me tregun.

4. Ekzistenca dhe funksionimi pranë Sh.L.P. ose Universiteteve Shqiptare me financim privat i shoqërive të tipit Spin-Off si dhe aftësia e tyre për të krijuar të ardhura nga tregu privat jashtë aktivitetit të edukimit universitar

Në të gjitha rastet Universitetet dhe Sh.L.P. me financim privat kishin struktura të ndërtuara për të dhënë të gjitha llojet e shërbimeve mbi bazën e specialiteteve që kishin si objekt të

veprimtarisë së tyre. Disa subjekte të veçantë faturonin deri në 10% të xhiros vetëm me shërbime në të tretë, por kryesisht me objekte shëndetësore ose të përkujdesit social. Më pak të organizuara ishin shërbimet në të tretë për objektiva të edukimit ekonomik dhe juridik ku megjithëse egzistonte një personel shumë i specializuar, të ardhura nga tregu për faturime në të tretë ishin shumë të vogla. Asnjë universitet apo Sh.L.P. nuk kishte shoqëri te tipit Spin-off, kjo dhe për faktin se në legjislacionin shqiptar nuk ekziston një kategori e tillë me përfitime të caktuara tatimore. E parë në përgjithësi, puna shkencore dhe studimore e universiteteve nuk ishte e ndertuar në varësi dhe në interes të sigurimit të të ardhurave nga tregu i lirë, por kryesisht në varësi të procesit të mësimdhënies.

5. Pjesëmarrja e studentëve të Sh.L.P. ose Universiteteve Shqiptare me financim privat në konkurime kombetare dhe ndërkombëtare që lidhen me krijimin e shoqërive startup apo ideve të veçanta të biznesit

Pothuajse në të gjithë subjektet e tregut universitar shqiptar kishin pjesëmarrje të studentëve në konkurse kombëtare dhe në tre konkurse ndërkombëtare me rezultate jo të dobëta. Megjithatë organizimet e këtyre konkurseve ishin kryesisht nga pushteti qëndror ose lokal dhe me pjesëmarrje individuale të vetë studentëve, vetëm në pak raste e kosultuar dhe e ndihmuar nga universitetet. Të gjitha projektet e propozuara nuk ishin përpunuar më vonë nga universitetet dhe përfitimet ishin individuale. Është një fushë ku universitetet dhe Sh.L.P. me financim privat mund të bëjnë shumë më tepër edhe duke vënë fonde të përbashkëta për konkurse të kësaj natyre. Konsiderohet ky aktivitet si një nga faktorët kryesor që rrit frymën e sipërmarrjes nëpër universitete dhe stimulon idetë e reja të biznesit.

Nga analiza e faktorëve të mësipërm vëmë re se, në përgjithësi, në tregun universitar shqiptar po rritet interesi për zhvillimin e frymës së sipërmarrjes, po rindërtohet gjithmonë e më mirë figura e sipërmarrësit dhe po adoptohen mënyrat më bashkëkohore të stimulimit të biznesit. Në vijim të lidhjes me të ngushtë të universiteteve dhe tregut të investimeve lë të analizojmë edhe efektet që mund të kenë platformat dixhitale.

II. PLATFORMAT DIXHITALE-ELEKTRONIKË, BIZNES, SHOQËRIZIM

Në aspektin teknik platformat dixhitale nuk janë gjë e re, por vëmendja ndaj tyre në dhjetëvjeçarët e fundit është rritur në mënyrë shumë të ndjeshme. Për platformat online të

bizneseve tërheqja dhe pjesëmarrja e klientëve është një nga sfidat e rëndësishme. Pavarësisht nëse ato bashkojnë dy apo më shumë palë përdoruesish, në fillimet e veta, çdo platformë është bosh (Edelman, 2015). Megjithë sfidën, numri i platformave dixhitale është vazhdimisht në rritje. Nuk është e vështirë të kuptohet se pse sipërmarrësit tërhiqen prej tyre: ato krijojnë vlerë të konsiderueshme duke mundësuar komunikimin që nuk mund të realizohet me rrugë të tjera; ato kanë kosto funksionimi të ulëta dhe efekti rrjete (netëork effect) e mbështet zhvillimin e tyre. E përshtatur vitet e fundit në mjediset universitare për zhvillimin e bizneseve të reja, përvoja e suksesshme e këtyre platformave vjen si nga SHBA, UK, Gjermania, edhe nga vende si Italia, Portugalia, Spanja dhe Greqia që kanë të përbashkët: një ekonomi “me probleme” dhe nevojën për të gjetur burime të reja rritjeje.

Platformat dixhitale në mjediset universitare janë element i rëndësishëm për nxitjen e sipërmarrjes së të rinjve edhe për faktin se:

- janë të ndërtuar dhe funksionojnë pikërisht në vendet ku gjendet përqëndrimi më i madh i të rinjve, në universitete,
- janë ndërtuar në atë formë përdorimi që preferojnë të rinjtë, sidomos ata që nuk e mbajnë mend më, erën e letrës së shtypur.

Platforma dixhitale Start-up & Re Start konceptohet si një instrument që mundëson identifikimin e elementeve krijues, mbështetjen dhe promovimin e ideve të reja drejt shndërrimit të tyre në inisiativa sipërmarrëse. E projektuar si një aplikacion i lehtë në përdorim dhe i thjeshtë në përpunimin e të dhënave, platforma lejon mbedhjen, vlerësimin, analizën dhe testimin e ideve të reja të studentëve, si individ ose në grupe. Objektivi është tërheqja e sa më shumë ideve që lindin në mjedisin universitar dhe jashtë tij, të cilat:

- mund të zhvillohen si biznese të reja nga vetë studentët (Start-up),
- mund të nxisin zhvillimin e bizneseve ekzistuese, të studentëve ose familjarëve të tyre,
- mund të ndihmojnë në ristrukturimin e rimëkëmbjen e bizneseve në vështirësi (Re-start).

Platforma ju krijon mundësi specialistëve të fushave që lidhen me aplikimet, të përpunojnë idetë e paraqitura dhe të vlerësojnë probabilitetin e suksesit të këtyre ideve. Më tej, platforma ofron një seri shërbimesh informacioni mbi mundësitë e financimit nga bankat, nga

bizneset aktive të suksesshme të interesuara për produkte/ shërbime inovative, nga vetë universitetet, si dhe mbi instrumentet financiare inovative (si *crowdfunding*). Aplikimet e përzgjedhura mbështeten me ndërtimin e një biznesplani me mundësi financimi dhe shërbime konsulence për zhvillim në një treg konkurrencial. Sic shprehen studjues të fushës së biznesit në përgjithësi dhe te varianteve start-up & re-start, “mundesite jane kudo, neqoftese je i aftë t’i shikosh dhe t’i shfrytëzosh ato“ (Biondi, 2014).

Platforma mund të konceptohet edhe si një aplikim ‘digital brainstorming’ që synon të përdoren të gjitha metodat për të shfrytëzuar në maksimum potencialet njereëore dhe fianciare që secili biznes ka ose mund të fitojë duke përdorur dhe shkëmbimin e eksperiencave reale apo bashkepunime partneriale.

Nga pikëpamja e të dhënave që kërkohen, në platformën dixhitale për bizneset e tipit startup pasqyrohet ideja e biznesit, produkti ose shërbimi që materializon këtë ide biznesi, çfarë produkti zëvendëson në treg ky produkt i ideuar, çfarë nevoja plotëson dhe nese i plotëson më mirë se produktet ekzistuese. Kujt i drejtohet, cili është profili i konsumatorit që do ta përdorë këtë produkt apo shërbim dhe nëse ekziston prototipi, janë elemente shtesë që ndikojnë ndjeshëm në vlerësimin e idesë.

Përveç informacioneve njohëse të idesë së produktit për bizneset e tipit startup, aplikuesit përfshijnë në platformë edhe disa informacione personale dhe një ide të përafërt për buxhetin total të realizimit të fazës përgatitore të krijimit të produktit, shoqëruar me mundesitë individuale për vetëfinancim të pjesshëm.

Platforma funksionon si një sistem që mundëson matjen e probabilitetit të suksesit të një ideje biznesi dhe ju vë në dispozicion specialistëve gjithë informacionet e nevojshme që të analizojnë më tej këtë ide. Kështu specialistë nga fushat përkatëse mund të japin gjykimin paraprak për suksesin e këtij biznesi potencial, gjë që i hap rrugën kalimit në fazat e mëpasme të përzgjedhjes deri në finalizimin me ndërtimim e një biznes plani analitik të gatshëm për financim dhe ngritjen e një kompanie.

Elemente kyç në suksesin e platformave të tilla konsiderohen:

1- promovimi i platformës për të mundësuar njohjen e saj nga të gjitha grupet e interesit, në radhë të parë nga brenda universiteteve, por edhe jashtë tyre, për të nxitur përdorimin e saj dhe për të tërhequr maksimumin e aplikantëve që kanë ide me probabilitet të lartë suksesi.

2- nxitja e interesimit dhe angazhimi i atyre partnerëve që do t'i hapte rrugë krijimit të lidhjeve për qëllime vlerësimi, financimi, konsulence, mbështetjeje teknike dhe manaxheriale të bizneseve Start-up dhe Re-start. Është pikërisht ky avantazh i pritshëm i platformave dixhitale/inkubatorëve të biznesit të vendosura pranë universiteteve që do të evidentonte sinergjinë e përpjekjeve të përbashkëta edukim universitar – sipërmarrje.

KONKLUZION

Ndërkohë që inovatorët e suksesshëm nxjerrin fitime nga produktet dhe shërbimet e reja, ekosistemet inovative të suksesshme kultivojnë përfitueshmërinë duke inkurajuar të tjerët të krijojnë oferta me vlerë. Nisur pikërisht nga kjo ne theksojmë konkluzionet si më poshtë:

- Inkubatorët e biznesit dhe format e ngjashme të nxitjes së aktiviteteve të biznesit të vendosura pranë universiteteve rrisin gjithmonë e më shumë lidhjen e ngushtë midis sipërmarrjes, edukimit sipërmarrës dhe studimit universitar, por ka ardhur koha që të gjenden dhe mënyra të tjera për të realizuar këtë objektiv.
- Platformat dixhitale përfaqësojnë një mjet të ri shumë të përdorshëm sidomos nga studentët, për të krijuar dhe vënë në jetë ide të reja biznesi. Format e thjeshta të ndërtimit të aplikacioneve, mundësia e përdorimit në çdo kohë dhe nga çdo vend, tërësia e informacioneve që mund të vlerësohen analitikisht dhe nxjerrja e rezultateve paraprake në kohë reale bën të mundur që rezultatet e para të një ideje biznesi të merren shumë shpejt dhe të analizohen në mënyrë objektive.
- Platformat dixhitale jo vetëm lindin ide biznesi, por edhe i përpunojnë ato duke bërë njëkohësisht zhvillimin e tyre nga një masë e gjerë të interesuarish. Për shkak të regjistrimit dhe evidentimit të përdoruesit ato ruajnë në të gjitha rastet pronësinë intelektuale të idesë fillestare.
- Universitetet private mund dhe duhet të përdorin këto rrugë zhvillimi bashkëkohor, në dobi të aktiviteteve të tyre, të ekonomisë dhe shoqërisë shqiptare në tërësi.

Referenca:

1. Barrow, C. (2001) Incubators - a realist's guide to the World's new business accelerators, John Wiley and Sons Ltd.
2. Biondi, A. (2014) Sorry, but Italy is no startup paradise AdEspresso June 13, 2014 Issue.
3. Edelman, B. (2015). How to Launch Your Digital Platform. From the April 2015 HBR Issue.
4. ISFOL (2013). Progetto "Formazione e impresa formative".
5. Kanter, R. M. (2012). Enriching the Ecosystem. From the March. 2012 HBR Issue.
6. Lendner, C. (2009) University technology transfer through university business incubators and how they help start-ups
7. Luethje, C., & Franke, N. (2004). Entrepreneurial intentions of business students: A benchmarking study. International Journal of Innovation and Technology, 1(3), 269-288
8. Schrage, M. (2014) How Innovation Ecosystems Turn Outsiders into Collaborators.
9. <http://ec.europa.eu/programmes/horizon2020/> (2016) Start -up success stories.

DEPRESIONI DHE ANKTHI TE ADOLESHENTËT DHE NDËRLIDHJA ME SUKSESIN E NXËNËSVE NË SHKOLLË

Ma.Sc. Azem ZYLFIJAJ

ABSTRAKT

Objekt studimi dhe hulumtimi i këtij punimi është “Depresioni dhe ankthi te adoleshentët dhe ndërlidhja me suksesin në shkollë në territorin e Kosovës dhe si mostër kemi marrë adoleshentët të cilët gjenden në shkollën fillore dhe në shkollën e mesme në Komunën e Kamenicës, ku dhe ushtrij profesionin si mësimdhënës në fshatrat Hogosht dhe Shipashnicë dhe në qytetin e Kamenicës.

Qëllimi i këtij studimi është për të testuar hipotezat e ngritura në lidhje me depresionin dhe ankthin te adoleshentët dhe ndërlidhja me suksesin e nxënësve në shkollë. Depresioni dhe ankthi ndikon negativisht në rritjen dhe zhvillimin e fëmijëve dhe adoleshentëve gjë që rritë rëndësinë e studimit të depresionit dhe ankthit te të rinjtë dhe po ashtu ndërlidhja me suksesin e nxënësve në shkollë.

Fjalë Kyçe: *Depresioni, Ankthi, Adoleshentët.*

HYRJE

Depresioni dhe ankthi në territorin e Kosovës nuk është studiuar, trajtuar e luftuar sa duhet dhe si duhet deri më tani. Pikërisht për këtë arsye iu rrekëm studimit të kësaj dukurie, më qëllim që të njihen përmasat, struktura dhe dinamika e saj, të analizohet në mënyrë të gjithanshme ndikimi i faktorëve të përgjithshëm që shkaktojnë depresionin dhe ankthin janë: *varfëria, papunësia, lufta, migrimi i popullsisë nga zonat malore në qytete dhe kushteve të banimit e të jetës si dhe faktorëve të posaçëm (ndarja e prindërve, fëmijët jetimë, familjet e degraduara, prindërit me depresion, lënia pas dore fëmijës etj.)*

Në shfaqjen e depresionit dhe ankthit, të vlerësohet puna dhe funksionimi i institucioneve dhe organizatave të tjera përkatëse, që ndikojnë drejtëpërdrejt te delikuentët, duke filluar nga *familja, shkolla, qendrat e punës sociale, pastaj masmediat, filmi, interneti etj*

DEPRESIONI

Depresioni është një çrregullim i gjendjes emocionale që karakterizohet nga pushtimi i ndjenjës së trishtimit, mungesës së interesit për veprimtari dhe ndjenjës së të qenit i pavlerë apo i të qenit fajtor (Schwartz & Schwartz,1993).

Depresioni është një nocion kompleks për simptome të shumëllojshme, i cili përfshinë: emocionet, kognicionin, motorikën, motivacionin si dhe gjendjen vegetative. Gjatë këtij çrregullimi mund të vie deri tek një mërzë, pikëllim, gjendje frike, shqetësim i brendshëm si dhe pengesa në të menduar dhe në gjumë (Lewinson, Rohde & Seeley,1998).

Depresioni klinik është një sëmundje serioze dhe individin që vuan nga ky çrregullim mund ta prek thuajse në të gjitha aspektet e tij jetësore. Komponentë kryesore e një individi në depresion është humbja e interesit në aktivitetet e tij të përditshme ku ai më herët ka gjetur kënaqësi (Schwartz & Schwartz, 1993).

Personat në depresion janë të shqetësuar dhe nervoz, ata kryejnë veprime të përsëritura motorike si lëvizje të gjymtyrëve. Ata kanë një pamje të zymtë dhe shumë rrallë mund të kenë sjellje agresive ndaj të tjerëve (Wetzel, 1984).

Depresioni te adoleshentët është i karakterizuar me disponim të vazhdueshëm negativ, nervozizëm, ndjenja e pafuqisë ose paaftësia për t'u ndjerë i kënaqur ose i lumtur, për një periudhë të gjatë kohore (Cheung, Zuckerbrot, Jensen, Ghalib, Laraque, Stein & the GLAD-PC Steering Group, 2007).

ANKTHI

“Ankthi gjithmonë ndikon si mbi trupin, ashtu edhe mbi mendjen”

Ankthi është gjendje të cilën mund ta përjetojmë kohë pas kohe. Ankthi është shenjë që i shkakton të sëmuarit vuajtje të mëdha shpirtërore. Ankthi e bënë të pasuruar depresionin dhe dëshpërimin e të sëmuarve, sepse është psikik dhe fizik. Ai shton në mas të madhe frikën dhe shqetësimin e të sëmuarve, prandaj shpesh bëhet nxitës i veprimeve për vetëvrasje.

Pjesa më e madhe e njerëzve e përjetojnë ankthin në formën e tensionit, pasigurisë, e ndoshta të frikës kur janë përpara një provimi, kur duhet të shkojnë në spital për një ndërhyrje të

caktuar, përpara se të bëjnë një intervistë pune, etj. Nga ana e tyre shqetësime mund të ndikojnë te gjumi, oreksi si dhe aftësia e juaj për t'u përqendruar.

Ankthi afat-shkurtër mund të jetë i vlefshëm. Stresi dhe ankthi përpara provimit mund të t'ju bëjë të ndiheni më të kujdesshëm dhe të përmirësoni performancën tuaj. Por, nëse ndjenjat e ankthit ju mbingarkojnë, aftësia juaj për t'u përqendruar dhe për të realizuar aktivitetin tuaj të përditshëm mund të dëmtohet (Polimeri, 1979).

Nëse një person ka një çrregullim ankthi, kjo nuk do të thotë që ai vuan nga një problem serioz i shëndetit mendor. Gjithsesi, është e rëndësishme që ai të konsultohet me mjekun e tij të familjes (Pettijohn 1996).

ADOLESHENCA

Adoleshenca është periudhë tranzicioni nga varësia drejt pavarësisë individuale, ndërsa përfundon kur individi arrin statusin e të rriturit. Me të drejtë psikologu Stanley Hall (1916) e konsideronte adoleshencën si një kohë “ të turbullimit dhe stresit”. Pothuasje gjithë secili gjatë adoleshencës has në disa vështirësi që kanë lidhje me identitetin, vetëdijen, kontrollin prindërore, konformizimin ndaj normave shoqërore etj.

Adoleshenca është një nga grupet shoqërore më të stigmatizuara. Nëse dikujt i thoni se sillet njëllë si adoleshent ajo nuk do të pranohet si kompliment por si ofendim. Vecanërisht nuk është mirë që për adoleshentët të mendohet në form stereotipe, sepse ndikojnë paragjykimet e moshës së rritur që nuk e vlerësojnë atë sa duhet.

Shumë prej streseve shkaktohen prej atyre ndryshimeve të përditshmërisë të cilat detyrojnë kapacitetin e individit të përshtas sjelljen në pajtim me situatat e reja të posakrijuara. (Lazarus,1981).

Në adoleshencë, gjërat ndryshojnë shumë dhe shpejt, edhe llojet e pjekurisë: sociale, morale, emocionale, intelektuale dhe fizike nuk zhvillohen njëllë. Prandaj adoleshenti quhet i papjekur. Prandaj i vlerësojmë veprimet apo mendimet e papjekura të të rriturve si sjellje adoleshenti (Dragoti, 2005).

SUKSESI NË SHKOLLË

Disa nxënës nuk arrijnë të kuptojnë arsyen e mosarritjes së suksesit megjithëse punojnë shumë ndërkohë që shokët e tyre bëhen të suksesshëm duke studiuar shumë pak. Në të vërtetë ky ndryshim krijohet nga mësimi i ndërgjegjshëm dhe të mësuarit me detyrim. Për këtë arsye duhet të konceptojmë mire motivimin, çfarë dhe pse duhet të mësojmë.

Shkollat tashmë kanë filluar, edhe mësimet po ashtu. Çdo nxënës dhe prind e fillon vitin e ri shkollor me dëshirën për të arritur sukses. Shumica e nxënësve e përfundojnë vitin shkollor të zhgënjyer megjithëse mund ta kenë filluar me dëshirë e vullnet. Shkaqet e kësaj dalin në pah ngadalë.

Çdo nxënës mund të arrijë suksesin në lëndë të ndryshme. Ka nxënës që janë të suksesshëm në disa lëndë e në disa të tjera jo. Ndërkohë që disa nxënës i përkushtohen më shumë lëndëve të mësuesve të preferuar disa të tjerë preferojnë të mësojnë lëndët për të cilat kanë më tepër prirje.

Disa nxënës arrijnë vlerësimin maksimal me shumë pak punë. Nxënësit e tjerë nuk arrijnë të kuptojnë arsyen dhe sesi arrijnë të bëhen të suksesshëm shokët e tyre me kaq pak punë. Megjithëse, me anë të studimit të ndërgjegjshëm në fillim mund të arrihet sukse si edhe me pak studim.

HULUMTIME RELEVANTE

Në një studim të bërë në vitin 1998 nga Lewinsohn, Rohde, & Seeley, tregohet se moshë 16 -18 vjeqare është më tipike të preket më shumë nga depresioni, sepse kjo është edhe koha kur të rinjtë janë në kërkim të identiteti të tyre. Në këtë moshë të rinjtë marrin vendime madhore për të ardhmen e tyre, pra ata në këtë moshë mundohen t'i qartësojnë vetes, shoqërisë dhe familjes, se cili do të jetë profesioni i ardhshëm i tyre.

Në shumë studime të bëra në SHBA nga Jackson & Lurie, në vitin 2006, Zalsman, Brent, & Weersing 2006, rezultatet tregojnë se 2,5 % deri në 8,3% të të rinjëve vuajnë nga depresioni.

Adoleshentët përjetojnë simptomat e depresionit në varësi të shkallës së ashpërsisë së sëmundjes. Një pasojë shumë e qartë e depresionit gjatë adoleshencës është vështirësia në

shkollë e cila merr formën e mungesës së arritjeve akademike, ndjekje e dobët e shkollës apo dështimin aktual të shkollimit (Hammen, Rudolph, Weisz, Rao & Burge, 1999).

Depresioni shkakton problem me përqendrimin dhe me motivimin gjë që bënë shumë të vështirë për adoleshentët të ndjekin detyrimet e shkollës si në klasë ashtu dhe në shtëpi. Në rastë shumë të rralla depresioni mund të rezultojë deri në refuzim ndaj shkollës apo lënie të saj (King & Bernstein, 2001).

Metodologjia e Hulumtimit

Për të studiuar këtë problem shkenca ka interes, praktika nevojë për njohjen e këtyre problemeve psikologjike **depresionit** dhe **ankthit** te adoleshentët dhe ndërlidhja me suksesin e nxënësve në shkollë.

Nocionet kryesore që ne do t'i përdorim në këtë hulumtim janë :

Si ndikon sukcesi jo i mirë në shkollë në manifestimin e simptomave të depresionit tek adoleshentët. Si ndikon sukcesi jo i mirë në shkollë në manifestimin e simptomave të ankthit tek adoleshentët. A kemi dallime në mes gjinis mashkullore dhe femërore në shfaqjen e simptomave të depresionit dhe ankthit tek adoleshentët me sukses më të lartë dhe më të ulët.

Qëllimi i hulumtimit

Qëllimi i hulumtimit është që të vërejmë dallimin ndërmjet nxënësve me sukses të dobët dhe nxënësve me sukses të lartë në shkollën fillore dhe të mesme se cili grup i nxënësve po shfaq me shumë simptoma të ankthit dhe depresionit .

Të bëjmë krahasime në mes suksesit të nxënësve të dobët në mësim dhe nxënësve me sukses të lartë në mësim se a janë më të brengosur dhe më nervoz nxënësit që kanë sukses më të dobët në mësimet.

Hipotezat Kryesore

Ekziston lidhshmëri statistikisht e rëndësishme mes depresionit, ankthit të përgjithshëm dhe depresionit të shfaqur brenda dy javëve të fundit, nga njëra anë dhe suksesit të përgjithshëm në mësim, nga ana tjetër, respektivisht sa më të theksuar të jenë karakteristikat të cilët formësojnë depresionin dhe ankthin ulet dukshëm sukcesi i përgjithshëm i nxënësve.

Hipoteza 1.1. Ekziston lidhshmëri statistikisht e rëndësishme mes depresionit të përgjithshëm dhe suksesit të përgjithshëm në mësim, respektivisht sa më të theksuar të jenë karakteristikat të cilët formësojnë depresionin e përgjithshëm duksëm ulet suksezi i përgjithshëm i nxënësve.

Hipoteza 1.2. Ekziston lidhshmëri statistikisht e rëndësishme mes ankthit të përgjithshëm dhe suksesit të përgjithshëm në mësim, respektivisht sa më të theksuar të jenë karakteristikat të cilët formësojnë ankthin duksëm ulet suksezi i përgjithshëm i nxënësve.

Hipoteza 1.3. Ekziston lidhshmëri statistikisht e rëndësishme mes depresionit të shfaqur gjatë dy javëve të fundit dhe suksesit të përgjithshëm në mësim, respektivisht sa më të theksuar të jenë karakteristikat të cilët formësojnë depresionin e shfaqur në dy javët e fundit duksëm ulet suksezi i përgjithshëm i nxënësve.

Nënhipotezat e Hulumtimit

1. Nxënësit me sukses të dobët shfaqin më shumë simptoma të depresionit, kundrejt atyre që kanë sukses të lartë shkollor.
2. Nxënësit me sukses më të dobët shfaqin më shumë simtoma të ankthit kundrejt atyre me sukses më të mirë
3. Nxënësit e gjinisë femërore shfaqin më shumë simptoma të depresionit kundrejt atyre të gjinisë mashkullore.
4. Nxënësit e gjinisë femërore shfaqin më shumë simptoma të ankthit kundrejt gjinisë mashkullore.
5. Nxënësit të cilët jetojnë me një prind shfaqin më shumë simptoma të depresionit kundrejt atyre nxënësve që jetojnë në familje të plotë.
6. Nxënësit të cilët jetojnë me një prind shfaqin më shumë simptoma të ankthit kundrejt atyre nxënësve që jetojnë në familje të plotë.

Variablat e Hulumtimit

Si çdo hulumtim që ka variablat në kuadër të së cilave mbështetet i tërë hulumtimi, andaj edhe ne në këtë pjesë kemi bërë përpjekje për të definuar dhe operacionalizuar variablat e hulumtimit në fjalë.

Variabla e parë e këtij hulumtimi është depresioni dhe simptomat e tija të shtrira tek subjektet e këtij hulumtimi. Depresioni në këtë hulumtim është marrur si variabël e pavarur. Variabla tjetër është e definuar si ankth në kuadër të së cilit janë marrë parasysh simptomat dhe niveli i shfaqjes së tij sipër mostrës së hulumtimit. Edhe variabla e ankthit në këtë hulumtim janë trajtuar si variabla të pavarura. Ndërsa variabla e fundit e varur është përcaktuar suksesi i nxënësve në shkollë.

ANKETA

Anketa do të zhvillohet me nxënësit e këtyre shkollave Shkolla Fillore „Skendërbeu “ në fshatin Hogosht, shkolla fillore „Sadri Misini “ në fshatin Shipashnicë, Shkolla fillore „Fan Noli “ në Kamenicë, Shkolla e Mesme Profesionale „Andrea Durrsaku“ në Kamenicë dhe Gjimnazi „Ismail Qemali“ në Kamenicë. Anketa është pyetësor i standartizuar për matjen e depresionit dhe ankthit quhet testi i Beckut për ankth dhe testi per depression i Beckut II. Para përdorimit të anketës do të bëjmë një hulumtim pilot për të përmirësuar e modifikuar pyetjet që nuk janë të përshtatshme.

POPULLACIONI DHE MOSTRA

a) Popullacioni

Popullacionin e këtij hulumtimi, e përbëjnë të gjithë nxënësit e shkollës fillore dhe të mesme në Kosovë, ku popullacioni është i madh numërikisht i caktuar dhe homogjen. Meqenëse ky popullacion është i madh ne nuk mund ta bëjmë me të gjithë nxënësi, por jemi të detyruar që hulumtimin ta bëjmë me një grup reprezentativ.

b) Mostra

Meqenë se numri i nxënësve është shumë i madhë .Për këtë qëllim jemi detyruar që hulumtimin ta bëjmë në disa shkolla fillore dhe të mesme dhe numri i nxënësve do të jetë 199 ku

do të jenë të përfshira tri shkolla fillore. Shkollat të cilat i kam zgjedhur janë : Shkolla Fillore „Skenderbeu “ në fshatin Hogosht, shkolla fillore „Sadri Misini “ në fshatin Shipashnicë, Shkolla fillore „ Fan Noli “ në Kamenicë, Shkolla e Mesme Profesionale„ Andrea Durrsaku“ në Kamenicë dhe Gjimnazi „Ismail Qemali“ në Kamenicë.

Organizimi i hulumtimit

- Hulumtimi është realizuar në Shkollën fillore dhe të mesme “Skenderbeu ”, “ Sadri Misini”, dhe në shkollën e mesme “Andrea Durrsaku” dhe “Ismail Qemali” gjatë vitit 2014. Pas kësaj kanë pasuar përpunimni i rezultateve dhe i të dhënve me anë të programit spss dhe diskutimi i rezultateve të fituara.

Tabela 1. Shpeshësia e paraqitjes së grupmohave në bazë të vitit kalenderik

	<u>Frekuenca</u>	<u>Përqindja</u>	<u>Përqindja valide</u>	<u>Përqindja cumulative</u>
1994	1	.5	.5	.5
1995	1	.5	.5	1.0
1996	6	3.0	3.0	4.0
Valid 1997	39	19.6	19.6	23.6
1998	81	40.7	40.7	64.3
1999	27	13.6	13.6	77.9
2000	44	22.1	22.1	100.0
Total	199	100.0	100.0	

Tabela 2. Paraqitja tabelare e ndarë në baza urbane dhe rurale

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid <u>Qytet</u>	103	51.8	51.8	51.8
<u>Fshat</u>	96	48.2	48.2	100.0
Total	199	100.0	100.0	

Tabela 3. Paraqitja tabelare e ndarë në baza gjinore

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
M	101	50.8	50.8	50.8
Valid F	98	49.2	49.2	100.0
Total	199	100.0	100.0	

Tabela 4. Paraqitja tabelare e ndarë në bazë të shkollave që ju përkasin nxënësit

	Frekuenca	Përqindja	Përqindja Valide	Përqindja Kumulative
Skenderbeu	19	9.5	9.5	9.5
Sadri Misimi	15	7.5	7.5	17.1
Fan Noli	20	10.1	10.1	27.1
Valida Andrea Durrsaku	31	15.6	15.6	42.7
Ismail Qemali	114	57.3	57.3	100.0
Total	199	100.0	100.0	

Tabela 5 Paraqitja tabelare e nxënësve që jetojnë me dy prindër dhe me njërin prindër

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Me dy prindërit	188	94.5	94.5	94.5
Valid Me njërin prindër	11	5.5	5.5	100.0
Total	199	100.0	100.0	

Tabela 7 Sukses i nxënësve në shkollë në gjysmëvjetorin e parë

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Më i mirë	104	52.3	52.3	52.3
Më i dobët	12	6.0	6.0	58.3
Valid I njëjti	83	41.7	41.7	100.0
Total	199	100.0	100.0	

Tabela 6 Suksesit në nxënësve në shkollë në gjysmëvjetorin e dytë

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
5	85	42.7	42.7	42.7
4	60	30.2	30.2	72.9
3	36	18.1	18.1	91.0
2	14	7.0	7.0	98.0
1	4	2.0	2.0	100.0
Total	199	100.0	100.0	

- **Tabela 8.** Besueshmëria Pyetësorit

Alfa Krombah	Alfa Krombah	Nr. Aitemeve
.921	.932	42

Tabela 9 . Korrelacionet mes depresionit të përgjithshëm dhe suksesit në shkollë

	Suksesit në shkollë	Suksesit më heret në shkollë	Suksesit në gjysmëvjetorin e fundit
Pearson Correlation	,025	-,226**	-,021
Sig. (2-tailed)	,751	,004	,791
N	161	161	161

** . Correlation is significant at the 0.01 level (2-tailed).

* . Correlation is significant at the 0.05 level (2-tailed).

Tabela 10. Korrelacioni mes ankthit të përgjithshëm dhe suksesit të përgjithshëm në mësim

		Suksesi ne shkolle	Suksesi më heret në shkollë	Suksesi ne qivsëmvjetorin e fundit
Ankthi përgjithshëm	Pearson Correlation	,099	-,099	,031
	Sig. (2-tailed)	,165	,162	,663
	N	199	199	199

** . Correlation is significant at the 0.01 level (2-tailed).

* . Correlation is significant at the 0.05 level (2-tailed).

Tabela 11. Korrelacioni mes depresionit të shfaqur gjatë dy javëve të fundit dhe suksesit të përgjithshëm në mësim


		Suksesi ne shkolle	Suksesi më heret në shkollë	Suksesi ne qivsëmvjetorin e fundit
depresionit të shfaqur brenda dy javëve të fundit	Pearson Correlation	-,014	-,144*	-,042
	Sig. (2-tailed)	,843	,043	,560
	N	199	199	199

** . Correlation is significant at the 0.01 level (2-tailed).

* . Correlation is significant at the 0.05 level (2-tailed).

Tabela 12. Korrelacionet mes variablave depresion, ankth dhe depresionit të shfaqur brenda dy javëve.

		Depresion I përgjithshëm	Ankthi I përgjithshëm	Depression brenda dy javëve
Depresion I përgjithshëm	Pearson Correlation	1	,621**	,687**
	Sig. (2-tailed)		,000	,000
	N	161	161	161
Ankthi I përgjithshëm	Pearson Correlation	,621**	1	,681**
	Sig. (2-tailed)	,000		,000
	N	161	199	199
Depression brenda dy javeve	Pearson Correlation	,687**	,681**	1
	Sig. (2-tailed)	,000	,000	
	N	161	199	199



Grafiku 1. Lakoja e cila përcjell raportin mes suksesit dhe depresionit.

KONKLUZION

Në të dy studimet e bëra janë vërejtur dallime gjinore në shfaqjen e problemeve të depresionit dhe ankthit gjithashtu janë vërejtur edhe dallime në mes nxënësve me sukses të dobët dhe sukses të lartë. Kjo dëshmi rritë arsyeshmërinë e hipotezave të parashtruara në këtë kërkim. Diagnostikimi dhe trajtimi i depresionit te fëmijët dhe adoleshentët me kohë është kriter për të parandaluar dëmtimin në funksionimin akademik, social, emocional dhe të sjelljeve. Nëse kjo gjë arrihet me kohë ndihmon dhe lejon që të rinjtë të zhvillojnë të gjitha potencialet e tyre për një jetë më të shëndosh. Në studime, janë vërejtur dallime gjinore në problemet e depresionit dhe ankthit, rezultatet tregojnë se femrat janë më të predispozuara të kenë probleme të depresionit dhe ankthit. Nga shumë studime që janë bërë, numërohen shumë faktorë që mund të shpiejnë të rinjtë në probleme të depresionit, mirëpo unë supozoj se faktor risku mund të jetë edhe lufta e fundit në Kosovë, sepse kjo grup-moshë i takon kategorisë së fëmijëve të cilët janë dëshmitar të luftës kësaj lufte. Rënia në vetëvlerësim është e zakonshme gjatë adoleshencës, zakonisht përfshinë një rënie në ndjenjat e kompetencës mësimore dhe të motivimit. Këto rënie mund të

vijnë si pasoj e ndryshimeve fizike dhe emocionale që i shoqëroj adoleshentët gjatë procesit të zhvillimit.

Rekomandime

Trajtimi i depresionit te fëmijët dhe të rinjtë mbetet një sfidë e madhe për të gjithë profesionistët e shëndetit mendor, edhe pse disa studime kanë krijuar sigurinë dhe efikasitetin e trajtimeve për depresion në adoleshencë. Zhvillimi i fëmijëve dhe adoleshentëve është duke shkuar me një ritëm më të shpejtë, pra zhvillimi fiziologjik dhe transformimet e shpejta shoqërore mund të jenë një ndër faktorët që shpiejnë adoleshentët në probleme afektive, tranzicionet janë stresuese vetëm kur ngjarjet jetësore vijnë papritur. Aktiviteti fizik është një ndër mekanizmat për çlirim nga depresioni, andaj rekomadohet që të rinjtë të merren më shumë me aktivitete fizike për të zhvilluar një jetë më të shëndoshë. Njerëzit që ndjehen jo mirë të informuar po ashtu tregojnë se janë depresiv. Prandaj mekanizëm tjetër për luftë me depresionin është zhvillimi intelektual i tyre. Është e rëndësishme për prindërit të kuptojnë që terapia multidisiplinare tregon sukses të madh në trajtimin e problemeve të depresionit te adoleshentët. Të rinjtë që kanë probleme të depresionit duhet të përkrahen nga familja, shkolla, e në veçanti nga miqtë e tyre, ata kanë nevojë që miqtë e tyre t'i inkurajojnë për tu përballuar me problemin duke kërkuar ndihmë tek profesionistët, kjo do tu ndihmojë ta kalojnë këtë sfidë dhe ta kenë më të lehtë ta kthejnë besimin në vete. Përkrahja nga rrethi social do jetë një shtysë drejt rikoooperimit më me sukses të problemve të depresionit. Duke pasur parasysh problemet që dalin si pasojë e depresionit mendoj që hartuesit e politikave shëndetsore duhet t'i kushtojnë vëmendje më të madhe kësaj problematike, duke themeluar instutucione të veçanta që merren me probleme të shëndetit mendor te të rinjtë. Është tejet e rëndësishme që adoleshentët që kanë probleme të depresionit të marrin trajtime adekuate profesionale, sepse nëse ky problem nuk trajtohet mund të paraqes rrezikshmëri për jetën e tyre.

Referenca:

1. American Academy of Child and Adolescent Psychiatry (AACAP). (1998). Practice parameters for the assessment and treatment of children and adolescents ëith depressive disorders. Journal of the American Academy of Child and Adolescent Psychiatry.

2. American Academy of Child and Adolescent Psychiatry (AACAP). (2007). Practice parameters for the assessment and treatment of children and adolescents with depressive disorders. *Journal of the American Academy of Child and Adolescent Psychiatry*.
3. Academy of Pediatrics (AAP) and the American Academy of Child and Adolescent Psychiatry (AACAP). (2009). Improving mental health services in primary care: Reducing administrative and financial barriers to access and collaboration. *Pediatrics*.
4. American Psychiatric Association (APA). (2000). *Diagnostic and statistical manual of mental disorders* (4th ed.). Washington, DC: Author.
5. Angold, A., & Costello, E.H. (2006). Puberty and depression. *Child and Adolescent Psychiatric Clinics of North America*.
6. Bailey, M., Zauszniewski, J., Heinzer, M., & Hemstrom-Krainess, A. (2007). Patterns of depressive symptoms in children. *Journal of the American Academy of Child and Adolescent Psychiatry*.
7. Birmaher, B., Arbelaez, C., & Brent, D. (2002). Course and outcome of child and adolescent major depressive disorder. *Child & Adolescent Psychiatric Clinics of North America*.
8. Borowsky, I., Ireland, M., & Resnick, M. (2001). Adolescent suicide attempts: Risk and protectors. *Pediatrics*.
9. Centers for Disease Control and Prevention (CDC). (2007). *Web-Based Injury Statistics Query and Reporting System (WISQARS™)*. Atlanta, GA: Author.
10. Fann, J.R., Bombardier, C.H., Dikmen, S., Esselman, P., Warms, C.A., Pelzer, E., ... Temkin N. (2005). Validity of the patient health questionnaire-9 in assessing head injury following traumatic head injury. *Journal of Head Trauma*.
11. Glowinski, A.L., Madden, P.A., Bucholz, K.K., Lynskey, M.T., & Heath, A.C. (2003). Genetic epidemiology of self reported lifetime DSM-IV major depressive disorder in population-based twin sample of female adolescents. *Journal of Child Psychology and Psychiatry*.
12. Geller, B., Fox, L., & Clark, K. (1994). Rate and predictors of prepubertal bipolarity during follow-up of 6 to 12-year-old depressed children. *Journal of the American Academy of Child and Adolescent Psychiatry*.

13. Hamrin, V., & Pachler, M.C. (2005). Child & adolescent depression: Review of the latest evidence-based treatments. *Journal of Psychosocial Nursing & Mental Health Services*.
14. Hamrin, V., & Pachler, M.E. (2007). Pediatric bipolar disorder: Evidencebased pharmacological treatments. *Journal of Psychosocial Nursing & Mental Health Services*.
15. Hatcher-Kay, C., & King, C. (2003). Depression and suicide. *Pediatrics in Review*.
16. Jeffrey, D.A., Sava, D.B., & Winters, N.C. (2005). Child and adolescent psychiatry: The essentials. In K. Cheng & K.M. Myers (Eds.) *Depressive disorders* (pp. 169–188). Philadelphia: Lippincott Williams & Wilkins.
17. Kisley, S., Duerden, D., Shaddick, S., & Jayabarathan, A. (2006). Collaboration between primary care and psychiatric services: Does it help family physicians? *Canadian Family Physician*.
18. Lewinsohn, P.M., Rohde, P., & Seeley, J.R. (1998). Major depressive disorders in older adolescents: Prevalence, risk factors, and clinical implications. *Clinical Psychology Review*.
19. Mental Health: A Report of the Surgeon General, Kidshealth.org from the Nemours Foundation,
20. Understanding Depression" ,Center for Mental Health Services, SAMHSA, A Family Guide, Keeping Youth Mentally Healthy and Drug Free, "Depression Hurts",
21. U.S. National Library of Medicine and National Institutes of Health, MedlinePlus Medical Encyclopedia, "Depression signs in Teenagers"
22. Mental Health: A Report of the Surgeon General, "Depression and Suicide in children and adolescents" eebMD.com : Depression in Childhood and Adolescence & eebMD/The Cleveland Clinic "Seasonal Depression".
23. Paxton, R.J., Valois, R.F., Watkins, K.W., Huebner, E.S., & Drane, J.W. (2007). Associations between depressed mood and clusters of health risk behaviors. *American Journal of Health Behaviors*.
24. Rao, U., Hammen, C., & Daley, S.E. (1999). Continuity of depression during the transition to adulthood: A 5-year longitudinal study of young women. *Journal of the American Academy of Child and Adolescent Psychiatry*, 34, 566–578.

25. Richardson, L., & Katzenellenbogen, R. (2005). Childhood and adolescent depression: the role of the primary care providers in diagnosis and treatment. *Current Problems in Pediatric and Adolescent Health Care*.
26. Scourfield, J., Rice, F., Thapar, A., Harold, G.T., Martin, N., & McGuffin, P. (2003). Changing etiological influences ÷ith development. *Journal of Child Psychology and Psychiatry*.
27. Williamson, D., Birmaher, B., Brent, D., Balach, L., Dahl, R.E., & Ryan, N.D (2000). Atypical symptoms of depression in a sample of depressed child and adolescent outpatients. *Journal of the American Academy of Child & Adolescent Psychiatry*.
28. Zalsman, G., Brent, D., & Weersing, V. (2006). Depression in children and adolescents: An overvieë. *Child and Adolescent Psychiatric Clinics of North America*.
29. Chiara Libero, Depresioni, ankthi dhe stresi : libri i pacientit (2007).
30. [Soren Kierkegaard](#), Koncepti i ankthit (2002).
31. [Joni E. Johnston](#), Ankthi:një udhërrëfyes i plotë për ta kontrolluar : mbajini frikërat dhe shqetësimet tuaja larg vetes (2011).
32. [Afrim Dangëllia](#), Trajtimi i depresioneve rezistente (2005).

INFORMATION TECHNOLOGY

DIGITAL SIGNATURE PARAMETERS TO INCREASE ITS VIABILITY**Dolantina HYKA**

Mediterranean University of Albania

dolantina.hyka@umsh.edu.al**Festim KODRA**

Mediterranean University of Albania

festimkodra@gmail.com**Elona SHEHU**

Mediterranean University of Albania

elonashahini@umsh.edu.al**ABSTRAKT**

Skemat e nënshkrimeve të verbëra janë përdorur për herë të parë rreth mesit të viteve 80. Me anë të tyre arrihet të nënshkruen mesazhe pa u evidentuar përmbajtja e tyre. Këto skema përdoren në pagesat elektronike, regjistrimin e kohës kur është krijuar një dokument, kontrollin anonim të hyrjes, për vërtetimet noteriale në rastin e njësisimit me origjinalin, votimet elektronike, etj. Nënshkrimi mund të kryhet mbi të gjithë tekstin ose mund të përdoren dhe hash funksionet me qëllim që të reduktohet materiali për nënshkrim. Ndodhë random që gjatë llogaritjeve në hapat e këtyre algoritmave të nënshkrimit të kryen gabime të cilat çojnë edhe pse nuk janë në skemën e duhur, të çojnë në nënshkrim korrekt tekstit të hapur ose në verifikim të gabuar të një skeme të saktë. Këto raste dhe të tjera mund të shmangen duke rritur sigurinë e skemave dhe duke kushtëzuar parametrat në mënyrë që të mos lejojnë gabime të tilla, e atëherë më tepër që këto gabime të konvergjojnë në rezultate të sakta.

Fjalë Kyçe: *Kriptosistem, Nënshkrim dixhital, RSA, Sistem Diagnostik.*

HYRJE

Skemat e nënshkrimeve të verbëra janë përdorur për herë të parë rreth mesit të viteve 80. Me anë të tyre arrihet të nënshkruen mesazhe pa u evidentuar përmbajtja e tyre. Këto skema

përdoren në pagesat elektronike, regjistrimin e kohës kur është krijuar një dokument, kontrollin anonim të hyrjes, për vërtetimet noteriale në rastin e njësisimit me origjinalin, votimet elektronike, etj. Nënshkrimi mund të kryhet mbi të gjithë tekstin ose mund të përdoren dhe hash funksionet me qëllim që të reduktohet materiali për nënshkrim.

ALGORTMI I NËNSHKRIMIT DHE I VERIFIKIMIT

Alice interesohet që Bob të nënshkruaj një mesazh M pa ja treguar atë përmbajtjen e tekstit.

- Bien dakord për të gjeneruar një modul të përbashkët $n=pq$
- Bob zgjedh çelësin e tij publik e i tillë që $(e, \varphi(n))=1$.
- Ai llogarit çelësin privat $d=e^{-1} \bmod \varphi(n)$

Për nënshkrimin veprohet si më poshtë:

- Fillimisht Alice zgjedh një numër të rastit r reciprokisht të thjeshtë me n dhe i dërgon Bob mesazhin e shifruar $P = r^e M \bmod n$
- Bob kryen shifrimin me anë të funksionit shifruar $S_B = P^d \bmod n$
- Alice përfton prej kësaj nënshkrimin e vërtetë duke vepruar me elementin e anasjelltë të çelësit të saj të shifrimit

$$S = r^{-1} S_B \bmod n = M^d \bmod n$$

Për sa i përket verifikimit ai mund të kryet nga çdo person i interesuar.

- Për këtë mjafton të përdorim fuqinë modulare me anë të çelësit publik e të nënshkruesit Bob

$$V = S^e \bmod n = M$$

GABIMET QË DUHEN SHMANGUR PËR TË NDËRTUAR SISTEM TË FORTË OSE DIAGNOSTIK

1. Gjenerimi i çelësit publik e duhet të jetë i tillë që $(e, \varphi(n))=1$ përndryshe nuk mund të gjenerojmë një çelës privat korespondues.
2. Nëse zgjidhet si çelës privat d një numër i tillë që $(d, n)=1$ dhe $e^{-1} \bmod n = e^{-1} \bmod \varphi(n)$ atëherë nuk do dallohej nëse veprimet për të llogaritur çelësin privat janë kryer saktë apo jo sipas modulit përkatës. Duke vendosur kushtin $(e, n) \neq 1$ që në fillim kur gjenerohet çelësi publik, e evitojmë këtë gabim në hapat e më pas më, kur ndërtojmë shembuj të fortë. Nëse duam të ndërtojmë shembuj diagnostik, ky kusht vendoset i veçantë në momentin që llogaritet çelësi privat $d = e^{-1} \bmod n \neq e^{-1} \bmod \varphi(n)$ me qëllim që të shohim se cili prej

gabimeve është kryer. Një tjetër mënyrë për të shprehur këtë kusht do ishte edhe $d \neq shvp(n, \varphi(n))$ i cili është ekuivalent me kushtin e parë.

2. Llogaritet $\varphi(n) = n-1$ në vend të $\varphi(n) = \varphi(p)\varphi(q) = (p-1)(q-1)$. Për të evituar këtë, $e^{-1} \bmod n-1 \neq e^{-1} \bmod \varphi(n)$ (e vendosim si kusht gjatë llogaritjes së d për shembujt diagnostik) dhe vendosim sërish kushtin $(e, n-1) \neq 1$ për shembujt e fortë. Një tjetër mënyrë do ishte edhe si në trajtimin e rastit të më sipërm duke marrë parasysh kushtin $d \neq shvp(n-1, \varphi(n))$
3. Në disa raste mund të merret shifrimi fillestar $A-Z = 1-26$ dhe në disa të tjera $A-Z = 0-25$ ose në ndonjë përcaktim tjetër. Një mënyrë për shmangien e këtij gabimi është përcaktimi i kalimi nga tekst alfanumerik në numerik dhe anasjelltas që në fillim me anë të një funksioni i cili thirret me një cikël apo me një emërtim të caktuar gjatë gjithë algoritmit në mënyrë që të mos lejohet përcaktimi i ri i shifrimit fillestar.
4. Çelësi publik e duhet të zgjidhet i tillë që të jetë i ndryshëm nga çelësi i shifrimit sepse për ndryshe kriptosistemi do ishte krejtësisht i thyeshëm, kjo pasi çdokush mund ta lexoj tekstin e hapur duke ripërdorur çelësin e edhe si çelës deshifrimi. Në këtë rast nga ana e studentit mund të mos bëhet dallimi cili është çelësi i shifrimit dhe i deshifrimit e të bëhen përlllogaritjet e sakta pa gjetur fare çelësin e deshifrimit. Për të shmangur këtë gabim, në algoritmin e Maple shtohet kushti $d = e^{-1} \bmod \varphi(n) \neq e \bmod \varphi(n)$ gjithashtu edhe $d \neq e \bmod n$
5. $e^{-1} \bmod \varphi(n) \neq -e \bmod \varphi(n)$. Mund të merret si çelës privat elementi i kundërt i çelësit publik në vend të anasjellit të tij kusht ky që ndikon në konceptimin e gabuar të kriptosistemit asimetric RShA.
6. $d \neq e$ sepse përndryshe veprimet do të kryheshin pa e llogaritur fare inversin e e-së dhe mund të krijohet ideja se është element i pa nevojshëm në kriptosistem. Një tjetër arsye është se kriptosistemi në këtë rast do ishte tepër i dobët. Gjithashtu nëse çelësi i shifrimit dhe i deshifrimit do ishin të njëjtë, kjo mund të çonte edhe në gabime të tjera si këto të më poshtmet (9,10)

7. $e \neq \varphi(n)$ Nëse ndodh që çelësi i shifrimit të jetë i barabartë me vet $\varphi(n)$, atëherë nga teorema e Fermait, në vend të tekstit të shifruar C do të transmetohej një mesazh, karakteret e të cilit do ishin të gjitha 1 (1111...11) dhe kështu jo vetëm që zbatohet gabimisht hapat e kriptosistemit por e kthejmë edhe mesazhin në një tekst pa kuptim i cili nuk mund të deshifrohet sepse nuk ekziston $\varphi(n)^{-1} \pmod{\varphi(n)}$. Pra në këtë rast është e pamundur të gjendet çelësi i deshifrimit. Kjo e bën mesazhin të pa lexueshëm edhe nga marrësi legjitim. Një mënyrë për ta evituar këtë do ishte të përcaktohet që në momentin e gjenerimit të e një kufi maksimal për të (i cili duket qartë se duhet të jetë $\varphi(n)$). Një tjetër mënyrë (në rastin e sistemit diagnostik është më e përshtatshme se mënyra e parë) do ishte që në algoritëm të vendoset kushti $e \neq \varphi(n)$ bashkë me komentimin përkatës se cilat janë gabimet në të cilat mund të konvergjojnë zgjedhja e një çelësi publik të tillë.
8. Mund të ndodh që gjatë llogaritjeve të çelësit privat d, të ngatërrohet moduli $\varphi(n)$ me çelësin publik e duke marrë si të anasjelltë të këtij të fundit në barazimin bezu, jo koeficientin pranë e por koeficientin pranë $\varphi(n)$. Është e qartë se ata nuk do kenë të njëjtën vlerë, por gjatë llogaritjeve për deshifrimin e mesazhit mund të ndodh që të arrihet në rezultatin e kërkuar edhe duke kryer këtë gabim.
9. $e^{-1} \pmod{n-1} \neq e^{-1} \pmod{\varphi(n)}$ që të shmanget përdorimi i gabuar i modulit
10. $e^{-1} \pmod{\varphi(n)} \neq e \pmod{\varphi(n)}$ që të shmanget përdorimi i gabuar i çelësit publik direkt
11. $e^{-1} \pmod{\varphi(n)} \neq -e \pmod{\varphi(n)}$ që të shmanget përdorimi i gabuar i te kundërtit të çelësit publik.
12. $(r,n)=1$ nëse si parametër r zgjidhet një numër i cili nuk është reciprokisht i thjeshtë me vlerën e modulit n atëherë mund të nënshkruet mesazhi i shifruar por nuk mund të verifikohet nëse është vërtet ky mesazh apo jo pasi nuk është e mundur të kthehet ai në gjendjen fillestare nëse nuk ekziston i anasjelli i r.

13. $(r, \varphi(n)) \neq 1$ në mënyrqë që të shmangen gabimet të cilat lidhen me përdorimin e gabuar llogaritjeve modulare.
14. $r \neq 1$ Po të merret parametri $r=1 \pmod n$ atëherë do dërgohej për nënshkrim vet teksti i hapur pa e shifruar atë më parë gjë e cila çënon në mënyrë direkte algoritmin e nënshkrimit të verbër jo vetëm sipas RShA po edhe sipas kriptosistemeve të tjera ku përdoret parametri ndihmës për një shifrim fillestar.
15. $r \neq e$ duhet që çelësi publik i palës që nënshkruan mesazhin të jet i ndryshëm nga parametri i zgjedhur në mënyrë të rastit r pasi për ndryshe teksti që duhet nënshkruar është i lexueshëm nga Bob duke thyer kështu skemën e sigurisë së nënshkrimit të verbër.
16. $r^{-1} \neq e$ arsyetimi është i ngjashëm me rastin kur vet parametri r është i barabartë me çelësin publik e
17. $r^{-1} \neq r$ Nëse parametri i cili përdoret për shifrimin e tekstit të hapur do ishte i njëjtë me atë që përdoret për ta verifikuar nënshkrimin atëherë tekstin e shifruar do të mund ta lexonte kushdo që ka të drejtë ta verifikoj atë.
18. $r^{-1} \neq d$ arsyetimi është i ngjashëm me rastin kur vet parametri r është i barabartë me çelësin privat d
19. $r \neq d$ gjithashtu duhet që çelësi privat i palës që nënshkruan mesazhin të jet i ndryshëm nga parametri i zgjedhur në mënyrë të rastit pasi edhe në këtë rast Bob mund ta lexoj lehtësisht mesazhin duke gjetur të elementin e anasjellë të d jo me sipas modulit $\varphi(n)$ për të gjeneruar çelësin e tij publik por sipas modulit n .
20. $P \neq M$. duhet që mesazhi i shifruar të jetë i ndryshëm nga mesazhi fillestar sepse për ndryshe nuk është më nënshkrim i verber por thjesht nënshkrim dixhital.

21. $S_B \neq P$ Nëse nënshkrimi do ishte i njëjtë me mesazhin e shifruar atëherë çdokush mund të pretendojë se është nënshkruesi legjitim. nga ana tjetër, studentit i krijohet ideja sikur në këtë proces mjafton vetem të shifrosh mesazhin dhe aty përfundon algoritmi i shifrimit të verbër ose mjafton vetëm të nënshkruash pa bër më pas shifrim të tekstit të hapur duke cënuar kështu sigurinë e këti sistemi.
22. $S_B \neq M$ Nënshkrimi duhet të jete i ndryshëm nga vet mesazhi pasi kështu nuk bëhet i qartë nënshkrimi nga teksti i hapur. Mund të krijohet ideja sikur çdo teks i hapur në vetvete është i nënshkruar.
23. $S_B \bmod n \neq S_B \bmod \varphi(n)$, $S \bmod n \neq S \bmod \varphi(n)$, $V \bmod n \neq V \bmod \varphi(n)$, $P \bmod n \neq P \bmod \varphi(n)$, $M \bmod n \neq M \bmod \varphi(n)$ Edhe në këtë rast duhet theksuar se veprimet për llogaritjen e tekstit të shifruar, nënshkrimit të verbër, nënshkrimit përfundimtar si edhe verifikimit, kryen sipas modulit n dhe jo ndonjë moduli tjetër.
24. $S_B \neq S$ Nëse ndodh që nënshkrimi i verbër të jet njëlloj me nënshkrimin dixhital, studentit mund ti krijohet ideja se nënshkrimi i mëhershëm i tekstit të hapur është i pa nevojshëm. Një mënyrë për ta shmangur këtë gabim mund të jetë vendosja e kushtit $r \neq 1$
25. $S_B \neq V$ Nëse teksti pas nënshkrimit të verbër do ishte i njëjtë me atë pas verifikimit atëherë kthehemi në rastin e gabimit $S_B = M$ ku është i vlefshëm arsyetimi i më sipërm, por vlet në shtohet edhe fakti se nënshkrimi dhe verifikimi janë procese të anasjellë të njëri – tjetrit. Gjithashtu do krijohet ideja se nënshkrimin mund ta bëj kushdo, e jo vetëm një nënshkrues legjitim. Apo nga ana tjetër mund të lindin dhe paqartësi të tjera për studentin siç do ishte fakti se verifikimin duhet ta bënte vetëm pala që nënshkruan meqënë se shikon rezultate të njëjta për nënshkrimin e verbër dhe verifikimin.
26. $S \neq V$ për analogji me pjesën e nënshkrimit të verbër edhe vet teksti i nënshkruar duhet të jetë i ndryshëm nga teksti pas verifikimit. Arsyetimi është i ngjashëm me rastin e më parshëm.

Referenca:

1. A. BAXHAKU, K. NAKA “Një problem gjeometrik i antikitetit në një protokoll me njohje zero dhe në zgjerimet algjebrike të fushave” ;
2. CHONG, S.K.,Farr G., Frost L., Hawley S.,“On pedagogically sound examples in public-key cryptography”, ACSC 2006;
3. CHONG, S. K.(2003),“Cryptographic teaching tools”, BCompScHonours, Monash University, Clayton, Australia;
4. Dolantina HYKA, Ardi BENUSI, “Some cryptographic weakness and the ways to avoid them in ict services of developing countries”, European Journal of Sustainable Development (2014), 3, 2, 73-88 ISSN: 2239-5938;
5. Dolantina HYKA, Artur BAXHAKU , “Some Maple algorithms generating diagnostically / strong cryptographic examples.” International Jurnal of Science, Innovation and new Tecnology, Vol 1, No.9 February 2014 Printed ISSN 2223-2257, Oline ISSN 2225-0751;
6. Ardi BENUSI, Dolantina HYKA “A framework for secure data exchange in mobile cloud computing”, Volume 8 No. 2 2014, 41-52, ISSN: 1314-0744;
7. A. IVAN, Y.DODIS, “Proxy Cryptography Revisited”, Proceedings of the Network and Distributed System Security Symposium, NDSS , (2003).

AN IMPROVEMENT OF ELGAMAL CRYPTOSYSTEM

Dolantina HYKA

Mediterranean University of Albania

dolantina.hyka@umsh.edu.al

Festim KODRA

Mediterranean University of Albania

festimkodra@gmail.com

ABSTRAKT

Duke marrë shtysë nga përmirësimi i parë dhe i dytë i kriptosistemit Massey – Omura, Në këtë punim paraqitet dhe një mundësi për përmirësimin e kriptosistemit ElGamal duke i kaluar veprimet nga një fushë e fundme Z_q në një grup me rend të fundëm. Kjo bën që siguria e kriptosistemit të rritet ndjeshëm duke e kaluar atë në tjetër nivel. Nëse ElGamali klasik e bazonte sigurinë e tij si sistem mbi problemin e logaritmit diskret, me anë të këtij përmirësimi i shtohet edhe siguria në bazë të faktorizimit të numrave të thjeshtë duke marrë kështu përmasa të tjera. Është vënë re se algoritmi funksionon në grupin e fundëm të marrë në studim dhe po punohet për të parë nëse këto rezultate mund të shtrihen edhe më gjerë në grupe të tjerë të fundëm apo edhe në vijat eliptike.

Fjalë Kyçe: *Përmirësim Kriptosistemi, Teori Numrash, Kriptografi, ElGamal.*

KRIPTOSISTEMI ELGAMAL MBI FUSHAT E FUNDME Z_q

Në kriptografi, edhe kriptosistemi i ElGamal – it është një kriptosistem me çelës publik i cili bazohet në shkëmbimin e çelësave të Diffie - Hellman. Ai u shpjegua fillimisht nga Taher ElGamal in 1985. Shifrimi i ElGamalit është përdorur në softuerin GNU, në një version të PGP dhe në kriptosisteme të tjera. Algoritmi i nënshkrimit dixhital sipas ElGamalit nuk duhet ngatërruar me shifrimin ElGamal.

Siguria e këtij kriptosistemi ashtu si dhe shkëmbimi i çelësave sipas Diffie – Hellman varet nga problemi i logaritmit diskret. Veprimet për shifrimi e deshifrimi kryen në një fushë Z_q

Ashtu si edhe shumë kriptosisteme të tjerë publik, përdoret më së shumti për transmetimin e çelësive të kriptosistemeve të ndryshme simetrik me qëllim që transmetimi të jetë sa më efektiv.

Algoritmi i shifrimit në kriptosistemin ElGamal është i randomizuar meqë teksti i shifruar varet jo vetëm nga teksti i hapur M por edhe nga vlera e rastit e parametrimit k (çelësit privat) të zgjedhur nga dërguesi. Kjo bën që të njëjtit tekst të hapur ti korespondojnë disa tekste të shifruara duke rritur kështu ndjeshëm sigurinë e tij.

ALGORITMI I SHIFRIMIT DHE DESHIFRIMIT NË KRIPTOSISTEMIN ELGAMAL

Fillimisht fiksohet një unazë me karakteristikë të fundme relativisht të madhe Z_q (por ne shembujt e konsideruar në këtë material karakteristika do jetë e vogël me qëllim studimor), një element g nga kjo fushë (preferohet të jetë gjenerues i saj por jo domosdoshmërisht).

- Tekstin e hapur që duhet transmetuar fillimisht e kemi kthyer nga alfanumerik në element të grupit Z_q dhe e shënojmë me M .
- Çdo përdorues A (Alice) zgjedh në mënyrë të rastësishme një numër të plotë a në intervalin $0 < a < q - 1$. Numri i zgjedhur a është çelësi sekret i cili do të përdoret për deshifrimin e mesazhit. Çelësi publik i Alice është elementi g^a nga fusha Z_q .
- Për ti dërguar Alice një mesazh M , Bob zgjedh një numër të plotë k në mënyrë të rastësishme, dhe i dërgon asaj çiftin (g^k, Mg^{ak}) nga Z_q . Çdokush mund ta bëjë këtë sepse mund të llogaritet g^{ak} pa pasur njohuri mbi çelësin privat a .
- Alice e cila ka këtë çelës mund ta lexoj mesazhin duke marrë $Mg^{ak} (g^k)^{q-a-1} \pmod q$.

Nëse një përgjues i mundshëm arrin të zgjidh problemin e logaritmit diskret në fushën Z_q , e thyen kriptosistemin duke gjetur kështu çelësin e deshifrimit a nga çelësi publik g^a .

GABIMET NË ELGAMAL MBI FUSHËN Z_q DHE PËRZGJEDHJA E PËRSHTATSHME E ÇELËSAVE

Shohim tani disa prej kushteve të këtij kriptosistemi me qëllim ndërtimin e shembujve, ushtrimeve e sistemeve të fortë e diagnostik. Gjatë zbatimit të tij duhet pasur parasysh se:

1. Algoritmi i shifrimit dhe deshifrimit zbatohet mbi një grup ciklik me rend q relativisht të madh (për të krijuar shembuj provë ky rend është marrë shumë i vogël krahasuar me përmasat reale që duhet të ketë)

Si çelësa privat-publik duhen zgjedhur :

2. $a \neq 1$. Nëse çelësi privat do merrte vlerën 1 atëherë gjatë procesit të shifrimit do transmetohej teksti i shifruar (g^k, Mg^{1k}) dhe për të deshifruar mesazhin mjafton të llogarisim $Mg^k(g^k)^{-1} \bmod q = M$. Meqë veprimet kryen në një fushë me karakteristike q atëherë çdokush mund ta llogaris $(g^k)^{-1}$ dhe të lexoj tekstin e hapur sepse e njeh parametrin publik q dhe tekstin e shifruar (g^k, Mg^k) . Gjithashtu mund të krijohet ideja se nuk është e nevojshme formula për deshifrimin $Mg^{ak} (g^k)^{q-a-1} \bmod q$ por mjafton të shumëzojmë me të anasjellin e elementit të parë të çiftit të dhënë. Kjo do të çonte në përfundimin se çdo tekst i shifruar mund të deshifrohej lehtësisht pa pasur nevojë për çelësin privat. Gjë që e cënon totalisht sigurinë e kriptosistemit.
3. $a \neq q-1$ nëse marrim $a = q-1$ do kishim $(g^k, Mg^{(q-1)k}) \bmod q$ e cila nga teorema e Fermait do ishte $(g^k, M \cdot I^k) \bmod q = (g^k, M) \bmod q$ duke transmetuar kështu tekstin e hapur.
4. $a \neq g$ Nëse marrim $a=g$ atëherë mesazhet të cilat i adresohen Alice mund ti lexoj edhe Bob sepse parametrin g e kanë të dyja palët. Nga ana tjetër, gjatë veprimeve për deshifrim, studentit mund ti krijohet ideja se ky parametër është i pa nevojshëm, duke cënuar kështu kushtet e kriptosistemit. Për ta shmangur këtë gabim, mjafton që në algoritmin Maple të shtojmë kushtin $a \neq g$

Figura 3.1.2.a

```

> a := Generate(posint(range = q)) : if (a = g)
    then jep nje vlere tjetër te celesit privat a sepse eshte i
    barabarte me parametrin else a := a end if;
250632 jep nje vlere tjetër te celesit privat sepse eshte barabarte
    me parametrin

```

5. $k \neq a$ Nëse ndodh që $k=a$ atëherë Bob mund të lexoj të gjithë tekstet e shifruara të adresuar për Alice. Nga ana tjetër $Mg^{aa} (g^a)^{q-a-1} \bmod q = M$ por edhe një përgjues i mundshëm pas disa provave (a provave) $Mg^{aa} (g^a)^{-1} (g^a)^{-1} \dots (g^a)^{-1} \bmod q = M$ mund të zbulojë tekstin e hapur, madje edhe të zbulojë çelësin privat a pasi është i njëjtë me nr e provave. Kjo gjë do çonte edhe në thyerje të kriptosistemit. Një rast i tillë i gjeneruar nga algoritmi i ndërtuar është lustruar në figurë. Tregohet kështu mesazh që sistem afishon lidhur me këtë gabim dhe s duhet vepruar për ta shmangur atë.

Figura 3.1.2.b

```

> k := Generate(posint(range = q)) : if (k = a)
    then "ndrysho vleren e parametrin k sepse është e njëjtë me
    a " else k := k end if;
= "ndrysho vleren e parametrin k sepse është e njëjtë me a "

```

6. $g^k \neq a$ sepse përndryshe $M = Mg^{ak} (g^k)^{q-a-1} \bmod q = Ma^a (a)^{q-a-1} \bmod q$ kështu edhe një ndërhyrës i mundshëm i cili është në dijeni të tekstit të shifruar (g^k, Mg^{ak}) që në këtë rast merr trajtën (a, Ma^a) e ka shumë të lehtë ta deshifroj atë duke përfutur kështu në mënyrë direkte tekstin e hapur. Kjo për sa i përket sigurisë së kriptosistemit. Nga ana tjetër, për ndërtimin e sistemeve të fortë ose diagnostik, një gabim i tillë mund të çoj në një gabim konceptual të kriptosistemit. E stimulon studentin të supozoj se nuk është e domosdoshme zgjedhja rastësore e parametrin k për të ndjekur skemën e ElGamal, gjë e cila do të çenonte totalisht kushtet e kriptosistemit. Për të shmangur këtë gabim, gjatë ndërtimit të algoritmit për sisteme të fortë e diagnostik në njërin nga gjuhët e programimit ose softuerët e përdorur mjafton të shtojmë kushtin $g^k \neq a$. (Nëse kërkojmë

të gjenerojmë një sistem diagnostik duhet shtuar dhe një koment përkatës që të kujton se cili gabim është kryer e cilat janë pasojat)

7. Mund të ndodh që në vend të $Mg^{ak} (g^k)^{q-a-1} \bmod q$ të merret $g^k (Mg^{ak})^{q-a-1} \bmod q$ dhe rezultati të jetë i njëjtë prandaj në algoritmin e ndërtuar duhet vendosur kushti $Mg^{ak} (g^k)^{q-a-1} \bmod q \neq g^k (Mg^{ak})^{q-a-1} \bmod q$ që këto dy mesazhe të jenë të ndryshme. Një rast i tillë është vërejtur gjatë zbatimit të algoritmit në male për gjenerimin e sistemeve diagnostik sipas ElGamalit siç tregohet në figurën e më poshtme:

```
> if M1 = M2
    then ndrysho parametrin k sepse mesazhi eshte perftuar
        duke nderruar vendet e y1 me y2 ne algoritmin e deshifrimit
    else M1 end if;
16 ndrysho parametrin sepse mesazhi eshte perftuar duke
    nderruar vendet e me [0, 0, 4] ne algoritmin deshifrimit
```

8. Në tjetër gabim që mund të reflektohet është edhe rasti kur $g^k \bmod q = Mg^{ak} \bmod q$ duke shënuar për lehtësi $y_1 = g^k \bmod q$ dhe $y_2 = Mg^{ak} \bmod q$, do kishim rastin kur si gabim merret $y_1 = y_2$. Kështu po të zbatojmë algoritmin e deshifrimit sipas ElGamalit përftojme si mesazh vetem $M=1 \bmod q$, që do të thotë se një gabim i tillë mund të shfaqet në rastin kur $M=1$.

```
> y2 := ([M[1]g^{a.k}, M[2]g^{a.k}, M[3]g^{a.k}]) mod q;
> if y2 = y1 then ndrysho vleren e a else y2 end if;
    ndrysho vleren e a
```

9. Veprimet për llogaritjen e tekstit të shifruar duhet të kryen sipas modulit q dhe jo q-1 si në rastin e llogaritjes së çelësave në ndonjë kriptosistem tjetër (Massey – Omura, etj...)

HAPAT E NDËRTIMIT TË SISTEMEVE TË FORTA E DIAGNOSTIKË

Në vazhdim paraqitet mënyra e ndërtimit të sistemeve, ushtrimeve e shembujve të ndryshëm diagnostik si edhe të fortë. Jepet gjithashtu edhe pseudokodi përkatës i cili i shmang këto gabime për rastin e kriptosistemit ElGamal mbi fushat e fundme.

- Zgjidhet një fushë e fundme.
- Kthehet teksti në element të fushës së zgjedhur me anë të një funksioni shifrimi ose të një hash funksioni.
- Zgjidhen çelësat privat a, k që plotësojnë kushtet e trajtuara më sipër.
- Zgjidhen çelësat publik g, g^a që plotësojnë kushtet e dhëna.
- Vendosen kushtet për kriptosistemin dhe çelësat si edhe komentet përkatëse për secilin rast të gabimeve në mënyrë që të gjenerohen sisteme ose ushtrime diagnostikë.
- Çelësat konvertohen në sistem binar për të zbatuar më pas algoritmin katror shumëzim lidhur me fuqinë modulare.
- Vendosen kushtet për tekstin e hapur dhe tekstin e shifruar gjatë procesit të shifrimit e deshifrimit siç janë përmendur më lartë.

Në vijim jepet një pseudokod për ndërtimin e sistemeve të fortë në rastin e ElGamal mbi fushat e fundme (më konkretisht në Z_q).

Algoritmi KatrorShumëzim

Hyrje: Fusha e fundme Z_q , $M \in Z_q$, $l = \sum_{i=0}^t l_i \cdot 2^i$ dhe $l_i = 1$

Dalje: $T = M^l$

Algoritmi ElGamal

Hyrje: q numër i thjeshtë $< Rg$, $M \in Z_q$

Dalje: $M \in Z_q$ shifrim dhe deshifrimi i M sipas kriptosistemit ElGamal mbi fushat e fundme.

Algoritmi:

Fillim

$Rg = 2^6$

Çelës_a = True

Çelës_k = True

Gjersa Çelës_a bëj

```
{
    a=Numër_Plotë(1,q-1)
    Nqs (pmp(a,q-1)=1 dhe pmp (a,q)=1) atëherë
    {
        P=KatrorShumëzim (g,Konvertbinar(a))
        Nqs (P =a ose P=M ose a=1 ose a=q-1) atëherë
        Çelës_a= False
    }
}
```

Gjersa Çelës_k bëj

```
{
    k=Numër_Plotë(1,q-1)
    Nqs (pmp(k,q-1)=1 dhe pmp (k,q)=1) atëherë
    {
        Nqs (k≠a dhe k≠ P dhe k≠M ) atëherë
        {
            y1= KatrorShumëzim (g,Konvertbinar(k))
            Nqs (y1=a ose y1=k ose y1= P) atëherë
            Çelës_k= False
        }
    }
}
```

B= KatrorShumëzim(y₁,Konvertbinar(a))

y₂=M*B mod q

Nqs (y₂ = M mod q ose y₂ = M mod q-1 ose y₂ = y₁ mod q)atëherë Çelës_k= False

C=vektor(y₁, y₂)

D=KatrorShumëzim (y₁,Konvertbinar(q-a-1))

Nqs (D= M mod q ose D= y₂ mod q) atëherë Çelës_a= False

M= y₂*D mod q

Nqs M= $y_1 * \text{KatrörShumëzim}(y_2, \text{Konvertbinar}(q-a-1))$

{

 Çelës_a = False

}

Kthe (C,M)

KONKLUZION

Duke marr shtysë nga përmirësimi i parë dhe i dytë i kriptosistemit Massey – Omura, Në këtë punim paraqitet dhe një mundësi për përmirësimin e kriptosistemit ElGamal duke i kaluar veprimet nga një fushë e fundme Z_q në një grup me rend të fundëm $U(Z_n)$. Në këtë rast veprimet nuk kryen më sipas një moduli të thjeshtë q por sipas modulit $n=pq$ ku p dhe q janë dy faktor të thjeshtë. Hapat për shifrim dhe deshifrim do ishin të njëjta me ato të kriptosistemit klasik ElGamal porse të përkthyer tashmë në grupin $U(Z_n)$.

Referenca:

1. A. BAXHAKU, K. NAKA “Një problem gjeometrik i antikitetit në një protokoll me njohje zero dhe në zgjerimet algjebrike të fushave” ;
2. Richard WINTON, “Enhancing the Massey-Omura Cryptosystem”, Journal of Mathematical Sciences & Mathematics Education Vol. 7 No. 1;
3. CHONG, S.K., Farr G., Frost L., Hawley S., “On pedagogically sound examples in public-key cryptography”, ACSC 2006;
4. Dolantina HYKA, Ardi BENUSI, “Some cryptographic weakness and the ways to avoid them in ict services of developing countries”, European Journal of Sustainable Development (2014), 3, 2, 73-88 ISSN: 2239-5938.;
5. Dolantina HYKA, Artur BAXHAKU , “Some Maple algorithms generating diagnostically / strong cryptographic examples.” International Jurnal of Science, Innovation and new Tecnology, Vol 1, No.9 February 2014 Printed ISSN 2223-2257, Oline ISSN 2225-0751.

**PLATFORMA E-LEARNING DHE ROLI INKURAJUES I MODELIT KONEKTIVIST
PERSPEKTIVA PSIKOLOGJIKE NË FUQIZIMIN E EDUKIMIT NË DISTANCË**

Msc. Ela TOLLKUÇI

ShLP `Mesdhetare e Shqipërisë`, Adresa: Blv. Gjergj Fishta, Nr.52,

Kodi Postar: 1023, Tiranë

ela.tollkuci@umsh.edu.al

PhD. Brikena BALLI

Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale,

Adresa: Blv. Gjergj Fishta, Tiranë

ballibrikena@gmail.com

ABSTRAKT

Fenomeni i edukimit në distancë, i njohur ndryshe si e-learning, ka lindur shumë kohë më parë por është futur në përdorim sidomos pas viteve 2000 me zhvillimin e gjerë të internetit. Vetë termi e-learning përkufizohet si përdorimi multimedial i internetit në arsim. Përgjithësisht identifikohen dy forma të veçanta e-learning: Synchronous training e-learning, të mësuarit e nxënësve dhe studentëve duke ndërvepruar me mësuesit me anën e web-it dhe në kohë reale; Asynchronous training e-learning, të mësuarit nëpërmjet ndërveprimit jo në kohë reale.

Forma e parë e-learning, që është ajo më në interes të këtij punimi, ka gjetur një përdorim të gjerë sidomos duke filluar nga viti 2010 nëpërmjet MOOCs ose kurseve gratis online. Këto kurse janë të vlefshme për të gjithë dhe kanë si objektiv të vetëm disponibilitetin në rrjet të formave të mësimdhënies universitare. Bazat psiko-sociale për funksionimin e formateve të tilla të të nxënësve e kanë origjinën tek modeli teorik i të Mësuarit Social. Megjithatë, është Konektivizmi i njohur si evolucioni në kohë të teorisë së të Mësuarit Social në botën digjitale, që analizon më nga afër efektet e teknologjisë në mënyrën tonë të komunikuarit dhe të mësuarit. Sot besohet se strukturimi i platformave e-learning sipas principeve të Konektivizmit do të sjellë rezultate inkurajuese duke rritur ndejshëm efikasitetin e këtyre platformave. Ky aspekt, si dhe konsekuencat më të përgjithshme psikologjike të mësimdhënies on-line, do të analizohen gjatë këtij punimi. Në fokus do të jenë konsekuencat pozitive të e-learning në tre aspekte kryesore të motivimit: motivimi drejt njohjes, motivimi drejt vetë-afirmimit dhe motivimi drejt shoqërizimit.

Në përfundim të punimit, do të analizohet niveli i integritimit brenda sistemit arsimor Shqiptar i platformave e-learning dhe prespektivat psiko-pedagogjike në fuqizimin e dyanshëm mësues-nxënës.

Fjalë Kyçe: *E-learnig, Synchronous training e-learning, Asynchronous training e-learning, MOOCs, Connectivism.*

HYRJE

Arsimimi në distancë përfaqëson çdo formë që lejon realizimin e procesit të mësimdhënies dhe të nxënës pa nevojën e një komunikimi të drejtpërdrejtë midis mësuesit dhe nxënësit apo pedagogut dhe studentit. Në këtë pikëpamje, edhe e-learning është një tipologji e veçantë edukimi në distancë. E-learning nënkupton përdorimin multimedial dhe të internetit në arsim. Kjo terminologji e përdorur, përfaqëson të gjitha format didaktike-elektronike që nxisin të mësuarin dhe mësimdhënien. E-learning mund të realizohet si brenda ashtu edhe jashtë ambjenteve të një klase: në rastin e parë, përdorimi i mjeteve multimediale bëhet për të realizuar mësimin, që do të thotë se në këtë kontekst ka një përdorim instrumental. Në rastin e dytë, i referohemi kurseve online që nxënësit ose studentët mund të ndjekin edhe jashtë orarit të zakonshëm të mësimdhënies.

PERSPEKTIVA PSIKOLOGJIKE NË FUQIZIMIN E EDUKIMIT NË DISTANCË

Në përgjithësi, mund të thuhet se futja e internetit dhe e mbështetjes multimediale në sistemin universitar, ka patur një impakt të madh pozitiv mbi të gjithë aktorët përbërës të sistemit. Për pedagogoët është kthyer në një mbështetje për zhvillimin e orës së leksionit në atë nivel sa që pjesa më dërrmuese e lektorëve përdorin slide që ngarkohen nëpërmjet internetit dhe që prezantohen nëpërmjet një projektori të sinkronizuar me kompiuterin. Studentët kanë përfituar nga përdorimi i kompiuterit personal në mbajtjen e shënimeve dhe gjatë lundrimit për të kërkuar informacione që ndihmojnë procesin e të mësuarit.

Në përgjithësi identifikohen dy tipologji të e-learning (Colli, 2013):

1. *Synchronous training e-learning*: termi sinkronik nënkupton "në të njëjtën kohë", pasi në fakt kjo lloj mësimdhënie përfshin një bashkëveprim të nxënësve dhe mësuesit nëpërmjet internetit në kohë reale. Bëhet fjalë për klasa të vërteta interneti, ku pjesëmarrësit komunikojnë me njëri-tjetrin me anë të mesazheve të çastit, chatit, audios dhe video konferencave; gjithashtu, të gjitha mësimet janë të regjistruara dhe mund të rishihen në çdo kohë. Përfitimet që një natyrë e tillë e të arsimuarit mund të sjellë janë të disa llojshme: mundësia për të ndjekur dhe për të regjistruar aktivitetet mësimore; mundësia e një monitorimi të vazhdueshëm; mundësia për të personalizuar formimin e secilit nxënës; përfshirja në një komunitet global si dhe mundësia për të bashkëpunuar me studentë të tjerë që vijnë nga vende, kultura dhe formime të ndryshme.
2. *Asynchronous training e-learning*: në këtë rast, ndërveprimi midis nxënësit dhe mësuesit nuk realizohet në kohë reale. Bëhet fjalë për regjistrime dhe materiale video që mund të konsultohen atëherë kur koha në dispozicion është e mjaftueshme. Avantazhi i këtij modeli e-learning është fakti se nxënësve i ofrohen informacionet që i nevojiten, në një kohë më të përshtatshme për ta. Përfitimi kryesor i referohet fleksibilitetit që ofron mundësia për të patur akses në çdo vend e në çdo kohë. Si gjatë trajnimit sinkronik ashtu edhe atij jo-sinkronik përdoruesi është pjesë e një komuniteti global ku vendosen marrëdhënie virtuale dhe shkëmbehen informacione nëpërmjet forumeve.
Duke nisur nga viti 2010, një ndryshim i madh shfaqet në sistemin e arsimit të lartë nëpërmjet futjes së kurseve online të njohur si *MOOCs* ose, *massive online open courses*, siç mund të njihen ndryshe, të cilat janë të përhapura gjerësisht dhe të disponueshme në rrjet dhe krijohen në bashkëpunim me universitetet. *MOOCs*, janë shpesh të përcaktuara si një kryqëzim midis arsimit të lartë ose universitar, mediave sociale, teknologjive dhe praktikave online që mundësojnë shkëmbimin e njohurive dhe të mësuarit kolektiv, ose të një model të mësuarit që bazohet në rritjen e bashkëpunimit duke vënë në dispozicion, në mbarë botën, leksionet e profesorëve më në zë të universiteteve më të njohura. Aspektet kryesore positive të platformave *MOOCs* mund të rradhiten si më poshtë (Colli, 2013):
 - Fleksibilitet në lidhje me kohën dhe vendodhjen e studimit
 - Aksesueshmëri në arsimin e lartë
 - Kurse cilësore në nivelin e atyre që ofrohen nga universitete më në zë të botës
 - Kurse pa pagesë

- Në shumë raste, një vlerësim formal në fund të kursit shoqërohet me një Certifikatë përfundimtare.

Nga 2010 platforma *MOOCs* ka patur një përhapje shumë të shpejtë. Pikëkthesa kryesore nga kurset e mëparshme në internet, siç ishin ato të ofruara përsëdrejti nga Universitetet Harvard dhe Yale, janë mundësia për t'i ndjekur pa pagesë, falë çeljes së *Start-Up-ve* fillestare si Udacity, e themeluar nga një profesor i Standfort Universitetit, EDX, e themeluar nga bashkëpunimi midis Harvard dhe MIT dhe Coursera, e themeluar nga Andrew Nig dhe Daphne Koller, Profesor në Universitetin e Stanfordit, duke ofruar kurse online pa pagesë. Këto *Start-Up* kanë krijuar platformat virtuale, të quajtur zakonisht si Platformat *MOOCs*, të cilave çdokush mund t'i bashkangjitet duke patur akses të lirë.

Filozofia që qëndron në themel të çeljes së platformave në internet është të bërit e arsimit të arritshëm nga të gjithë. Këto platforma mundësojnë një eksperiencë virtuale të kurseve Universitare për të gjithë ata që nuk kanë mundësira si pasojë e kushtëzimeve ekonomike, gjeografike dhe të moshës (Colli, 2013).

Ky sukses i madh dhe i pabesueshëm i platformës *MOOCs*, u zhvilluara nga Profesor Siemens në vitin 2008 dhe është ende duke u konsideruar si një pikë referimi për të gjitha aspektet që lidhen me proceset e mësimdhënies dhe të nxënimit përmes platformave online duke u projektuar mbi bazën e udhëzive të një modeli psikologjik të njohur si Konektivizmi⁶⁸.

Modeli Konektivist, i formuluar për herë të parë nga profesor George Siemens (2005) që është një nga ekspertët më të shquar në botën e të mësuarit të lirë, përqendrohet në efektet që teknologjia ka në mënyrën se si ne të komunikojnë dhe veçanërisht sesi nxëmë. Ky model, konsiderohet si zhvillimi i teorisë së të Mësuarit Social të Albert Bandurës (1977) i aplikuar në botën dixhitale. Sipas kësaj teorie, që është bërë gjithnjë e më e njohur dhe e vlerësuar (siç tregohet nga studimet e shumta të kryera në Universitetin Stanford dhe sidomos me eksperimentin e famshëm të "Kukullës Bobo" duke eushëndërruar në teori themelore për studimet akademike) procesi i të mësuarit të një individi nuk është vetëm dhe ekskluzivisht nga

⁶⁸ Brugnoni, G, 2014. <http://www.gamification.it/gamification/apprendimento-sociale-connettivismo-e-gamification>

kontakti i drejtpërdrejtë me një objekt, por edhe nga përvoja e tërthortë nëpërmjet njerëze të tjerë⁶⁹. Në praktikë, duke e thjeshtëzuar dhe përmbledhur për qëllime interpretuese, sipas teorisë së të mësuarit shoqëror, sjellja jonë do të ndryshojë në bazë të asaj që vërejmë në sjelljen e njerëzve të tjerë, duke u "modeluar" nisur nga përgjigja e tyre. Siç thotë Downes (2007): *“të mësuarit është të modelosh dhe të demonstrososh kurse të nxësnet është të praktikosh dhe të reflektosh”*. Është këtu që hyn në lojë Konektivizmi, i cili modifikon teoritë kryesore ekzistuese të psikologjisë (si Konstruktivizmi, Konjitivizmi dhe Bihevizimi) duke i orientuar ato drejt mjeteve të reja të komunikimit dhe ndërlidhjes dhe duke mundësuar kështu projektimin e platformave dixhitale të cilat nxisin në masë procesin e të mësimit dhe të nxënimit.

Gjithçka nisët nga presupozimi që bota si një e tërë, tashmë e ndryshuar thellësisht, është transformuar në krahasim me të kaluarën e afërt, duke gjetur veten shumë të ndërlidhur përmes internetit. Mënyra se si ne perceptojmë realitetin "dixhital" tani ka ndryshuar, duke i dhënë atij një peshë dhe një substancë që e bën çdo ditë e më të barabartë me "realitetin" në vetëvete. Sipas këtij parimi, përvojat që transmetohen përmes teknologjisë së re realizojnë një proces të nxënimit që lidhet me perceptimin sikurse dhe për njerëzit që mësojnë brenda një konteksti social. Konektivizmi, trajton hendekun midis procesit të të mësuarit që vjen nga jashtë, nëpërmjet teknologjisë, dhe mënyrës sesi realizohet procesi mësimor i organizuar⁷⁰. Të strukturosh në këtë mënyrë platformat e-learning, duke ndjekur parimet e konektivizmit, prodhon rezultate inkurajuese, duke maksimizuar rendimentin dhe efikasitetin e platformës. Siç thotë Siemens (2005): *“Në mjedisin e sotëm, veprimi është shpesh i nevojshëm edhe pa të nxënin personal – për këtë arsye, ne duhet të veprojmë duke tërhequr informacion nga jashtë, përtej njohurive tona bazilare. Aftësia për të sintetizuar dhe për të njohur lidhjet dhe modelet është shumë e vlefshme”*

Ajo që duhet të kemi parasysh janë disa parime kryesore mbi të cilat bazohet Konektivizmi Siemens (2005):

- Të mësuarit është i bazuar në diferencën e mendimeve

⁶⁹ McLeod, 2016. <http://www.simplypsychology.org/bandura.html>

⁷⁰ Connectivism: A Digital Social Learning Theory, 2011. <http://www.mhëilleke.com/connectivism-a-digital-social-learning-theory>

- Të mësuarit është një process lidhjesh me anë "nyjesh" të specializuara ose si burim informacioni
- Të mësuarit mund të qëndrojë në aplikime jo-njerëzore
- Të ushqesh dhe të ruash lidhjet është e nevojshme për të lehtësuar të mësuarin gjatë gjithë jetës
- Marrja e një vendimi është në vetvete një proces të mësuarit

Në këtë pikë, duhet theksuar sesi parimet e mësipërme, karakterizohen nga një ngjashmëri e madhe me parimet mbi të cilat bazohet mekanika e aplikacioneve të lojërave elektronike. Krijimi i një gjenerate të shkëmbimit të informacionit, edhe me anë të mjeteve jo-njerëzore, krijimi i një rrjeti kontaktesh aktive që lejon shtresëzimin e informacionit të fituar dhe rëndësia e marrjes së vendimeve aktive të orientuara dejt përfitimit të informacionit janë elemente që gjenden gjithkund në mekanikën e lojërave elektronike, veçanërisht në qoftë se aplikohen për grupe të mëdha njerëzish⁷¹.

Së fundmi, duhet të vihet në dukje një tjetër ngjashmëri e rëndësishme midis Konektivizmit dhe lojërave elektronike, pasi një aspekt i veçantë i teorisë Konektiviste është përdorimi i një rrjeti "nyjesh" dhe lidhjesh të destinuara, si një metaforë, për të shpjeguar mënyrën sesi proceset e të nxënit zhvillohen. Sipas kësaj metafore, një "nyje" është gjithçka që mund të jetë e lidhur me një tjetër nyje. Nyjet mund të jenë të dhënat, imazhe, etj, të cilat mund të transmetohet lehtësisht me anë të një platforme lojërash elektronike. Duhet theksuar se të mësuarit në këtë kontekst, është një proces që krijon lidhje dhe zhvillon një rrjet, që është pikërisht ajo çka ndodh në një platformë e-learning të huazuar nga ajo e lojërave elektronike.

Në një studim me fokus përmirësimin e cilësisë së përgatitjes së mësuesve (Domenici, Biasi, Ciraci, 2014), autorët u nisen nga fakti se, mbi bazën e dëshmimeve të disa studime të rëndësishme, rezultoi një lidhje e ngushtë midis cilësisë profesionale të mësuesve dhe performancën së nxënësve (Darling-Hammond et al, 2005; Rivkin, Hanushek dhe Kain, 2005). Në këtë kuadër, puna e studiuesve të Departamentit të Shkencave të Edukimit në Universitetin "Roma Tre", përfshiu 287 mësues që shërbenin në shkollat fillore të Rajonit të Lazios të diplomuar në Shkenca Edukimi nëpërmjet platformës e-learning të Universitetit " Roma Tre". Kjo mënyrë e re

⁷¹ Brugoni. G, 2014. <http://www.gamification.it/gamification/apprendimento-sociale-connettivismo-e-gamification>

formimi e-learnig, prodhon perceptimin e një ndryshimi në stilin ndërveprues të huazuar nga lektorët tek të cilët formohet në këtë formë një kapacitet perceptues për të kuptuar të tjerët si dhe një fleksibilitet mendor dhe një kreativitet që i bashkangjiten konceptit të *problem solving*. Ky qëndrim, lidhet edhe me perceptimin e të paturit më shumë burime për të përballuar vështirësitë profesionale. Të njohësh dhe të komunikosh më mirë me atë që ke përball çon drejt një përmirësimi të kapacitetit për të ndërvepruar dhe zhvillon një qëndrim pozitiv në fushën e marrëdhënieve edukative, duke fuqizuar kështu procesin e të nxënit dhe duke shtuar mundësitë e arritjes së rezultateve përgjatë formimit të marrë.

Gjithashtu, të një rëndësie të veçantë për realizimin e mirë të të nxënit multimedial përmes e-learnig, janë të gjitha aspektet konjitive, emocionale dhe motivuese të cilat studiohen në thellësi nga shkenca e psikologjisë. Rëndësia e këtyre faktorëve është vënë në dukje nga një studim i dytë i një grupi kërkuesish të Universitetit `La Sapienza` dhe `Roma Tre` në Itali të cilët u fokusuan në rolin e komponentëve psikologjik dhe të tutorit shkencor gjatë të nxënit on-line (Biasi, D`Aloise, Longo, 2013). Sipas këtij studimi, evidentohet se, për të analizuar proceset konjitive dhe afektive në bazë të procesit të të nxënit on-line si dhe të nxënit në përgjithësi, këndvështrimi psikologjik është shumë i rëndësishëm. Në mënyrë të veçantë, në detyrën e tutorimit, është e lehtë të identifikohet ndikimi thelbësor që ka kjo kujdestari për aspektet psikologjike të marrëdhënies edukative, për aspektet motivuese, ndërvepruese dhe për ndikimin e këtyre faktorëve në realizimin e mirë të procesit të nxënies. Idea që roli i figurës tutoriale është thelbësore për suksesin e të nxënit është e vërtetë deri në masën që, abandonimi i ndjekjes së kursve nga ana e studentëve është shpesh herë i lidhur me ndërhyrjen e pa përshtatshme nga ana e një tutori në menaxhimin e dinamikave të komunikimit në rrjet ose në përvetësimin e materialeve gjatë të nxënit (Trentin, 2001). Motivimi drejt të nxënit është shpesh herë i nënvlerësuar ndërkohë që përbën një faktor thelbësor për efikasitetin e të nxënit në vetëvete. Ky faktor, duhet të konsiderohet si një dimension i ri që duhet marrë parasysh gjatë programimit dhe vlerësimit të platformave e-learning. Këto vlerësime integrohen me vizionin sipas së cilit motivimi ka një efekt parësor në meta-konjeksion (vetë-efikasitet, verë-menaxhim, etj). Gjithashtu, në rolin e tutorit përfshihet edhe menaxhimi dhe gjetja e informacionit si dhe ndërveprimi i vazhdueshëm me studentin, që është kusht i domosdoshëm për realizimin e mësimdhënies së individualizuar. Në përfundim, mund të thuhet se nga pikëpamja psikologjike,

funkcioni i tutorit i referohet sa aspekteve konjitive të lidhura me përmbajtjen e lëndës, ashtu edhe komponentëve mbështetës të natyrës afektive dhe ndërvepruese.

Në kontekstin shqiptar, klasat on-line dhe tiplogjitë e të mësuarit e-learning, janë praktika shumë të reja që karakterizohen nga eksperiencia fillestare në nivelin e mësimdhënies parauniversitare që përcillen me ndihmën e një platforme edukative pa pageë. Kjo platform, e njohur si ALMOOC⁷², ka në përmbajtjen e saj, deri më tani, pesë kurse për nivel nxënësish të klasave 9-vjeçare në lëndët: anglisht, kodim, matematikë, fizikë dhe kimi. Një platform e tillë është aktualisht e mundur vetëm në bashkëpunim me shkollat 9-vjeçare të Kosovës pavarësisht se janë duke u bërë përpjekje që në këtë projekt të përfshihen edhe institucionet e formimit parauniversitar në të gjithë Shqipërinë. Ndër vështirësitë kryesore që hasen në kontekstin tonë për të përqafuar platforma të tilla innovative, është mungesa e pajisjes me teknologjinë e përshtatshme dhe me laboratorët e informatikës për regjistrimin dhe përshtatjen në formation online të orës të mësimi.

KONKLUZION

Së fundmi, në Kosovë do të vijë në shtator Universiteti i parë on-line për inxhinierë të softuerit. Synimi i këtij Universiteti do të jetë krijimi i inxhinierëve të softuerit, të cilët do të kenë mundësinë të marrin leksione nga profesorë eminentë të teknologjisë informative. Universiteti do të ofrojë një program dyvjeçar në të cilin, në vitin e parë, studentët do të përvetësojnë teorinë dhe punën praktike, kurse në vitin e dytë akademik do të përfshihen për së drejti në projekte. Të gjithë të rinjtë me aftësi në kodim, sikurse dhe ata që ndjekin studimet e shkencave kompjuterike, do të kenë mundësinë të aplikojnë në këtë universitet, përmes një ëbfaqeje zyrtare të Universitetit.

⁷² ALMOOC, 2016. www.Almooc.com

Referenza:

1. ALMOOC, 2016. www.Almooc.com;
2. Biasi.V, D`Aloise. D, Longo. S, 2013. Componenti psicologiche del ruolo del tutor scientifico nell'apprendimento on-line. ECPS Journal – 7/2013; <http://www.ledonline.it/ECPS-Journal/>;
3. Brugnoli. G, 2014. <http://www.gamification.it/gamification/apprendimento-sociale-connettivismo-e-gamification>;
4. Colli. C, 2013. Temè Diplome: e-learning: I massive open online courses e il loro impatto sull'istruzione universitaria. Facoltà di Economia “Marco Biagi”, Università degli studi di Modena e Reggio Emilia, Italia.
5. Connectivism: A Digital Social Learning Theory, 2011; <http://www.mhwilleke.com/connectivism-a-digital-social-learning-theory>
6. Darling-Hammond, L. et al. (2005). Does teacher preparation matter? Evidence about teacher certification, teach for America, and teacher effectiveness. Education Policy Analysis. Archives, 13(42) 16-20;
7. Domenici. G, Biasi. V, Ciraci. A. M, 2014. Formazione e-learning degli insegnanti e pensiero creative. ECPS Journal – 10/2014. <http://www.ledonline.it/ECPS-Journal/>;
8. Downes, S. (2007). An introduction to connective knowledge. In T. Hug (Ed.), Media, Knowledge & Education – Exploring new spaces and dynamics in digital media ecologies. Proceedings of the international conferences held on Jun 25-26;
9. McLeod, 2016. <http://www.simplypsychology.org/bandura.html>;
10. Rivkin, S. G., Hanushek, E. A., & Kain, J. F. (2005). Teachers, schools, and academic achievement. Econometrica, 73(2), 417-458;
11. Siemens, G. (2005). Connectivism: A learning theory for the digital age. International Journal of Instructional Technology and Distance Learning, 2(1);
12. Trentin. G, 2001. Dalla formazione a distanza all'apprendimento in rete. Milano: Franco Angeli.

ON THE INITIAL VALUE PROBLEM OF A DELAY DIFFERENTIAL EQUATION**DISHMEMA Elfrida¹,**

¹Agriculture University of Tirana, Faculty of Economy and Agribusiness,
Mathematics & Computer Science Department, Tirana- Albania

E-mail: elfridadishmema@gmail.com

PETI Elizabeta²

²University of Tirana, Faculty of Natural and Science,
Mathematics Department, Tirana-Albania

E-mail: elisabeta.koci@fshn.edu.al

ABSTRACT

Differential equations constitute one of the most powerful tools of mathematics to the study of processes in natural and physical sciences. Differential problems are characterized by a long series of formulations: functional differential equations, ordinary differential equations (ODE), linear and non-linear delay differential equations (DDE), hybrid equations, partial differential equations (PDE), the impulsive equations and their discrete format (equations with finite difference (FDE)), dynamic systems and many other types. Delay Differential Equations (DDE), also called time delay differential equations are widely used for describing and mathematical modelling of various processes and systems in various applied problems. In this paper are presented the main differences between DDE and ODE. Unlike ODEs, even for linear DDEs, there are no general methods for finding solutions in explicit forms. So, the development of numerical methods for DDEs is a problem with a particular importance. Nowadays, various numerical methods have been constructed for solving DDEs. We have been interested in the study of existence and uniqueness of the Initial Value Problem (IVP) of Delay Differential Equations. We have showed that DDE theory is more general than ODE theory. Although some of the theorems treated in the study are so close to the ODE corresponding version, it has been shown that the proofs of them are quite different. In the study are treated delay differential equations (DDEs) with a constant delay. Also is shown how these equations may be integrated based on the ODE theory. The aim of the study is to present some effective approximations of the Delay Differential Equation Theory.

Keywords: *Delay Differential Equation, Initial Value Problem, existence, uniqueness.*

INTRODUCTION

The Delay Differential Equations (DDEs) can be studied in a similar way for Ordinary Differential Equations (ODEs) in many aspects, and some results are also similar to those for ODEs. However, the DDEs are different from ODEs. One of the most notable feature of a DDE is the infinite-dimensional Banach space, rather than the Euclidean space for ODE. The solution space of a DDE, no matter what dimensions the equation has, is always infinite-dimensional, whereas the solution space of an ODE is of finite dimensions. This can be understood as following. The problem of solving ordinary, delay, neutral and difference differential equations is related with the problem of finding the roots of the characteristic equation. With the study of the nature of these characteristic roots deals the basic theorems of oscillating theory for differential equations. [1], [2].

The equation of order n

$$\alpha_0 y + \alpha_1 y' + \alpha_2 y'' + \dots + \alpha_{n-1} y^{(n-1)} + \alpha_n y^{(n)} = 0, \quad (y = y(t)) \quad (1.1)$$

is a linear homogeneous ordinary differential equation with real constant coefficients $\alpha_i, i = \overline{0, n}$ when $\alpha_n \neq 0$. Finding a solution of (1.1) means finding a function that on some interval, possesses at least n derivatives and satisfies the equation (1.1).

It is clear that for the equation (1.1) the functions having the property

$$\frac{d^k}{dt^k} [f(t)] = cf(t), k = \overline{0, n} \quad (1.2)$$

are of the exponential form $f(t) = e^{\lambda t}$ where λ is constant.

These functions satisfy the property (1.2)

$$\frac{d^k}{dt^k} [e^{\lambda t}] = \lambda^k e^{\lambda t}$$

If we assume that the solutions have the form $y = e^{\lambda t}$ (1.3) where the constant λ will be chosen such that $e^{\lambda t}$ satisfy the equation we have

$$\begin{aligned} y' &= \lambda e^{\lambda t} \\ y'' &= \lambda^2 e^{\lambda t} \\ &\dots \dots \dots \end{aligned}$$

$$y^{(n)} = \lambda^n e^{\lambda t}$$

Substituting in (1.1) we have

$$\alpha_0 e^{\lambda t} + \alpha_1 \lambda e^{\lambda t} + \alpha_2 \lambda^2 e^{\lambda t} + \cdots + \alpha_{n-1} \lambda^{n-1} e^{\lambda t} + \alpha_n \lambda^n e^{\lambda t} = 0$$

By factorising $e^{\lambda t}$

$$(\alpha_0 + \alpha_1 \lambda + \alpha_2 \lambda^2 + \cdots + \alpha_{n-1} \lambda^{n-1} + \alpha_n \lambda^n) e^{\lambda t} = 0$$

Since $e^{\lambda t} \neq 0$ for all t , we obtain the characteristic equation of (1.1)

$$\alpha_0 + \alpha_1 \lambda + \alpha_2 \lambda^2 + \cdots + \alpha_{n-1} \lambda^{n-1} + \alpha_n \lambda^n = 0 \quad (1.4)$$

that is a polynomial equation. $y = e^{\lambda t}$ can be a solution of the equation (1.1) only if λ is a root of the characteristic equation (1.4). If λ is a root of the characteristic equation (1.4) then $y = e^{\lambda t}$ is a solution of the differential equation (1.1). It is easily observed that the characteristic equation (1.4) can be obtained from the differential equation (1.1) by replacing the k -th derivative in (1.1) by λ^k , $k = \overline{0, n}$. The problem of solving the homogeneous equation of the form (1.1) can be reduced to the problem of finding the roots of the characteristic equation associated to it. The equation (1.4) is of degree n ($n \geq 1$) and by the fundamental theorem of algebra we know that it has at least one root, counting multiplicities, exactly n roots.

Delay Differential Equations (DDEs) provide realistic mathematical models for systems in which the rate of change depends not only on their present stage but also on their past history. Minorsky was one of the first investigators to study DDEs and their effects on simple feedback control systems in which communication time can not be neglected. Delay Differential Equations (DDEs) arise naturally in many other systems involving time lags such as population models, models for nuclear reactors, models for epidemics, economic models etc.

The first order linear differential equation with several delay has the form

$$y'(t) + \alpha_1 y(t - \tau_1) + \alpha_2 y(t - \tau_2) + \cdots + \alpha_n y(t - \tau_n) = 0, t \geq t_0$$

or in the short form we can write

$$y'(t) + \sum_{i=1}^n \alpha_i y(t - \tau_i), t \geq t_0 \quad (1.5)$$

where $\alpha_i, \tau_i, i = \overline{1, n}$ are positive constants.

Let y_0 be a function such $y_0 \in C([t_0 - \tau, t_0], R)$ and $\tau = \max\{\tau_1, \tau_2, \dots, \tau_n\}$.

A solution of (1.5) with the initial function y_0 at t_0 is a function $y \in C([t_0 - \tau, \infty], R)$ such that $y(t) = y_0(t)$ for $t_0 - \tau \leq t \leq t_0$, y is continuously differentiable and satisfies (1.5) for $t \geq t_0$.

The characteristic equation of (1.5) is of the form

$$\lambda + \sum_{i=1}^n \alpha_i e^{-\lambda \tau_i} = 0$$

Teknologjia cloud është shfaqur si zhvillim i rëndësishëm në teknologjinë e informacionit. “Cloud Computing” apo “Retë Kompjuterike” janë një model që mundëson qasje të përshtatshme sipas nevojës në një grup të ndarë të resurseve të konfigurueshme kompjuterike si psh.: rrjetat kompjuterike, serverë, aplikacione dhe shërbime të tjera, të cilat klienti mund ti përzgjedhë apo tërheqë lehtësisht me mundimin minimal menaxhues apo me ndërhyrjen e ofruesit të shërbimeve.

Teknologjia Cloud është një teknologji relativisht e re në teknologjinë informative dhe zhvillimi i kësaj teknologjie pritet të jetë i hovshëm. Në vend që ju të instaloni software të veçantë për çdo kompjuter, ju vetëm do të ju duhet që të instaloni një aplikacion që do të përmbajë të gjitha programet që përdoruesit do të kenë nevojë për punën e tij.

Punimi jonë për veq që do të trajtoj infrastrukturën Cloud, ne do të fokusohemi në qështjen e sigurisë së “Cloud Computing”, se në çfarë niveli është siguria në këtë teknologji, ndërsa do të trajtojmë edhe infrastrukturën tradicionale.

Në këtë punim do të merremi në detaje me aspektet e sigurisë në “Cloud Computing”, aspektet e hezitimeve lidhur me termin “Cloud” si një termin që mund të jetë shumë i gjerë, dhe në të njejtën kohë mungesa e kësaj terminologjie të qëndrueshme për cloud ka penguar aspektet e sigurisë në “Cloud Computing”, kritikën për sigurinë në këtë teknologji kan përfshirë një përzierje të vazhdueshme në mes qështjeve aktuale dhe qështjeve të reja.

Ne patjetër që jemi të vetëdijshëm se siguria është njëra ndër qështjet më të rëndësishme në “Cloud Computing”, mirëpo pavarësisht sfidave të sigurisë “Cloud Computing” do të zhvillohet në teknologji. Ambicja jonë është që të krahasojmë aspektet e sigurisë midis infrastrukturës tradicionale dhe teknologjisë Cloud. Aspekti i sigurisë është dhe do të jetë sfidë në gjithë teknologjinë e Internetit prandaj kjo temë mund të jetë aktuale edhe nga shumë aspekte.

Fjalë Kyçe: *Konfidencialiteti, integriteti, autentikimi, rikuperimi i të dhënave në rast fatkeqësie.*

HYRJE

Sot ne nuk mund të mendojmë botën pa internet. Nesër ne nuk mund të mendojmë botën pa Cloud Computing. Cloud Computing do të ndryshojë mënyrën se si teknologjia kompjuterike është duke u përdorur për aktivitete tona të përditshme. Me këto ndryshime, një numër sfidash në fushën e shkencave kompjuterike do të zgjidhen.[1]

Tashmë janë bërë realitet teknologji të tilla si grup kompjuterësh, rrjete dhe së fundmi Cloud Computing. Qëllimi i krijimit të tyre është përdorimi i këtyre burime të fuqishme dhe të virtualizuara, në dukje si një i tërë, për qëllime të ndryshme të individëve, kompanive dhe më gjerë. Cloud Computing është një term i përdorur nga kompanitë e mëdha kompjuterike si Amazon, Google dhe Microsoft, për shërbimet komerciale informatike që ato ofrojnë.

Qëllimi kryesor i këtij modeli është ofrimi i ruajtjes të të dhënave (storage), dhënia e programeve „si shërbim“, për biznese apo individë të cilët i aksesojnë këto në çdo kohë dhe nga çdo vend ku ato ndodhen. Cloud Computing përshkruhet si: iluzionin i burimeve të pafundme, apo mundësia për të paguar “aq sa duhet” as më shumë e as më pak; ndërsa sipas NIST (Instituti Kombëtar i Standardeve dhe Teknologjisë) përcaktohet si: paguaj aq sa e përdor, përdor në çdo kohë që të duhen këto burime informatike (rrjete, servera, të dhënat, aplikacione apo shërbime), merr aq sa të nevojitet, shfrytëzoi kur të duash këto burime.[2]

MODELI REFERENCIAL I TEKNOLOGJISË CLOUD

Teknologjia cloud është një lloj i sistemit paralel dhe të shpërndarë që përbëhet nga një koleksion i kompjuterëve të ndërlidhur dhe virtualizuar që janë parashikuar dhe prezantuar në mënyrë dinamike si një ose më shumë burimeve kompjuterike të unifikuara. Figura 1 ilustron arkitekturën e shtresuar të kësaj teknologjie.



Figura 1. Arkitektura e shtresuar e teknologjisë cloud

Në përgjithësi, arkitektura cloud përcakton 4 shtresa të dallueshme nga hardueri fizikë deri te e fundit aplikacionet e përdoruesëve. Burimet fizike duke përfshirë makina të këmbimit desktop, grupimeve dhe qendra e të dhënave formojnë nivelin më të ulët të shtresës në krye të cilave është vendosur infrastruktura virtuale. Infrastruktura fizike menaxhohet nga shtresa kryesore middleware, objektivi i të cilit është që të sigurojë një ambient të përshtatshëm në kohë për aplikacionet dhe për të maksimizuar përdorimin e burimeve fizike. Në mënyrë që të ofrojë shërbime të avancuara, të tilla si izolimin e aplikimit, cilësia e shërbimit, dhe sandboxing, thelbi i middleware mbështetet në teknologjitë virtuale.[3]

ASPEKTET E SIGURISË TEK CLOUD COMPUTING

Nëse dëshirojmë të dijmë lidhur me aspektet e sigurisë në Cloud computing atëherë ne duhet të kemi njohuri rreth fushës së sigurisë në përgjithësi në fushën e IT-së. Cloud computing ofron përfitimet të rëndësishme, duke përfshirë kursimet në kosto dhe përmirësimin e rezultateve të biznesit për kompani dhe institucione të tjera. Megjithatë, ka një shumëllojshmëri të rreziqeve të sigurisë tek teknologjia Cloud computing që duhet ti konsiderojmë me kujdes. Rreziqet do të ndryshojnë në varësi të ndjeshmërisë së të dhënave të ruajtura ose të përpunuara.

Kontrollet e sigurisë në cloud computing në rastet e përgjithshme, nuk janë të veçanta nga aspektet e sigurisë tek teknologjia tradicionale e IT-së. Megjithatë, për shkak të modelit të shërbimit në formë të reve kjo teknologjia është më shumë e sfiduar në aspektin e sigurisë në krahasim me teknologjinë tradicionale.

Ka çështje të shumta të sigurisë në Cloud që përfshinë shumë teknologji duke përfshirë rrjetat, bazat e të dhënave, sistemet operative, virtualizimin, menaxhimin e transaksioneve, menaxhimin e memorjes etj. Çështjet e sigurisë për shumë nga këto sisteme janë të zbatueshme tek Cloud computing. Rrjeti i cili ndërlidh sistemet në Cloud duhet të jetë i sigurtë, për më tepër tek virtualizimi në Cloud ka shqetësime për nivelin e sigurisë, për shembull makinat virtuale dhe makinat fizike dhe komunikimi ndërmjet tyre duhet të jetë i sigurtë. Siguria e të dhënave përfshinë enkriptimin e të dhënave, si dhe duke siguruar që politikat e sigurisë të jenë të zbatueshme në ndarjen e të dhënave, për veq kësaj ndarja e burimeve dhe algoritmet e menaxhimit të memories duhet të jenë të sigurtë.




Figura 2. Parametrat që ndikojnë tek sigurinë në Cloud[5]

Në infrastrukturën e bazuar në Cloud computing shfrytëzuesit janë në lokacione të ndryshme dhe në distanca, në shumicën e rasteve kërkohet që shfrytëzues të ndryshëm të pakten të jetë e mundur që ti ruajnë të dhënat në ndonjë server të largët cloud. Më poshtë po shënojmë tri gjendje të ndieshme nga aspekti i Cloud computing:

- Transmetimi i të dhënave personale në serverët cloud
- Transmetimi i të dhënave nga serveri cloud tek klientët dhe
- Ruajtja e të dhënave personale të klientëve tek serverët e largët cloud të cilët nuk janë të qasshëm nga klientët[4]

Disa nga ofruesit e shërbimeve në retë kompjuterike janë: Amazon EC2, Amazon S3, SQS, Google, Microsoft, Salesforce.com, Sun Microsystems etj dhe secili ka karakteristikat sipas klasifikimeve të bazuara në strukturën e shërbimeve: private, publike dhe hibride.

Siguria në cloud menaxhohet përmes politikave dhe nivelit të shërbimit të marrëveshjeve (SLAs- Service Level Agreements). Një SLA është një marrëveshje që shërben si bazë e pritjes për shërbim mes konsumatorit dhe ofruesit. Këto marrëveshje janë në vend për të mbrojtur të dy palët. Marrëveshja thotë se çfarë shërbime do të ofrohen, si do të sigurohen, dhe se çfarë ndodh në qoftë se pritjet nuk përmbushen.

Në figurën 3, mund të shihni një infrastrukturë tipike të ofrimit të shërbimeve në cloud.




Figura 3. Arkitektura tipike cloud computing[4]

Një ndër sfidat kryesore në cloud computing pa dyshim është siguria, cloud computing është përcaktuar si një teknikë që është në gjendje të sigurojë një infrastrukturë elastike, ku përdoruesit nuk janë pronarë, por që u siguron atyre shërbimet e kërkuara duke u ndarë në disa shtresa varësisht nga shërbimet që ofrojnë:

- ✓ *IaaS* ose infrastruktura si shërbim, ofron shërbimet bazë të infrastrukturës. IaaS i referohet ndarjes së burimeve HW duke përdorur kryesisht virtualizimin, ku shumë përdorues përdorin të njëjtat burime. Përshkallëzimi i aksesit në burimet HW bëhet në bazë të kërkesave të përdoruesve dhe faturimi realizohet sipas modelit: “paguaj aq sa përdor”.
- ✓ *PaaS* ose platforma si shërbim, është shtresa që përveç sigurimit të ambientit për aplikimet e përdoruesve, ofron dhe platforma për shërbime të orientuara. P.sh një server aplikimi Paas, u mundëson zhvilluesve të aplikacioneve të krijojnë aplikime të ndryshme web pa blerë servera dhe HW të tjerë, si dhe pa konfigurime dhe licenca shtesë.
- ✓ *SaaS* ose software si shërbim, është shtresa më e lartë që ofron aplikime më të plota sipas nevojave dhe kërkesave specifike. SaaS siguron se të gjitha aplikimet janë të hedhura në internet dhe pagesa e shërbimeve të ofruar janë në bazë të përdorimit.




Fig. 4 Hierarkia e Cloud computing

Autentifikimi i përdoruesëve është qështja kyqe sa i përket aspektit të sigurisë, qalimi në këtë fushë qonë deri tek pasiguarja totale në Cloud. Siguria tek cloud computing përfshinë shumë fusha si psh: rrjetat, bazat e të dhënave, sistemet operative, virtualizimi, menagjimi i transaksioneve, kontrollin e konkurrencës dhe menagjimin e memorjes.

SIGURIA NË PUBLIKIMIN E TË DHËNAVE APLIKUAR NË CLOUD COMPUTING

Cloud computing lehtëson ruajtjen e të dhënave në një vend të largët për të maksimizuar përdorimin këtyre burimeve. Si rezultat i kësaj, është e rëndësishme që këto të dhëna të jenë të mbrojtura dhe të jenë të disponueshme vetëm për individët e autorizuar, këtu mund të supozojmë se kemi një XML dokument që mund të ruhet në një web server.

Përdoruesit duhet të kenë kredencialet për qasje në dokumente XML, dhe caktohet niveli i autorizimit në këto dokumente dhe roli i përdoruesëve, psh mësimdhënësi ka qasje në të gjitha të dhënat e nxënësve ndërsa sekretari mund të ketë qasje vetëm tek informacionet administrative.

Specifikimet XML janë përdorur për të sqaruar politikat e sigurisë, qasja është dhënë për një dokument të tërë XML ose pjesë të caktuara të dokumentit, kjo mund të shihet edhe nga figura 5.




Figura 5. Korniza e qasjes së autorizuar[5]

Qasja në dokumente XML mund të sqarohet në formë të pemës dhe qasjes me autorizim të caktuar, psh, nëse qasja është dhënë në një rrënjë kjo nuk do të thotë se qasja është për të gjitha rrënjët, një qasje mund të jetë tek skema XML por jo tek instanca XML, shembull një profesor nuk ka qasje në informatat shëndetësore për studentët mirëpo ka qasje në informatat e tyre lidhur me përgatitjet e tyre dhe gradat e fituara.

Ofruesit e shërbimeve në Cloud duhet të ofrojnë siguri për konsumatorët të cilët nuk duhet të përballen me problem të sigurisë siq janë humbja e të dhënave ose qasja e pa autorizuar e përdoruesëve të ndryshëm dhe keqpërdorimi nga ta.

Një ndarje me katër probleme kryesore tek siguria në Cloud:

1. Qështja e të dhënave në Cloud
2. Problemi i privatësisë
3. Infektimi i aplikacioneve
4. Qështja e sigurisë në Cloud[5]




Figura 6. Siguria në Cloud Computing[6]

RUAJTJA E TË DHËNAVE TË ENKRIPUARA NË CLOUD

Që të dhënat të ruhen dhe të vendosen ku do në cloud, është e rëndësishme që të dhënat të jenë të ekriptuara. Nga figura 7 mund të shohim përdorimin e një ko-prosecori si pjesë e infrastrukturës për qasje dhe ruajtje të të dhënave në formë të sigurtë.




Figura 7. Pjesë nga instrumenti i enkriptimit

Ne mund ti ekriptojmë grupin e të dhënave sensitive duke përdorur çelësa të rastësishëm privat për të lehtësuar rrezikun e zbulimit të infomacionit, ruajtja e këtyre çelësive nuk të bëhet në këtë memorje për ti ikur rrezikut nga sulmuesit e mundshëm. Vazhdimisht ka përpjekje nga ana e sulmuesëve për dëshifrimin e këtyre të dhënave ose marrjen e çelësive, mirëpo kjo mënyrë e ruajtjes së të dhënave të ndieshme për mes ko-procesorit garanton siguri.

Rreziqet për privatësinë dhe sigurinë nga cloud nuk mund të injorohet. Jo të gjitha këto rreziqe janë të reja, dhe disa prej tyre mund të zbuten përmes investimeve të teknologjisë dhe të kujdesit të duhur nga klienti. Por të tjerët janë sistematike në natyrë, dhe nuk mund të jenë të zgjidhshme nëpërmjet inovacioneve të një anshme.

SIGURIA NË TEKNOLOGJINË TRADICIONALE DHE CLOUD COMPUTING

Siguria në një mjedis tradicional është arritur nga përdorimi i firewall-ëve, protokolleve të internetit, politikat për kontrollin e qasjes, mbrojtjen nga virusët dhe auditimi, të gjitha këto gjëra kontrollohen nga administratorët lokal. Firewall-ët janë hardware ose software, që shëbejnë për të mbrojtur një sistem kompjuterik ose të rrjetit nga përdoruesit e paautorizuar dhe të mbrojtur kundër ndërhyrjeve. Protokollat e rrjetit përcaktojnë se si të dhënat dërgohen në rrjet, në dhe nga interneti. Ka disa, të tilla si HTTP, TCP / IP, SMTP dhe Internet Protokollit të Sigurisë (IPSec). IPsec është standardi për sigurinë bazë në internet. Konfidencialiteti, integriteti, dhe disponueshmëria, të krijojnë një treshe që është një model i sigurisë. Ky model shërben zakonisht si standard i cili është i bazuar në siguri.[7]

Qëllimi i sigurimit të një sistemi është për të mbrojtur një sistem duke siguruar konfidencialitetin e të dhënave, integritetin e të dhënave dhe disponueshmërinë e dyjave të dhënave dhe sistemit.

Siguria në cloud përfshin disa aspekte, si sigurinë e serverit, sigurinë e klientit, sigurinë e fjalëkalimit, dhe enkriptimin. Qasja e kontrollit është një nga rreziqet më të mëdha të sigurisë në teknologjinë cloud. Qasja e kontrollit mund të bëhet një çështje kur një organizatë përdor cloud pasi që burimet janë në një kompjuter në distancë e cila është në pronësi dhe të kontrolluara nga një organizatë tjetër. Siguria në cloud menaxhohet përmes politikave dhe nivelit të shërbimit të marrëveshjeve (SLAs). Një SLA është një marrëveshje që shërben si bazë e pritjes për shërbim mes konsumatorit dhe ofruesit. Këto marrëveshje janë në vend për të mbrojtur të dy palët. Marrëveshja thotë se çfarë shërbime do të ofrohen, si do të sigurohen, dhe se çfarë ndodh në qoftë se pritjet nuk përmbushen.

Teknologjia cloud është duke u përdorur si një mënyrë për të shpërndarë të dhënat përgjatë shumë serverave që janë të kontrolluar dhe mirëmbahen nga ofruesit e tjerë. Të dhënat në çdo kohë transmetohen në një host të largët për ruajtje, ka rreziqe të përfshira të sigurisë. Këto rreziqe përfshijnë kapjen e të dhënave gjatë transmetimit dhe rreziqe të tjera, ndërsa të dhënat kalojnë në duart e kompanive të panjohura. Ky është një besim i përbashkët në mesin e shumë profesionistëve të teknologjisë së informacionit që teknologjia cloud ekspozon të dhënat për rreziqet shumë më të larta se të sigurisë tradicionale në Internet, megjithatë kjo mund të mos jetë rastësi.

KONKLUZION

Cloud computing është një model i ri kompjuterik që ofron mundësi të mëdha llogaritjesh dhe burime të konsiderueshme për ruajtjen e të dhënave. Individët, p.sh shkencëtarët dhe ndërmarrjet e ndryshme, mund të kenë akses në këto burime duke paguar një shumë të vogël parash, për vetëm atë që vërtet u nevojitet, as më shumë e as më pak. Ofruesit e shërbimeve Cloud dhe klientët duhet të ndihen me siguri të mjaftueshme nga të gjitha kërcnimet e jashtëme. Nëpërmjet rritjes së kërkesave për akses në aplikacione të ndryshme, mundësia për sulme kibernetike gjithashtu rritet.

Ne jemi të vetëdijshëm që në këtë punim nuk mundemi të sqarojmë në detaje dhe të gjitha vrimat sa i përket aspektit të sigurisë në cloud computing, mirë jemi mundur që të pasqyrojmë sa do pak nevojën e rritjes së nivelit të sigurisë në cloud. Pa dyshim që jo vetëm cloud computing po e gjithë fusha e IT-së janë të rrezikuar nga keqbërës, ndërsa ne kemi trajtuar me kujdes enkriptimin e të dhënave në cloud përdorimin e çelsave dhe mënyrën e ruajtjes së këtyre çelsave, tek kriptografia paraqitet sfida e ruajtjes së çelsave dhe rritjes së nivelit të sigurisë dhe algoritmeve të përdorura në ekriptim. Neve jemi munduar që të sqarojmë se qëllimi i sigurimit të një sistemi është për të mbrojtur një sistem duke siguruar konfidencialitetin e të dhënave, integritetin e të dhënave dhe disponueshmërinë e dyjave të dhënave dhe sistemit. Siguria në cloud përfshin disa aspekte, si sigurinë e serverit, sigurinë e klientit, sigurinë e fjalëkalimit, dhe enkriptimin.

Rreziqet e sigurisë lidhen me secilin model cloud computing dhe varen nga një gamë e gjerë faktorësh, duke përfshirë ndjeshmërinë e aseteve të informacionit, arkitekturës cloud dhe kontrollin e sigurisë të përfshirë në mjedise të veçanta cloud.

Referenca:

- [1] Abhay Kumar Sinha; Challenges in Cloud Computing; ICFAI, University, Jharkhand;
- [2] Ardi Benusi, Teza e Doktoratës, Zhvillime të teknologjisë “Cloud” Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Tiranë,2015;
- [3] Mansooreh Moghadam,Wendy Sterkel; Cloud Computing vs Traditional Internet Setting;Cameron University Spring 2012;
- [4] Monjur Ahmed¹ and Mohammad Ashraf Hossain², Cloud Computing and Security Issues in the Cloud, International Journal of Network Security & Its Applications, January 2014;
- [5] Kevin Hamlen, Murat Kantarcioglu, Latifur Khan, Bhavani Thuraisingham; Security Issues for Cloud Computing; The University of Texas at Dallas, USA, International Journal of Information Security and Privacy, 2010;
- [6] Prince Jain, Security Issues and their Solution in Cloud Computing; Malwa Polytechnic College Faridkot, Punjab-151203, India;
- [7] Dexter Duncan, Xingchen Chu, Christian Vecchiola, and Rajkumar Buyya; Cloud Computing Part I; Department of Computer Science and Software Engineering The University of Melbourne, Australia.

POLITICAL SCIENCES

**SISTEMI EVROPIAN MBI MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË NJERIUT
REPUBLIKA E MAQEDONISË**

Doc.dr. Drita M. FAZLIA⁷⁶

Fakulteti Juridik, Universiteti Shtetëror i Tetovës

drita.fazlia@unite.edu.mk

ABSTRAKT

Të drejtat e njeriut janë pjesa më e rëndësishme e individit, por njëkohësisht mbi të ndërtohet funksionimi i sistemit nacional, por edhe e atij ndërkombëtar. Me shkeljen e të drejteve dhe lirive pamundësohet ekulibri midis stabilitetit nacional dhe atij ndërkombëtar. Për këtë arsye, përveç kujdesit të veçant të sistemit nacional edhe organizatat ndërkombëtare rrin në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, siç është rasti i miratimit të Konventa Evropijane për të drejtat e njeriut dhe themelimit të Gjykatës Evropiane për mbrojtjen e të drejtat e njeriut. Qëllimi i punimit është të të paraqes përpyekjen, por edhe rezultatin e Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut duke dhënë edhe këndvështrim të raportit të Republikës së Maqedonisë dhe suksesin për mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve të Maqedonisë. Me këtë njëkohësisht do të potencohet nevoja e mbrojtjes ndërkombëtare me theks të veçant të mbrojtës Evropiane për të drejtat e njeriut. Hipoteza kryesore e punimit do të jetë sa është efikas sistemi nacional për mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve në RM dhe sa është treguar efikas sistemi evropian për këtë.

Fjalët kyçe: *Të drejtat e njeriut, mbrojtja e tyre, Gjykata Evropijane për të drejtat e njeriut, efikasiteti i mbrojtjes së drejtave të njeriut, etj*

HYRJE

Sistemi Evropian ka qenë i aftë të funksionojë në mënyrë efektive sepse qeveritë relevante kanë pasur vullnet të bashkëpunojnë me organet qeveritare dhe me të vërtetë kanë dashur që të sigurojnë ushtrim efektiv të së drejtave të njeriut brenda territorit të tyre. Problemet që vijnë në Strazburg, sado që janë të rëndësishme për individët relevant, përveç disa

përrjashtimeve, janë margjinale krahasuar me shkeljet masive dhe flagrante të së drejtave të njeriut që paraqiten në pjesët tjera të botës.⁷⁷

Me Protokolin nr.11 të Konventës Europiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut (KEDNJ) nga viti 1994 është paraparë krijim i gjykatës së vetme e cila do të veprojë sipas aplikacioneve për shkeljen e të drejtave të njeriut të vërtetuara me Konventën Europiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Në të vërtetë me Protokolin e sipërpërmendur u braktis funksionimi i Komisionit Europian për të drejtat e njeriut dhe u autorizua Gjykata Europiane të jetë trup i cili do të veprojë sipas aplikacioneve të shteteve dhe individeve, të vendos për lëshimin e tyre dhe të vendos sipas të njëjtave.⁷⁸

Për të siguruar respektimin e zotimeve të ndërmarra nga Palët e Larta Kontraktuese të kësaj Konvente dhe nga Protokollet e saj, krijohet Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, në vijim referuar si “Gjykata”. Ajo funksionon në mënyrë të përhershme.⁷⁹

1. Kompetencat e Gjykatës Evropijane mbi mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut

Juridiksioni i Gjykatës shtrihet për të gjitha çështjet në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e Konventës dhe të protokolleve që i referohen asaj sikurse parashikohet në nenet 33, 34, 46 dhe 47.

Gjykata vendos vetë në rast të mosmarrëveshjeve në lidhje me juridiksionin e saj.⁸⁰ Çdo Palë e Lartë Kontraktuese mund t'i referojë Gjykatës çdo shkelje të pretenduar të dispozitave të Konventës dhe të protokolleve të saj nga një Palë tjetër e Lartë Kontraktuese.⁸¹ Gjykata mund të marrë kërkesat nga çdo person, organizatë joqeveritare ose grup individësh që pretendojnë të jenë viktima të një shkeljeje nga një prej Palëve të Larta Kontraktuese të të drejtave të parashtruara në Konventë ose në protokollet e saj. Palët e Larta Kontraktuese zotohen të mos

⁷⁷ J.G. Merrils, Këshilli i Evropës: Konventa Evropiane për të drejtat e njeriut, Hyrje në Mbrojtjen Ndërkombëtare të së Drejtave të Njeriut, Instituti për të Drejtat e Njeriut, Universiteti i Abo Akademisë, 1999, fq. 372.

⁷⁸ Anica Tomsik – Stojkovska, Donce Boskovski, Mekanizmat nacional për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, Grafohartija, Shkup 2011, fq.45.

⁷⁹ Neni 19 i Konventa për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore Romë, 4.XI.1950

⁸⁰ Neni 32 i Konventës.

⁸¹ Neni 33 i Konventës.

pengojnë në ndonjë mënyrë ushtrimin efektiv të kësaj të drejte.⁸² Gjykata mund të trajtojë çështjen *vetëm pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet e brendshme ligjore sipas rregullave përgjithësisht të pranuarra të të drejtës ndërkombëtare dhe brenda një periudhe prej gjashtë muajsh nga data në të cilën është marrë vendimi i formës së prerë.*

Gjykata nuk merr në shqyrtim asnjë kërkesë individuale të paraqitur sipas nenit 34, kur:

- a. është anonime; ose
- b. është në thelb e njëjtë me një çështje të shqyrtuar më parë nga Gjykata ose që i është nënshtruar një procedure tjetër për zgjidhje ose hetim ndërkombëtar dhe nuk përmban fakte të reja përkatëse.

Gjykata deklaron çdo kërkesë individuale të bërë në bazë të nenit 34 të papranueshme, kur mendon se:

- a. kërkesa është e papajtueshme me dispozitat e Konventës ose protokollet e saj, haptazi e paarsyetuar ose përbën abuzim të së drejtës për kërkesë individuale; ose
- b. kërkuesi nuk ka pësuar ndonjë dëm të konsiderueshëm, përveç kur respektimi i të drejtave të njeriut sipas përcaktimit të Konventës dhe protokolleve të saj kërkon shqyrtimin e kërkesës në lidhje me themelin, me kusht që të mos rrëzojë asnjë çështje për këtë shkak nëse nuk është shqyrtuar si duhet nga një gjykatë kombëtare.

Gjykata rrëzon çdo kërkesë që e konsideron të papranueshme në zbatim të këtij neni. Ajo mund ta bëjë këtë në çdo fazë të procedimit.⁸³

Jurisdikcioni i Gjykatës është i kufizuar. Ankesat mund të merren në konsideratë vetëm nëse i plotesojnë kriteret e pranimit të përcaktuara me nenin 35 të Konventës. Shkurtimisht, këto janë kriteret që domosdo duhet t'i plotesoj një ankese.⁸⁴

- Të parashtrohet nga personi i autorizuar;
- Të ketë të bëj me çështjen e rregulluar me Konventë;
- Të ketë të bëj me periudhen brenda të cilës shteti është i obliguar t'i përmbahet Konventës;
- Të ketë të bëj me jurisdikcionin për të cilin Konventa shtrihet;

⁸² Neni 34 i Konventës.

⁸³ Neni 35 i Konventës.

⁸⁴ Gjylieta Mushkolaj, Mbrojtja ndërkombëtare e lirive dhe të drejtave të njeriut, marrë nga web linku

<https://juristat.files.wordpress.com/2012/08/te-drejtat-e-njeriut-me-mbrojtje-nderkombetare.pdf,më>

[15.04.2016](#)

- Të parashtrohet pas shterjes së të gjitha mjeteve juridike të brendshme;
- Të jenë shtruar të gjitha argumentet e Konventës në gjykatat e brendshme;
- Të parashtrohet brenda 6 (gjashtë) muajsh nga dita e shfrytezimit të mjetit të fundit juridik të brendshëm.

1.FORCA DETYRUESE DHE EKZEKUTIMI I VENDIMEVE

Palët e Larta Kontraktuese marrin përsipër të respektojnë vendimin e formës së prerë të Gjykatës në çdo çështje ku ato janë palë.

Vendimi i formës së prerë i Gjykatës i përcillet Komitetit të Ministrave, i cili mbikqyr ekzekutimin e tij. Nëse Komiteti i Ministrave është i mendimit se mbikqyrja e ekzekutimit të një vendimi të formës së prerë pengohet nga një problem i interpretimit të vendimit, ai mund t'ia referojë çështjen Gjykatës për t'u shprehur me vendim për çështjen e interpretimit. Një vendim i tillë kërkon një shumicë prej dy të tretave të përfaqësuesve që kanë të drejtë të marrin pjesë në Komitetin e Ministrave.⁸⁵

Nëse Komiteti i Ministrave është i mendimit se një Palë e Lartë Kontraktuese refuzon të respektojë një vendim të formës së prerë të Gjykatës në një çështje ku ajo është palë, pasi t'i ketë dërguar një njoftim formal asaj Palë dhe me vendim që merret me një shumicë prej dy të tretave të përfaqësuesve që marrin pjesë në të, mund t'i referojë Gjykatës problemin nëse Pala e ka përmbushur detyrimin e saj në bazë të paragrafit 1.

Nëse Gjykata gjen një shkelje të paragrafit 1, ajo ia referon çështjen Komitetit të Ministrave për shqyrtimin e masave që duhen marrë. Nëse Gjykata nuk gjen asnjë shkelje të paragrafit 1, ajo ia referon çështjen Komitetit të Ministrave, i cili e mbyll shqyrtimin e çështjes.

Kompetenca tjetër e Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut është edhe dhinia e mendimeve këshilluese nëse:

- Gjykata, me kërkesë të Komitetit të Ministrave, mund të japë mendime këshilluese për çështje ligjore që lidhen me interpretimin e Konventës dhe të protokolleve të saj.
- Mendime të tilla nuk trajtojnë asnjë çështje që lidhet me përmbajtjen dhe shtrirjen e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në Titullin I-rë të Konventës dhe në protokollin e saj, ose me ndonjë çështje tjetër të cilën Gjykata ose Komiteti i Ministrave mund të shqyrtojë si pasojë e paraqitjes së ndonjë kërkesë në pajtim me Konventën.

⁸⁵ Neni 46 i Konventës.

- Vendimi i Komitetit të Ministrave për t'i kërkuar Gjykatës mendime këshilluese merret me votën e shumicës së përfaqësuesve që kanë të drejtë të marrin pjesë në të.⁸⁶ Gjykata vendos nëse kërkesa për mendim këshillues që paraqitet nga Komiteti i Ministrave është në kompetencën e saj, siç përcaktohet në nenin 47.⁸⁷ Shpenzimet për Gjykatën mbulohen nga Këshilli i Evropës.⁸⁸ Këtu Gjykata Evropiane për mbrojtjen e lirive dhe të drejteve të njeriut vepron erga omnes, ose në raport me të gjithë.⁸⁹

2. INKORPORIMI I STANDARTEVE EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT NË LEGJISLACIONIN E RM-së

Sistemi nacional për mbrojtjen e të drejtave të njeriut (SNMDNJ) paraqet përmbledhje të ligjeve, politikave dhe institucioneve të cilat punojnë në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, apo në një definicion më të gjërë mund të përshkruhet si infrastrukturë e të drejtave të njeriut në kuadër të një shoqërie. Ajo përbëhet nga të gjithë indikatorët dhe parakushtet të cilat mundësojnë shkallë të lartë të përgjegjësisë nga ana e institucioneve shtetërore në kahje të realizimit të obligimit të tyre për respektim, mbrojtje dhe zhvillim të të drejtave të njeriut si për të drejtat qytetare dhe politike ashtu edhe për ato ekonomike, sociale dhe kulturore.⁹⁰ Natyra politike e të drejtës ndërkombëtare shkakton pasoja, të cilët janë akoma më rëndësi thelbësore për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.⁹¹

Nuk është patjetër të jeni shtetas i ndonjë shteti që e ka ratifikuar Konventën për të kërkuar mbrojtje të të drejtave nga Gjykata Evropiane për të drejtat e njeriut. Për të inicuar procedurën përpara Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut duhet të jenë të shterura të gjitha mjetet juridike në shtetit kundër së cilës ankoheni, me të cilët mjete mund të zgjidhet situata e cila është lëndë e ankesës suaj (zakonisht kjo do të thotë që duhet të parashtrohet padia te gjykata

⁸⁶ Neni 47 i Konventës.

⁸⁷ Neni 48 i Konventës.

⁸⁸ Neni 50 i Konventës.

⁸⁹ Është terminologji ligjore për ti përshkruar detyrimet ose të drejtat kundrejt të gjithëve.

Gentian Zylberi, E drejta ndërkombëtare e të drejteve të njeriut, Botart, Tiranë

⁹⁰ Anica Tomsik – Stojkovska, Donce Boskovski, Mekanizmat nacional për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, Grafohartija, Shkup 2011, fq. 14.

⁹¹ Frederik Sudre, E drejta Evropiane dhe Ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, botuar në gjuhën shqipe nga Ars Lamina, 2013, fq. 21.

kompetente, më pas, nëse është e mundëshme, duhet të parashtrohet ankesa, dhe të drejtohen deri tek instanca më e lartë gjyqësore, siç është p.sh. deri tek Gjyqi suprem ose Kushtetues, nëqoftëse gjyqi i tillë ekziston në shtetin kundër së silit ankoheni). Nuk është e mjaftueshme vetëm që ti shfrytzoni mjetet juridike ekzistuese, por duhet edhe ti parashtroni edhe bazat e ankesës (respektivisht lëndimin e Konvenës për të cilën thirreni). Ankesa e juaj mund të parashtrohet vetëm në afat prej gjashtë muajve nga dita e vendimit përfundimtarë të nivelit nacional (zakonisht kjo është data e aktvendimit të instancës më të lartë gjyqësore). Pas skadimit të këtij afatit Gjyqi nuk mund të pranoj ankesën tuaj. Pala ka të drejtë që të parashtrroj padi kundër njëres ose më shumë shteteve nënshkruese të Konventës, të cilët sipas jush e kanë shkel Konventën Evropiane për të drejtat e njeriut.⁹²

Nevoja për plan aksionar nacional në mënyrë të drejtpërdrejtë buron nga rekomandim i përmbajtur në Deklaratën e Vjenës dhe Programi për aksione i miratuar nga konferenca Botërore për të drejtat e njeriut nga viti 1993 ku parapëlqehet që çdo shtet të miratojë plan aksionar në të cilin do të identifikohen hapat për përmirësim e gjendjes me promovim dhe mbrojtje të të drejtave të njeriut në nivel të shtetit.⁹³

Qëllimi i shtetit përmes miratimit të planit të tillë sistemor është sigurimi i respektimit dhe përparimit afatgjatë i të drejtave të njeriut në vend, ose kompatibilitet i tërësishëm i rregullimit juridik të shtetit me detyrimet të cilat Republika e Maqedonisë i ka ndërmarrë me ratifikimin e dokumenteve dhe konventave ndërkombëtare nga fusha e mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Për realizimin e këtij qëllimi, shteti duhet të realizojë analiza të rregullta dhe kontrol të problemeve të mundshme të cilat ekzistojnë në shoqëri nga aspekti i realizimit të tërësishëm i të drejtave dhe lirive fundamentale për të gjithë qytetarët dhe personat e territorit të RM –së. Detyrë tjetër e rëndësishme është rritja e nivelit të njohjes së qytetarëve me të drejtat e tyre, e cila realizohet përmes edukimit të të drejtave të njeriut, si dhe koordinimit të të gjitha aktiviteteve të subjekteve shtetërore në drejtim të realizimit të qëllimit të parashtruar me planin aksionar.⁹⁴

⁹² Европски суд за човекови права, Прашања и Одговори, Council of Europe, F-67075 Strasbourg cedex, www.echr.coe.int fq.6-7.

⁹³ Paragrafi 71, Vienna Declaration and Programme of Action, World Conference on Human Rights, Vjenë, 14 – 25 qershor 1993.

⁹⁴ Anica Tomsik – Stojkovska, Donce Boskovski, Mekanizmat nacional për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, Grafhartija, Shkup 2011, fq.27.

3. NIVELI I MBROJTJES SË TË DREJTAVE TË NJERIUT, BAZUAR NË KONVENTËN EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT NË RM

Garancitë kushtetuese për realizimin e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut dhe të qytetarit janë të vendosura në nenin 50 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, në të cilin është paraparë mbrojtja juridike e cila përfshin procedurë të përgjithshme para gjykatave dhe procedurë para Gjykatës Kushtetuese. Kështu, sipas kushtetutës 1 të këtij neni nga Kushtetuta, *çdo qytetar mund të thirret në mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të përcaktuara me Kushtetutën para gjykatave dhe para Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë në procedurën të bazuar në përparësinë dhe urgjencën.* Në të njëjtin nen, në paragrafin 2, Kushtetuta e *garanton mbrojtjen gjyqësore të ligjshmërisë të akteve të veçanta të administratës shtetërore dhe të institucioneve të tjera të cilat zbatojnë autorizime publike.* Gjykatat i mbrojnë liritë dhe të drejtat e njeriut përmes zgjidhjes së lëndëve konkrete në kuadër të kompetencës së vet, në procedura të përshkruara me ligjet (Ligji për procedurë penale, Ligji për procedurë ndërgjyqësore, Ligji për kontestet administrative), ndërsa Gjykata Kushtetuese i mbron liritë dhe të drejtat edhe në mënyrë të tërthortë përmes vlerësimit të kushtetutshmërisë së ligjeve dhe të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së dispozitave dhe akteve të përgjithshme të tjera.⁹⁵

Trup kompetent për mbikëqyrje të pëpmbarimit të aktgjykimeve të Gjykatës Europiane është Komiteti i ministrave të Këshillit të Europës. Kur gjykata Europiane për të drejtat e njeriut do të vërtetojë çënim të ndonjëres prej të drejtave të njeriut ose të lirive themelore të njeriut të parapara në Konventën Europiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut edhe në Protokolet Plotësuese të Konventës, të cilat Republika e Maqedonisë i ka ratifikuar, pala mundet në afat brenda 30 ditëve nga përfundimi i aktgjykimit në Gjykatën Europiane për të drejtat e njeriut të parashtrijë kërkesë deri te Gjykata e Republikës së Maqedonisë e cila ka gjykuar në shkallë të parë në të cilën është marë vendimi ku është çënuar ndonjëra prej të drejtave ose lirive themelore të njeriut për ndryshim të vendimit me të cilën ajo e drejtë ose liri themelore është çënuar¹⁸.

Në përsëritjen e procedurës gjykatat janë të detyruara ti respektojnë qëndrimet juridike të shprehura në aktgjykimin përfundimtar të Gjykatës Europiane për të drejtat e njeriut me të cilat

⁹⁵ *Millojka Kalakashlieva*, Mbrojtje juridike e të drejtave të njeriut në Republikën e Maqedonisë, Dialogut Juridik nr. 5, Instituti për të drejtat e njeriut, Dhjetor, 2011, fq.14-15.

janë vërtetuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Nëse gjykata vlerëson se ekziston shkelje e Konventës dhe nëse e drejta e brendshme mundëson vetëm mënjanim të pjesërisht të pasojës nga shkelja, mund të vendosë që palës së dëmtuar ti jepet kompensim i drejtë.⁹⁶

Aktvendimet dhe vendimet e Gjykatës nuk e kanë për qëllim vetëm për të gjykuar për kontestin konkret të parashtruar pran Gjykatës, por shumë më gjërë për të ndihmuar që standardet dhe parimet e pranuar të bëhen pjesë përbërëse të pasurisë juridike të shtetit nënshkruar të Konventës.⁹⁷

KONKLUZION

Meqë Republika e Maqedonisë në vitin 1997 e ka ratifikuar Konventën Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe liritë themelore të njeriut, ajo tash më është pjesë përbërëse e sistemit të brendshëm juridik të RM. Në këtë rast RM nuk i mjafton vetëm ratifikimi i saj, por për ta jetësuar atë seriozisht duhet të përgatis plan aksional me çka do të vë punën praktike (jo teorike) të Gjykatës në dispozicion të qytetarëve. Dhe për këtë duhet:

- Të shihet relacioni i ligjeve pozitive të RM të cilët nuk janë në korelacion me Konventën Evropiane për mbrojtjen e liritë dhe të drejtave të njeriut dhe qytetarit, se të shihet se sa shkeljet e këtilla mund të shqyrtohen nga Gjykata Evropiane dhe të jenë të detyrueshme për përmbushje, kur nuk kemi mekanizëm për përmbushje të dhunëshme. Në rastin e RM kjo është ende më e theksuar pasi që sistemi gjyqësor i RM, në bazë të Marrveshjes së Përzahinos është i shpallur si joefikas me çka edhe u konstituua edhe Prokuroria Speciale.
- Gjykata nuk ka kompetencë ti abrogoj vendimet e miratuara nga gjykatat nacionale, por as edhe të abrogoj ligjet nacionale. Në situatën momentale të RM kjo do të thotë që qytetaret e kanë shumë të vështirë që të kërkojnë mbrojtjen e liritë dhe të drejtave të tyre pran Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut, pasi që shterja e mjeteve nacionale është gati i pamundur, duke i pasur parasysh edhe kritikën e Komisionit Evropian mbi punën e gjyqësorit të RM, përfshirë këtu edhe stërzgjatje të proceseve gjyqësore.

⁹⁶ Anica Tomsik – Stojkovska, Donce Boskovski, Mekanizmat nacional për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, Grafohartija, Shkup 2011, fq.45-46

⁹⁷ Mirjana Lazarovska Trajkovska, Presudite i odlukite vo vrska so govorot na omraza od sudskata praksa na Evropskiot sud ya covekovite prava, OBSE, Shkup, 2012, fq. 5.

- Gjykata Evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut nuk qëndron si gjykat e apelit në raport me sistemin gjyqësor nacional, edhe pse për të shqyrtuar raste e ka parakushtin shterjen e mjeteve juridike nacionale.
- Lidhshmëria midis sistemit Evropian të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut dhe nevojës së RM për të inkorporuar një sistem të tillë, për çka nuk mjafton vetëm inkorporimi i Konventës, por si hap bazë në fazën e inkorporimit duhet bërë analizë më të gjërë të definimit të qëllimeve të shtetit për të qëndruar besnik ndaj mbrojtjes së lirive dhe të drejteve të njeriut, me çka do ti jepet një vend të rëndësishëm edhe punës dhe kompetencës së Gjykatës Evropiane për të punuar në të njëjtën frymë.
- Përforcimi i kapaciteteve, kompetencave dhe rolit të Avokatit të popullit.
- Përgatitja dhe sjellja e planit akcional
- Përforcimi i kompetencave të komisionit për mbrojtjen nga diskriminimi.
- Nevoja e themelimit të një trupi kompetent për mbikqyrje të ekzekutimit të aktgjyqimeve të Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut.

Referenca:

1. J.G. Merrills, Këshilli i Evropës: Konventa Evropiane për të drejtat e njeriut, Hyrje në Mbrojtjen Ndërkombëtare të së Drejtave të Njeriut, Instituti për të Drejtat e Njeriut, Universiteti i Abo Akademisë, 1999,
2. Anica Tomsik – Stojkovska, Donce Boskovski, Mekanizmat nacional për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, Grafhartija, Shkup 2011,
3. Konventa për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore Romë, 4.XI.1950
4. Gjylieta Mushkolaj, Mbrojtja Ndërkombëtare e lirive dhe të drejtave të njeriut, marrë nga web linku <https://juristat.files.wordpress.com/2012/08/te-drejtat-e-njeriut-me-mbrojtje-nderkombetare.pdf>, më 15.04.2016 ,
5. Frederik Sudre, E drejta Evropiane dhe Ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, botuar në gjuhën shqipe nga Ars Lamina, 2013,
6. Европски суд за човекови права, ПрашањаиОдговори, Council of Europe, F-67075 Strasbourg cedex , www.echr.coe.int
7. Vienna Declaration and Programme of Action, World Conference on Human Rights, Vjenë, 14 – 25 qershor 1993,

8. *Millojka Kalakashlieva*, Mbrotje juridike e të drejtave të njeriut në Republikën e Maqedonisë, Dialogut Juridik nr. 5, Instituti për të drejtat e njeriut, Dhjetor, 2011,
9. Mirjana Lazarovska Trajkovska, Presudite i odlukite vo vrska so govorot na omraza od sudskata praksa na Evropkiot sud za covekovite prava, OBSE, Shkup, 2012,
10. Gentian Zylberi, E drejta ndërkombëtare e të drejteve të njeriut, Botart, Tiranë

**SITUATA SOCIO-EKONOMIKE E KOMUNITETIT ROM NË SHQIPËRI PAS
RËNJES SË KOMUNIZMIT - NJË ANALIZË KRITIKE E SISTEMIT SHQIPTAR TË
TË DREJTAVE TË NJERIUT ME FOKUS NË SISTEMIN ARSIMOR**

Enian LAMÇE

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë

Alketa DUMANI

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë

ABSTRAKT

Rënia e regjimit komunist në Shqipëri në 1991 shënoi edhe fillimin e zhbërjes së një mirëqenie relative të komunitetit rom drejt një varfërie ekstreme dhe përjashtimit social. Ky ndryshim socio-ekonomik u shoqërua me 4 procese varfëruese: 1. Braktisja në masë e shkollës nga fëmijët romë. 2. Zhbërja e vendeve të punës si pasojë e mbylljes së ndërrmarjeve dhe punishteve shtetërore në industri dhe bujqësi. 3. Shitja e shtëpive. 4. Mungesa e programeve shtetërore serioze për adresimin e këtyre problematikave.

Fjalë kyçe: *Mbrojtja e të drejtave të njeriut, përjashtimi social, e drejta për arsimim, grupet vulnerabël, komuniteti rom.*

HYRJE

Romët janë minoriteti etno-linguistik më i madh në Shqipëri. Në të njëjtën kohë ata përbëjnë edhe një prej grupeve më të marginalizuara të shoqërisë shqiptare. Problematikat e lidhura me komunitetin rom janë për shoqërinë dhe politikën shqiptare pjesërisht të njohura. Trajtimi i tyre bëhet shpesh nga një perspektivë statistikore, ku numrat dhe përqindjet kanë kryesisht karakter përshkrues dhe shpjegojnë shumë pak rreth shkaqeve që cojnë në lindjen e këtyre problematikave. Përjashtimi dhe diskriminimi i romëve shihet nga shoqëria shqiptare si një fenomen negativ i tranzicionit të gjatë dhe të vështirë të Shqipërisë, pasojat negative të të cilit, në një mënyrë apo një tjetër kanë prekur të gjithë shoqërinë. Kjo është pjesërisht e vërtetë. Rolit të shtetit, veprimeve dhe mosveprimeve të institucioneve shtetërore dhe shoqërisë ju kushtohet shumë pak vëmendje në këto analiza. Trajtimi i këtyre temave nga kjo perspektivë ka cuar në një mungesë të theksuar të analizave kritike mbi politikën shtetërore përkundërt komunitetit rom, duke ndikuar kështu në një mënyrë të tërthortë në përforcimin e sjelljeve diskriminuese dhe

përrjashtuese nga ana e institucioneve shtetërore dhe shoqërisë. Në diskursin politik dhe shoqëror shqiptar mbi problematikën romë ka shumë pak traditë në tematizimin e saj në një aspekt social politik duke përfshirë në të edhe aspektin e të Drejtave të Njeriut.

Ky punim synon të paraqesë situatën aktuale të romëve në Shqipëri dhe ta analizojë atë bazuar në një prej aspekteve më të rëndësishme të lëndimit të të drejtave të njeriut, përrjashtimit social. Një vëmendje e vecantë do ti kushtohet të drejtës për tu arsimuar, si një e drejtë e aftësisimit dhe fuqizimit, (mos)respektimi i së cilës përbën një moment shumë të rëndësishëm në sistemin e mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut, por edhe në kuadër të luftimit të përrjashtimit social dhe të formave të ndryshme të diskriminimit. Në këtë kuadër do të analizohet në mënyrë kritike aksesit i romëve në arsim, problemet dhe pengesat që ata hasin si edhe programet shtetërore në lidhje me integrimin e tyre në sistemin arsimor shqiptar. Pjesë e këtij punimi do të jetë edhe analizimi i aksesit të romëve në tre fusha të tjera: shëndetësi, punësim dhe strehim, si pjesë të rëndësishme të një integrimi dhe përfshirjeje sociale të sukseshme.

SITUATA E ROMËVE NË SISTEMIN ARSIMOR DHE E DREJTA E TYRE PËR TUA ARSIMUAR

Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut është dokumenti i parë ndërkombëtar, në të cilin artikullohet qartë e drejta për arsimim (Neni 26) si pjesë e qenësishme e të Drejtave të Njeriut. Kjo e drejtë parashtrohet edhe në dokumente të tjera ndërkombëtare të rëndësishme si Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Civile dhe Sociale (Neni 13 dhe 14), Konventa për Eleminimin e cdo Forme të Diskriminimit, Karta Europiane e të Drejtave të Njeriut si edhe Konventa Kuadër për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare (Neni14). Në të gjitha këto dokumente e drejta për arsimim lidhet drejtpërdrejtë me përpjekjet për të minimizuar të gjitha llojet e diskriminimit dhe të përrjashtimit.⁹⁸ Kjo e drejtë duhet ti garantohet cdo individit. Mohimi apo shkelja e saj e ndikon negativisht procesin e formimit dhe të zhvillimit të personalitetit apo aftësisë së tyre për të mbrojtur vetëveten dhe të tjerët duke kuptuar e artikuluar më mirë të drejtat e tyre. Cënimi i kësaj të drejte dëmton edhe pjesëmarrjen e individëve në jetën ekonomike, politike, shoqërore e kulturore. Jo më kot e drejta për arsimim është cilësuar edhe si e drejta për aftësim dhe fuqizim. Një rëndësi të vecantë kjo e drejtë merr sidomos në lidhje me mbrojtjen, fuqizimin dhe integrimin e grupeve të marginalizuara.

⁹⁸ Krh. Motakef, Mona (2006), f. 9

Mbrojtja, promovimi, garantimi dhe zbatimi i kësaj të drejtë është detyrë e institucioneve shtetërore dhe shoqërisë. Shqipëria nëpërmjet nënshkrimit dhe ratifikimit të dokumenteve të mësipërme zotohet se do të punojë për të krijuar kushtet e nevojshme për të garantuar akses të barabartë për të gjithë individët në të gjitha nivelet e arsimit. Fenomeni i braktisjes në masë të shkollës nga fëmijët romë coi në formimin e një gjenerate pak të arsimuar dhe për pasojë me aftësi të ulta konkurruese. Të dhënat mbi situatën dhe statusin e romëve në sektorin e arsimit janë shumë të mangëta dhe shpesh herë kundërshtuese. Numri i fëmijëve romë nën 18 vjec sipas një studimi të Open Society Institut vlerësohet nga 631 deri 47.500.⁹⁹ Si pasojë e të ardhurave të pakta për shumë familje rome është financiarisht e pamundur të mbështesin arsimimin e fëmijëve të tyre duke e vështirësuar kështu sigurimin e veshmbathjeve, librave apo mejteve të tjera mbështetëse dhe të nevojshme për një proces normal. Referuar studimit të Bankës Botërore të vitit 2005 rreth 64% e fëmijëve romë ndërmjet moshës 7-20 vjec janë analfabetë.¹⁰⁰ Referuar një studimi të Qendrës së Zhvillimeve Humane numri i fëmijëve romë (ndërmjet 3-16 vjec) të regjistruar është rreth 4.654, nga të cilët 62% nuk frekuentojnë as sistemin e detyrueshëm shkollor dhe as ciklin parashkollor.¹⁰¹ Kuota e vogël e regjistrimeve të fëmijëve romë në sistemin arsimor, frekuentimi i shkollës në mënyrë jo të rregullt si edhe braktisja e saj nga një numër i madh fëmijësh romë vijnë si rezultat i shumë faktorëve. Këta faktorë lidhen drejtpërdrejt me varferinë e madhe brenda komunitetit rom, sjelljet përjashtuese e diskriminuese të pjesës jo rome të shoqërisë shqiptare, mangësive financiare, materiale e strukturore që karakterizojnë institucionet e shtetit shqiptar, përfshirë këtu edhe ato të sistemit arsimor.

Varfëria është një moment i rëndësishëm në analizën mbi mosfrekuentimin e shkollës nga ana e fëmijëve romë. Vihet re një lidhje e fortë ndërmjet varfërisë dhe mosfrekuentimit të shkollës. Rreth 91% e fëmijëve (8 deri në 18 vjec) romë që nuk e frekuentojnë shkollën vijnë nga familje shumë të varfra.¹⁰²

Më shumë se 67% e familjeve rome nuk mund ti përballojnë kostot për blerjen e librave¹⁰³ dhe të mjeteve të tjera shkollore të domosdoshme për procesin mësimor.¹⁰⁴ Si pasojë e varfërisë

⁹⁹ Krh. OSI (2006), f. 6

¹⁰⁰ Krh. De Soto, Hermine/Beedies,Sabine/Gedeshi,Ilir (2005),f. XXIII

¹⁰¹ Krh. Tamo,Adem/ Karaj, Theodhori (2007), f.10-12

¹⁰² Krh. UNDP (2012), f.53

¹⁰³ Duhet thënë se dy vitet e fundit tekstet e arsimit bazë jepen falas për fëmijët rom që ndjekin këtë cikël

shumë fëmijë romë detyrohen nga prindërit e tyre për të punuar me qëllim sigurimin e të ardhurave për familjen. Procesi i regjistrimit të fëmijëve romë në sistemin arsimor në shumë raste vështirësohet edhe për shkak të mungesës së dokumentacionit të nevojshëm nga ana e anëtarëve të këtij komuniteti. Shumë fëmijë romë të lindur gjate viteve 90' nuk janë regjistruar në rregjistrat e gjëndjes civile duke e bërë kështu rregjistrimin e tyre në shkolla shumë të vështirë dhe në të njëjtën kohë i bën fëmijët e këtij komuniteti viktima potenciale të krimeve të ndryshme si trafikimi dhe shfrytëzimi. Një tjetër pengesë jo të vogël përbëjnë edhe njohuritë e mangëta të gjuhës shqipe nga fëmijët rom, si pasojë e të cilave mësimi bëhet i pakuptueshëm dhe jo interesant për shumë fëmijë të këtij komuniteti që frekuentojnë shkollën. Ky problem bëhet akoma më i madh nëqoftëse merret në konsideratë fakti që në sistemin arsimor shqiptar ka shumë pak mësues që vijnë nga komuniteti rom ose që njohin gjuhën rome. Kjo problematikë haset edhe në shkollat ku nxënësit romë përbëjnë një numër të konsiderueshëm, por pavarësisht kësaj nuk ka asnjë lëndë që të zhvillohet në gjuhën rome.

Vetëm kohët e fundit kultura, historia dhe gjuha rome janë përfshirë në kurrikulën shkollore si lëndë me zgjedhje. Përjashtim në këtë rast bëjnë disa projekte të NGO të ndryshme, të cilat në mënyrë të sukseshme arritën të ndërthurrnin mësimin e kulturës dhe gjuhës rome me lëndë të tjera në gjuhën shqipe. Vazhdimësia e këtyre praktikave të suksesshme ndërpritet pas përfundimit të projekteve si pasojë e mbarimit të fondeve të parashikuara. Ajo që vihet re është një ngathtësi e institucioneve shtetërore për të adaptuar këto praktika të suksesshme dhe për ti shtrirë ato në të gjitha shkollat ku ka nxënës romë. Institucionet arsimore shqiptare janë të ngurta dhe larg të qenurit qendra komunitare. Si të tilla shkollat shqiptare shfaqen si të paaferta dhe tepër të ngurta për të kuptuar dhe për t'iu përshtatur psikologjisë dhe temperamentit të nxënësve romë. Studime të ndryshme, por edhe vetë përvoja e mësuesve kanë treguar se fëmijët romë kanë një natyrë lozonjare dhe preferojnë më shumë ato lëndë të cilat nuk i vendosin ata nën presion, si muzika apo sporti.¹⁰⁵ Projektet e implementuara nga NGO të ndryshme kanë zhvilluar programe alternative për arsimimin e fëmijëve romë duke ndërthurrur programet argëtuese me programin mësimor. Rezultati i këtyre programeve ishte shumë pozitiv pasi rezultoi jo vetëm në një frekuentim më të lartë të mësimin nga ana e fëmijëve romë, por edhe në një rritje të motivimit tek

¹⁰⁴ Krh. De Soto, Hermine/Beddies, Sabine/Gedeshi, Ilir (2005), f.XXVIII

¹⁰⁵ Krh. Tamo, Adem/Karaj, Theodhori (2007), f. 34

ata.¹⁰⁶ Kjo mospërputhje ndërmjet kurrikulave shkollore me temperamentin apo motivacionin e fëmijëve romë nga njëra anë dhe paaftësia e të dyja palëve për tu përshtatur me njeri tjetrin nga ana tjetër e kanë dobësuar rolin dhe kontributin e shkollës në promovimin dhe mbështetjen e një procesi efektiv të integritit të romëve në shoqëri.

Komuniteti rom është njohur nga shteti Shqiptar si minoritetet gjuhësor dhe si i tillë ai gëzon një status dhe disa të drejta të vecanta të lidhura me mbrojtjen e minoriteteve. Në këtë kuadër e drejta për tu arsimuar në gjuhën amtare merr një rëndësi të vecantë, sidomos po të marrim në konsideratë vendimin e Qeverisë Shqiptare për të njohur Konventën Kuadër për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare edhe për minoritetet gjuhësore.¹⁰⁷ Në nenin 14, pika 1 dhe 2 të kësaj Konvente artikullohet qartë marrja e masave për krijimin e kushteve dhe mundësive për të mësuar ose për tu arsimuar në gjuhën amtare:

1. Palët angazhohen të njohin se çdo person që i përket një pakice kombëtare ka të drejtën të mësojë gjuhën e tij/saj të pakicës.

2. Në zonat ku personat që i përkasin pakicave kombëtare, banojnë tradicionalisht apo në numër thelbësor, në se ka një kërkesë të mjaftueshme, Palët do të përpiqen të sigurojnë, për aq sa është e mundur, dhe në kuadrin e sistemeve të tyre arsimore, që personat që i përkasin këtyre pakicave të kenë mundësi të përshtatshme për të mësuar gjuhën e pakicës apo për të marrë mësim në këtë gjuhë.

Fëmijët romë të cilët frekuentojnë shkollën bëhen shpesh objekt i sjelljeve diskriminuese nga ana e mësuesve apo nxënësve të tjerë të klasës. Këto sjellje me natyrë diskriminuese bëhen kryesisht për shkak të përkatësisë etnike dhe ngjyrës së lëkurës. Më shumë se 90% e nxënësve romë pohojnë se nxënësit e tjerë i etiketojnë ata me fjalët “gabel” dhe “zezak”. Rreth 46% e tyre mendojnë dhe pohojnë se ata ndëshkohen më shpesh dhe më ashpër nga mësuesit sesa nxënësit e tjerë jo romë.¹⁰⁸ Një tjetër formë shumë e përhapur e diskriminimit (të fshehur) në sistemin arsimor është vendosja apo ulja e nxënësve romë në bankat e fundit dhe e nxënësve jo romë në bankat e para.¹⁰⁹ Këto veprime janë në kundërshtim jo vetëm me parimin e barazisë dhe të mosdiskriminimit të artikuluar në Kushtetutë, por edhe në nenin 3 të ligjit “Për Sistemin Arsimor

¹⁰⁶ Po aty.

¹⁰⁷ Krh. Salamun, Michaela (2006), f. 439

¹⁰⁸ Krh. Tamo, Adem/Karaj, Theodhori (2007), f.8-9

¹⁰⁹ Po aty.

Parauniversitar".¹¹⁰ Kapacitetet e kufizuara të shtetit shqiptar si në rrafshin lokal ashtu edhe në atë kombëtar kanë një rol jo të vogël në situatën e krijuar. Një rast tipik i kësaj paaftësie të strukturave shtetërore është moszbatimi i ligjit për arsimin parauniversitar, ku parashikohen sanksione të ndryshme financiare për ata prindër që nuk i lejojnë fëmijët e tyre të shkojnë në shkollë.¹¹¹

Tërësia e këtyre faktorëve dhe ndërveprimi i tyre me njëri-tjetrin e bëjnë përmirësimin e kësaj gjëndjeje në sistemin arsimor shqiptar shumë të vështirë dhe kompleks. Në kuadër të përmbushjes së detyrimeve që burojnë nga konventat ndërkombëtare shteti shqiptar ka ndërrmarë nisma dhe programe të ndryshme për të përmirësuar kushtet e jetesës së këtij komuniteti si edhe statusin e tyre social. Programet kryesore shtetërore që u hartuan për të përmirësuar situatën e romëve në sistemin arsimor janë dy: 1) *Strategjia Kombëtare për Përmirësimin e Kushteve të Jetesës së Komunitetit Rom*: Kjo strategji u zhvillua në kuadër të ratifikimit të Konventës Kuadër për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare. Hartimi i saj u bë nga bashkëpunimi i 11 Ministrive dhe u përcaktua si një angazhim politik i qeverisë shqiptare për integrimin e komunitetit Rom.¹¹² Në lidhje me fushën e arsimit kjo strategji parashikonte nxitjen e fëmijëve romë për të frekuentuar shkollën, krijimin e nje sistemi bursash me qëllim mbështetjen e tyre, krijimin e mundësive për akses në arsimin profesional si edhe mundësimin e kurseve të gjuhës shqipe pa pagesë. Janë shënuar disa zhvillime pozitive, kanë dalë disa udhëzime nga Ministrisa e Arsimit dhe Shkencës (sot MAS) për regjistrimin e fëmijëve romë në shkolla edhe pa certifikatë lindjeje¹¹³, për dhënien e librave falas për nxënësit romë që ndjekin arsimin bazë, për regjistrimin e fëmijëve romë në kopësht etj. Pavarësisht këtyre zhvillimeve pozitive kjo strategji pati një efekt të kufizuar si pasojë e disa mangësive në organizim. Ajo nuk u koordinua me strategjitë apo programet e tjera lokale, përcaktimi i objektivave u bë mbi të dhëna jo realiste dhe si rezultat dhe objektivat e saj ishin jo realiste, sidomos po të merret në konsideratë që mjetet financiarë në dispozicion të saj ishin tepër të kufizuara. Personeli i angazhuar për implementimin e saj ishte I

¹¹⁰ Krh. Motakef, Mona (2006), f. 17

¹¹¹ Ligji Nr. 7952, Data 21.06.1995 "Për Sistemin Arsimor Parauniversitar", Art. 24, 59, 60

¹¹² Strategjia Kombëtare për Përmirësimin e Kushteve të Jetesës së komunitetit Rom (2003), f. 10

¹¹³ Krh. MASH (2006): Udhëzim nr.6, datë 20.03.2006, "Për regjistrimin në shkollë të nxënësve Rom që nuk janë të pajisur me certifikatë lindjeje"

pakët dhe jo i mjaftueshëm për të koordinuar punën ndërmjet ministrive të linjës dhe autoriteteve lokale.

Mosidentifikimi i numrit të fëmijëve romë në moshë shkolle ishte një prej efekteve negative më të dukshme të këtij moskoordinimi. Megjithatë duhet theksuar se përgjegjësia për suksesin e kufizuar të kësaj strategjie nuk është vetëm e institucioneve shtetërore, por edhe e vetë komunitetit rom. Indiferenca e shfaqur prej tij si edhe mospjesëmarrja në disa prej programeve të parashikuara kanë bërë që ato të dështonin. i tillë është rasti me frekuentimin tepër të ulët nga ana e fëmijëve romë të kurseve të gjuhës shqipe apo edhe me sistemin e bursave, ku si pasojë e aplikimeve të pakta nuk e arriti qëllimin e tij final: rritjen e pjesëmarrjes dhe të frekuentimit të shkollës nga fëmijët romë.¹¹⁴

2) *Shansi i dytë*: Objektivi kryesor i këtij programi ishte riintegrimi në sistemin shkollor i të gjithë fëmijëve dhe të rinjve, të cilët kishin braktisur shkollën ose rrezikonin ta braktisnin atë. Ky program përbën në të njëjtën kohë edhe një prej përpjekjeve shtetërore më të mëdha për integrimin e fëmijëve rom në shkolla pas viteve 90'.¹¹⁵ Nga vlerësimet e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës rezultoi se 469 nxënës, prej të cilëve 50% ishin rom, përfituan nga ky program.¹¹⁶ Kjo u prezantua si një arritje në implementimin e këtij programi. Megjithatë duhet shtuar se grada e këtij sukseesi është e paqartë në një kohë kur nuk kemi një shifër zyrtare të fëmijëve romë në moshë shkolle për ta krahasuar. Në ndryshim nga programet dhe projektet e tjera, të cilat shoqëroheshin me një plan implementimi duke parashtruar prioritetet dhe objektivat, “Shansi i dytë” nuk e kishte një të tillë. Prioritetet, mjetet financiare për arritjen e tyre si edhe personeli i angazhuar për zbatimin e saj mbeten jo të qarta. Edhe në këtë program janë vënë re mangësi në koordinimin me projektet dhe programet e tjera në të njëjtën fushë si edhe tendencat jo bashkëpunuese nga ana e komunitetit rom. Megjithatë tendencat jo bashkëpunuese nga antarët e komunitetit rom nuk duhen interpretuar si një mungesë dëshire për tu integruar në shoqëri dhe sistemin arsimor, por ato duhen analizuar si mekanizma mbrojtës të zhvilluara ndër vite nga ky komunitet si pasojë e përjashtimit dhe diskriminimit të vazhdueshëm që iu është bërë atyre nga shoqëria dhe institucionet shtetërore. Si pasojë e këtyre përvojave negative në rradhët e këtij komuniteti është krijuar idea e të qënurit të padëshiruar. Të gjendur në këtë situatë ky komunitet

¹¹⁴ Krh. ECRI (2010), f. 22-23

¹¹⁵ Krh. Tamo, Adem/Karaj, Theodhori (2007), f. 27

¹¹⁶ Po aty.

është mbyllur në guaskën e tij dhe shpeshherë duke u nisur nga përvoja dhe mosbesimi shfaqin tendenca jo bashkëpunuese.

SITUATA E ROMËVE NË TREGUN E PUNËS

Zhbërja e vëndeve të punës si pasojë e mbylljes së ndërrmarjeve dhe punishteve shtetërore në industri dhe bujqësi. Ky proces coi në një papunësi masive në radhët e komunitetit rom. Romët ishin ndër të parët që humbën vendet e tyre të punës. Nëqoftëse i referohemi vitit 1996 papunësia në radhët e komunitetit rom varionte nga 80 deri në 90 %.¹¹⁷ Rritjet ekonomike të cilat Shqipëria ka njohur në vitet e kaluara dhe që kanë cuar në një reduktim të varfërisë në vend janë reflektuar shumë pak ose aspak në përmirësimin e gjëndjes ekonomike të komunitetit rom. Referuar një studimi të Bankës Botërore të vitit 2002 papunësia në radhët e komunitetit rom ishte rreth 71% në një kohë kur përqindja e papunësisë kombëtare ishte rreth 15.8%.¹¹⁸

Si pasojë e kësaj papunësie të madhe në rradhët e komunitetit të tyre rreth 78 % e anëtarëve të komunitetit rom jetojnë nën kufirin e varfërisë, pra me më pak se 4.30\$ në ditë, nga të cilët 39% në varfëri ekstreme me më pak se 2.15\$ në ditë¹¹⁹. Për shkak të shkallës së ulët të arsimimit dhe të përjashtimit social romët angazhohen kryesisht në sektorin informal në punë të një profili shumë të ulët. Të dhënat tregojnë se rreth 95.9% e romëve që punojnë nuk kanë kontrata pune.¹²⁰ Mungesa e kontratave të punës reflektohet edhe në pagesën e kontributeve shoqërore, ku vetëm 2.8% e të punësuarve i paguajnë ato. Ky moment vlen të theksohet pasi si pasojë e mospagesave të kontributeve shoqërore, romët përjashtohen ose ngelin jashtë skemave të ndryshme të përfitimeve dhe ndihmës sociale, përfshirë këtu edhe librezën shëndetësore. Të ardhurat mujore të një familje rome vlerësohen deri në 68 € në muaj, ndërsa të ardhurat mujore të një familje jo rome llogariten në rreth 175€ në muaj¹²¹. Në Shqipëri vihen re tendenca që për të njëjtën punë romët të paguhen më pak sesa kolegët e tyre jo romë. Kjo lloj sjelljeje dhe trajtimi financiar që iu bëhet romëve në vendin e punës në sektorin privat çënon dhe është në kundërshtim me Nenin 23, pika 2 dhe 3 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, ku shprehimisht thuhet se:

¹¹⁷ Krh. De Soto, Hermine/Beedies, Sabine/Gedeshi, Ilir (2005), f. XXIII

¹¹⁸ Krh. Progress Report on the National Strategy "On Improving the Living Conditions of the Roma Community", Albania (2005), f.43

¹¹⁹ Krh. Social Inclusion Crosscutting Strategy 2007-2013 (2007), f 35

¹²⁰ Krh. ECRI (2010), f. 40

¹²¹ Krh. DEZA (2011): Bildung für ethnische Minderheiten in Albanien. Unterricht und praktische Ausbildung für Roma

2. *Secili, pa kurrfarë diskriminimi, ka të drejtë që për punë të barabartë të marrë rrogë të barabartë.*

3. *Secili që punon ka të drejtë për një shpërblim të drejtë dhe të favorshëm, në mënyrë që t'i sigurojë atij dhe familjes së tij një jetë që i përgjigjet dinjitetit njerëzor dhe që, po qe se është e nevojshme, do të plotësohet me mjete të tjera të mbrojtjes sociale.¹²²*

Pavarësisht këtyre tendencave nuk është vënë re asnjë program shtetëror specifik për të luftuar format e diskriminimit të romëve në tregun e punës me përjashtim të disa iniciativave lokale të cilat kanë pasur një efekt të dobët dhe të kufizuar¹²³.

Ndër burimet kryesore të të ardhurave të komunitetit rom mund të rendisim shitjen e rrobave dhe sendeve të përdorura, mbledhjen e kanaceve dhe plastikës si edhe punë të ndryshme të castit në tregun informal të punës. Këto aktivitete sigurojnë rreth 60 % të të ardhurave të përgjithshme të komunitetit rom. Një tjetër burim të ardhurash i këtij komuniteti është edhe ndihma shtetërore e marrë në formën e pensioneve të pleqërisë dhe të invaliditetit si edhe në formën e ndihmës sociale. Të ardhurat nga këto burime, megjithëse të pakta, përbëjnë rreth 13.1 % të një familjeje rome.¹²⁴ Aksesit i romëve në tregun e punës bëhet vecanërisht i vështirë për shkak të nivelit të ulët të arsimit, vendeve të munguara të punës si edhe për shkak të etnicitetit të tyre (identitetit social). Romët dhe joromët jetojnë më së shumti të ndarë nga njëri tjetri. Romët jetojnë kryesisht në zona periferike mono-etnike. Kjo i kufizon mundësitë e tyre për të vendosur kanale komunikimi apo për të ndërtuar rrjete bashkëpunimi me pjesën jo rome të shoqërisë. Si pasojë e këtij ndërveprimi të dobët social me popullatën jo rome, romët kanë një kapital social¹²⁵ të kufizuar si pasojë e të cilit shanset për të gjetur një punë nëpërmjet kontakteve përkeqësohen dukshëm¹²⁶. Niveli i lartë i papunësisë dhe të ardhurat e ulëta në rradhët e komunitetit rom kanë cuar në një përkeqësim të standartit të jetesës të këtij komuniteti. Ky përkeqësim pasqyrohet edhe në fusha të tjera si arsimimi, strehimi dhe shëndetësia.

¹²² DEKLARATA UNIVERSALE PËR TË DREJTAT E NJERIUT (1948)

¹²³ Krh. ECRI (2010), f. 25

¹²⁴ Krh. UNDP (2012), f.37

¹²⁵ Kapitali social në këtë kapitull do të kuptohet sipas pikëpamjes së Bourdieus. Ai përcakton si kapital social tërësinë e resurseve që krijohen nga bashkëpunimi ndërmjet qytetarëve në proceset e njohjes së ndërsjellë. Sa më i madh kapitali social aq më i lehtë aksesit në fushat e jetës shoqërore si: punësimi, arsimimi apo forma të tjera të mbështetjes.

¹²⁶ Krh. De Soto, Hermine/Beedies, Sabine/Gedeshi, Ilir (2005), f.67

STREHIMI

Çështja e strehimit në rradhët e komunitetit rom është shumë problematike dhe nga vëzhgimet në terren apo edhe intervistat e ndryshme del se përbën një prej vështirësive më të mëdha me të cilat një numër I madh I anëtarëve të këtij komuniteti përballen. Shitja dhe humbja e shtëpive në të ashtuquajturat firma piramidale shënon edhe momentin kryesor të humbjes së shtëpive në masë nga ana e antarëve të komunitetit Rom. Si pasojë e kësaj shumë romë u shndërruan në të pastrehë dhe shumë prej tyre iu rikthyen jetës nomade. Vitet e fundit edhe në kuadër të Strategjisë Kombëtare për Përmirësimin e Kushteve të Komunitetit Rom (2003) janë vënë re përpjekje serioze nga ana e institucioneve shtetërore për të adresuar këtë problematikë nëpërmjet ndërtimit të banesave sociale.¹²⁷ Pavarësisht shumave të mëdha të parashikuara rezultatet kanë qenë të pakta. Kjo mungesë rezultatesh mund të shpjegohet me burokracitë e shumta dhe të komplikuar lidhur me implementimin e projekteve, por jo rrallë here implementimi i tyre është penguar edhe si pasojë e reflektimit të krizave dhe ngërceve politike në Këshillat Bashkiakë. Si rezultat i këtyre vështirësive vetëm 1/3 e buxhetit të parashikuar për këto projekte u shndërrua në vepra konkrete.¹²⁸

Forma të qarta të diskriminimit shfaqen në mënyrën se si përzgjidhen familjet për banesat sociale, ku edhe pse shumë familje rome i plotësojnë kriteret për tu bërë pjesë e programit të ndihmës me banesa sociale ato nuk përzgjidhen. Shpeshëherë familjet rome nuk aplikojnë për tu bërë pjesë e këtyre programeve edhe sepse një pjesë e mirë e antarëve të këtij komuniteti nuk arrijnë të plotësojnë dokumentacionin e nevojshëm për shkak të pamundësisë për të shkruar dhe lexuar apo nuk janë fare të informuar mbi ekzistencën e këtyre programeve. Në një studim të UNDP (Shqipëri), ku u pyetën 1200 romë rezultoi se 14.3% e tyre kishin aplikuar për banesa sociale dhe prej tyre vetëm 1.5% kishin arritur të përfiton një të tillë.¹²⁹ Pjesa më e madhe e tyre (46.2%) thonë se nuk kanë aplikuar për shkak të mungesës së informacionit.¹³⁰ Romët kryesisht banojnë në zona periferike dhe peri-urbane, pjesërisht të izoluar nga pjesa jo rome e shoqërisë. Infrastruktura në zonat ku ata jetojnë lë shumë për të dëshiruar duke bërë që këta individë të kenë

¹²⁷ Po aty, f.19

¹²⁸ Po aty.

¹²⁹ Krh. UNDP (2012), f. 25

¹³⁰ Po aty.

akses të kufizuar në burimet e ujit të pijshëm apo edhe në shërbimet e tjera sociale si shkolla apo edhe qendrat shëndetësore.

SHËNDETSIA

Të dhënat mbi aksesin e romëve në sistemin shëndetësor janë shumë të pakta dhe shpeshëherë të pasakta. Gjerësisht i njohur dhe i pranuar është fakti që romët gjenden në një pozicion shumë të papërshtatshëm dhe të lënë pas dore në lidhje me aksesin e tyre në shërbimet e ofruara nga sistemi shëndetësor. Shpeshëherë ata bëhen objekt diskriminimi nga ana e mjekëve dhe infermiereve duke mos iu dhënë atyre shërbimin e nevojshëm. Në një studim të Bankës Botërore rreth 22% e 331 romëve të pyetur pohuan se kanë qenë objekt i diskriminimit nga ana e mjekëve për shkak të përkatësisë së tyre.¹³¹ Pavarësisht se në legjislacionin shqiptar parashikohet që fëmijët deri në moshën 16 vjecare, personat me aftësi të kufizuara, pensionistët, marrësit e ndihmës sociale dhe nënat shtatëzëna përjashtohen nga pagesat për sigurimet shëndetësore, rreth 42% e romëve nuk kanë librezë shëndetësore dhe për pasojë janë të përjashtuar nga përfitimi i shërbimeve shëndetësore pa pagesë.¹³² Kjo ka ndikuar në mënyrë të drejtëpërdrejtë dhe negativisht në shëndetin e tyre individual. Jetëgjatësia në rradhët e komunitetit rom është rreth 10 vjet më e vogël se ajo e pjesës jo romë të popullsisë.¹³³ Akoma më problematike shfaqet situata tek fëmijët e komunitetit rom, sidomos tek ata që nuk janë të regjistruar në regjistrat civilë. Duke mos qenë të regjistruar ata janë automatikisht të përjashtuar nga shërbimet e sistemit shëndetësor dhe për pasojë humbin mundësinë e bërjes së vaksinave bazë.

Duhet thënë se nuk kanë munguar përpjekjet nga institucionet shtetërore për të përmirësuar aksesin e romëve në shëndetësi, por pavarësisht këtyre përpjekjeve shumë pak ka ndryshuar në përmirësimin e kësaj situate. Si praktika të mira mund të përcaktojmë fushatën me të ashtuquajturat qendra shëndetësore lëvizëse të cilat shkonin në vendbanimet romë kryesisht në zonat jashtë qyteteve, me qëllim kryerjen e check up-eve dhe vaksinimin e fëmijëve nga ky komunitet. Nga kjo fushatë, megjithëse nuk ka të dhëna të sakta, përfituan edhe fëmijët romë të paregjistruar.

¹³¹ Krh. De Soto, Hermine/Beddies, Sabine/Gedeshi, Ilir (2005), f. 47-48

¹³² Krh. UNDP (2012), f. 32

¹³³ Krh. ECRI (2010), f.16

KONKLUZION

Kombinimi i një sërë faktorëve në disa fusha specifike të jetës socio-ekonomike coi në një përkeqësim të dukshëm të kushteve të jetesës së komunitetit rom. Humbja e vëndeve të punës si pasojë e mbylljes së punishteve shtetërore, braktisja në masë e shkollës nga fëmijët romë, shitja e shtëpive si edhe mungesa e programeve shtetërore serioze ishin ndër faktorët kryesorë që e përshpejtuan këtë proces. Varfëria që lindi dhe u zgjerua në dinamikën e zhvillimit të këtyre proceseve mund të shikohet si shkak, por edhe si pasojë në të njëjtën kohë e përjashtimit social. Aksesit i ulët i anëtarëve të këtij komuniteti në tregun e punës, arsimim, shëndetësi dhe strehim, si edhe mosrespektimi i të drejtave të tyre sociale që burojnë dhe garantohen nga legjislacioni kombëtar dhe në të njëjtën kohë nga konventat e marrëveshjet ndërkombëtare kanë cuar në përjashtimin e tyre nga aspektet më të rëndësishme të jetës shoqërore, politike e ekonomike. Shumë problematike shfaqet situata në fushën e arsimit. Aksesit i munguar i romëve në sistemin arsimor lidhet drejtpërdrejt me varfërinë dhe diskriminimin. Si pasojë e të ardhurave shumë të ulta mundësitë për të financuar shkollimin e fëmijëve të tyre shndërrohen për shumë familje rome në një mision të pamundur.

Një frekuentim i suksesshëm i shkollës ka një rëndësi shumë të madhe sidomos për aftësimin dhe fuqizimin e këtij komuniteti duke ndikuar kështu në një përmirësim të statusit të tyre socio - ekonomik. Për shkak se shteti dhe institucionet e tij ishin ekonomikisht jo në gjëndje për të mbështetur këtë komunitet shanset e punësimit dhe të arsimimit erdhën duke u ulur duke cuar kështu në një kufizim të mundësive të tyre ekonomike¹³⁴. Romët u bënë pjesë e një rrethi vicioz bazuar tek varfëria, dhe shkalla e ulët e arsimimit. Nuk ekziston një zgjidhje e lehtë për këtë problem. Ajo çfarë nevojitet përkundrejt kësaj situatë janë iniciativat e mirëorganizuara dhe mirëkoordinuara si në rrafsh kombëtar ashtu edhe në atë lokal. Çështja rome nuk duhet parë si një fenomen shqiptar, por si një fenomen rajonal dhe europian dhe si i tillë ajo kërkon një koordinim me politikën dhe projektet europiane në këtë drejtim.

Referenca:

1. Motakef, Mona ,2006;
2. De Soto, Hermine/Beedies,Sabine/Gedeshi,Illir, 2005;

¹³⁴ Krrh. UNICEF (2007), f. 19

3. Tamo,Adem/ Karaj, Theodhori ,2007;
4. UNICEF (2007),
5. DEKLARATA UNIVERSALE PËR TË DREJTAT E NJERIUT (1948);
6. Social Inclusion Crosscutting Strategy 2007-2013 (2007),
7. Progress Report on the National Strategy “On Improving the Living Conditions of the Roma Community”, Albania, 2005.

IDENTITETET FETARE DHE IMPAKTI I TYRE NË SIGURINË DHE POLITIKËN E JASHTME TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË: NJË QASJE SIPAS REALIZMIT NEOKLASIK

Jordan JORGJI

Universiteti Fan.S.Noli – Korçë, Shqipëri

jordanjorgji@yahoo.com

ABSTRAKT

Synimi kryesor i këtij artikulli është eksplorimi dhe analiza e identiteteve fetare të Shqiptarëve dhe më pas, e ndikimit të tyre mbi ndërgjegjen kolektive kombëtare. Në këtë kontekst, do të vijojë një analizë mbi impaktin e faktorëve të mësipërm në politikën e jashtme të Republikës së Shqipërisë, por edhe tek siguria kombëtare. Kjo analizë do të zhvillohet brenda kuadrit dhe perspektivës të Realizmit Neoklasik, si model teorik i Marrëdhënieve Ndërkombëtare.

Gjatë studimit, do të preken aspektet historike të identitetit kombëtar dhe karakteri dinamik i aspekteve në lidhje me zhvillime kombëtare, rajonale dhe globale, siç janë pavarësia e Kosovës, Marrëveshja e Ohrit, kriza financiare greke, evropiane dhe globale, integrimi evropian, si dhe fanatizmi fetar. Në këtë kuadër është i nevojshëm vëzhgimi i marrëdhënieve të Shqipërisë me fqinjët dhe vendet e tjera të rajonit, si në nivelin ndërshtetëror, ashtu dhe në nivel ndërshtetëror.

Analiza e identiteteve fetare do të marrë parasysh teorinë dhe aplikimin e “harmonisë dhe dashurisë fetare”, si parim historik që reflekton cilësi psikosociale, individuale dhe kolektive, por dhe ato dimensione që mund të venë në dyshim parimin e mësipërm.

Në fund, do të ngrihen sugjerime dhe rekomandime mbi dinamikën e identiteteve fetare si dhe mbi impaktin e tyre në politikën e jashtme shqiptare.

Fjalë Kyçe: *Identitet fetar, identitet kombëtar, harmoni fetare, politikë e jashtme, realizëm neoklasik, nacionalizëm, irredentizëm, islam politik, siguri kombëtare, siguri rajonale.*

HYRJE

Qëllimi i këtij punimi është evidentimi i impaktit të fesë si faktor i brendshëm i shtetit shqiptar tek siguria dhe politika e jashtme. Këtë qasje do të mundohem ta arrij përmes një modeli teorik të marrëdhënieve ndërkombëtare, atij të realizmit neoklasik.

Siç do të shihet në vijim, është e vështirë të heqësh vija të qarta se ky apo ai identitet fetar ka impakt të drejtpërdrejtë mbi politikën e jashtme shqiptare. Kjo vështirësi vjen të paktën për dy arsye themelore. E para, sepse prevalojnë aspekte thelbësore në impaktin e tyre mbi politikën e jashtme, aspekte të cilat kanë synim të drejtpërdrejtë dhe rezultat të prekshëm. Një prej shembujve kryesorë ka të bëjë me orientimin e vendit drejt aleancave strategjike, të cilat mbrojnë interesin kombëtar të Republikës së Shqipërisë në skenën ndërkombëtare. Së dyti, shpesh herë, imazhi real mbulohet nga autoimazhi i manipuluar, duke bërë, kështu, që të mos shihet me sy të lirë lidhja e fesë, si faktor i brendshëm, me politikën e jashtme. Në këtë kontekst, mund të përmendet fenomeni i harmonisë fetare, term i cili konceptohet pothuajse nga cilido si ligj absolut i shtetit dhe shoqërisë shqiptare, si një doktrinë që nuk mund të vihet në dyshim¹³⁵. Manipulimi i pjesshëm i këtij autoimazhi mund të ndikojë tek formimi i opinionit publik, si një orientim thelbësor i cili maskon gjykimet që mund të bëhen duke u bazuar posaçërisht mbi sentimentet fetare¹³⁶.

Pra, duke marrë parasysh aspektet kryesore që bëjnë të vështirë eksplorimin e relacionit të identiteteve fetare mbi politikën e jashtme të Republikës së Shqipërisë, do të përpiqem të identifikoj këtë relacion përmes analizimit të ecurisë historike të marrëdhënies së identiteteve fetare me Shqiptarizmin, si dhe përmes zhvillimeve aktuale të politikës së jashtme.

¹³⁵ Zyhdi Dervishi, *Vështirësi të kryqëzuara në det*, Botimi i katërt, Tiranë: Jerusalem, 2007: 31.

¹³⁶ Noel Malcolm, "Myths of Albanian National Identity," tek Stephanie Schwandner-Sievers, Bernd J. Fischer, eds, *Albanian Identities: Myth and History*, London: Hurst & Co, 2002: 70-87 (84-87).

REALIZMI NEOKLASIK SI MODEL TEORIK NË MARRËDHËNIET NDËRKOMBËTARE

Në fushën e teorive të marrëdhënieve ndërkombëtare, vlen të përmendet një rrymë relativisht e re, e cila lindi në fillimet e viteve '90 brenda familjes së madhe të realizmit¹³⁷. Kjo rrymë përbën një kombinim të arritur midis realizmit klasik, atij strukturor – neorealizmit – dhe disa teorive të politikës së jashtme, të cilat bazohen tek elementë të brendshëm të shteteve, të quajtura ndryshe *innenpolitik*¹³⁸.

Nga realizmi klasik merret koncepti i interesit kombëtar dhe i balancës së fuqisë, si karakteristika kryesore të shtetit dhe sistemit ndërkombëtar¹³⁹. Nga neorealizmi huazohet logjika se është sistemi ai që përcakton sjelljen e shteteve si aktorë në politikën botërore¹⁴⁰. Megjithatë, shteti nuk analizohet hollësisht nga neorealizmi. Këtë boshllëk teorik dhe metodologjik fillon ta zërrë realizmi neoklasik, i cili vendos theksin mbi elementët brenda-shtetërorë. Këto të fundit mund të jenë: lidershipi dhe perceptimet e tij, marrëdhënia shtet-shoqëri, eksperiencat historike, kultura, modelimi psikosocial dhe socialkulturore i shoqërisë, siguria, ideologjia, balancat e brendshme, feja, etj¹⁴¹.

Sipas realizmit neoklasik sinjalet strukturore përpunohen nga elementë autonomë, me rezultat formulimin e politikës së jashtme, sipas skemës *inputs → process → outputs*.

Në këtë kuadër, impakti i identiteteve fetare mbi politikën e jashtme të Republikës së Shqipërisë, zhvillohet në kontekstin e rolit të këtyre identiteteve mbi kohezionin fluid të shoqërisë shqiptare.

¹³⁷ Randall Schweller, "Unanswered Threats: A Neoclassical Realist Theory of Underbalancing," *Internal Security*, Vol. 29, No. 2, Fall, 2004: 159-201 (164).

¹³⁸ Gideon Rose, "Neoclassical Realism and Theories of Foreign Policy," *World Politics*, 51, no.1, October 1998: 144-172 (163).

¹³⁹ Hans J. Morgenthau, *Politics among Nations: The Struggle for Power and Peace*, New York: Alfred A. Knopf, 1948: 129-133.

¹⁴⁰ Jeffrey W. Taliaferro, "Neoclassical realism and resource extraction: State building for future war," tek Steven E. Lobell, Norrin M. Ripsman, Jeffrey W. Taliaferro, eds, *Neoclassical Realism, the State, and Foreign Policy*, Cambridge, Cambridge University Press, 2009: 207-210.

¹⁴¹ Thomas Christensen, *Useful Adversaries: Grand Strategy, Domestic Mobilization, and Sino-American Conflict, 1947-1958*, Princeton, NJ: Princeton University Press, 1996: 11.

Shqipëria si një vend i vogël dhe vulnerabël, ka nevojë për stabilitet politik, ekonomik, institucional dhe kryesisht shoqëror, në mënyrë që të mund të procedojë në nivelin rajonal dhe ndërkombëtar. Pra, që politika e jashtme ti shërbejë interesit kombëtar për ruajtjen e pavarësisë dhe sovranitetit, zhvillimit ekonomik dhe politik, si dhe mbrojtjes së Shqiptarëve dhe rritjes së mirëqenies së tyre, Shqipërisë i nevojitet, midis të tjerash, edhe kohezioni shoqëror. Përderisa shoqëria e shtetit shqiptar është multifetare, atëherë mirëkuptimi dhe kohezioni ndërfetar ka rëndësi themelore dhe strategjike për sigurinë dhe politikën e jashtme të Republikës së Shqipërisë.

IDENTITETET FETARE DHE SHQIPTARIZMI NË RRJEDHËN E KOHËS

Feja, së bashku me gjuhën, përbëjnë dy nga ngjithësit kryesorë të etnicitetit të politizuar, pra të idesë kombëtare¹⁴². Nëse gjuha është kriteri themelor i vetëdërgjegjësimit dhe vetëpërcaktimit të individëve si pjesë e grupit etnik dhe më vonë kombit, feja forcon lidhjet komunitare të një kombi të caktuar.

Ndërsa pjesa më e madhe e grupeve etnike në Ballkan janë homogjene për sa i përket fesë – si për shembull, Grekët, Serbët – Shqiptarët karakterizohen nga heterogjeniteti fetar. Të paktën tre religjione e gjysmë kanë qenë ato më kryesoret në periudhën e zgjimit dhe lëvizjes kombëtare të Shqiptarëve: Myslimanët suni, si pjesa më e madhe e popullsisë; Ortodoksët, si pjesa më e rëndësishme në disa rajone në jug të vendit; Katolikët, të cilët banojnë kryesisht në Shqipërinë veriore; dhe Bektashinjë, një version Shiit, të cilët banojnë kryesisht në zonat jugore por edhe në Krujë.

Përgjatë shekullit të XIX dhe XX, marrëdhënia fluide e identitetit kombëtar në përpunim, nga njëra anë dhe heterogjenitetit fetar, nga ana tjetër, pati ndikim tek prioritetet kombëtare dhe politike, si dhe u ndikua nga ato.

Nacionalizmi nacionalizues – pra nacionalizmi i përdorur nga shteti që tashmë është formuar – zakonisht përpiqet të forcojë kulturën dhe identitetin kombëtar, në disfavor të subkulturave dhe llojeve të ndryshme të nënidentiteteve. Ky proces ka intensitet akoma më të madh kur

¹⁴² John E. Joseph, "Identity," tek Carmen Llamas, Dominic Watt, eds, *Language and Identities*, Edinburgh: Edinburgh University Press, 2010: 9-17 (9). Amado M. Padilla, "Psychology," tek Joshua A. Fishman, ed, *Handbook of Language and Ethnic Identity*, Oxford: Oxford University Press, 1999: 109-121 (111).

nënidentitetet e shohin me mosbesim pushtetin qendror dhe ndërgjegjien kolektive në veprim¹⁴³. Në këtë kontekst, marrëdhënia e Shqiptarizmit me identitetet e ndryshme fetare ka marrë forma të shumta, përgjatë periudhave kohore.

Në fillimet e shtetit shqiptar, bashkëjetesa midis besimit kolektiv kombëtar dhe ndërgjegjes fetare, kishte trajtën e bashkekzistencës midis identiteteve paralele.

Më pas, ideja kombëtare mori formën e identitetit-çati që ngrihej si çadër mbi identitetet fetare. Këto të fundit u kthyen, gradualisht, në nënidentitete. Kjo u vu re përgjatë periudhës së konsolidimit të shtetit shqiptar deri në dy dhjetëvjeçarët e parë të periudhës së socializmit totalitar.

Më vonë, nënidentitetet fetare u shtypën akoma më shumë nga identiteti kombëtar, i cili ishte përforcuar me elemente të ideologjisë së Marksizmit Leninist-Stalinist, si dhe kishte filluar të implementojë forma dhune¹⁴⁴. Tashmë, nënidentitetet fetare kalojnë në ilegalitet. Në këtë periudhë, të ishe Ortodoks, Shqiptar Katolik apo komunist Mysliman, anatemohej jo vetëm nga shteti por edhe nga vetë shoqëria.

Pas përfundimit të periudhës së Luftës së Ftohtë, rizgjimi i ndjenjave të nacionalizmit, lokalizmit, individualizmit, u shoqërua me rizgjim të sentimenteve fetare, si në nivel individual, ashtu dhe në atë shoqëror dhe shtetëror, duke kontribuar, kështu, në ringritjen e shumë institucioneve dhe monumenteve të religjionit¹⁴⁵.

Kriza identitare që na karakterizoi pas rënies së sistemit socialist-totalitar si dhe emigrimi masiv i Shqiptarëve drejt vendeve të zhvilluara¹⁴⁶, të cilat, në aspektin historik dhe kulturor, dispononin karakter të krishterë, ndikuan që shumë Shqiptarë, kryesisht të Shqipërisë, të joshen nga identiteti kristian dhe ta adoptojnë atë. Kthimi i syve nga Perëndimi i krishterë apo laik, përkonte me përparësitë politike të shtetit shqiptar.

¹⁴³ Janice E, Thomson, "State Sovereignty in International Relations: Bridging the Gap Between Theory and Empirical Research," *International Studies Quarterly*, 39 (June), 1995: 213-233. (216).

¹⁴⁴ Giovanni Sartori, *Ç'është Demokracia?* Tiranë: Dituria, 1998: 122.

¹⁴⁵ Robert Philipson, "Political Science," tek Joshua A. Fishman, ed, *Handbook of Language and Ethnic Identity*, Oxford: Oxford University Press, 1999: 94-108 (97).

¹⁴⁶ Zyhdi Dervishi, *Gratë në turbulencat e mëndësive dhe realiteti politik*, Tiranë: Emal, 2011: 19-24

Nga ana tjetër, pas përfundimit të konfliktit në Kosovë dhe Maqedoni, u zgjeruan haptazi të drejtat e Shqiptarëve në vendet përkatëse. Kjo çoi në çlirimin dhe eksportimin e identitetit kolektiv, të tipit nacional-fetar, të pjesës dërmuese të Shqiptarëve të këtyre trojeve, si identitet përfaqësues i një popullsie pothuajse homogjene myslimane suni.

Rënia e barrierave midis Shqiptarëve, pati si rezultat diferencimin më intensiv të identiteteve fetare. Nga njëra anë kemi identitetin e krishterë, atë laik, si dhe identitetin mysliman të moderuar të Shqiptarëve të Shqipërisë, si properëndimorë; ndërsa nga ana tjetër, vjen si shtojcë, identiteti i deklaruar nationalist-mysliman i Shqiptarëve të Kosovës dhe Maqedonisë, të cilët, zakonisht, ndajnë solidaritet të konsiderueshëm me vende si Turqia apo udhëheqës të veçantë saj.

Rritja e heterogjenitetit fetar tek Shqiptarët si dhe prirjet e kundërta të identiteteve fetare për tu identifikuar me periudha të ndryshme kohore, me kultura dhe politika të kundërta të vendeve fqinjë dhe më gjerë, mund të shërbejnë si forca centrifugale sfiduese ndaj ndërgjegjes kombëtare, ndaj simboleve të personifikuara kolektivisht, si dhe ndaj kohezionit të shoqërisë së shtetit shqiptar. Për shembull, nëse identiteti i theksuar fetar do të vinte në dyshim legjitimitetin historik dhe kombëtar të simboleve kolektive, kjo do të rriste mosbesimin tek pjesa tjetër e Shqiptarëve, të cilët ndajnë identitete të ndryshme, qoftë laik, të krishterë, apo mysliman të moderuar.

Politizimi i identitetit të ngurtë mysliman të një pjese të rëndësishme të Shqiptarëve të Kosovës, Maqedonisë dhe Malit të Zi, mund të çojë drejt një islami politik, i cili do të mund të bazojë ekzistencën e Shqipërisë si shtet, prosperitetin e saj apo dhe irredentizmin, me të qenit mysliman i devotshëm. Shohim se flamuri *Autochthonous* po personifikohet jo vetëm nga Shqiptarët e ish-Jugosllavisë, por dhe nga shumë Shqiptarë të Shqipërisë, duke sfiduar në një farë mënyre dhe vetë flamurin kombëtar. Gjithashtu, identifikimi i fesë ortodokse si fe e kundërshtarëve dhe armiqve – Sllavë – do të vështirësonte urat e komunikimit me Ortodoksët Shqiptarë, duke bërë që këta të fundit të ndjejnë një farë pasigurie fetare, fenomen i cili mund të vijë gradualisht duke u rritur.

Një version fanatik dhe jo i moderuar i identiteteve fetare mund të rrisë pasigurinë e Shqipërisë si një vend i vogël dhe i dobët, për sa i përket brishtësisë së kohezionit shoqëror.

Impakti i këtij procesi në sigurinë kombëtare është diçka që duhet të shihet me kujdes, jo vetëm nga institucionet e ushtrimit të autoritetit politik mbi Shqiptarët, por edhe nga ato institucione shoqërizuese si familja, shkolla, media, institucionet e kultit, etj¹⁴⁷.

Përtej aspektit të sigurisë, një brishtësi potenciale e kohezionit shoqëror, mund ketë pasoja negative, në lidhje me stabilitetin e vendit për sa i përket politikës së jashtme në rajon dhe më gjerë¹⁴⁸. Në këtë kontekst, harmonia fetare duhet të ushqehet herë pas here nga shteti dhe shoqëria, si një kolonë e rëndësishme për ruajtjen e karakterit ndërfetar të Shqiptarizmit.

STUDIM I RASTIT (CASE STUDY)

Në kuadër të kësaj tematike, u zhvillua një kërkim primar dhe modest, me qëllim eksplorimin dhe analizimin e marrëdhënies midis identiteteve fetare dhe politikës së jashtme të shtetit shqiptar, në raport me vende që ndodhen gjeografikisht dhe historikisht afër me Republikën e Shqipërisë, siç janë: Maqedonia, Greqia, Italia, Mali i Zi, Serbia, Turqia dhe Kroacia.

Pilotimi i referohet një pjese të të rinjve të rajonit të Korçës, të cilët studiojnë në Universitetin Fan.S.Noli. U plotësuan 50 pyetësorë nga studentë të përzgjedhur rastësisht¹⁴⁹.

- Identiteti fetar i studentëve që plotësuan pyetësorin ishte:
 - Myslimanë Suni – 27 veta ose 54% e pjesëmarrësve;
 - Të Krishterë Ortodoksë – 9 veta ose 18%;
 - Bektashinj – 4 veta ose 8%;
 - Protestantë – 3 veta ose 6%;
 - Agnostikë – 2 veta ose 4%;

¹⁴⁷ Anthony M. Orum, John G. Dale, Political Sociology, Fifth Edition, New York: Oxford University Press, 2009: 67.

¹⁴⁸ Randall Schweller, "Unanswered Threats: A Neoclassical Realist Theory of Underbalancing," Internal Security, Vol. 29, No. 2, Fall, 2004: 159-201 (200-201).

¹⁴⁹ Pilotim përmes pyetësorit, tek studentët e Universitetit Fan.S.Noli, Korçë, Shkurt, 2016.

- Ateistë – 2 veta ose 4%;
 - Katolikë – 1 vetë ose 2%;
 - Miks (Bektashi dhe Katolik) – 1 vetë ose 2%;
 - Bahai – 1 vetë ose 2%.
- Bie lehtë në sy fakti që preferenca kryesore e të gjithë personave të pyetur, pothuajse pa dallim identiteti fetar, lidhet me Italinë. Vendi i dytë më i preferuar është Greqia, edhe pse kjo e fundit përbëhet nga një popullsi e ndryshme për sa i përket identitetit fetar të pjesës më të madhe të popullsisë shqiptare dhe gjithashtu të kampionit në pilotim. Vendi i tretë është Turqia ndërsa vendi më i pa preferuar për opinionin publik shqiptar është Serbia. Në këtë kontekst, është interesant fakti se tek pyetjet për të vlerësuar shtetet e mësipërme me pikë preference nga pika më e ulët 1 deri tek pika më e lartë 10, dy studentë kishin shënuar qartësisht përbri Serbisë fjalën dhe simbolin *Zero*, ndërsa tek alternativa e Italisë ishte shënuar nota 15!
 - Myslimanët Suni, të cilët, qartësisht, përbëjnë pjesën më të madhe të personave që morën pjesë në pilotim, pas Italisë, preferojnë më shumë Turqinë.
 - Bektashinjtë preferojnë më shumë Greqinë, në vend të dytë Italinë dhe më pas Malin e Zi.
 - Në preferencat e të Krishterëve Ortodoksë në vend të parë renditet Greqia, më pas Italia, ndërsa në vend të tretë Kroacia.
 - Për sa i përket pyetjes se cili shtet shihet si partneri strategjik i Shqipërisë në politikën e jashtme të kësaj të fundit, pjesa më e madhe e të intervistuarve preferojnë Italinë, në vend të dytë Turqinë, e më pas Greqinë. Nëse do hiqnim mënjatë Italinë, si aleati rajonal i preferuar nga pothuajse të gjithë Shqiptarët, myslimanët suni preferojnë Turqinë si partnerin strategjik të Shqipërisë në rajon, ndërsa ortodoksët dhe bektashinjtë Greqinë. Nga ana tjetër, Serbia shihet nga të gjithë, si aleati më i pamundur strategjik i Shqipërisë, duke u radhitur, përsëri, në vend të fundit.

- Për sa i përket formimit të opinionit, pjesa më e madhe e të intervistuarve deklaroi se është influencuar nga njohuritë universitare, media dhe shkolla.

KONKLUZION

Në nivel retorik, është theksuar shumë herë nga udhëheqësit shqiptarë se aleatet strategjike të Republikës së Shqipërisë në rajon janë Italia, Greqia dhe Turqia.

Mund të themi, në vija të trasha, se emigracioni masiv shqiptar në Greqi menjëherë pas fillimit të viteve '90; perceptimi i Turqisë si mburojë e Shqiptarëve nga ndonjë kërcënim serbo-grek; imazhi masiv i Italisë si porta e Perëndimit dhe e Shqipërisë Evropiane, si dhe përqendrimi mediativ shqiptar drejt kulturës italiane; kanë ndikuar në mënyrë thelbësore tek orientimin i preferencave të opinionit publik shqiptar.

Përveç këtyre faktorëve thelbësorë, treshja strategjike Romë-Athinë-Ankara koïncidon edhe me përbërjen fetare të shoqërisë në shtetin shqiptar, qoftë në aspektin historik, por edhe në atë aktual. Në kuadrin e një analize të politikës së jashtme marrja në konsideratë e identiteteve fetare është një element, gjithashtu i rëndësishëm, i cili nuk duhet anashkaluar.

Referenca:

Bibliografia parësore:

Pilotim përmes pyetësorit, tek studentët e Universitetit Fan.S.Noli, Korçë, Shkurt, 2016.

Bibliografia dytësore:

Libra

1. Christensen, Thomas. Useful Adversaries: Grand Strategy, Domestic Mobilization, and Sino-American Conflict, 1947-1958. Princeton, NJ: Princeton University Press, 1996.
2. Dervishi, Zyhdi. Vështrime të kryqëzuara në det. Botimi i katërt, Tiranë: Jerusalem, 2007.
3. Dervishi, Zyhdi. Gratë në turbulencat e mëndësive dhe realiteti politik. Tiranë: Emal, 2011.

4. Fishman, Joshua, A. ed. *Handbook of Language and Ethnic Identity*. Oxford: Oxford University Press, 1999.
5. Llamas, Carmen. Watt, Dominic. eds. *Language and Identities*. Edinburgh: Edinburgh University Press, 2010.
6. Lobell, Steven, E. Ripsman, Norrin, M. Taliaferro, Jeffrey, W. eds. *Neoclassical Realism, the State, and Foreign Policy*. Cambridge, Cambridge University Press, 2009.
7. Morgenthau, Hans, J. *Politics among Nations: The Struggle for Power and Peace*. New York: Alfred A. Knopf, 1948.
8. Orum, Anthony, M. Dale, John, G. *Political Sociology*. Fifth Edition, New York: Oxford University Press, 2009.
9. Sartori, Giovanni. *Ç'është Demokracia? Tiranë: Dituria*, 1998.
10. Schwandner-Sievers, Stephanie. Fischer, Bernd, J. eds. *Albanian Identities: Myth and History*. London: Hurst& Co, 2002.

Revista

1. Rose, Gideon. "Neoclassical Realism and Theories of Foreign Policy." *World Politics*, 51, no.1, October 1998: 144-172.
2. Schweller, Randall. "Unanswered Threats: A Neoclassical Realist Theory of Underbalancing." *Internal Security*, Vol. 29, No. 2, Fall, 2004: 159-201.
3. Thomson, Janice, E. "State Sovereignty in International Relations: Bridging the Gap Between Theory and Empirical Research." *International Studies Quarterly*, 39 (June), 1995: 213-233.

MORALI DHE DISKURSI POLITIK

Ma.Sc. Kujtim KASAMI

Candidate of Doctoral Sciences

kujtimkasami@gmail.com

ABSTRAKT

Morali i takon individit. Individit vepron sipas moralit të tij, dhe përmes veprimeve të tij, ai ndikon tek të tjerët dhe kështu është politika. Politika i takon publikut. Mendimet e përbashkëta të publikut përcatojnë kushte, dhe nëpërmjet këtyre kushteve ndikohet individit. Pastaj, morali, duket që lidh individin me politikën. E shtynë individin të kontribuojë për mendimet e publikut, mendime të cilat ndikojnë tek individit përmes atyre kushteve. Dhe me të vërtetë, morali është çështje që dominon në diskutimet e fundit në politikë. Më parë, zona “morali – dritë” ishte si një aferë e huaj, kujdes shëndetsorë, ekonomia dhe në veçanti lart – fund reduktimi i taksave, tani i bashkangjiten moralit tradicional, siç është aborti, hulumtimet biologjike dhe të drejtat e homoseksualve. Këto çështje dhe të tjerat, të gjithë janë përshtatur termit të moralit, ose së paku pa dyshim apelojnë nën rryma morale. Pyetjet janë ngitur: A është ky moral i fokusuar në arritjen e diçkaje të re? Çfarë gjuhe njollosoi bisedimet e tanishme morale të ngarkuara? Pse diskutimet morale mund të dominojnë me sa duket në shumë zona të pandërlidhura? Është ky morali që shtyn shkëmbimet e shëndetit për politikë? Ky punim kërkon përgjigjet e këtyre bisedimeve, pyetjet e së cilës bazohen në ekzaminimin e vendit të moralit në politikë.

Fjalë kyçe: *Morali, etika, politika dhe demokracia.*

HYRJE

Përfshirja e moralit në politikë mund të gjurmohet qysh nga fillimi i qeverisjes. Në lashtësi mbretërit jo despotik autoritetin e tyre e themeluan në dhuntitë e tyre shpirtërore, aftësitë e tyre personale, bamirësitë dhe cilësi të tjera që gjetën subjektet e tyre të vlefshme dhe bujare. Shumë nga këto figura mbretërore kaluan në histori. Në atë kohë ishte idealizimi i mbretit filozofik të Platos, personazhe biblike siç është Mbreti Arthur, dhe figura të tjera të pa krahasueshme nga të dyja traditat ajo perëndimore dhe lindore. Dikush mund të tregojë nëse këta mbretër me të vërtetë janë modern në politikë, dikush mund të akuzojë që çdo mbret i vërtetë ka qenë despot dhe i pamoralshëm.

MORALI SI ELEMENT I POLITIKËS PËR GJATË KOHË I THEMELUAR

Megjithatë, madje si që pranojmë dallimet midis qeverisjes antike dhe politikës moderne, mund me siguri të vendosim atë se këta mbretër, figurat më të ngritura antike kanë patur veti dhe kanë bërë respektimin e vlerave që lirshëm mund ti thirrim morale. Kështu morali, luajti një pjesë thelbësore në “politikën e antikitetit.

Me kalimin e kohës, pjesa e moralit evuloi në politikë sikur që vetë morali evuloi. Morali i individit nga mbreti është zavendësuar nga grupi i fesë së moralit. Teokracia dhe pseudoteokracia u shfaq nëpër botë. Këto shtete zakonisht ishin organizuar në mënyrë feudale, por zotërinjtë feudal dhe mbretërit tash themelojnë autoritetin e tyre mbi “miratimin nga parajsa”. Këto zotërinj fetar dhe mbretërit me sa duket ndjekin “urdhërin e parajsës” urdhër që aktron përmes zotërinjve dhe mbretërve për të krijuar një shtet të mençur. Shembujt më të mirë të këtyre shteteve përfshin shumë mbretëri Europjane të Mesjetës, poashtu edhe dinastitë e Perandorisë Kineze. E vërteta do të ketë kohë të vështir duke barazuar fenë dhe moralin. Pa mos u thelluar në dallimin midis moralit kundër fesë, ne do të themi që organizata e shteteve dhe autoritetet e qeverisjeve pushuan mbi besimet e tanishme, zakonet, principet institucionale dhe normat shoqërore që janë në mesin e fesë dhe mund lirshëm të quhen moral. Në këtë mënyrë morali vazhdoi të luaj rol thelbësor në politikë.

Kohët e fundit, shfaqja e politikës moderne krejtësisht ndryshoi rolin e moralit. Nuk ka çast vendimtar të qartë ose tekst definues që shënon fillimin e politikës moderne. Megjithatë njëra nga veprat e para të politikës moderne ishte “Princi” i Nikolla Machiavelit. Heroi i këtij teksti, një dashamirës por princ despot, përdori metoda politike që ishin blafsemuese, pastaj u bënë të detyrueshme nga standardet prej të cilave veprat e tij ishin të kufizuara nga krijimi i autoritetit dhe ligjshmërisë së tij. Autoriteti i tij, ligjshmëria dhe pushteti i erdhi nga njerzit. Që prej kur njerzit gjykonin veprimet e princit duke përdorur standartet morale, morali bëhet mjet për të fituar miratimin e njerëzve dhe rritjen e pushtetit. Ky princ ndau moralin personal që Machiaveli gjeti dhe e përshkruajti si “republika të imagjinuara dhe principatat” nga nevojat politike, “arsyet e shteteve” që duhet të gjej republika të vërteta dhe principata. Morali nuk është më fundi i politikës, por thjeshtë është një nga shumë mjete politike.

Machiaveli nuk jetoi për të parë lindjen e demokracisë dhe rritjen e kapitalizmit. Duke ndjekur këto dhe të tjera evente, politika moderne u arrit. Për pak kohë, analizat politike dhe bisedimet ju përshtatën kryesisht termeve të konsideratës së ekonomisë, forcave shoqërore, dhe

të tjera të arsyeshme “arsyet e shtetit”. Morali tani merr “vendin e dytë” si i pranueshëm dhe gjerësisht përdoret si mjet politik. Ekonomia shoqërore shpesh argumenton dhe gjen ankesa me karakter dhe sulmon si sasi e plotë. Virtytet personale, siç është ndershmëria, bamirësia dhe drejtësia që ishin thelbësore për mbretin antik tash janë marrë dhe janë dhënë presidentit modern. Ashtu si presidenti modern dhe njerzit nënshkruan një “marrveshje të besueshme” të nënkuptuar që u bë shumë e qartë. Pastsaj, presidenti fatkeq u bë futbollli i politikës, u gjuajt me këmbë nga armiqtë e tij, ish-aleatët e tij, njerëzit dhe mediat, që supozohet pipëzimi i dyfishtë nga njerëzit për njerëzit. Më shumë shembuj të turpshëm si kjo politikë “loja e topave” përfshin skandalin watergate dhe arratisjen e Monica Levinsit.

Evucioni i moralit siç ne e përshkruajmë deri tani është përmbledhur në Figurën 1

Mbretëria antike	Teokracia feudale	Politika e hershme modern	Dita e sotshme
Morali individual si bazë e legjitimitetit të politikës dhe parakushtet për qeverisje të mirë. Mbretëritë materializojnë dhe e ilustrojnë me shembuj këtë moral.	Grupi moral i fesë si bazë e legjitimitetit të politikës. Mbretërit fetar udhëheqin me pëlqim të parajsës dhe ndjekin “urdhërin e parajsës” të arrijnë qeverisje të mirë.	Morali u propozua si mjet i politikës të fitojë miratimin e popullit. Miratimi i popullit si bazë e legjitimitetit të politikës. Veprimet e princave nuk janë të kufizuar prej moralit.	Morali është marrë për të dhënë dhe është detyësor në forcat ekonomike dhe shoqërore. Morali bëhet i përdorur gjerësisht dhe mjet pranues i politikës.

Figura 1 Vendi i evolucionit të moralit në politikë.

Ky moral, ku në të është forma përfundimtare, është detyësor në lidhje me forcat ekonomike dhe shoqërore, dështon në llogari në shumë debate të ditëve të sotshme.

MORALI SI NDARJE POLITIKE MODERNE

Vështirë duhet përsëritur atë që shumë thirrje politike janë të fokusuara në moral: aborti, hulumtimi biologjik, të drejtat e homoseksualve madje edhe reduktimin e taksave, kujdesi shëndetsor dhe punët e jashtme. Ndonjëherë morali është në qendër të këtyre debateve të hidhura, ndonjëherë ndryshon nga morali që kemi diskutuar deri tash. Së pari morali diskutohej si personal në alternativë mund ta quajmë këtë moral “tipare personale positive”. Në të kundërtën sot morali është në qendër të debateve politike në shoqëri. Ky moral shoqëror manifeston standardet shoqërore që kanë në konsiderat: aborti – sa shumë shoqëria duhet të vlersojë jetën? Në hulumtim biologjik – çfarë duhet të jenë kufizimet në përpjekjet shkencore? Në të drejtat e

homoseksualve – si duhet njerëzit të jetojnë dhe në çfarë shtrirje duhet të jenë të drejtat civile të njerëzve të vendosura në bazë të mënyrës që ata jetojnë? Në përkujdesjen shëndetsore – si duhet mallrat publike të shpërndahen? Në reduktimin e taksave – çfarë duhet shoqëria të shpërblejë dhe inkurajojë? Në punët e jashtme – si duhet shoqëria të përhapë besimet positive morale shoqërisë tjetër?

E dyta, diskutimi i moralit më parë ishte absolut. Pak a shumë pajtohen në çfarë tiparet personale janë positive. Përgjithsisht çdo çështje morale ka miratim të pakalueshëm ose dënim të pakalueshëm. Në krahasim, morali këtu është relativ. Në debatet e sotshme morale, njerëzit shumë nuk pajtohen çfarë duhet të jenë normat shoqërore madje edhe nëse ata mundohen me vrull në anën tjetër imponojnë normat e tyre shoqërore. Mosmarrveshje do të thotë që këndvështrimet në këto debate morale janë të organizuara sipas linjave politike, fraksioneve dhe demografikave. Në sistemin multipartiak, parti të ndryshme mund të mbikqyrin pozicione të ndryshme në këto debate. Ndërrime të vogla në këto pozicione mundësojnë të bëhen kompromise, dhe aleancat partiake të formojnë dhe shpërbëjnë sipas nevojave politike.

Në Amerikë sistemi dy partiak, disa pozicione të ndryshme reduktojnë në dy kampe kundërshtarë. Kompromiset s'janë të mundshme, dhe çdokush është i detyruar të zgjedh “ne ose ata”. Çështjet morale s'mund të jenë të vendosura për kënaqsinë e të gjithëve. Për paraqitjen e shkurtër të kësaj “ne ose ata” trajtojmë shiko: Tabelën 1 Fraza të paraqitura të ngarkuara nga bisedimet e politikës së sotshme.

Tabela 1 Fraza të zakonshme të para sot në debatet e mëdha morale

Aborti: pro – zgjedhjeve Të drejtat kushtetuese, kufizimi i ngurtë ideologjik, nuk mund të nxjerrë ligje nga besimi.	Aborti: pro – jeta Respekto jetën, vrasja e fetusit, viktimat të palindura, praktikë brutale, mirësevjen çdo fëmijë.
Hulumtimi biologjik: Për hulumtimin e qelizës. Kërkime etike të mundshme, respektoje jetën duke gjetur kurimin për smundje.	Hulumtimi biologjik: Kundër hulumtimit të qelizës. Nevojë e balansimit të etikës dhe shkencës, respektoje jetën duke mos e shkatërruar atë.
Të drejtat e homoseksualve: Për martesën e homoseksualve. Homoseksualizmi nuk është zgjidhje, diskriminimi nuk pranohet, përkrah të drejtat kushtetuese	Të drejtat e homoseksualve. Kundër martesave të homoseksualve. Shenjtëria e martesës, mbrojtja e martesës si institucion.
Kujdes shëndetsor: Për mbulim të zgjeruar, të përballueshëm, të arritshëm, mbulim për të	Kujdes shëndetsor: Kundër mbulimit të zgjeruar, qeverisjes së madhe dhe fiskale të

gjithë.	çmendur.
Taksat: Kundër fundit të reduktimit të lartë, reduktimi i të pasurve, përgjegjësia fiskale, klasa e mesme e shtypur.	Taksat: Për fundin e reduktimit të lartë, shtyrjen e ekonomisë përpara, nxitja e investimeve, taksat kushtojnë punët dhe nxjerrin para nga kuletat e njerëzve.
Mardhënie me jashtë: Pëllumbat punojnë me alienët, alternativat diplomatike, lufta si mjet i fundit, duke kaluar organeve të botës, besueshmëri dhe legjitimitet.	Mardhënie me jashtë: Skifterët shpërndajnë lirinë, detyrë për ti mbrojtur, duke marrë qëndrime të ashpra, të jetë i vendosur, të sfidojnë ideologjinë e kundërshtarve, duhet të qëndrojnë në sulm.

Në disa mënyra “ne ose ata” kemi qasje të misterhme. Njëri do ta pranonte atë për arsye të moralit shoqëror përkatës, mendimet e panumërta morale do të shpërndajnë sipas të famshmes “bell curve”. Me fjalë të tjera njëri do ta pranonte të gjejë shumicën e popullsisë të vendosur përgjatë një lloji të moralit modern. Sistemi dy partiak do të “japë fund” bell curvit në dy qëndrime politike morale të veçanta. Por si dy parti më të mëdha dallojnë qëndrimet e tyre delikate dhe të vogla. Të dy partitë e mëdha pritet të synojnë për qendrën e bell curve, dhe të luftojnë mbi një grup të vetëm politikisht ritmin e votuesve.

Tabela nr 1 shfaq realitetin e kundërt. Nuk duket të jetë një pozicion i moralshëm mesatar, dy partitë e mëdha mbikëqyrin larg pozicionet dhe baza politike për këto pozicione duket të jenë dy statike dhe me kampe mirë të ngulitura. Nuk duket të jetë ritëm votuesish për çështje morale. Njëri është ose “ne ose ata”.

Çfarë është përgjegjëse për këtë ndarje të madhe morale ky qëndrim i pakompromis? Njëri mund të joshet për të fajtuar “mediat e këqija”. Por kush mund të fajsojë mediat për ekzagjerimin e dallimeve ku aty ka dallime të mëdha që presin të ekzagjerohen. Kush mund të fajsojë mediat, konfrontimet sezacionale, nëse aty ka konfrontime që presin të senzacionalizohen? Mediat nuk mund të krijojnë ndarje morale nëse njëra nuk egziston. Mediat mund vetëm ta lavdrojnë atë. Kështu mediat nuk mund të llogarisin vetëm për këtë ndarje morale.

Ndoshta kjo ndarje morale zbulon kufizimet e modelit bell curve për ështëjet morale. Dy partitë e mëdha nuk do të marrin qëndrimin e njeri tjetrit nëse aty nuk ka avantazhe politike në bërjen e saj. Ndoshta bell curve modeli prishet për çështje morale, dhe shumica e popullsisë koncentrohet në këto dy qëndrime. Ndoshta curve vazhdimisht afron një shpërndarje dhe bëhet “e rrafshët” me koncentrimin politik aktiv përreth bell curve modeli mban, por shumica e

popullatës aktive koncentrohet rreth pozicioneve larg njëri tjetrit. Ose ndoshta bell pozicionit të dy partive. Çështja e dinamikës së shpërndarjes këtu duhet definitivisht të shqyrtohet detajisht.

Ka një tjetër model që shpjegon pse çështjet morale janë shumë konfrontuese, gjithashtu pse morali mbizotërues qëndron larg njëri tjetrit. Ky model i propozuar nga George Lakoff në librin e tij Politika Morale, si mendojnë Liberalët dhe Konservatorët interpreton konfrontimet në politikën morale si konflikt i botëvështrimeve, Lakoff argumenton se dy idealizime të familjes shpien kah dy idealizime të ndryshme të kombit si një familje. Si pasojë, dy interpretime të ndryshme të prindërve roli i tyre si udhëheqës i familjes shpie tek dy pritje të ndryshme nga roli i qeverisjes si udhëheqës të kombit. Lakoff i quan këto dy mbizotrues, dhe ideale të ndryshme të familjes “Modeli i babit strikt” dhe “Modeli i pridërit ushqyes” respektivisht korrespondon tek Konservativët dhe Liberalët pikpamjet mbi çështjet morale. Në sistemin dy partiak partitë më të mëdha natyrisht janë lidhur me qëndrimet e tyre dominuese në mënyrë që të mbizotrojnë politikën bazë që korrespondon me çdo model. Në dukje me papajtueshmërinë e dy modeleve të llogarive për natyrën konfrontuese të debateve për moral.

Modeli i familjes shpjegon shumë mirë dinamikën e debateve të sotshme morale. Megjithatë, modeli i familjes, vetvetiu, nuk shpjegon pse janë aq shumë çështje të përshtatura në mënyrë morale, p.sh pse njerzit zgjedhin të shohin kombin si një familje. Pse moraliteti?

MORALI SI NJË TJETËR “ARSYE E SHTETIT”

Ne mund të arrimë përgjigjen duke shqyrtuar suksesin e modelit të familjes duke analizuar debatet morale. Lidhja në mes familjes dhe moralit është e ngjajshme me atë të politikës dhe moralit. Ne cilësuam dy arsye kryesore deri tek sukcesi i modelit të familjes. Së pari, familja është mekanizëm kryesor midis së cilës virtytet morale janë krijuar dhe rinovuar. Edhe pse ne mund të argumentojmë se familja përfshinë moralin ose e kundërta, eksperiencia e madhe e familjes tregon një njësi matëse të madhe kundër së cilës gjithë çështjet morale janë matur. Ngjajshëm, morali është përcaktues i një veprimi. Edhe pse ne mund të argumentojmë nëse morali është përcatues kryesor, morali kryesisht konsiderohet krijues i botkuptimit midis së cilës gjithë eksperiencat politike vlerësohen duke përdorur moralin si njësi matëse. Në këtë mënyrë shihet morali se bashkohet me të dhënat ekonomike, forcat shoqërore, dhe konsiderata të tilla të tjera si “arsye e shtetit”.

Së dyti eksperiencia familjare është diçka të cilës çdokush mund ti ndërlihet. Modeli i familjes redukton dinamikat komplekse të ndonjëhershme të çështjeve morale poshtë diçkaje të menjëhershme dhe të njohshme. Ngjajshëm, morali është diçka ndaj të cilit çdokush mund ti ndërlihet. Morali siguron kornizë familjare dhe konkrete, që lejon të gjithë argumentet politike dhe konceptet për tu kapur dhe kuptuar. Në të kundërtën të dhënat ekonomike dhe forcat shoqërore kërkojnë një specialist të analizojë dhe kuptojë. Edhe atëherë specialistët janë të detyruar të bëjnë supozime dhe thjeshtëzime në analizat e tyre. Argumentet politike të bëra midis këtyre analizave janë hapur për të sulmuar, ri - interpretimin dhe keqinterpretimin. Në kohën e shkuar, personat mesatar mund të përcaktojnë vlershmërinë dhe korrektsinë e argumenteve të tilla. Pas asaj afërsia e verifikueshme nga kësioj argumentesh i bëri ata mbizotërues “Arsye e shtetit”. Ndërkohë të dhënat ekonomike bënë më të gjëra dhe forcat shoqërore u bënë më komplekse, shfaqen argument të tilla të pakalueshme, të ndërlikuara dhe abstrakte për persona mesatar. Këto argumente ende mbajnë ashpërsinë e tyre, por tash është pothuajse e pamundur për personat mesatar dhe madje politikanët profesional vlerësojnë argumente kufizuese. Disa mund të shpëtojnë një breshëri të qëndrueshme të të dhënave ekonomike ose lloj përmes një liste të dendur të forcave shoqërore. Kështu argumentet morale, prekshëmria dhe kuptimshmëria lejojnë që morali ta zavendësojë ekonominë shoqërore si mbizotëruese e sotme “arsyeja e shtetit”.

Edhe pse çdokush mund të kuptoj moralin dhe kanë të bëjnë me moralin, morali fut disa probleme, si dominues “arsyeja e shtetit”. Së pari, sepse argumentet morale janë të lehta për ti kuptuar, jashtë orarit, frazat që shprehin ideja morale u identifikua si ideja të vjetra morale. Si pasojë, natyra konfrontuese e bisedimeve të moralit do të bëhen ide morale të brendshme.

Idetë morale konfrontuese thelbësore ftuan në bisedime senzacionale që zmadhon konfrontimin dhe si pasojë, çështjet morale asnjëherë nuk do të zgjidhen. Në të kundërtën argumentet ekonomike shoqërore ofrojnë shumë hapsirë për të gjetur rrugën e mesme, madje për qëndrim gjersisht të ndryshëm. Kompleksi, dhe pak a shumë natyra objektive e të dhënave empirike hapin argumente ekonomiko-shoqërore të interpretimeve të ndryshme.

Përveç kësaj, çdokush mund të lidhet me argumente morale, demagogët shumë lehtë mund ta abuzojnë argumentet morale dhe ambicjet e mëtejme personale me një kosto publike. Këto demagogë moral shpesh nxitin mbështetjen publike për ekstremet ideologjike. Gjatë gjithë historisë, siç janë figurat e Joseph McCarthy duket që çdo herë gëzojnë një lulzim të shkurtër nga mbështetja publike para se të jenë përjetsisht të mallkuar për qëndrimin e tyre ekstremiste. Këto

demagog morali/idologjik janë veçanërisht të rrezikshëm sepse përderisa çdokush mund të lidh argumentet e tyre, askush nuk mund në mënyrë efektive të kundërshtojë kërkesat e tyre në kulmin e popullaritetit të tyre. Argumenti moral është në rregull nëse njëri beson se është në rregull. Në krahasim, kompleksi dhe natyra empirike e argumenteve ekonomike shoqërore ofron shumë mundësi: për interpretime të ndryshme dhe kundër argumente.

Këto mangësi të menjanshme, morali dominon politikën, ose së fundmi morali dominon bisedimet politike që ka shumë aspekte positive.

MORALI SI FORCË UNIFIKUESE

Deri tani, ne kemi parë se si dy modele familjare në dukje të papajtueshme që çojnë në konfrontim të bisedimit moral. Ende, arsyeja pas së cilës konfrontohet politika morale poashtu do të bëjë moralin forcë potenciale bashkuese.

Fillimisht modeli i dy familjeve qarkon njëjtë si parimet morale të vendosura edhe pasi ata të caktojnë prioritete të ndryshme për çdo parim. Lackoff e pranoi atë, dhe tregoi se si këto dallime delikate në çdo prioritet parimet çojnë drejt ndryshimeve të mëdha në këtë efekt të llogarive për frazat morale konfrontuese.

Sidoqoftë këto fraza morale konfrontuese janë thjeshtë një konfrontim bisedash, më tepër se sa një konfrontim i principeve morale. Kjo do të kërkojë nga dy modelet familjare përfshirjen reciproke të grupeve ekskluzive të principeve morale. Ky nuk është rasti. Kështu dy qëndrimet e mëdha morale janë ndarë nga njëri tjetri dhe janë pa bazë të përbashkët. Baza e përbashkët do të thotë zgjidhje pa kompromis. Ne gjejmë provë nga kjo bazë e përbashkët nga frazat e paraqitura në Tabelën nr 1. Për shembull të dyja anët rjedhëse të qelizave të debatit hulumtues pajtohen në nevojën për balansimin etikë dhe shkencorë dhe të dyja anët respektojnë jetën.

Poashtu kolona e majtë përdor “përgjegjësinë fiskale” për të argumentuar kundër shkurtimit të taksave të larta, një argument i tillë fiskal paraqitet në kolonën e djathtë, argumentojnë kundër mbulimit të zgjeruar shëndetsor. Shumë është delikat kampi i abortit për jetën, zbulon një ndjenjë respekti për çdo individ duke argumentuar atë se çdo fëmijë duhet të jetë i mirëpritur. Kuptim i njëjtë i respektimit të individit është përdorur për kampin e martesave të homoseksualve. Këtu diskutimi i terrenit të përbashkët nuk është menjëherë i dukshëm nga bisedimet e sotshme morale. Vetëm përpjekjet sistematike dhe të koncentruara mund të shkojnë përtej konfrontimeve ligjore për të zbuluar parimet e përbashkëta morale.

Duke përdorur këto parime morale për të kaluar hendekun moral, kërkon përpjekje sistematike dhe të koncentruar. Sepse disa fraza morale janë identifikuar me qëndrime të moralit të caktuar, propozim i cili izolon gjysmën e popullatës që kërkon pak më shumë kthesa të shkathta palidhje që i apelojnë të gjithë. Një politikan i shkathtë mund të thotë dhe të japë apel konservator propozimit liberal nga inkuadrimi i propozimit liberal në “diskutim konservator”. Kuptohet që argumentet morale të cilat më parë lejonin përçarje idejave morale tash do të lejojnë bisedimet morale unifikuese të bëhen ide morale unifikuese. Prekshëmria univerzale e argumenteve të moralit, të cilat më parë lejuan demagogët të abuzonin argumentet morale për mbështetjen popullore, tash do të mundësojnë liderët politik të hartojnë mbështetjen popullore pas rezolutës unifikuese të moralit.

Deri më sot, tashmë ka pasur shumë përpjekje të kalojnë ndarjen morale në nivel ligjërues. Por këto përpjekje pothuajse gjithmoë kanë dështuar. Në librin e tij, Lackoff jep shembuj të këtyre përpjekje të dështuara dhe atributon dështimin e tyre në keqkuptimin e synuar të gjuhës së audiencës morale. Ne nuk duhet të jemi dekurajues nga dështimet e tilla. Ato tregojnë vetëm vështirësitë por jo edhe mundësinë e ndërtimit të kësaj ure biseduese të moralit. Për të kaluar këto vështirësi, intelektualët duhet që sistematikisht të analizojnë bisedimet morale egzistuese, të identifikojë dhe kuptojë të dyja “bisedë liberale” dhe “bisedë konservative” dhe të krijojnë fraza të reja morali dhe më pak konfrontuese, pas të gjitha frazave morale ekzistuese pak a shumë bartin konotacion konfrontues. Veç kësaj, ne kemi nevojë për vetmohues, ambiciozë, politikan të guximshëm për të bërë një përpjekje të vazhdueshme për të provuar dicka të re dhe strategjitë e paprovuara të bisedimeve morale. Pavarësisht se duan politikan të këtillë, dhe pavarësisht vështirësive që përballen intelektualët, kjo urë lidhëse e moralit duhet të ndërtohet, për këtë duket të ketë zgjidhje të mirë ose të lehtë. Po të mos ishin disa filozofë të shquar, që në fakt zgjodhën dallimet fundamentale të moralit, në vend të anashkalimit të tyre duke unifikuar bisedimet e moralit, intelektualët dhe politikanët që tërheqin nga kjo vështirësi dhe me të vërtetë bëjnë përpjekje të guximshme do të mbahet mend si asgjë më shumë se një hero politikan që mbylli ndarjen e moralit.

MORALI SI NJË FORCË DEMOKRATIKE

Njeriu mund të pyesë pse ne duhet të mbyllim përfundimisht ndarjen morale. Pas gjithçkaje, një trup politikan, veçanrisht një demokratik, funksionon siç duhet vetëm nëse aty ka konflikt të shëndoshë nga mendimet. Ne nuk argumentojmë kundër konfliktit shëndetsor por

kundër konflikteve të shumëta. Debatet morale të sotshme krijojnë shumë konflikte, që është jashtzakonisht e vështirë të krijojn zgjidhje për zbatimin e politikës së qëndrueshme për shumë çështje urgjente morale. Kjo pengon efektivitetin e qeverisë. Në qoftë se ne mbyllim ndarjen e moralit, mekanizmi demokratik siguron që uniteti i elektoratit që rezulton me qeveri të unifikuar dhe efektive. Madje edhe nëse ne nuk mund të mbyllim ndarjen e moralit dhe vetëm mund të parandalojmë nga destabilizimi i shoqërisë, morali dominon politikën megjithatë ofron shans më të madh të qeverisë efektive se politika e dominuar shoqërore ekonomike.

Politika e dominuar shoqërore ekonomike merret kryesisht me të dhënat ekonomike empirike dhe forcat shoqërore që vazhdimisht ndryshojnë dhe evoluojnë. Nëse kushtet shoqërore ekonomike luhaten shpejt, një qeveri e zgjedhur për ekonominë shoqërore mund të rrëzohet me të njëjtën ekonomi shoqërore. Qeveria e re mund të ndryshojë ose të paktën të kthejë efektet e politikës nga qeveria e rrëzuar. Politika e qeverisë së tillë luhetet me kushtet ekonomiko shoqërore. Megjithatë, problemet afatgjate ekonomiko shoqërore kërkojnë qëndrueshmëri, zgjedhjen e politikave afatgjate. Zgjedhje të tilla kurrë nuk mund të materializohen nëse qeveria e suksesshme miraton atë dhe neutralizon njëri tjetrin.

Në krahasim, morali dominon politikën dhe merret me normat e sjelljeve shoqërore dhe principet morale që janë pak a shumë të pandryshueshme. Ajo qëndron për arsye se normat e sjelljes shoqërore dhe principet morale janë të pandryshueshme se sa të luhatshme, popullartitei i pozicionit moral ndryshon shumë ngadalë sesa ajo e politikës ekonomiko shoqërore. Si pasojë, disa qeveri të njëpasnjëshme mund të zgjidhen dhe rizgjidhen në qëndrime të njëjta morale. Kjo do të mundësojë përpjekje të vazhdueshme politike për të zgjidhur kushtet e problemeve të gjata madje problemet e përshtatura shoqërore ekonomike në kontekst moral. Suksesi i dukshëm i qeverisë në zgjidhjen e problemeve afatgjate për një rinovim të institucioneve qeverisëse dhe proceseve demokratike. Ky vullnet në kthim shpie në rritje të participimit politik. Të dyja participimi dhe besimi janë kryesore për qeverinë demokratike që prezanton njerëzit dhe rrjedh nga legjitimiteti i elektoratit.

Sigurisht, qeveria e paaftë mund të keqësojë problemet në vend që ti zgjedhi ato. Rritja e mundësisë së zgjidhjeve të qëndrueshme politike përkthehet në rritje të mundësisë se zgjidhjeve te gabimeve të politikave. Poashtu politikat e qëndrueshme që favorizon përfitimin e grupit të caktuar do të marginalizojë gjithnjë grupet tjera. Ne besojmë mekanizmin demokratik që kryqzojnë politikisht çdo qeveri që bie nga testi i kompetencës. Ne mbështetemi në ndryshimet e

ngadalshme por megjithatë, të ndryshosh dinamikën e politikës morale do të dënojë qeveritë që tepër marginalizojnë grupet.

Madje nëse “qeveria morale” nuk arrin të jetë efektive, politika e përqëndruar në moral megjithatë do të çoj në rritjen dhe pjesmarrje më të balancuar politike. Çdokush kupton moralin, çdokush mund të tregojë për moralin, çdokush ka pikpamje morale. Prandaj çdokush ka një “shtyllë” të qartë të çështjeve të moralit, dhe aty ka një shtyes për çdokënd të marri pjesë, madje edhe votuesit me edukim të ulët dhe të ardhura të larta kanë më shumë të ngjarë të participojnë. Vetëm të pasurit dhe të edukuarit kuptojnë konceptet abstrakte ekonomiko shoqërore; vetëm ata mund të lidhen me të dhënat e largëta ekonomiko shoqërore; vetëm pasioni politik kalon paprekshmërinë e zhvillimit të të dhënave ekonomiko shoqërore. Ai që dështon të kuptoj bisedimet mbizotëruese politike nuk ka gjasa të participojnë në procese politike. Edhe nëse ai participon, ai ka problem me artikullimin e pikëpamjeve të tij në bisedimet mbizotëruese politike. Morali i jep individin publikut dhe mundëson votuesin të kuptojë politikën dhe të artikulohet në arenën politike.

Të dhënat historike mbështesin argumentin tonë. Figura nr 2 tregon pjesëmarrjen e votuesve në zgjedhjet presidenciale prej vitit 1924. Ne identifikojmë zgjedhjet e viteve 1940,1952, 1960, 1964, 1968 dhe 2004 si zgjedhje me pjesëmarrje veçanërisht të larta.

Në vitin 1940 dhe 1952, respektivisht elektorati u përballë me rritjen e Gjermanisë Naziste dhe Unioni Sovjetik Socialit i Republikës. “Liria kundër Tiranisë” retorika e mbushur me bisedime politike dhe shqetsimet ideologjike aktivizojnë elektoratin. Në vitin 1960 dhe 1964, çështjet dominojnë zgjedhjet duke përfshirë të drejtat njerëzore dhe barazinë racore. Këto çështje morali, përshtasin kushtet për analiza kushtetuese dhe shoqërore, sigurojnë bazën për aktivizimin politik. Në vitin 1968, President Nixoni paraqiti një qasje raciale/morale më delikate. Temat “Ligji dhe urdhëri” u kapitalizuan”. Në vitin 2004 mobilizimi dhe regjistrimi i votuesve çoi elektoratin masiv dhe të shtrenjtë të rezultojë në pjesmarrje më të lartë të votuesve në vitet e tridhjet e gjashta. Përsëri, çështjet morale siguruan lidhjen për këto përpjekje për tu mbledhur. Kështu nëse pjesmarrja në votime në zgjedhjet presidenciale ofron një tregues të mirë për pjesmarrjen në politikë, atëherë të dhënat historike sugjerojnë së paku një korrelacion në mes pjesmarrësve të lartë politik dhe politikës dominuese nga çështjet morale.

Shkurtimisht, morali dominon politikën dhe e çon në rritjen dhe participimin universal, poashtu si qeverisje efektive që mund të zgjedhë probleme të mëdha.

KONKLuzion

Në përmbledhëm përgjigjet e katër pyetjeve të paraqitura në hyrje. Morali nuk është element i ri politik, megjithëse kupitmi i moralit evoluoi prej moralit personal absolut në moral relativ shoqëror. Frazat morale që dominuan bisedimet politike në kohët e fundit korrespondojnë me kampet kryesore politike, mbajnë konotacione konfrontuese që e kanë origjinën nga dy modele të papajtueshme familjare të cilat posedojnë një thjeshtësi që lejon konfrontimet në bisedimet morale, të bëhen të ngulitura si konfrontim në idetë e moralit. Morali mund të dominojë diskutimet në shumë çështje sepse cdokush mund të kuptojë dhe tregojë argumentet morale, ndërsa vetëm specialistët mund të deshifrojnë dhe verifikojnë argumentet komplekse ekonomiko shoqërore. Si mbizotrues “arsyeja e shtetit” morali paraqet një ndarje të gjerë morale që pengon efektivitetin e qeverisë, si dhe thirrja e demagogëve për debtet e abuzimit moral të ndihmojnë ambiciet e tyre politike. Në anën tjetër, parimet e përbashkëta themelore morale ofrojnë mundësi për bisedimet morale që të mbyllin hendekun moral. Veç kësaj, morali dominoj politikën që çoi në qeveri efektive që mund të zgjidh problem të madh, si dhe rritjen politike të balansuar të pjesmarrësve.

Analiza jonë duhet të interpretohet me kujdes. Në bisedat tona ne pa dyshim kufizuan modelin tonë demokratik; një qeveri ideale ofron zgjidhje të politikave për të trajtuar një numër problemesh; një elektorat ideal merr pjesë në mënyrë aktive në politikë. Dikush mund ta përshkruaj një model më egalitar të demokracisë që fokusohet më pak në participimin e votuesve, duke marrë më shumë pamje mosndërhyrëse që kufizojnë rolin e qeverisë që vetëm të sigurojnë integritetin e tregut të lirë. Plotësisht kanë të bëjnë me këto kundërshtime që kërkojnë debate në shkencat politike dhe teorinë demokratike më mirë se sa vetëm politika morale.

Gjithashtu ne trajtojmë moralin që dominon politikën si një zëvendësim i ekonomisë sociale. Një pamje më e zbutur do të trajtojë moralin jo si një zëvendësim, por si një plotësim. Ekonomit sociale mbeten të vlefshme dhe mjete me të vërtetë thelbësore politike.

Ato janë të bashkuar tani nga morali, një tjetër “arsye e shtetit” që mund të ndajë shoqërinë dhe pengojë efektin e qeverisjes, por në të njëjtën kohë një tjetër vegël politike që mund të sjellin një shoqëri më të drejtë me anë të një demokracie të unifikuar.

Referenca:

1. Bush, George W. and Kerry, John F. Presidential Debates 2004. Commission on Presidential Debates, 2004. Retrieved 9 Jan 2005.
2. Center for Voting and Democracy. Presidential Election Voter Turnout 1924-2000. Retrieved 15 Jan 2004.
3. CNN All Politics. "A Chronology: Key Moments in the Clinton-Lewinski Saga." CNN 1998. Retrieved 13 Jan 2005.
4. Connolly, Judy et al. "The Way You See It, From Coast to Coast." Opinion Articles to USA Today 1/2/2005. Retrieved 3 Jan 2005.
5. Fallows, James. *Breaking the News: How the Media Undermine American Democracy*. New York: Pantheon Books, 1996.
6. Federal Election Commission. *National Voter Turnout in Federal Elections: 1960-1996*. Retrieved 15 Jan 2005.
7. Hudson, William E. *American Democracy in Peril: Eight Challenges to America's Future*. Washington D.C.: CQ Press, 2005.
8. Kellman, Laurie. "Voter Turnout Highest Since 1968." News Article to Associated Press 1/15/2005. Retrieved 15 Jan 2005.
9. Lakoff, George. *Moral Politics: How Liberals and Conservatives Think*. Chicago: University of Chicago Press, 2002.
10. Machiavelli, Nicollo. *The Prince*. New York: Bantam Dell, 2003
11. Office of History Education. *History of Ancient China*. Beijing: People's Education Press, 1989.
12. Plato. *The Republic*. Trans. Tom Griffith. New York: Cambridge University Press, 2000.
13. U.S. Senate. *Censure of Senator Joseph McCarthy*. 83rd Congress, 2nd Session, Senate Resolution 301, Washington D.C. 1954. Retrieved 13 Jan 2005.
14. Wald, Kenneth D. et al. "Morality Politics vs. Political Economy: The Case of School-Based Health Centers". *Social Science Quarterly*. 82.2 June 2001: 221-234. Retrieved 2 Jan 2005.
15. *Watergate: The Scandal That Brought Down Richard Nixon*. Retrieved 13 Jan 2005.

FILOZOFIA E POLITIKËS OSMANE NDAJ LËVIZJES KOMBËTARE SHQIPTARE

Dr.Marela GUGA

Universiteti "A. Xhuvani" Elbasan, Shqipëri

Marela.guga@yahoo.com

ABSTRAKT

Politika e Perandorisë osmane u mbështet në otomanizimin dhe islamizimin e popujve nën Perandorinë, mohimin e identitetit të tyre. Edhe shqiptarët, si pjesë e kësaj Perandorie, iu nënshtruan politikës panislamiste. Dy ishin rrugët që Perandoria ndoqi në këtë drejtim, *rruga kulturore dhe filologjike*, e cila ishte një rrugë paqësore dhe *rruga ushtarake* e nënshtrimit, e cila parashikonte luftë ndaj popullit shqiptar. Ndërsa instrumentet që u përdorën në funksion të politikës së tyre ishin, institucionet fetare, shkollat dhe ndarja krahinore dhe fetare. Por, kjo politikë, shkonte në kah të kundërt me programin e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Sa më shumë forcohej dhe rritej ideologjia e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, aq më shumë rritej presioni mbi aktivistët e kësaj lëvizje. Ky punim kërkon të hedhë dritë mbi filozofinë e politikës osmane të ndjekur nga Perandoria osmane ndaj popujve nën këtë Perandori. Ajo mbështetej mbi parimin e unitetit turko-myslimano-osman, në mjetet dhe metodat të cilat pengonin krijimin e një fronti unik të shqiptarëve. Politika panislamike e qeverisë turke u përkrah edhe nga politika panheleniste e Mbretërisë greke dhe përballë tyre janë përpjekjet dhe lufta e ideologëve të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Ideja e hedhur nga Pashko Vasa mbi kombëtarizimin përshkoi tërë jetën politike dhe kulturore të periudhës së Rilindjes. Shqiptaria u bë substancë bashkuese, forca që bashkoi shpirtërisht dhe mendërisht shqiptarët në luftë për çlirimin kombëtar.

Fjalë kyçe: *Lëvizje Kombëtare, panislamiste, panheleniste, ideologji.*

HYRJE

Pushtimi osman në Shqipëri u shoqërua me *islamizimin* e popullsisë shqiptare, më pas u ndoq një politikë panislamiste. Brenda një kohe të shkurtër, rreth 3/4 e shqiptarëve, konvertuan fenë e tyre me fenë islame, duke patur të njëjtën fe me sundimtarin. Defteri i vitit 1566 shënon në qytetin e Beratit 395 shtëpi të krishtere dhe asnjë myslimane, ndërsa në vitin 1583 kemi të regjistruar bashkësinë e parë myslimane. Në shek. XVII proçesi i islamizimit përparon. Ritmet e

islamizimit të qyteteve të Shqipërisë ishin më të shpejta se në qytetet e Ballkanit (Thengjilli:102-103). *Osmanizmi* mbeti parimi bazë i pushtetit dhe politikës teokratike të Abdyl Hamitit. Në thelb të kësaj politike qëndronte mbështetja që Perandoria duhej t'u jepte të gjithë shtetasve myslimanë pa dallim kombësie dhe jo të gjithë komunitetit etnik. Kjo politikë u ligjërua në kushtetutën e vitit 1877 në nenin tetë të së cilës shkruhej: " Të gjithë individët e Perandorisë, pa dallim të çfardo feje apo sektit që të jenë, quhen otomanë".

Doktrina e otomanizimit, panislamizmit u mendua të vihej në jetë nëpërmjet kombinimit të *rrugës kulturore e filologjike* një rrugë paqësore , e cila synonte otomanizimin e popullsisë myslimane dhe rrugës *ushtarake*, që do të thoshte nënshtrim me dhunë të popujve që nuk i bindeshin politikës së Perandorisë. Por kjo rrugë, rezultonte me kosto për një perandori në krizë. Otomanizimi dhe islamizimi ishin dy ideologji të pandara nga njëra tjetra, në të cilën profesori i universitetit Boylor-it G. Gawrych përfshinte edhe shqiptarizmin. "... ishte e pamundur të hiqje vija ndarëse mes otomanizmit, shqiptarizmit dhe islamizmit, duke argumentuar se shqiptarët shiheshin si vëllezër me myslimanët, por ishin dhe ushtarët më besnikë, tek të cilët mund të mbështetej në çdo situatë Perandoria. (Gawrych:311) Ata u kthyhen në shtylla mbështetëse për ruajtjen e sundimit otoman në Ballkan, ndaj u ndoqën politika të veçanta dhe më të moderuara ndaj tyre.

Si hap drejt otomanizmit, Perandoria u përpoq t'u mohonte identitetin popujve joturkë, si të tillë, të zhdukte ndryshimet mes turqve, shqiptarëve, bullgarëve, grekëve, armenëve etj. Të gjithë duhet të beheshin shtetas të bindur të Perandorisë dhe elementi që do të sundonte do të ishin turqit dhe myslimanët. Kjo sipas saj, do të ishte mënyra që të mund të siguronte bashkimin dhe harmoninë e popujve në Perandori, ruajtjen e unitetit dhe tërësisë së saj. "...ideja e osmanizimit, turqizimit dhe e përkatësisë perandorake, vërtet nuk kishte përparuar, por edhe ajo e bashkimit kombëtar shqiptar kishte mbetur prapa", sipas Eqerem bej Vlorës, i cili arsyet i gjen te politika përndjekëse e Turqve të Rinj ndaj çdo aksioni kombëtar. Më tej E. Vlora vazhdon: "Politikisht ne, shqiptarët ishim shumë më të pjekur dhe më largpamës se ata. Ne e dinim se idetë e bashkimit teokratiko-monarkik të Perandorisë osmane, nuk ishin më të realizueshme, sepse në Gadishullin e Ballkanit, trashëgimia osmane ishte hedhur në erë prej kohësh nga krijimi i shteteve të lira nacionaliste " (Vlora:236), edhe pse synimet e Turqve të Rinj, ishin të ruanin me çdo mjet sundimin e tyre mbi shqiptarët dhe popujt nën Perandorinë, qoftë edhe duke nxitur

urrejtjen e shqiptarëve ndaj vendeve fqinje, e për të siguruar një bashkëpunim sa më të ngushtë me ta.

Për Perandorinë otomanizmi ishte një politikë që i shkonte më shumë përshtat politikës së Abdyl Hamitit se islamizmi, sepse përfshinte brenda tij konceptet e shqiptarizmit dhe turqizimit. Jo në pak raste u bënë përpjekje për të unifikuar termin "shqiptar" me atë "mysliman". Në filozofinë ideologjike turke, termi « osmanli » i identifikonte të gjithë. "As neve të na thonë turk e manof, e as shqiptarëve t'u thonë shqiptar, por të gjithë bashkë të quhemi Osmanli!-shkruhej në gazetën "Shkopi" të vitit 1908. Dhe më pas shkrimi citon presionin që ushtrohej ndaj shqiptarëve. "...Thuaj me gojë që je shqipëtar, po nënshkrimin vëre që je turk. Nëse je osmanli mëso gjuhën e turkut e që të rrosh, bëj be që do të mbrosh me gjakun tënd osmanllinjte e jo një tjetër komb." (Vruho, 1908:3) Gjithsesi shqiptarët mbetën një entitet shqiptar, duke hedhur poshte idenë që feja përbën identitetin.

Në fillim shqiptarët nuk shihnin ndonjë kontraditë mes identitetit të tyre politik otoman dhe entitetit shqiptar. Por më pas ata shfrytëzuan me shumë elegancë krizën politike që po kalonte Turqia për të rritur ndikimin e vet në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare. Sami Frashëri një patriot shqiptar, por që njihej dhe si reformator otoman, i cili mbartte shtresa të shumëfishta identiteti dhe besnikërie, ruajti me shumë kujdes dhe të pacënuar lidhjet etnike, krahinore dhe fetare. Ai nuk e pranoi despotizmin e sulltanit, sepse demokracia dhe liria ishin idealet e tij. Botimi i traktatit politik "Shqipëria ç'ka qënë, ç'është dhe çdo të bëhetë" ishte në të njëjtat shina me platformën politike të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Kjo u pa me shqetësim nga sulltan Abdyl Hamiti, i cili u kthye përfundimisht kundër shqiptarëve. Ai mbylli dy shkollat shqipe në Korçë, klubet kulturore në Berat, Korçë, Elbasan, Kolonjë e Manastir, u ndalua botimi i librave në gjuhën shqipe, u burgosën mjaft baballarë bektashinj, që ishin pjesa më atdhetare shqiptare. (Gawrych:199)

Përdorimi i gjuhës shqipe në shkolla ishte një prej kërkesave të ideologëve shqiptarë. Arsimi në gjuhën shqip do të kontribuonte në rritjen e nivelit kulturor të popullit, zgjimin e ndërgjegjes kombëtare shqiptare, ndaj patriotët shqiptarë si masë të parë, menduan të zëvendësonin shkronjat arabo-turke me shkronjat latine. Luftën ndaj shkronjave shqipe, E. Vlora e quante marrëzi dhe të pakuptimtë. "... Për fat të keq, xhonturqit sulmuan ashpër nacionalizmën shqiptare. Ata filluan sistematikisht të ndjekin lëvizjen tonë kombëtare, duke mbyllur shkollat shqipe dhe klubet "Bashkimi", me qëllim që të mbytnin nacionalizmin, para se të zhvillohej

ndërgjegjia kombëtare, në një kohë që popujtë e Ballkanit e kishin fituar këtë të drejtë. Edhe vetë Mustafa Qemali nuk donte të dëgjonte mbi përdorimin e shkronjave latine në gjuhën shqipe, vetëm e vetëm se e shihte, si mjet të prishjes së parimit unitar turko-myslimano-osman”. (Vlora: 246) Përdorimi i shkronjave latine, shihej si faktor bashkimi, shkëputje nga kultura lindore turko-islamike dhe një orientim drejt perëndimit. Ndaj dhe alfabeti latin u kundërshtua edhe nga ndjekësit e orientimit islamik në Shqipëri. Me inspirimin e disa drejtuesve të komunitetin mysliman dhe me ndihmën e partisë së Xhemijetit (Itihat ve Terekki) u organizuan antimitingje në qytetet më të mëdha të Shqipërisë për të kundërshtuar alfabetin e Stambollit. Por kjo lëvizje kulturore u mbështet nga intelektualë e gazetarë në Turqi. Njëri prej tyre ishte deputeti i partisë "Bashkim e Përparim" dhe gazetari i njohur turk Hysein Xhahiti. Në një shkrim në gazetën "Tanin", ai u dha të drejtë kërkesave të patriotëve shqiptarë për përdorimin e shkronjave latine në shkollat kombëtare. (Gawrych:276) Ai e shikonte otomanizmin si një zhvillim kulturor në të cilën dy ideologjitë duhet të ecnin paralel.

Në një realitet multietnik, për të siguruar bashkimin dhe harmoninë e popujve dhe një sundim të efekshëm, Porta e Lartë kërkoi të realizonte politikën panislamiste nëpërmjet disa instrumenteve që ishin:

a. *Institucionet fetare* të cilat shiheshin si një hallkë ndërmjetëse me shtetin dhe më pas lidhje të shqiptarëve me Perandorinë. Kërkesat për të futur gjuhën shqipe në predikimet fetare, qeveria otomane e kishte refuzuar vazhdimisht. Ajo mendonte se ekzistenca e institucioneve fetare islamike në gjuhën shqipe mund të minonte unitetin e myslimanëve nën flamurin e islamizimit (Gawrych:131)

b. *Institucionet arsimore*. Sistemi shkollor krijoi një infrastrukturë organizuese për propogandën panislamike. Të gjitha kombësitë e ndryshme jetonin së bashku si otomanë, të bashkuar nga gjuha turke si "gjuha e jetës publike", edhe pse vetëm një pjesë e vogël në Shqipëri e zotëronte plotësisht turqishten. Mungesa e shkollave në gjuhën shqipe dhe shkollimi i shqiptarëve në gjuhën turke e greke, ndikoi në ngadalësimin e formimit të ndërgjegjes kombëtare shqiptare.

c. U adaptua një politikë "*divide et impera*", që do të thotë "ndaji për të mbretëruar". Ndarja në vilajete ndikoi në ndarjen krahinore të shqiptarëve sepse, siç shprehet Vaso Pasha "u ndanë ata që duhej të ishin të bashkuar dhe u vunë së bashku elementë të ndarë, të cilët duke qënë të shtytur prej parimeve të ndryshme, kanë lëftuar njeri-tjetrin dhe mbaruan duke asjetërsuar njeri-tjetrin." (Pasha:117) Politika përçarëse që Perandoria ndoqi, shkonte në kah të kundërt me

shqiptarizmin e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, e cila duhej të përballlej jo vetëm me ideologjinë panislamike, por edhe politikën panheleniste të mbretërisë greke. Dallimet midis popullsisë së veriut dhe jugut u bënë më të dukshme duke penguar unitetin midis tyre."...Ndonëse toskët janë vellznit' e gegëvet dhe këta vellezërit e toskëve kanë qënë të ndarë të dy palët. Shkaku i kësaj çarje përsëri nuk' është gjë veç hyqmetit i cili gjith-një mbillte çarjen e ndarjen midis dy vëllazënve të cilët që të dy i thonë bukës bukë e ujit ujë, edhe me gjithë këtë duke kaptuar vite shumë, harruan njeri- tjetrin", shkruante publicisti i diasporës Jani Vruho në vitin 1911.(Vruho 1911:3)

Perandoria Osmane, në zbatimin e politikës së saj, nuk u mbështet dhe nuk respektoi trashëgiminë historike të popujve apo nevojat e tyre lokale. Shqiptarët nuk mundën të vendosnin një rend të ri juridik apo të ushtronin një pushtet jure propri, por baza juridike ishin dhe mbetën ligjet juridike të Perandorisë, mbështetur mbi bazën e normave juridike osmane duke nënvlerësuar parimet themelore që ngrihej e drejta në Shqipëri. Ligjet e përpiluara për popujtë joturkë, nuk u bazuan as në karakteret dhe zakonet e popujve e as mbi mundësitë dhe aftësinë e vendit, ndaj dhe shqiptarët iu kthyhen të drejtës zakonore shqiptare si nevojë mbijetese. Hartimi dhe aplikimi i ligjit mbi "bandat guerrile" ishte një nga masat më të ashpra, sepse dënonte me vdekje të gjithë që bënin pjesë në çetat patriotike. "Ç'armatosja, gjyqjet ushtarake ndaj shqiptarëve nacionalistë, çështja e alfabetit, shmangia e diskutimeve politike dhe veprimtaritë me karakter kulturor apo letrar, ishin arsytet e përkeqësimit të marrëdhënieve me Turqit e Rinj", shkruan Margaret Vickers. (Vickers:106)

FEJA PJESË E POLITIKËS OSMANE

Siç e thamë më lartë, Perandoria Osmane funksiononte si një shtet islamik, në të cilën dallimi midis popujve bëhej mbi bazën e fesë. Ideologjia zyrtare dhe gjuha e vendit shprehnin “unitetin e fesë islame dhe të shtetit otoman”, ku shteti dhe feja ishin shkrirë së bashku. Abdyl Hamiti mbeti mbështetës i ideologjisë së islamizmit dhe nuk pranoi t'u jepte shqiptarëve të drejtat e tyre kombëtare. Ai mendonte se lëshime të tilla do të gërryenin nga poshtë fenë islame. (Gawrych:214) Si doktrina otomaniste ashtu dhe islamiste mbështetej në parimin fetar, i cili u përdor si kriter në përcaktimin etnisë së popullsisë. "...Për Perandorinë nuk ka bullgarë, grekë, rumunë, çifutë apo myslimanë. Të gjithë jemi të barabartë, të gjithë krenohemi që jemi otomanë". (Gawrych: 234) Përpyekja për të barazuar kombin me fenë, duke e parë fenë si pjesë

të identitetit kombëtar, pengonte unitetin kombëtar. Edhe pse dallimi fetar në Shqipëri nuk ka qenë kurrë etnotipik, feja në këtë kohë u bë forca më përcarëse në Shqipëri. Qeveritarët e Stambollit zhvillorin një fushatë panislamike për të nxitur fanatizmin fetar ndër shqiptarët. Ata dërguan në Shqipëri misionarë klerikë nga Anadulli e nga vende të tjera lindore, (Histori e e Popullit Shqiptar,2002:104) të cilët u mbështetën nga elementët fetarë brenda shoqërisë shqiptare, kryesisht kleri mysliman shqiptar, si dhe një pjesë e parësisë me pozitë të privilegjuar në administratën shtetërore. Në të gjithë territorin e Shqipërisë u ndërtuan shkolla dhe xhami dhe nuk u lejua përdorimi i gjuhës shqipe në to. Gjatë gjysmës së dytë të shek. XIX u rrit numri i shkollave turke, por dhe greke. Shqiptarët ortodoksë edhe pse të gjithë i përkisnin një entiteti, sulltani i la nën ndikimin panhelenistë, ndërsa shqiptarët myslimanë i përfshiu në ideologjinë e panislamiste. Ideologjia panislamike lehtësohej nga politika helenizuese e Mbretërisë Greke dhe Patrikanës së Stambollit, e cila mbështeti helenizimin gradual në Perandorinë Osmane, duke synuar transformimin në një shtet greko-turk. (Dushku:44)

ROLI I PATRIKANËS DHE MBRETËRISË GREKE

Në Shqipëri administrimi i popullsisë realizohej sipas sistemit të milletit (të kombësisë), bazë klasifikuese e të cilit ishte feja. Myslimanët i përkisnin milletit me të njëjtin emër, ndërsa të krishterët ortodoksë i përkisnin milletit rum. Miletit rum përfshinte popullsi të krishterë ortodokse, të shpërndarë në territore të ndryshme të Perandorisë, dhe drejtohej nga Patrikana Ikumenike Ortodokse, e cila kishte një pozitë të rëndësishme në Perandori. Sulltani krahas funksioneve shpirtërore, i lejoi Patrikanës të luante një rol të rëndësishëm në administrimin e nënshtetasve të saj ortodoksë. (Dushku: 45) Ajo administronte si kishat, ashtu edhe shkollat e kësaj popullsie. Në dekretin sulltanor të vitit 1680 caktoheshin llojet e taksave që mitropolit Ignatios kishte të drejtë të mbledhte nën autoritetin e tij. Ai cilësohej në këtë dekret si autoriteti më i lartë. ” ...I sapo emëruari ka cilësinë e prijësit shpirtëror të atyre vendeve dhe ushtron të gjithë autoritetin që gëzonin edhe patrikët e mëparshëm, prandaj askush në ato vende nuk ka të drejtë t’i ndërhyjë atij në ushtrimin e detyrës së patrikut”, shkruhej në fermanin e Sulltanit drejtuar kadilerëve të Ohrit dhe Beratit. (Berati në dokumentat Arkivore Osmane:32) Patrikana shërbeu si mekanizëm homogjenizimi dhe asimilimi të kësaj pjese të popullsisë. Ajo shkishëroi apo bashkëpunoi në eliminimin fizik të personave shqiptarë me peshë në jetën kulturore dhe politike. Marrëdhëniet miqësore midis Mbretërisë greke dhe Perandorisë osmane, do t’i

shërbenin drejtuesve grekë të Patrikanës në zhvillimin dhe përhapjen e programit kulturor dhe arsimor dhe helenizimin e një numri të vogël të popujve jogrekë. (Kofos:17)Të dyja mbështetën njëra-tjetrën dhe bashkëvepruan, për t'u kundërvënë kërkesave të shqiptarëve për hapjen e shkollave shqipe në gjuhën amëtare dhe mosnjohjen e kombit shqiptar. Në të gjitha qytetet u hapën dhe shkolla greke. Popullsia që ndiqte besimin ortodoksë u arsimua në gjuhën greke, ndërsa popullsia myslimane në gjuhën turke. Në Shqipëri shkollat shtetërore turke formalisht quheshin laike, sepse në të vertetë pjesën më të madhe të programit e zinin lëndët fetare islamike.Madje qeveria vuri nën kontrollon përmbajtjen e tyre, gjuhën turke e vuri me detyrim, ndërsa gjuha shqipe vetëm në nivelet e ulta të shkollave.

Qeveria greke mbështeti financiarisht një pjesë të mësuesve të shkollave greke, duke mos hasur pengesa nga autoritetet osmane (Nikolaidhu:103). Qarqet greke mbështetën propaganduesit e "Idesë së Madhe" në Shqipëri dhe u përpoqën të shfrytëzonin një pjesë të parësisë së krishtere si dhe nevojën e madhe për arsim që kishte popullsia shqiptare, nevojë e cila, për mungesë shkollash në gjuhën shqipe, nuk kishte mundësi të plotësohej veçse në shkollat greke. Por ata mbështetën edhe propagandën, dhe luftën e Turqve të Rinj për një alfabet me shkronja arabe dhe jo latine. (Frashëri:8) Si konkluzion mund të themi se, vërtet mungesa e shkollave në gjuhën shqipe dhe shkollimi në gjuhën greke e turke ndikoi në, formimin e ngadaltë të ndërgjegjes kombëtare shqiptare dhe nxorri në pah vështirësitë që qëndronin në rrugën e unitetit të shqiptarëve, (Swire:55) por ato nuk mundën të pengonin zgjimin kombëtar të shqiptarëve, sepse gjuha shqipe mësohej klandestine.

LËVIZJA KOMBËTARE SHQIPTARE PËRBALLË PERANDORISË OSMANE

Gjatë shekullit të XIX lëvizjet nacionale sollën krijimin e shteteve kombëtare dhe ndryshimin e realitetit në Ballkan. Tanimë shtetet e reja dhe lëvizjet kombëtare të popujve ballkanikë në platformën e tyre kishin një shkollë dhe kishë kombëtare në gjuhën amë. Në këtë kuptim edhe Lëvizja Kombëtare Shqiptare nuk bëri përjashtim. Platforma e saj politike ishte çlirimi nga sundimi osman dhe bashkimi i viseve shqiptare në një shtet të vetëm shqiptar.*(Historia e Shqipërisë,*

2002: 18). Perandoria nuk lejoi një program kombëtar për shqiptarët , madje kërkesat e tyre shiheshin si rrezik për Perandorinë. Ideologët shqiptarë e drejtuan propogandën e tyre në neutralizimin e ndikimit negativ të faktorit fetar të shqiptarët dhe idesë së harmonisë fetare në interes kombëtar. Ideja e kombëtarizimit e hedhur nga Pashko Vasa, feja e vertetë e shqiptarit është shqiptaria, përshkoi lëvizjen politike, kulturore dhe artistike të periudhës së Rilindjes. Shqiptaria u bë një substancë bashkuese, forcë ideore, që bashkoi shpirtërisht dhe mendërisht shqiptarët në luftë për çlirimin kombëtar. "... ne duam të bashkohemi e të tokësohemi në mest t'enë, për me shpëtu nga thonjtë e lakëmonjësës. Çdo besë, fe a dogmë, duhet të jetë e nderuar prej kujtdo shqipëtar. As një fe a dogmë urdhëron të hamë njeri-tjatin!"shkruhej në gazetën "Rrufeja".

(Vruho,1910:3)

Sundimi despotik dhe autokratik tridhjetë e dy vjeçar i Abdyl Hamitit, i detyroi një grup atdhetarësh shqiptarë, të zhvillonin veprimtarinë politike dhe kulturore në mërgim dhe fshehtësi. Duke qenë se në viset shqiptare, lëvizja kombëtare zhvillohej në kushte ilegale, veprimtaria e diasporës shqiptare mori një rëndësi gjithnjë e më të madhe. (Historia e Popullit Shqiptar, 2002: 240) Kolonitë shqiptare të krijuara në Rumani, Bullgari, Egjipt, Amerikë, kishin si qëllim kryesor të tyre të viheshin në shërbim të çështjes kombëtare shqiptare dhe të ndikonin në zgjimin kombëtar. Ata dërgonin libra shqip që t'i shërbenin ndërgjegjësimit të shqiptarëve në Shqipëri. Shqiptarizmi u bë ligjërimi publik i diasporës. Një pjesë e mirë e shqiptarëve që shkoi në kurbet, u bënë anëtarë dhe aktivistë të shoqërive patriotike atje. Ata iu kundërvunë mediatikisht politikës aneksioniste të *Megali-Idesë* dhe turkomanizmit, duke shqetësuar qarqet politike turke e greke. Gazetat dhe shoqëritë greke në vendet ku vepronte diaspora shqiptare, ushtruan trysni mbi elementin shqiptar në emigracion. Shtypi grek u përpoq t'i paraqiste shqiptarët përpara Europës si popull që nuk ishte në gjëndje të zgjohej, pasi "Lëvizja Kombëtare Shqiptare ishte lëvizje turma fanatikësh islamikë dhe shqiptarët nuk mund të formonin një komb, pasi ishin turq". (Buda: 10)

Në lëvizjen Kombëtare Shqiptare rol të rëndësishëm luajtën e kryengritjet shqiptare të viteve 1910-1912. Shqiptarët u ndjenë të mashtruar nga Perandoria, edhe sepse lirinë që ata e kishin pasur nën turqit e vjetër u gllabërua nga turqit e rinj. Në këto kushte shpirti shqiptar i kundërshtimit u zgjua përsëri dhe mosmarrveshjet u ashpërsuan ndjeshëm. Shqiptarët kundërshtuan politikën e Abdyl Hamitit, por edhe të Turqve të Rinj, të cilët përdorën po ato

metoda në Shqipëri: zjarr, flakë, barut e tym. "...Zonët shqiptarët e Veriut i doqnë, përvëluan, syrgjynuan, i vranë, i prenë, i ç'atdhenuan më të shumën e gjindjes s'atjeshme..." shkruhej në shtypin e kohës. E ndërsa shtypi turk, u përpoq ta paraqiste rozë situatën në Shqipëri. Gazetat turke publikonin shpesh në faqet e tyre besnikërinë e shqiptarëve ndaj pushtetit të sulltanit dhe osmanizmit, duke përgenjshtruar kryengritjet në Shqipëri.

Lëvizja Kombëtare Shqiptare iu kundërvu politikës kulturore të Perandorisë, politikë e cila kishte si qëllim të pengonte; lëvizjen kulturore, punën e klubeve dhe shoqërive për një alfabet kombëtar dhe daljen e gazetave shqip. Si rrjedhim, në gjithë territorin shqiptar, Turqit e Rinj mbyllën klubet, shkollat shqipe të hapura qysh në kohën e sulltan Abdyl Hamitit. Edhe pse Ministri i Arsimit në Turqi deklaronte në fillim të vitit 1910 se "qeveria do të qëndrojë neutrale në punët e alfabetit ...në shkollat shtetërore ajo përdori vetëm alfabetin arab". (Histori e Popullit Shqiptar, 2002:420) Qeveria refuzoi deri në krijimin e një letërsie kombëtare shqiptare.

KONKLUZION

Për sa i përket asaj që u tha më sipër, mund të themi se të dy politikat e Turqve të Rinj dhe Abdyl Hamitit hiqnin tangentin osmanli, komb turk dhe jo komb shqiptar

Të dy nuk e njihnin kombin shqiptar dhe Shqipërinë, por një vend të ndarë në vilajete, njësi administrative osmane. Në filozofinë e tyre ideologjike prevalonte koncepti se para se të jesh shqiptar duhet që pikë së pari të jesh turk dhe duhet të dish mirë turqishten. Kjo filozofi ideologjike e politike vinte në rrezik identitetin kombëtar shqiptar.

Referenca:

1. Buda, A. (1978), "Shqiptarët përballë krizës lindore të viteve 1878-79", në *Studime Historike*, Nr. 1, Tiranë.
2. Dushku, L. *Filozofia e politikës greke ndaj Lëvizjes Kombëtare Shqiptare*, Revista "Aktet" Vëll. II, Nr. 1.
3. Frashëri, K. (1978), "Fillimet e Lëvizjes Kombëtare në Shqipëri", në "Studime Historike", Nr. 1, Tiranë.
4. Thengjilli P. (2002), *Shqiptaret midis Lindjes dhe perëndimit 1506-1839*. Fusha fetare1; Tiranë.
5. Grup autorësh, *Historia e Popullit Shqiptar* (2002), Vëll. II, Akademia e Shkencave e Shqipërisë&Instituti i Historisë, Toena, Tiranë.

6. Gawrych G. (2007), *Gjysmëhëna dhe shqiponja, sundimi otoman, islamizmi dhe shqiptarët, 1874-191*. Bota Shqiptare, Tiranë.
7. Guga, M. (2012), *Prefektura e Beratit 1920-1939*, Albanian University Press, Tiranë.
8. Muzeu Historik Berat, (2013), *Berati në dokumentat Arkivore Osmane*.
9. Nikolaidha, E. (1978), *Propagandat e huaja dhe LKSH-ja në krahinën metropolitane të Durrësit dhe të Beratit në fund te shek 19 dhe fillim të shek të 20*, Janinë, në: *AIH*, A-IV-422.
10. Kofos, E. (1982), *Greek reaction to developments leading to the Albanian League of Prizren*, në "Balkan Studies", no. 2, Thessalonica.
11. Swirë, J. (2005), *Shqipëria, ngritja e një mbretërie*, Dituria, Tiranë.
12. Stavrianos, L.S. (2000), *The Balkans since 1453*, Hurst Company, London.
13. Pasha V. (2003). "*E vërteta mbi Shqipërinë dhe shqiptarët*" në Antologji e Mendimit Shqiptar 1870-1945. Plejad, Tiranë.
14. Vlora. E, (2003), *Kujtime 1885-1925*. Shtëpia e librit & Komunikimit, Tiranë.
15. Vickers, M. (2008), *Shqiptarët një histori moderne*. Tiranë.
16. Vruho, J. (1910/7 korrik), *Një gabim*, "Rrufeja", nr. 14, Kajro.
17. Vruho, J. (1908/15 nëntor), *Destur i Myqeremi i xhonërvet*, "Shkopi", nr.4, Kajro.
18. Vruho, J. (1911), *Kushtetuta e 1908-ës*, "Liri e Shqipërisë" Sofje, nr.13.

SPECIFIKAT E BESIMEVE FETARE DHE NDIKIMI I TYRE NË ÇËSHTJEN SHQIPTARE

Ma.sc. Meli JAKUPI

meli_uka@hotmail.com

ABSTRAKT

Specifikat e besimeve fetare, parë nga këndi i rrafshit retrospektiv, imponojnë gjetjen e pikës së referimit që shënon emëruesin e zanafillës së këtyre specifikave. Ndikimet e tyre në kontekst etnik e kanë shtrirjen e tyre horizontale dhe atë vertikale e që kanë si rrjedhojë përmasat e tyre në diakroni, pra përpjekjet për ngritje të vijës së perspektivës si model të vetin.

Sa janë funksionale dhe pragmatike këto specifika të besimeve fetare ndër ne, shfaqin një varg pyetjesh e dilemash. Në radhë të parë, a e kanë pikën e referimit të përcaktuar, cila është shtrirja e tyre në vijën horizontale e atë vertikale? Shikuar nga këndi retrospektiv, a e kanë shfaqur qartë kontekstin e vijës etnike e gjuhësore ndër ne? Koekzistenca e këtyre specifikave a e shënon vijën e ndërtimit të perspektivës sonë etnike e atë gjuhësore në shtrirje të gjerë. Këto çështje, parë në kontekst të harmonisë si ndjesi, kërkon gjetjen e koeficientit të harmonisë së poseduar, kërkuar dhe harmonisë së humbur, si shtrirje koherente apo inkoherente në diagonalen e specifikave të tyre.

Të gjitha këto shfaqin nevojën e gjetjes së modelit të hulumtimi, vrojtimit, trajtimit, analizave e atë të sintezës dhe, do të nxjerrin në spikamë gjetjen e përfundimeve që do të reflektojnë të vënit re përmes modelit komperativ e kritik, që do të reflektojnë rezultatet e pritura nga ky studim.

Fjalët kyçe: *retrospektivë, perspektivë, diakroni, sinkroni, koekzistencë, koherente, inkoherencë.*

HYRJE

Specifikat e besimeve fetare, parë nga këndi i rrafshit retrospektiv, imponojnë gjetjen e pikës së referimit që shënon emëruesin e zanafillës së këtyre specifikave.

Për gjetjen e diagonales së këtyre specifikave, në radhë të parë, duhet të përcaktohet vija e studimit dhe vija e shtrirjes së këtyre specifikave të besimeve fetare dhe, të përcaktohet shtrirja dhe funksioni i tyre në retrospektivën dhe perspektivën gjithëpërfshirëse.

Reflektimi i specifikave të besimeve fetare dhe ndikimi i tyre në çështjen kombëtare, shtron nevojën e gjetjes së paradigmës të modelit të shtrirjes së tyre si koncepte brenda besimit dhe atë: vijën teorike, si akceptim nga këndi i racionalitetit dhe vijën praktike si funksionalitet brenda ekzistencës të qenësisë sonë etnike në periudha kohore të caktuara.

Konstatimi i theksuar do të jepet nëpërmjet sqarimeve teorike dhe përmes modelit skemë, që do ve në shqyrtim besimin si ndjesi dhe funksionalitetin e këtyre specifikave, të besimeve, si mekanizëm që përcakton koherencë në shtrirje diakronike e atë sinkronike.

I. VIJA TEORIKE

Në radhë të parë, specifikat e besimeve fetare, duhet vështruar për kah shtrirja e tyre në rrafshin e retrospektivës, sepse vetëm kështu mundësohet dhe detyrohemi të gjejmë pikën së cilës do t'i referohemi që prezanton zë fillin e zanafillës së këtyre besimeve.

Për të përcaktuar pikën e referimit, që në kuptim logjik kërkon vrojtimit të atyre gjendjeve tona psikofizike, që në hapat e parë, të gjurmëve të qenësisë sonë si pjesë e pandashme e Universit brenda dimensionit të vet.

Duke zbritur në këtë pikë referimi, në njërin anë dhe duke parë specifikat e lindjes së këtyre besimeve si cilësi koncepti, në anën tjetër; nuk mund të mos vrojtojmë shtrirjen e këtyre specifikave edhe në shtrirjen e tyre në kontekstin etnik-linguistik.

Në shtrirjen vertikale, këto specifika, kanë kornizat e tyre të shfaqura në diakroninë e zhvillimeve në kontekste më të gjera, që në vijën psikofizike të qenësisë sonë shënon pretendimin për të prekur ndjesinë tonë si shkas i ekzistimit tonë psikofizik, të species njerëzore brenda Universit.

Nëse specifikat e këtyre besimeve vështrohen në vijën e diakronisë dhe sinkronisë së tyre, sërish lind si nevojë e patjetërsueshme, gjetja e modelit të tyre dhe shfaqim pretendimet tona subjektive në bërjen e këtyre modeleve; pra të gërshetuara brenda universit tonë psikofizik dhe, njëkohësisht, tendencën për të parë imponimet në cilësi ndikim përmes modelit që i janë vënë mekanizmi i detyrimit duke e shndërruar atë në vijë të dogmatizmit ideologjik.

Tendenca e ngritjes të një modeli, në vijë të specifikës së njërit apo besimit tjetrit, kërkon të vrojtohet tendencioziteti i tentimeve drejt imponimit të vijës etnolinguistike të njëres etni kundrejt tjetrës.

Në këtë pikë, këto specifika e kanë humbur kuptimin e tyre dhe bërë mjet për krijimin e mekanizmit të imponimit deri në përmasa torturimi; pra, unë kundrejt tjerëve dhe, të tjerët kundrejt meje, më pak të vlefshëm?!

Për të nxjerrë në dukje të gjithë elementet e specifikave të besimeve, lypset parë pikën fillestare të vijës retrospektive- prapavështruese të zanafillës kronike të tyre, por pa lënë anash edhe gjendjen psikofizike tonën, me synimin, për të krijuar perspektivën e hulumtimit , vrojtimit dhe analizës që të jenë koherente me qenësinë tonë brenda relativitetit në vijë të absolute.

Shtrirja e përmasave të Universit, që ka simetrinë dhe harmoninë e vet si shtrirje absolute, qëndrimi ynë relativ në këndin tjetër, vetëm sa shfaq synimin për të gjetur një që ndanë absoluten me relativitetin ku ndodhemi ne.

Në pikën e shtrirjes së vrojtimit, kërkimit, analizës e konstatimit, vetëm sa përkon me përpjekjen tonë për të përcaktuar harmoninë e absolute me harmoninë e relatives.

Në të kundërtën, shfaq ndjesinë tonë në trajtë imponimi kundrejt tjetrit-tjerëve, atëherë, specifikat e këtyre besimeve nuk mund të kuptohen, pa vënë në dukje korrelacionin tonë kundrejt përsosmërisë së Universit dhe disharmoninë që ne tentojmë për ta shfaqur si harmoni e ndjeshmërisë kundrejt besimit.

Këto çështje duhet të vrojtohen në vijë të paradigmaticës në koherencë me vetë parimin e besimit dhe, për të parë bashkekzistencën tonë në përbërje të këtyre parimeve.

Sa janë koherente lidhshmëritë tona psikofizike me koherencën e universale, kjo mbetet të vëshetrohet përmes tri pikave që qartësojnë specifikat e këtyre besimeve me njëri-tjetrin dhe në anën tjetër, tentimin për të bërë model që pastaj të imponues.

Pikat që qartësojnë specifikat e këtyre besimeve, janë ligje themelore që shënjojnë vullnetin personal a atë kolektiv të ndjesisë. Ky ligj shfaqet në disa nivele , harmoninë që e kanë si emblemë e tërësishme, me nivelet e kuptueshmërisë, në trajtë aktive dhe afektive.

Duke kërkuar tërësinë e këtyre niveleve, ata shfaqen si në vijim:

harmonia e poseduar,

harmonia e kërkuar dhe,

harmonia e humbur.

Këta gjendje reflektojnë në gjetjen e paradigmës së vet dhe për t'i vendosur ato në shtrirje që qartësojnë nivelet dhe disnivelet e tyre, në vazhdim do ta paraqesim me anë të një skematizimi që e konkretizon punën tonë gjatë hulumtimit.

Harmonia si ligj thelbësor	Harmonia e poseduar	Harmonia e kërkuar	Harmonia e humbur
Intelektuale	Reflekton të bukurën	Sublimen	Shpirtëroren
Aktive ...	Të madhërishmen	Tragjiken	Çekuilibrimin
Afektive ...	Hirplotën	Dramatiken	Nihilizmi

Nga modeli i dhënë, le të kuptojmë se të gjitha format mendimit janë zbatime të ndryshme të tendencës themelore që variantet e ndryshme t'i kthejë në një pikë referuese, atë të ndryshueshmërisë në njësi.

Tendenca për të përvetësuar ndryshueshmërinë në një njësi të vetme dhe të pranueshme vetëm për përshtatshmëri të pozitës dhe funksionalitetit, ka shfaqur haptazi tendencën e diskriminimit që ka sjellë, praktikisht, dogmatizëm religjioz.

Dogmatizmi i vjetër qëndron në vijë të apologjisë për të kaluarën dhe shfaq tendencën për të rikthyer imponimin si hipotetikë.

Krijimi i një dogmatizmi të ri, e rikthen kujtesën tonë në hyznizim të trillit që ngutet të ngulfat të ardhmen.

II. VIJA PRAKTIKE

Pashmangshëm imponohet gjetja e pikës së referimit dhe, kjo pikë i ka korrelacionet horizontale e ato vertikale?

Lidhur me etnolinguistikën tonë, pellazge-ilire, pika e referimit që kupton ligjin thelbësor, atë të besimit, parë në vijën vertikale e atë horizontale, pati qëndruar në vijë të harmonisë së poseduar, me synimin për të gjetur harmoninë e kërkuar.

Zanafilla jonë etnolinguistike ishte model i pastër i harmonisë së poseduar, modeli i mirëfilltë që pranonte absoluten dhe relativen të gërshetuara si pjesë përbërëse të një tërësie, Universit.

Universaliteti integral i të bukurit absolut simbas dogmatizmit të vjetër e shumon pakufishëm numrin e individëve, por asgjë nuk i jep më tepër asnjërit prej tyre.¹⁵⁰

¹⁵⁰ Charl Lalo, Nociione të estetikës, Redaksia e botimeve-Rilindja, Prishtinë, 1978, f.83.

Zanafilla jonë pikën fillestare e ka te referenca gjuhë-psikologji. Kjo ka bërë që të kuptohet zanafilla si shtrirje në përbërje të harmonisë si vetëdije aktive dhe më pastaj, parë nga prizmi i mëvonshëm, si proces aktiv të ndikuar nga ai afektiv.

Harmonia e poseduar, që në zanafillën tonë etnopsikologjike që pati të gërshetuar të bukurën si ndjesi besimi e racionalizmi; madhështia reflektonte referencë etnopsikologjike, etnolinguistike, etnokulturë të të gjitha rrafsheve.

Për të përplotësuar këtë do të bazohemi te konstatimi studiuesit gjerman, Eduard Sapir-it, ku ndër të tjera pohon: në përgjithësi duhet të pranohet se ideshmëria mbisundon në gjuhë, se vullneti dhe ndjenja hyjnë në faktor të dalluar të dorës së dytë. Kjo, në fund të fundit, është fare e kuptueshme.¹⁵¹

Me rivënien e konceptit të religjiozitetit në vijën e referencave dhe interferencave, në kontekstet e etnisë, është keqpërdorur dhe keqinterpretuar prej zanafillës së saj.

Në etninë shqiptare, specifikat e besimit fetar kanë pasur dhe kanë shtrirjen e vet në interferencat shpirtërore, por, gjithmonë në pikën e referimit që ka ruajtur ekuilibrin brendapërbrenda vetë etnisë.

Në shtrirjen diakronike të këtyre specifikave, kanë krijuar përgjithësimin e gjetjes së një baraspeshë që përkonte me arsyen dhe që përshtatur karakterit të vet në kuptimin e gjetjes së pikës së referimit.

Specifikat e besimit, të shtrira ndër ne shqiptarët, janë reflektuar në imponime nga jashtë, por për nga perspektiva kanë shfaqur nevojën e gjetjes së pikës fillestare të gjërave.

Ndikimi nga jashtë ka shfaqur referenca të dogmave të këtyre besimeve, saqë kanë vënë në pikëpyetje ekzistencën tonë në rrafshin retrospektiv dhe atë perspektiv.

Në vijën e perspektivës së këtyre specifikave ka ndodhur që etnia jonë të tkurret dhe të jetë para kundërshtimit të ndikuara nga jashtë, ndonëse shkatërruese për ne.

Zbritur në pikën e referimit dhe të baraspeshës së gjërave, ndjesia kundrejt besimit, te etnia shqiptare, ka pasur qëndrimin racional si sintagmë të logjikës dhe arsyes linguistike si interferencë, edhe pse në retrospektivën e këtyre specifikave ka pasur keqinterpretime dhe keqtrajtim të tyre në cilësi referencash brenda referencave shoqërore. Në të shumtën e herëve, këto specifika të besimit kanë qenë dhe mbeten si imponime kundrejt natyrës dhe logjikës sonë.

¹⁵¹ Eduard Sapir, Gjuha - Hyrje në studimin e ligjërit, Redaksia e botimeve-Rilindja, Prishtinë 1980, f.51.

Parë në vijën e çështjes sonë etnike, këto specifika të besimit/besimeve fetare, kanë reflektuar përmes ndikimit nga jashtë, në rastin konkret, nga ndikimet sllave dhe ato të orientit.

Këto ndikime kanë shkaktuar amplitudën e drithërimeve brenda nesh, ndërsa faktori sllavë, përfshirë këtu serbët, bullgarët, grekët; kanë krijuar konceptin e tyre për bërë përvetësimin e trashëgimisë shqiptare duke krijuar dogmatizmin e tyre fetar, mbi mohimin e qenësisë shqiptare.

Nëse vështrohet në këtë vijë, kjo çështje, del qartë tendenca e këtyre etnive, pra sllavëve, për të rikthyer veten te pika fillestare e zanafillës së trashëgimisë dhe civilizimit në këtë pjesë të kontinentit të Evropës-*Gadishullit Ilirik*.

Sllavët kanë ardhur vonë në *Gadishullin Ilirik*, nuk mund të kenë pikën e referencës së tyre mbi atë të autoktonisë shqiptare!

Monumentet fetare, faltoret e të gjitha besimeve, në veçanti ato të besimit krishterë, nuk mund të shërbejnë si model, që sllavët, të ndërtojnë referencat e tyre etnike e religjioze për të identifikuar veten e tyre para civilizimit evropian e atij botëror.

Shikuar në veçanti, specifikat e besimeve fetare ndër ne shqiptarët, secili besim ka gjetur shtrirjen e vet, parë në vijën e modelit të ndjesisë shpirtërore.

Ndonëse edhe besimi tjetër, ai islam, qëndron në shpërpjesëtim ndër ne shqiptarët, sepse bartë me vete ndikimet retorike dhe atë të ndikimit gjuhësor, që janë tendencioze, me synim të një dogmatizmi në shtrirje, që ka prapavijën ideologjike.

Kjo ka bërë që një kategori e etnisë shqiptare të tkurret brenda relikteve që janë keqinterpretime dhe keq shpjegime nga klerikët e këtij besimi, që kanë për të vetmin synim, të tëhuajësojë karakterin etnik dhe atë gjuhësor ndër ne shqiptarët!

KONKLUZION

U morëm me një të tjetër mënyrë për të sqaruar thelbin e besimit dhe për të bërë dallimin mes vijës teorike e asaj praktike. I pashmangshëm ishte të vrojtuarit kritik dhe të shpjeguarit racionalist të shtrirjes së këtyre besimeve ndër ne, duke nxjerrë sintezën e këtyre diagonaleve, shumë të ndjeshme tanimë. Ndërkaq dihet se çfarë teprimesh dhe moskuptimesh kanë sjellë praktikisht këta dogmatizma në etninë shqiptare. Pra kanë qëndruar dhe qëndrojnë në inkoherencë me vet natyrën e besimit, si ngritje vertikale dhe koherencën e diagonales shpirtërore.

Dogmatizmi i vjetër u shndërrua në apologji për të imponuar ndikimin gjuhësor dhe, më pastaj në zhbërjen e thelbit etnik nder ne dhe, prurjen e një ideologjie në emër të besimit.

Ndonëse dogmatizmi i ri ka krijuar vijën e trillit që ngutet t'i zë frymën ngritjes vertikale të vlerave gjuhësore e shpirtërore ndër ne shqiptarët, në emër të ndjesisë shpirtërore-besimit.

Referenca:

1. Charl Lalo, Nocione të estetikës, Redaksia e botimeve-Rilindja, Prishtinë, 1978.
2. Eduard Sapir, Gjuha - Hyrje në studimin e ligjëritimit, Redaksia e botimeve-Rilindja, Prishtinë 1980
3. Imanuel Kanti, Mbi të bukurën e të madhërishmen, Redaksia e botimeve-Rilindja, Prishtinë 1990.
4. Northrop Fraj, Anatomia e kritikës, Ndërmarrja Botuese-Rilindja, Prishtinë, 1990.
5. Muharrem Abazaj, Pellazgët kanë folur dhe shkruar shqip, Rozafa, Tiranë, 2013.
6. Aid el Karni, Mos u trishto, Psikologji islame, Qendra kulturore "Kibla", Gostivar,2015.
7. Sherif Ahmeti, Kur'an-i, Përkthim me komentim në gjuhën shqipe, P. Box 3561, Medine, (ii).
8. Bibla, Dhijata e Vjetër dhe Dhijata e Re, Shoqëria Biblike Shqiptare, Tiranë, 2002.

ZGJIDHJA E KONFLIKTEVE DHE DREJTËSIA NË TRANZICION

PhD Candidate, Monika QERIMI

monika.qerimi@yahoo.com

ABSTRAKT

Ky artikull shqyrton disa nga çështjet kyçe në procesin e tranzicionit të drejtësisë dhe të zhvillimit të institucioneve demokratike. Bazuar në hulumtimet e mia dhe praktikat e shoqërive në tranzicion duke pasë parasysh variacionet kulturore dhe politike në hartimin e drejtësisë tranzicionale, praktikat dhe proceset janë të nevojshme për të përmbushur qëllimet kryesore të shumicës për drejtësi. Ideja e procesit që rrjedh nga fushat më të përgjithshme të zgjidhjes së konflikteve duke përfshirë edhe 'zgjidhjen alternative të' kontesteve' në kontekste ligjore, është një pjesë thelbësore e drejtësisë tranzicionale, ku proceset e shumta mund të ndodhin në të njëjtën kohë ose njëra pas tjetrës me kalimin e kohës duke vënë theksin në proceset me interesa lokale dhe komunitare duke pasur një kujdes maksimal të mos dëmtohen interesat e subjekteve individuale dhe kolektive. Drejtësia tranzicionale është në vetvete "në tranzicion" si mësimi përsëritës i zhvilluar nga vlerësimi i proceseve të ndryshme në kontekste të ndryshme. Ky artikull tregon se "zhvillimi i demokracisë" dhe ligjërimi për 'sundimin e ligjit' qëllimi dhe pasqyrimi institucional mund të mos jetë e vetmja formë e dëshiruar dhe e suksesshme në drejtësinë tranzicionale, ku më shumë se sa 'ligjore' dhe 'qeveritare' na duhet një drejtësi që nuk vë në rrezik lulëzimin e demokracisë në njërën anë dhe të drejtat e njeriut në anën tjetër. Për të përdorur një koncept të rëndësishëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ka shumë lloje të ndryshme të 'mekanizmave' që do të trajtohen në drejtësinë tranzicionale, në nivele të ndryshme të shoqërisë - më shumë se ligjore dhe qeveritare duhet të jenë dhe sociale e kulturore

Fjalë kyçe: *Drejtësia tranzicionale, zgjidhjen e konflikteve, process pluralizmi, variacione kulturore, individuale dhe kolektive të drejtësisë.*

HYRJE

Drejtësia tranzicionale është një qasje kritike ndaj shkeljeve të vazhdueshme, sistematike apo masive të të drejtave të njeriut që ofron dëmshpërblim për viktimat dhe krijon ose rrit mundësitë për transformimin e sistemeve politike, konflikteve dhe ndryshimin e kushteve të tjera që mund të kenë qenë gjeneza dhe ushqimi i abuzimeve. Kjo qasje e drejtësisë tranzicionale në

këtë mënyrë tregon se ka dy qëllime që kanë të bëjnë me goditjen e sistemit të abuzimit të vazhdueshëm apo masiv të grupeve të caktuara shoqërore, kulturore, etnike, fetare etj. E para është për të fituar një nivel të drejtësisë për viktimat. E dyta, është për të përforcuar mundësitë për paqe, demokraci dhe pajtim. Për të arritur këto dy qëllime, masat e drejtësisë tranzicionale shpesh kombinohen me elementet penale të drejtësisë dhe ato sociale.

ÇFARË ËSHTË DREJTËSIA TRANZICIONALE?

Drejtësia tranzicionale nuk është formë e veçantë e drejtësisë. Ajo është, drejtësi e përshtatur me shpesh në kushtet unike të shoqërive të ndryshme duke kaluar nëpër një transformim të gjatë kur shkelja e të drejtave të njeriut, abuzimi mund të kenë qenë një gjendje normale. Në disa raste, këto transformime ndodhin papritur dhe kanë pasoja të dukshme dhe të thella. Ndërsa në vende të tjera ato mund të zhvillohen gjatë shumë dekadave me një rrjedhshmëri të natyrshme të proceseve tranzicionale, por pa abuzuar asnjëherë me të drejtën ekskluzive të viktimave për pozicionim komod dhe të respektueshëm në shoqëri. Qasja e parë u shfaq në fund të viteve 1980 dhe fillim të viteve 1990, kryesisht në përgjigje politike të tranzicionit që ndodhi në Evropën Lindore dhe pretendimet për të përparuar në drejtësi gjatë këtij tranzicioni. Në atë kohë, aktivistët e të drejtave të njeriut dhe shoqëria civile ishin të shqetësuar me pyetjen se si të trajtoheshin mënyrë efektive, abuzimet sistematike të ish regjimeve, por edhe, si ti përforconin dhe të mos prisheshin transformimet politike që ishin në zhvillim e sipër. Këto ndryshime janë quajtur gjerësisht "tranzicioni drejt demokracisë," por njerëzit filluan duke e quajtur këtë fushë të re multidisiplinare "drejtësia tranzicionale" ose "drejtësia në kohën e tranzicionit." Drejtësia tranzicionale dhe masat që janë miratuar përfshijnë ndjekjet, zakonisht të liderëve të regjimit; thënie të vërtetash, iniciativa të tilla; si hapja e arkivave shtetërore dhe krijimin e komisioneve zyrtare për të vërtetën; krijimin e programeve të reparacioneve për viktimat dhe verifikimit të të punësuarve publikë, sidomos (por jo ekskluzivisht) anëtarëve të forcave të sigurisë.

Drejtësia tranzicionale është shfaqur si pjesë e njohjeve të abuzimeve sistematike ose abuzimeve masive, ajo kërkon një qasje të veçantë e cila është largpamëse. Masat e drejtësisë kanë për qëllim jo vetëm të vendosin për dinjitetin e viktimave, por edhe për të ndihmuar në parandalimin e viktimizimit e ngjashëm të tyre në të ardhmen. Qëllimet afatgjata të masave të drejtësisë tranzicionale janë për promovimin e paqes, demokracisë, dhe pajtimin, me idenë se

këto kushte do të ndihmojnë për të parandaluar shkelje të të drejtave të njeriut në mënyrë të vazhdueshme në të ardhmen. Sipas Qendrës Ndërkombëtare për Drejtësi Tranzicionale, përpjekjet e drejtësisë tranzicionale përfshijnë:

1. Të sjellë para drejtësisë ata që janë përgjegjës për shkeljet e kryera në lidhje me dënimet penale, dhe format jo-juridike të hetimit (psh. mekanizmat e kërkimit të së vërtetës)
2. Të ofrojë dëmshpërblim për viktimat dhe të plotësojë disi nevojat e tyre.
3. Të transformojë sistemet e sigurisë, t'i bëjë ata përgjegjës për shkeljet në të kaluarën dhe të heqë mundësisht abuzuesit e të drejtave të njeriut nga institucionet publike.
4. Të reformojë institucionet publike për të parandaluar përsërijten e shkeljeve nga e kaluara.

Për më tepër, drejtësia tranzicionale përfshin gjithashtu një llojshmëri të gjërë të mekanizmave të kërkimit të së vërtetës si iniciativa kërkimore, komisione, qendra dokumentimi etj..

Kështu pra, drejtësia tranzicionale, ndërton rrugën nga shkeljet e vazhdueshme të të drejtave të njeriut në të kaluarën për në regjime të qëndrueshme dhe demokratike të bazuara në rendin dhe ligjin.

Nevoja për të dhënë llogari për krimet e kryera në të kaluarën ka qenë dhe është masë koherente duke pasur parasysh natyrën e kontestuar të konfliktit dhe mosmarrëveshjet e vazhdueshme rreth shkaqeve dhe motivit të luftimeve dhe mjeteve e mekanizmave të përdorura .

DREJTËSIA TRANZICIONALE SOT

Drejtësia tranzicionale, sot, është një fushë në ndryshim. Ajo është rritur dhe ka gjetur terren me lëvizjet sociale të drejtësisë, si dhe fushat e zgjidhjes së konfliktit, në ndërtimin e paqes dhe të kujtesave historike.

Si kontekste kalimtare janë zhvendosur nga shoqëritë post-autoritare si të Argjentinës dhe Kilit në shoqëritë pas konfliktit të Bosnjës dhe Hercegovinës, Serbi, Kosovë dhe në Republikën Demokratike e Kongos, sfida të reja praktike kanë detyruar këtë fushë për të përtëritur dhe për të zgjeruar kufijtë. Spastrimi etnik, ri-integrimi i ish-luftëtarëve, pajtimi në mesin e komuniteteve, si dhe rolin e drejtësisë në funksion të paqes, këto të gjitha bëhen të rëndësishme si çështje të reja për të trajtuar praktikuesit e drejtësisë tranzicionale. Ri-integrimi i ish-luftëtarëve, për

shembull, është një çështje e rëndësishme për disa arsye. Së pari, ndër radhët e ish-luftëtarëve mundet të ketë autorë apo edhe organizatorë të shkeljeve masive të të drejtave të njeriut. Së dyti, në përgjithësi, ish luftëtarët, shpesh marrin para dhe trajnime për punë, ndërsa viktimat, zakonisht marrin pak ose asgjë për të rindërtuar jetën e tyre. Zhbalancime të tilla janë moralisht të dënueshme, dhe të pamatura. Ato mund të nxisin pakënaqësi, dhe mund të kërcënojnë stabilitetin e brishtë të krijuar të demokracisë.

Si kontekste kalimtare janë zhvendosur gjeografikisht nga Amerika Latine dhe Evropa Lindore për te Afrika dhe Azia, praktikuesit e drejtësisë tranzicionale janë angazhuar edhe në lokalitete nganjëherë të quajtura "tradicionale" në drejtësi.

Në disa vende, të tilla si Sierra Leone dhe Uganda, komunitetet vendase mund të dëshirojnë të përdorin ritualet tradicionale në mënyrë që të nxisin pajtimin e palëve ndërluftuese ose riintegrimin e ish-luftëtarëve. Në raste të tilla, roli i drejtësisë tranzicionale është të sigurojë një qasje holistike, por që as të përjashtojë mundësinë e drejtësisë penale për ata, që janë përgjegjës për krime të rënda, as me zbatimin e masave të tjera të drejtësisë, të tilla si dëmshpërblime, për të siguruar forma të tjera të kompensimit.

Globalisht, nga Australia dhe Shtetet e Bashkuara në Guatemala dhe Afrikën e Jugut, lëvizjet për drejtësi sociale, janë përshtatur me masat e drejtësisë tranzicionale për të përfituar dëmshpërblim për padrejtësitë e vazhdueshme. Këto lëvizje shpesh përqëndrojnë përpjekjet e tyre te abuzimet afatgjata të krijuara nga kushtet social-ekonomike, konfliktet racore, apo pabarazisë gjinore, abuzimeve fizike, të tilla si vrasje dhe zhdukje të detyruar, që ishin në qendër të përpjekjeve kalimtare të drejtësisë.

Si një fushë e zgjeruar dhe e larmishme gjatë njëzet viteve të fundit, është zhvilluar edhe një bazë e rëndësishme në të drejtën ndërkombëtare. Një pjesë e bazës ligjore për drejtësinë tranzicionale merr frymëzimin e saj në fillim në 1988 me vendimin e Gjykatës Ndër-Amerikane për të Drejtat në të cilin ka gjetur se të gjitha shtetet kanë, katër detyrime themelore minimale, në fushën e të drejtave të njeriut. Këto janë:

- Ndërrmarrja e hapave të arsyeshme për të parandaluar shkeljet e të drejtave të njeriut;
- Kryerja e hetimeve serioze të shkeljeve, kur ato të ndodhin;

- Të vendosë sanksione të përshtatshme për ata që janë përgjegjës për shkeljet;
- * Të sigurojë dëmshpërblimin për viktimat.

Thelbi i vendimit është afirmuar në mënyrë të qartë nga jurisprudenca e gjykata, dhe pa dyshim është afirmuar dhe miratuar në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të Të drejtave të njeriut dhe vendimet e trupit të traktatit të OKB-së të tilla si Komiteti i të Drejtave të Njeriut. Ajo, gjithashtu ka qenë e përfshirë direkt në shumë dokumente të rëndësishme të OKB-së të tilla si 1997, 2004 dhe 2005, raportet e raportuesit special të OKB-së në luftën kundër mosndëshkimit, dhe raporti i vitit 2004 nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm në Sundimi i ligjit dhe drejtësisë tranzicionale në Konfliktin dhe Post-Konfliktin e vitit 1988. Krijimi i Gjykatës Ndërkombëtare Penale është gjithashtu i rëndësishëm . Statuti i Gjykatës ruan obligimet shtetërore të një rëndësie jetike për luftën kundër mosndëshkimit dhe respektimi i të drejtave të viktimave.

QASJE HOLISTIKE

Shumë dilema morale, ligjore dhe politike, e sfida që kanë të bëjnë me shkelje sistematike apo masive të të drejtave të njeriut janë ndër më të ndjeshme politikisht dhe praktikisht të vështira për tu zgjidhur. Bilanci politik i pushtetit është shpesh delikat dhe qeveritë pasardhëse nuk mund të jenë plotësisht të gatshme për të ndjekur drejtësinë tranzicionale. Ata nuk mund të jenë në gjendje ta bëjnë këtë pa vënë stabilitetin e tyre në rrezik. Në vazhden e shkeljeve masive, interes në drejtësinë penale shpesh merr faza kryesore, për shkak të nevojës për të mbajtur përgjegjësi ata që janë përgjegjës për shkelje masive, dhe për shkak të dramave e gjykimeve gjyqësore. Por drejtësia penale mund të ndeshet me probleme si një qasje më vete për të kërkuar drejtësi. Sidomos me raste të abuzimi masiv, të tilla si gjenocid, mund të ketë dhjetra apo edhe qindra e mijëra viktimat. Si mund ata të gjithë të trajtohen në mënyrë të drejtë përmes sistemit gjyqësor, kur ka të ngjarë të jetë një problem më i mprehtë? Plus, gjyqësori mund të jetë jofunksional, pjesa më e madhe e policisë, prokurorëve dhe gjyqtarëve mund të jetë shumë të dobët ose të korruptuar, ose shumë të paktë në numër, për të qenë në gjendje dhe të gatshëm për të vepruar në interes të publikut dhe për të siguruar të drejtat e viktimave para drejtësisë.

Në shumë probleme që rrjedhin nga abuzimet e kaluara shpesh këto probleme janë shumë komplekse për t'u zgjidhur nga gjyqësori. Pas dy dekadash praktikë, përvoja deri tani sugjeron

që, për të qenë efektive, drejtësia tranzicionale duhet të jetë gjithëpërfshirëse. Ajo duhet të jetë e përbërë nga disa iniciativa që plotësojnë dhe zbatojnë njëra tjetrën. Elementet e iniciativave të tilla shpesh përfshijnë: ndjekjet penale që janë hetimet gjyqësore të atyre që janë përgjegjës për shkeljet e të drejtave të njeriut. Prokuroritë shpesh i japin një peshë të madhe për të hetuar atyre që konsiderohen më përgjegjës për krimet masive ose sistematike. Komisionet e së vërtetës janë komisionet e hetimit të themeluar dhe autorizuar nga shtetet për qëllimet kryesore të hetimit dhe raportimit për periudhat kryesore të abuzimit të kohëve të mëparshme. Ata shpesh bëjnë rekomandime për të korrigjuar abuzime të tilla e për të parandaluar përsëritjen e tyre. Mirëpo ato shpesh nuk kanë qenë frytdhënëse. Programet e riparimit të dëmeve janë nisma të sponsorizuara nga shteti që kanë për qëllim për të kontribuar në riparimin, në një shkallë masive, pasojat materiale dhe morale të abuzimit të kaluar e të përjetuara nga pjesë të caktuara të shoqërisë. Ata, zakonisht, bëjnë një shpërndarje të përfitimeve materiale dhe simbolike për viktimat.

Reforma e sistemit të sigurisë përbëhet nga programe të gjera për të transformuar dhe filtruar ushtrinë, policinë, gjyqësorin dhe strukturat tjera shtetërore nga instrumente të represionit dhe korrupsionit në instrumentet e shërbimit dhe të integritetit publik. Përpjekjet e përkujtimit kanë peshën e vetë rehabilituese për shoqërinë ku përfshijnë muzeumet, përmendoret, dhe mjete të tjera për kujtim të viktimave dhe për të ngritur vetëdijen morale në lidhje me abuzimin e kaluar, për të ndërtuar një “mur” mbrojtës kundër përsëritjes së saj.

Praktikisht dhe konceptualisht, masat e ndryshme të thirrjes së drejtësisë tranzicionale për njëri-tjetrin bëhet e qartë kur merren parasysh pasojat e mundshme të zbatimit të ndonjë një prej tyre në mënyrë të izoluar nga të tjerët. Pa gjetjen e së vërtetës, reforma institucionale, ose përpjekjet për zhdëmtim e viktimave, ndëshkimi i autorëve mund të shihet si viktimizim apo një formë e hakmarrjes politike. Zbulimi i të vërtetës, në mënyrë të izoluar nga përpjekjet për të ndëshkuar abuzuesit, reformat si dhe dëmshpërbimi për viktimat, mund të shihet si asgjë më shumë se fjalë boshe. Përpjekjet e përkujtimit, gjithashtu, ka të ngjarë të duken të cekta dhe të pasinqerta kur ato nuk plotësohen me përpjekje më të fuqishme dhe me masa konkrete. Kompesimi pa asnjë lidhje me masat e tjera të drejtësisë tranzicionale mund të perceptohet si "para gjaku" - një përpjekje për të blerë heshtjen apo pranimin e heshtur nga ana viktimave. Në mënyrë të ngjashme, reformimin e institucioneve pa asnjë përpjekje për të kënaqur pritjet legjitime të drejtësisë, të së vërtetës, dhe dëmshpërblimin e viktimave, nuk është vetëm i

paefektshëm nga pikëpamja e përgjegjësisë, por nuk ka gjasa të ketë sukses në kushtet e veta. Zbatimin e këtyre masave me strukturën dhe rendin e duhur mund të jetë një sfidë komplekse. Ka disa rregulla të përgjithshme që masat e para të drejtësisë tranzicionale duhet të strukturohen në një mënyrë që të ndihmojë për të maksimizuar plotësimin dhe minimizuar konfliktet ose kontradiktat. Së dyti, marrëdhëniet në mesin e masave nuk duhet të jetë shumë të paqarta ose shumë komplekse, sepse mund të kenë efekt të kundërt-produktiv dhe mund të shkaktojnë konfuzion në lidhje me qëllimet. Dhe së treti, masat e ndryshme të drejtësisë tranzicionale në mënyrë ideale duhet të renditen në një mënyrë që i ndihmon të ruajnë dhe përmirësojnë elementet përbërëse të tranzicionit, vetë-demokracisë dhe paqes pa të cilat të gjitha mundësitë e drejtësisë tranzitore mund të zvogëlojnë fushëveprimin dhe cilësinë.

Një kontribut tjetër të rëndësishëm, në këtë proces, për të maksimizuar plotësimin e nevojave të viktimave dhe për të minimizuar konfliktet apo kontradiktat duhet të japin: organizata e të drejtave të njeriut, shoqëria civile, media, religjionet dhe institucionet e tjera. Roli i tyre është i madh dhe i fuqishëm. Sepse kontributi i tyre ka efekt më të shpejtë, se sa pritja e gjatë e përfundimit të gjyqeve, të cilat shpesh bien ndesh në pakënaqësinë e viktimave dhe familjarëve të tyre. Të mos harrojmë që këto procese gjyqësore përveç kohës së gjatë të procesit ato kushtojnë shumë në vlera monetare të cilat shumë mirë mund të shkojnë në mbylljen sadopak të plagëve të të prekurve nga abuzimet e ndryshme.

Nevojat e familjeve të viktimave nuk janë te njëjta, ato janë të larmishme, sepse të ndryshme kanë qenë menyrat dhe aktet e abuzimit me to. Organizatat e të drejtave të njeriut duhet të punojnë më shumë me të abuzuarit, që ato të njohin të drejtat që u takojnë të cilat shpesh dhe u anashkalohen në mungesë të njohjes së tyre.

NJOHJA DHE PAJTIMI

Proceset që duhet të ndërmerren nga individë që jetojnë brenda këtyre shoqërive të dala nga konfliktet e zgjatura, dhuna dhe diktatura e vazhdueshme mund të përfshijnë hapa të ndryshme, si fizike dhe emocionale. Këto hapa formojnë bazën e asaj që unë e quaj "njohje direkte", një pjesë e procesit individual dhe shoqëror të shërimit. Duhet të kërkohet falje për krimet e kryera, në mënyrë që besimi social dhe angazhimi qytetar do të mund të fillojnë të marrin formë. Është bindja ime që në kërkimin e një shoqërie për të kapërcyer një trashëgimi të

shkeljeve të të drejtave të njeriut, ajo jo vetëm që duhet të përballet me të kaluarën e vet, por të fillojë të bëjë diçka për të të kapërcyer atë.

Konceptimi i fazës së pikëllimit është i dobishëm në sigurimin e një pasqyre të proceseve: si mohimi, zemërimi, bisedime, depresioni dhe perceptimi. Është e rëndësishme të zhvillohen procese rreth individëve të shoqërisë të dalë nga shoqëritë diktatoriale, të cilët shfaqin ndjenja të humbjes, mungesën e vetë-vlerësimit / vetë-respektit, pafuqisë për të vepruar dhe besuar. Në shumë raste, në qoftë se ajo nuk shprehet, trauma e përjetuar nga individë brenda shoqërisë bëhet normale. Në të tjera raste, individët e njëjtë mund të zgjedhin për të refuzuar të vërtetën rreth ngjarjeve të kaluara. Një tjetër komponent i rëndësishëm që lidhet me kapërcimin e së kaluarës është kujtesa, mos-harrimi, të folurit e shoqërisë për atë që ka ndodhur. Pra dallimi i mos-harresës individuale dhe kujtesës kolektive, i cili është një koncept më vete si fazë e rëndësishme nëpër të cilën një shoqëri në tranzicion duhet të kalojë. Kujtesa kolektive me anë të përmendoreve, monumenteve shërben si një tregues i shoqërisë në shërimin e plagëve të veta, mund të shërbejë si një matës i rëndësishëm në pozicionimin e administratës shoqërore për të ecur përpara. Ajo shërben si një mjet i rëndësishëm në psikikën kolektive. Këtë proces unë e quaj mirënjohje. Dhe ky proces i vështirë, duhet të ndërmerret në mënyrë që të realizojë çdo lloj suksesi për të ecur përpara pas një periudhe të shkeljes masive të të drejtave të njeriut. Ky është një përbërës kyç, i nevojshëm, por jo kusht i mjaftueshëm, në raport me të kaluarën, si në nivel individual dhe në kontekstin e shërimit shoqëror. Falja dhe shkallët e ndryshme të procesit të faljes dhe pajtimit të çon në besim. Besimi është një konstrukt i cili ekziston në mënyrë të veçantë në kontekstin e marrëdhënieve shoqërore. Ai është një përcaktues i rëndësishëm në rezultatin e një shoqërie. Me anë të të cilit vihet në lëvizje shoqëria civile.

KONKLuzion

Në fund të fundit, nuk ka një formulë të vetme për t'u ballafaquar me shpërdorimin sistematik në të kaluarën. Çdo shoqëri duhet të zgjedhë rrugën e vet. Deri më sot, praktika na ka mësuar se zgjedhjet e një shoqërie ka më shumë gjasa të jetë efektive kur ato janë të bazuara në një ekzaminim serioz të përvojave të mëparshme kombëtare dhe ndërkombëtare. Një ekzaminim i tillë zvogëlon mundësitë për të përsëritur gabimet e pashmangshme, të cilat shoqëritë në tranzicion mund të përballojnë. Sigurimi i konsultimit aktiv dhe pjesëmarrjes më e madhe nga ana e grupeve të viktimave dhe publikut në proces është një tjetër faktor i rëndësishëm në ecurinë

e punës. Për më tepër, përfitimet e mundshme të iniciativave kalimtare të drejtësisë ka të ngjarë të ndikojnë në shumë njerëz, kjo vjen nga një qasje jo e drejtë e pabarazisë gjinore, masave kalimtare të drejtësisë si dhe neglizhimit për lëndimet që kanë vuajtur gratë, si dhe modelet e ndryshme të abuzimit që mund të kenë ndikuar te gratë dhe burrat në qasjen e tyre në drejtësi.

Është gjithashtu e rëndësishme për të siguruar shkëmbimin e vazhdueshëm intelektual dhe praktik midis specialistëve të drejtësisë dhe atyre që punojnë në fusha të tjera të lidhura ngushtë me zgjidhjen e konflikteve, demokratizimin, zhvillimin, ndërtimin e paqes, dhe anti-korrupsionin. Ky proces është thelbësor për krijimin e politikave reale.

Së fundi, për shkak se drejtësia tranzicionale është një fushë relativisht e re, ka një nevojë të vazhdueshme për të vlerësuar ndikimin empirik të masave të shumëllojshme të drejtësisë tranzicionale. Nëpërmjet vlerësimit, politikat e ardhshme do të kenë shansin më të mirë të mundshëm për arritjen e qëllimeve të menjëhershme duke siguruar dëmshpërblim për viktimat, si dhe qëllimet afatgjata të paqes, demokratizimit dhe pajtimit.

Referenca:

1. Freeman, Mark and Priscilla B. Hayner. "Truth - Telling." In *Reconciliation After Violent Conflict: A Handbook*, edited by David Bloomfield and International Institute for Democracy and Electoral Assistance. Stockholm: International IDEA, 2003;
2. Kritz, Neil. "Progress and Humility: The Ongoing Search for Post-Conflict Justice," in *Post-Conflict Justice*, edited by M. Cherif Bassiouni (Transnational Publishers, 2002);
3. Orentlicher, Diane and UN. Independent Expert to Updated the Set of Principles for the Protection and Promotion of Human Rights through Action to Combat Impunity. Geneva: UN, 2005;
4. Baines, Erin, Stover, Eric and Wierda, Marieke, *War-affected Children and Youth in Northern Uganda: Toward a Brighter Future* (Chicago, Ill.: John D. and Catharine T. MacArthur Foundation, 2006);
5. United Nations, Office of the High Commissioner for Human Rights (OHCHR), *Making Peace Our Own: Victims' Perceptions of Accountability, Reconciliation and Transitional Justice in Northern Uganda* (New York: United Nations, 2007);

6. Kelsall, Tim, 'Truth, Lies, Ritual: Preliminary Reflections on the Truth and Reconciliation Commission in Sierra Leone', *Human Rights Quarterly*, no. 27 (2005), pp. 361–91;
7. Baines, Erin K., 'The Haunting of Alice: Local Approaches to Justice and Reconciliation in Northern Uganda', *International Journal of Transitional Justice*, vol. 1 (2007), pp. 91–114;
8. Orentlicher, Diane, 'Settling Accounts Revisited: Reconciling Global Norms with Local Agency', *International Journal of Transitional Justice*, vol. 1 (2007), pp. 10–22;
9. Tutu, Desmond, *No Future Without Forgiveness* (London: Rider, 1999) United Nations, *The Rule of Law and Transitional Justice in Conflict and Post-Conflict Societies: Report of the Secretary-General*, UN document S/2004/616, 23 August 2004;
10. Waldorf, Lars, 'Mass Justice for Mass Atrocity: Rethinking Local Justice as Transitional Justice', *Temple Law Review*, vol. 79, no. 1 (2006), pp. 1–88.

**GADISHULLI BALLKANIK DHE ÇËSHTJA SHQIPTARE GJATË DEKADAVE TE
FUNDIT TE SHEKULLIT TË XX-të**

Ph.D. Mustafë HAZIRI¹⁵²

Universiteti “Hasan Prishtina”, Prishtinë

Tel; 049-494-565, 049-922-804

E-mail: mustaf.haziri@live.com

ABSTRAKT

Çështja shqiptare në Gadishullin Ballkanik është një temë që është trajtuar mjaft, por kjo qështje, meriton një trajtim të vaqant shkencore.

Duke u bazuar në burimet arkivore, historiografike dhe publicistike, në këtë studim do të paraqes pozitën e shqiptareve në kuadër të problemeve të Gadishullit Ballkanik gjatë shek XX. Në vështrimin historiografik në mënyre të përgjithësuar do ta elaburoj edhe aspektet ekonomiko-sociale dhe gjeopolitike në kontekstin e raporteve të shqiptarëve me popujt e Ballkanit .

Duke u nisur nga fakti dhe rëndësia që kishin zhvillimet politike në Ballkan, dhe duke i shikuar këto ngjarje në aspektin e historisë shkencore, faktet shkencore flasin. se në retrospektiven historike, ngjarjet të cilat kanë determinuar në problemet e ballkanit kanë pasur rëndësi të madhe si në planin ushtarak ashtu edhe në atë ekonomikë .

Në këtë aspekt në mënyrë kronologjike do t’i trajtojmë ngjarjet me rëndësi të veqantë historike, duke u bazuar në faktorët e brendshëm dhe të jashtëm në si në aspektin politik ashtu edhe në atë strategjik.

Qëllimi i këtij studim është që në mënyrë të përgjithësuar të pasqyroj çështjen shqiptare në kuadër të problemeve në këtë Gadishull gjatë shekullit të kaluar .

¹⁵² Autori është Doktorant në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina” në Prishtinë, Sekretar i Lidhjes së Historianëve të Kosovës dega në Mitrovicë dhe autorë i dy librave, “Grevat e Minatorëve të Trepçës në Stan-Tërg, 20-28 shkurt, 1989”, dhe monografisë për mësuesin dhe veprimtarin e çështjes kombëtare “Shaban Idrizi”, si dhe referues dhe organizatorë i shumë simpoziumeve shkencore brenda dhe jashtë vendit.

Fjalë kyçe: *Gadishulli Ballkanik, shqipëtar, historiografike, gjeopolitike, ekonomiko- sociale.*

HYRJE

Nëse i hedhim një vështrim historisë së afërt të shteteve të ballkanit, ajo është e mbushur me shembuj të përpjekjeve për homogjenizimin e popullsisë që kanë sjellë shpërngulje të popullësive, dhunë, shpronsime dhe dëbime të mëdha .

Në vështrimin gjeografik Ballkani, shpesh është quajtur si urë kalimi nga një gjeohapsirë në tjetrën, ky Gadishull është i rëndësishëm edhe në aspektin strategjik . Ballkani është rajoni i vetëm në Evropë që ka lindur shtete te reja, ndonse arsyet ishin, historike, politike, ekonomike, ushtarake, gjeopolitike dhe strategjike .

Në historinë e ballkanit gjatë shek XX, mbizotëronin krimet, urrejtjet patologjike deri te gjenocidi .

Ballkanit i janë referuar disa herë si “ Gadishulli Ballkanik “ pasi që ai është i rrethuar me ujë : Deti i zi në lindje, Deti mesdhe në jug dhe në perendim duke përfshirë detin adriatik dhe Jon .¹⁵³

Nga studiuesit e ndryshëm dhe sipas dëshmimeve gjuhësore historike, “Ballkan” në fillim u quajt Masivi Malor që e mban të njëjtin emër edhe sot .

Që nga shek XVII, emëri i tij i kaloi ter Gadishullit që përbënte pjesën evropiane të Perandorisë .Pra si shihet rajoni e merr emrin e tij nga mali “Ballkan”një fjalë turke me rrënjët e osmanishtes që do të thotë “Një varg i maleve të pyllëzuar “).

Këtë e ka sqaruar edhe Faik Konica në hyrje të monografisë së tij “Shqipëria – Kopsht shkëmbor në Evropën juglindore” , ku thekson se “ Burimi i këtij toponimi lidhet me turqishten “Ballkan”, që do të thotë “mal”¹⁵⁴

Rajoni ka një sipërfaqe prej 795.000 km² dhe një popullësi për rreth 75.0000 banorë , me një pozitë të rëndësishme politiko-strategjike .

Një vëmendje të posaçme i duhet kushtuar gjeografisë ushtarake të Ballkanit, Pasi harta politike e ballkanit ka pasur ndryshime të vazhdueshme gjatë shek. XIX dhe XX .

Disa kombe të ballkanit filluan të rimarrin pavarësin e tyre në shek XIX-te siq ishin Greqia, Serbia, Bullgaria, Rumania, Mali i zi dhe në fillim të shek XX, Shqipëria .

¹⁵³ Lleshi, Abaz, “Gjeopolitika e Ballkanit dhe perspektiva e sigurise ne rajon”, Tiranë, 2009, fq.16

¹⁵⁴ <http://www.gazetakritika.net/Forumi/index.php?itemid=33>

Shekulli i XX- të gjeti ballkanin të ndarë në disa shtete, ku influenza e fuqive të mëdha kanë qenë jo vetëm kontraditore, por edhe konfliktuale.¹⁵⁵

Ekziston mendimi i dy forcave komplekse në Ballkan, ajo imprealiste dhe e patriotizmit, ku këto forca në çdo vend të Evropës janë dalluar në krijimin e një lloj skepticizmit.³

Shpeshherë në literaturën historiografike nxjerrin qëndrime kontraditore të fuqive të mëdha rreth Ballkanit.¹⁵⁶

Pas luftës së dytë botërore Bashkimi sovjetik dhe komonizmi kanë luajtur një rol shumë të rëndësishëm në ballkan.

1.ÇËSHTJA SHQIPTARE NË KONTEKSTIN JUGOSLLAV

Çështja shqiptare pas luftës së dytë botërore, u pa e kushtëzuar në dy aspekte: “Dokomunistizimi” i Shqipërisë nga njera anë, dhe demokratizimi i Serbisë, “pengesë e vetme” i pavarësisë së Kosovës.

Kështu pasi u plotësuan këto dy qëllime, me ndryshimin ideologjik në Tiranë dhe ndryshimet institucionale (por jo demokratike M.H) në Beograd, do të arrihej një status tjetër prej Kosovës.¹⁵⁷

Çështja e Kosovës, veçmas ajo shqiptare mori karakterin e çështjeve gjeopolitike qysh në fillim të viteve të 80-ta, pas vdekjes së marshallit të Jugosllavise J.B. Tito dhe fillimit të demonstratave të rinisë shqiptare në vitin 1981.

Këto ngjarje ndodhën kur në Evropë problemet nacionale, konsideroheshin të “Ngrira”¹⁵⁸.

Vlen të theksohej edhe rëndësinë e vizitës së Shtrausit në Shqipëri pas demonstratave shqiptare të Kosovës, dhe parullës Kosova – Republika dhe bashko.

Austro –Gjermanet ishin shumë të ndieshem ndaj zgjimit Shqiptar në Kosovë. Politika Gjermane u zgjua e emocionua nga shperthimi i ndjenjave kombëtare në Kosovë, pasi Gjermanet kishin nevojë për precedentin e bashkimit që tua lehtësonte rrugën e bashkimit të vetë

¹⁵⁵ Lleshi, Abaz. Vep e cit., fq.17

¹⁵⁶ Schevill, Ferdinand, “Ballkani, Historia dhe Qytetrimi”, Sh.b. UEGEN, Tiranë, 2006, fq.423

¹⁵⁷ Luka, Esileta, “Diplomacia Evropiane ndaj Shqipërisë”, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2015, fq.8

¹⁵⁸ Shabani, Sinan., “Kosova në gjeopolitike”, Botues, Dritero, Tiranë, 1998, fq.97

gjeranëve në të ardhmen . Duke marrë parasysh se problemi i shqiptarve në Jugosllavi, si problem i pozitës së tyre politike, nuk ishte dalur tani, madje as në vitet e 90-ta të shek XX, por me ndryshimet e aspektit gjeopolitik dhe ripercaktimi i idealeve të një pjese të madhe të Shqiptarëve .

Viti i provës kombetare të Shqiptareve ishte viti 1981, kur rinia e Kosovës me demonstratat e saja, që me traditën dhe organizimin e gjerë treguan se zgjidhje të vetme kishin ideologjine që ishte nën qellimin kombëtarë “¹⁵⁹.

Si rezultat i luftës së shqiptarëve për pavarësi, fytyra e botës politike ndryshoi një dekadë më vonë . Deri te vitet e 90-ta, të shek XX, Ballkani dhe në këtë rast edhe çështja shqiptare nuk ishte në qendër të vëmendjes së perëndimit .

Çështja shqiptare e Kosovës shihej si çështje e të drejtve të njeriut .¹⁶⁰ Dezintegrimi i bllokut të lindjes, zhbërja e Paktit të Varshavës dhe pavarësia e vendeve baltike, shënuan përfundimin e një rendi të krijuar pas luftës së dytë botërore .

Nga kjo periudhë duket qartë shenjat e një vëmendje të Evropës në këtë Gadishull .¹⁶¹ Është e natyrshme se këto procese erdhën si rezultat i kryengritjeve në Hungari në vitin 1956 , në Çeko-Slllovakia në vitin 1968, pastaj në Poloni etj. Të gjitha këto ngjarje si pasojë e një sovraniteti të kufizuar .¹⁶²

Sipas historianit kroat Ivo Banac, se ndihma Bashkësisë ekonomike Evropiane i ka afruar Jugosllavisë gjatë vitit 1989 – 90 krijoi lehtësime të ndryshme ekonomike në mënyrë që të evitohej kriza .

Rezistenca për ndaj forcave Serbo -madhe në Jugosllavi filloi në Slloveni pikërisht nga shkakun se Sllovenët konsistonin se zgjedhja e çështjes nacionale në Kosovë nga ana e regjimit të Millosheviqit është model i cili nuk mund të aplikohet gjithkund në Jugosllavi¹⁶³. Ç’është e verteta demonstrimi i parë i nacionalizmit serb në mënyrë të hapur u bë me rastin e vdekjes së Aleksandër Rankoviqit në vitin 1983 .

¹⁵⁹ Po aty, fq. 76

¹⁶⁰ Po aty, fq. 111

¹⁶¹ Kastelan, George, “Historia e Ballkanit”, Tiranë, 1991, fq.418

¹⁶² Sinani, Shaban, vep.cit., fq.115

¹⁶³ Tupella, Mirko, “Bosnia ne Pranga” sh.b. Liria, Lubjan/Tiranë, 1996, fq. 71

Raporti i Amnesty International mbi Jugosllavinë të botuar në vitin 1985, thuhet se në Kosovë disa vjetra mijëra vetë janë burgosur për arsye të pastëra politike.¹⁶⁴

Dënimi i nacionalizmit nga regjimet e ndryshme komuniste ka qenë një lojë e fshehur, nga se nacionalizmi si shprehja duhet kuptuar si ideologji e jo si levizje politike, apo ngritje te vetedijes kombetare. Demonstratat e vitit 1981 ishin pretekst për marrjen e masave repressive në Kosovë, të diferencimit të intelektualëve, e rinisë studentore etj..

Me keto veprime të Serbisë dhe federates jugosllave u nisen në drejtim të Kosovës, njësi speciale të cilët përdoren dhunë dhe burgosen qindra vetë me burgje të rënda.¹⁶⁵

Edhe plenumi i brijoneve i vitit 1966, e kishte zhvlerësuar deklaratat e deri atëherëshme të krerëve të Beogradit se edhe R.S.F.J është model i demokracisë¹⁶⁶.

Shikuar në të kaluarën e hershme, zhvillimet gjeopolitike në rajonin e Ballkanit, kanë qenë të lidhura, në rolin e rëndësishëm që kanë luajtur vendet perëndimore në gjeopolitikën ballkanike, në veçan,ti Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me qëndrimin e tyre në mbrojtjen e të drejtave, të popujve për vetvendosje dhe demokraci. Me këtë rast, vlen të theksohet, thenja e Winston Churcill se “ Ballkani konsumon me shumë histori sesa që prodhon”.¹⁶⁷ Ndërsa studiuesja britanike, Edit Durham, thekson se ky regjon ka shërbyer si terren eksperimentues për ideologji dhe sisteme të ndryshëm.¹⁶⁸

Diplomacitë evropiane kishin dallime për sa i përket Ballkanit edhe pas përfundimit të Luftës së parë botërore, për divergjencave të mëdha të fuqive botërore, ku Rusia, Franca dhe Britania e Madhe ushtronin rol vendimtar, ndërsa SHBA dhe Gjermania kishin ndikim të kufizuar.¹⁶⁹

Pas luftës së dytë botërore historiografia shqiptare bëri përpjekje, që fenomenin e heshtjes të kanalizoj në interes kombëtar, por duke mos lënë jashtë interesin shkencor.

Shqiptarët në gjeopolitikën strategjike të Gadishullit Ballkanik kanë vende me strategji gjeopolitike ku gërshetohen interesat e fuqive të mëdha të cilat kanë instaluar dhe bëjnë plane për

¹⁶⁴ Haziri, Mustafë “Grevat e Minatorëve të Trepçës 1989” Sh.b. Timegate, Prishtinë, 2011, fq.32

¹⁶⁵ Abrashi, Aziz, Kavaja, Burhan “Epopeja e Minatorëve” shb. “KOHA”, Prishtinë, 1986, 15

¹⁶⁶ Lalaj, Ana, “Rruga e gjatë drejt vetvendosjes, 1948-81”. Shb. Mesnjetorja e pare, Tirane. 2000, fq.149

¹⁶⁷ Lleshi, Abaz, vep. cit., fq. 200

¹⁶⁸ Kastelan, George, “Historia e Ballkanit, Tiranë, 1991, fq. 14

¹⁶⁹ Tahiri, Edit, “Konferenca e Rambujes” sh, Dukagjini, Pejë, 2002, fq. 34

instalim të mjeteve të tyre të sofistikuara për të vëzhguar dhe mbajtur në kontroll vendet Ballkanike dhe Aziatike nëpërmjet hapësirave gjeostrategjike shqiptare.

Parë në tërësi çështja shqiptare sot paraqet një rol të rëndësishëm gjeopolitik dhe gjeostrategjik në Ballkan. Falë politikës dhe diplomacisë shqiptare të mbështetur nga aleati i tyre natyror SHBA dhe shtetet e Evropës perëndimore, shqiptarët sot janë një faktor i rëndësishëm në gjeopolitikën e Ballkanit dhe zgjedhja e çështjes shqiptare është më afër se kurrë, kur kemi parasysh ndikimet politike të faktorit politik shqiptar në Kosovë, Shqipëri. Perkraja e çështjes shqiptare në kuadër të ish-Jugosllavise nga faktori nderkombetar, dhe mos lejimi i ndikimit rus në Ballkan ishte një ndër faktore të rëndësishme që ndikojnë në avansimin e çështjes shqiptare në fund të shekullit të XX-të.

KONKLUZION

Duke marrë parasysh, rëndësinë historike, që ka gadishulli ballkanik si dhe rrethanat politike të cilat kanë kaluar popujt e tij, mund të arrijmë në përfundim se çështja shqiptare në kuadër të problemeve ballkanike ka dalluar nga popujt e tjerë, jo vetëm për arsye politike por edhe për ato ekonomike dhe gjeostrategjike.

Në këtë aspekt, duke u bazuar në burimet historiografike dhe publicistike kemi arritur në përfundim se rëndësia historike, ekonomik-politike e këtij gadishulli është aq e madhe, sa që është e pamundur që në këtë studim të përfshihen në mënyrë të përgjithësuar, e gjithë ajo që duhet të thuhet. Por këtë studim kam paraqitur në mënyrë kristalizuar pozitën gjeopolitike të Ballkanit dhe çështjen shqiptare në kuadër të proceseve historike gjatë dekadave të fundit të shekullit të XX-të.

Nisur nga fakti se historiografia bashkohore është një periudhë e rëndësishme e lëvizjeve dhe e ndryshimeve të mëdha si e planit ekonomik, politik dhe shoqëror, është e natyrshme që këto lëvizje kanë lënë paqja në jetën shoqërore dhe në organizimin politik të shteteve të cilat e kaluan këtë tranzicion, prandaj qëllimi im dhe në përgjithësi i komunitetit intelektual, e sidomos i historianëve si segment i kërkuar dhe i rëndësishëm për shoqërinë është që t'i pasyrojë ngjarjet me objektivet shkencor.

Për shkak të pozitës gjeografike të gadishullit ballkanik fuqitë e mëdha evropiane u karakterizuan me një rivalitet, për hegemonin e tyre në këtë pjesë të Evropës.

Në këtë aspekt, politika e fuqive të mëdha në këtë rajon jo vetëm që kishin qëndrim kontradiktor por edhe qëndrime konfliktuale. Në këtë kuptim çështja shqiptare dhe veçmas e Kosovës mori karakterin e një çështje gjeopolitike qysh në fillim të viteve të 90'ta të shekullit të XX, pasi që deri në këtë kohë problemet nacionale në Evropë konsideroheshin si të ngrira, për këtë arsye çështja shqiptare deri në fund të viteve të 90'ta nuk ishte në qendër të vëmendjes nga perëndimi. Ndërtimi i relacioneve të Shqipërisë dhe Kosovës me vendet evropiane dhe Nato-në u bënë komponenti themelore për avansimin e çështjes shqiptare në ballkan. Kjo njëherësh rezultoj me çlirimin e Kosovës, anëtarësimin e Shqipërisë në Nato, dhe nënshkrimin e marrëveshjes së Ohrit si një bazë e mirë në funksion të realizimit të të drejtave nacionale, dhe për një stabilitet të qëndrueshem ekonomik dhe politik në këtë Gadishull.

Referenca:

1. Abrashi, Aziz, Kavaja, Burhan "Epopëja e Minatorëve" shb. "KOHA", Prishtinë, 1986;
2. Haziri, Mustafë "Grevat e Minatorëve të Trepçës 1989" Sh.b. Timegate, Prishtinë, 2011;
3. Kastelan, George, "Historia e Ballkanit, Tirane, 1991;
4. Lalaj, Ana, "Rruga e gjatë drejt vetëvendosjes, 1948-81". Shb. Mësnjetorja e parë, Tiranë, 2000;
5. Luka, Esileta, "Diplomacia Evropiane ndaj Shqipërisë", Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2015;
6. Lleshi, Abaz, "Gjeopolitika e Ballkanit dhe perspektiva e sigurisë në rajon", Tiranë, 2009;
7. Shabani, Sinan., "Kosova ne gjeopolitike", Botues, Dritero, Tiranë, 1998;
8. Schevill, Ferdinand , "Ballkani, Historia dhe Qytetrimi", Sh.b. UEG;
9. Luka, Esileta, "Diplomacia Evropiane ndaj Shqipërisë", Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2015EN, Tiranë, 2006;
10. Tupella, Mirko, "Bosnia ne Pranga" sh.b. Liria, Lubjan/Tiranë, 1996;
11. Tahiri, Edit, "Konferenca e Rambujes" sh, Dukagjini, Peje, 2002 ;
12. <http://www.gazetakritika.net/Forumi/index.php?itemid=33>.

TEORIA E NACIONALIZMIT BANAL SI NJE PERQASJE MODERNE E STUDIMIT TE NACIONALIZMIT

Kriton KUÇI

Phd Candidate University of Macedonia, Thessaloniki, Greece

Lecturer, Mediterranean University of Albania, Tirana Albania

kritonkuci@umsh.edu.al

Nevila RAMA

PhD, Institute of Doctoral Studies and Scientific Research of the State University of Technology
and Information, Sofia, Bulgaria

Vice Rector, Mediterranean University of Albania

ABSTRAKT

Teoria moderniste i konsideron kombet si konstruksione te krijuara nëpërmjet proceseve historike dhe vendos theksin te karakteri modern i kombeve dhe i nacionalizmit dhe te proceset e prodhimit dhe riprodhimit të kombeve. Sipas studiuesve që bëjnë pjesë në këtë kategori, kombet dhe nacionalizmi janë të lidhura në mënyrë thelbësore me periudhën moderne të historisë njerëzore dhe jo me periudha të mëparshme. Kemi të bëjmë me një fenomen të ri i cili është produkt i proceseve historike moderne si kapitalizmi, industrializimi dhe lindja e shtetit burokratik. Nacionalizmi si ideologji i paraprin kronologjikisht kombit, pra është nacionalizmi që prodhon kombet dhe jo vice versa. Nacionalizmi është bartës, zëdhënës dhe prodhues i kombit. Prodhon, riprodhon, ridefinon dhe riformulon në mënyrë të vazhdueshme konceptin e kombit. Ky punim synon të bëjë një rishikim të literaturës së teorisë moderniste të nacionalizmit duke u fokusuar te teoria e “Nacionalizmit banal” e Michael Billig. Kjo e fundit analizon proceset nëpërmjet të cilëve ideja e kombit dhe pjesëmarrja jonë në të riprodhohet në mënyrë të përditshme. Kjo ndodh jo vetëm nëpërmjet festave kombëtare zyrtare, paradave kombëtare, luftrave patriotike në emër të atdheut por edhe me mënyra të tjera jo zyrtare që shpesh herë kalojnë pa u vënë re. Në pjesën e fundit të punimit do të paraqiten disa ide dhe rekomandime të cilat lidhen me aplikimin e kësaj kornize teorike në lidhje me rastin e Shqipërisë.

Fjalë kyçe: *Teoritë e nacionalizmit, modernizmi, nacionalizmi banal, Shqipëria.*

HYRJE

Teoria moderniste i konsideron kombet si konstruksione te krijuara nëpërmjet proceseve historike dhe vendos theksin te karakteri modern i kombeve dhe i nacionalizmit dhe te proceset e prodhimit dhe riprodhimit të kombeve. Sipas studiuesve që bëjnë pjesë në këtë kategori, kombet dhe nacionalizmi janë të lidhura në mënyrë thelbësore me periudhën moderne të historisë njerëzore dhe jo me periudha të mëparshme.

TEORIA E NACIONALIZMIT BANAL

Modernizmi, në kundërshtim me primordializmin¹⁷⁰, mbështet idenë se kombet dhe nacionalizmi nuk janë fenomene organike, natyrale por fenomene historike që u shfaqën ndërmjet shekujve të 16 dhe 18 dhe janë në thelb produkte të proceseve moderne që lidhen me transformimet sociale të periudhës në fjalë. Kombet dhe nacionalizmi janë produkte të proceseve që kanë shënjuar periudhën moderne të zhvillimit shoqëror dhe janë pasoia të modernizimit dhe urbanizimit. Besimi te moderniteti i kombeve dhe nacionalizmit është dicka që i bashkon studiuesit që karakterizohen si modernistë, por përvec kësaj ka shumë pak pika ku përputhen. Pra për të përmbledhur përqsja moderniste i konsideron kombet si struktura të krijuara dhe jo

¹⁷⁰ Termi “primordializëm” përdoret shpesh herë në studime e nacionalizmit për të përshkruar një përqsje të caktuar në këto studime. Bëhet fjalë për paradigmen e parë të analizës së nacionalizmit, e cila u pranua së pari nga vetë nationalistët dhe në vazhdim nga studiues të ndryshëm të nacionalizmit. Nuk bëhet fjalë në thelb për një teopri por për një përkufizim “cati” nën të cilën qëndrojnë studiuesit që mbështesin idenë se kombësia është një karakteristikë “natyrale” e qenieve njerëzore. Sipas kësaj përqsjeje kombet janë “natyrale” dhe për këtë arsye ushtrojnë një ndikim të madh në eksperiencën njerëzore. Për arsye se kombet janë natyrale, organike, pra pjesë e natyrës njerëzore ato mund ti hasim në të gjitha fazat e historisë njerëzore. Pra besimi te antikiteti dhe te natyralizmi i kombeve janë komponentë që bashkojnë primordialistët. Megjithëse përqsja primordialiste e nacionalizmit bazohet të antikiteti i supozuar i kombeve, rrjedh nga veprat dhe studimet e shoqërive moderne. studime që janë kryer nga sociologë dhe antropologë me më kryesorët Clifford Geertz dhe Edward Shils. Për sa i përket varianteve të kësaj përqsjeje, Umut Ozkirimli dallon tre të tilla: “variantin natyralist”, “variantin socio-biologjik” dhe “variantin kulturor”. Ndërkohë Anthony Smith dallon edhe një variant tjetër. Atë që ai quan “perennialism” që në shqip mund të përkthehet si “i vazhdueshëm”. Ky kategorizim i mëtejshëm është shumë i dobishëm sepse sot praktikisht nuk ka studiues të nacionalizmit që të mbështesin pozicionet themeluese të primordializmit dhe që të karakterizohen si “natyralistë”. Umut Ozkirimli, *Θεωρίες του εθνικισμού. Μία κριτική προσέγγιση*. Εκδόσεις Σιδέρης, Αθήνα 2013, fq. 97; Anthony D. Smith, *Nationalism and modernism. A critical survey of recent theories of nations and nationalism*. Routledge, London, 1998, fq.146

natyrale. I jep rëndësi karakterit modern të kombeve dhe nacionalizmit, proceseve të prodhimit të kombeve si dhe të riprodhimit të nocionit të kombit. Kombet dhe nacionalizmi sipas përjasjes moderniste janë përbërës të pandashëm të jetës shoqërore në periudhën moderne dhe vetëm në këtë periudhë dhe jo në periudha të përparshme mund të flasim për kombe dhe nacionalizëm.

Modernistët fokusohen në pika të ndryshme në përpjekjet e tyre për të analizuar dhe shpjeguar nacionalizmin. Megjithatë përjasja moderniste paraqet më shumë kohezion se sa primordializmi dhe përbën sot përjasjen mbizotëruese në studimet e nacionalizmit. Kjo jo vetëm nga numri i madh i studiuesve që vetëidentifikohen si modernistë por edhe nga forca e dukshme shpjeguese e argumenteve të tyre. Përjasja moderniste paraqet një varietet të madh dhe është shumë e vështirë të konsiderohet si një kategori monolitike. Megjithatë mund të dallojmë disa çështje të përbashkëta që përshkojnë këtë përjasje:

- Nevoja e ekonomive industriale dhe kapitaliste për një identitet relativisht të përbashkët.
- Shteti modern si prodhues i këtij identiteti.
- Përhapjen e arsimit zyrtar si dhe homogjenizimin dhe standardizimin e gjuhës si përbërësit kryesorë të kulturës masive dhe të identitetit të përbashkët kombëtar.

Modernistët fokusohen në një ose në një kombinim të çështjeve të mësipërme. Shumëllojshmëria e varianteve të modernizmit si dhe diferencat ndërmjet studiuesve rrjedhin pikërisht nga mënyra se si i përjasen këtyre çështjeve. Karakteristike e shumëllojshmërisë së modernizmit është edhe fakti se edhe vetë kategorizimi i varianteve të modernizmit ndryshon nga autori në autor.

Kështu, Anthony Smith¹⁷¹ bën dallimin ndërmjet “modernizmit klasik” dhe “post modernizmit”. Në kategorinë e parë hyjnë “përjasja socio-kulturore”, e cila lidhet me studimet kolosale të Ernest Gellner¹⁷², “përjasja socio-ekonomike” që bazohet në modelet e Tom Nairn

¹⁷¹ Anthony D. Smith, *Nationalism and modernism. A critical survey of recent theories of nations and nationalism*. Routledge, London, 1998, fq.5-6, 23-25

¹⁷² Ndër veprat më kryesore të Ernest Gellner mund të përmendim: Ernest Gellner, *Selected Philosophical Themes*, volume I, II, III, Routledge, London, 1973-1974; *Nations and nationalism (New perspectives on the past*, Cornell

dhe Michael Hechter¹⁷³, “përqsja politike” me veprat e Charles Tilly, Anthony Giddens, Michael Mann dhe John Breuilly¹⁷⁴ dhe “përqsja ideologjike” me versionin e Elie Kedourie¹⁷⁵. Veprat e Eric Hobsbawm¹⁷⁶ dhe Benedict Anderson¹⁷⁷ sipas Smith-it tejkalojnë disa nga hipotezat bazë të përqsjes moderniste dhe si rrjedhojë mund të konsiderohen edhe versione marksiste të modernizmit edhe si post moderniste bashkë me punimet e Roger Brubaker¹⁷⁸, Partha Chatterje¹⁷⁹ dhe Michael Billig¹⁸⁰.

Studiues të tjerë si Atsuko Ichijo dhe Gordana Uzelac dallojnë dy kategori në përqsjen moderniste. Në kategorinë e parë hyjnë ato teori moderniste që fokusohen në proceset ekonomike dhe politike të cilat duan drejt integritit të sistemit ndërsa në kategorinë e dytë bëjnë pjesë ato teori të cilat fokusohen në proceset sociale dhe kulturore. Kategoria e parë e përshkruan procesin e modernizimit si një proces shpërbërjeje të strukturave shoqërore tradicionale dhe zëvendësimin e tyre me struktura të reja. Këto teori bazohen në idenë se industrializimi i shpejtë,

University Press, 1983; Encounters with nationalism, Balckwell Publishers, UK, 1994; Plough, sword and book. The structure of human history. University of Chicago Press, 1988,

¹⁷³ Kryesisht: Tom Nairn, The breakup of Britain: Crisis and neo-nationalism, New Left Books, London, 1977, si dhe Michael Hechter, Internal colonialism: The Celtic fringe in the British national development. Routledge, London, 1975; Containing Nationalism . Oxford University Press, USA, 2004

¹⁷⁴ Kryesisht: Charles Tilly, The formation of national states in western Europe, Princeton University Press, NJ, 1975; Anthony Giddens, The nation state and violence, Polity Press, Cambridge, 1985; The consequences of modernity, Polity Press, Cambridge, 1981; Michael Mann, The sources of social power, vol 1&2, Cambridge University Press, Cambridge 1986, 1993; John Breuilly, Nationalism and the state, Manchester University Press, UK, 1983

¹⁷⁵ Elie Kedourie, Nationalism, Hutchinson, London, 1960; si dhe Nationalism in Asia and Africa, (ed) Weidenfeld and Nicolson, London, 1971

¹⁷⁶ Eric Hobsbawm, Nations and Nationalism since 1780. Programme, Myth, Reality, Cambridge University Press, 2012; Eric Hobsbawm, Terence Ranger, (ed) The Invention of Tradition, Cambridge University Press, 2012

¹⁷⁷ Benedict Anderson, Imagined Communities. Reflections on the Origin and Spread of Nationalism, Verso, 2006

¹⁷⁸ Rogers Brubaker, Nationalism Reframed. Nationhood and the National Question in the New Europe, Cambridge University Press , 1996; Ethnicity without Groups. Harvard University Press, 2004

¹⁷⁹ Partha Chatterje, Nationalist thought and the colonial world: A derivative discourse, Zed Books, London, 1986; The nation and its fragments, Cambridge University Press, Cambridge, 1993

¹⁸⁰ Michael Billig, Banal nationalism, SAGE, 1995;

urbanizimi dhe zhvillimi teknologjik në Evropën Perëndimore shkaktuan një gërryerje në integrimin dhe kohezionin e sistemit të shoqërive tradicionale dhe cuan në zëvendësimin e strukturave të tyre me struktura të reja. Grupi i dytë i teorive e konsideron kombin dhe nacionalizmin si promotorë të proceseve të integritit socio-kulturor të shoqërive moderne. Ky integrim bëhet ose në nivel idesh, ose nëpërmjet mjeteve të komunikimit¹⁸¹.

Studiuesi Umut Ozkirimli dallon tre kategori në përfaqsimin moderniste duke u bazuar në faktorët që konsiderohen si bazikë dhe të rëndësishëm në procesin e prodhimit të kombeve. Ozkirimli e thjeshtëson kategorizimin e Smith-it dhe dallon tre variante të modernizmit: “variantin ekonomik”, “variantin politik” dhe “variantin socio-kulturor”¹⁸². Për efekt të këtij punimi do ta konsideroj teorinë e “Nacionalizmi banal” si një teori moderniste duke qenë se ndan të njëjtat komponentë kryesorë të modernizmit pavarësisht se fokusohet te procesi i riprodhimit të përditshëm të kombit.

Sic përmenda më sipër argumenti thelëbsor mbi të cilin mbështetet përfaqsimi moderniste është se nacionalizmi është një fenomen modern, lindja e të cilit erdhi si pasojë e proceseve moderne si kapitalizmi, industrializimi, urbanizimi dhe krijimi i shtetit burokratik. Nacionalizmi i paraprind kombeve dhe është pikërisht nacionalizmi që prodhon kombet dhe jo e kundërta. Nacionalizmi është bartësi, zëdhënësi por kryesisht prodhuesi i kombeve. Prodhon, rridefinon dhe riformulon vazhdimisht nocionin e kombit¹⁸³. Pra kombi është një konstrukcion social që duhet të prodhohet. Por përveç kësaj u duhet rikujtuar vazhdimisht anëtarëve të një kombi që janë pjesë e këtij kombi. Akoma më shumë që i përkasim kombit dhe kombi na përket ne. Teoria e studiuesit Michael Billig, teoria e “Nacionalizmit banal” analizon pikërisht proceset nëpërmjet të cilave ideja e kombit dhe pjesëmarrja jonë në të riprodhohet në mënyrë të përditshme.

Në studimin e tij me të njëjtin titull pra “Banal nationalism”, Billig merret pikërisht me çështjen e nacionalizmit të përditshëm, i cili shpesh herë kalon pa u vënë re dhe fokusohet

¹⁸¹ Atsuko Ichijo, Gordana Uzelec (ed), When is the nation? Toward an understanding of theories of nationalism. Routledge, NY, 2005, fq. 9-11

¹⁸² Umut Ozkirimli, Θεωρίες του εθνικισμού. Μία κριτική προσέγγιση. Εκδόσεις Σιδέρης, Αθήνα 2013, fq.120, 140, 166

¹⁸³ Παντελής Ε. Λέκκας. Η εθνικιστική ιδεολογία : πέντε υποθέσεις εργασίας στην ιστορική κοινωνιολογία. Εκδόσεις Παπαζήση, Αθήνα, 2011, fq. 98

pikërisht në nacionalizmin e vendeve perëndimore sepse ky nacionalizëm injorohet nga studiuesit. Sidoqoftë kjo vlen për çdo vend dhe shoqëri. Tendencë është që me termin “nacionalizëm” të përkufizohen veprimet e “te tjerëve” kurse veprimet “tona” të konsiderohen “patriotizëm”

Sipas Billig, shtetet kombe nga momenti që krijohen, riprodhohen dhe konsiderohen vazhdimisht si entiteti më i lartë i legjitimitetit dhe besnikërisë. Ky fakt gjendet në zemrën e nacionalizmit. Krijimi, prodhimi por edhe riprodhimi i kombit dhe i shteteve kombe është pasojë e nacionalizmit dhe i funksionimit të vazhdueshëm të tij. Nacionalizmi banal përshkruan zakonet ideologjike që u japin mundësi kombeve të riprodhohen¹⁸⁴. Riprodhon zakone dhe ndjenja që përjetësojnë kombin. Simbolet që përdoren për të shprehur natyrën e shenjtë të kombit e bëjnë këtë nëpërmjet një veprimtarie të “butë” por të vazhdueshme dhe shpesh herë të padukshme. Thelbi i nacionalizmit banal nuk është vetëm flamuri që valëvitet me zell të zjarrtë por flamuri që ngrihet në ndërtesa publike dhe që askush nuk e vë re sepse e konsideron gjë normale dhe të mirëqenë.

Jo vetëm kombet riprodhohen në mënyrë të përditshme si të tilla por kjo gjë ndodh edhe me qytetarët si pjesë e kombit, si subjekte kombëtare¹⁸⁵. Ky proces i përditshëm i konfirmimit të rëndësisë së kombit dhe të kombësisë përfshin riprodhimin e një rrjeti perceptimesh, zakonesh, traditash dhe praktikash që riprodhohen në mënyrë banale, të zakonshme. Me mënyra të ndryshme u rikujtohet qytetarëve që janë pjesë e një kombi të caktuar dhe janë pjesë e një bote që përbëhet prej kombesh. Ky rikujtim është kaq familjar, kaq i vazhdueshëm sa që nuk perceptohet si i tillë. Pra në mënyrë të përditshme kemi një lloj “valëvitje” konstante të kombësisë dhe të idesë së kombit.

Nuk është e dobishme që ta kufizojmë analizën e nacionalizmit vetëm në format e tij më ekstreme, pra në lëvizjet nacionaliste, luftat nacionaliste etj. Nacionalizmi përbën një diskurs të caktuar, një mënyrë të shprehuri që formëson ndërgjegjen tonë, një mënyrë dhe një kornizë e caktuar analize e vetes dhe botës që na rrethon dhe përveç këtyre një fenomen të përditshëm që megjithëse ka shfaqje ekstreme nuk kufizohet vetëm te to. Përjasja moderniste në përgjithësi dhe

¹⁸⁴ Michael Billig, *Banal nationalism*, SAGE, 1995, fq.6

¹⁸⁵ Ibid: 6-8

ajo e nacionalizmit banal në vecanti vë në dyshim analizat sipas të cilave pas themelimit të shtetit komb nacionalizmi bëhet i tepërt në jetën e përditshme dhe riaktivizohet vetëm kur rrjedha normale e gjërave prishet. Nacionalizmi nuk zhduket në momentin që kombi gjen strehë shtetërore, përkundrazi, përthithet nga habitati i përgjithshëm i “atdheut” të themeluar. Simbolet e kombit (flamuri, monedhat, pullat e postës etj) bëhen pjesë e përditshmërisë dhe shndërrojnë në “kombëtar” sfondin që rrethon jetën tonë. Pra këto simbole himnizojnë kombin, valëvisin idenë e kombit pa qenë nevoja ta valëvisin (flagging the nation unflaggingly), himnizojnë dhe përjetësojnë idenë e kombit nëpërmjet një valëvitjeje që nuk bie në sy. Kjo është edhe një nga arsyet se pse është e vështirë të harrohet identiteti kombëtar. Jo sepse është një gjë natyrale, organike por sepse në mënyrë të përditshme qytetarëve u rikujtohet se janë pjesë e një kombi të caktuar.

KONKLuzion

Pra, për këto arsye është e rëndësishme kjo lloj përqaasjeje e nacionalizmit, pikërisht për faktin se nuk kufizohet vetëm të shfaqet ekstreme të tij por e konsideron një fenomen të përditshëm. Jo vetëm një ideologji dhe një lëvizje por një diskurs të caktuar. Megjithatë duke u nisur nga fakti se nacionalizmi konsiderohet përgjithësisht si dicka e keqe, një forcë shkatërruese dhe një ndjenjë negative askush nuk dëshiron ta pranojë si një dicka që i përket vetes së tij ose kombit përkatës. Përkundrazi. Egziston trendi që të konsiderohet si përkatësi apo karakteristikë ekskluzivisht e të tjerëve. E personave të tjerë apo e kombeve të tjerë. Në këtë mënyrë ndihet kënaqësi sepse nuk jemi thjesht “të mirë” por jemi “më të mirë” krahasuar me “të tjerët”. Pikërisht ky është edhe celësi i nacionalizmit.

Kjo përqaasje e nacionalizmit është akoma më e rëndësishme kur bëhet fjalë për studimet e nacionalizmit në Shqipëri, ku vihet re një lloj “primordializmi akademik” që karakterizon jo vetëm studimet përgjatë shekullit të kaluar (gjatë periudhës së formimit të shtetit shqiptar si edhe gjatë periudhës nacional-komuniste) por fatkeqësisht edhe studimet përgjatë periudhës pas ndryshimeve të sistemit në fillim të viteve 1990 e në vazhdim. Pjesa më e madhe e studimeve kritike për nacionalizmin shqiptar ka ardhur kryesisht nga studiues jo shqiptarë si dhe nga disa

zëra të vecuar në botën akademike dhe publicistike shqiptare¹⁸⁶. Kjo ndodh sepse nacionalizmi, ashtu sic përmenda më sipër, mbetet diskursi mbizotërues gjatë viteve të periudhës së pluralizmit; nacionalizmi thuhet kurrë nuk konsiderohet problem i “yni” por problem i “të tjerëve” edhe sepse vetë nacionalizmi shqiptar ka kaluar në një fazë tjetër, më intensive pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës.

Referenca:

1. Anthony D. Smith, Nationalism and modernism. A critical survey of recent theories of nations and nationalism. Routledge, London, 1998;
2. Anthony Giddens, The consequences of modernity, Polity Press, Cambridge, 1981;
3. Anthony Giddens, The nation state and violence, Polity Press, Cambridge, 1985;
4. Atsuko Ichijo, Gordana Uzelec (ed), When is the nation? Toward an understanding of theories of nationalism. Routledge, NY, 2005;
5. Benedict Anderson, Imagined Communities. Reflections on the Origin and Spread of Nationalism. Verso, 2006;
6. Charles Tilly, The formation of national states in western Europe, Princeton University Press, NJ, 1975;
7. Elie Kedourie, Nationalism in Asia and Africa, (ed) Weidenfeld and Nicolson, London, 1971;
8. Elie Kedourie, Nationalism, Hutchinson, London, 1960;
9. Eric Hobsbawm, Nations and Nationalism since 1780. Programme, Myth, Reality, Cambridge University Press, 2012;

¹⁸⁶ Këtu mund të përmendim: Nathalie Clayer, Në fillimet e nacionalizmit shqiptar : lindja e një kombi me shumicë myslimane në Evropë, Përpjekja, Tiranë, 2012; Islam, state and society in post communist Albania, në Hugh Poulton, Suha Taji Farouki (eds), Muslim Identity and the Balkan state. Hurst & Company, London, 1997; God in the “Land of the Mercedes” the religious communities in Albania since 1990. Peter Jordan, Karl Kaser, Walter Lukan et alii. Albanien, Peter Lang, pp.277-314, 2003, osterreichische Osthefte.<halshs00189819> ; Religion et nation chez les Albanais. XIXe-XX siècles, Les Editions isis, Istanbul, 2002; National and Religious identity among Albanians Muslims after the political upheaval of 1990, Islamic studies, 36, 2997; si dhe artikuj të vecantë dhe me shumë vlerë nga studiues në Revistën Përpjekja, <http://www.revistaperpjekja.org/>

10. Eric Hobsbawm, Terence Ranger, (ed) *The Invention of Tradition*, Cambridge University Press, 2012;
11. Ernest Gellner, *Encounters With Nationalism* , Blackwell, 1995;
12. Ernest Gellner, *Nationalism* . London, Phoenix, 1998;
13. Ernest Gellner, *Selected Philosophical Themes*, volume II. *Contemporary Thought and Politics*, 2003;
14. http://www.revistaperpjekja.org/images/stories/botimet/perpjekja_15-16.pdf;
15. John Breuilly, *Nationalism and the state*. Manchester, Manchester University Press, 1993;
16. John Breuilly, *Nationalism and the state*, Manchester University Press, UK, 1983
17. Michael Billig, *Banal nationalism*, SAGE, 1995;
18. Michael Hechter, *Containing Nationalism* . Oxford University Press, USA, 2004;
19. Michael Hechter, *Internal colonialism: The Celtic fringe in the British national development*. Routledge, London, 1975;
20. Michael Mann, *The sources of social power*, vol 1&2, Cambridge University Press, Cambridge 1986, 1993;
21. Nathalie Clayer, God in the “Land of the Mercedes” the religious communities in Albania since 1990. Peter Jordan, Karl Kaser, Walter Lukan et alii. *Albanien*, Peter Lang, pp.277-314, 2003, osterreichische Osthefte.<halshs00189819>;
22. Nathalie Clayer, *Islam, state and society in post communist Albania*, στο Hugh Poulton, Suha Taji Farouki (eds), *Muslim Identity and the Balkan state*. Hurst & Company, London, 1997;
23. Nathalie Clayer, *National and Religious identity among Albanians Muslims after the political upheaval of 1990*, *Islamic studies*, 36, 2997;
24. Nathalie Clayer, *Në fillimet e nacionalizmit shqiptar : lindja e një kombi me shumicë myslimane në Evropë*, Përpjekja, Tiranë, 2012;
25. Nathalie Clayer, *Religion et nation chez les Albanais. XIXe-XX siècles*, Les Editions isis, Istanbul, 2002;
26. Partha Chatterje, *The nation and its fragments*, Cambridge University Press, Cambridge, 1993;

27. Partha Chatterje, Nationalist thought and the colonial world: A derivative discourse, Zed Books, London, 1986;
28. Revista Përpjekja 15-16;
29. Rogers Brubaker, Ethnicity without Groups. Harvard University Press, 2004;
30. Rogers Brubaker, Nationalism Reframed. Nationhood and the National Question in the New Europe, Cambridge University Press , 1996;
31. Tom Nairn, The breakup of Britain:Crisis and neo-nationalism, New Left Books, London, 1977;
32. Umut Ozkirimli, Θεωρίες του εθνικισμού. Μία κριτική προσέγγιση. Εκδόσεις Σιδέρης, Αθήνα 2013;
33. Παντελής Ε. Λέκκας. Η εθνικιστική ιδεολογία : πέντε υποθέσεις εργασίας στην ιστορική κοινωνιολογία. Εκδόσεις Παπαζήση, Αθήνα, 2011.

УЛОГАТА НА СОЦИЕТАЛНИТЕ РАСЦЕПИ ВО СТРУКТУРИРАЊЕТО НА ПОЛИТИЧКИТЕ ПАРТИИ ВО ПАРТИСКИОТ СИСТЕМ ВО ЗЕМЈИТЕ НА КОНСОЦИЈАЛНАТА ДЕМОКРАТИЈА

Никола АМБАРКОВ¹

¹ М-р по европски студии, д-р на политички науки

ambarkov_nkl@yahoo.com amvelbares@gmail.com

ул. „Димитар Влахов“ 59/І-15 1400 Велес

АПСТРАКТ

Предмет на анализа во овој труд е улогата на социеталните расцепи во структурирањето на политичките партии во партискиот систем во земјите на консоцијалната демократија. Консоцијацијата не претставува посебен вид на политички систем, туку модел за градење на одржлива демократија во општества кои се остро поделени долж религиските, идеолошките, јазичните, културните, етничките или расните линии во виртуелно одделени подоштества со свои сопствени политички партии, интересни групи и медиуми за комуникација. Токму поради таквата нагласена религиозна, етничка, лингвистичка, идеолошка сегментација, логично е во политичкиот систем на овие земји да имаме мултидимензиониран партиски систем, во кои партиското здружување ги рефлектира таквите социетални расцепи.

Трудот е структуриран на начин, преку споредбена анализа, најнапред да се даде осврт на улогата на социеталните расцепи во структурирањето на партискиот систем на Холандија, во периодот на т.н шеесетгодишна холандска консоцијација (1917-1967), затоа што самата Холандија беше *case study* врз чија основа беше теориски развиен консоцијалниот модел, од страна на неговиот најмаркантен претставник Аренд Липхарт. Липхарт, подоцна го посочуваше и политичкиот систем на соседна Белгија, кој со процесите на интензивното уставно ремоделирање, кои отпочнаа во текот на раните седумдесетите, резултираше со зајакнување на консоцијалните елементи во системот од една страна, но продуцираше драмтично раслојување на партискиот систем долж линиите на јазичниот расцеп во државата, од друга страна. Затоа на белгискиот случај му е посветено посебно внимание во овој труд, како што тоа ќе биде направено и по однос на

политичките партии во уникалниот директоријален политички систем на Швајцарија. Покреј улогата на социеталните расцепи во структурирањето на партискиот систем во овие етаблирани западноевропски консоцијации, посебен осврт ќе биде направен врз партискиот систем на Дејтонска Босна и Херцеговина, но и на Република Македонија, по ОРД, бидејќи станува збор за држави кои ја посвоија консоцијацијата по пат на уставен инжењеринг, независно од фактот, што тие и пред формалното воведување на консоцијативните елементи, истите ги негуваа повеќе низ политичката прагма отколку преку систематски загарантирани решенија. БиХ и РМ се интересни за една ваква анализа поради карактерот и природата на расцепите помеѓу нејзините сегменти, кои несомнено се рефлектираат и врз моделите на партиското организирање и политичко дејствување во овие две држави.

Клучни зборови: *консоцијација, партиски систем, социетални расцепи, политички партии, Линхарт.*

ВОВЕД

Политичките партии отсекогаш биле доживувани како срцето на демократијата, бидејќи во демократските политички системи тие се главните посредници помеѓу гласачите и нивните интереси, од една страна, и институциите за донесување на одлуките, од друга страна (Пуле, 2008: 79). Политичката партија е подвижна сила во политиката, затоа што идеите, вредностите, едноставно не може да постојат, да се реализираат и да се самовреднуваат изолирно (Климовски и Каракамишева, 2006: 13).

Предмет на анализа на овој труд е улогата на социеталните расцепи во структурирањето на политичките партии во земјите на консоцијалната демократија, при што треба да се нагласи дека консоцијацијата не претставува посебен вид на политички систем, туку се вклопува во основната структура на моделите на парламентарен, мешовит, претседателски или директоријален (т.е. уникатниот Швајцарски) систем (Ванковска, 2007: 163). Според истиот автор, овој модел “ја сфаќа демократијата како постоење на широк договор меѓу политичките партии и елити, кои ги претставуваат различните делови во општеството” (Ibid, 153). Во теориска и емпириска смисла моделот беше развиен од страна на повеќе автори во доцните шеесети години на XX век, но најмаркантен претставник

останува да биде Аренд Липхарт. Политичките поредоци на Холандија, Белгија, Швајцарија, според Анета Јовевска (1999: 110) беа клучниот детерминирачки фактор во развојот на оваа теорија.

Сржта на консоцијалниот пристап „е ефективно справување со политичките расцепи кои ги следат споменатите поделби во општеството како суштински за функционирање на политичкиот режим и негова подолготрајна стабилност“ (Ibid., 111). Бидејќи овој концепт според Кенет Ри (1974: 184) го нагласува степенот на религиозната, идеолошката, или лингвистичката сегментација, логично е во ваквите политички системи да се продуцира мултидимензионаран партиски систем во кои партиското здружување ги рефлектира таквите сегментни расцепи. Повеќепартизмот, заедно со рамнотежата на моќта на сегментите во општеството, малата големина на државата и расцепите кои се вкрстуваат, се клучните претпоставки за поуспешна консоцијација во длабоко поделените општества. Според Ванковска (2007: 159), политичките партии во консоцијативниот модел се соочени со еден широк дијапазон на предизвици започнувајќи од политичкото артикулирање на интересите на сегментите, нивно претставување низ институциите на системот, селекција на најдобрите лидери внатре во сегментот, лавирање помеѓу поддршката од својот сегмент и акомодирање (прилагодување) кон интересите на другите сегменти итн.

Хомогеноста и консензусот отсекогаш биле пресудни за стабилноста на една демократија, но политичките системи на Холандија, Белгија, Швајцарија, ја преокупираа современата политичка наука, бидејќи овие општества и покрај својата плуралност успеаа нивната социјална фрагментираност комбинирајќи ја со ефикасна и стабилна коалициона влада (клучниот елемент на консоцијалниот модел) да ја преточат во политичка стабилност на својот поредок. И покрај критицизмот што беше проследуван кон консоцијалниот модел, истиот стана многу популарен конституционен инженеринг за надминување на конфликтите кои настанаа во некои хетерогени и во значителна мера поделени општества. За Славиша Орловиќ (2015: 33), БиХ и Р.Македонија како земји кои беа соочени со национални конфликти кои ескалираа дури и во вооружен судир, несомнено претставуваат таков вид на општества, бидејќи двете земји беа подложени во постконфликтниот период на *concosiational institutional state building*, отелотворен во Дејтонскиот 1995 и Охридскиот договор 2001.

Клучната расправа во овој труд е дали сите расцепи во една заедница имаат еднаква тежина во структурирањето на политичките партии во партискиот систем во земјите на консоцијалната демократија, а како предмет на анализа во овој труд се земени токму партиските системи на овие три етаблирани консоцијации - Белгија, Холандија и Швајцарија, но и политичките партии во двата постконфликтни консоцијацијативни модели на БиХ и Р.Македонија.

1. ХОЛАНДСКИОТ *verzuilt* ПАРТИСКИ СИСТЕМ

Никулците на холандскиот консоцијативен модел се врзуваат, според Loots (2004), за 1917 кога во Холандија се случи т.н голема пацификација помеѓу водечките партии во политичкиот систем, која подразбираше регулирање на прашањето за универзалното право на глас за сите мажи и јавно финансирање на религиозните училишта. На универзалното машко право на глас инсистираше Работничката партија, а партиите со религиозен предзнак добија целосно државно финансирање на училиштата (Андевег, 2009: 520).

Овој компромис, според Липхарт (1976: 31-32), уште еднаш ја отсликал поделеноста на холандското општество, како феномен кој датирал многу поодамна од 1917, бидејќи и претходно холандското општеството било поделено на четири различни, помалку затворени социјални групации, познати како столбовска поделеност или *zuilen*. “Во Холандија поделбата е религиозна и идеолошка што продуцира четири блока (Католици, Калвинисти, Либерали и Социјалисти“(Orlović, 2015: 31).

Погоре посочената столбовска поделеност се рефлектирала и врз партискиот систем на Холандија. Секоја од овие групации си имала своја водечка партија, со исклучок на протестантите, кои имале две партии. Според Андевег (2009: 518), овие пет партии (социјалдемократската SDAP, либералната VDB, католичката KVP, протестантските антиреволуционери од ARP и Христијанско-историската унија CHU), од четирите столба, доминирале на политичката сцена на Холандија, од 1917-1967, кога се смета дека консоцијалните елементи биле најсилно одразени во политичкиот систем на Холандија, бидејќи тие отсекогаш освојувале од 80-90% од местата во Парламентот. Липхарт ќе нотира дека „нивната релативна сила се должела на перманентната поддршка уште од првите избори на кои беше прокламирано универзалното гласачко право за сите полнолетни од 1918“. Во оваа смисла треба да се нагласи дека класната припадност

отсекогаш била помалку релевантна за изборниот процес отколку религиската. Затоа само кај поддржувачите на лаичките партии (на социјалистите и либералите) може да се говори за класно втемелена избирачка база, додека партиите на католиците (KVP), и калвинистите (ARP и CHU) се обраќале и привлекувале глсови на избирачи со различна класна припадност, но со конкретна религиска определеност.

Сите пртии во Холандија и од религиозниот (католици, протестанти) и арелигиозниот столб (социјалисти, либерали), никогаш, во ниту еден изборен циклус, не освојувале самостојно апсолутно мнозинство, туку сите имале малцински статус и биле упатени да коалираат едни со други во периодот на т.н шеесетгодишна консоцијација (1917-1967). Не случајно и Аренд Липхарт велеше дека консоцијалната демократија најидеалано функционира онаму каде постојат 3-4 сегмента со приближно еднаква големина (види Ванковска, 2007: 159).

Клучниот пресврт во холандската политика, ќе се случи во втората половина на XX век, кога на партиската сцена ќе се искристализираат две нови пртиски формации, Демохристијанскиот апел - CDA (во која ќе се обединат некогашните проклерикални партии KVP, ARP, CHU) и Партијата на трудот - PvdA (во која ќе се слејат социјалистичката SDAP и социјално-либералното крило на VVD). Овие политички партии ќе бидат носители на процесите на дестолбовизација во Холандија, со што шеесетгодишната холандска консоцијација ќе биде приведена кон крај, токму благодарение на консоцијалните аранжмани, кои ги ублажиле острите социетални поделби помеѓу четирите препознатливи холандски сегмента, со што консоцијацијата поради својот успех се сторила за непотребна.

2. БЕЛГИСКИОТ КАРТЕЛИЗИРАН ПАРТИСКИ СИСТЕМ

Додека Холандија во доцните шеесети се дестолбовизираше, напуштајќи ги со тоа консоцијативните правила, нејзиниот јужен сосед Белгија, со вкупно шесте државни реформи од 1970, 1980, 1988/89, 1993, 2001, 2011, само го конзервираше својот типичен модел на консоцијација во поларизиран (*pillarized*) политички систем. Со овие реформи се формираа три културно-јазични заедници (фламанска, франкофона и германофона) и три региона (фламански, валонски, бриселски) со што Белгија стана *fully fledge* (полноправно) федерална држава. Најголеми импликации ваквата реформа имаше врз партискиот систем

на Белгија, кој во предфедералниот период беше доминиран од три големи партиски блока - либерален, демохристијански и социјалистички, кои по серијата од државни реформи ќе се раслои по следниве оски: лево-десно, клерикално-антиклерикално, регионално-лингвистичко, материјалистичко-постматеријалистичко, системско-антисистемско, постматеријалистичко контрареволуционерно.

Според Ливен де Винтер (2009) регионално-лингвистичкиот аспект бил најсилен причинител за партиското раслојување на некогашните единствени национални партии, втор по интензитет, несомнено е религиозниот расцеп, кој во предоминантно католичка Белгија, се манифестира на начин, порелигиозниот дел од населението да ги поддржува демохристијанските и социохристијанските формации, додека помалку религиозните, најчесто ги поддржуваат социјалистите и либерлите.

Прва политичка формација која ќе се раслои долж линиите на јазичниот расцеп ќе биде Католичката партија која ќе се подели на Centre democrate humaniste во Валонија и Christen-Democratisch en Vlaams во Фландрија. Расцепот кај либералите ќе се случи во 1972. Од тоа раслојување ќе се создадат денешните Mouvement reformateur во Валонија и Open VLD во Фландрија. Потоа ќе следува расцепот во Лабуристичката партија на Белгија Partie ouvrier Belge (Belgische Werkliedenpartij), која во 1978 формално ќе се подели на Parti Socialiste во Валонија и Socialistische Partij Anders во Фландрија (Vasović, 2007).

Вака фундираниот партиски систем на Белгија е од картелски тип, каде што партиските елити успешно ја браната *pillarized* формата на системот, бидејќи тој ја следи хоризонталната и вертикалната поделеност на белгиското општество, во кое секој од столбовите и секоја од јазичните заедници се речиси самостојни субјекти во современата белгиската политика. Белгискиот партиски систем е повеќе фрагментиран од она што е потребно за поуспешна консоцијација, бидејќи покрај шесте унилингвални партии, кои ги претставуваат главните столбови во белгиското општество (католичкиот, социјалистичкиот, либералниот), постојат и некои типично регионални (Новата фламанска алијанса) и посматеријалистички партии како и антисистемски партии (Фламански интерес), но сепак на федерално ниво партискиот систем покажува инзвонредна стабилност да се справи со кризните ситуации. Затоа некои автори како Кеман (2008: 225), сметаат дека за Белгија е поисправно да се говори не за еден единствен, туку за два

партиски система. Токму поради ова Белгија останува да биде дефинирана како држава каде што „постојат партии и провинции, но не и нација“(Wagstaff, 1994: 41).

3. ШВАЈЦАРСКИОТ ПАРТИСКИ СИТЕМ

Во последните неколку децении, за партискиот систем на Швајцарија може да се говори за четири партии со специфична тежина. Тука во прв ред се мисли на оние четири политички формации кои учествуваат во композицијата на Федералниот совет¹⁸⁷, односно ги потполнуваат неговите седум места според т.н магична формула (2:2:2:1).

Многумина автори се на мнение дека политичките партии во Швајцарија се слични во својата развојност споредено со партиите во некои други консоцијативни модели (Белгија, Холандија), бидејќи во него има мноштво партии, но сепак е стабилен. Ако се следи лево-десната димензија, најрелевантните политички партии во Швајцарија може да се позиционираат на политичкиот спектар на следниов начин – SP (Социјалдемократската партија) е на левата страна на политичкиот спектар, додека Демокристијанската партија (CVP), FDP (Либерално-демократската партија) и SVP (Швајцарската народна партија), кои се со буржоаско потекло, се на десната страна, што го прави швајцарскиот партиски систем да биде биполарен. Колку и швајцарскиот партиски систем да биде доживуван како биполарен, избирачкото тело генерално е лоцирано во центарот на политичкиот спектар, независно од фактот што водечките партии заземаат нешто поекстремни лево-десни позиции (види Gross & Siegelmann 1984; Ware, 1996; Lane & Ersson, 1994: 185). Процесот на настанување на партиите во Швајцарија, врз либералната, конзервативната или социјалистичката идеја предничел во оние кантони каде процесите на демократизација заземале посериозен замав, кадешто директната избирачка активност и граѓанскиот активизам се зародувале околу определени политички проекти, заеднички идеи и интереси, познати личности на кантонално или комунално ниво што е во духот на швајцарската непосредна демократија (види кај Vasović, 2007: 139).

Во вака димензионираниот партиски систем на Швајцарија, може да се нотираат елементи на религиски, јазичен и социо-економски расцеп. Но треба да се потенцира дека јазичниот расцеп во швајцарските *mainstream* партии е многу успешно помирен и

¹⁸⁷ Во швајцарскиот политички систем тој е носител на директоријалната и извршната власт во земјата. Неговите членови ги избира Националното собрание, со мандат од четири години.

лимитиран (во споредба со партискиот систем на Белгија, како пример) бидејќи сите тие без исклучок, се хетерогени во јазична смисла, и ни една партија не го мобилизира електоратот врз јазичната основа. Од друга страна религиозниот расцеп е тој кој ги структурира швајцарските политички партии (нешто слично како во периодот на шеесетгодишната холандска консоцијација), на начин демохристијаните да добиваат поддршка од католичките верници, социјалдемократите и либерлите да бидат поддржани од помалку религиозните католици и протестанти, кои ретко или воопшто не одат во црква, додека *народњациите* од Швајцарската народна партија имаат силна електорална база меѓу германофоните протестантски фармери и протестантите во франкофоните кантони во Романдија. Затоа, како што забележува Васовиќ (2007: 146-147), социјалната и културната хетерогеност, ги прави партиите во Швајцарија да бидат помалку хомогени, независно од фактот што на кантонално или комунално ниво тие се нешто похомогени.

4. ПАРТИСКИОТ СИСТЕМ НА БОСНА И ХЕРЦЕГОВИНА

Како што погоре беше посочено, БиХ и Р.Македонија, по крвавата трииполгодишна војна (1992-1995) и вооружениот конфликт 2001, беа соочени со процес на рedefиниција на нивните политички системи, преку воведување на определени консоцијални елементи, кои произлегоа директно од Дејтонскиот и Охридскиот мировен договор. Кога сме кај партискиот систем треба да се нагласи дека тој останува да биде еден од важните потсистеми на политичкиот систем. Конкретно на примерот на БиХ, и дисолуцијата на некогашна Југославија, треба да се напомене дека процесот на политичката плурализација во оваа земја се одвиваше на начин нејзините најзначајни политички партии во раните 1990-ти веднаш да се исцртаат долж линиите на доминантниот расцеп во земјата – религиозниот. Овие политички формации на местата каде нивните етникуми живеа поконцентрирано сакаа да формираат своја сопствена држава, ентитет или енклава. Во тој период клучни беа три партии – Српската демократска странка, бошњачката Странка за демократска акција и филијалата на Туѓмановата ХДЗ за БиХ. “Како пример, на првите оджрани повеќепартиски избори во БиХ, овие национални партии (СДА, ХДЗ, СДС) освоија повеќе од 80% од гласовите“(Orlović, 2015: 31). По војната според Вулетиќ (2005: 116), три автономни суб-национални авторитета беа креирани на начин што секои од нив продолжи да биде

контролиран од една „национлистичка“ партија на својата сопствена територија и над својот сопствен народ. На тој начин, според истиот автор, во БиХ бил креиран тоталитарен еднoпартиски систем, во секој од трите сегмента – бошњачкиот, српскиот, хрватскиот. Токму поради ова, партискиот систем на БиХ, е типичен за земја која го прифатила консоцијалниот модел за градење на демократија во длабоко фрагментирано општество, бидејќи партиите во главно се структурираат врз преобладавајќите социјални расцепи во земјата, религиозниот (муслимани, католици, православни), националниот (Бошњаци, Хрвати, Срби), јазичниот (бошњачки, хрватски српски).

Затоа Мирко Пејановиќ (2005: 54), констатира дека партиите во институциите на БиХ ги претставуваат не граѓаните или државјаните на БиХ, туку нациите или националните идентитети во БиХ. Наместо политичките партии да ги унапредуваат индивидуалните интереси и правата на граѓаните, политичките интереси се оформуваат врз националните интереси, односно врз интересите на колективитетите. Вака позиционирани партии во партискиот систем на БиХ, со нивната реторика и дејствување остануваат да бидат главен кочничар во процесот на помирување и демократизација, а граѓаните во една ваква констелација продолжуваат да бидат најголеми жртви (Vuletić, 2005: 138). Бошњачките, хрватските и српските партиски елити остануваат да бидат премногу респонзивни кон барањата на нивната електорална база, кои пак и штетат на заедницата во целина. Затоа во постдејтонска Босна, како што забележува Орловиќ (2015: 34) гласачите продолжија да ги даваат гласовите според етничкиот принцип, што резултираше со создавање на еден вид на етно-демократија во БиХ.

5. ПАРТИСКИОТ СИСТЕМ ВО МАКЕДОНИЈА

Прогласувањето на македонската независност во 1991 на 8-ми септември, но и донесувањето на одлуката за градење на политички систем од западно-европски либерален прототип, во кои партискиот плурализам е *conditio sine qua non*, е политичкиот моментум кои создаде претпоставка за градење повеќепартиски систем во земјата. Партискиот плурализам во Република Македонија, продуцираше ефект политичките партии да се искристализираат околу четири основни критериуми: група на етнички политички партии; група на граѓанско-либерални партии; група на социјалистички и социјал-демократски партии; група на други партии (Спасов, 1993).

Политичките права во раните 90-ти беа сведени на избирачкото право, но исто така тие беа и длабоко етнизирани. Сето ова, според Ванковска резултираше со „политичко организирање по етничка основа создавајќи етнички партии, кои оневозможија развојност на граѓанската демократија“ (2007: 199). Со ова *de facto* Република Македонија, се соочи со трендови, кои постоеа во партискиот систем на другите држави кои имаат хетерогена етничка структура и фрагментирана политичка култура. Консеквенцата од сето ова беше создавање на два национални блока од партии, македонски и албански. Системот поприми не само мултипартиска, туку и поларизирана димензија, бидејќи политичките партии започна да се структурират врз основа на предоминантните линии на расцеп во државата – етничка, религиозна, јазична. Сето ова кулминираше со Конфликтот во 2001 кои беше приведен кон крај со потпишување на ОРД со кои се промени Уставот од 1991 каде Македонија беше дефинирана како национална држава, за по амандманската промена на Уставот од 2001 да се нотираат елементи на мешавина од национална, граѓанска и двонационална држава (Bieber 2008: 8).

Во овој контекст, неминовни промени настанаа и во рамките на самиот партиски систем. Преседанот се случи една година подоцна со трансформацијата на една вооружена сила ОНА во политичка партија ДУИ, која подоцна беше и партиципиент во владата на големата коалиција поради изборниот резултат. Некои автори се на мнение дека сепак не станува збор за преседан бидејќи воени формации да се доразвијат во политички или да коезистираат напоредно со своите политички крила, не е некој новитет за поделените и постконфликтните општества. Примерирте со ИРА и Шин Фејн, воените структури на либанските политички партии од граѓанската војна во Либан од 70-те, ги потврдуваат овие тези (види Климовски и Каракамишева, 2006: 20).

Треба да се нагласи дека македонските политички партии, особено кога беше воведен пропорционалниот изборен модел во 2002, на сите изборни циклуси се одлучија да настапат во големи предизборни блокови, во кои партиципираа политичките субјекти на помалите уставотворни народи Турците, Ромите, Србите, Власите и Бошњаците. Формирање на вакви интеретнички политички блокови, кои пак, претставуваа своевиден признак на центрипетална политичка култура во македонскиот политички простор, сепак не го напуштија впечатокот за етничката поделеност на македонското општество, бидејќи етничкиот критериум беше и останува да биде најважниот критериум за формирање на

политичките партии, со што идеолошките и програмските определувања остануваат да бидат во втор план (Ibid, 114).

ЗАКЛУЧОК

Од погоре направениот преглед, за карактерот на партискиот систем во овие парадигматични примери на држави со елементи на консоцијација, може да се констатира дека нивниот партиски систем се структурира(ше) низ предоминантните линии на социетален расцеп во секоја од нив. Но, во некои од овие држави, пред се Холандија, но и Швајцарија, со текот на времето заслбнувааше острината на социеталните расцепи во овие земји, кои омекнуваа и создаваа претпоставки за покооперативен однос помеѓу политичките партии и нивните елити, што консеквентно резултираше со напуштање на консоцијалните правила на игра.

Но, ако се анализира партискиот систем на Белгија, ќе се забележи дека во периодот кога кај нејзиниот сосед Холандија се нотираа тенденции за надраснување на консоцијалните аранжмани, тридеценискиот процес на интензивно уставно ремоделирање на Белгија пак резултираше со јакнење на консоцијалните аранжмани и центрифугалните трендови кој најповеќе дојдоа до израз во партискиот систем, кои се раслои долж линиите на јазичниот расцеп, јакнејќи ги притоа етнонационалните партии, пред се од фламанска провиниенција.

Што се однесува до партиските системи на БиХ и Р.Македонија, тие остануваат да бидат нагласено етнифицирани, поради поларизацијата во двете општества причинет од религиските, културните, јазичните *cross cutting cleavages*. Вака фундираниот партиски систем во двете земји во определени околности го отежнуваше процесот во постигнувањето на консензус помеѓу линиите на расцепот (*consensus across lines of cleavages*). Недостатокот од ваквиот консезус во одредени ситуации се одразуваше и на односите меѓу партиите, односно и тие не успеваа да најдат заеднички јазик во надминување на меѓупартиските разлики (*consensus across party lines*). Затоа овие општества треба да прават напори за градење на политички формации, кои суштински и содржајно ќе раскинат со етно-национализмот и ќе создадат преспективи за партии со граѓанска платформа, преку кои, во крајна линија, ќе се мери успехот на самиот

консоцијативен инженеринг кои беше извршен во нив, т.е колку истиот овозможи да ги консолидира овие длабоко поделени општества.

Референци:

1. Андевег, Р.Б, (2009). “Холандија: Важноста на пропорционалноста”, во Галагер и Мичел (ед.), *Политика на изборни системи*, Скопје: Академски печат.
2. Bieber, F. (2008). Power-Sharing and the Implementation of the Ohrid Framework Agreement. In Beiber F (ed.) *Power-Sharing and the Implementation of the Ohrid Framework Agreement*. Skopje: Friedrich Ebert Stiftung Office in Skopje, pp. 7-40.
3. Duverger, M. (1959). *Die politischen parteie*. Tübingen.
4. Де Винтер, Л. (2009). “Белгија: Давање право на гласачите или на партиските елити”, во Галагер и Мичел (ед.) *Политика на изборни системи*, Скопје: Академски печат.
5. Gross, D. A., and Siegelmann, L. (1984). “Comparing Party Systems: A Multidimensional Approach”, *Comparative Politics*, 16, pp. 463-79..
6. Јовевска, А. 1999. *Изборните концепти во теориите на демократијата*. Скопје: Институт за социолошки и политичко-правни истражувања.
7. Keman, H. (2008). “The Low Countries: Confrontation and Coalition in Segmented Societies”, *Comparative European Politics*, London: Routledge.
8. Климовски, С. и Каракамишева, Т. *Политички партии и интересни групи*. Штип: 2-ри Август, 2006.
9. Lijphart, A. (1976) “Repliek op M. Fennema”, In *Acta Politica* 11 (1, 1976), 78-84.
10. Lijphart, A. (1999). *Patterns of Democracy: Government Forms and Performance in Thirty-Six countries*, New Haven: Yale University Press.
11. Lane, J-E., and Ersson, S. (1994). *Politics and Society in Western Europe*, Sage, 3rd Edition.
12. Loots, J. (2004). *Voor het volk, Van het volk, van districtenteles naar evenredige verte-genwoordiging*, Amsterdam: Verelddbibliotheek.
13. Orlović, S. (2015). “Consociational experiments in the Western Balkans: Bosnia and Herzegovina and Macedonia.” in *New Balkan Politics* Issue 17, pp.29-50.

14. Pejanović, M. (2005). *Politički razvitak Bosne i Hercegovine u postdejtonskom period*, TKD Šahinpašić.
15. Пуле, Ј. Х. (2009). „Сеуште ли трае ерата на сеопфатноста? Volksparteien и Partaistenstaat во кризи и рееквилибрација“ во Гантер, Р., Х. Р. Монтеро и Х. Х. Линц (едц.). Политички партии, стари концепти и нови предизвици. Скопје: Академски печат, 79-105.
16. Reilly, B. (2003). *Political Engineering of Parties and Party Systems*, From the American Political Science Association website.
17. Спасов, Ѓ. (1993). *Фактори на обликување и природата на партискиот систем на Република Македонија*, Скопје: ИСПИИ.
18. Vasović, V. (2007). *Savremene demokratije 2-* Том 2, Beograd: JP „Službeni glasnik“.
19. Vuletić, D (2005). “Organizational Structures and Internal Party Democracy in Bosnia and Herzegovina” in Georgi Karasimeonov (eds.) *Organizational Structures and Internal Party Democracy in South Eastern Europe*, Sofia: Gorex Press, 114-142.
20. Ванковска, Б. (2007). *Политички систем*, Скопје: Бомат.
21. Ware, A. (1996). *Political Parties and Party Systems*, New York: Oxford University Press.
22. Wagstaff, P. (1994). “Regionalism in Belgium”, in Wagstaff, P. (eds.), *Regionalism in Europe*, Vol. 1.—No.2/3.

**ZANAFILLA E KONFLIKTIT IZRAEL- PALESTINË FAKTORËT HISTORIK,
POLITIK DHE FETAR QË BLOKOJNË ZGJIDHJEN AFATGJATE**

Msc.Senada LAÇKA

International University of Struga

e-mail: s.lacka@eust.edu.mk

Msc.Rudina KAJA

International University of Struga

e-mail: r.sela@eust.edu.mk

ABSTRAKT

Lindja e Mesme vijon të jetë rajoni më i militarizuar në botë dhe zona ku bëhet trafikimi dhe shitja më e madhe e sasisë të armëve. Luftërat e bëra në këtë rajon prej më shumë se 1300 vjetësh vijnë si rezultat i luftës të vazhdueshme politike dhe ekonomike për kontrollin e burimeve pasurore ku vend të veçantë zë NAFTA që llogaritet si pasuria dhe vlera më e madhe që ky rajon ia ofron tregut botëror.

Në gjeopolitikën moderne, Lindja e Mesme ka hyrë si sinonim i konflikteve dhe luftërave permanente për naftën. Domethënë, shkaku kryesor dhe themelor i krizave në Lindjen e Mesme është Ekonomik. Ky rajon posedon 1/3 e të gjithë rezervave të naftës në botë që furnizon ekonominë e Evropës Perëndimore. Edhe pse ish-in të ndara nga ana ideologjike, vendet arabe kanë një problem të përbashkët, që është prezenca e shtetit të Izraelit.

Në shekullin e XIX, shteti i Palestinës ka qënë i banuar me popullsi multikulturore prej të cilëve 86% muslimanë, 10% të krishterë dhe 4% hebrenjë. Rrënjët e konfliktit fillojnë me përplasjet rreth të drejtës mbi territorin që përfshin pjesë të Bregut Lindor të Detit Mesdhe dhe Rivierës Jordaneze ose Bregut Perëndimor (West Bank) dhe Ripit të Gazës.

Pothuajse në të gjitha shtetet arabe të Lindjes së Mesme, zgjidhja e çështjes së Palestinës përbën qëllimin kryesor të politikës së tyre të jashtme.

Që muajin e parë që u krijua, arabët i shpallën luftë Izraelit, i cili vazhdon të shkelë vendimin e OKB-së për krijimin e tij, OKB i njohu Izraelit gati 1/2 e territorit të Palestinës dhe në pjesën tjetër do të formohej shteti i Palestinës, ndërkohë që Izraeli ka gati 2/3 nën zotërimin e tij.

Edhe pse për zgjidhjen e këtij konflikti janë inkuadruar faktorë të shumtë ndërkombëtarë, janë realizuar bisedime dhe marrëveshje të dështuara, konflikti më agresiv dhe më i gjatë në historinë e njerëzimit edhe më tej vazhdon me intenzitet të fuqishëm dhe me rritje të numrit të viktimave nga të dy anët.

Fjalët kyçe: *Izrael, Palestinë, Konflikt, OKB, Nafta.*

HYRJE

Që muajin e parë që u krijua, arabët i shpallën luftë Izraelit, i cili vazhdon të shkelë vendimin e OKB-së për krijimin e tij, OKB i njohu Izraelit gati 1/2 e territorit të Palestinës, dhe në pjesën tjetër do të formohej shteti i Palestinës, ndërkohë që Izraeli ka gati 2/3 nën zotërimin e tij.

Stereotipi i ndryshëm kulturor ka ushqyer racizmin dhe fundamentalizmin reciprok mes popujve arab dhe popujve perëndimor për njeri tjetrin. Popujt perëndimor i personifikojnë arabët si terroristë e fundamentalistë kurse në perceptimet e popujve arabë, popujt perëndimore janë perceptuar si raciste, neo-raciste dhe anti-islamike.

Në këtë krizë janë përfshirë Arabët, Izraelitët, Fuqitë Perëndimore dhe Fuqitë Lindore. Ngjarja e vitit 1947-1948 që solli themelimin e shtetit Izraelit, krijoi problemin Arabo- Izraelit që vazhdon sot e kësaj dite. Hapi historik për krijimin e shtetit të Izraelit ishte rezultat i Holokaustit të shkaktuar nga Hitleri që eliminoi rreth 7 milion hebrenj nga Evropa. 188 Bashkimi Sovjetik dhe shtetet Arabe besonin që krijimi i Izraelit ishte punë e fshehtësisë kospirative të shteteve kapitaliste-imperialiste dhe kembënguljes të Izraelitëve. Në periudhën e krijimit të Izraelit, Franca dhe Britania dërguan notë diplomatike (whitepaper) kundër formimit të shtetit Izraelit si shtet pa hartl. Sovjetiket dhe blloku i tyre ishin në mbështetje të arabëve kurse amerikanët dhe blloku i tyre në mbështetje të Izraelit.

Shteti izraelit u themelua nga vetë izraelitët në 14 maj të vitit 1948. Presidenti amerikan Truman e njohu menjëherë atë. Edhe Stalini disa ditë më vonë e pranoi diplomatikisht themelimin e Izraelit. Pak kohë më pas për shkaqe të brendshme, Bashkimi Sovjetik ndryshoi politikën si antisemit dhe proarab.

¹⁸⁸ Bashkurti, Lisen, "Krizat Ndërkombëtare" "GEER", Tiranë, 2008, fq.68

Pika më e nxehtë dhe më e ngatërruar e konfliktit palestinezo-izraelit mbetet Jerusalemi rreth keraktarit të shenjtë të qytetit për tre besimet: Judaizmin, Krishterizmin dhe Islamin. Për ortodokset hebraike, Judea dhe Samaria bëjnë pjesë në Izraelin e Madh dhe i përkasin vullnetit hyjnor. Problemi bazë mes dy palëve ka lindur për shkak të territoreve të pushtuara nga Izraeli në vitin 1967: Gaza, Jordania Perëndimore, Sinai(që më pas iu rikthye Egjiptit), Rripi i Gazës dhe qyteti i vjetër i Jerusalemit.

Krijimi i Mbretërisë së Jordanisë mbi gjithë Palestinën e shëndroi debatin për Jerusalemin si një ndër çështjet më të vështira diplomatike që pasoi me negociata të gjata dhe të vështira. Në anën hebreje psikologjia e imponimit me forcë nga vendet e shenjta determinoi shqetësimin e hebrejve. Në anën arabe filloi tensioni ndërmjet palestinezve vendas dhe regjimit të Jordanisë.

Në fillim të viteve '70, lëvizja politike e arabëve palestinez u organizua nga organizata për çlirimin e Palestinës që përfaqësonte interesa të palestinezëve në rajon. Në zgjidhjen e problemit të Jerusalemit u angazhuan shumë shtete dhe institucione ndërkombëtare duke përfshirë një kontribut të SHBA-ve dhe OKB-së.

Përballimi i Krizës së Mesme mblodhi Konferencën e Madridit në tetor të vitit 1991, ku çështja Izraelito-palentineze u përfshi në proces negociatash paqësore. Në këtë konferencë, me iniciativë të dy palëve dhe SHBA-së u ra dakord të mos hapet çështja e Jerusalemit por më vonë kjo çështje shpërtheu si qendër e bisedimeve në Konferencë. Një tjetër përpjekje diplomatike ishte “ Deklarata e parimeve Izraelito-Palentineze “ e vitit 1993 në Washington.

Me kauzën palestineze u ngrit nacionalizmi i Naserit, megalomania e Gadafit, revanshimi i Sadamit dhe hegjemonizmi i Ahmadinexhatit.

1.PRAPAVIJA HISTORIKE E KRIZËS SË LINDJES SË MESME-KRIJIMI I SHTETIT TË PAVARUR TË IZRAELIT

Prapavija historike e kësaj krize daton qysh në periudhën e Perandorisë Osmane. Para ndërhyrjes së Perandorisë Osmane, Lindja e Mesme ka qënë rajon mononacional, me një identitet, fe, gjuhë e kulturë. Sulltani i coptonte dhe ndante kombet homogjene (mononacionale) me qëllim të sundimit permanent dhe shumë më të lehtë. P.sh Shqipëria ishte e ndarë në 4 pashallëqe kurse Iraku në 3 pashallëqe.

Pas kolapsimit të Perandorisë Osmane, në Lindjen e Mesme u futën 5 forca të reja: Britania, Franca, Italia, Gjermania dhe Rusia. Në këtë periudhë të shekullit XIX deri në mesin e shekullit XX, Lindja e Mesme u nda mes Francës dhe Britanisë, të cilët për të udhëhequr më lehtë me këtë rajon, në vendet e tyre përgatitën elitën e lindjes që të ishin lidheshit e shteteve arabe dhe shteteve tjera. Elita politike dhe ekonomike e Lindjes së Mesme është më e korruptuara në botë (oligarki) dhe kjo ka ndihmuar depërtimin e lehtë të Fuqive të Mëdha në këtë rajon.

Me shpërthimin e Luftës së Parë Botërore, nacionalistët arabë menduan se kishin përpara dy zgjidhje: të bashkoheshin me turqit me shpresën e arritjes të një lloji autonomie dhe vetëqeverisjeje si synim final ose të mbeshteshin aleatët me shpresën e arritjes së pavarësisë të tyre të plotë. Nga fundi i Luftës së Parë Botërore ashpërsia me të cilën turqit u sollën me arabët, bëri që arabët të shëndërohen në anti-turq të vendosur. Këtë e shfrytëzoi Britania dhe diplomacia e saj e cila së pari synonte dobësimin e Perandorisë Osmane përmes revoltës arabe. Diplomacia Britanike synonte shmangien e xhihadit islamik (luftës së shenjtë) të shpallur nga Sulltani, dhe së fundi, Britania e Madhe synonte të krijojë shtetin e pavarur arab në vend të Perandorisë Osmane si hapësirë politike tepër e rëndësishme për koridorin drejt Indisë.

Pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore, në Konferencën e Paqes në Paris mori pjesë edhe një delegacion Sionist (hebrej) dhe ky moment daton hyrje në lojë intensive të diplomacisë izraelite që kishte pozitë më të fortë se palestinezët, për shpalljen e shtetit të tyre në Lindjen e mesme, pranë palestinezëve. Ndërkohë, arabët kishin pretendime të mëdha kundër tentativave sioniste në Palestinë dhe Jeruzalem.

Përfundimi i Luftës së Dytë Botërore u shoqërua me dobësim serioz të fuqive tradicionale kolonialiste siç ishin Franca dhe Britania. Në fillim të Luftës së Ftohtë u paraqitën dy Fuqi të Mëdha të reja botërore (worldpower): Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Sovjetik - Rusia, të cilët e ndanë *de facto* Lindjen e Mesme për interesa personale. Në vitin 1943 Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Sovjetik u takuan në Teheran ku i ndanë interesat e pasluftës.

1.1 Lufta e Dytë Botërore dhe krijimi i shtetit të Izraelit

Gjatë Luftës së Dytë Botërore, përpjekjet e hebrenjve ishin të ndihmonin në humbjen e nazistëve dhe në rritjen e pozicionit politik dhe ushtarak brenda dhe jashtë Palestinës. Gjatë vitit 1944 zionistët ndihmuan britanikët të rekrutonin rreth 43 000 hebrenj palestinez në shërbimin ushtarak. Si pasojë e presioneve izraelite në Britani dhe në SHBA, Britania më në fund ra dakord të krijonte në v. 1944 një brigadë hebreike brenda ushtrisë së saj. Pas Luftës së Dytë Botërore vazhduan divergjencat mes arabëve palestinez dhe Zionismit në Palestinë. Në 15 Maj 1947, Asambleja e Përgjithshme e OKB adoptoi një rezolutë që autorizonte një komision special prej 11 kombesh në Palestinë për të investiguar të gjitha pyetjet lidhur me çështjen palestineze dhe për të bërë rekomandime nga OKB-ja brenda shtatorit 1947. Anëtarë të komitetit ishin përfaqësues nga Australia, Kanadaja, Çekosllovakia, Guatemala, India ,Irani , Hollanda, Peruja, Suedija . Uruguaji dhe Jugosllavia.

Në deklaratën e tyre para këtij komisioni, përfaqësuesit e zionismit theksuan të drejtat ligjore, fetare dhe historike të hebrenjve¹⁸⁹. Ata theksuan se rasti i tyre ishte unik, dhe se vetëm themelimi i një shteti të pavarur izraelit mund të zgjidhte problemin e pastrehësisë, pasigurisë dhe persekutimit ndaj tyre. Ata shtuan se arabët do të përfitonin materialisht nga prania e kombit hebre i cili posedonte kapital të konsiderueshëm dhe asistencë teknike të kohës. Komiteti i lartë Arab, nga ana tjetër, refuzoi të kooperonte me komisionin dhe përfaqësuesit e zionismit, pasi sipas tyre tashmë ishte më se e qartë se të drejtat e arabëve në Palestinë ishin dhunuar rëndë.

Për më tepër, për të marrë në dorë Palestinën, Zionismit i nevojitej mbështetje nga arena ndërkombëtare. Truman, presidenti amerikan i kohës ndjente keqardhje për hebrenjtë pas persekutimit të tyre gjatë Luftës së Dytë Botërore, kështu që ai ishte në favor të krijimit të një shteti izraelit për të lehtësuar sado pak dhimbjen e tyre. Pjesa dërmuese e komisionit 11 kombesh UNSCOP¹⁹⁰ propozoi ndarjen e Palestinës në një shtet arab, një shtet izraelit, dhe një Jeruzalem të pavarur nën mbikqyrjen e OKB-së. Që të dy palët, arabët dhe hebrenjtë reagueshan

¹⁸⁹ David Mcdowall, Palestine and Israel, IB tauris and co.l.t.d London 1990.

¹⁹⁰ United Nations Special Committee on Palestine (UNSCOP) was created on 15 May 1947, General Assembly Resolution 106 Constituting the UNSCOP.

shumë shpejtë ndaj këtij vendimi, i cili u bë publik në fillim të shtatorit 1947. Arabët u ngritën në revoltë kundër këtyre propozimeve. Ndërkohë, ishte e qartë se vendimi i shumicës së UNSCOP favorizonte Zionistët dhe ishte një humbje për arabët palestinez. Në debatet e tyre në Ligën e Kombeve, arabët akuzuan shumicën vendimmarrëse të komisionit si të padrejtë dhe aspak demokratike. Ata protestuan kundër dhënjes së territorit më të mirë të Palestinës ndaj hebrenjve që përbëninin vetëm 6% të popullsisë, prandaj ata do të rezistonin duke u vetëmbrojtuar nga dominimi hebre.

Nga ana tjetër jo të gjithë hebrenjë ishin të interesuar për vendimet e UNSCOP sepse ata ishin të frikësuar nga opozita e dhunshme arabe. Grupet ekstremiste si IRGUN deklaruan se kjo ndarje e vendlindjes ishte e papranueshme dhe bënë thirrje se ndarje nuk do të thotë paqe, ata kërkonin që hebrenjtë të çoheshin në ofansivë. Pra, jo thjeshtë të përballonin sulmet ushtarake palestineze, por të luftonin për ta shtënë atë teren në dorë.

Gjithsesi, në 14 maj 1948, Ben Gurion¹⁹¹, Khazar izraelit deklaroi krijimin e shtetit të pavarur të Izraelit.

1.2.Aspekti historik dhe politik i Zionismit

Zioninismi nuk është më shumë se Nacionializmi Hebre. Kjo vjen nga fjala ‘Zion’, ose rikthim në Zion, ky i fundit është sinonimi tradicional për Jeruzalemin dhe Palestinën.

Izraelitët besonin se Zoti i tyre ‘Yahweh’, kishte zgjedhur ato si populli i tij. Ata besonin se historia e tyre fillonte që në kohën e Abrahamit, të përcjellur tek djali i tij Isaac dhe më vonë djali i tij Jacob. Njerëzit hebre besonin se Abrahamit i ishte kërkuar të ishte themeluesi i një populli të ri në një tokë të re. Pas tij, Jacob dhe 12 djemtë e tij bashkë me familjet e tyre u shpërngulën në Goshen East (Goshen lindor) të deltës së Nilit në Egjipt. Së fundmi, pasardhësit e tyre u kthyen në skllëvër duke punuar nën presionin e dhunës. Pas 4 mije vitesh vuajtje të tilla, populli Hebre u udhëhoq drejt lirisë nga Moisiu (Moses). Sipas rrëfimeve biblike, ai ishte i dërguari i Zotit për të nxjerrë njerëzit e tij nga Egjipti drejtë tokës së Premtuar, e cila sipas Teheranit zyrtar është nga kufiri i Egjiptit deri tek lumi Eufrat.

¹⁹¹ The primary founder of the State of Israel and the first Prime Minister of Israel.

Lëvizja moderne zioniste daton nga gjysma e dytë e shekullit të 19, e frymëzuar nga nacionalizmi sekular dhe paragjykim kundërhebre në Evropën perëndimore, e veçanërisht lindore. Ishte Teodor Herzi, një Austrian çifut dhe gazetar i cili i dha Zionismit Politik leadership më efikas. Ai e konsideroi problemin Hebre një problem politik që duhej zgjidhur me veprim të menjëhershëm nga arena ndërkombëtare. Në përgjigje të librit 'Shteti Hebre' dhe botime të tjera të tij, Kongresi i parë Zionist u mbledh më 31 gisht 1879 në Basel, Zvicër dhe krijoi *Organizatën ndërkombëtare Zioniste*. Shumica e delegatëve ishin nga Evropa lindore dhe shumë prej tyre kërkonin të themelonin menjëherë shtetin hebre. Ata aprovuan një rezolutë e cila favorizonte vetëm një shtëpi në Palestinë për njerëzit Hebre.

Kongresi në Basel bëri një draft të programit ku shkruhej:

"Qëllimi i Zionismit është të krijojë për popullin Hebre një shtëpi në Palestinë e siguruar nga ligji ndërkombëtar". Kongresi studion mjetet e mëposhtme për përmbushjen e këtij qëllimi:

- 1- Përforcimin, në kushte të përshtatshme, të kolonizimit të Palestinës nga punonjës bujqësor dhe industrial.
- 2- Organizmi dhe mbledhja e të gjithë hebrenjve nëpërmjet institucioneve përkatëse, locale dhe nderkombtare, in perputhje me ligjin nderkombtar
- 3- Përforcimi i ndërgjegjes kombëtare tek hebrenjtë
- 4- Hapa përgatitore drejt marrjes së konfirmimit qeveritar, kur është e domosdoshme , për përmbushjen e qëllimit të Zionismit. ‘

Nga sa përmendet më lartë, është e qartë se qëllimi kryesor i Zionismit politik modern ishte krijimi i një shteti të pastër hebre në tokën e Palestinës. Mirëpo, jo e tërë elita çifute ishte në solidaritet me këtë lëvizje. Shumë hebrenj ortodoks kundërshtuan aspektin politik të Zionismit sepse ata besonin se një rikthim tek Zion duhej të arrihej vetëm nga ndërhyrje hyjnore dhe jo nga lëvizje politike. Hebrenj të tjerë kundërshtuan aspektet nacionaliste sepse ato besonin se Judismi ishte një fe dhe jo një kombësi. Britaniku Rabbi Hirman Eulir, në vitin 1878 argumentoi se:

“Nga koha që romakët pushtuan Palestinën ne nuk mund të konsiderohemi grup politik hebre. Ne hebrenjtë jemi të bashkuar ndaj përjashtimit politik vetëm në shtetin ku ne jetojmë, ne jemi britanik, gjerman ose francez në këtë aspekt”¹⁹²

Për më tepër, në këtë përfundim arriti edhe konferenca në Petersburg të SHBA më 1885, e cila deklaroi se: *“Ne hebrenjtë nuk jemi duke e konsideruar veten tonë si ‘komb’, por thjeshtë grup fetar. Ne madje as nuk mendojmë të kthehemi në Palestinë dhe të krijojmë atje shtetin e Izraelit”*. Gjithashtu, edhe hebrenjtë markist në ideologji, e konsideronin Zionismin një lëvizje reaksionare borgjeze.

2.ARSYET E FUQISHME PËR NJË KONFLIKT AFATGJATË

Konfliktet në Lindjen e Mesme janë të shpeshta dhe vështirë se mund të gjendet një arsye e vetme pasi çështja është tepër konfuze dhe e komplikuar. Sa i përket konfliktit izraelito-palestinez, konflikti i armatosur dhe i vërtetë ka nisur në momentet që Izraeli shkeli territorin që i ishte përcaktuar nga OKB-ja, madje duke zhvendosur edhe popullatë në territore jo të njohura ndërkombëtarisht si të sajat. Konflikti aktual lidhet me faktin se Hamas ka sulmuar pjesën jugore të Izraelit, ndërkaq që ky i fundit iu kundërpërgjigj me bombardime. Në këtë konflikt një rol iu është dhënë edhe shteteve të tilla si Egjipti dhe Irani pasi i pari ka predominancë e një vendi të madh ndërsa i dyti ka një pakicë etnike të sajën në Gaza.

2.1. Jerusalemi- Një qytet i shenjtë me tre fe monoteiste (hebreike, muslimane dhe kristiane) që u nda nga lufta e vitit 1948 në dy zona: një arabo-jordaneze në lindje dhe një hebraike në perëndim. Me luftën e vitit 1967, Izraeli posedoi edhe pjesën lindore të këtij qyteti dhe shpall kryeqytet të shtetit hebraik pa marrë një njohje ndërkombëtare. Jerusalemi ka marrë një vlerë të madhe simbolike në të gjitha marrëveshjet mes arabëve dhe izraeliteve. Në vitin 2000, çështja e sovranitetit të këtij qyteti të shenjtë ka qënë një ndër pikat kryesore të negociatave midis Arafatit dhe Barakut.

2.2.Rripi i Gazës: Një territor palestinez në kufi me Izraelin dhe Egjiptin, në afërsi të qytetit të Gazës. De facto, ai është një territor autonom dhe i vetëqeverisur që nga viti 2005. Është një rajon bregdetar me rreth 1 milion e 700 mijë banorë etnikë arabë. Së bashku me Jordaninë Perëndimore dhe Jerusalemin Lindor pretendohet të jetë pjesë e shtetit të Palestinës. Aktualisht,

¹⁹² Ben Halpen, “The idea of the Jewish state”, second edition, Harvard University, press, 1969.

qeveriset nga Hamasi për llogari të qeverisë palestineze. Kjo zonë nuk njihet ndërkombëtarisht si një shtet sovran, por pretendohet nga Autoriteti Palestinez se është pjesë e Palestinës. Në janar të v.2006, me një fitore në zgjedhjet parlamentare palestineze, Hamasi mori shumicën. Direkt pas Betejës së Gazës, Hamasi morri de facto edhe qeverinë e Rripit të Gazës. Egjipti e qeverisi Rripin e Gazës nga viti 1948 deri në vitin 1967 dhe sot kontrollon kufirin jugor të saj midis shkretëtirës së Sinait dhe Rripit. Nga Marrëveshja e Oslos, Izraeli mban kontrollin ushtarak mbi hapësirën ajrore të Rripit të Gazës, si dhe kufijtë tokësorë dhe detarë. Që nga viti 2012, OKB-ja e njeh Rripin e Gazës si pjesë të Palestinës. Catherine Shakdan, shkruan për Middle East Monitor, se qysh nga viti 2000, British Gas Company, ka raportuar se në bazë të studimeve të saj, Gaza qëndron mbi rezerva gazi natyror me vlerën 4 miliardë dollarë. Në vitin 2007, e njëjta kompani deklaroi që rezervat e gazit janë shumë më të larta dhe bëjnë që Gaza të jetë më e pasur se Kuvajti. Hamasi, që qeveris Gazën pas fitores së zgjedhjeve në territoret palestineze, ka refuzuar të lejojë përdorimin e gazit nga shteti izraelit apo një marrëveshje me të. Izraeli kërkon të mposhtë Hamasin në mënyrë që të vendosë një qeveri palestineze, me të cilën mund të arrijë në ujdi në lidhje me gazin natyral. E përditshmja izraelite Haaretz ka shkruar prej kohësh se Izraeli po përballet me krizë energjitike. Disa analistë izraelitë kanë shprehur këto ditë shqetësimin se teksa gjer më sot kanë gëzuar mbështetjen e publikut amerikan, rrjetet sociale dhe përhapja e lajmeve përtej korporatave mediatike mund të sjellin ndryshimin e opinionit publik amerikan e kjo do krijojë presion mbi politikanët amerikanë. Disa nga figurat më të njohura të hebrenjve amerikanë këto ditë janë distancuar nga shteti izraelit, sic ishte parashikuar në fakt vite më parë nga Hannah Arendt.

2.3.Refugjatët Palestinezë- refugjatët palestinez janë kryesisht Arabët dhe pasardhësit e tyre të cilët janë larguar ose kanë qënë të detyruar të largohen në periudhën e konfliktit Arabo-Izraelit në vitin 1948. OKB i definon si refugjatë palestinezë të gjithë ato persona të cilët kanë pasur vendbanim të përhershëm në Palesitinë në periudhën mes viteve 1948-1967, të cilët i kanë humbur të gjitha mjetet për egzistencë dhe e njëjta gjë i referohet edhe pasardhësve të tyre, pa marrë parasysh nëse jetojnë në kampe për refugjatë ose në bashkësi të përkohshme qëndrimi.¹⁹³ Pasardhësit e refugjatëve palestinezë janë e vetmja kategori refugjatësh që në kuadër të OKB-së

¹⁹³ Rezoluta 194 e OKB-së

ju garantohet statusi i refugjatit me vetë lindjen e tyre. Në bazë të këtij definimi, numri i refugjatëve palestinezë nga 711.000 në v.1949 është rritur në 4.7 milion deri në v.2010. Më 2012, numri i refugjatëve palestinezë, sipas të dhënave të UNRWA, ka qenë 4,950,000, nga të cilët rreth 1,5 milionë jetojnë në kampet e UNRWA. 194

2.4.Vendbanime Izraelite në Bregun Perëndimor-Në vitet pas Luftës Gjashtëditore, e sidomos në vitet 90 të shekullit të kaluar, gjatë periudhës të procesit paqësor, Izraeli ka rindërtuar bashkësitë e shkatëruara në vitin 1929-1948, por, njëkohësisht ka ndërtuar edhe lagje të reja në pjesën perëndimore në të cilin janë shpërngulur rreth 35.000 persona. Një pjesë e madhe e tyre shtrihen në pjesën perëndimore të bregut perëndimor, por pjesa e mbetur e lagjeve përfshihet në teritorin palestinez, afër qyteteve palestineze. Këto koloni janë burim i shumë konflikteve dhe sipas bashkësisë ndërkombëtare (SHBA, Britania e Madhe dhe BE) dhe mediave botërore, këto koloni janë arsya bazë për moszgjidhjen e konfliktit në mënyrë paqësore. Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Sigurimit të OKB-së i llogarisin këto lagje si jolegale dhe në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare. 195 Sipas Ministrisë të punëve të brendshme të Izraelit, në v.2012 në lagjet formalisht të pranuar në rripin Gaza jetojnë rreth 350.150 evreje dhe rreth 300.000 në Jerusalemin Lindor.

2.5.Statusi Ndërkombëtar- Me marrëveshjen e përkohshme të OSLOS, qeverisë palestineze i është mundësuar kontroll mbi qytetet (zona A) kurse rrethina e qyteteve i është dhënë në kontroll forcave të sigurisë izraelite dhe administratës palestineze (Zona B) ose në kontroll të plotë të Izraelit (Zona C). Për shkak të negociatave të shpeshta dhe propozimeve të shumta për zgjidhjen e krizës, zonat shpesh kanë hasur në ndryshime. Asnjëra nga palët nuk propozon zgjidhje afatgjatë për një hartë përfundimtare.

2.6.Shpërndarja e Resurseve: Resursi më i madh natyror me rëndësi politike në Lindjen e Mesme është uji. Përdorimi i ujit në Izrael dhe Palestinë është një problem kyç. Zgjidhja e këtij problem duhet të ndjekë rrugën e plotësimit të tre kushteve bazë:

1. Shtetet duhet të vërtetojnë të drejtën mbi resurset e caktuara të ujit;
2. Duhet të marrin vendim pozitiv për atë që vërtetojnë;

¹⁹⁴ <http://koha.net/>

¹⁹⁵ Këshilli për siguri dhe mbrojtje evropiane- Raport vjetor i Departamentit të shtetit.

3. Të gjejnë një mënyrë të përshtatshme për përdorim të ujit në bazë të dy veprimeve të lartëpërmendura.

Burime të tjera konflikti: Statusi i territoreve të okupuara, bllokimi i Gazës, hapësira ajrore, njohja ndërkombëtare dhe pranimi i palëve në mes veti, aktet terroriste palestineze jashtë Izraelit, luftimet mes HAMAS dhe FATA, e të tjera.

KONKLUZION

Prej shumë dhjetëvjeçarësh palestinezët po bëjnë një jetë të tmerrshme si “*popull refugjat*” për turpin e bashkësisë ndërkombëtare. Ata madje po qortohen si terroristë sepse nuk u ka mbetur rrugë tjetër veçse ajo e veprimeve individuale si kamikazë për të luftuar kundër makinës së rëndë e të sofistikuar të luftës që ka Izraeli. Bosnja e Kosova në Ballkan dhe Palestina në Lindjen e Mesme kanë vajtur nga pasojat më të tmerrshme të politikës shtetërore për spastrim etnik në kohët moderne. Ka një të vërtetë në pohimin se nafta bashkë me pozitat gjeostrategjike janë tani arsyet madhore të rivaliteteve në këtë pjesë të Euroazisë që shtrihet nga Ballkani në Lindjen e Mesme, duke përfshirë edhe rivalitetet në Afganistan.

Ka gjithashtu një të vërtetë në mendimin e shprehur se “*Islami është parë si kërcënim më i madh sepse sasia më e madhe e naftës botërore nxirret në Iran, Irak, Arabinë Saudite*”¹⁹⁶. Por gjithsesi analistët mendojnë se kjo do t’i largojë akoma edhe më shumë nga paqja të dy vendet.

Historiani izraelit Ilan Pape tha në një intervistë këto ditë se Izraeli ka zgjedhur të jetë një ‘*vend racist aparteidi*’ me ndihmën e ShBA-së. Të gjitha arsyet e deklaruara nga qeveria izraelite për këtë sulm më të fundit mbi Gazën janë demaskuar nga vetë qeveritarët izraelitë. Kryeministri izraelit Netanyahu deklaroi se Hamasi rrëmbeu dhe vrau tre adoleshentë izraelitë dhe për këtë duhej të paguante. Zyrtarët e policisë izraelite kanë deklaruar së fundmi se – sic dinin prej kohësh – tre adoleshentët izraelitë, në fakt, nuk ishin rrëmbyer e vrasë nga Hamasi. Gaza nuk është entitet i huaj, por territor i pushtuar nga Izraeli e si i tillë, sipas ligjit ndërkombëtar, Izraeli ka përgjegjësinë të ofrojë siguri e mbrojtje për popullsinë e atjeshme. I njëjti ligj ndërkombëtar i njeh palestinezëve, si popullsi e pushtuar, të drejtën t’i rezistojnë okupimit. Ndërkohë, edhe

¹⁹⁶ <http://shenja.mk/index.php/opinion-analize/12990-shqiptarët-që-nuk-besojnë-tek-liria.html>

zyrtarët ushtarakë izraelitë deklarojnë se periudha qysh nga marëveshja e fundit me Hamasin, pra periudha përpara këtij sulmi ndaj Gazës, ka qenë periudha me më pak sulme drejt Izraelit krahasuar me këdo periudhë më parë.

Këto ditë, nuk kanë munguar shqiptarët në politikë dhe në media që kanë deklaruar se shqiptarët nuk duhet të mbështesin Gazën, por duhet të jenë në anën e miqve të tyre si ShBA. Këta politikanë e shohin pavarësinë e Kosovës si rezultat klientelizmi politik dhe jo si e drejtë e patjetërsueshme e popujve për të jetuar të lirë e për të vendosur fatin e tyre. Sigurisht që nuk është vështirë të shohësh paralelet e qëndrimeve nacionaliste serbe qysh nga deklarimi i Kosovës si Jeruzalemin e Serbisë tek përpjekjet për të sjellë vazhdimisht kolonë serbë. E megjithatë politikanët kosovarë zgjedhin të mbështesin një rregjim kolonial më brutal se ai serb, dhe jo një popull të shtypur si ishte populli kosovar.

Kur ky ndryshim të ndodhë, atëherë ndoshta dhe qëndrimi i politikanëve shqiptarë do ndryshojë, por jo si besim tek vlera e lirisë, por si pasojë konjunkturale. Këto qëndrime shqiptare nuk i sjellin dëm palestinezëve, por një popull që beson se duhet të përqafojë oportunizmin në vend të principeve apo të mbështesë kolonializmin në vend të rezistencës, tregon që nuk ka mësuar asnjë vlerë universale nga eksperiencia e vet historike e se nuk beson tek liria. Ky qëndrim është ogur i keq për shqiptarët, më shumë se për palestinezët.

Referenca:

1. Pr.Dr Llambro Filo, "Historia Boterore, shek XX", Albin ,1995;
2. H. Kisinger , "Diplomacia" , Tirane, 1999;
3. Israel Information Center , Facts about Israel , 1995;
4. D.Ola Abu Zejd, "Zhvillimi i filozofise politike ne Islam", , shtepia botuese "Al-Shark, Kajro 2001;
5. D.Muhamed Selim Al-Aua , "Sistemi politik i shtetit islam", botim i shtepise botuese "Egjipti i ri" Kajro ,1983;
6. Sejjid Kutub , "Kjo Fe" , Shkup 1995;
7. Hasan Al Bena, "Aspekti politik i Levizjes se Vellezerve muslimane", 2000;

8. Fred J. Khouri, "*The Arab –Israeli dilemma*", second edition, Syracuse University Press, 1976;
9. Lawrence Ziring, "*The middle East Political dictionary*", Clio Press LTD, 1984;
10. Ж.Ковачевиќ, "Меѓународно преговарање", Белград, 2004;
11. Albin, "Fairnes in International Negotiation", Cambridge, 2001;
12. Charles D. Smith, "*Palestina and the Arab-Israeli conflic*"t, second edition, ST Martin press 1992;
13. Razuq As'ad, *Great Israel*, Palestine research Center, 1970;
14. David Mcdowall, "*Palestine and Israel*", IB tauris and co.l.t.d London ,1990;
15. Ben Halpen, "*The idea of a the Jewish state*", second edition, Harvard University ,press 1969;
16. , Botim I kishes Ortodokse Kopte "*Kisha dhe ceshtja kombtare*", vellimi I katert ,1994;
17. Bashkurti , Lisen, "Krizat Nderkombetare" "GEER", Tirane, 2008;
18. D.Kurtzer, S.Lasensky, "Negotiaating Arab-Israeli Peace American Leadership in the Middle East", Washington, 2008;
19. Israel Ministry of Foreign Affairs, "The Israeli-Palestinian Interim Agreement", Aneks 1, 1995;
20. Jerusalem Media and Communications Centre: Pool on Palestinian Public Opinion, 2008;
21. United Nations Office for the Coordination of Humanitarian Affairs "Israeli-Palestinian Fatalities Since 2000-Key trends", 2007;
22. World Association of International Studies, "Israel and the Palestine right of return", 2008;
23. Y.Ginosaur, "The Camp David Samit-What Went Wrong?", 2012;
24. US departamenr of State, RoadMap for Peace, 2002;
25. www.dailystar.com;

26. www.shenja.mk;

27. www.tiranaobserver.al;

28. www.sot.com.al.

ARTI I NEGOCIATAVE DHE ZGJIDHJA E KONFLIKTEVE**Msc. Ulusi BEQIRI**

e-mail: ulusi.beqiri@gmail.com

ABSTRAKT

Negociatat janë mekanizmi për shmangien e thellimit të problemeve të kontradiktave, luftërave, shuarjes së konflikteve të cilat paraqesin dukuri në marrëdhëniet ndërnjerëzore, të cilat mund të rezultojnë nga: mosmarrëveshjet, dallimet në vlerat shpirtërore dhe kulturore, perceptimet e ndryshme rreth interesave personale dhe interesave të palës tjetër, paaftësia në shprehjen e ndjenjave dhe mendimeve personale, kërkesave të papërbushura etj. Si bartës të negociatave, diplomati është ai i cili në vetvete mbart një integritet vlerash ku theksohen patriotizmi qytetar, morali, respekti për ligjin kombëtar e ndërkombëtar, moderniteti e bashkëkohësia, admirimi i paqes dhe kundërshtimi i dhunës. Diplomati apo palët negociatore duhet të formulojnë strategjinë për të përpiluar axhendën e cila do të zbatohet nëpërmjet taktikave të detajuara. Gjykimi i gjendjes së negociatave paraqet një proces që duhet të ndihmojë në vlerësimin në çdo kohë se si kundërshtari po i përfaqet negociatave.

Në fazën para mbylljes së negociatave, pra kur palët janë pranë arritjes së marrëveshjes, është me rëndësi që të verifikohet se të gjithë ndajnë të njëjtin mendim lidhur me mirëkuptimin rreth çështjeve përkatëse dhe të rikonfirmojnë atë për të cilën është rënë dakort. Vetëm pasi kjo të jetë bërë qartësisht nga palët atëherë mund të mbyllen negociatat. Mbas arritjes së marrëveshjes, aspekti themelor është zbatimi i vendimit. Vendimi i arritur nëpërmjet negociimit nuk mund të konsiderohet sukses për sa kohë nuk është zbatuar, pasi që vlera e marrëveshjes qëndron pikërisht te zbatimi i saj. Mbasi është arritur edhe mirëkuptimi për afatet kohore të zbatimit të marrëveshjes atëherë ngelet vetëm të shtrëngohen duart midis palëve në bisedime, të reagohet në mënyrë pozitive dhe të shprehet entuziazëm i domosdoshëm i palëve negociuese. Është koha finale që me respekt, besim e ngrohtësi të: “Buzëqeshni - shtrëngoni duart – të uroni njëri-tjetrin!”

Fjalë kyçe: *Negociata, konflikt, kompromis, dialog, dhunë, diplomati, strategjia, zbatimi i marrëveshjes.*

HYRJE

Ne jetojmë me mundësi të pareshtura të konfliktit ditor. Ne hyjmë në konflikte pa dëshirë, me kujdes, të zemëruar, nervoz, të sigurtë – dhe dalim prej tyre të mundur, të rraskapitur, të pikëlluar, të kënaqur, ngadhënjimtarë. Dhe ende shume prej neve i nënçmojmë ose i mbivlerësojmë meritat e konfliktit – mundësinë (shansin) që konflikti ofron çdo herë që ndodhë.

Konflikti është një dukuri që shpie në dhunë të organizuar të shkaktuar nga përfshirja e palëve, që kanë pozicione të papërputhshme për çështje të ndryshme, kanë qëndrim armiqësor dhe forma të caktuara veprimi diplomatik dhe ushtarak¹⁹⁷.

Ato paraqesin një dukuri në marrëdhëniet ndërnjerëzore, të cilat mund të rezultojnë nga: mosmarrëveshjet, dallimet në vlerat shpirtërore dhe kulturore, interesat kundërtëne, perceptimet e ndryshme rreth interesave personale dhe interesave të palës tjetër, paaftësia në shprehjen e ndjenjave dhe mendimeve personale, kërkesave të papërbushura etj.

Derisa nuk kuptohet se konflikti është problem i përbashkët që mund të zgjidhet vetëm me përpjekje dhe bashkëpunim të përbashkët, të dyja palët në konflikt nuk mund të fitojnë.

NOCIONI KONFLIKT

Nuk ekziston një teori gjithëpërfshirëse e cila i shpjegon shkaqet e konfliktit. Konfliktet ndodhin për shkak të palëve të cilat kanë qëllime ikompatibile që paraqet perceptimin subjektiv të konflikteve si dhe shkaqeve strukturale si padrejtësia, varfëria dhe jobarazia që paraqesin perceptimin objektiv. Metodologjia e analizës bazohet në aspektin historik të konfliktit, problemin themelor dhe palët e përfshira në konflikt, në kontekstin global dhe rajonal si dhe përvojat e përfituara nga konfliktet e mëhershme apo që kanë ndodhur diku tjetër.

Duke u nisur nga rrethanat specifike dhe karakteristikat e çdo konflikti, i cili kërkon zgjidhje, në varësi të natyrës së tij, objektiv kryesor qoftë i palëve të përfshira në konflikt, qoftë i palës së tretë, e cila ndërhyr në rolin e ndërmjetësit në mes palëve, në fazën e zhvillimit të konfliktit është parandalimi i konfliktit të dhunshëm, moment ky cili përcakton të ardhmen jo

¹⁹⁷ Lisen Bashkurti, Krizat ndërkombëtare fq.236 Tiranë 2008

vetëm për zgjidhjen e konfliktit, por edhe për shumë situata postkonfliktuale. Sot në botë ekzistojnë shembuj nga më të ndryshmit se si intervenimi i vonë në konfliktet të cilat janë injoruar ka ndikuar që të zgjerohen format e tyre të dhunshme me këtë edhe pasojat, rajonale e globale siç ndodhi në Bosnjë dhe Hercegovinë apo edhe në Ruandë.

NDËRMJETËSIMI SI FORMË E PARANDALIMIT TË KONFLIKTEVE

Ekzistojnë forma të ndryshme të parandalimit të konfliktit të cilat përcillen me metoda relevante në varësi të natyrës së konfliktit. Njëra ndër to është, parandalimi sipërfaqësor i cili arrihet duke parandaluar konvertimin e konfliktit latent në konflikt të hapur dhe të armatosur e cila arrihet nëpërmjet diplomacisë zyrtare dhe jo zyrtare, ndërmjetësimit, presionit të fuqive të jashtme, sanksioneve e deri te vendosja e trupave paqëruajtëse¹⁹⁸.

Ndërmjetësimi më së shpeshti definohet si intervenim i palës së tretë në negociata ose në konflikt e cila është e pranueshme për të dyja palët të përfshira në konflikt. Përveç marrëveshjeve dhe bisedimeve si koncepte bashkëkohore të zgjidhjes së konflikteve posaçërisht dallohen ndërmjetësimi dhe arbitrazhi.

Procedurat e ndërmjetësimit janë të bazuara në zgjidhjen e pranueshme për të gjitha palët në konflikt. Si pikënisje shërben parimi se konfliktet më lehtë zgjidhen nëse në plan të parë vendosen interesat e palëve, e jo forca dhe e drejta.

Zgjidhja paqësore supozon vendosjen e komunikimit mes palëve, analizën dhe të kuptuarit e drejtë të të gjitha elementeve që janë shkaktarë të konflikteve.

Po ashtu zgjidhja e konfliktit varet ngushtësisht nga analizimi i komponentëve, të cilat janë pjesë esenciale e çdo konflikti, siç janë: palët në konflikt, çështjet konfliktuale, tensionet si dhe veprimet. Gjithashtu edhe bashkëpunimi nënkupton punën e përbashkët drejt zgjidhjes së konfliktit, dhe mundëson mbledhjen e informatave si dhe një lloj zgjidhjeje të problemit. Për të bashkëpunuar, ju dhe kundërshtari juaj duhet të jeni në gjendje si dhe të keni vullnet për të dhënë kontributin në kohë, energji dhe mjete për gjetjen dhe zbatimin e zgjidhjes.

¹⁹⁸ Lisen Bashkurti, Krizat ndërkombëtare fq236 Tiranë 2008

Ekzistojnë lloje të ndryshme të konflikteve, të cilat mund të klasifikohen në varësi të natyrës së tyre, materiale siç janë: territoriale, politike, për institucione, si dhe konflikte për ekonominë legale dhe ilegale. Kurse në anën tjetër konflikte të cilat kanë të bëjnë me përplasjen e ideve, siç janë: konflikte etnike, fetare, ideologjike, konflikte që shënojnë mosmarrëveshje në rang botëror.

NAFTA- BURIMI QË MUND TË SJELLË KONFLIKT

Në këtë botë të ndërtimit të mozaikut të ri të rendit botëror nafta¹⁹⁹ është lënda e parë më e rëndësishme në botë, si në terma ekonomikë, ashtu edhe politikë që mund të sjell deri te ndonjë konflikt të përmasave më të mëdha. Ka qenë në të kaluarën dhe do të mbetet dhe në të ardhmen si njëri ndër burimet kyçese që mund të sjellë deri te ndonjë konflikt, meqë është njëra ndër pasuritë më të mëdha që kontribuon me të madhe në të ardhurat e një shteti, po dhe politikave të shteteve në mes, me çka mund të sjellë deri tek ndonjë destabilizim në rendin botëror.

Nafta është lënda e parë dhe më e rëndësishme në botë. Ndërvarësia në një rajon të caktuar ndodh shpeshherë brenda një kuadri rregullash, normash e institucionesh, që quhet regjim. Me kalimin e dekadave, regjimi ndërkombëtar i naftës ka ndryshuar në mënyrë dramatike. Në vitin 1960, regjimi i naftës ishte oligopol privat, me lidhje të ngushta me qeveritë e vendeve më të mëdha konsumatore të naftës. Çmimi i naftës varej nga sasia që prodhohin kompanitë e mëdha dhe nga kërkesa e vendeve të pasura, të cilat blinin shumicën e naftës. Kompanitë transnacionale përcaktonin ritmin e prodhimit, ndërsa çmimet përcaktoheshin nga situatat në vendet e pasura.

Pas vitit 1973 vërehet një pikë vendimtare kthese në regjimin ndërkombëtar të naftës. Vendet prodhuese përcaktuan ritmin e prodhimit, duke shkaktuar, në këtë mënyrë, një efekt të fortë mbi çmimin, duke mos e përcaktuar më atë ekskluzivisht nga tregu i vendeve të pasura. Gjatë shekullit XX²⁰⁰, politikat e naftës ka gjasa të bëhen edhe më komplekse, ndonëse kompleksiviteti do të varet nga larpamësia dhe zgjuarësia jonë kolektive. Nafta nuk është burim i pa rinovueshëm, dhe nëse vazhdojmë ta nxjerrim me ritëm të lartë, një ditë ka gjasa të shterojë

¹⁹⁹ Joseph S.Nze, Jr| David A.Welch, Konflikti dhe Bashkëpunimi në Marrëdhëniet Ndërkombëtare, fq.455, Tiranë, 2014.

²⁰⁰ Joseph S.Nze, Jr| David A.Welch, Konflikti dhe Bashkëpunimi në Marrëdhëniet Ndërkombëtare, fq.465, Tiranë, 2014

dhe të paraqitet konflikt në rangun botëror me çka mund të vijë deri te ndonjë mosmarrëveshje mes vendeve. Ndërkohë, nafta do të vijojë të zërë vend të spikatur në politikën globale. Andaj bëhet e nevojshme që të kërkohet një zgjidhje e cila do të çojë deri te shuarja e konfliktit të mundshëm dhe ruajtja e paqes në vend dhe në botë.

FORMAT E ZGJIDHJES TË KONFLIKTEVE

Shpeshherë parakusht jo vetëm për zgjidhjen e konfliktit por edhe për parandalimin e tyre janë: zhvillimi ekonomik, ndryshimet politike dhe kushtetuese, zhvillimi i kulturës politike.

Githashtu dhe gjuha me të cilën flasim ndikon nëse ne do të ngujohemi në konflikte apo do t'i ndalojmë ato të cilat janë të panevojshme. Gjuha negative përçon imazh të keq të bashkëbiseduesi dhe tek të tjerët përreth. Nganjëherë ajo shkakton konflikt dhe kundërvënie kur nuk është e nevojshme dhe kur askush nuk e do atë. Andaj duhet të ushtrojmë gjuhën pozitive që të jemi më të suksesshëm në konflikte të cilat do t'i zbusim dhe do t'i kalojmë me sukses.

Ndër metodat kryesore të treguara si më efikase për zgjidhjen e konflikteve janë: ndërhyrja e një pale të tretë, grupet e synuara, negociatat, arbitrazhi, si dhe ndërmjetësimi.

Domethënë kjo strategji e quajtur “ndërhyrje kërkimore”, konkretisht përfshin thirrjen e një pale të tretë për të vepruar si ndërmjetësues konflikti. Ndonjëherë konflikti nuk mund të zgjidhet vetëm me pjesëmarrjen e personave që kanë mosmarrëveshje. Ndërmjetësuesit ndihmojnë për të zgjidhur konfliktin duke lehtësuar komunikimin.

NEGOCIATAT SI FORMË E ZGJIDHJES SË KONFLIKTEVE

Negociatat janë forma të bisedimit, komunikimit dhe dialogut dy ose shumëpalësh për zgjidhjen e problemeve të çfarëdolloji. Negociatat janë të vjetra sa edhe vet historia e njerëzimit. Ato janë rruga më e drejtë për kapërcimin e kontradiktave, mospërputhjeve apo divergjencave të ndryshme, janë afrimi drejt zgjidhjeve që ofrojnë palët e ndryshme apo të kundërta drejt një kompromisi që pranohet prej tyre dhe që prodhon marrëveshjen e qëndrueshme.

Negociatat janë rruga më e mirë e kompromisit. Ato janë mekanizmi për shmangien e thellimit të problemeve të kontradiktave apo konflikteve, janë zgjidhja që prodhojnë më së shumti fitues dhe më së paku humbës. Negociatat janë produkt i nevojës për të shmangur

tensionet, kontradiktat, konfliktet dhe luftërat. Ato burojnë nga nevoja për mirëkuptim njerëzor, nga nevoja për paqe, nga domosdoshmëria për zgjidhje të çfarëdolloj problemi midis palësh, me anë të bisedimeve, të këmbiimit të ideve, informacioneve, dhënies së propozimeve dhe nxitjes mbi bazën e tyre të dialogut dypalësh apo shumëpalësh.

Sa më thellë që futemi në labirintet e historisë, aq më pak ndeshim negociata si formë apo mënyrë e zgjidhjes së problemeve dhe aq më tepër ndeshemi me rrugë e forma të tjera siç janë imponimi, dhuna, forca e konfliktit. Ndërkaq sa më tepër që u afrohem kohëve moderne e sa më shumë që kemi të bëjmë me rritjen e konsolidimit të elementeve të civilizimit, aq më shumë shohim të rritet prania e negociatave, përdorimi dhe vlerësimi gjithnjë e më i madh i tyre si rruga më e mirë, më e drejtë dhe më me pak kosto për zgjidhjen e çdo problemi duke arritur marrëveshje mes dy palëve apo më shumë palëve.

Në negociata udhëheq aryeja mbi gjithçka. Armët në negociata janë argumentet, faktet, të dhënat, aktet ndërkombëtare. Pra, të dhënat, faktet, aktet- janë armët më të përdorura në negociata.

Negociatat janë produkt i aryetimit njerëzor dhe në vetvete, nga ana e tyre prodhojnë zgjidhje të arsyetueshme. Për sa kohë që negociatat udhëhiqen nga arsyeja dhe jo nga emocionet, udhëhiqen nga të dhënat dhe jo nga subjektivizmat, udhëhiqen nga faktet dhe jo nga mashtrimet, udhëhiqen nga aktet dhe jo nga interesat – do të thotë se rruga e negociatave është rruga më e mirë për zgjidhjen e problemeve të çfarëdolloj natyre dhe ndërmjet çfarëdolloj palësh.

Zgjidhja me anë të negociatave është më e qëndrueshme sepse është vepër e arsyeshme, bazuar në të dhëna, fakte dhe akte, është zgjidhje e përbashkët pra bashkëautorësi, as humbës dhe fitues, nga ku palët dalin pa ndjenja inferioriteti dhe epërsie mbi njëra-tjetrën, dalin pa u fyer dhe pa u mburur, rezultati është me një kosto të lirë dhe të leverisshme gjithashtu për të dyja palët.

NEGOCIATAT-ART I ZGJIDHJES TË PROBLEMEVE

Pra, negociatat janë arti i zgjidhjes së problemeve dhe konflikteve me anë të bisedimeve dy apo shumëpalëshe. Vendi e roli i tyre ka ardhur duke u rritur me zhvillimin e shoqërisë

njerëzore, të rendeve politiko-shoqërore dhe të sistemeve të marrëdhënieve dhe të drejtës ndërkombëtare²⁰¹.

Njerëzimi ka ardhur duke e konsideruar gjithnjë e më shumë rëndësinë e negociatave sepse negociatat prodhojnë zgjidhjen më të mirë, pasi shmangin zgjidhjet me sanksione, penalitete dhe forcë; prodhojnë zgjidhje më të shpejta; ofrojnë zgjidhje me kosto më të lirë e të favorshme për palët; dhe së fundi prodhojnë zgjidhje më të qëndrueshme dhe afatgjate.

Çdo negociatë e suksesshme normal që duhet të udhëhiqet dhe nga individ apo grup negociatorësh të suksesshëm, andaj dhe formimi i grupit apo ekipit negociator është njëri prej hapave shumë me rëndësi në tërë procesin e negociatave. Emërimi më i ndjeshëm në grupin negociator, është gjithësesi emërimi i personit që do ta udhëheqë këtë grup, dhe njëherit do t'i udhëheqë dhe negociatat. Ky person është diplomati profesionist që mbart mbi supe përgjegjësinë e përfaqësimit ndërkombëtar, të vlerave dhe të interesave të popullit e të vendit në arenën ndërkombëtare.

Si mjeshtër i negociatave, diplomati mbart në vetëvete një integritet vlerash ku mpleksen patriotizmi qytetar, morali, respekti për ligjin kombëtar e ndërkombëtar, moderniteti dhe bashkëkohësia, admirimi i paqes dhe kundërshtimi i dhunës.

Diplomati është profesion i përgjegjësive më të larta njerëzore. Ndaj diplomati ka një sërë tiparesh të karakterit siç janë qetësia, vetëpërmbajtja, durimi, vendosmëria, elokuenca, gjuha e kulturuar, pasuria e argumenteve, buzëqeshja, etj.

Për t'u bërë negociator i mirë duhet mësuar për të lexuar mirë nevojat e palës tjetër të kundërt, kurdoherë duhet mbajtur në mendje se nuk ka gjithnjë mundësi e kohë të mjaftueshme për negociatorët për t'u përgatitur sa duhet.

Gjithashtu negociatat duhen nisur duke paraparë mundësinë e fitores dhe jo të humbjes. Palët duhen përgatitur për kompromis ndërsa hyjnë në negociata. Lypet të vendoset qartësisht strategjia në përputhje me tipin, llojin, formën dhe kategorinë e negociatave.

²⁰¹ Lisen Bashkurti, Praktika e negociatave fq398 Tiranë 2007

Pala e interesuar që emëron një agjent si negociator, duhet të përcaktojë qartësisht përgjegjësitë e agjentit. Dhe ndërsa vendoset të shkohet në negociata, nevojitet përgatitje, të dihet se ku mund t'i bëhen lëshime palës tjetër, ose ku nuk mund të bëhen.

Ka çështje në proces negociimi që janë të pakapshme menjëherë ose të papërceptueshme për momentin. Në këtë rast, ajo çështje duhet të përcaktohet qartësisht përpara se të vijojë procedimi i mëtejshëm i negociatave.

Në thelb negociatat parakuptojnë që palët në proces janë të vullnetshme për të arritur kompromise mbi çështjet që diskutohen.

Çdo gjë që implikon apo detyron palën tjetër, përbën implikim dhe detyrim edhe për palën ose palët e tjera në negociata.

PROCESI I ZGJATJES TË NEGOCIIMIT

Pas fazës përgatitore, në të cilën palët negociatore kanë marrë njohuri të mjaftueshme për dëshirat dhe qëllimet e palës tjetër, mund të fillojnë negociatat e drejtpërdrejta. Kontaktet e drejtpërdrejta që vendosen ndërmjet palëve negociatore shërbejnë edhe për vlerësimin e palës tjetër negociatore.

Mënyra në të cilën një palë i zhvillon negociatat, shkalla e organizimit edhe e efikasiteti të saj, mënyra e marrjes së vendimeve brenda grupit negociator, logjika me të cilën paraqiten argumentet, taktika brenda grupit negociator, logjika me të cilën paraqiten argumentet, taktika dhe butësia në komunikim – të gjitha këto i shërbejnë palës tjetër për ta vlerësuar partnerin me të cilin negocion.

Nëse përshtypja është më e keqe nëse elementet e tjerë janë të kënaqshëm, partneri i jashtëm mund të heq dorë nga lidhja e kontratës. Në procedurën e negociimit shfaqen dy grupe të çështjeve themelore. Nga njëra anë, paraqiten problemet lidhur me organizimin fizik të negociatave, kurse nga ana tjetër, bëhet fjalë për çështjet e strategjisë dhe të taktikës që do ta ndihmojnë në zhvillim e negociatave në mënyrë që ta bindim palën tjetër që me ne të lidhë kontratën e cila do t'i plotësojë kërkesat tona.

Pas përcaktimit të qartë të objektivave të veta²⁰², madje edhe të objektivave hipotetike të palës kundërshtare negociuese si dhe të prioritizimit të tyre, është momenti që të përgatitet strategjia për arritjen e objektivave deri për përfundim të negociatave.

Formulimi i strategjisë²⁰³ kërkon angazhimin e kapaciteteve më të mira të ekipit negociator, sepse përbën një nga detyrat më të vështira që kërkon dije, njohje, përvojë dhe aftësi negociuese të larta.

Strategjia është një politikë përgjithshme e përpiluar për të arritur një numër objektivash të pacaktuara dhe të specifikuara, ndërkaq taktikat janë metodat e detajuara që nevojiten të përdoren për të zbatuar strategjinë e përpiluar.

Gjatë formulimit të strategjisë duhen parë me kujdes dinamika e njerëzve të ekipit negociues në marrëdhënie me shkaqet, subjektin dhe ecurinë e negociatave si dhe të zgjidhen negociuesit që kombinojnë në vetvete mençurinë, kulturën, forcën dhe aftësinë për arritjen më të mirë të objektivave të ekipit negociues.

Në strategjinë është e paraparë mënyra dhe metodat se si do të zhvillohen taktikat, sa njerëz do të jenë të nevojshëm për ekipin negociator, sa kohë do të duhet për formulimin e strategjisë, a është e domosdoshme që të gjithë anëtarët e ekipit të ndjekin gjithë procesin negociues apo jo; kur mund të bëhen provat për rolet e secilit dhe taktikat që duhen aplikuar.

Në shumicën e tipeve të negociatave është e nevojshme të bëhet paraprakisht axhenda, ku do të përfshihen lista e çështjeve që do të debatohen. Përpilimi i axhendës është me rëndësi të përdoret si moment që t'i shërbejë arritjes së marëveshjes nga gjithë palët përpara fillimit të negociatave.

Ajo përmban fushat mbi të cilat bisedohet kështu që nëse përpilimi i njëanshëm rrezikon klimën e negociatave, atëherë axhenda bëhet në bashkëpunim midis palëve përpara fillimit të procesit negociues.

²⁰² Branko Vukmir, *Strategjia dhe teknika e negocimit* fq 116 Prishtinë 2007

²⁰³ Lisen Bashkurti, *Praktika e negociatave* fq 498 Tiranë 2007

Negociatat janë sa dëgjim aq dhe vëzhgim dhe bisedim. Kjo e bën domosdoshmëri vëmendjen vigjilente ndaj gjendjes, mënyrës, humorit të negociatave dhe negociuesve. Mënyra, gjendja apo humori i negociatave mund të ndryshojë shumë shpejtë, varësisht procesit. Kjo kërkon vigjilencë të lartë për t'u kapur çdo sinjal që mund të vijë nga pala tjetër negociuese.

Përgjatë procesit të negociatave duhen vëzhguar me shumë kujdes reagimet dhe mesazhet që rrjedhin nga pala tjetër. Në mënyrë të veçantë duhet hetuar për të kapur ndonjë inkosistencë qëndrimesh e gjendjesh.

Negociatat preferohen që të fillojnë me pika që përgjithësisht nuk janë kontradiktore, pra me pika që kanë kuptim të përbashkët, gjithashtu duhet theksuar nevoja për arritjen e marrëveshjes qysh në fillim të negociatave duke i kushtuar vëmendje përmbajtjes së fjalëve, tonit dhe nuancave të fjalëve me të cilat ato thuhën.

Bërja e propozimeve është detyrë themelore e çdo negociate. Padyshim që është jetike që të vendoset nëse do të qëndrohet në pozicionin e reagimit ndaj propozimeve të bëra fillimisht nga pala tjetër, apo të merret iniciativa për të bërë propozimet e veta. Ky vendim konsiderohet nga teoria dhe praktika e negociatave si fundamental për strategjinë e negociatave.

Negociatori i lejon vetes mjaft hapsirë për të monovruar gjatë paraqitjes së çështjes së tij. Nuk sugjerohet të bëhen deklaratime eksplicit të mbyllura, që i japin kuptueshmëri të palëvizshme opsionit të paraqitur. Propozimet është mirë të bëhen në mënyrë hipotetike apo supozuese, me qëllim që t'i lënë hapsirë të dy palëve për të mundur të bëjnë konçesionet e duhura.

Në kuadër të përgatitjeve²⁰⁴ të mira bëjnë pjesë edhe njohuritë për atë se me kë do të zhvillojmë negociata. Nëse kemi paralajmërime për një grup negociatorësh të palës tjetër, duhet të përpiqemi që të mësojmë se cila është pozita dhe çfarë janë autorizimet e tyre, përvojat e dituritë e tyre për temën për të cilën do të diskutohet, dhe çfarë janë cilësitë e tyre negociuese.

Është me rëndësi të kuptohet përbërja e grupit negociator të palës tjetër, përkatësisht se a bëhet fjalë për nëpunësit e kryeorganizatorit të punës ose për nënkontaktuesit e tij apo për ekspertë dhe këshilltarë të pavarur. Njohuritë për pozitën e secilit anëtar të grupit negociator të palës tjetër na ndihmojnë që të përqëndrohemi me kujdesin më të madh në ata me të cilët më së

²⁰⁴ Branko Vukmir, *Strategjia dhe teknika e negocimit*, fq. 120 Prishtinë 2007

shumti do të komunikojmë dhe çfarë rëndësie duhet t'u japim deklaratave të disa prej anëtarëve të grupit negociator.

OBJEKTI, QËLLIMI DHE ROLI I NEGOCIATAVE

Qëllimi i negociatave është arritja e pajtueshmërisë me palën tjetër negociatore. Këtu mund të bëhet fjalë për lidhjen e kontratës, për arritjen e ujdisë, për zgjidhjen miqësore të ndonjë kontesti ose çështjeje të paqartë.

Pa marrë parasysh objektin e negociatave, çdo negociator dëshiron që pala tjetër t'i pranojë pikëpamjet e tij dhe mbi këtë bazë të arrihet marrëveshja. Duke pasur parasysh faktin se pa pëlqimin e ndërsjellë nuk mund të arrihet kurrëfarë marrëveshjeje, është e natyrshme që të gjithë negociatorët janë, para së gjithash, të interesuar që ta bindin palën tjetër që ta pranojë qëndrimin tonë, përkatësisht ta pranojë zgjidhjen që ne ia propozojmë dhe e cila për ne është e pranueshme.

Negociatat kanë për qëllim gjetjen e zgjidhjes, e pothuajse nuk ka situatë të tillë për të cilën nuk do të mund të gjendej zgjidhja. Arti i negociatave konsiston në përpjekjen për të pajtuar atë çfarë është e pranueshme dhe e mirë për gjithë palët. Për të arritur në një situatë ku palët të fitojnë dicka për veten e tyre është e nevojshme që të bëhet përgatitje e mirë, të ketë vigjilencë dhe fleksibilitet.

Në fazën para mbylljes së negociatave, pra kur palët janë pranë arritjes së marrëveshjes, është me rëndësi që te ato në bisedime të verifikojnë edhe njëherë që ndajnë të njëjtin mendim lidhur me mirëkuptimin rreth çështjes përkatëse dhe të rikonfirmojnë atë për të cilën është rënë dakort. Vetëm mbasi kjo të jetë bërë qartësisht nga palët atëherë mund të mbyllen negociatat.

Mbas arritjes së marrëveshjes, pavarësisht nëse është arritur me kompromis negociues të drejtpërdrejtë, me ndërmjetësim të një pale të tretë, me arbitrazh apo gjykatë, aspekti themelor është zbatimi i vendimit.

Zbatimi i vendimit nuk mund t'i lihet spontanitetit. Zbatimi i vendimit është pjesë e të njëjtit proces që ka nisur qysh me negociatat dhe ka konkluduar me marrëveshjen midis palëve.

Për zbatimin e marrëveshjes, palët mund të ndjekin disa alternativa. Ato mund të caktojnë një grup të përbashkët njerëzish, të cilët do të përpilojnë palnin e veprimit dhe do të ndjekin veprimtarinë për zbatimin e tij. Ose, palët mund të caktojnë një trup të pavarur që do të mbykqyrë zbatimin e marrëveshjes. Është e mirë që plani i veprimit dhe alternativave për zbatimin e tij të vendosen sa më shpejtë mbas firmosjes së marrëveshjes, sepse përndryshe pala, ose palët firmosëse do të mund të përballen me sanksione që rrjedhin nga kalimi i afateve kohore të parashikuara në termat e firmosura për zbatimin e marrëveshjes. Sanksionet mund të jenë të natyrës së veprimit ligjor apo të penalteteve financiare.

Vendimi i arritur nëpërmjet negociimit nuk mund të konsiderohet sukses për sa kohë nuk është zbatuar. Vlera e marrëveshjes së arritur qëndron pikërisht te zbatimi i saj.

Mbasi është arritur edhe mirëkuptimi për afatet kohore të zbatimit të marrëveshjes dhe planin e veprimit në këtë aspekt, atëherë ngelet vetëm të shtrëngohen duart midis palëve në bisedime, të reagohet në mënyrë pozitive dhe të shprehet entuziazëm i domosdoshëm i palëve negociuese.

KONKLUZION

Negociatat, sado të vështira që të jenë, sërish ato janë më të dobishme, përbëjnë kosto më të ulët dhe prodhojnë zgjidhjet më të drejta dhe më të qëndrueshme. Diplomatët, si mjeshtrit e negociatave lypet ta perfeksionojnë artin e negociimit për veten e tyre, por edhe për ta përhapur atë gjithnjë e më shumë si tipar dhe virtyt i ndërgjegjes dhe kulturës së lartë njerëzore.

Sa më tepër që i afrohem kohëve moderne e sa më shumë që kemi të bëjmë me rritjen e konsolidimit të elementeve të civilizimit aq më shumë shohim të rritet prania e negociatave, përdorimi dhe vlerësimi gjithnjë e më i madh i tyre si rruga më e mirë, më e drejtë dhe më me pak kosto për zgjidhjen e çdo problemi dhe arritjen e marrëveshjeve midis dy apo më shumë palëve.

Sa më i lartë të jetë civilizimi njerëzor aq më shumë rritet prania, përdorimi dhe vlerësimi i negociatave. Negociatat janë, kështu, një tregues shumë i plotë i pjekurisë së shoqërisë njerëzore dhe institucioneve të krijuara prej saj. Niveli i ulët i pranisë, përdorimit dhe vlerësimit të

negociatave shpreh nivelin e ulët, të civilizimit dhe të institucioneve të një shoqërie të caktuar apo të një sistemi marrëdhëniesh ndërkombëtare.

Pra, negociatat janë rruga më e mirë dhe më e drejtë për zgjidhje me mirëkuptim paqësisht të problemeve në çdo fushë midis dy apo më shumë palëve, janë mekanizmi që prodhon konsensusin dhe kompromisin ndërmjet tyre, janë mënyra më ekonomike e kapërcimit të çdo krize si dhe instrumenti që dhuron zgjidhjen më afatgjatë dhe më të qëndrueshme.

Referenca:

1. Branko Vukmir, 2007, *Strategjia dhe taktika e negocimit*, Prishtinë.
2. Joseph S.Nze, Jr| David A.Welch, 2014, *Konflikti dhe Bashkëpunimi në Marrëdhëniet Ndërkombëtare*, Tiranë.
3. Lisen Bashkurti, 2007, *Praktika e negociatave*, Tiranë.

TOURISM

**TURIZMI NË HOTESH (LUZNI) TË DIBRËS NËPËRMJET NJË ESEJE
KLASIFIKUESE DHE VLERËSIMI SIPAS ANALIZËS “SWOT”**

Prof. Asoc. Dr. Arif MURRJA

Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit

amurrja@ubt.edu.al

Dr. Ilir TOMORRI

Universiteti Bujqësor i Tiranës, Shqipëri

itomorri@ubt.edu.al

ABSTRAKT

Fshati Hotesh në Luzni të Dibrës, në Shqipëri ofron turizm të llojeve të ndryshme. Promovimi i turizmit ndikon në zhvillimin ekonomik, jo vetëm të këtij fashti, por edhe të krahinës Luzni. Artikulli është organizuar si gërshetim i esesë klasifikuese letrare me esenë shkencore. Qëllimi i punimit është promovimi i turizmit, si dhe evidentimi i përparësive, dobësive, mundësive dhe kërcënimeve. Për të promovuar turizmin janë shfrytëzuar burimet historike, arkeologjike, gjeografike, natyrore, kulturore, etnografike dhe folklorike, ndërsa për të evidentuar përparësitë, dobësitë, mundësitë dhe kërcënimet e turizmit është aplikuar analiza “SWOT”. Në përfundim rekomandojmë vizitorët që të zgjedhin si destinacion turistik, fshatin Hotesh në Luzni të Dibrës sepse aty do të gjejnë qytetrimet parahistorike, mesjetare, do të gjejnë male, parqe, lumenj, liqene me pamje çlodhëse, do të gjejnë florë dhe faun të larmishme dhe së fundi do të gjejnë një mikpritje dhe bujari nga më të rrallat jo vetëm në Dibër, por edhe në Shqipëri.

Fjalët kyçe: *Trevë, turizëm, vizitorë, zhvillim dhe promovim.*

HYRJE

Hoteshi është një nga gjashtë fshatrat me të hershme të njësisë administrative Luzni²⁰⁵ (ish komunë) në Bashkinë e Peshkopisë në Dibër. Ky fshat është i vendosur në juglindje të kësaj njësie administrative dhe shtrihet nga brigjet e lumit Drini i Zi, duke u kufizuar në jug me Gurrën

²⁰⁵ Njësi administrative (ish komuna) Luni ka në territorin e saj gjashtë fshatra, të cilat janë Hotesh, Katundi i Ri, Arap i Epërm, Arap i Poshtëm, Lishan i poshtëm dhe Lishan i Epërm.

e Mazhicës dhe pyjet e Lagavishtës deri në fshatin Shpukth, në perëndim me fshatin Gjuras nëpërmjet kodrave të Çenzës e pyllit të Zojës (fshatra të njësisë administrative Shupenzë në Bashkinë Bulqizë), në veriperëndim me gurrën e vet fshatit Hotesht, që është kufiri ndarës me fshatrat Katundi i Ri e Lishan i Poshtëm (fshatra të njësisë administrative Luzni). Me fshatin Lishan i Poshtëm vazhdon ndarja me përroin e Kusares dhe mbyllet ky kufi në lagjen Murate në kodrat e Çenzës. Nga gojdhënat e banorëve të këtij fshati në breza e shekuj “Hotesht” do të thotë zjarr, flakë. Fshati është pagëzuar me këtë emër sepse në kështjellën/kalanë e saj dhe fortesat përreth janë zhvilluar luftra të përgjakshme. Fshati ka dy lagje: Mëhalla e Epërme dhe Mëhalla e Poshtme.

Hoteshti, ashtu si treva Dibrës ka një klimë mesdhetare me tipare kontinentale të ndjeshme. Dimri është i ftohtë, ndërsa vera mban e ngrohtë. Reshjet zënë zakonisht 100-115 ditë të vitit, mesatarisht në dimër 12 ditë në muaj, ndërsa në verë 5 ditë në muaj. Dëbora mbullon sipërfaqen e trevës rreth 40 ditë të vitit (Frashëri 2012).

1.BALLAFAQIMI ME LITERATURËN PËR PROBLEMET E TRAJTUARA

Për turistët e huaj që vendosin të vizitojnë Dibrën, por edhe për ata vendas, për të “konsumuar” dhe shijuar turizmin: historik/qytetar; arkeologjik; gjeografik, malor, të bardhë, të ujrave të ëmbla duhet të shkojë në një nga vendet më të bukura të trevës së Dibrës, fshatin Hotesht në Luzni. Përpara se të vendosni të zgjidhni Hoteshtin për destinacionin turistik duhet të keni parasyshë, jo vetëm cilësitë dhe bukuritë e resurseve turistike, por edhe mikpritjen dhe bujarinë e banorëve të Hoteshtit. Më poshtë po prezantojmë llojet e turizmit sipas grupeve dhe nëngrupeve. Duke vizituar Hoteshtin në Dibër do të njiheni me:

Së pari, me turizmin historik/qytetar:

- 1) **Lashtësia.** Jeta në lashtësi në këtë fshat vërtetohet shkencërisht me rritjen deri në ditët e sotme të ariut të shpellës, dërrit të egër, dhisë së egër etj. Në juglindje të fshatit ndodhet Shpella e Arushës (Ariut).
- 2) **Parahistoria e fshatit Hotesht.** Nga gërmimet arkeologjike gjurmë të lashta të kësaj epoke janë zbuluar në Tumën e Zojës në Mazhicë (Bunguri 2010:34 & Frashëri 2012:162). Më poshtë do të shpjegojmë lidhjen e Kështjellës/Kalasë së Zojës me Kështjellën/Kalanë e

Hoteshit dhe varësia e tyre nga Kështjella/Kalaja e Grezhdanit (ish qytet ilir Uskana Uscana²⁰⁶).



Figura 1. Fshati Hotesh në Dibër (marrë në google)

3) **Antikiteti i fshatit Hotesh.** Sipas burimeve të shkruara historike, treva dibrane ka qenë Penestia ose toka e Penestëve dhe penestët banorët e saj. Fshati Hotesh, si pjesë e Penestisë konfigurohet në hartën e vendbanimeve antike (Frashëri 2012:52).

a) **Kështjella e Hoteshit në Dibër**²⁰⁷, ndodhet në jug të fshatit me të njëjtin emër, në krahun e majtë të rrjedhës së Drinit të Zi, 740 m mbi nivelin e detit e njohur nga vendasit me toponimin Kalaja e Qytezës ose Kodra e Kalasë. Ajo zotëron një pozitë gjeografike të favorshme për këtë zonë nga e cila mund të vrojtohet një pjesë e madhe e pellgut të Peshkopisë, në veri të Kështjellës së Volezës (Suhadollit ose Sohodollit) dhe në lindje Kalanë e Grazhdanit. Pjesa jugore e kodrës ku është ndërtuar kështjella është mjaft e thepisur dhe kufizohet nga përroi i Gurrës së Mazhicës, anë kjo me një mbrojtje të sigurt natyrore. Kështjella e Hoteshit ka një sipërfaqe afro 0.5 ha. Forma planimetrike e saj është e çrregullt pasi muret ndjekin me rreptësi të madhe izoipset e kodrës. E gjithë kështjella është e fortifikuar prej një kulle në trajtë katrore (Përzhita 2004).

b) **Fortesa e Videnit**, ndodhet në juglindje të Kështjellës/Kalasë së Hoteshit, rrëzë lumit Drini i Zi. Fortesa shërben si pik lidhje e Kështjellës/Kalasë së Hoteshit me Kështjellën/Kalanë e Grazhdanit dhe Kështjellën/Kalanë e Gradecit.

c) **Fortesa e Zojës**²⁰⁸, ndodhet rrëzë Gurrës dhe Livadheve të Mazhicës në kodrën më të vogël, në veriperëndim të Kështjellës/Kalasë së Hoteshit. Ekzistencën e

²⁰⁶ Sipas Tit Livit, Uskana ishte qyteti kryesor i penestëve me rreth 10.000 banorë (Frashëri 2012:47).

²⁰⁷ Sipas arkeologut Luan Përzhita në revistën "Candavia", botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Arkeologjisë, Departamenti i Antikitetit të Vonë dhe Mesjetës e përshkruan Kështjellën/Kalanë e Hoteshit.

²⁰⁸ Sipas arkeologut Adem Bunguri kjo fortesë quhet Tuma e Zojës dhe është vendbanim parahistorik (Bunguri dhe Frashëri).

fortesës e vërtetojnë toponimet e sotme, si: Fortesa e Zojës, Pylli i Zojës e Tuma e Zojës që ndodhen përreth saj.

- 4) **Hoteshi si qendër e Malit të Luznisë.** Gjatë pushtimit osman, Dibra ndahej në nëntë Male, tre Oxhaqe dhe një Bajrak. Disa komunitete në Dibër, kanë funksionuar në bazë të “Teorisë ekonomike të klubeve” (Murrja, Bedini & Borakaj 2011:248-249). Pjesa kodrinore malore e Dibrës në të majtë të rrjedhës së Drinit të Zi është administruar nga “malet”²⁰⁹, të cilat nuk kanë pranuar autonominë që Perandoria Osmane u dha krahinave të tjera të Shqipërisë. Në krye të çdo "mali" (njësie administrative) ishte kreu i tij²¹⁰.




Figura 2. a) Kulla e Elez Murrës në Hotesh dhe b) Gjendja e kësaj kulle sot

- 5) **Murrja si kreu i Luznisë.** Kreu (drejtuesi) ishte institucioni ekzekutiv i njësisë administrative të "malit". Në përgjithësi krerët e "maleve" zgjidheshin dhe trashëgonin pushtetin nga njëri fis tek tjetri në mënyrë paqësore. Në fillim të shekullit të XVII, në "malin" e Luznisë drejtimi i komunitetit u dorëzua paqësisht nga fisi i Sefere tek fisi Murrja (Murrja, Bedini & Borakaj 2011:250).

- a) **Atdhetarët Elez dhe Isuf Murrja.** Studiuesi i historisë së Dibrës, Hazi Ndreu, në librin e tij "Dibra në Udhën e Historisë" shkruan: "- Isuf Murrja, biri i atdhetarit Elez Murrja, që pat udhëhequr Luznisë kundra Hajerdin Pashës ". Isuf Murrja u vra nga turqit në tetor të vitit 1882 në luftën e Qenokut në Dibër (Koljegjja 1990).

²⁰⁹ “Mal”, quhej një zonë administrative, nahije ose ish komunë para reformës territoriale të vitit 2015. E gjithë zona kishte 9 "male". Malet e Dibrës janë: Reçi, Dardha, Çidhna, Luznia, Muhurri, Katër Grykët/Selishta [Bënin pjesë në Dibrën e Poshtme (Frashëri 2012:186)], Gryka e Vogël, Gryka e Madhe, Bulqiza [Bënin pjesë në Dibrën e Epërme (Frashëri 2012:186)].

²¹⁰ Krerët e "Nëntë maleve" të Dibrës janë: Troci në Reç, Ndreu në Dardhë, Alia (Demiri) në Çidhën, Murrja në Luzni, Hoxha në Muhurr, Dema në Grykë të Vogël, Shehu në Grykë të Madhe, Karaj në Bulqizë dhe Gazihani në Selishtë ose Katër Grykë (Martini, 2003:12).




Figura 3. a) Elez Murrja dhe b) Isuf Murrja (i biri i Elezit)

Së dyti, me turizmin gjeografik (malor/të bardhë dhe i ujrave të ëmbla).

1. ***Lumin Drini i Zi***, i cili kalon rrzë fshatit, si duket qartë në Figurën 1, Figurën 4 dhe Figurën 5. Pamjet janë magjepsë dhe shume të bukura. I gjithë bregu rrzë fshatit shrytëzohet nga frekuntuesit gjatë sezonit të verës. Uji është shumë i pastër dhe nuk ka derdhje të ujrave të zeza.



Figura 4. Pamje të lumit Drini i Zi në Hotesh Dibër

2. ***Me Gurin dhe Shtëpinë e Çelës***, që ndodhet në hyrje të fshatit rrzë lumit Drini i Zi. Është një ballkon i bukur, ku shikohet bregu i lumit. Në lartësinë 60 - 80 m (me shikim të lirë dhe e pa matur) mbi nivelin e lumit, diku nga mesi i Gurit të Çelës ndodhet shtëpia e Gurit të Çelës. Shtëpia shikohet lehtësisht nga sipër dhe nga poshtë.



Figura 5. Pamje nga Guri dhe Shtëpia e Çelës (*Pozicioni ku ndodhet Shtëpia e Çelës)

3. **Me Shtëpinë e Sudes**, që ndodhet përball vendit të quajtur Shëremete rrëzë lumit Drini i Zi rreth 4-5 km më sipër Shtëpisë së Çelës. Është shtëpi e së njëjtës periudhë me Shtëpinë e Çelës. Sipas arkeologëve këto shtëpi (Shtëpia e Çelës dhe e Sudes) kanë qenë vend strehimi i priftërinjëve në fundin e perandorisë Bizantine, ndërsa gojëdhënat pa baza shkencore të banorëve i kanë transmetuar në breza si vendbanime të xhindeve.
4. **Me Gurrën e Hoteshit**, që derdhet në lumin Drini i Zi. Gurra është edhe kufiri ndarës me fshatrat Katundi i Ri dhe Lishan i Poshtëm.
5. **Me pyjet**, si: Pylli i Kalasë, i Lagavishtës, i Arës së Bidonit, i Çenxës, i Kodrës dhe i Lugut Rade, i Kodrës së Mullirit, i Kodrës Vorthe, Kodrës Rrasës etj. Këto kodrina dhe lugina ofrojnë pamje çlodhëse dhe magjepse dhe janë të veshura me pyje dushku.

Së treti, me turizmin dimëror.

Dëbora në dimër dhe terreni malor ofrojnë mundësi shumë të përshtashëm për turizëm dimëror dhe organizmin e sportit të skive (Murrja 2008).

Së katërti, me turizmin e gjahut.

Hoteshi ofron kushte shumë të përshtashme për zhvillimin e këtij turizmi. Dashmirësit e turizmit të gjahut në sezonet e lejuara gjejnë një shumëllojshmëri kafshësh e shpendësh, si: ujku, ariu, lepuri i egër, dhelpra, derri i egër, thia e egër, kaprolli, kunadhja, baldosa, thëllënxa, pëllumbi i egër, shqiponja etj.

Së pesti, me alegorinë e luznake.

Të folurit alegorik në Dibër është një veçori e dialektit lokal, një stil i veçantë, i figurshëm e gjuhës popullore. Baza e kësaj specifike janë të ashtuquajturat “mesele”, tregimet alegorike ose të sajuara, që pas paraqitjes së drejtëpërdrejtë fshehin kuptimin domethënës. Shkurt “i bie pragut të të degjojë dera” (Gjinari & Shkurtaj 2003). Në përgjithësi dibranët shquhen për intelekt të lindur apo antyror, por vlen të theksohet Luznia dhe Çidhna, si dy burime kryesore të të folurit alegorik. Nga kënaqësia e të folurit alegorik në Dibër thuhet “Universiteti i Luznisë” (Murrja 2016).

Shtëpia e Plakut. Shtëpia e Plakut në Malet e Dibrës ishte gjykata që zgjidhte mosmarrëveshjet midis banorëve. Për shembull, në Luzni ka patur dy shtëpi plaku, Nikolli në fshatin Katundi i Ri dhe Murrja në fshatin Hotes. E para kryhesohej nga Maliq Nikolli, ndërsa e dyta nga Vesel Murrja. Tradita e të drejtës së plakut/gjyqtarit është pasuar deri vonë dhe konkretisht nga Brahim Nikolli dhe Musa Murrja.

2. METODOLOGJIA

Për të promovuar turizmin në fshatin Hotes, Luzni në trevën e Dibrës janë përdorur udhëzimet e shkrimit të një eseje klasifikuese. Në fillim është bërë klasifikimi i llojeve të turizmit në grupe të mëdha dhe më pas ndarja në nëngrupe. Ndarja në nëngrupe e resurseve turistike është bërë përmes zbatimit të pandërprerë të rregullave të klasifikimit. Në përshkrimin tonë nuk ka patur kapërcime mes grupeve dhe klasifikimet kanë qenë të plota. Eseja është e organizuar në paragrafe koherente dhe të uniformuara.

Për të evidentuar përparësitë, dobësitë, mundësitë dhe kërcënimet e turizmit në fshatin Hotes, Luzni në trevën e Dibrës është përdorur analiza SWOT.

4. Diskutime dhe analiza SWOT

<p>Përparësitë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Natyra shumë e bukur; 1) Komunitetit mikpritës dhe bujar; 2) Trevë e sigurt; 3) Gatim tradicional; 4) Konsumi i produkteve BIO; 5) Monumentet e natyrës; 6) Klima e shëndetshme; 7) Qytetrim parahistorik dhe mesjetar; 8) Figura të shquara të historisë lokale. 	<p>Dobësitë</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Mos menaxhimi i mbeturinave; 2) Website me informacion shumë të cunguar; 3) Mungesa e udhëzuesit turistik; 4) Mungesa e një muzumi të që tregojë historinë e fshatit; 5) Mungesa e tradiës së turizmit familjar; 6) Mungesa e hoteleve në fshat; 7) Mungesa e infrastrukturës rrugore.
<p>Mundësitë</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Kujdes më madh i qeverisë qendrore dhe lokale, agjencive të zhvillimit dhe donatorëve; 2. Promovim dhe interesim më të madh të Ministrisë së Linjës për zhvillimin e turizmit në njësinë administrative Luzni; 3. Prodhimet BIO 	<p>Kërcënime</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Kapacitete njerëzore lokale në rënie për shkak të emigracionit dhe migrimin të rinjve të arsimuar; 2) Fatkeqësitë natyrore, si: zjarre, përmytje, rrëshqitje, orteqe etj.; 3) Dëmtimi i natyrës.

KONKLUZION

- Jeta e kafshëve si ariu, dhia e egër, derri i egër, ujku etj., dëshmojnë për një lashtësi të këtij fshati.
- Parahistoria, periudha ilire dhe mesjtare ofrojnë kalatë dhe kështjellat nga më interesante në Dibër të Shqipërisë.
- Zgjuarsia luznake ofron informacion për funksionimin e Kanunit të Dibrës dhe Kanunit të Skënderbeut, si dhe tregimet alegorike si nga më të veçantat, jo vetëm në Shqipëri por në Ballkan dhe më gjerë.
- Kodrat dhe luginat në këtë fshat ofrojnë pamje çlodhëse, me florë dhe faun të larmishme me lule shumëngjyrëshe, të mbushuara me pyje dushku.
- Bregu i Drini të Zi në këtë fshat është nga më të pastrat, pasi nuk ka derdhje të ujrave të zeza dhe ofron mundësinë e plazhit në sezonin veror.
- Dëbora dhe terreni krijojnë mundësinë e turizmit të skive, sidomos në Cenxë dhe te Ara e Bidonit.
- Klima ofron prodhime bimore dhe shtazore BIO.

REKOMANDIME

Të nderuar turistë, tani është në dorën tuaj për të zgjedhur fshatin Hotesh në Dibër si destinacion turistik, gjithashtu edhe të vendosni se çfarë do të vizitoni më parë. Në këtë trevë do të gjeni ..., fushat e gjera me lule..., ... bregore bukuroshe, ... lumenj të kulluar, çuka, kodra, brinja gërxe dhe pyje të gjelbëruara (sipas shkrimtarit rilindas Naim Frashëri te Poema Bagëti e Bujqësi). Duke e mbyllur me rilindasin Naim Frashëri, në këtë trevë do të gjeni vendëthit e bekuar, që ju mendjen ta defreni me alegorinë luznake.

Referenca:

- Bunguri Adem, “Prehistoria e Dibrës”, Tiranë 2010.
- Frshëri Kristo, “Historia e Dibrës” (Që nga lashtësia deri në mars 1939) ISBN: 978-99956-04-82-0 Tiranë 2012.
- Frashëri Naim, “Poezi të zgjedhura” Botuese e Librit Shkollor, Tiranë 1977, fq. 9.
- Gjinari Jorgi&Shkurtaj Gjovalin, “Dialektologjia”, Tiranë 2003.

- Kolgjegja Hilmi, “Folklor nga Dibra 7”, Botim i Institutit të Kulturës Popullore të Akademisë së Shkencave të RPSSH, Tiranë 1990.
- Martini Xhaferr, “Kanuni i Dibrës”, ISBN: 99927-874-4-9, Tiranë 2003.
- Murrja Arif, “Zhvillimi i turizmit në rajonin e Dibrës”, Revista *Ekonomia dhe Tranzicioni*, Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike, Viti XIII, 2008, fq. 129-142.
- Murrja Arif, Meço Maksim, Tomorri Ilir, “Turizmi në Dibër nëpërmjet një eseje klasifikuese dhe vlerësimi sipas analizës SWOT, 2016.
- Murrja Arif, Bedini Belina & Borakaj Daniel, “Financat Lokale dhe Qeverisja” 2011, ISBN 978-9928-4092-3-2.
- Murrja Ibrahim, “Nandë Malet e Dibrës” 2015.
- Musai Bardhyl, “Si të shkruajme ese” Qendra për Arsim Demokratik 2004, ISBN 99927-994-1-2.
- Përzhita Luan, “Të dhëna të reja për fortifikime të shek. IV-VI në luginën e Drinit të Zi”, Candavia 1-2004, Botim i Departamentit të Antikitetit të Vonë në Mesjetë të Institutit të Arkeologjisë.

PASURITË NATYRORE SI PREMISA PËR ZHVILLIMIN E TURIZMIT TË QËNDRUESHËM NË PARKUN KOMBËTAR DETAR KARABURUN-SAZAN

Dr. Fatlinda SHKURTI¹

¹Departamenti i Edukimit, Fakulteti i Shkencave Humane, Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë,
e-mail: fshkurti@yahoo.com

Msc. Marjeta BALAJ²

²Departamenti i Financës, Fakulteti i Ekonomisë, Akademia e Studimeve të Aplikuara "Reald",
Vlorë, e-mail: marjetabalaj@hotmail.com

ABSTRAKT

Parku Kombëtar Detar Karaburun-Sazan paraqet një zonë me resurse të larta natyrore. Punimi synon njohjen, analizën dhe vlerësimin e ofertës natyrore turistike, duke u mbështetur në resurset primare e sekondare, me qëllim përcaktimin e plotë të potencialit turistik. Ky potencial turistik lidhet me elementet e pasur fiziko-gjeografik, ku hapësira e gjerë detare me ujëra të pastër, klimë mesdhetare me orë të shumta me diell, krijon kushte për lloje të ndryshme turizmi. Parku prezanton në mënyrë të ndërthurur elementët fiziko-gjeografikë, si mozaiku i formave të relievit, ujërat, bimësia, bota shtazore. Trajtat e larmishme atraktive gjeomorfologjike të tilla si, kanione të thella, faqe shkëmbore vertikale (faleza), shpella (shumica në ujë), gjire, kepe etj., kanë zgjuar interesin e të apasionuarve të këtyre peizazheve. Gjeohapësira me mjedis bregdetar ekologjikisht të pastër, me biodiversitet të lartë dhe të pashfrytëzuar plotësisht ofron kushte për veprimtari argëtuese e çlodhëse si: noti, zhytja, shëtitja në natyrë, hipizmi, eksplorimi i shpellave, kanioneve, peshkimi, gjuetia etj.

Infrastruktura e papërshtatshme plotësisht pengon lëvizjen e lirë në brendësi të Parkut Kombëtar Detar, por edhe në hapësirën detare. Veprimtaria turistike duhet të integrohet me ekonominë tradicionale të zonës, në funksion të turizmit, duke zgjeruar biznesin lokal e duke siguruar të ardhura të mjaftueshme për njësitë e tipit familjar. Inventarizimi i resurseve natyrore e shfrytëzimi me kriter, krahas mbrojtjes së mjedisit duhet të jenë në harmoni të plotë me zhvillimin e qëndrueshëm. Pushteti lokal e qendror duhet të krijojnë e zbatojnë legjislacionin e plotë në ruajtjen, menazhimin dhe zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm për gjeohapësirën e këtij parku dhe më gjerë.

Fjalë kyçe: *Park kombëtar detar, ofertë primare turistike, biznes lokal, zhvillim i qëndrueshëm.*

HYRJE

Parku Kombëtar Detar Karaburun-Sazan është pjesë përbërëse e Krahinës Malore Jugore dhe paraqet një territor tranzit midis Rajonit Perëndimor dhe Rajonit Jugor. Bën pjesë në rrethin e Vlorës (Qarkun Vlorë). Territori është pjesë e dy zonave tektonike të Albanideve të Jashtme (Zona e Sazanit dhe Jonike). Paraqet një njësi gjeomorfologjike me ndërtim gëlqeror duke përfaqësuar një ekosistem tipik karstik. Me elementët e larmishëm fiziko-gjeografik, Parku Kombëtar Detar përmban vlera shkencore, turistike dhe praktike.

1. METODIKA E PUNËS

Punimi synon njohjen, analizën dhe vlerësimin e ofertës natyrore turistike, duke u mbështetur në resurset primare dhe sekondare, me qëllim përcaktimin e plotë të potencialit turistik. Ky territor prezanton në mënyrë të ndërthurur elementët fiziko-gjeografikë, si mozaiku i trajtave të relievit, klima, ujërat, flora e fauna (ujore e tokësore). Materiali është siguruar në pjesën më të madhe nga ekspeditat në terren, grumbullimi, sistemimi e përpunimi i tij dhe nga literatura e derisotme në fushën e gjeomorfologjisë, gjeografisë fizike, gjeologjisë, biologjisë, legjislacionit për zonat e mbrojtura etj. Janë përcaktuar pikat, stacionet e vendqëndrimit me rëndësi, duke realizuar sistemimin paraprak të elementëve përbërës të ofertës turistike.

Shfrytëzimi i elementëve natyrorë, me kapacitet të plotë do të jetë në varësi të ngushtë me ofertën kulturore, ku në harmoni me to, është përcaktuar roli i faktorëve fiziko-gjeografikë për të afirmuar rëndësinë turistike të kësaj gjeohapësire. Parku Kombëtar Detar paraqet një zonë unike me mjedis bregdetar ekologjikisht të pastër, me biodiversitet të lartë dhe të pashfrytëzuar plotësisht, ofron kushte për veprimtari argëtuese e çlodhëse si: noti, zhytja, shëtitja në natyrë, hipizmi, eksplorimi i shpellave, kanioneve, peshkimi, gjuetia etj. Treguesit e shumtë e cilësor të ofertës turistike, do të kërkojnë për rrjedhojë përgatitjen e projekteve për shfrytëzimin sa më të plotë të çdo treguesi të saj.

2. FAKTORËT KRYESORË TË OFERTËS TURISTIKE

2.1. Relievi

Gadishulli i Karaburunit futet në det deri në 15 km, e së bashku me ishullin e Sazanit krijon gjirin e mbrojtur të Vlorës.²¹¹ Ndërtimi tektonik i këtij territori përbëhet nga rrudha antiklinale e

²¹¹ Krutaj. F., Gaçe. B., Abazi. H., "Vlora Porti jugor i Adriatikut", Tiranë 2001, Toena, f. 80

me shtrirje VP-JL. Karaburuni përfaqëson një pjesë të antiklinalit të madh me të njëjtin emër që shtrihet 40 km nga zhytja në det në Kepin e Gjuhëzës në VP e deri në afërsi të Palasës në JL.²¹² Zona e Sazanit, zë ishullin e Sazanit, gadishullin e Karaburunit që është rrudhë e madhe dhe e butë me gjatësi 50 km, Malin e Rrëzës së Kanalit deri në Dhërmi mandej riduket përsëri në disa ishuj të Greqisë, në jug të Korfuzit (ishulli i Paksos). Ajo përbën krahuin lindor të platformës apuljane.²¹³ Në të dyja anët e Karaburunit, sidomos në pjesën perëndimore, krijohen peizazhe të bukura nëpërmjet gjireve të vegjël, honeve, shkrepave, falezave shkëmbore. Vendet përrallore si: Gjiri i Gramës, pllaja e Ravenës, Kepi i Gjuhëzës, Shpella e Haxhi Alisë, Shpella e Duk Gjonit, Gjiri i Brisanit, i Dafinës, Rogozhës tërheqin vizitorë të shumtë.²¹⁴ Majat më të larta janë Maja e Hilqes (733 m) në pjesën veriore dhe Maja e Koretës (826 m) në pjesën jugore.²¹⁵ Në Karaburun zhvillim ka karsti në Ravenë, kurrizi i së cilës është përpunuar fuqishëm prej tij. Në Rrëzën e Kanalit gjenden shumë kreshta në formë heshtash, zgavrime, kanale e shpella karstike bregdetare. Midis tyre përmenden shpella e Pëllumbave, shpella e Gjon Gjilekës etj.²¹⁶ Proceset e abrazionit në shumë zona ndërthuren me proceset e karstit duke sjellë formimin e shpellave të mëdha (Haxhi Alisë etj.) dhe forma të tjera karstike.

Në Sazan ndodhen dy tipe kryesore relievi: relievi i zhvilluar në serinë karbonatike dhe ai i zhvilluar në serinë terigjene. Relievi i zhvilluar në serinë karbonatike shumë i zhvilluar nga proceset karstike është më i lartë dhe shfaqet në pjesën perëndimore të ishullit.²¹⁷ Ai përbëhet nga maja relativisht të rrumbullakosura, kurse shpatet janë tepër të rrëpirëta, sidomos ai perëndimor karakterizohet me shkëmbinj të lartë e të thepisur me rënie vertikale mbi det e me kanione tektoniko-abrazive disa dhjetëra metra të larta e shpella nënujore.²¹⁸ Lartësitë e ishullit ulen nga skajet në drejtim të qendrës, ku lugina e përroit të Xhenemit dhe e përroit të Shën Kollës rrjedhin në drejtim të kundërt, e ndajnë ishullin në dy pjesë: pjesën veriore më të lartë (342 m) dhe atë jugore më të ulët.²¹⁹

²¹² Akademia e Shkencave e R.SH, Gjeografia Fizike e Shqipërisë, Vëllimi I, Tiranë, 1990, f. 67

²¹³ Po aty

²¹⁴ Krutaj. F., Gaçe. B., Abazi. H., “Vlora Porti jugor i Adriatikut”, Tiranë 2001, Toena, f. 81

²¹⁵ Instituti për ruajtjen e Natyrës në Shqipëri “Ruajtja e biodiversitetit detar në Shqipëri, f.1

²¹⁶ Akademia e Shkencave e R.SH, Gjeografia Fizike e Shqipërisë. Vëllimi II, Tiranë, 1991, f. 410

²¹⁷ Fjalori Enciklopedik Shqiptar, f. 949

²¹⁸ Komiteti i Mbrojtjes së Mjedisit, “Administrimi i Inegruar i Zonës Bregdetare”

²¹⁹ Mitro. I., Buletini Shkencor Nr. 8, Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë 2006, f.38

2.2. Kushtet klimatike

Kushtet klimatike përbëjnë një nga faktorët kryesorë në zhvillimin e ardhshëm të turizmit të mirëfilltë. Kjo hapësirë bën pjesë në zonën klimatike mesdhetare fushore: nënzona mesdhetare fushore jugore, në zonën mesdhetare kodrinore: nënzona mesdhetare jugperëndimore dhe në zonën mesdhetare malore me nënzonën mesdhetare malore jugore.

Tiparet dhe veçoritë e përgjithshme klimatike të hapësirës në studim i atribuohen pozicionimit klimatik të mësipërm. Në përcaktimin e tipareve klimatike jemi mbështetur në të dhënat dhe botimet e Institutit Hidrometeorologjik Tiranë, si dhe në studimet e këtij karakteri prej specialistëve të kërkimit gjeografik.

Së pari, do të veçonim karakterin e theksuar mesdhetar të klimës, shprehur në prezencën e një dimri të butë dhe të lagët, me verë të nxehtë dhe të thatë. Stina e dimrit merr 1/3 e rrezatimit të verës.

Së dyti, klima në këtë territor dallohet për pasuritë e mëdha klimatike të shprehura: **shuma mesatare vjetore e rrezatimit diellor** është rreth 1500 (1481.65 kwh/m²); **sasia vjetore e orëve me diell** (zgjatja faktike e diellzimit) është rreth 2500 orë (2437 për stacionin e Vlorës), **sasia vjetore e ditëve me diell** llogaritet në mbi 320 ditë; **numri i ditëve pa diell** (vranësia) llogaritet në 42.2 ditë; **shuma e temperaturave efektive dhe aktive** 4400-; shuma mesatare vjetore e reshjeve varion nga rreth 989 mm-1000 mm.

Së treti, klima në këtë territor dallohet edhe për karakterin e theksuar kapriçioz, lëkundjet e mëdha të vlerave të të gjitha elementeve klimatike nga mesatarja e tyre shumëvjeçare. Në mars të vitit 1987, në Vlorë temperatura shënoi (6.3°C).²²⁰

2.2.a. Rrezatimi diellor

Territori në studim i favorizuar prej pozitës gjeografike, merr një energji diellore jo të vogël. Shuma mesatare vjetore e energjisë së rrezatuar rezulton rreth 1646.81 kwh/cm² (Vlorë). Një shumë e tillë, kur për tërë vendin llogaritet në vlerën 1984.32 kwh/cm² vë në dukje, që territori në studim është ndër më të pasurit në energji termike.

Ndryshimet në aspektin hapësinor (shuma mesatare vjetore e energjisë së rrezatuar), lidhen më së shumti me rolin kryesor që luan në këtë shpërndarje vranësira dhe lartësia jo e njëjtë mbi

²²⁰ M. Kaso, V. Duri, G. Ruspi, F. Shkurti, Gjeografia, SHBLU, Tiranë, 2006, f. 137

nivelin e detit. Vlerat më të larta në sasinë mujore të rrezatimit të përgjithshëm i takojnë muajve korrik dhe gusht.

Sasitë mujore dhe vjetore të rrezatimit të përgjithshëm në këh/m² Tabela Nr.1²²¹

Vend matjet	Mesataret mujore												Σ vjetore
	J	Sh	M	P	M	Q	K	G	Sh	T	N	DH	
Vlorë	70.06	71.22	101.97	144.38	179.98	204.44	221.69	208.89	163.21	118.22	83.41	79.84	1646.81

Kohëzgjatja e diellzimit në orë merr vlera mesatare vjetore për Vlorën është 2734 orë. Referuar krahasimit të vlerave të mësipërme thuhet se ky rajon dallon për sasinë e madhe të orëve me diell. Mesataret maksimale vendosen në muajt qershor, korrik-gusht me 340 orë, pra mesatarisht rreth 11.5 orë me diell në ditë. Me një klimë mesdhetare që shprehet në temperaturat e volitshme dhe mundësitë e shfrytëzimit të rrezatimit diellor, hapësira gjeografike në studim, paraqet një zonë mjaft të përshtatshme nga pikëpamja turistike. Sipas muajve të vitit, zgjatja e diellzimit luhetet nga rreth 115 orë (në dhjetor), në mbi 340 orë (në muajt korrik dhe gusht). Diellzimi përbën faktorin më pozitiv në ushtrimin e banjove në brigjet e detit Adriatik e Jon.

2.2.b. Temperaturat

Temperaturat ndikojnë drejtpërdrejt dhe indirekt në aktivitetin jetësor të popullsisë. Për të gjykuar për temperaturën e territorit të studimit, së pari, vrojtohen temperarura mesatare vjetore, temperatura e muajve më të nxehtë dhe më të ftohtë, si dhe maksimalet dhe minimalet absolute të temperaturave të marra këto për një periudhë shumëvjeçare. Temperaturat mesatare shumëvjeçare për këtë territor është 16.1°C.²²²

Temperaturat mesatare shumëvjeçare të ajrit (1951-1980) Tabela Nr.2²²³

Stacionet	MUAJT												Mes Vjet	Amp Vjet.
	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII		
Vlorë	9.1	10.0	11.4	14.4	18.3	22.0	24.1	24.2	21.6	17.9	14.1	10.8	16.5	15

Nga tabela më sipër viher re që temperaturat mesatare shumëvjeçare marrin vlerat më të larta në muajt qershor, korrik e gusht (24.6) dhe më të ulëtat në dhjetor, janar, shkurt (9.1).

²²¹ Akademia e Shkencave të RPSSH, Gjeografia fizike e Shqipërisë, Vëllimi I, Tiranë, 1990, f. 171

²²² H. Abazi, "Të njohim vendlindjen", SHBLSH, Tiranë 1979, f. 57

²²³ A. SH. SH, vep. e cit. Vëllimi I, Tiranë, 1990, f. 185

Klima përbën ofertën e parë turistike pasi këtu regjistrohen mbi 2700 orë me ndriçim dielli ose rreth 8 orë me diell në ditë, shifër kjo mjaft e lartë jo vetëm për vendin tonë, por për krejt Ballkanin. Kjo përbën një pasuri natyrore të pashtershme, të qëndrueshme dhe që nuk ndot mjedisin ndaj duhet të vihet në shërbim të ekonomisë.²²⁴

2.2.c. Erërat

Për të gjykuar mbi rolin apo efektin e erës, do të nevojitet të merren në analizë **drejtimi dhe shpejtësia**, pasi në dallim nga elementet e tjera klimatike era është madhësi vertikale si dhe **përmbajtja** (e ngrohtë / e ftohtë) në planin kohor dhe në hapësirë, pasi dihet se ajo ndryshon gjatë vitit, stinëve, përkundrejt ekspozimit të territorit, lartësisë etj. Le t'i referohemi fillimisht, të dhënave mbi shpërndarjen vjetore të drejtimit të saj së bashku me qetësinë.

Shpejtësia mesatare vjetore e erës sipas drejtimeve në m/s Tabela Nr. 3²²⁵

Stacionet	V	VL	L	JL	J	JP	P	VP
Vlorë	3.3	2.9	3.0	3.9	5.9	5.3	3.8	4.8

Në territorin në studim të dhënat flasin se erërat, që rastisin më shumë gjatë vitit janë ato **të kuadrantit L** (për Vlorën më tipike, por është e mbrojtur nga këto erëra) **dhe JP**, të cilat fryjnë gjatë periudhës tetor-mars, të kuadrantit **VP e J**, fryjnë në periudhën e pranverës, të kuadrantit **VP e P** fryjnë në periudhën nga qershori në shtator, **JL dhe VL** drejtim ky që ndjek deri diku edhe drejtimin e vargjeve malore dhe të luginave. P.sh: në vendmatjen e Vlorës erërat Lindore zënë 15.2%, erërat VP zënë 10.6%, kurse drejtimi Jugor 7.2%.

Në gjirin e Vlorës nuk kanë munguar rastet kur shpejtësia e erës në dimër ka arritur në 45 m/sek (zakonisht në muajt dhjetor, janar, shkurt). Por dhe në stinën e verës, në muajn gusht, janë regjistruar erëra me shpejtësi deri në 20 m/sek. Nisur nga këto të dhëna përgjithëse për erën mund të arrijmë në përfundimin se shpejtësia e erës duhet marrë parasysh jo vetëm për mjetet turistike lundruese, por edhe për tipin dhe shkallën e qëndrueshmërisë së çatave, të ndërtimeve të lehta, të çadrave etj.²²⁶

Në Vlorë ka sektorë që rrihen vazhdimisht nga erërat (Ravena, ishulli i Sazanit, Llogara, Tragjas, Kaninë, etj.) ndaj n.q.se., duhet të bëhen studime konkrete e të specializuara, mund e duhet të

²²⁴ Krutaj. F., "Mjedisi, turizmi dhe zhvillimi i qëndrueshëm i Rajonit të Vlorës", Vlorë 2004, f.8

²²⁵ A. SH. SH, vep. e cit. Vëllimi I, Tiranë, 1990, f. 178

²²⁶ Mitro. I., Buletini Shkencor Nr. 8, Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë 2006, f.41

arrihen rezultate premtuese.²²⁷ Reshjet mesatare vjetore shumëvjeçare (954 mm) janë nën normën mesatare të krejt vendit, gjë që shpjegohet kryesisht me ndikimin e relievit fushor.²²⁸

2.3. Pasuritë ujore

Sazani, ashtu si Karaburuni, nuk kanë asnjë rrjedhje sipërfaqësore dhe asnjë burim nëntokësor e me dukuri karstike të zhvilluara.²²⁹ Ujërat e shirave që grumbullohen në brendësi të masivit malor të Sazan-Karaburunit shkarkohen në det në trajtën e burimeve nëndetare.²³⁰ Brenda hapësirës së marrë në studim, ka burime të shumta ujore, me ujë të pijshëm (burimet e Dukatit, Tragjasit, Ujit të Ftohtë si dhe një numër i konsiderueshëm burimesh nëndetare), të cilët, po të përdoren me efektivitet, mund të përballohen kërkesat për një turizëm cilësor dhe gjithëvjetor.²³¹ Në të gjithë bregun lindor të Karaburunit dalin burime të shumta nëndetare, të cilat shkarkojnë drejtpërsëdrejti në det ujërat e shirave që grumbullohen në brendësi të masivit gëlqeror të Karaburunit.²³²

2.4. Pasuria bimore dhe shtazore në funksion të turizmit

Bimësia e zonës është kryesisht e tipit të makjes mesdhetare me gjelbërim të përhershëm. Makja është shumë e dendur në anën perëndimore. Nga drurët e lartë në Sazan (në lindje) rritet në gjendje të natyrshme pisha e egër, ilqja dhe vidhi. Pisha shtrihet deri në lartësinë 70-100m, më lartë ajo nuk rritet për shkak të erërave të forta.²³³ Në Karaburun bimësia është e rrallë dhe përbëhet nga ilqja dhe valanidhi.²³⁴ Pyjet e valanidhit në Karaburun konsiderohen si pyjet më të ruajtura në Shqipëri. Gryka e Xhenemit dhe ishulli i Sazanit janë kufiri verior i përhapjes së rriellit si dru dhe aleancës Oleo-Ceratonion, të cilat kanë vlera shkencore në aspektet biogjeografike dhe ekologjike.²³⁵ Në habitatet detare dhe bregdetare, janë të pranishme, si në

²²⁷ Krutaj. F., “Mjedisi, turizmi dhe zhvillimi i qëndrueshëm i Rajonit të Vlorës”, Vlorë 2004, f.8

²²⁸ Krutaj. F., Gaçe. B., Abazi. H., “Vlora Porti jugor i Adriatikut”, Tiranë 2001, Toena, f. 28

²²⁹ Komiteti i Mbrojtjes së Mjedisit, “Administrimi i Inegruar i Zonës Bregdetare”, f. 94

²³⁰ Mitro. I., Buletini Shkencor Nr. 8, Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë 2006, f.42

²³¹ Krutaj. F., “Mjedisi, turizmi dhe zhvillimi i qëndrueshëm i Rajonit të Vlorës”, Vlorë 2004, f.8

²³² A. SH. SH, vep. e cit.Vëllimi I, Tiranë, 1990, f. 413

²³³ Mitro. I., Buletini Shkencor Nr. 8, Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë 2006, f.42

²³⁴ Qiriazi. P., Gjeografia Fzike e Shqipërisë, Vëllimi 2, SHBLU, Tiranë 1998, f.247

²³⁵ Instituti për ruajtjen e Natyrës në Shqipëri “Ruajtja e biodiversitetit detar në Shqipëri, f.8

ishullin e Sazanit dhe gadishullin e Karaburunit, biocenoza e dominuara nga alga e kuqe kalcike, lloj karakteristik i Mesdheut perëndimor dhe detit Adriatik. Biocenoza tjetër e rëndësishme është ajo e shpellave gjysëm të errëta, ku jeton korali i kuq. Kjo biocenoza është e zhvilluar më mirë në anën perëndimore të ishullit të Sazanit dhe gadishullit të Karaburunit.²³⁶

Ndër kafshët më të njohura të kësaj treve janë: derri i egër (gadishulli i Karaburunit, Llogara), ujku, dhelpra, lepuri, baldosa etj. Shpendët janë të shumta si lloje (numërohen rreth 70 të tillë) të cilat gjejnë kushte të favorshme ushqimi e dimërimi.²³⁷ Në ujërat e zonës Karaburun-Sazan është raportuar prania e breshkave të detit (*Carreta carreta*), delfinëve dhe fokës së Mesdheut, të cilat janë ndër llojet më të kërcënuara në shkallë globale.²³⁸

3. Format dhe llojet e turizmit

Vlerat mjedisore, natyrore, kulturore, historike dhe arkeologjike, biodiversiteti dhe larmia e peizazheve e bëjnë këtë zonë një nga pikat më tërheqëse për sa i takon turizmit. Këtu mund të aplikohen disa lloje turizmi nga ekoturizmi ose turizmi elitë (në Llogara, Sazan, Ravenë etj.), i cili siguron fitime të larta duke mos shkaktuar “stresë” mjedisore.²³⁹

3.1. Turizmi balnear

Turizmi balnear, përfaqëson formën më masive të lëvizjes turistike e cila aplikohet nëpërmjet banjove diellore e sporteve ujore, peshkimit. Si formë e turizmit blu, krahas kalimit të kohës së lirë, çlodhjes, argëtimit e ushtrimit të sporteve, ai jep efekte shëndetësore në organe të ndryshme. Mjediset bregdetare me larminë e tyre, mundësojnë kohëzgjatje të sezonit turistik nga muaji maj deri në tetor. Ishulli i Sazanit ka potenciale për këtë lloj turizmi që në të ardhmen të jetë destinacion turistik për një numër të konsiderueshëm turistësh.

Perspektiva të mëdha hapen për kthimin në vend turistik të gjireve të virgjër të Shën Janit dhe Shën Vasisë që janë kaq të bukur dhe piktoreskë.²⁴⁰

3.2. Turizmi sportiv

²³⁶ Po aty

²³⁷ Krutaj. F., Gaçe. B., Abazi. H., “Vlora Porti jugor i Adriatikut”, Tiranë 2001, Toena, f. 33

²³⁸ Instituti për ruajtjen e Natyrës në Shqipëri “Ruajtja e biodiversitetit detar në Shqipëri, f.8

²³⁹ Krutaj. F., “Mjedisi, turizmi dhe zhvillimi i qëndrueshëm i Rajonit të Vlorës”, Vlorë 2004, f.9

²⁴⁰ Krutaj. F., Gaçe. B., Abazi. H., “Vlora Porti jugor i Adriatikut”, Tiranë 2001, Toena, f. 33

Turizmi sportiv në të ardhmen e afërt do të jetë një nga llojet më masive për shkak të kushteve të favorshme për sporte të ndryshme me funksion argëtues, edukativ, shëndetësor e kulturor.

Sportet e lundrimit sot janë zgjeruar në lloje, mjete e teknika dhe në përgjithësi ato bëhen për “argëtim”, veç aspektit profesional të konkurimit.²⁴¹ Është sukses dhe krenari që Llogoraja si vend klasik turistik i Vlorës, është futur edhe në hartën europiane si pistë e rëndësishme e turizmit sportiv aeronautik (ajrore). Apo shpallja e ishullit të Sazanit-zonë perspektive e turizmit aero-naval (ujor).²⁴² Topografia interesante nënujore, me shpella e mikro habitate shumë të larmishëm, si dhe prania e anijeve të mbytura, i japin zonës më tepër vlera turistike, veçanërisht për të apasionuarit pas sportit të zhytjes.²⁴³ Larmia e madhe e formacioneve topografike me shkëmbinj të thepisur dhe të pakalueshëm, kanione, shtigje e fushëgropa (si fushëgropa e Ravenës) ofron mundësi të mira që përveç sporteve të ujit të zhvillohen edhe alpinizmi, shëtitjet me kuaj apo sporte të tjera.²⁴⁴ Ekzistojnë mundësitë për një akses të kontrolluar të turistëve dhe vizitorëve në zonë nëpërmjet shtigjeve që kalojnë nga zonat pyjore e kodrinore dhe/ose me varka në plazhet dhe gjiret e vegjël, ku ka mundësi ankorimi, si gjiri i Raguzës dhe gjiri i Shën Janit në bregun lindor, dhe gjiri i Bristanit, gjiri i Dafinës dhe gjiri i Gramës në bregun perëndimor të Karaburunit.²⁴⁵

3.3.Turizmi shëtitës

Turizmi shëtitës, përfshin lëvizjet nëpër itinerare të ndryshme me funksion njohës, argëtues me një shfrytëzim gjatë gjithë vitit e sidomos në pranverë dhe në vjeshtë. Forma të tjera të lëvizjes turistike janë shëtitjet, ekskursionet, marshimet dhe ekspeditat turistike. Shëtitjet, si ndër format më të thjeshta e të lehta për turizmin në masë, realizohen me këmbë, biçikletë, e makinë.²⁴⁶

Marshimet turistike me organizim masiv, zhvillohen në itinerare me destinacion të largët në distancë, në Ravenë, gjiret e Shën Janit, Shën Vasisë, Gramës etj., shpellat, grykat në ishullin e Sazanit.

²⁴¹ Doka. Dh., Draçi. B., “Gjeografia e Turizmit”, SHBLU, Tiranë 2002, f. 73

²⁴² Abazi. H., “Mjedisi, turizmi dhe zhvillimi i qëndrueshëm i Rajonit të Vlorës”, Vlorë 2004, f. 25

²⁴³ Instituti për ruajtjen e Natyrës në Shqipëri “Ruajtja e biodiversitetit detar në Shqipëri, f.10

²⁴⁴ Po aty

²⁴⁵ Instituti për ruajtjen e Natyrës në Shqipëri “Ruajtja e biodiversitetit detar në Shqipëri, f.10

²⁴⁶ UT, Fakulteti i Histori Filologjisë, Studime Albanologjike, IV, “Gjeografi”, Tiranë 2009, f. 193

4. Trajtimi gjeoturistik aktual

Kjo zonë është më parë është vlerësuar vetëm për pozitën e saj natyrore gjeostrategjike-politike. Asnjëherë nuk është vendosur një raport i drejtë midis faktorëve gjeostrategjikë dhe faktorëve gjeobioklimatikë, që do të shpinte në kthimin e këtij rajoni në një “perlë” ekonomiko-turistike.²⁴⁷

Bëhet fjalë për një zonë që përfshin 30% të vijës bregdetare Joniko-Adriaktike, që zë 75% të Rivierës Shqiptare.

Por sikur të mos mjaftonin mangësitë në lidhje me mos zhvillimin turistik, akoma edhe gjatë tranzicionit pllakosi kriza mjedisore për këto rajone.²⁴⁸ Shpallja e bregdetit të Vlorës prej grykëderdhjes së Vjosës e deri në Qeparo-zonë turistike me përparësi, është një sukses, pamvarësisht se ende i jepet rëndësi më tepër turizmit klasik detar-bregdetar (turizmi balnear).

Me propozim të Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, më datë 28 Tetor 2010, Këshilli i Ministrave me Vendimin Nr. 289, shpalli zonën Karaburun – Sazan si të parën zonë të mbrojtur detare (Park Detar) në Shqipëri.²⁴⁹ Motivet për gjallërimin e lëvizjes turistike janë të shumta, gjithëvjetore e fitimprurëse veçse kërkohet një politikë e zgjuar dhe bashkëkohore që turizmi në këtë zonë të jetë i qëndrueshëm dhe të shndërrohet në një industri fitimprurëse për biznesin lokal pa pasoja mjedisore.

Rëndësi ka gjithashtu politika e nxitjes, përkrahjes dhe integritit të turizmit në ekonomi, duke iu shmangur politikave konfliktuale me biodiversitetin e hapësirës.²⁵⁰

KONKLUZION

Parku Detar Karaburun Sazan përfaqëson një zonë natyrore me potenciale të shumëllojshme turistike. Shuma mesatare vjetore e energjisë së rrezatuar rezulton rreth 1646.81 kwh/cm² (Vlorë). Një shumë e tillë, kur për tërë vendin llogaritet në vlerën 1984.32 kwh/cm² vë në dukje, që territori në studim është ndër më të pasurit në energji termike.

Shuma mesatare vjetore e rrezatimit diellor është rreth 1500 (1481.65 kwh/m²); sasia vjetore e orëve me diell (zgjatja faktike e diellzimit) është rreth 2500 orë (2437 për stacionin e Vlorës),

²⁴⁷ Abazi. H., “Mjedisi, turizmi dhe zhvillimi i qëndrueshëm i Rajonit të Vlorës”, Vlorë 2004, f. 24

²⁴⁸ Krutaj. F., “Situata e mjedisit dhe disa probleme të administrimit të hapësirës bregdetare të Vlorës”, Konferencë Shkencore, Vlorë 2001, f. 173

²⁴⁹ Instituti për ruajtjen e Natyrës në Shqipëri “Ruajtja e biodiversitetit detar në Shqipëri, f.7

²⁵⁰ Krutaj. F., “Mjedisi, turizmi dhe zhvillimi i qëndrueshëm i Rajonit të Vlorës”, Vlorë 2004, f.10

sasia vjetore e ditëve me diell llogaritet në mbi 320 ditë; numri i ditëve pa diell (vranësia) llogaritet në 42.2 ditë; shuma e temperaturave efektive dhe aktive 4400-; shuma mesatare vjetore e reshjeve varion nga rreth 989 mm-1000 mm.

Brenda hapësirës së marrë në studim, ka burime të shumta ujore, me ujë të pijshëm (burimet e Dukatit, Tragjasit, Ujit të Ftohtë si dhe një numër i konsiderueshëm burimesh nëndetare), të cilët, po të përdoren me efektivitet, mund të përballohen kërkesat për një turizëm cilësor dhe gjithëvjetor. Bimësia e zonës është kryesisht e tipit të makjes mesdhetare me gjelbërim të përhershëm. Nga drurët e lartë në Sazan (në lindje) rritet në gjendje të natyrshme pisha e egër, ilqja dhe vidhi.

Vlerat mjedisore, natyrore, kulturore, historike dhe arkeologjike, biodiversiteti dhe larmia e peizazheve e bëjnë këtë zonë një nga pikat më tërheqëse përsa i takon turizmit. Këtu mund të aplikohen disa lloje turizmi nga eksturzimi ose turizmi elitë (në Llogara, Sazan, Ravenë etj.), i cili siguron fitime të larta, ai balnear, shëtitës, arkeologjik etj. Pushteti qëndror dhe lokal duhet të ndërtojë strategji zhvillimi për menaxhimin me efikasitet të kësaj zone duke bërë të mundur shfrytëzimin e potencialave që ofron.

Referenca:

- [1] Akademia e Shkencave e R.SH, Gjeografia Fizike e Shqipërisë, Vëllimi I, Tiranë, 1990;
- [2] Abazi. H., “Mjedisi, turizmi dhe zhvillimi i qëndrueshëm i Rajonit të Vlorës”, Vlorë 2004;
- [3] Abaz. H., “Të njohim vendlindjen”, SHBLSH, Tiranë 1979;
- [4] Doka. Dh., Draçi. B., “Gjeografia e Turizmit”, SHBLU, Tiranë 2002;
- [5] Fjalori Enciklopedik Shqiptar;
- [6] Instituti për ruajtjen e Natyrës në Shqipëri “Ruajtja e biodiversitetit detar në Shqipëri, Tiranë 2011;
- [7] Krutaj. F., Gaçe. B., Abazi. H., “Vlora Porti jugor i Adriatikut”, Toena ,Tiranë 2001;
- [8] Krutaj. F., "Situata e mjedisit dhe disa probleme të administrimit të hapësirës bregdetare të Vlorës”, Konferencë Shkencore, Vlorë 2001;
- [9] Krutaj. F., “Mjedisi, turizmi dhe zhvillimi i qëndrueshëm i Rajonit të Vlorës”, Vlorë 2004;
- [10] Komiteti i Mbrojtjes së Mjedisit, “Administrimi i Inegruar i Zonës Bregdetare”;
- [11] Kaso. M., Duri. V., Ruspi. G., Shkurti. F., Gjeografia, SHBLU, Tiranë 2006;
- [12] Mitro. I., Buletini Shkencor Nr. 8, Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë 2006;

[13] Qiriazhi. P., Gjeografia Fzike e Shqipërisë, Vëllimi 2, SHBLU, Tiranë 1998;

[14] UT, Fakulteti i Histori Filologjisë, Studime Albanologjike, IV, “Gjeografi”, Tiranë 2009.

ASPEKTE TË ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM BAZUAR NË AKTIVITETET E MARKETINGUT NË TURIZËM

Fatos UKAJ

Universiteti "Hasan Prishtina"

Fakulteti Ekonomik, Prishtinë, Kosovë

fatos_ukaj@yahoo.com

ABSTRAKT

Organizimi dhe implementimi i aktiviteteve për zhvillimin e turizmit dhe hotelerisë në Kosovë duhet të përcillet më ngritjen e një oferte turistike, e cila duhet të ketë kualitet më të lartë dhe për këtë duhet që të behet një komunikim i koordinuar dhe intensiv më palët e interesuara. Faktorët që e përcaktojnë ofertën turistike janë të shumtë, dhe ndër ta veçojmë investimet e kapitalit, qofshin ata të vendit por sidomos ata të huaj. Bazuar në të dhënat e mbledhura do të analizojmë situatën aktuale dhe duke vërtetuar hipotezën se zhvillimi i turizmit në Kosovë varet nga një planifikim i mirë, e ky planifikim bazohet në njohjen e resurseve dhe krijimin e kushteve adekuate që të tërhiqen Investimet në turizëm. Ndikimi i ndërsjellë i shumë faktorëve në zhvillimin e turizmit dhe hotelerisë është në fokus të këtij punimi, në mënyrë që të njihen dhe analizohen më qëllim të gjetjes së kombinimit më të mirë për arritjen e suksesit, duke pranuar se ky ndikim do të shtrihet edhe tek degët tjera, dhe në përgjithësi në zhvillimin ekonomik të vendit. Gjithnjë duke mos harru mjedisin i cili vazhdimisht po ndryshon.

***Fjalët kyçe:** Turizmi, zhvillimi i qëndrueshëm, investimet, komunikimi.*

HYRJE

Industria e Turizmit dhe Hotelerisë në Kosovë dhe në vendet e regjionit siç janë Shqipëria, Mali i Zi, Maqedonia ka arrit rezultate të ndryshme, ku më shume sukses e ku më pak suksesshëm është arrit përparim në tërheqjen e vizitorëve. Nëse i krahasojmë vendet e rajonit më njëra tjetrën rezultatet janë të ndryshme qofshin ato shprehur në të dhëna numerike-fizike apo kualitative, por ka dallime në zhvillimin e turizmit edhe në kuadër të një vendi si tërësi e ofertës turistike. Turizmi dhe hoteleria në disa shtete e nder to edhe në ShBA-të, e ka vendin në njërin ndër 6 sektorët që kanë ndikuar në rritjen e punësimit [McKinsey GI 2011], pse kjo mos të ndodhe edhe

në Kosovë si destinacion turistik. Pas disa viteve të një ngecje para vitit 2009, më pas ka një tendencë të rritjes së numrit të vizitave, fjetjeve, ndërtimit të kapaciteteve hoteliere, dhe shtimit të numrit të shërbimeve të tjera. Shembull marrim Shqipërinë e cila për 12 muajt e vitit 2010 ka pas një rritje të vizitave prej 29% krahasuar më periudhën e njëjtë të vitit paraprak, ku pat më se 1,8 milion vizitor, dhe po në vitin 2009 inkasoi 1,302 mil euro që në fakt ka qenë 14.9% e GDP vendore.[OD 2015, Instat 2009]. Në të njëjtën periudhë krahasuese (2010 më 2009) vërejmë rritjen e numrit të hoteleve të kategorizuara që në vitin 2010 ishte 290 dhe apo 19% më shume se në vitin 2009. Ndërsa një indikatorë i rritjes është edhe numri i shtretërve në hotelet e kategorizuara ishte në vitin 2010 ku evidentohen 11,739 shtretër që është një rritje prej 8% krahasuar më vitin 2009. Evidentohet në pikat kufitare të shtetit të Shqipërisë në vitin 2013 më se 3,460,103 vizitore e që një pjese janë udhëtar transit në vendet tjera, ndërsa evidentohen 616,600 vizitore si pushues[OD 2015]. Kjo duket inkurajuese, por sipas rangimit të bërë nga WEF(world economic forum) në bazë të indeksit të konkurrencës e vendos Shqipërinë në vendin e 90 nga gjithsejtë 133 shtete në botë.

Të gjitha vendet e regjionit janë ranguar para Shqipërisë, përveç Bosnje dhe Hercegovinës. Edhe pse shumica prej tyre në këtë periudhë kane regjistrua rënie të vizitave dhe të hyrave nga turizmi, më se shumti nga kriza ekonomike e cila ishte dhe vazhdon të jetë një ngadalësues i zhvillimit në këtë periudhë. Oferta turistike e Kosovës është e larmishme dhe potencën duhet vendos në zhvillimin e kushteve për Turizmin Transit, Turizmit në Natyrë, Turizmit Shëndetësor, Turizmit Dimëror, Turizmit Kulturor, Turizmit Aventuristik, për të cilat tipa të turizmit Kosova posedon resurse dhe mundësi që në të ardhmen ti valorizoj, dhe të bie turizmin në një nivel që të jetë shtylla e zhvillimit ekonomik. E shtrojmë si të domosdoshme aplikimin e konceptit të marketingut në ndërmarrjet turistike dhe hoteliere, duke e cekë faktin së turizmi në botë si industri është thellësisht i orientuar kah tregu dhe kërkesat e konsumatorëve, të cilat duhet të plotësohen me ofrimin e produktit adekuat turistik.[Ukaj 2013]

Duke mësuar nga përvojat e mira të vendeve të regjionit edhe Kosova mundet që të bëjë një avancim më të madhe drejt rritjes së numrit të vizitorëve, jo vetëm në sezonin kryesorë turistike (që në Shqipëri dhe Mal të Zi numërohen 3 muaj vere) por edhe në pjesën tjetër të vitit. Çështjen e mësimit nga përvoja e vendeve të rajonit e konsiderojmë të rëndësishme shkaku i asaj se një numër i konsiderueshëm i vizitave në këto vende dhe në Kosovë bëhen nga vizitorët dhe turistët e vendeve të rajonit dhe në të njëjtën kohe regjistrohen lëvizje të turistëve nga një vend në tjetrin

si pjesë e paket aranzhmaneve për vizitorët p.sh, të Japonisë, dhe kjo e drejton çështjen ka nevoja për kooperim në lëmin e turizmit dhe më gjere. Çka përfiton vendi turistik më mbledhjen dhe ofrimin e të dhënave për turizmin, ofertën dhe kapacitetet në dispozicion, nga punimi dalin këto mundësi: e para është tërheqja e investitorëve për investim në industrinë turistike, e dyta është ngritja e performances në vetë vendet turistike karshi konkurrencës, dhe e treta promovimi i vendeve turistike duke përdorur konceptin e komunikimit të integruar të marketingut.

HAPAT E MËTEJME NË NDËRTIMIN E KONCEPTIT TË ZHVILLIMIT TË TURIZMIT NË NIVEL VENDI

Në baze të përvojave të deritanishme në turizëm dhe hotelieri, rajonet e Kosovës por edhe në nivel vendi do të duhej të ndërtojnë konceptin e bazuar në ndërtimin e identitetit të “Vendi Turistik”, i cili do të bëhet sinonim për vizitorët-shfrytëzuesit e ofertës ekzistuese turistike dhe përparimin e përmbajtjeve të reja të bazuara në trashëgimin kulturo-historike, më të cilën disponojnë rajonet dhe Kosova si destinacion turistik.

Mund të konstatojmë se zhvillimi i turizmit në Kosovë në përgjithësi ka qenë jo i koncentruar, e kjo duke ju falënderua faktit se edhe lokalitetet dhe destinacionet turistike janë të shpërndarë gjithandej, pra ka një disperzion në hapësirën e gjithë vendit, e që është shkak i faktorëve shoqëroro-ekonomik të ndryshëm nëpër rajone. Se a është ma mirë që zhvillimi i turizmit të jetë i koncentruar apo i shpërndarë në aspektin gjeografik, në nivelin e teorisë nuk mund të jepet një konstatim i prerë. Kjo sepse secila formë, edhe ajo kur zhvillimi i turizmit dhe hotelierisë bëhet më shumë dhe shpejt në disa rajone se në tjerat, por edhe kur zhvillimi i turizmit dhe hotelierisë është i koncentruar në të njëjtën kohë në tërë rajonet, apo në nivel vendi ka përparësitë krahasuese, dhe mangësitë, kështu që e sugjerojmë që arsyetimin e zhvillimit të koncentruar apo të shpërndarë-disperziv të vërtetohet sipas rasteve konkretë duke u bazuar edhe në caqet shoqëroro-ekonomike të cilat dëshirohet të arrihen më këtë zhvillim.

Ndërtimi dhe zhvillimi i ofertës turistike qoftë në mënyrë të koncentruar apo në mënyrë të shpërndarë nga rasti në rast, por edhe niveli i saj duhet pikësëpari të bazohet në plotësimin e kushteve të shfrytëzuesve aktual të ofertës së turizmit dhe hotelierisë, por edhe që duhet dhënë maksimumin që kjo ofertë e rajoneve gjeografike të Kosovës si “Destinacione turistike” të gjejnë vendin e duhur në: Ofertën turistike të Kosovës, Ofertën turistike të Regjionit të Ballkanit

Perëndimor, Ofertën globale të tregut turistik. Për të arrit këtë duhet që se pari të përcaktohet vendi dhe roli i turizmit dhe hotelerisë, në Kosovë duhet që të përcaktohen kahet dhe caqet strategjike të turizmit dhe hotelerisë si degë ekonomike, duke bërë:

- Identifikimin dhe valorizimin e potencialeve turistike duke u bazuar në qasjen strategjike për udhëheqjen më turizmin,
- Orientimin në krijimin e identitetit në tregun e turizmit global si “Destinacion Turistik”,

Sigurisht se është bërë mundë dhe punë në identifikimin e potencialeve ekzistuese por jemi të bindur se ka edhe shumë lokalitete turistike atraktive dhe segmente të destinacioneve turistike për vizitorët, të cilat duhet hulumtuar, përgatit, vënë në funksion, dhe zhvillu aktivitetet e marketingut për njoftimin e publikut më to. Marketingu i përdorur për destinacionet turistike duhet që të ndihmoj edhe në eliminimin e dëmeve të krijuara në imazhin jo të volitshme të vendit nga koha e krizës politike, luftës dhe kohës së tranzicionit deri te pavarësia, tek vizitorët e huaj por edhe ata vendas në disa raste.

Nëse nuk punohet sistematikisht në krijimin e imazhit pozitiv të vendit atëherë edhe zhvillimi i turizmit mund të mos jetë ai që në presim , por ky imazh duhet ndërtuar edhe me mundin dhe investimet në ruajtjen e trashëgimisë kulturo-historike, ruajtjen e ambientit, ruajtjen e baraspeshës ekologjike të florës dhe faunës, ujit dhe ajrit, si mundësi për të avancuar ofertën turistike me markën “ekologjike”. Është numëruar tek masat strategjike të zhvillimit të ekonomisë se Kosovës, turizmi dhe hoteleria si degë dhe aktivitet ekonomik do duhej të kenë shenjën e prioritetit, dhe më aktivizimin si partner i qeverisë dhe Institucioneve qe janë donator të projekteve në turizëm (USAID,GTZ,OJQ lokale, etj), ka marrë hov promovimi i turizmit dhe hotelerisë, si një ndër prioritetet në kuadër të zhvillimit të gjithëmbarshtëm ekonomik të Kosovës. Ndër shumë aktivitete që zhvillohen dallojmë atë për licencimi dhe kategorizimi i objekteve hotelier[MTI 2015], përkrahja e projekteve për ruajtjen e trashëgimisë kulturore, hartimi i ligjeve dhe politikave për përkrahje të turizmit.

MËNYRAT E ARRITJES SË REALIZIMIT TË KONCEPTIT TË ZHVILLIMIT TË TURIZMIT DHE HOTELERISË

Në mënyrë që të arrihet një zhvillim i qëndrueshëm ekonomik i vendit duhet patjetër që të mbështetet edhe industria turistike e Kosovës. Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik i një vendi arrihet më bashkëpunimin në nivel të institucioneve shtetërore dhe subjekteve ekonomike, por në

fakt ky bashkëpunimi do të duhet të bazohet në tre përbërësit e vetë, e ato janë: ekonomia, ekologjia dhe shoqëria e vendit. Këto tri dimensione të zhvillimit të qëndrueshëm janë në ndërveprimin e vazhdueshëm të ndërsjellë duke e plotësuar njëra tjetrën. [Ebner,D. & Baumgartner,R.J 2006].

Për të arrit këtë synim duhet që të stimulohet investimi i kapitalit në turizëm dhe hoteleri, këtu mendojmë edhe në Investimet e Huaja Direkte. Investimet e Huaja Direkte në Kosove në vitin 2012 ishin 232 milion euro që është për 41,2% më pak se në vitin 2011 , që është 5% të PBB që është një përkeqësim i dukshëm.[BQK 2012].Kapaciteti i investitorëve vendas është i vogël dhe i limituar, ndërsa investitorët e jashtëm të mëdhenj ende nuk kanë vendos të hyjnë në këtë regjion, pik së pari nga mungesa e informacioneve, rrethanat politiko-juridike, kriza financiare, etj. në Investimet direkte të huaja, dallojmë dy mënyra dominante të investimeve, të cilat janë:

Investimet horizontale direkte të Huaja, dhe Investimet vertikale direkte të huaj. Investimet horizontale direkte të huaja në fakte janë atëherë kur investohet në të njëjtën lëmi në shtetin tjetër , mundësia është që në këtë raste do të ishte që ndërmarrjet turistike nga Shqipëria (qofshin vendore apo më kapital të huaj) të investojnë në lëmin e turizmit në vendin tonë, apo e kundërta. Investimet Vertikale direkte të huaja në fakt na paraqiten në dy forma, e para atëherë kur investitori dëshiron që më investimin e bërë në vendin tjetër të arrij të siguroj inpute për procesin në vendin amë. E dyta është kur investitori dëshiron të investoj në një vend, të cilin do të shfrytëzonte për shitjen e outputeve të tij. Kur është fjala të investimet në turizëm, edhe këto forma janë të aplikueshme dhe kemi investitor nga lëmit e ndryshme që investojnë në transport, sport e rekreacion, vend parkingje për jahte,etj. Për të arrit një sukses në zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit, duhet që të shkojmë më tutje dhe si vend turistik duhet zhvilluar : aktivitete, përmirësuar kualitetin, dhe ngrit nivelin e komunikimit më tregun turistik vendor e deri të ai botëror.

2.1.Aktivitetet

Në funksion të zhvillimit më të shpejtë të ofertës turistike të rajoneve dhe të Kosovës si tërësi, planifikimin dhe zhvillimin e konceptit duhet shikuar në nivelin mikro dhe makro. Në nivelin mikro duhet: që në mënyrë adekuate të evidentohet dhe planifikohet zhvillimi i mikro lokacioneve turistike nëpër rajone. Në nivelin makro duhet :

- të hartohet, evidentohet dhe planifikohet ndërlidhja e mikro lokacioneve turistike në destinacione turistike rajonale dhe në nivel vendi,
- të identifikohen dhe planifikohen aktivitetet përcjellëse që janë në funksion të zhvillimit të turizmit (komunikacioni, pastërtia, legjislacioni etj.)
- të planifikohet dhe përkrahet zhvillimi i kapaciteteve turistike hoteliere dhe përmbajtjeve turistike plotësues (hotele, motele, pasione, kampingje, restorante, bife etj.) që do të ishte si parakusht i zhvillimit turistik.

Tabela 1. Pasqyra e numrit të bizneseve aktive sipas seksioneve ekonomik apo të regjistruara në lëmin e Turizmit dhe Hotelarisë në Kosovë, krahasuar më numrin e përgjithshëm të bizneseve në aktivitetet afariste tjera.

Viti	Gjithsej ndërmarrje të regjistruara gjatë vitit	Hotelet dhe Restorantet	% e Hoteleve dhe Restoranteve në numrin e ndërmarrjeve të regjistruara
2008	41,124	3,498	8,5%
2009	42,086	3,559	8,5%
2010	41,063	3,364	8,2%
2011	41,425	3,459	8,4%
2012	41,757	3,715	8,9%
2013	29,057	3,126	10,8%

Burimi: ESK 2015,

Në tabelë shihet numri dhe përqindja e ndërmarrjeve të përfshira në “Akomodimi dhe aktivitetet të shërbimeve më ushqim”, në Kosove krahasuar më numrin e përgjithshëm të ndërmarrjeve aktive. Aktivitetet të cilat do të duhej ndërmarr në nivel të rajonit turistik por edhe në nivel vendi për rritjen dhe zhvillimin konstant të ofertës turistike do të ishin:

- formimi dhe zhvillimi i asociacioneve dhe shoqatave në nivel rajoni dhe nivel vendi, që do të funksiononin si gjenerator i zhvillimit të turizmit si biznes fitimprurës.
- zhvillimi i ofertës turistike për tregun e vizitorëve një ditore,
- zhvillimi i ofertës turistike për turizmin kongresial dhe format tjera,
- përgatitja dhe zhvillimi i aktiviteteve marketingore domethënëse për regjionet dhe në nivel vendi.

Tërë këto do të jenë të rëndësishme për profilimin e mëtejshëm të mikro lokacioneve dhe makro lokacioneve në kuadër të zhvillimit të industrisë së turizmit dhe biznesit në përgjithësi. Kjo do të jetë e dobishme nga aspekti makro, ndërsa bashkëpunimi i mëtejshëm kah baza e piramidës do të sjellë koordinimin më të mirë të aktiviteteve individuale për përfitimin e përgjithshëm të bizneseve që marrin pjesë në industrinë turistike të Kosovës.

2.2 Kualiteti

Përpos të përmendurave më lartë, zhvillim të turizmit nuk mund të ketë pa zhvillimin e agjencioneve turistike të cilat janë ndërmjetësues në qarkullimin turistik. Duhet vërejt faktin se ato e kanë rolin e vetë në formimin e produkteve turistike, e nxitin dhe e drejtojnë kërkesën turistike, e mbështesin marketingun e destinacioneve turistike dhe përmbajtjeve interesante për vizitorët. Të bazohesh në emocionet pozitive të harxhuesve-vizitorëve ndaj ofertës ekzistuese nuk do të preferohej, në aspektin se vjen deri tek ngopja më ofertën turistike, rrjedhimisht duhet kushtuar rendësi kualitetit të shërbimeve në afat të gjatë. Domosdoshëmërishtë kualiteti në turizëm duhet të jetë në fokus të vëmendjes së akterve në turizmin e Kosovës, duke bërë përpjekje të vazhdueshme që të freskohen, apo ndërtohen gjithnjë mënyra të reja të ofrimit të shërbimeve në turizëm. Nga kjo rrjedhë se :

- kualiteti do të duhej të jetë nisma-mbarimi i çdo veprimi-aktiviteti të cilat ndërmerren dhe do të ndërmerreshin në të ardhmen,
- do të duhej insistuar në kualitetin më të mirë të mundshëm të gjithë produkteve-shërbimeve të cilat e përbejnë ofertën turistike në tregun turistik-hotelier i cili po bëhet gjithnjë e më përzgjedhës dhe i rafinuar,
- do të duhej krijua dhe vendos në afarizëm një standard i cili do të përmblihte “Kualitetin e Vlerave Regjionale”, të behët standardizimi i kualitetit të produkteve-shërbimeve që do të

ndihmoj në krijimin e imazhit për Ofertën Turistike të Kosovës dhe çështjet tjera të lidhura më të,

Krijimi dhe futja në veprim e standardeve të kualitetit do të ishte detyrë urgjente, e për këtë të thirru janë bizneset dhe institucionet.

2.3 Komunikimi

Zhvillimi i turizmit ka, dhe jep efekte pozitive në punë zënien e popullsisë lokale, në veprimtarit e ndryshme që ofrojnë produkte-shërbime për turistët dhe turizmin. Ky zhvillim i turizmit nëse bëhet në bazë të konceptit të marketingut, do të duhej që të krijohet një sistem informativ i cili do të mundësonte përcjelljen e zhvillimeve në nivel rajonesh, nivel vendi dhe në nivelin e tregut global të turizmit. Nevoja për të komunikuar e “Destinacionit Turistik” do të mbështetej në këto aspekte të komunikimit: Komunikimi Intern (Biznesi, komuniteti, vizitori-harxhuesi), Komunikimi më faktorët e jashtëm (mikro lokacionet, tregu në nivel vendi, tregu global), Komunikimi Miqs (komuniteti, destinacioni turistik, tregu i vendit, tregu global ndërkombëtar).

Destinacionet Turistike dhe Bizneset do të duhej të jenë të gatshëm dhe të kenë interes gjithnjë për zhvillimin e marrëdhënieve më mediet dhe publikun, në mënyrë të gjetjes së formave më të mira të marketingut-promovimit të turizmit Kosovar. Në varësi të asaj se si komunikohet në mesë të bartësve të këmbimit në turizëm, dallojmë edhe mjetet e ndryshme të përdorura të cila mund të jenë: a) mjetet konvencionale (TV, radio, shtypi,etj), dhe b) mjetet e specializuara (interneti, evinimentet, etj). Duhet potencuar gjithsesi se komunikimi nuk mund të bëhet vetëm në nivel të aktiviteteve marketingore të destinacionëve turistike.

KONKLuzion

Njohja e potencialit turistik të vendit dhe angazhimi për zhvillimin e turizmit si degë e rëndësishme ekonomike duhet të mbështetet në kombinimin e llojeve të ndryshme të ofertave të produktit turistik, duke e përfshi gjithnjë e më shume trashëgimin kulturo historike të cilën e disponojmë, dhe atyre të cilat janë në fazën e zbulimit dhe përgatitjes për vizitor. Çdo lloj plani dhe planifikimi për zhvillimin e turizmit në Kosovë, do të jetë vështirë të realizohet pa angazhimin dhe përfshirjen e të gjithë akterve të tregut turistik kosovar dhe partnerëve të interesuar nga tregu global turistik. Tradita e turizmit në Kosovë është relativisht e mangët duke pas parasysh historinë dhe situatën politike në të cilën ka kalua Kosova, por kjo nuk do duhej të

paraqes pengesë për angazhimin e ekspertëve ekzistues dhe atyre të edukuar rishtas në botën e jashtme për të krijuar një traditë autoktone, të bazuar në të arriturat e vendeve të zhvilluara turistike.

Është e nevojshme të përcaktohet se : Si, Kush dhe Kur do të marr leadershipin në zhvillimin e turizmit në vend. Komunikimi ndërmjet akterve të ofertës turistike por edhe më vetë turistët tregohet si domosdoshmëri dhe nevojë, në mënyrë që ti përgjigjemi pyetjeve të vazhdueshme të tij. E vërejmë trendin se turisti më nuk pyet se “ku do të shkojë në pushime” por e shtron pyetjen se “çfarë do të beje atje ku do shkoje”. Bartja e eksperiencës nga jashtë nëpërmes bashkëpunimit më vendet e regjionit dhe më gjerë duhet që të bëhet në mënyrë permanent, ashtu që të arrihet baraspeshimi i njohurive dhe dijes, bile më vendet në regjion që kanë ofertë të përafërt turistike. Bazuar në këto konstatime del si e nevojshme që të bëhet hulumtim intensiv për risit dhe ndodhitë në tregjet turistike. Implementimi i një sistemi Informativ mbi, dhe për turizmin Kosovar shihet si imperativ. Një planifikimi i turizmit i koncipuar mirë do të tregoj rrugën nga duhet të shkohet në zhvillimin e turizmit në rajonet e ndryshme dhe në nivel vendi në Kosovë. Si ndikim i zbatimit të këtij plani do të mundë të lindin projekte tjera që do të jenë burim i aktiviteteve tjera shoqërore dhe afariste, e që kanë të bëjnë direkt apo indirekt më zhvillimin degës se turizmit, por edhe në përgjithësi të zhvillimit ekonomik e kulturor të Kosovës.

Në këtë punim kemi bërë përpjekje që të japim kontribut në analizën e realitetit ekonomik në Kosovë, dhe faktorëve me ndikimin në zhvillimin e turizmit si një ndër faktorët e zhvillimit të qëndrueshëm të vendit. E për këtë rëndësi të madhe ka “punësimi i popullsisë” si një nga faktorët, dhe potencialet në të cilat duhet llogaritur, por edhe vlerësuar si të arriturat e zhvillimit të turizmit në vend në të ardhmen e afërt.

Referenca:

[1]Ebner,D. & Baumgartner,R.J. 2006. The relationship between Sustainable Development and Corporate Social Responsibility. www.crrconference.org

[2] McKinsey Global Institute, “An economy that works: Job creation and America’s future”, June 2011, available at

http://www.mckinsey.com/Insights/MGI/Research/Labor_Markets/An_economy_that_works_for_US_job_creation

- [3] Roli i planifikimit të Aktiviteteve të Marketingut në zhvillimin e vendit si destinacion turistik-në rastin e Kosovës, Konferencën e pestë shkencore ndërkombëtare „Investimet në funksion të zhvillimit ekonomik dhe proceset integruese“, Ulqin 5.04.2013.
- [4] Fatos Ukaj ” Trashëgimia kulturore dhe historike si potencial i zhvillimit të turizmit- me fokus në regjionet e Kosovës /Cultural and historical heritage in Kosova as a potential for development of tourism - focus on the Kosova regions”, University Library of Munich, Germany in its series [MPRA Paper](http://mpra.ub.uni-muenchen.de/21509/) with number 2159, <http://mpra.ub.uni-muenchen.de/21509/>
- [5] Fatos Ukaj, 2010, “Marketing Concept as a tool for Development of Tourism in Kosovo”, Journal of Environmental Management and Tourism(JEMT), Volume 1 issue1, ASERS, p 57-62.
- [1]Opendata.al, 2015, <http://open.data.al/sq/lajme/lajm/id/1076/titull/Vizitore-te-huaj-dhe-turiste-2013/> qasur 01.04.2015.
- [6] Instat-Instituti i statistikave i Shqiperis, 2009, http://www.instat.gov.al/media/100336/llogarite_rajonale_shqip.pdf
<http://www.instat.gov.al/media/99797/botim.pdf> , qasur 01.04.2015
- [7]Agjencia e statistikave të Kosovës, Rezultatet e Anketës Strukturore të Ndermarrjeve2008-2013. 2015, <https://ask.rks-gov.net/regjistri-statistikor-i-bizneseve/publikimet> qasja 11.02. 2015
- [8]Ministria e Tregtis dhe Industrise, 2015, <http://www.mti-ks.org/sq/Turizmi-dhe-Hoteliera>
KIESA, 2015, <http://www.invest-ks.org/sq/Trashegimia-Kulturore>
- [9]Banka qendrore e Kosovës, Raporti Vjetor 2012, <http://www.bqk-kos.org/repository/docs/2013/BQK-RV-2012.pdf>